SHABAN TAIRI

SQARIME ME DOBI NGA HADITHET KUDSI

1

SHKUP
2021

Titulli i librit:
SQARIME ME DOBI NGA HADITHET KUDSI

Autor:
Shaban Tairi

Recensent:
Prof.Dr. Bejadin Ameti
Mr. Hazir Selmani

Lektorë gjuhësor:
Prof. Vebi Rustemi

Kopertina:
Mujaser Mamuti

Tirazhi:
500 copë

Shtypi:
Shtypshkronja “Alma”, - Shkup; A.Makedonski, nr.42 b

HYRJE

Falënderimet dhe lavdërimet e panumërta i takojnë vetëm Krijuesit të universit, Allahut xh.sh. i Cili na pajisi me të gjitha të mirat, na krijoj në formën më të bukur, na udhëzoj në fenë e vërtetë dhe të vetmen të pranuar, na e shpalli Kuranin udhërrëfyes dhe na e dërgoj Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem si mësues. Përshëndetjet tona të përzemërta, i takojnë vulës së pejgamberisë, mëshirës për botërat, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe mbi familjen e tij të ndershme.

Lexues të nderuar, të marrësh guximin të shkruash për fjalët e Pejgamberit tonë, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është një përgjegjësi shumë e madhe, është një detyrë e rëndë, sepse fjalët e tija përbëjnë segment kryesor në fenë tonë Islame. Ai është sqaruesi i fjalës së Allahut xh.sh. dhe është interpretuesi i fesë. Por, nga ana tjetër, kënaqësia e leximit të fjalëve të Pejgamberit tonë sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe dëshira për të qenë sa më afër tyre, na bën të fortë, të qëndrueshëm që të përballojmë sfidat në përpilimin e një vepre të këtillë, në të cilën përmblidhen fjalët e më të dashurit tonë, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Ideja për të shkruar një vepër në të cilën përmblidhen *hadithet kudsije* ka ardhur si nevojë e kohës, kur në skenë paraqiten njerëz të cilët mohojnë hadithin e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe kundërshtojnë gjykimin sipas fjalëve të tij sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Nga iritimi i njerëzve të tillë që mundohen t`i largojnë besimtarët nga jeta dhe fjalët e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, me arsyetimin se muslimani duhet të ndjek vetëm Kuranin, morëm iniciativën që të përmbledhim një vepër dhe ta sjellim në gjuhën shqipe një koleksion me hadithe kudsij të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Po ashtu, këtë nismë e kemi filluar pasi kemi vërejtur zbrazëtirën shkencore në literaturën shqipe për një vepër me tematikë të tillë, sepse në gjuhën shqipe nuk kemi hasur në ndonjë libër i cili përmbledh dhe sqaron hadithet kudsije të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që ishte edhe një nxitje shtesë për të përfunduar këtë vepër.

Këto hadithe, përpos që i kemi përmbledhur në libër, të njëjtat i kemi sqaruar më parë edhe në xhami përgjatë ligjëratave të xhumasë. Pra, fillimisht e kemi përgatitur ligjëratën në formë të shkruar, e pastaj të njëjtën e kemi ligjëruar edhe në xhami, kuptohet të përshtatur për ligjëratë xhamie. Fillimi i këtyre ligjëratave ka qenë më datën 26.2.2016 kur është sqaruar hadithi i parë dhe të njëjtat i kemi përfunduar më 25.9.2019, që do të thotë janë realizuar në periudhë brenda 3 vite e 7 muaj.

Në këtë libër janë përmbledhur 205 hadithe kudsije të radhitura me renditje numerike, kurse shumë hadithe tjera kudsije i kemi sjellur brenda tekstit, të cilat kanë qenë të përafërta me hadithin bazë që është sqaruar në temë.

Hadithet kudsij të cilat përsëriten ose kanë tekst shumë të përafërt me njëra tjetrën, nuk i kemi shënuar, përpos nëse ka pasur ndonjë detaj të rëndësishëm që nuk e ngërthen tjetri.

Në këtë përmbledhje kemi shënuar hadithet kudsije të cilat gjenden nëpër kolekcionet më të njohura të hadithit, si librat Sahih el-Buhari, Sahihu`l-Muslim, katër Sunenet (Suneni Tirmidhiut, Ebu Davudit, Nesaiut dhe Ibni Maxhes), Musnedi i Ahmedit, Muvettau i Malikut, Suneni i Darimijut, Mu`xhem-et e Taberaniut, Suneni i Bejhekiut, Mustedreku i Hakimit dhe shumë vepra të tjera të cilat janë shënuar në fusnotë.

Për çdo hadith, është sjellur teksti në origjinal dhe i përkthyer në gjuhën shqipe. Në gjuhën arabe është shënuar teksti i plotë (me zinxhirin e transmetuesve dhe fjalën e Pejgamberit a.s.) kurse në gjuhën shqipe nuk i kemi përkthyer transmetuesit e hadithit në tërësi, por vetëm transmetuesin prej sahabëve, që të mos stërgjatet teksti dhe që lexuesi shqiptarë mos të lodhet me leximin e emrave të transmetuesve. Më pas ka vijuar sqarimi i hadithit përmes ajeteve dhe haditheve tjera të cilat e përforcojnë dhe e dëshmojnë temën e njëjtë.

Çdo hadith e kemi sjellur me referenca, se nga cili libër është marrë ai tekst dhe kemi dhënë detajet e librit bazë. Në disa situata për ndonjë hadith jemi mjaftuar t`i shënojmë vetëm dy kolekcionet e njohura të hadithit, "Sahih"-un e Buhari-ut dhe "Sahih"-un e Muslim-it, pasi janë prej kolekcioneve më të besueshme të hadithit dhe nuk kemi shënuar burime tjera. Në disa raste, kemi sjellur burimet edhe nga librat tjera.

Për disa hadithe, për të cilët dijetarët nuk kanë qenë unik se janë të vërtetë ose të dobët, e kemi shënuar duke përmendur edhe mendimet e dijetarëve

për atë hadith dhe arsyet e ndryshimit të mendimeve. Nëse ndonjë transmetues është i përfolur, kemi sjellur edhe mendimet e ekspertëve për vlerësimin e tij, se është i besueshëm ose jo.

Gjithashtu për disa hadithe kemi sjellur edhe kategorizimin e të njëjtit, si i saktë (sahih), i mirë (hasen), i dobët (daif) ose i falsifikuar (meudu`) nëse për të kemi gjetur vlerësim nga dijetarët e njohur të hadithit.

Nëse për ndonjë hadith kudsij kemi vërejtur që të gjithë dijetarët janë unik se është i falsifikuar ose shumë i dobët, ato nuk i kemi shënuar aspak.

Tekstin e hadithit kudsi, e kemi shënuar me ngjyrë të trashë (**bold**) dhe me shkrim të pjerrët *(Italic),* kurse ajetet kuranore, për t`i dalluar prej haditheve kudsi, i kemi shkruar vetëm me ngjyrë të trashë (**bold**). Hadithet që nuk janë kudsij, por janë hadithe të zakonshme të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem (nebevij), ato i kemi shkruar me tekst të pjerrët *(Italic),* kurse pjesa tjetër e materialit, është shkruar me shkrim të zakonshëm.

Fjalët që nuk janë të gjuhës shqipe por janë fjalë arabe, si *ajet, hadith, shefat, sheriat, shirk, kudsij,* e shumë fjalë tjera, edhe ato i kemi shkruar me shkrim të pjerrët *(Italic).* Shprehjet *xhel-le shanuhu* i kemi shkruar shkurtimisht me (xh.sh.), *alejhi selam* me (a.s.), *radijAllahu anhu* me (r.a.), ndërsa për *radijallahu anha* me (r.a.h.).

Librin e kemi ndarë në tema të ndryshme dhe në bazë të tyre kemi bërë radhitjen e haditheve kudsij. Është filluar me tema që flasin mbi çështjen e besimit, çështjet juridike, moralit dhe botës tjetër (ahiretit).

Për recenzimin e kësaj vepre, falënderoj profesorin tim të hadithit Prof. Dr. Bejadin Ameti dhe shokun tim të klasës në medrese, Mr. Hazir Selmani. Po ashtu, falënderoj edhe prof. Vebi Rustemi për lektorimin gjuhësor të veprës dhe shokun Mujaser Mamuti për dizajnimin e kopertinës. Po ashtu falënderoj edhe hoxhën Zeqirja Tairi nga Bukoviqi për sponzorizimin e kësaj vepre dhe që sot ta keni në duart tuaja.

Shpresojmë që nga ky libër të kemi dobi në botën tjetër, të vëndohet në peshoren e veprave tona të mira, të gjejë në të lexuesi udhëzim dhe të jetë një tullë e kontribut për shkencën e hadithit në gjuhën shqipe.

Çka është HADITH?

(Nocioni dhe kuptimi)

Hadith në aspektin gjuhësor do të thotë diçka e re, risi, ngjarje, e shumë kuptime të ngjashme.[1]

Në aspektin terminologjik, *hadith* do të thotë: "Çdo gjë që vjen përmes të Dërguarit të Allahut prej fjalëve, veprave, miratimeve të tij, cilësit fizike ose morale".[2]

Çka do të thotë hadith kudsi?

Në aspektin gjuhësor, *kudsi* do të thotë: *e pastër, pastërti*.[3]

Në aspektin terminologjik, *hadith kudsi* do të thotë: "Çdo fjalë që i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ia mbështet Allahut xh.sh., kurse formulimi është nga i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem".[4]

Hadithi kudsi ndonjëherë quhet edhe "hadith ilahi" ose "hadith rebanij".[5]

[1] Isa Memishi, "Fjalor arabisht-shqip", Logos-A, Shkup, 2014, vëll.1, fq.309;
[2] Amër Abdulmun`im Sulejmi, "Tejsiru Ulumi`l-Hadith", Daru Dija, fq.12; Muhamed Menshavi, "Kamus Mustalahatu`l-hadithu`n-Nebevij", Daru`l-Fadile, Kajro, fq.53;
[3] "El-Mu`xhemu`l-Vesit", botimi i dytë, Kajro, 1973, vëll.2, fq.719;
[4] Muhamed Menshavi, "Kamus Mustalahatu`l-hadithu`n-Nebevij", fq.54;
[5] Abdulmaxhid el-Gauri, "Mausuatil ulumil hadith", Daru Ibni Kethir, Damask-Bejrut, botimi i parë, 2007, vëll.2, fq.34;

Veçoritë e hadithit kudsij

Frymëzimin e këtij lloji të hadistheve Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka marrë përmes frymëzimit të natyrshëm (ilham) ose në gjumë. Inspirimi ka ardhur drejtpërdrejt nga Zoti, kurse formulimi i fjalëve është bërë nga vet Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Në hadithet kudsije, zakonisht flitet mbi çështje të besimit, udhëzimit, mëshirës, inkurajimit, kërcënimit, amshimit, asketizmit, moralit, e tema të ngjashme.

Hadithi kudsi zakonisht fillon me shprehjet: "Ka thënë Allahu xh.sh.", "Thotë Allahu xh.sh.", Thotë Zoti" e shprehje të ngjashme. Ndonjëherë nga konteksti i hadithit kuptohet se bëhet fjalë për hadith kudsi edhe nëse hadithi nuk fillon me këto shprehje.

Dallimi mes Kuranit dhe hadithit kudsi

Duhet të dijmë se edhe Kurani, edhe hadithi kudsi si dhe hadithi nebevij, e kanë një pikë të përbashkët, që është shpallja hyjnore, sepse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem çdo herë që ka folur diçka në emër të fesë, e ka bërë përmes shpalljes, e nuk ka folur asgjë nga hamendja, siç thotë Zoti në Kuran: "**Ai nuk flet nga hamendja, porse çdo gjë është shpallje që i shpallet atij".**[6]

Dijetarët janë unik se Kurani, hadithi kudsi edhe hadithi nebevij, e kanë kuptimin nga Allahu xh.sh. porse Kurani si shprehjen ashtu edhe kuptimin e ka nga Allahu xh.sh., kurse sa i përket hadithit kudsi, kuptimi i tij është nga Allahu xh.sh. por shprehja ose formulimi i fjalës është nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Vetë fakti, se fjalët e Kuranit quhen ajet ose sure, kurse fjalët e hadithit kudsi quhen hadith, e jo ajet, kuptojmë se ka dallim rrënjësor në mes tyre.

[6] Kurani, Nexhëm, 3-4;

Kurani ndërlidhet drejtpërdrejt me Allahun xh.sh. prandaj thuhet me rastin e transmetimit `ka thënë Allahu`, kurse hadithi Kudsij ndërlidhet me Allahun xh.sh. përmes Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, prandaj thuhet `ka thënë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem se Allahu xh.sh. ka thënë`.

Kurani ka zbritur përmes melekut Xhibril a.s. kurse hadithi kudsij, ka ardhur në mënyra të ndryshme, si shpallje, inspirim, ëndërr, etj.

Kurani është mrekulli për botën njerëzore dhe xhinëve, mrekulli për të gjitha kohët dhe është i mbrojtur nga ndryshimi, kurse hadithi kudsij nuk është mrekulli ngjashëm si çdo hadith tjetër i zakonshëm, por senedi është ai i cili e përcakton rangun, përkatësisht nivelin e hadithit dhe ka mundësi të devijohet, pasi ekzistojnë hadithe kudsij të dobëta bile dhe të falsifikuara.

Kurani është i mbrojtur nga ndryshimi, kurse hadithi kudsij nuk është i mbrojtur.

Kurani nuk ka asnjë gabim ose lëshim, sepse është i mbrojtur nga ana e Zotit nga çdo formë e ndryshimit, sa i përket hadithit kudsij, është e mundur që transmetuesi të ketë bërë ndonjë lëshim gjatë përcjelljes së hadithit, mu për këtë edhe ekzistojnë hadithe kudsije që janë të dobëta për nga transmetimi.

Në Kuran nuk ka mundësi të ndërfutet diçka jashta fjalës së Zotit, kurse te hadithet kudsije ka mundësi të ketë ndërfutur ndonjë transmetues diçka prej *israilijateve* (tregimeve nga popujt e feve qiellore).

I gjithë teksti i Kuranit është i përcjellur me transmetim të njëpasnjëshëm (mutevatir), kurse hadithi kudsi nuk është i tillë, prej haditheve kudsije ka edhe që janë përcjellur nga një transmetues (ahad) dhe ka të tillë që janë të dobët ose të falsifikuar.

Teksti i Kuranit është mrekulli edhe në aspektin e tekstit, gjithashtu edhe në aspektin e kuptimit, kurse hadithi kudsi nuk e ka tekstin mrekulli, por vetëm kuptimin.

Leximi i Kuranit konsiderohet adhurim, leximi i hadithe kudsije jo.

Leximi i një shkronje të Kuranit i ka dhjetë shpërblime, kurse leximi i hadithe kudsi nuk e ka këtë veçori.

Leximi i Kuranit në namaz është farz, e nëse lexojmë hadithe kudsije, namazi prishet.

Në Kuran nuk lejohet transmetimi sipas kuptimit, e as ndryshimi i ndonjë fjale ose shkronje, kurse hadithi kudsi lejohet të transmetohet sipas kuptimit, por duke pasur parasysh disa kushte të caktuara.

Kurani nuk lejohet të transmetohet me kuptim por vetëm tekstualisht, ndërsa hadithi kudsi lejohet.

Kurani ndalohet të preket pa abdes dhe duke qenë i papastër (xhunub), për dallim nga *hadithi kudsi* që lejohet prekja dhe leximi i tij pa abdes.

Mohuesi i Kuranit është *kafir* (pabesimtar), kurse mohuesi i hadithit kudsi është *fasik* (mëkatar).

Dallimi mes hadithit kudsi dhe hadithit nebevij

Sipas një konstatimi, hadithi kudsij e ka kuptimin prej Zotit, kurse tekstin e formulon Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndërsa hadithi nebevij kuptimin edhe tekstin e ka të formuluar prej Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Hadithin kudsij Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e mbështet tek Zoti, kurse hadithet tjera i shpreh me fjalët e veta.

Në hadithet kudsije shohim se konteksti aludon në fjalët e Zotit, kurse në hadithet nebevij, ndonjëherë përfshihen edhe përshkrimet e sahabëve ndaj veprimeve të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Hadithet kudsije më shumë flasin mbi çështjen e Zotit, besimit (imanit), botës tjetër (ahiretit), kurse hadithet e zakonshme përpos këtyre temave kanë edhe dispozita dhe ligje të caktuara.

Hadithet e zakonshme janë me mijëra, kurse hadithet kudsije janë disa qindra.

Dijetarët dhe librat që kanë shkruar për hadithet kudsi

Hadithet kudsije janë të regjistruara nga dijetarët e hadithit që në kohën e koleksionimit të tyre, por janë shkruar bashkë me hadithet tjera, më vonë filluan të përpilojnë koleksione të veçanta në të cilat do të përfshihen vetëm hadithet kudsij. Prej autorëve më të njohur që kanë tubuar këtë lloj hadithi në libër të veçantë mund të përmendim:

Zahir b. Tahir en-Nisaburi (vd.533 h) ka shkruar librin "El-ehadithu`l-Ilahijat" ku ka përmbledhur 449 hadithe kudsij.

Abdulganij b. Abdulvahid el-Makdisiu (vd.600 h) ka shkruar librin "El-Erbeine min kelami rabbil alemine".

Hafidh Ali b. Mufadal el-Humi el-Maliki (vd.611 h) shkroi në librin e tij 40 hadithe kudsij.

Muhjidin el-Arabiu (vd.638 h) ka shkruar librin "Mishkatu`l-Envar fima reva anilahi subhanehu minel ehbar", ku tuboi njëqind hadithe kudsij.

Ebu Kasim Belban el-Makdisiu (vd.684 h) në librin "El-Mekasidu`s-Sunije fi ehadithi`l-ilahije", ka përmbledhur 100 hadithe kudsij.

Hafidh Salahudin ebu Seid Kejkeldi el-Alaiu (vd.761 h) ka shkruar mbi katërdhjetë hadithe kudsije duke shkruar edhe verifikimin e tyre.

Abdurahman b. Dibi esh-Shejbani (vd.944 h) i cili shkroi librin "El-Ehadithu`l-Kudsijeti", ka përmbledhur 80 hadithe.

Mul-la Ali el-Kariu el-hanefi (vd.1016) në librin e tij "Ehadith el-Kudsije el-erbainije" përmbledh 40 hadithe.

Abdureuf Munaviu (1035 h.) shkroi librin "El-Itihafat es-sunije bil ehadithi`l-kudsije" përmblodhi mbi 272 hadithe.

Muhamed b. Mahmud b. Salih et-Terbezuni el-Hanefi (vd.1200 h), në librin e tij "El-Itihafat es-sunije fi ehadithi`l-kudsije", përmblodhi 864 hadithe kudsije.

Xhemal Muhamed Ali Shukejri në veprën “El-Ehadithu`l-Kudsije” ka regjistruar 400 hadithe kudsije.

Mustafa b. Adevi, në veprën “Sahih Musned minel ehadithi`l-kudsije” radhiti 185 hadithe kudsi që janë Sahih.

Muteveli esh-Sha`ravi ka shkruar librin “Ehadithu`l-Kudsije” të përmbledhur me 50 hadithe në dy vëllime.

Umer Ali Abdullahu në librin e tij “El-Ehadithu`l-Kudsije, xheman ve dirasan”, në dy vëllime, në të ka përmbledhur 482 hadithe.

Abduselam b Muhamed b Alushi në “Kitab Xhamiu fi ehadithi`l-Kudsije” ka përmbledhur 772 hadithe kudsij.

Isamudin Sababetiju në “Xhamiu`l-Ehadithi`l-kudsije” të cilën e ka përmbledhur në tre vëllime, ka regjistruar 1.150 hadithe kudsi, ka përmbledhur të gjitha transmetimet, qofshin ato të dobëta, të falsifikuara dhe të vërteta etj.

IMANI, TEUHIDI DHE SHIRKU

HADITHI I PARË (1)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ بَهْرَامَ الدَّارِمِيُّ، حَدَّثَنَا مَرْوَانُ يَعْنِي ابْنَ مُحَمَّدٍ الدِّمَشْقِيَّ، حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ، عَنْ رَبِيعَةَ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ أَبِي إِدْرِيسَ الْخَوْلَانِيِّ، عَنْ أَبِي ذَرٍّ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فِيمَا رَوَى عَنِ اللهِ تَبَارَكَ وَتَعَالَى أَنَّهُ قَالَ: «يَا عِبَادِي إِنِّي حَرَّمْتُ الظُّلْمَ عَلَى نَفْسِي، وَجَعَلْتُهُ بَيْنَكُمْ مُحَرَّمًا، فَلَا تَظَالَمُوا، يَا عِبَادِي كُلُّكُمْ ضَالٌّ إِلَّا مَنْ هَدَيْتُهُ، فَاسْتَهْدُونِي أَهْدِكُمْ، يَا عِبَادِي كُلُّكُمْ جَائِعٌ، إِلَّا مَنْ أَطْعَمْتُهُ، فَاسْتَطْعِمُونِي أُطْعِمْكُمْ، يَا عِبَادِي كُلُّكُمْ عَارٍ، إِلَّا مَنْ كَسَوْتُهُ، فَاسْتَكْسُونِي أَكْسُكُمْ، يَا عِبَادِي إِنَّكُمْ تُخْطِئُونَ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ، وَأَنَا أَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا، فَاسْتَغْفِرُونِي أَغْفِرْ لَكُمْ، يَا عِبَادِي إِنَّكُمْ لَنْ تَبْلُغُوا ضَرِّي فَتَضُرُّونِي وَلَنْ تَبْلُغُوا نَفْعِي، فَتَنْفَعُونِي، يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوَّلَكُمْ وَآخِرَكُمْ وَإِنْسَكُمْ وَجِنَّكُمْ كَانُوا عَلَى أَتْقَى قَلْبِ رَجُلٍ وَاحِدٍ مِنْكُمْ، مَا زَادَ ذَلِكَ فِي مُلْكِي شَيْئًا، يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوَّلَكُمْ وَآخِرَكُمْ وَإِنْسَكُمْ وَجِنَّكُمْ كَانُوا عَلَى أَفْجَرِ قَلْبِ رَجُلٍ وَاحِدٍ، مَا نَقَصَ ذَلِكَ مِنْ مُلْكِي شَيْئًا، يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوَّلَكُمْ وَآخِرَكُمْ وَإِنْسَكُمْ وَجِنَّكُمْ قَامُوا فِي صَعِيدٍ وَاحِدٍ فَسَأَلُونِي فَأَعْطَيْتُ كُلَّ إِنْسَانٍ مَسْأَلَتَهُ، مَا نَقَصَ ذَلِكَ مِمَّا عِنْدِي إِلَّا كَمَا يَنْقُصُ الْمِخْيَطُ إِذَا أُدْخِلَ الْبَحْرَ، يَا عِبَادِي إِنَّمَا هِيَ أَعْمَالُكُمْ أُحْصِيهَا لَكُمْ، ثُمَّ أُوَفِّيكُمْ إِيَّاهَا، فَمَنْ وَجَدَ خَيْرًا، فَلْيَحْمَدِ اللهَ وَمَنْ وَجَدَ غَيْرَ ذَلِكَ، فَلَا يَلُومَنَّ إِلَّا نَفْسَهُ» قَالَ سَعِيدٌ: كَانَ أَبُو إِدْرِيسَ الْخَوْلَانِيُّ، إِذَا حَدَّثَ بِهَذَا الْحَدِيثِ، جَثَا عَلَى رُكْبَتَيْهِ.

Transmeton Ebu Dherr el-Gifariju radijeAllahu anhu se Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu xhele she`nuhu:* ***"O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar padrejtësinë Vetvetes dhe e kam bërë atë të ndaluar në mesin tuaj, andaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit!***
O robërit e Mi! Të gjithë jeni të devijuar, përpos atë që e kam udhëzuar Unë, andaj kërkoni udhëzimin, do t`ju udhëzoj!
O robërit e Mi! Të gjithë jeni të uritur, përpos atë që e ushqej Unë, pra, kërkoni që t`ju ushqej dhe do t`ju ushqej!
O robërit e Mi, të gjithë ju jeni të zhveshur, përveç atyre që Unë i kam veshur, pra kërkoni veshjen Time dhe Unë do t'ju vesh!
O robërit e Mi, ju bëni mëkate natën dhe ditën, e Unë ua fshij të gjitha mëkatet, pra kërkoni nga Unë falje dhe Unë do t'ju fal!
O robërit e Mi, ju nuk arrini dot dëmtimin Tim që të më dëmtoni dhe as mirësinë Time e të më bëni mirë!
O robërit e Mi, edhe nëse prej të parit e deri tek i fundit prej njerëzve dhe xhinëve kanë zemrën e më të devotshmit tuaj, kjo nuk do t`i shtonte sundimit Tim asgjë!
O robërit e Mi, edhe nëse prej të parit e deri tek i fundit prej njerëzve dhe xhinëve kanë zemrën e më të ligtit tuaj, kjo nuk do t`i pakësonte sundimit Tim asgjë!
O robërit e Mi, nëse prej të parit e deri tek i fundit prej njerëzve dhe xhinëve, të tubohen në një vend dhe të më luten dhe Unë i përgjigjem lutjes së çdonjërit prej jush, kjo nuk do të pakësonte nga ajo që kam tek Unë, pos aq sa mund të merr gjilpëra nëse futet në ujin e detit!
O robërit e Mi, këto janë veprat tuaja, të cilat tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, e për to Unë do t'ju shpërblej. Pra, ai që gjen mirë le ta falënderojë Allahun, ndërsa ai që gjen keq, le të mos e fajësoj askënd pos vetvetes!".[7]

[7] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab tahrimu`dh-dhulm (15), nr.2577 Daru Ibni Hazëm, Kajro, botimi i parë, 2010; Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", Dëshmia botime, Shkup, 2010, nr.490; Ahmed-i, "Musned", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 2001, tahkik Shuajb el-Arnauti, 35/332, nr.21.420; Hakim-i, "Mustedrek", Daru`l-Kutubi`l-Ilmije, Bejrut, 2002, 4/269, nr.7606 dhe thotë se ky hadith është Sahih sipas kushteve të imam Buhari-ut dhe imam Muslim-it, por ato nuk e kanë regjistruar me këtë përmbajtje; Ebu Nuajm-i, "El-Hilje", Daru`l-Fikr, 1996, vëll.5, fq.125-127 dhe thotë se hadithi është Sahih; Po ashtu me zinxhir tjetër nga Ebu Dherri radiaAllahu anhu e shënojnë edhe Tirmidhiu, në "Sunen", Daru`l-Fikër, Bejrut, 2008, kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 48, nr.2503 dhe thotë se hadithi është Hasen; etj.

Seid b. Abdu`l-Azizi ka thënë: "Ebu Idriz el-Haulani çdoherë kur e tregonte këtë *hadith*, ulej në gjunjë". Këtë e vepronte në shenjë respekti ndaj këtij *hadith*-i madhështorë. Ndërsa imam Ahmedi ka thënë: "Ky është *hadith*-i më i ndershëm që na ka ardhur nga banorët e *Sham*-it".[8]

Zoti e fillon këtë *hadith* me një thirrje që e nderon qenien rob, duke e thirr: "O robi Im".

Ai që mediton për *hadith*-in e lartpërmendur, ai e kupton se Zoti është Bujar dhe Fisnik, i Cili krijesave u flet me butësi për t`ua përfituar zemrat, prandaj thotë: "O robërit e Mi", për t`i nderuar dhe ngritur ata, por edhe për ta treguar famën e Vet.

Nga ky *hadith* i ndershëm dhe madhështorë që e përcjell i Dërguari i Allahut nga Zoti, shohim se Allahu xhele she`nuhu e ka ndaluar padrejtësinë për Veten, ngase çdo gjë që bën Allahu xh.sh. ajo asnjëherë nuk është padrejtësi, sepse atë e ka ndalur. Allahu xh.sh. nuk i bën padrejtësi ndonjë krijese, siç thotë edhe vet Ai në Kuranin Fisnik: **"Unë nuk jam i padrejtë ndaj robërve".**[9] Po ashtu në një tjetër *ajet* thotë: **"E Allahu nuk e do padrejtësinë për njerëzit".**[10] Gjithashtu Zoti na bën me dije se nuk i donë ata që janë të padrejtë dhe kryejnë padrejtësi në mesin e njerëzve, duke thënë: **"...All-llahu nuk i do të padrejtët".**[11]

Në bazë të kësaj, njeriu duhet të jetë i sigurtë se do të marr vetëm atë që ka punuar, e Zoti nuk i bën padrejtësi duke ia ngarkuar mëkatet e dikujt tjetër, ose t`i shtojë mëkate më tepër sesa ato që i ka vepruar. Kjo është kështu, për shkak se Zoti e ndaloi padrejtësinë për Veten dhe nuk i kryen padrejtësi asnjë krijese as sa një grimcë, duke ia dhënë çdokujt atë që e meriton në bazë të veprimit të tij, andaj nuk e toleron padrejtësinë në mes njerëzve, kështu që na urdhëron të mos e aplikojmë atë në kontestet tona.

Zoti e ndaloi çdo formë të padrejtësisë, qoftë ajo padrejtësi ndaj vetes, qoftë padrejtësi ndaj njerëzve tjerë. Forma më e keqe e padrejtësisë ndaj vetes, është njeriu të bjerë në baltën e *shirk*-ut, që është mëkati më fatal që mund ta

[8] Mul-la Ali el-Kariu, "Kitabu`l-Ehadithi`l-Kudsijjeti`l-Erbainijjeti", Mektebetu`s-Sahabe, Xhidde, fq.44;
[9] Kurani, Enfal, 51;
[10] Kurani, Ali Imran, 108;
[11] Kurani, Ali Imran, 57;

kryejë njeriu. Kështu na tregoi Zoti në Kuran ku tha: **"Sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe".**[12] Gjithashtu e ndaloi edhe padrejtësinë ndaj të tjerëve, siç tregoi edhe i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem në *hadith* kur tha: *"Gjaku i juaj, pasuria e juaj dhe nderi i juaj, janë të ndaluar që të nëpërkëmben në mes jush, siç është e ndaluar kjo ditë, në këtë muaj në këtë vend".*[13] Këtë e tha Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Ditën e *Arafat*-it, që ishte ditë e *xhuma*, në muajin e shenjtë *Dhul-Hixhe*, në vendin e shenjtë *Arafat*.

Padrejtësia është errësirë e shpirtit në këtë botë dhe errësirë për njeriun në Botën Tjetër, siç tha edhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Padrejtësia është errësirë në Ditën e Gjykimit".*[14]

Ky *hadith kudsij*, nxjerr në pah varshmërinë e krijesës për Krijuesin Absolut, i Cili e furnizon çdo gjallesë me atë që i nevojitet, askush nuk mund ta sigurojë vetveten pa ndihmën e Zotit. Kështu që Zoti na bën me dije se njeriu është i pafuqishëm dhe i dobët nëse Zoti nuk e mbështet. Të gjithë njerëzit kanë nevojë për Zotin në plotësimin e nevojave të tyre dhe eliminimin e asaj që u shkakton dëm edhe në gjërat fetare dhe në gjërat e kësaj bote. Nga gjithë kjo, njerëzit nuk posedojnë asgjë.

Udhëzimi është një mirësi që Zoti ia jep atij që dëshiron, e nëse Zoti e lë dikë në lajthitje, ai nuk mund të gjejë udhëzim, pos nëse e mëshiron Ai. Nuk mundet krijesa të arrijë diçka pa vullnetin e Zotit, pa marrë parasysh se sa përpiqet, andaj duhet të mbështetet plotësisht në Zotin e qiejve dhe tokës, i Cili ndihmon në udhëzim dhe mirësi.

Zoti i kritikoi ashpër idhujtarët të cilët adhuronin edhe idhujt krahas Tij, duke u treguar atyre se idhujt nuk janë në gjendje të veprojnë asgjë, ata nuk munden të udhëzojnë njeriun për kah e mira, e si të adhurohen ata krahas Atij i Cili udhëzon dhe drejton kah udhëzimi?! Zoti thotë në Kuran: **"Thuaj: "A ka ndokush prej idhujve tuaj që ndonjë të humbur ta drejtojë në rrugën e drejtë?" Thuaj: "Vetëm All-llahu udhëzon në të vërtetën. Atëherë pra, a është më e drejtë të shkohet pas Atij që udhëzon në rrugën**

[12] Kurani, Lukman, 13;

[13] Buhari-u, "Sahih", Elfa, Kajro, botimi i parë, 2010, kitab el-Ilmu, bab kauli nebiji: rubbe mubel-legin min samiin, nr.67; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Kasametu, bab teglidhu tahrimi`dimai.., nr.1679; etj.

[14] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Medhalimi, bab edh-dhulmu dhulumatun jaume`l-kijameti, nr.2447; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab tahrimu`dh-dhulmi, nr.2579; etj.

e drejtë, apo pas atij që nuk udhëzon, (sepse nuk mund të udhëzojë as vetveten) vetëm nëse prej dikujt tjetër udhëzohet?" Ç'është me ju? Si gjykoni kështu?"[15]

Prandaj, Zoti tregoi se as pejgamberët e askush tjetër nuk e ka mundësinë të udhëzojë njerëzit në rrugën e drejtë, përpos se të thërras në atë rrugë, kurse nga Zoti varet se a do ta udhëzojë dikë ose jo. Se udhëzimi është e drejtë ekskluzive e Zotit të gjithësisë, e gjejmë në Kuran ku thuhet: **"**...**Ai udhëzon në rrugën e drejtë atë që do"**[16] si dhe në *ajet*-in tjetër: **"Atë që e udhëzon Allahu, ai është me të vërtetë i udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjesh për të ndihmës që do ta udhëzonte".**[17]

Vet Ai na mësoi që të kërkojmë udhëzimin, gjersa e lexojmë suren Fatiha përgjatë çdo namazi, kur themi: **"Na udhëzo në rrugën e drejtë"**, pra, që në fillim të Kuranit, na bëhet me dije se Ai që udhëzon është Allahu xhele she`nuhu. Kërkimi i udhëzimit në suren Fatiha, gjë e cila përsëritet në çdo namaz, është një mesazh që njeriu të kuptojë dobësinë e tij të përhershme, nevojën për korigjim në çdo kohë dhe heqjen e mundësisë për të qenë i kënaqur në mënyrë absolute me veten.

Më pas, Zoti na lajmëron për një aspekt tjetër, ajo është ushqimi dhe furnizimi i krijesave. Zoti na lajmëron se çdokush është i varur për Zotin, saqë as kafshatën e gojës nuk mund ta sigurojë pa ndihmën e Tij, sepse Ai është që garanton furnizimin e krijesave me ushqim. Njeriu pa marrë parasysh se sa do të përpiqet, përsëri do të arrijë vetëm atë që i është caktuar nga Zoti, e nuk mund të arrijë diçka në mënyrë të pavarur. Prandaj, në këtë pjesë, Zoti na tregon se jemi të varur prej Tij, kështu që duhet të kërkojmë ushqim prej Zotit, që të na furnizojë me më të mirat që ka në pronësi të Tij dhe pastaj t`i marrim shkaqet që *risku* i Zotit t`na arrijë, e jo të mendojmë se ne jemi ata që arrijmë të sigurojmë kafshatën për vete dhe për familjet tona. Zoti thotë në Kuran: **"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë siguruar furnizimin e vet".**[18] Pra, Allahu xh.sh. është Furnizuesi i vërtetë, e jo krijesat. Dhe Zoti u jep ushqim të tjerëve, e vet nuk ka nevojë për të, siç thotë në Kuran**: "**..**i ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet..".**[19]

---

[15] Kurani, Junus, 35;
[16] Kurani, Bekare, 142;
[17] Kurani, Kehf, 17;
[18] Kurani, Hud, 6;
[19] Kurani, El-En`am, 14;

Zoti kërkon prej nesh që ne Atij t`i lutemi për furnizim, të mos lusim dikë tjetër pos Tij, sepse kjo është një padrejtësi, ngase kërkojmë prej atyre që nuk posedojnë asgjë, ndërsa nuk kërkojmë prej Atij i Cili është Pronari Absolut i të gjitha mirësive. Kështu që Zoti na mëson të lutemi që të kërkojmë prej Tij. Ai do të na plotësojë nevojat tona.

Pa Zotin, të gjithë do të ishin të humbur në humbje të madhe, në varfëri të skajshme dhe në mëkate të shumta. Mirëpo, Ai nuk është i kënaqur që robërit e Tij të jenë në mosbesim, varfëri dhe humbje.

Në mënyrë të njëjtë Zoti na nxit edhe për kërkimin e begative tjera, siç është veshja dhe mbulimi i trupit, sepse njeriu si qenie është i zhveshur dhe si i tillë lind prej nënës së vet, por me begatinë e Zotit, arrin të sigurojë tesha që të mbulojë pjesët e turpshme të trupit. Zoti zbriti enkas për qenien njeri, tesha që ta dallojë nga të gjitha krijesat, duke i dhënë pamjen më të mirë, si në aspekt të formës të trupit, po ashtu edhe në aspektin e pamjes së jashtme, duke e mbuluar me tesha të përshtatshme. Kështu Zoti thotë në Kuran: **"O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendet e turpshme dhe petk zbukurues...".**[20]

Prandaj, edhe kjo mirësi është pronë e Zotit, kështu që kur të kërkojmë këtë mirësi, duhet ta kërkojmë prej Pronarit të Përgjithshëm i Cili posedon çelësat e qiejve dhe të tokës.

Pasi Zoti tregoi se është Furnizuesi i jonë, i Cili na furnizon me të gjitha mjetet e nevojshme për jetë, na tregoj se Ai është edhe falësi i mëkateve tona, të cilat i kryejmë gjatë tërë kohës, kështu që nëse kërkojmë falje, duhet t`i drejtohemi Atij i Cili pranon faljen e robërve të Vet, të cilët e kanë ngarkuar veten me mëkate. Zoti na bëri me dije se njeriu kalon tërë kohën duke kryer mëkate, si ditën ashtu edhe natën, e kush mund t`i fal këto mëkate të shumta, përpos Falësit të Gjithëmëshirshëm?!

Zoti kërkon prej neve që t`i drejtohemi Atij me kërkimin e faljes, sepse nuk mund të na fal mëkatet dikush tjetër përpos Tij. Zoti na tregon në Kuran, që nuk duhet t`i humbim shpresat nga Mëshira e Zotit, saqë na thotë: "**O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar veten me mëkate, mos i humbni shpresat nga Mëshira e Zotit, sepse Allahu i fal të gjitha mëkatet".**[21]

[20] Kurani, A`raf, 26;
[21] Kurani, Zumer, 53;

Nuk ka *ajet* më madhështor se ky, i cili u jep shpresë njerëzve të ngarkuar me mëkate, se ka Zot i Cili fal gabimet dhe të kaluarën tonë, andaj mos i humbni shpresat, sepse Zoti fal mëkatet e robërve të Tij. Dyert e faljes janë të hapura për ata të cilët kanë humbur nga rruga e udhëzimit. I Dërguari i Zotit na tregoj se nuk ka njeri pa mëkate, porse më i miri prej tyre është ai që pendohet dhe kërkon falje për mëkatet e tija, andaj edhe ky *hadith kudsij* na udhëzon në kërkimin e faljes pas çdo mëkati që e bëjmë.

Vetëm Ai i Cili njerëzit i krijon, i udhëzon, i furnizon, u jep jetë ose vdekje, u fal mëkatet dhe i mirëmban, meriton të jetë i adhuruar dhe i denjë që t`i robërohen krijesat.

Ky *hadith,* është argument se Zoti dëshiron që njerëzit nga Ai të kërkojnë për të gjitha nevojat e tyre fetare dhe të kësaj bote, siç janë ushqimi, pija, veshmbathja dhe gjëra tjera deri te udhëzimi dhe falja e mëkateve.

Pasi ky *hadith* tregon atributet e përsosura të Allahut xhele she`nuhu, në vazhdimësi na tregon edhe për një Cilësi tjetër të Zotit, që është Fuqia dhe mos varja e Tij prej krijesave. Zoti nuk është i nevojshëm për asgjë, Atij nuk i nevojitet adhurimi i jonë, porse ne kemi nevojë që ta adhurojmë. Zoti nuk ka nevojë për ne, kurse ne kemi nevojë për Të. Nëse njerëzit do të dëshironin ta dëmtojnë Zotin në ndonjë farë mënyre, atë nuk do ta arrinin asnjëherë, sepse Zoti është Plotëfuqishëm në mënyrë Absolute, andaj nuk mundet krijesa ta dëmtojë Krijuesin. Por edhe e kundërta, nëse njeriu dëshiron t`i bëjë mirë Zotit, ai nuk do të arrijë të shtojë diçka në pushtetin absolut të Tij, kështu që te Zoti nuk ndryshon gjendja, pa marrë parasysh kontributin e njeriut.

Në vijim, Zoti na bën me dije, se sikur të gjithë njerëzit, duke filluar prej te Ademi alejhi`s-selam dhe deri te njeriu i fundit që do të ekzistojë në këtë botë, të tubohen në një vend, po ashtu të jenë aty prezent edhe të gjithë *xhin*-ët, të cilët kanë ekzistuar që nga fillimi i tyre dhe deri në fund, që të gjithë të mundohen bashkërisht të jenë të mirë dhe të devotshëm, si njeriu më i mirë në rruzullin tokësor, këta nuk do të arrijnë të shtojnë diçka në pushtetin e Zotit, pasi njerëzit me adhurimin e tyre nuk i bëjnë dobi Atij, por vetes. Zoti është i panevojshëm për adhurimet tona.

Edhe të kundërtën e vërteton Zoti, ku thotë se nëse tubohen të gjithë njerëzit dhe *xhin*-ët në një vend, duke filluar prej të parëve të tyre dhe deri tek të fundit, e nëse këta bëhen të këqij si njeriu më i keq që mund të ekzistojë mbi

rruzullin tokësor, kjo nuk do të arrinte të pakësojë diçka nga pushteti i Zotit dhe nuk do të arrinin t`i bëjnë dëm Atij, porse do ta dëmtonin veten dhe do ta ngarkonin veten me barrë e cila do t`i shpinte në rrugën e devijimit dhe përfundim në zjarr të Xhehenemit.

Zoti në shumë *ajet*-e kuranore na bën me dije se njerëzit nuk mund ta dëmtojnë në asnjë mënyrë Zotin, sado që përpiqen për një gjë të tillë, e as që mëkati i tyre e dëmton Zotin diçka, porse mëkati dëmton vetëm atë që e kryen veprimin e tillë. Zoti thotë në Kuran: "**E ty mos të brengosin ata që përpiqen për mosbesim, ata kurrsesi nuk mund ta dëmtojnë asgjë Allahun",**[22] dhe *ajet*-i tjetër: "**Musa tha: "Nëse mohoni ju dhe të gjithë në tokë, Allahu është i pasur dhe i falënderuar".**[23] Gjithashtu thotë në një *ajet* tjetër: **"..e kush kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak..".**[24]

Gjithashtu në Kuran, na bën me dije se asgjë prej veprave tona nuk ndikon në Madhështinë e hirësisë së Tij, porse thjesht verifikimi i bindjes sonë personale, për të vërtetuar atë që besojmë. Zoti thotë në Kuran: "**Te Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj".**[25]

Kjo do të thotë se Allahu xh.sh. do që robërit e Tij t`i binden dhe nënshtrohen, siç urren për ta që t`i bëjnë mëkat Atij. Allahu xhele she`nuhu i gëzohet pendimit të robit kur ai pendohet, edhe pse nuk është i nevojshëm për pendimin e njerëzve, sepse dobia nga ai pendim, i kthehet njeriut e jo Zotit. Krejt kjo, është si rezultat i bujarisë dhe mirësisë së Zotit ndaj njerëzve.

Nga ky *hadith*, vërejmë se burimi i mirësisë dhe ligësisë, devotshmërisë dhe mëkatit, është zemra, sepse aty fillon çdo punë, qoftë e mirë ose jo. Nëse zemra do të jetë e mirë, do të jenë të tilla edhe pjesët tjera të trupit, e nëse zemra është e prishur, atëherë të tilla do të jenë edhe veprat. Në bazë të kësaj, i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem bëri me shenjë në gjoksin e tij dhe tha: *"Devotshmëria është këtu".*[26]

Në këtë kontekst, ka *ajete* të shumta që vërtetojnë se zemra është burimi i mirësisë dhe ligësisë, si në ajetin: **"Nuk u janë verbëruar sytë, por zemrat**

[22] Kurani, Ali Imran, 176;
[23] Kurani, Ibrahim, 8;
[24] Kurani, Ali Imran, 144;
[25] Kurani, Haxh, 37;
[26] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 10, nr.2564; etj.

që kanë në gjokset e tyre”.[27] Ose *ajet*-i: **“Kjo është përkujtim për atë që ka zemër..”**[28] dhe *ajet*-i: **“Në ditën kur nuk bën dobi malli dhe fëmijët, por vetëm kush e takon Zotin me zemër të shëndoshë”.**[29]

Me pjesën e parafundit të *hadith*-it, Zoti na dëshmon se të mirat e Tij nuk kanë fund, nuk pakësohen ato me shpërndarje, saqë nëse tubohen të gjitha qeniet dhe kërkojnë të gjithë atë që mund ta paramendojnë, Zoti është në gjendje t`ua plotësojë, e kjo nuk do të pakësonte prej të mirave të Tij as një grimcë. A mund vallë të pakësohet uji i detit nëse marrim një pikë ujë me gjilpërë?! Ajo as që do të pakësonte ujin e detit, e as që do të vërehej uji në majën e gjilpërës, andaj mos mendojë njeriu se do t`i pakësohet prona Zotit nëse kërkon prej Tij, ngase prej Emrave të Tij është edhe *El-Ganij* që do të thotë `i Pasuri`, pasuria e të cilit nuk shterret asnjëherë.

Zoti përdor shembuj të ndryshëm për t`u sqaruar njerëzimit sa më mirë esencën e gjërave, që njeriu të fus në përdorim trurin e tij dhe të mendojë rreth gjërave përreth tij. Zoti mori shembull gjilpërën, sepse ajo në esencë është e lëmuar dhe uji nuk qëndron në të, si dhe tregon për sasinë e vogël të ujit që gati nuk vërehet në të kur ajo futet në ujë, andaj Zoti solli shembull të mrekullueshëm që njerëzimi të kuptojë madhështinë e Fuqisë dhe Pushtetit të Tij.

Allahu xhele she`nuhu furnizon krijesat që nga krijimi i tyre, me miliarda qenie të gjalla, të gjithë marrin prej furnizimit të Zotit, e kjo aspak nuk e shterr pronën e Tij.

Pasi Zoti vërtetoi Fuqinë e Tij absolute dhe dobësinë e krijesave, e ndërlidh fundin e këtij *hadith*-i me fillimin e tij, ku tregon që askujt nuk do t`i bëhet padrejtësi, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër, atje ku çdokush do të gjejë atë që ka vepruar. Zoti thotë në Kuran: **“E shpërblimet tuaja u plotësohen Ditën e Kijametit”.**[30]

E gjithë e mira është prej Zotit, andaj kush do të gjejë veprat e mira, do të falënderojë Zotin për gjithçka, sepse Ai është Dhuruesi i tyre, e nëse gjen veprat e këqija, le të mos kërkojë fajtorë tjetër pos vetes, sepse atë e ka

[27] Kurani, Haxh, 46;
[28] Kurani, Kaf, 37;
[29] Kurani, Shuara, 88-89;
[30] Kurani, Ali Imran, 185;

vepruar. Zoti thotë në Kuran: **“Çfarëdo e mire që të vjen është nga Allahu, e çka të ndodhë ndonjë e keqe, është nga vetja jote..”.**[31]

Nuk ndodh asgjë e të mos jetë e shënuar në Librin e Ruajtur, çdo gjë është e regjistruar, qoftë vepër e vogël ose e madhe, qoftë e mirë ose e keqe, të gjitha regjistrohen tek Ai, e në Ditën e Llogarisë, do të del në shesh e gjithë veprimtaria jonë.

Njeriu nuk ka arsyetim pas shpalljes së Kuranit dhe dërgimit të Pejgamberit të Tij, pasi kjo është drejtësia e Zotit, e kush mohon pas kësaj, ai ka ngarkuar veten, e këtë do ta gjejë në Ditën e Llogarisë, e kush gjen udhëzimin, Allahu xhele she`nuhu do ta mbulojë me Mëshirën e Tij. Ky le të shpreh falënderim Zotit, sepse edhe veprat e mira që i ka realizuar, janë prej mirësisë së Zotit ndaj tij dhe sikur mos ia mundësonte Zoti, ky nuk do të kryente asnjë të mirë prej tyre, por Zoti ia ka mundësuar ato veprime, andaj Atë le ta falënderojë.

Edhe *shejtan*-i do ua përkujtojë pasojën e veprave të tyre, kur të përfundojë çështja dhe të shkojnë banorët e *Xhenet*-it në *Xhenet* dhe banorët e Zjarrit në *Xhehenem*, ku do t`u drejtohet *shejtan*-i pasuesve të tij duke u thënë: **“Unë nuk pata asnjë pushtet mbi ju, përpos se ju kam thirr, e ju m`u përgjigjët, andaj mos më qortoni mua, por qortoni veten tuaj”.**[32]

Ky ishte një *hadith* i cili me të vërtetë na bën me dije Madhështinë e Fuqisë së Zotit, andaj njeriu duhet të logjikojë dhe të bindet se i vetmi që meriton adhurim dhe i Cili meriton t`i drejtohemi në lutjet tona, është Allahu xhele she`nuhu.

[31] Kurani, Nisa, 79;
[32] Kurani, Ibrahim, 22;

HADITHI I DYTË (2)

حَدَّثَنِي زُهَيْرُ بْنُ حَرْبٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، أَخْبَرَنَا رَوْحُ بْنُ الْقَاسِمِ، عَنِ الْعَلَاءِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ يَعْقُوبَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " قَالَ اللهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: أَنَا أَغْنَى الشُّرَكَاءِ عَنِ الشِّرْكِ، مَنْ عَمِلَ عَمَلًا أَشْرَكَ فِيهِ مَعِي غَيْرِي، تَرَكْتُهُ وَشِرْكَهُ "

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu i cili thotë: "Ka thënë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Thotë Allahu xh.sh.:* ***"Unë jam i panevojshëm për ortak. E kush vepron një vepër dhe e përzien qëllimin e tij me Mua, e refuzoj atë vepër dhe ortakun e tij!".***[33]

Një ndër Emrat të Bukur të Allahut xh.sh. është edhe emri *El-Ganij*, që do të thotë *`i Pasuri absolut`* i Cili nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd. Zoti është aq i pasur, saqë nëse të gjitha krijesat do të kërkonin atë që dëshirojnë, Atij nuk do t`i pakësohej nga pasuria e Tij as sa një grimcë. Nëse do të dëshironi të krahasoni pasurinë e Zotit me pasurinë e njerëzve, atëherë mendoni për një çast, se a do të mund një mbret i pasur në këtë botë, të shtronte një darkë për shtatë miliard njerëz në botë?! Po t`u jepte edhe drekë dhe mëngjes?! Po të pinë ujë dhe kafe?! Këtë nuk do të mund ta realizonte askush. Kurse Allahu xh.sh. shtatë miliard njerëzve, u jep çdo ditë të hanë dhe të pinë, po ashtu me miliarda xhinë të cilëve nuk ua dimë numrin, po pastaj me miliarda qenie të gjalla, kafshë, shtazë, peshq, bimë, insekte dhe gjithçka që ushqehet, prej në fillim të krijimit e deri në ditën e fundit, të gjitha i furnizon Allahu xh.sh. dhe asgjë nuk pakësohet prej pasurisë së Tij. Pra, kjo është një pasuri absolute që vetëm Zoti e dinë sasinë e saj.

[33] Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zuhdu, bab 5, nr.2985; Ibni Maxheh, "Sunen", Darul-Fikër, Bejrut, botimi i parë, 2003, kitab ez-Zuhdi, bab 21, nr.4202; Ahmed-i, "Musned", 13/377, nr.7999-8000; Busiri-u në "Zevaid" thotë: "Zinxhiri i tij është Sahih, kurse transmetuesit janë të besueshëm". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmed-it, për këtë hadith thotë se zinxhirin e ka Sahih sipas kushteve të Muslim-it;

Zoti thotë në Kuran: **“O ju njerëz, ju jeni të varfër te Zoti, kurse Allahu është i Pasur dhe i falënderuar”.**[34]

Po përse edhe përskaj të gjitha këtyre mirësive, njeriu shkon dhe adhuron dikë tjetër e jo Zotin e botëve?! Vallë, a do të gjejë zot tjetër i Cili e furnizon me mirësi sikur Allahu xh.sh.?! Zoti thotë në Kuran: **“Zoti i juaj është vetëm një Zot dhe nuk ka tjetër përpos Tij, e Ai është (Allahu) i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirues”.**[35]

Allahu xh.sh. është Ai i Cili na fal mëkatet tona dhe na shpërblen për çdo gjë me mirësi, saqë edhe na pastron nga mëkatet, nëse ne kujdesemi nga mosrënia në *shirk*. Transmeton Enesi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Thotë Zoti i juaj:* ***“Unë jam më i denjë për të më pasur frikën, andaj mos besoni hyjni tjera krahas Meje. E kush ka frikë që të përshkruajë hyjni tjetër krahas Meje, Unë do t`ia fal atij mëkatet”.***[36]

Zoti në disa vende në Kuran, na jep shembuj logjik, që njeriu të meditojë rreth tyre dhe të vijë në përfundim, se nuk ka Zot tjetër pos Tij, e sikur të kishte më tepër se një Zot, do të shkatërrohej gjithësia. Pasi secili Zot do të veçohej me krijimin e tij, do të kishte dëshira të ndryshme, njëri do dëshironte të ketë shi e tjetri borë, njëri do thoshte të bëhet dimër e tjetri verë, kështu do të kishte përplasje dëshirash në mes tyre dhe do të vinte deri te shkatërrimi i galaktikave.

Zoti thotë në Kuran: **“Thuaj: “Sikur të kishte zota të tjerë përveç Atij, sikundër thonë ata, atëherë ata (zotat) do të kërkonin rrugë për mbizotërim ndaj të Madhëruarit (për t’ia marr pushtetin). I pa të meta është Ai, Lartësia e Tij është e madhe nga ajo që thonë ata**”.[37]

---

[34] Kurani, Fatir, 15;

[35] Kurani, Bekare, 163;

[36] Tirmidhi-u, “Sunen”, kitab Tefsiru`l-Kuran, bab sure Mudethir, nr.3339 ku thotë se hadithi është Hasenu-Garib; Ibni Maxheh, “Sunen”, kitab ez-Zuhdi, bab 35, nr.4299; Ahmed-i, “Musned”, 19/430, nr.12.442; Hakim-i, “El-Mustedrek”, vëll.2, fq.552, nr.3876 dhe thotë se “Zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar”, me të pajtohet edhe Dhehebiu; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sunen-it të Ibni Maxhes (5/355) për këtë hadith thotë se ka zinxhirin e dobët, shkaku i dobësisë së Suhejl b. Abdullah el-Kutai-ut..”.

[37] Kurani, Isra, 42-43;

Po ashtu thotë: **“All-llahu nuk ka marr për veten kurrfar fëmije (as engjëjt, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohej me atë që ka krijuar, dhe do të dominonte njëri mbi tjetrin! I lartë, i pastër është All-llahu nga ato që i përshkruajnë”.**[38]

Edhe gjërat të cilat i ka bërë njeriu me dorën e tij, i sheh se nuk mund të udhëhiqen nga dy persona. Vallë, a keni parë ndonjë shtet të ketë dy kryetarë në të njëjtën kohë?! Apo një mbretëri të ketë dy mbretër?! Apo mos ka parë dikush të ketë një veturë me dy timonë, ku secili shofer do të dëshironte të shkojë në një rrugë të caktuar, atëherë ajo veturë do të përfundonte shumë shpejt në humnerë. E vallë, si atëherë i përshkruajnë Zotit shok dhe ortak?! Zoti thotë në Kuran: **“Adhuroni Allahun dhe mos i përshkruani Atij asnjë ortak”.**[39]

Zoti në formë retorike u drejtohet njerëzve, që të vënë në lëvizje mendjen dhe logjikën e tyre, se si mundet të adhurojnë dikë i cili vet është i krijuar? A po besoni gurët dhe drunjtë, të cilët njerëzit me duart e tyre i gdhendin e pastaj u thonë se janë zota?! Zoti u thotë: **“A po adhuroni ata të cilët asgjë nuk kanë krijuar, kurse vet ata janë të krijuar”.**[40]

Çka ka krijuar njeriu, guri apo druri, planeti apo yjet, shejtani apo *xhin*-i, që të meritojnë të adhurohen krahas Zotit të vërtetë, i Cili është Krijuesi i çdo gjëje?!

Kjo është një padrejtësi e madhe, sepse nuk e orienton besimin në Atë i Cili është meritori për t`u adhuruar, porse në të tjerë të cilët nuk kanë kontribuar asgjë për njerëzit. Thotë Zoti në Kuran: **“Me të vërtetë, shirku është padrejtësia më e madhe”.**[41] Si të mos jetë kështu kur Zoti të furnizon, kurse njeriu falënderon tjetër që, Zoti na mbron, kurse njeriu është mirënjohës ndaj tjetërkujt!

Ky është *shirku* i madh ose *shirk-u* i dukshëm, kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem aludoi edhe në një lloj tjetër *shirk-u*, e ajo është *shirk-u* i vogël ose i fshehtë. Veprat që bien në këtë kategori janë dyfytyrësia e vogël (*nifaku`l-esgar)* ose syefaqësia (*rija)*. Edhe këto janë shumë të rrezikshme, nga

[38] Kurani, Mu`minun, 91;
[39] Kurani, Nisa, 36;
[40] Kurani, A`raf, 191;
[41] Kurani, Lukman, 13;

shkaku se mund ta sjellin personin në pragun e *shirk*-ut të madh. Dikush e kryen namazin, agjërimin, zekatin, haxhin, *sadaka*-në për njerëzit dhe për t`u parë para njerëzve, kurse në Ditën e Gjykimit nuk do të ketë asnjë shpërblim për këto vepra, pasi nuk i ka kryer sinqerisht për Zotin. Prandaj, njeriu duhet të jetë i sinqertë në besimin dhe punën e vet.

Transmeton Mahmud b. Lebidi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më së tepërmi që kam frikë për ju, është frika nga shirku i vogël".* Njerëzit pyetën: "E çka është *shirk*-u i vogël, o i Dërguari i Allahut?" Ai tha: *"Syfaqësia". Allahu xh.sh. do t`u thotë atyre në Ditën e Kijametit, kur njerëzit do t`i marrin shpërblimet për veprat e tyre:* ***"Shkoni tek ata të cilët veprat i kryenit për t`u parë prej tyre dhe shikoni a do të merrni prej tyre ndonjë shpërblim?!".***[42]

Me këtë lidhet edhe *hadith*-i tjetër që e transmeton Ebu Seid b. Ebi Fadale el-Ensariu radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu do t`i tubojë të parët dhe të fundit në Ditën e Kiametit, ditë në të cilën nuk ka asnjë dyshim, do të thërras një thirrës: "Kush i ka shoqëruar Allahut dikë në veprat e veta, le të kërkojë shpërblimin prej atij për të cilin e ka vepruar atë, sepse Allahu është i pasur që t`i përshkruhet Atij ortak".*[43]

Po ashtu, në një *hadith kudsij*, transmetohet nga Xhabiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ka thënë Allahu xh.sh.:* ***"Kush vepron një vepër me të cilën synon dikë tjetër përpos Meje, Unë jam i distancuar prej tij".***[44]

Këtu mund të përmendim edhe transmetimin e Enes b. Malikut r.a. i cili thotë: "Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Do të vijnë në Ditën e Kijametit me disa fleta të vulosura dhe i sjellin para Zotit, e Ai u*

---

[42] Ahmed-i, "Musned", vëll.39, fq.39, nr.23.630; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, për këtë hadith thotë: "Hadithi është Hasen, transmetuesit janë përcjellës të Sahiheve, por ka shkëputje, pasi Amri nuk ka dëgjuar prej Mahmud b. Lebidit r.a., në mes tyre duhet të jetë Asim b. Umer b. Katade, i cili është i besueshëm, kurse Amri është i sinqertë…";

[43] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiri`l-Kurani, bab 7, nr.3165 dhe thotë se është hadith Hasenu-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 21, nr.4203; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sunen-it të Ibni Maxhes (5/291) për këtë hadith thotë se është Sahih në bazë të përcjelljeve tjera, kurse zinxhirin e ka të mirë...

[44] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", mektebetu`r-Rushd, Rijad, botimi i parë, 2003, vëll.9, fq.202, nr.6519;

thotë melekëve: ***"Hiqeni këtë dhe pranonia këtë".*** *Melekët do të thonë: "Për Madhërinë Tënde! Ne nuk shohim të shkruar këtu përpos se të mira". E Zoti do të thotë (e Ai e dinë më së miri):* ***"Këtë e ka vepruar për dikë tjetër e jo për Mua, e sot nuk do t`u pranohet asnjë vepër përpos atyre që janë kryer për Mua".***[45]

Pra, ai që ka punuar për ta parë njerëzit dhe ta lavdërojnë, ai do të dërgohet në Ditën e Gjykimit që të lyp prej njerëzve ta shpërblejnë për veprat e kryera, me çka njeriu do të ngel në dëshpërim, sepse ata nuk do të mund t`i ndihmojnë asgjë dhe do të dëshpërohet pasi nuk i ka kryer veprat sinqerisht për Allahun xh.sh. por për njerëzit dhe lëvdatat e tyre. Allahu na i pastroftë qëllimet dhe na bëftë të sinqertë në besimin tonë.

[45] Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", Mektebetu`l-ulum ve`l-hikem, Medine, botimi i parë, 1988, vëll.14, fq.8, nr.7388 dhe thotë: "Nuk e dimë që transmetohet nga Enesi nga ndonjë rrugë tjetër përpos kësaj, kurse Harith b. Gasani është nga Basra, nuk ka diç të keqe tek ai, prej tij kanë transmetuar shumica e dijetarëve"; Ukajli, "Duafau`l-Kebir", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 1/218, nr.267; Taberan-i, "Mu`xhemu`l-Euset", Daru`l-Haramejn, Kajro, 1995, vëll.6, fq.183, nr.6133 dhe thotë se nuk e përcjellë këtë hadith prej Ebu Imranit askush tjetër përpos Harith b. Gasanit; Darekutni, "Sunen", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 2004, 1/77, nr.132; Hejthemi-u thotë: "E transmeton Taberani në "Euset" përmes dy rrugëve, kurse transmetuesit e njërit zinxhir janë përcjellës që gjenden në Sahihe, ndërsa e përcjellë edhe Bezzari" (Hejthemiu, "Mexhmeu`z-Zevaid", Darul-Kutubil-Ilmije, Bejrut, botimi i parë, 2001, 10/460, nr.18.395 dhe 18.396);

HADITHI I TRETË (3)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ إِسْحَاقَ الجَوْهَرِيُّ البَصْرِيُّ قَالَ: حَدَّثَنَا أَبُو عَاصِمٍ قَالَ: حَدَّثَنَا كَثِيرُ بْنُ فَائِدٍ قَالَ: حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ عُبَيْدٍ، قَالَ: سَمِعْتُ بَكْرَ بْنَ عَبْدِ اللَّهِ المُزَنِيَّ، يَقُولُ: حَدَّثَنَا أَنَسُ بْنُ مَالِكٍ، قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " قَالَ اللَّهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: يَا ابْنَ آدَمَ إِنَّكَ مَا دَعَوْتَنِي وَرَجَوْتَنِي غَفَرْتُ لَكَ عَلَى مَا كَانَ فِيكَ وَلَا أُبَالِي، يَا ابْنَ آدَمَ لَوْ بَلَغَتْ ذُنُوبُكَ عَنَانَ السَّمَاءِ ثُمَّ اسْتَغْفَرْتَنِي غَفَرْتُ لَكَ، وَلَا أُبَالِي، يَا ابْنَ آدَمَ إِنَّكَ لَوْ أَتَيْتَنِي بِقُرَابِ الأَرْضِ خَطَايَا ثُمَّ لَقِيتَنِي لَا تُشْرِكُ بِي شَيْئًا لَأَتَيْتُكَ بِقُرَابِهَا مَغْفِرَةً "

Transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu, i cili ka thënë: "E dëgjova të Dërguarin e All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"All-llahu i Madhëruar ka thënë:* ***"O biri i Ademit, derisa të më lutesh Mua dhe të shpresosh tek Unë (falje), Unë do të fal çka do që ka ardhur prej teje e nuk mërzitem aspak! O biri i Ademit, nëse mëkatet e tua arrijnë deri në kupën e qiellit e pastaj kërkon falje nga Unë, Unë do të fal dhe nuk mërzitem aspak! O biri i Ademit, nëse vjen te Unë me mëkate të mëdha sa toka, pastaj më drejtohesh duke mos më bërë shok asgjë (në adhurim) Unë do të dhuroj falje po aq të madhe (sa madhësia e tokës)!"***[46]

[46] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 98, nr.3551 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib pasi nuk përcillet përmes ndonjë rruge tjetër pos kësaj; Ebu Nuajm-i, "El-Hilje", 2/231 i cili po ashtu thotë se është Garib; Mul-la Ali el-Kari-u në "Ehadithul Kudsije el-Erbainije" fq.78 thotë se e përcjell Tirmidhi-u me zinxhir Sahih; ky hadith përcillet edhe nga Ebu Dherri r.a. që e shënon Ahmed-i në "Musned", 35/294-295, nr.21.367 dhe Bejheki-u në "Shu`abu`l-Iman", 2/336, nr.1041-1042; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmed-it për këtë hadith të Ebu Dherrit r.a. thotë se është Sahih, kurse ka zinxhirin e dobët shkaku i Lejth b. Ebu Sulejmit dhe Shehër b. Haushebit të cilët janë të dobët;

Edhe ky është një prej *hadith*-eve që sjell në pah vlerën e njëshmërisë së Zotit, veçimi i lutjes vetëm ndaj Zotit dhe të mos përshkruarit Atij ndonjë ortak. Me këtë *hadith*, po ashtu vjen në shprehje edhe Mëshira e gjërë e Zotit, i Cili na bën me dije se nuk ka mëkat që nuk falet, përderisa njeriu nuk i bën Zotit ortak dhe i lutet vetëm Atij. Mëkatet mund të jenë të shumta dhe të ndryshme, por Zoti na tregon se asgjë nuk mund të tejkalojë Mëshirën e Tij, si dhe asgjë nuk mund të jetë më e madhe se Falja e Zotit.

Ngjajshëm si ky *hadith*, është edhe *hadith*-i tjetër, të cilin e përcjell Abdullah b. Abasi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sellem ka thënë: *"Zoti thotë*: ***"Kush e din që Unë kam fuqinë për faljen e mëkateve, do t`ia fal atij dhe nuk mërzitem, përderisa nuk më përshkruan shok".***[47]

Ky është një *hadith* shumë shpresëdhënës, ngushëllim për mëkatarët që të mos humbin shpresat nga Mëshira e Zotit.

Zoti në shumë vende në Kuran, na bën me dije se është shumë i mëshirshëm, se i fal mëkatet dhe se nuk dëshiron dënimin e robërve të Vet. Thotë në një *ajet* kuranor: **"Allahu është i mëshirshëm dhe mëkatfalës".**[48]

Ajet-et në lidhje me këtë temë janë të shumta, por ne do t`i shënojmë vetëm disa për ilustrim: **"Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqëndrohet në rrugën e drejtë".**[49]

"Edhe ata të clët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë padrejtësi vetës së tyre, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç All-llahut? - duke ditur, nuk vazhdojnë në ata që kanë punuar (në të keq)".[50]

---

[47] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", mektebetu Ibni Tejmije, Kajro, botimi i tretë, 1994, vëll.11, fq.241, nr.11.615; Hakim-i, "El-Mustedrek", 4/291, nr.7676 dhe thotë se "zinxhiri i këtij hadithi është Sahih", por me të nuk pajtohet Dhehebiu duke thënë se Hafs b. Umer el-Adeniju është i dobët; Mulla Ali el-Kariju, një dijetarë i medhhebit Hanefi, në librin e tij "Kitabu`l-Ehadithi`l-Kudsijjeti`l-Erbainijjeti", fq.75, thotë se senedi i këtij hadithi është Sahih.

[48] Kurani, Nisa, 100;

[49] Kurani, Taha, 82;

[50] Kurani, Ali Imran, 135;

“E kush pendohet pas punës së keqe dhe përmirësohet, s’ka dyshim, All-llahu ia pranon pendimin, All-llahu është që falë shumë, është mëshirues”.[51]

“S’ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt të do. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh”.[52]

Me këtë *hadith*, kishim për qëllim të tregojmë për rëndësinë e besimit në një Zot dhe mos përshkrimi Atij ortak, të cilën më lart e kemi sqaruar në mënyrë të hollësishme, kurse për faljen e Zotit, do të flasim më tepër kur të arrijmë te kapitulli i `Faljes së Zotit`.

[51] Kurani, Maide, 39;
[52] Kurani, Nisa, 48;

HADITHI I KATËRT (4)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مَسْلَمَةَ، عَنْ مَالِكٍ، عَنْ صَالِحِ بْنِ كَيْسَانَ، عَنْ عُبَيْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُتْبَةَ بْنِ مَسْعُودٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ خَالِدٍ الجُهَنِيِّ، أَنَّهُ قَالَ: صَلَّى لَنَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ صَلاَةَ الصُّبْحِ بِالحُدَيْبِيَةِ عَلَى إِثْرِ سَمَاءٍ كَانَتْ مِنَ اللَّيْلَةِ، فَلَمَّا انْصَرَفَ أَقْبَلَ عَلَى النَّاسِ، فَقَالَ: هَلْ تَدْرُونَ مَاذَا قَالَ رَبُّكُمْ؟ قَالُوا: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ، قَالَ: " أَصْبَحَ مِنْ عِبَادِي مُؤْمِنٌ بِي وَكَافِرٌ، فَأَمَّا مَنْ قَالَ: مُطِرْنَا بِفَضْلِ اللَّهِ وَرَحْمَتِهِ، فَذَلِكَ مُؤْمِنٌ بِي وَكَافِرٌ بِالكَوْكَبِ، وَأَمَّا مَنْ قَالَ: بِنَوْءِ كَذَا وَكَذَا، فَذَلِكَ كَافِرٌ بِي وَمُؤْمِنٌ بِالكَوْكَبِ"

Transmeton Zejd b. Halid el-Xhuheniju radijeAllahu anhu i cili ka thënë: "Na priu i Dërguari i All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem në namazin e mëngjesit në vendin e quajtur *Hudejbije,* ku kishte rënë shi natën. Kur e kryem faljen, i Dërguari i All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem u kthye kah *xhemati* dhe na u drejtua të pranishmëve duke na thënë*: "A e dini se çka tha Zoti juaj?"* Të pranishmit thamë: "All-llahu dhe i Dërguari i tij e dinë". *Ai (All-llahu) tha:* ***"Këtë mëngjes prej robërve të Mi njëri u bë besimtar dhe tjetri pabesimtar. Ai që tha: "Ky shi është nga mirësia dhe mëshira e All-llahut" u bë besimtar në Mua, ndërsa mohues i (adhurimit të) yjeve; E ai që tha: "Na zbriti shi për shkak të rënies së këtij apo atij ylli" është mohues ndaj Meje dhe besimtar në yje".***[53]

Ky *hadith* përcillet nga Nesaiu edhe përmes Ebu Hurejres radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. ka thënë:* ***"Nuk ka dhunti që u kam dhuruar robërve të Mi, e që në mëngjes***

[53] Buhari-u, "Sahih", kitab`ul-Edhani, bab 156, nr.846; Muslim-i, "Sahih", kitab`ul-Imanu, bab 32, nr.71; Ebu Davud-i, "Sunen", darus-Selam, Rijad, botimi i parë, 1999, kitab et-Tibbu, bab 21, nr.3906; Nesai-u, "Sunen", darus-Selam, Rijad, botimi i parë, 1999, kitab Istiska, bab 16, nr.1526; Malik-u, "Muvetta", muessesetu`l-Muhtar, Kajro, botimi i parë, 2006, kitab Nidau`s-Salat, bab el-istimtari bi`n-Nuxhumi, nr.447; etj.

kur të zgjohet një pjesë prej tyre të mohojnë duke thënë: "Ky yll dhe prej këtij ylli".[54]

Ndërsa në një transmetim nga Ebu Seid el-Hudriju radijeAllahu anhu thuhet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sikur Zoti t`ua ndërprente njerëzve shiun për pesë vite, e pastaj t`ua lëshonte atë, përsëri do të haset një grup prej njerëzve që janë mohues të cilët thonë: "Ka rënë shiu shkaku i rënies së këtij ylli (Mixhdeh)".*[55]

I Dërguari i jonë sal-lallahu alejhi ve sel-lem kishte shkuar në Hudejbije në vitin e gjashtë *hixhri*, në muajin Dhu`l-Ka`de. Ai u nis për në Meke, për të kryer *umre*-n, porse kurejshitët nuk dëshironin ta lejonin për një veprim të tillë. Në këtë gjendje, myslimanëve nuk iu lejua që atë vit të kryejnë *umre*-n, por u arrit një marrëveshje mes myslimanëve dhe kurejshëve, që muslimanët të kryejnë *umre*-n vitin e ardhshëm. Shkrues i kësaj kontrate ishte Aliu radijeAllahu anhu në prezencën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Umeri radijeAllahu anhu mendoi se kjo marrëveshje është në disfavor të myslimanëve, porse i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte më largpamës dhe e dinte se nga kjo marrëveshje do të dalin triumfues. Kjo marrëveshje u konsiderua si fillimi i fitores së myslimanëve dhe çlirimit të Mekes.

I Dërguari i Allahut në këtë mëngjes pasi fali namazin e sabahut, u kthye me fytyrë kah *xhemat*-i ashtu siç e kishte traditë dhe u mbajti një fjalim të pranishmëve, pasi e kishte princip që pas namazit, të mbajë ndonjë këshillë për muslimanët. E kishte zakon që t`i pyes pas namazit të sabahut se a ka parë dikush ndonjë ëndërr, nëse askush nuk kishte diçka për të thënë, ai fillonte të mbajë ndonjë predikim.[56]

Më pas, i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem u tregoi se njeriu mund të bëhet besimtar ose pabesimtar, në bazë të bindjes së tij që posedon dhe ndërlidhjes së fenomeneve me shkaktarët e tyre. Ai që e ndërlidh fenomenin natyrorë me Allahun xh.sh. dhe është i bindur se çdo gjë ndodh me vullnetin dhe dëshirën e Zotit, ai është besimtar i vërtetë, kurse kush

[54] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 32, nr.72; Nesai-u, "Sunen", kitab Istiska, bab 16, nr.1525; etj.

[55] **Mixhdeh** është një yll të cilin e mendonin paganët arabë se është shkak për zbritjen e shiut. Shih: "Sunen Nesai bi Hashijeti Sindi", Daru`l-Marife, Bejrut, vëll.2, fq.184;

[56] Buhari-u, "Sahih", kitab Ta`biri, bab ta`biri`r-ru`ja ba`de salati`s-subhi, nr.7047; Ahmedi, "Musned", 33/284, nr.20.094;

mendon se yjet, ose krijesat tjera janë shkaktar që të bie shiu, ata nuk kanë besuar Allahun xh.sh.

Shumë njerëz si në të kaluarën ashtu edhe sot, mendojnë se faktorët klimatik janë shkaku esencial që ndodhin fenomenet natyrore, si: shiu, bora, nxehti, etj, por në fakt, të gjitha këto, e kanë një shkak i cili i vë në funksion, e Ai është Allahu xh.sh.

Po ashtu, ka prej tyre që mendojnë se yjet kanë ndikim të drejtpërdrejt në kushtet klimatike ose në fatin e njerëzve, siç janë parashikuesit e fatit dhe përpiluesit e horoskopëve, të gjithë këta u përshkruajnë yjeve aftësi të cilën në fakt ato nuk e posedojnë.

Zoti tregon se vetëm Ai është që lëshon shiun dhe mundëson që prej tij të mbijnë bimët. Ai thotë: **"Ai (Allahu) është që lëshoi nga lart shiun e me të nxori bimën e çdo sendi dhe prej bimës gjelbërim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj..".**[57] Po ashtu thotë: **"A nuk e di se All-llahu e lëshoi shiun prej qiellit, e toka agon e gjelbëruar, vërtet, All-llahu është i kujdesshëm dhe mirënjohës".**[58]

Kurse në *sure*-n Rum, Zoti na tregon se jo të gjithë pabesimtarët kanë këto bindje, sepse kishte edhe prej tyre që e dinin se të gjitha këto i realizon Zoti. Thotë Allahu xh.sh.: **"Dhe nëse ti pyet ata: "Kush e lëshon shiun nga qielli dhe me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj?" Ata thonë: "All-llahu!" Thuaj: "Falënderimi i qoftë All-llahut, por shumica e tyre nuk mendojnë".**[59]

Allahu xh.sh. po ashtu na bëri me dije se çështja e shiut, është dije që e din vetëm Zoti dhe këtë fshehtësi nuk e din askush pos Tij. Për këtë thotë në Kuran: **"S'ka dyshim se vetëm All-llahu e di kur do të ndodhë Kijameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se çka ka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se çka do t'i ndodhë (çka do të punojë) nesër dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç'vend (ose kohë) do të vdesë. All-llahu është më i dijshmi dhe më i njohuri".**[60]

[57] Kurani, En`am, 99;
[58] Kurani, Haxh, 63;
[59] Kurani, Rum, 62;
[60] Kurani, Lukman, 34;

Ndërsa sa i përket asaj që thonë specialistët e fushës së meteorologjisë, ajo nuk është diçka tjetër përpos se një supozim dhe parashikim i arritur në bazë të vrojtimit të përhershëm të dendësisë së mjegullave, shpejtësisë së erës, temperaturës, lagështisë së ajrit dhe kushteve tjera klimatike. Duke i vrojtuar këto, supozohet edhe parashikimi klimatik. Ky parashikim nuk është diçka e prerë dhe shpesh ndodh e kundërta e asaj që parashikohet. Po ashtu, ky parashikim, nuk është fall, porse vrojtim fizik i atmosferës. Pra, Allahu xh.sh. është i Vetmi që në mënyrë të saktë e di të ardhmen, ndërsa vrojtimet e meteorologëve janë mendime të ngritura duke shikuar fuqinë dhe krijimin e Allahut xh.sh. në atmosferë.

Ne si besimtarë, duhet të jemi të bindur se vetëm Zoti është Ai që ka nën sundim gjithë universin dhe nuk ndodh asgjë në të pa lejen e Tij. Zoti e dërgon shiun në disa raste si mëshirë, kurse në disa raste edhe si dënim, përmes së cilës shkatërron vendbanime të tëra. Besimtari duhet të jetë i sinqertë në besimin e tij e të mos i përshkruaj Zotit ortak dhe të mendojë se diçka mund të ndodh pa lejen e Zotit.

Ne duhet të përforcojmë në zemrat tona besimin dhe të mos lejojmë që diçka ta luhat atë, pa marrë parasysh avancimin e teknologjisë dhe zbulimeve shkencore, ne duhet të besojmë se vetëm Zoti është shkaku i të gjitha shkaqeve, kurse gjithçka që është në funksion në natyrë për ndonjë veprim të caktuar, është si shkak i caktuar nga ana e Zotit.

HADITHI I PESTË (5)

حَدَّثَنَا سُلَيْمَانُ بْنُ دَاوُدَ يَعْنِي الطَّيَالِسِيَّ، حَدَّثَنَا صَدَقَةُ بْنُ مُوسَى السُّلَمِيُّ الدَّقِيقِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ وَاسِعٍ، عَنْ سُمَيْرِ بْنِ نَهَارٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، قَالَ: " قَالَ رَبُّكُمْ عَزَّ وَجَلَّ: لَوْ أَنَّ عبيدِي أَطَاعُونِي، لَأَسْقَيْتُهُمُ الْمَطَرَ بِاللَّيْلِ، وَأَطْلَعْتُ عَلَيْهِمُ الشَّمْسَ بِالنَّهَارِ، وَلَمَا أَسْمَعْتُهُمْ صَوْتَ الرَّعْدِ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Zoti i juaj xh.sh. ka thënë:* ***"Nëse robërit e Mi, do të më nënshtroheshin Mua, do t`u dërgoja atyre shi natën dhe nuk do ua largoja atyre diellin ditën, e as që do ta dëgjonin bubullimën".***[61]

T`i nënshtrohesh Zotit plotësisht, nënkupton të kryesh urdhërat që ka përcaktuar Ai dhe të largohesh nga ndalesat që ka vënduar. Pra, të qëndrosh në kufijtë e fesë e të mos i tejkalosh ato. Këtë e kërkon Zoti prej nesh në shumë ajete kuranore, ku thotë: **"O ju që keni besuar, nënshtrohuni Allahut dhe pejgamberit të Tij dhe prijësve tuaj..".**[62] Nuk ka nënshtrim ndaj krijesës, në veprat ku është i hidhëruar Krijuesi. Pra, nënshtrimi është vetëm në vepra të mira, e kur bëhet fjalë për mëkate, atëherë nuk ka nënshtrim ndaj asnjë krijese.

---

[61] Ebu Davud el-Tajalis-i, "Musned", Hixhër, botimi i parë, 1999, 4/312, nr.2709; Ahmed-i, "Musned", vëll.14, fq.327, nr.8708; Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/380, nr.3331 dhe thotë se hadithi është me zinxhir Sahih, por Buhari-u dhe Muslim-i nuk e kanë shënuar; Mul-la Ali el-Kari-u në "Ehadithu`l-Kudsijje el-Erbainijje", fq.81, nr.32, thotë se ky hadith është me zinxhir Sahih; Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmed-it thotë se "Zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, Sadaka b. Musa është konsideruar i dobët nga Ibni Meini, Ebu Davudi, Nesaiu, etj. Ebu Hatim er-Razi-u thotë se hadithi shkruhet prej tij, por nuk shërben për argument, pasi nuk është i fortë, si dhe Sumejr b. Nehar është konsideruar i panjohur nga Darekutni".

[62] Kurani, Nisa, 59;

Nëse njerëzit do të ishin nënshtruar vetëm Zotit për atë që Ai urdhëron, atëherë si mëshirë ndaj tyre, Zoti do të zbriste shiun në mbrëmje si freski për ta, duke mos i dëmtuar me të. Prej këtij shiu, do të kishin dobi bereqetet tokësore, kafshët dhe gjithë krijesat. Zoti e përmend në Kuran dërgimin e shiut, ku thotë: **"...dhe ju dhamë të pini ujë që ua shuan etjen".**[63] Po ashtu tha: **"..e nga qielli (retë) lëshojmë shi dhe atë ju japim ta pini...".**[64] Si dhe *ajet*-i: **"Edhe Ai është që i lëshon erërat myzhde në prag të mëshirës së Tij (shiut) dhe Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër. Që me të t`i japim jetë një toke të vdekur dhe që t`u japim të pijnë atyre që i krijuam, kafshë e shumë njerëz".**[65] Si dhe *ajete* tjera të shumta që flasin në këtë drejtim. Pra, uji është një begati dhe dhunti e madhe për krijesat, sepse pa të, do pasonte shkatërrimi i gjallesave.

Nga mirësitë dhe dhuntitë e Zotit për krijesat e Tija, është ndriçimi i ditës, që njerëzit të mund të shohin dhe punojnë, të gjallërojnë dhe të furnizohen nga dobitë që sjellin rrezet e Diellit. Sipas shkenctarëve, rrezet e Diellit u bëjnë dobi eshtrave të njeriut, sepse i forcojnë ato, pasi përmes rrezeve që prekin lëkurën, trupi krijon vitaminën D, e cila pastaj e ndihmon trupin të përthith kalcium, i cili është bazor për shëndetin e eshtrave.[66] Njerëzit nga Dielli përfitojnë ngrohje, sepse kjo është prej nevojave jetësore. Po ashtu, Dielli me dritën e vet, e ndriçon Hënën, me çka na mundësohet të kemi ndriçim edhe gjatë natës.

Bimët shfrytëzojnë rrezet e Diellit për fotosintezë, për të prodhuar oksigjen, të cilin njerëzit e shfrytëzojnë për frymëmarrje.[67] Dielli është ylli i vetëm i cili e ngroh planetin Tokë, sepse sikur të mos ishte nxehtësia e Diellit, planeti Tokë do të ishte i ftohtë dhe nuk do të kishte kushte për jetesë në të.

Po ashtu, Toka qëndron në orbitën e saj, shkaku i gravitacionit që e tërheq Dielli kah vetja.[68] Shkaku i nxehjes që shkakton Dielli, avullohen detet, oqeanet dhe formohen retë për të rënë shiu, që është një faktor tjetër shumë i rëndësishëm për zhvillimin e jetës në tokë. Dhe dobitë e tija janë të shumtë, saqë do duhej të shkruajmë një libër të tërë vetëm në këtë temë. Për këtë Allahu xh.sh. e kategorizoi si mrekullinë e Tij. Zoti thotë: **"Ai (Allahu) bëri për ju natën, që në te të pushoni, e ditën të ndritshme (të shihni). Në**

[63] Kurani, Murselat, 27;
[64] Kurani, Hixhër, 22;
[65] Kurani, Furkan, 48-49;
[66] www.theactivetimes.com;
[67] www.sciencing.com
[68] www.worldmetday.wmo.int;

këtë vërtet ka argumente për një popull që dëgjon".[69] Po ashtu thotë: **"E Ai është që natën ua bëri petk, gjumin pushim e ditën e bëri për gjallërim".**[70]

Më pas, bubullima është prej fenomeneve që krijoi Zoti në natyrë, i cili fut frikë dhe dridhje në zemrat e njerëzve, shkaku i forcës dhe ushtimës së saj. Nëse një person në gjumë do ta dëgjonte, do të trishtohej dhe do të zgjohej nga gjumi. Murmurima ose bubullima, është prej dukurive natyrore e cila vërteton fuqinë e Zotit, ngase ajo vjen me retë, të cilat bartin ujin, që sjell jetë, por edhe vetëtimën, e cila mund të zhduk jetën. Që të gjitha këto argumentojnë për fuqinë e Zotit. Kaptina e 13 në Kuran, e ka marr emrin "Er-Rra`d" ose bubullima. Këtu Zoti thotë: **"Ai është që ju shfaq vetëtimën trishtuese por dhe shpresëdhënëse (për shi) dhe formon re të dendura".** [71]

Në këtë *sure*, vërtetohet se edhe bubullima i bën *tesbih* dhe madhërim Allahut xh.sh. Zoti thotë në Kuran: **"Ndërkaq, murmurima madhëron (Zotin Një) me falënderimin (që i takon) Atij, (e madhërojnë) edhe melekët nga droja e Tij. E Ai dërgon rrufetë dhe me ato godet kë të dojë...".**[72]

Çdo gjë e madhëron dhe i bën *tesbih* Zotit, porse njerëzit dhe xhinët nuk janë në gjendje të kuptojnë *tesbih*-un e tyre, sepse ata nuk kanë gjuhën e njeriut, e as njeriu nuk ka kapacitetin e dëgjimit të tyre. Zoti thotë: **"Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiej dhe toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbih) duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre (sepse nuk është në gjuhën tuaj)..."**[73]

Sipas shpjegimeve shkencore, zëri i bubullimës shkaktohet nga vetëtima. Kur vetëtima kalon përmes mjegullave, ajo hap një vrimë në ajër. Pasi përfundon vetëtima, ajri tërhiqet pas dhe krijon një valë zëri që dëgjohet në qiell, që quhet murmurimë ose bubullimë. Temperatura e vetëtimës është

[69] Kurani, Junus, 67;
[70] Kurani, Furkan, 47;
[71] Kurani, Rra`d, 12;
[72] Kurani, Rra`d, 13;
[73] Kurani, Isra, 44;

29.982 °c.[74] Shumë njerëz frikohen prej bubullimës, me çka ndoshta i mbyllin edhe veshët e tyre. Kjo frikë njihet me emrin `Brontophobia`.[75]

Porse, edhe prej tyre ka dobi të ndryshme. Murmurima shërben edhe si freskues i tokës, sepse shkakton shiun dhe largon ndotjen e ajrit. Dobitë e saja janë të shumta për njeriun dhe mjedisin, porse ne nuk kemi mundësi t`i përmendim të gjitha, pasi edhe nuk i takon fushës sonë dhe nuk kemi hapsirë për t`u zgjeruar shumë në këtë temë.

[74] www.scotsman.com;
[75] www.medicinenet.com;

HADITHI I GJASHTË (6)

حَدَّثَنَا خَيْرُ بْنُ عَرَفَةَ الْمِصْرِيُّ، ثَنَا حَيْوَةُ بْنُ شُرَيْحٍ، ثَنَا بَقِيَّةُ، حَدَّثَنِي صَفْوَانُ بْنُ عَمْرٍو، حَدَّثَنِي عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ جُبَيْرِ بْنِ نُفَيْرٍ، وَشُرَيْحُ بْنُ عُبَيْدٍ الْحَضْرَمِيَّانِ، عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: قَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ «إِنِّي وَالْجِنُّ وَالْإِنْسُ فِي نَبَأٍ عَظِيمٍ، أُخْلَقُ وَيُعْبَدُ غَيْرِي , وَأَرْزُقُ وَيُشْكَرُ غَيْرِي»

Transmeton Ebu Derda radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *''Thotë Allahu xh.sh.:* ***"Unë me njerëzit dhe xhinët jam në (prag të) një çështje të madhe. Unë krijoj, ndërsa adhurohet tjetërkush pos Meje, Unë furnizoj, ndërsa falënderohet tjetërkush pos Meje".***[76]

Në këtë transmetim bëhet fjalë për gjykimin, llogaridhënien dhe shpagimin, që do ta bëjnë njerëzit dhe xhinët jomysliman para Allahut xh.sh. për mosadhurimin korrekt dhe mosfalënderimin e duhur.

Allahu xh.sh. nuk është se me të vërtetë ka ndonjë brengë dhe paaftësi në raport me veprimet e njerëzve, sepse Zoti do t`i pyes krijesat, kurse ata nuk mund ta marrin Zotin në pyetje dhe llogari. Ai thotë në Kuran: **"Ai nuk pyetet se çka punon, po ata (njerëzit), pyeten".** [77] Porse, Zoti na tregon mosmirënjohjen e krijesave ndaj Krijuesit suprem dhe absolut, të cilët gëzojnë mirësitë e shumta, porse nuk adhurojnë Zotin e atyre mirësive, ata shohin mrekulli për çdo ditë, por nuk e njohin si Zot Allahun xh.sh. Kurse Zoti na tregon esencën e krijimit të këtyre dy krijesave, të cilat posedojnë logjikë, por

[76] Taberani, "Musnedu`sh-Shamijin", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1989, vëll.2, fq.93, nr.974-975; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.6, fq.311, nr.4243; Dejlemi-u, "Firdeus", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 1986, vëll.3, fq.166, nr.4439; Hamdi Abdulmexhid es-Selefi në verifikim të veprës së Taberanit, për këtë hadith thotë se transmetuesit janë të besueshëm, por ka shkëputje në mes Shurejhit dhe Ebu Derdasë, pasi ai nuk e ka takuar atë; Muhtar Ahmed en-Nedeviu në verifikim të veprës "Shu`ab" të Bejhekiut, thotë se ky hadith ka zinxhir të dobët;

[77] Kurani, Enbija, 23;

nuk e shfrytëzojnë atë për të ardhur deri në besim. Zoti thotë në Kuran: **"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë".**[78]

Njerëzit për çdo ditë ushqehen nga mirësitë e Zotit, hanë dhe pinë në sajë të Mëshirës së Tij ndaj krijesave, porse për të gjitha ato mirësi, falënderojnë dikë tjetër. Pra, braktisin Zotin e vërtetë dhe falënderojnë idhuj të rrejshëm dhe i falënderojnë ata për të mirat që posedojnë.

Vallë, kush do të na kishte dhuruar ushqim, nëse Zoti do të na ndërpriste furnizimin e Tij?! Në Kuran thuhet: **"Kush është ai që ju ushqen, po që se Ai ua ndërpret furnizimin e Vet? Jo, askush, por ata vazhdojnë me arrogancë e kundërvënie".**[79] Po nëse do të humbej uji të cilin e konsumojmë, kush do të na furnizonte me ujë të pijshëm përpos Allahut xh.sh.?! Edhe këtë na e bëri me dije në fundin e sures Mulk ku thotë: **"Thuaj: "Më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t'ju sjell ujë mbitokësor (burimor)?"**[80]

Pra, duhet të jemi mirënjohës vetëm ndaj Allahut xh.sh. dhe vetëm Atë ta adhurojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë të kërkojmë. Ta falënderojmë Atë për të gjitha të mirat që kemi e mos tregohemi mosmirënjohës.

[78] Kurani, Dharijat, 56;
[79] Kurani, Mulk, 21;
[80] Kurani, Mulk, 30;

HADITHI I SHTATË (7)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ عَامِرِ بْنِ زُرَارَةَ الْحَضْرَمِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ فُضَيْلٍ، عَنْ مُخْتَارِ بْنِ فُلْفُلٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، عَنْ رَسُولِ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " قَالَ اللهُ عَزَّ وَجَلَّ: إِنَّ أُمَّتَكَ لَا يَزَالُونَ يَقُولُونَ: مَا كَذَا؟ مَا كَذَا؟ حَتَّى يَقُولُوا: هَذَا اللهُ خَلَقَ الْخَلْقَ فَمَنْ خَلَقَ اللهَ "

Transmeton Enes b. Maliku (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu i madhëruar:* ***"Ummeti yt nuk do të ndalen së pyeturi duke thënë: "Çka është kjo? E çka është kjo?" Gjersa të thonë: "Ky është Allahu i Cili i krijoi krijesat, e kush e krijoi Allahun?".***[81]

Ky *hadith* na flet për dyshimet të cilat mundohet djalli t`i fus në zemrat e njerëzve, për ta vënë atë në dyshim mbi ekzistencën e Zotit, saqë njeriu të fillojë të hutohet në lidhje me Zotin, që të mendojë se edhe Ai duhet të ketë fillim, siç kanë të gjitha gjërat një fillim. Por, këtu është gabimi i kësaj pyetje, të cilën shumë ateist dhe pabesimtarë e parashtrojnë, se si mundet Zoti të krijojë gjërat, kurse vet nuk është i krijuar? E nëse do të kishim thënë se edhe Zoti ka fillim, atëherë ata që e sulmojnë fenë do të thonin: "Si mundet të besojmë një zot i cili ka fillim dhe është i krijuar?" Pra, ata bëjnë vazhdimisht pyetje të tilla, shkaku se kanë rënë nën ndikimin e *shejtan*-it. Por, duhet ta kemi të qartë, se Allahu xh.sh. është Zot i Cili nuk ka fillim, sepse sikur të ishte i krijuar, atëherë nuk do të ishte Zot.

Jo rastësisht na mëson feja, që në çdo veprim të kërkojmë mbrojtje te Zoti nga *shejtan*-i i mallkuar, sepse ai përmes vesveseve, mundohet ta shkatërrojë njeriun, sidomos përmes dyshimeve që prekin çështjet e besimit.

Ngjashëm me këtë *hadith*, e kemi edhe transmetimin tjetër, të cilin e sjell Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"I vie shejtani ndonjërit prej jush, duke i thënë: "Kush e krijoi këtë, kush e krijoi*

[81] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 60, nr.136; Ahmedi, "Musned", 19/54, nr.11.995;

atë?" derisa t`i thotë: "E kush e krijoi Zotin?" e nëse vie te kjo, le të kërkojë mbrojtje te Zoti dhe të thotë: "E besoj Allahun".[82]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na këshilloi që të mos thellohemi shumë në analiza në lidhje me Qenien e Zotit, sepse mund të vijmë në pyetje të ngjashme me ato që u përmendën më herët dhe mund të devijojë nga besimi i saktë, por për të arritur bindje më të thellë, edhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem edhe Zoti në shumë ajete në Kuran na kanë bërë thirrje që të meditojmë në lidhje me krijesat që Ai ka krijuar. Transmeton Ibni Umeri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Meditoni rreth krijesave të Zotit, e mos meditoni për (Qenien) e Zotit".*[83] Po ashtu, Allahu xh.sh. na thotë në Kuran: **"Është fakt se në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit dhe tokës, ka argumente për një popull që ka mend".**[84]

Po ashtu, kur u zbritën *ajet*-et: **"Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që Allahun e përmendin me përkushtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës (duke thënë: "Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të Zjarrit".**[85] Me rastin e zbritjes së këtyre ajeteve, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem qau shumë dhe kur Bilali r.a. e pyeti për arsyen, ai i tha: *"A*

[82] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Halki, bab 11, nr.3276; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 60, nr.134; kurse te Ebu Davud-i në "Sunen", kitab Sunneti, bab fi`l-xhehmijeti, nr.4722 vjen me shtesën: "*le të thotë: `Allahu Ehad, Allahu Samed, lem jelid ve lem juled, ve lem je kul-lehu kufuven ehad" pastaj le të pështyjë tri herë në anën e majtë dhe të thotë: "Eudhu bilahi minesh-shejtani`r-raxhim"*. Në "Musned" të Ahmed-it, (vëll.15, fq.10) hadithi 9027, lutja "Allahu Ehad..." dhe deri në fund jepet si transmetim *meukuf*, d.m.th. sipas versionit të imam Ahmed-it kjo lutje në fund të kësaj vesveseje, është mendim i Ebu Hurejres r.a. dhe jo hadith i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Mirëpo, si do që të jetë, hadith i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem apo mendim i Ebu Hurejres r.a., një gjë është e sigurtë, se kjo lutje është ilaç i këtyre cytjeve dhe këtë e di çdokush që ka kaluar në kësi cytjesh të shejtanit.

[83] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.6, fq.250, nr.6319;

[84] Kurani, Bekare, 164;

[85] Kurani, Ali Imran, 190-191;

mos jem rob falënderues?! I mjeri ti, si të mos qaj, kur sonte më kanë zbritur këto ajete? Mjer për atë i cili i lexon ato dhe nuk mediton rreth tyre".[86]

Në transmetimin e Ebu Davudit i cili po ashtu e shënon këtë *hadith kudsij*, ai në fund regjistron se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka këshilluar për ata që ndjejnë dyshime të tilla, të lexojnë *sure*-n Ihlas, e cila jep shpjegim rreth kësaj dileme dhe largon dyshimet për këto cytje. Zoti në këtë *sure* thotë: **"Thuaj Ai Allahu është Një. Atij i mbështetet çdo krijesë. Nuk ka lindur kë, e as që është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë".**[87]

Çdo besimtarë duhet ta kuptojë dhe ta ketë të qartë se *shejtani* është armik i tij dhe se ai mundohet me çdo kusht që ta çojë në devijim, sidomos qëllimi primar i tij është që fundi i njeriut të jetë Xhehenemi. Zoti thotë: **"...me të vërtetë, *shejtan*-i është armik i hapur i juaji".**[88]

[86] Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1988, vëll.2, fq.386-387, nr.620; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të kësaj vepre, thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i fortë sipas kushteve të Muslimit..

[87] Kurani, Ihlas, 1-4;

[88] Kurani, Bekare, 168;

HADITHI I TETË (8)

حَدَّثَنَا أَبُو اليَمَانِ، حَدَّثَنَا شُعَيْبٌ، حَدَّثَنَا أَبُو الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " قَالَ اللَّهُ: كَذَّبَنِي ابْنُ آدَمَ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ ذَلِكَ، وَشَتَمَنِي وَلَمْ يَكُنْ لَهُ ذَلِكَ، فَأَمَّا تَكْذِيبُهُ إِيَّايَ فَقَوْلُهُ: لَنْ يُعِيدَنِي، كَمَا بَدَأَنِي، وَلَيْسَ أَوَّلُ الخَلْقِ بِأَهْوَنَ عَلَيَّ مِنْ إِعَادَتِهِ، وَأَمَّا شَتْمُهُ إِيَّايَ فَقَوْلُهُ: اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا وَأَنَا الأَحَدُ الصَّمَدُ، لَمْ أَلِدْ وَلَمْ أُولَدْ، وَلَمْ يَكُنْ لِي كُفُؤًا أَحَدٌ"

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se i Dërguari i All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"All-llahu i Lartësuar ka thënë:* ***"Biri i Ademit më përgënjeshtroi dhe nuk kishte të drejtë ta bëjë këtë gjë. Dhe ai më shau duke mos pasur të drejtë ta bëjë këtë gjë. Më përgënjeshtroi kur tha: "All-llahu nuk do të më rikthejë ashtu siç më krijoi herën e parë (dmth nuk do të më ringjallë pas vdekjes)", ndërsa krijimi fillestar i tij nuk është më i lehtë se ringjallja e tij". Më shau kur tha: `All-llahu ka djalë`, kurse Unë jam Një, Strehim i Përherëshëm, nuk kam lindur (dikë), e as që Jam i lindur (nga dikush) dhe askush me Mua nuk është i barabartë!"***[89]

Në këtë *hadith* Allahu xh.sh. e refuzon dhe e kritikon bindjen e gabuar të idhujtarëve, ateistëve dhe materialistëve, të cilët thonë se ringjallja e njerëzve nuk është e vërtetë dhe nëse njeriu do të shkatërrohet në varr ose në ndonjë hapësirë, ai më nuk do të ringjallet. Ata dëshirojnë të përgënjeshtrojnë lajmin e Zotit për ringjalljen edhe pse këtë qartë e kanë konfirmuar të gjitha Librat e shpallura dhe pejgamberët e dërguar. Zoti e krahason mohimin e ringjalljes, të barabartë me mohimin e Zotit, sepse ai që

[89] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Tefsiri, bab sure Kul hu vallahu ehad (112), nr.4974; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 117, nr.2080; Ahmed-i, "Musned", 13/531, nr.8220; Ky hadith përcillet edhe nga Ibni Abasi r.a. që e shënon Dejlemi-u, në "Firdeus", vëll.3, fq.180, nr.4488;

mohon mundësinë e ringjalljes, ai mohon fuqinë e Zotit për një gjë të tillë, kurse mohimi i Cilësisë së Zotit, është mohim i Qenies së Tij.

Mohimi i ringjalljes ka qenë prezent edhe në kohën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që na rrëfen edhe Kurani, ku Ai thotë: **"Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: "Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i Dijshëm për çdo krijim"**.[90]

Këtë besim e kanë sot shumë prej ateistëve dhe idhujtarëve nëpër botë, të cilët mohojnë gjithçka në lidhje me çështjet fetare. Zoti tregon për mohimin e tyre dhe kundërshton atë bindje të prishur, duke iu thënë: **"Ata që nuk besuan, menduan se kurrsesi nuk do të ringjallen. Thuaj: "Po, pasha Zotin tim, patjetër do të ringjalleni dhe do të njiheni me atë që keni punuar, ajo për All-llahun është lehtë!".**[91]

Po ashtu edhe në ajetin tjetër thotë: **"Ata thanë: "Nuk ka tjetër, vetëm kjo jeta jonë në këtë botë, dhe ne nuk do të rigjallemi". Dhe, sikur t'i kishte parë ata kur të ndalohen para Zotit të tyre e u thuhet atyre: "A nuk është kjo (ringjalja) e vërtetë?" Ata thonë: "Po, për Zotin tonë!" Thotë: "Shijoni pra dënimin për atë që mohonit!".**[92]

Mohimi i ringjalljes ka filluar shumë herët në mesin e njerëzve, duke qenë prezent që nga koha e Hudit a.s. Këtë e konfirmon Kurani ku thotë: **"Mos vallë ai (Hudi a.s.) po ju premton se pasi të vdisni, të bëheni dhe e eshtra (të kalbur), do të nxirreni të gjallë? Sa larg është sëndërtimi i asaj që premtoheni. Nuk ka tjetër, pos jetës sonë të kësaj bote, vdesim, lindim dhe nuk do të ringjallemi!".**[93]

Zoti tregon se për të aspak nuk është e vështirë ringjallja e njerëzve për së dyti, siç nuk ka qenë vështirë për të as krijimi i parë. Ai thotë në Kuran: **"Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lehtë për Te (sipas mendimit tuaj). Shembëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e tokë dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti".**[94]

---

[90] Kurani, Jasin, 78-79;
[91] Kurani, Tegabun, 7;
[92] Kurani, En`am, 29-30;
[93] Kurani, Mu`minun, 35-37;
[94] Kurani, Rum, 27;

Ne besimtarët musliman jemi të bindur plotësisht se një ditë kjo botë do të përfundojë dhe çdo gjë do të merr fund, e më pas, Allahu xh.sh. do të ringjall përsëri krijesat dhe do t`i llogarit në Ditën e Gjykimit, e më pas çdokush do të merr rrugën e tij për në Xhenet ose Xhehenem. Se besimi në ringjallje është kusht i *iman*-it, dëshmon edhe transmetimi nga Ebu Hurejre r.a. se një njeri e pyeti Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Çka është Imani?" Ai tha: *"Iman është të besosh në Allahun, në melekët e Tij, në takimin me Të, në pejgamberët e Tij dhe të besosh në Ringjalljen"..."*.[95]

Po ashtu, në pjesën e dytë, Zoti kritikon edhe bindjen e ithtarëve të Librit, të cilët nuk e mohojnë Zotin dhe Ringjalljen, por ato i përshkruajnë Zotit fëmijë. Këtë na e thotë edhe Kurani: **"E jehuditë thanë: "Uzejri është djali i All-llahut", e të krishterët thanë: "Mesihu është djalë i All-llahut". Ato ishin thënie të tyre me gojët e veta (fraza të thata), që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm. All-llahu i vraftë, si largohen (nga e vërteta)! Ata i konsideruan "ahbarët" (rabinët) të tyre, "ruhbanët" (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj All-llahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë".[96]**

Për këtë shpifje që i bënë Zotit, gjithashtu thuhet në Kuran: **"Ata thanë: "I Gjithëfuqishmi ka fëmijë". Ju (jobesimtarë) vërtet sollët një fjalë shumë të shëmtuar. Aq të shëmtuar sa gati u copëtuan qiejt, gati pëlciti toka dhe gati u shembën kodra nga ajo (fjalë). Për atë se të Gjithëmëshirshmit i përshkruan fëmijë. E të Gjithëmëshirshmit nuk i takon të ketë fëmijë. Nuk ka tjetër, vetëm se githë çka është në qiej e në tokë ka për t'iu paraqitur Zotit si rob. Ai me diturinë e vet i ka përfshirë të githë, dhe ka numëruar e evidentuar çdo gjë të tyre në mënyrë të saktë. Dhe në ditën e Kijametit secili do t'i paraqitet Atij i vetmuar".[97]**

Zoti nuk ka nevojë që të ketë fëmijë dhe të lind, sepse për të mjafton që t`i thotë diçkaje vetëm "bëhu" dhe ajo bëhet. Këtë mesazh ua ka përcjellë edhe Uzejri edhe Isai a.s. porse ata e ndryshuan të vërtetën dhe shpifën mbi Zotin, duke i përshkruar Atij mangësi. Thuhet në Kuran: **"Nuk i takoi (nuk ka nevojë) All-llahu të ketë ndonjë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një**

[95] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab suali Xhibrile`n-nebijje ani`l-imani, nr.50; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab bejanu`l-imani, nr.9; etj.
[96] Kurani, Teube, 30-31;
[97] Kurani, Merjem, 88-95;

send Ai vetëm i thotë atij: "Bëhu!" dhe ai menjëherë bëhet. (Isai i tha popullit të vet) Dhe se All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra adhuronie Atë, kjo është rruga (fe) e drejtë".[98]

Zoti e konfirmon besimin e pastër Islam në suren Ihlas, ku u tregon të gjithëve për Qenien e Tij, ku thotë: **"Thuaj: "Ai Allahu është Një. Atij i mbështetet çdo krijesë. Nuk ka lindur kë, e as që është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë".**[99]

[98] Kurani, Merjem, 35-36;
[99] Kurani, Ihlas, 1-4;

HADITHI I NËNTË (9)

حَدَّثَنَا الحُمَيْدِيُّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، حَدَّثَنَا الزُّهْرِيُّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ المُسَيِّبِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: " يُؤْذِينِي ابْنُ آدَمَ يَسُبُّ الدَّهْرَ وَأَنَا الدَّهْرُ، بِيَدِي الأَمْرُ أُقَلِّبُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ"

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se i Dërguari i All-llahut sallallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *''All-llahu i Lartësuar ka thënë:* ***"Biri i Ademit më fyen, e shan kohën, e në fakt Unë jam koha, në Dorën Time është çështja, e ndërroj natën dhe ditën".***[100]

Imam Ahmedi këtë transmetim e sjellë me këtë tekst: *''Thotë Zoti:* ***"I kam dhënë hua robit Tim, e ai nuk më ka dhënë hua. Më përshkruajti mangësi robi Im gjersa ai nuk dinë. Thotë: "Ah mjerë koha, ah mjerë koha" kurse Unë jam koha".***[101]

Zotit nuk i përshkruhet asnjë mangësi, sepse Cilësitë e Tija janë të plota dhe Emrat e Tij të bukur, andaj nuk duhet të mendohet se fyerja e jonë arrin deri te Zoti dhe se Ai dëmtohet me të, nga shkaku se Ai nuk dëmtohet edhe nëse të gjithë njerëzit do të ishin si njeriu më i prishur dhe do ta ofendonin Zotin, po ashtu nuk do të shtohej sundimi i Tij edhe nëse të gjithë njerëzit do të ishin si njeriu më i devotshëm në tokë.

Ky *hadith* është marr nga armiqtë tanë dhe është interpretuar me kuptimin se Zoti është koha, ose se koha është e barabartë dhe e vjetër me Zotin, ose se koha nuk është e krijuar, siç pandehnin disa prej natyralistëve dhe

[100] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Tefsiri, bab tesfir sure Xhathije, nr.4826, në kitab el-Edebu, bab 101, nr.6181 dhe në kitab et-Teuhidi, bab 35, nr.7491, po ashtu e shënon edhe në librin "Edebu`l-Mufred", bab 331, nr.770; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Elfadhu mine`l edebi ve gajriha, bab 1, nr.2246; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab 180, nr.5274; etj.

[101] Ahmed-i, "Musned", 13/368, nr.7988; Shuajb el-Arnauti thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Hasen;

filozofëve. Por që në fillim do të përgjigjemi se Zoti është Krijues i kohës, e nuk është Ai vet koha, pasi koha është krijesë, e Zoti nuk përngjasohet me krijesat e Tija. Po ashtu, nuk mund të themi se koha është e barabartë me Zotin (*kadim)* pasi të gjitha gjërat që janë të krijuara kanë fillim, kurse Zoti nuk është krijesë, por Krijues dhe Ai nuk ka fillim. Gjithashtu te ideja e tyre se koha nuk është e krijuar, ka lëshim sepse Zoti është jashta kohës dhe hapësirës dhe nuk ngërthehet nga krijesat e Tija, Ai nuk është i varur prej tyre dhe nuk ka nevojë për to, kurse koha është e filluar në një pikë të caktuar dhe nuk mund të pretendohet se nuk ka fillim.

Nuk mund të themi se koha është sikur Zoti ose të jetë zot, pasi Zoti është pa fillim dhe pa mbarim, ndërsa koha ka fillimin e vet. Zoti është krijues i kohës, kurse koha është e krijuar dhe nuk është e krijuar vetvetiu. Apo të themi se Zoti është i barabartë me kohën dhe Zotin e përfshin koha, që del se Zoti është i krijuar siç është koha e krijuar, gjë që është e pamundur. Këto komente dhe interpretime janë nga ata që nuk e kanë kuptuar Qenien e Zotit.

Ky *hadith* bën pjesë në *hadith*-et *Muteshabiha* (hadithe me më shumë se një kuptim), nuk lejohet të komentohet fjalë për fjalë dhe është e pamundshme që të definohet saktësisht qëllimi i tij, pasi *hadith*-i është me kuptim metaforik e nuk mund të kuptohet nga teksti por duhet të shikohet qëllimi. Duhet theksuar se jo të gjitha *hadith*-et e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem duhen kuptuar tekstualisht sidomos kur kanë të bëjnë me tekstet *muteshabiha*. Pra, përkthimi kuptimor i *hadith*-it është *"mos e shani kohën se unë jam Krijuesi i kohës"*. Siç thotë Zoti në Kuran: **"Allahu është dritë e qiejve dhe tokës".**[102] Që ka për kuptim: "Allahu është Zot, Krijues dhe udhëzues i qiejve dhe tokës".

Për të kuptuar më mirë edhe kontekstin e *hadith*-it, duhet të shikohet edhe rrethana në të cilën është shprehur *hadith*-i, si dhe nivelin e përdorimit të alegorisë në gjuhën e pastër arabe të asaj kohe kur është thënë ai *hadith.* Injorantët në kohën e paganizmit thoshin: "Qoftë e mbrapshtë koha, na u bë kjo e kjo". Pra, veprat e Allahut të Madhërishëm ia veshin kohës dhe e shajnë atë. Ndërkaq, realisht këto gjëra i bën Allahu xh.sh. Për këtë, u ndalua sharja e kohës.

Sipas imam Nevevi-ut ky *hadith* ka kuptim alegorik dhe shkaku i tij është se arabët e kanë pasur shprehi të fyejnë kohën në raste mjerimi, fatkeqësie dhe në ndodhitë e këqija që iu kanë ndodhur, si humbja e pasurisë, pleqëria ose

[102] Kurani, Nur, 35;

vdekja, e në këso raste thoshin: "Oj kohë e mjerë!", e pastaj është thënë ky *hadith* për tu tërhequr vërejtjen, që mos e shani Krijuesin e fatkeqësive, pra, mos e shani kohën.[103]

Sipas Shafii-ut dhe Ebu Ubejdes, kur arabët e shanin kohën, ata kanë sharë Krijuesin e asaj kohe, pra nuk janë pajtuar me *Kader*-in e Zotit, sepse bërësi i fatkeqësisë është Allahu e nuk është koha, e për këtë e ka ndaluar sharjen e kohës.

Me këtë *hadith*, Zoti tregon që është Pronari i kohës dhe udhëheqësi me gjërat të cilat kanë të bëjnë me kohën. Sipas kësaj, ai i cili e shan kohën për atë pse ajo e bënë atë dhe e bartë, ai në këtë mënyrë do ta shan Krijuesin e vet, i Cili e ka krijuar atë, d.m.th. kohën.

Ibni Kajjim el-Xheuzijje thotë: "Në këtë ndalesë (në sharjen e kohës) përfshihen tri rreziqe të mëdha. Rreziku i parë, është sepse shahet ajo që nuk e meriton sharjen, sepse koha është njëra nga krijesat e nënshtruara të Allahut xh.sh. e cila i nënshtrohet ligjeve të Tij dhe e cila është e përulur. Prandaj, sipas kësaj, ai i cili e shanë kohën, domosdoshmërisht duhet të shahet dhe të urrehet.

Rreziku i dytë, është sepse ajo sharje në vete përmban *shirk*, sepse ai i cili e shan kohën, e shanë atë për shkak se mendon se ajo atij i sjell dëm dhe dobi. Përveç kësaj, sharësi në të njëjtën kohë, është edhe dhunues, sepse i bënë dëm atij që nuk e meriton atë, i ka dhënë ndokujt diç që nuk e meriton, ia ka ndaluar dikujt diç, që nuk e meriton që ajo t`i ndalohet. Koha te ata që e shajnë atë është dhunuesi më i madh. Kështu shumë të paditur janë kategorik në mallkimin dhe nënçmimin e saj (kohës).

Rreziku i tretë i sharjes së kohës, është ajo sepse sharja e tyre ka të bëj me Atë i Cili e ka krijuar rrethanën kohore, sikurse e vërteta t`i pasonte epshet e tyre, do të zhdukeshin qiejt e toka. Andaj, për shembull, nëse koha do të ishte në përputhshmëri me epshet dhe dëshirat e tyre, atëherë ata do ta lavdëronin dhe do ta lartësonin atë... Andaj, në të gjitha këto, koha nuk ka asnjëfarë ndikimi. Sipas kësaj, sharja e kohës në të vërtetë është sharja e Allahut xh.sh. prandaj të sharët e kohës, e hidhëron Atë.

Pra, sharja e kohës, sillet në mes dy mundësive, njëra prej tyre ka të bëj me atë i cili e shanë. E para, ai i cili e shanë kohën e shanë Allahun, ndërsa e

[103] Nevevi-u, "Sahih Muslim bi sherh Nevevij", Daru`sh-Shuab, Kajro, vëll.5, fq.102-103;

dyta që ai me atë sharje bën *shirk*, sepse nëse është i bindur që koha së bashku me Allahun, kanë ndikim mbi jetën, atëherë ai në të vërtetë është *mushrik* (politeist), por nëse është i bindur që vetëm Allahu e jep kohën edhe përkundër kësaj, ai e shanë Atë i Cili e ka dhënë kohën, atëherë ai në të vërtetë e ka sharë Allahun".[104]

Nëse shahet koha duke pasur për qëllim sharjen e Krijuesit të kohës është *kufër* por nëse e shajmë kohën duke mos pasur qëllim Zotin, edhe kjo është haram pasi besimtari duhet të bëj durim, e nëse vetëm themi `oh, kohë e nxehtë ose kohë shumë ftohtë`, me këtë nuk gabojmë asgjë.

Koha është e krijuar nga Allahu xh.sh., e si krijesë e Zotit, kuptojmë se ndalohet të shahet krijesa e Tij. Pa marrë parasysh se çfarë krijese bëhet fjalë, Zoti ndalon që të shahet siç thotë një fjalë e urtë: "Respektoje krijesën për hir të Krijuesit", e pasi sharja e kohës nënkupton sharje indirekte të Zotit, sepse kur e shan krijesën e Zotit, e shan Krijuesin, ngjashëm sikur ia ofendon dikujt veprën, e ofendon autorin.

Allahu xh.sh. e ndaloi sharjen në tërësi, e kur njeriu shahet, ai do të shajë ndonjë krijesë, e Zoti nuk do që t`i shahet krijesa, por pasi nuk i cek që të gjitha krijesat, e ka zgjedhur kohën për vlerën e madhe që ka dhe Zoti thirret përmes saj se "Unë jam Koha".

Sharja e kohës nënkupton edhe mospajtim me pëlqimin e Zotit ose caktimin e Tij. Kur njeriu shan kohën, ngjan sikur të shash *kader*-in (përcaktimin) e Zotit, sepse njeriu shan kohën kur nuk është i kënaqur me diçka që e ka goditur, kjo faktikisht është mospajtim me *kader*-in, pra, ka lidhje të ngushtë me *kader*-in e Zotit. Nuk është koha që u sjell njerëzve të mira ose të këqija, por ato i sjell Allahu xh.sh., andaj kur ti e dinë këtë fakt, atëherë sharja e kohës është sharje indirekte e Zotit.

Në shumë vende në Kuran, hasim *ajete*, që aludojnë në nxitjen e besimtarit për ndonjë vepër të caktuar dhe ndërlidhet cilësia e asaj vepre në mënyrë të drejtpërdrejt me Zotin, por nga ana tjetër këtë e bën vetëm për të treguar vlerën e asaj vepre e jo shkaku i nevojës për atë vepër. Siç është p.sh. *ajet*-i: "**O besimtarë, nëse ju ndihmoni Allahun, Ai u ndihmon juve..."**[105] Këtu Zoti nuk kërkon ndihmë nga besimtarët, por i nxit që ta mbrojnë fenë e Allahut xh.sh. Ose siç është *hadith*-i i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ku

[104] Ibni Kajjim el-Xheuzije, "Zadu`l-Mead", Ebu Hanife, Shkup, 2011, vëll.2, fq.345-347;
[105] Kurani, Muhamed, 7;

interpreton fjalët e Zotit: *"Unë isha i uritur e ti nuk më ushqeve!"* Njeriu thotë: "Po si të ushqej kur Ti je Zoti i botave" *"...Unë isha i sëmurë e ti nuk më vizitove..."* etj, dhe shprehje të ngjashme me këto, pra, nuk nënkuptojnë se Zoti ka nevojë për diçka, por pjesa e cila i referohet diçkaje, tregon se ai send ka vlerë, si ndihma ndaj besimtarëve, ndihma ndaj fesë, dhënia ujë udhëtarit, vizita e të sëmurëve, të ushqyerit varfanjakët. Zoti i përshkruan gjërat sikur njeriu është duke ia bërë të mirën direkt Zotit edhe pse ai ia bën të mirën njerëzve, pra, edhe koha ka një vlerë të veçantë te Allahu xh.sh., mu për këtë edhe Ai thirret me të.

Allahu xh.sh. disa gjëra i quan me emra që ndërlidhen me Emrin e Tij, por të gjithë dijetarët janë unik se ato nuk nënkuptojnë se Zoti është i nevojshëm për to. Raste të tilla në Kuran kemi shumë si p.sh. xhamisë ose Qabes i thuhet *Bejtullah* (shtëpia e Zotit) por ne e dimë se Zoti nuk ka nevojë për shtëpi, por për shkak të vlerës së madhe që ka xhamia, quhet kështu.[106] Po ashtu thotë: **"E Pejgamberi atyre u pat thënë: "Kini kujdes devenë e All-llahut (*Nakatallahi*)...".[107]** Pra, deveja është deve, por nga vlera që ka pasur deveja që Zoti e nxori si mrekulli në kohën e Salihut a.s., është quajtur Deveja e Zotit. Raste të ngjashme në Kuran kemi shumë, andaj ne nuk do t`i përmendim të gjitha ajetet që përmenden në këtë drejtim.[108]

Duhet ndalur pak edhe në sqarimin e fjalës "*Ed-Dehru*" që d.m.th. *kohë, epokë, periudhë, i përhershëm, i amshuar*. Fjala *Dehrun* në Kuran përmendet 2 herë.[109] Disa komentues kanë deklaruar se emri "*dehr*" i cekur në *hadith* është një ndër emrat e Zotit prandaj thotë mos e shani kohën se "*ed-Dehru*" jam Unë, kurse disa kanë thënë se "*Dehrun*" nuk është nga emrat e Zotit. Emrat e Allahut janë të gjithë të bukur, sepse përmbajnë domethënie të përkryera dhe bëhet e ditur që *Ed-dehru* nuk është prej emrave të Allahut. Kjo fjalë (koha) nuk përmban domethënie të bukur dhe të përkryer që të jetë prej emrave të Allahut dhe se "*Ed-Dehru*" është emër i kohës, koha është e krijuar, ajo është – "kalimi i ditëve dhe i netëve". Allahu xh.sh. thotë në Kur'an për mohuesit e ringjalljes: **"Ata thanë se kjo nuk është gjë tjetër vetëm se jetë e kësaj bote, vdesim e ngjallemi dhe nuk na shkatërron (zhduk) vetëm se (Ed-dehru) koha".** Këtu bëhet fjalë se shkatërruese është "*ed-Dehru*" e cila është: "kalimi i ditëve dhe i netëve". Ndaj –*"Ed-dehru"*

[106] Shih: Kurani, Haxh, 26;
[107] Kurani, Shems, 13;
[108] Mund të shihni ajetet: "Ibadallah" (rob të Zotit) (Safat 40); "Resulullah" (I Dërguari i Allahut) (Ahzab 40); "Ruhilah" (shpirti i Zotit) (Jusuf 87); "Ardullah" (toka e Zotit) (A`raf, 73). E shumë ajete tjera;
[109] Kurani, në suren Xhathije, 24 dhe Insan, 1;

(koha), nuk ka ndonjë domethënie të bukur, të përkryer që të jetë emër prej emrave të bukur të Allahut xh.sh.

Në *hadith*, koha është përshkruar si diçka që ndryshon dhe rrotullohet. Allahu nuk mund të jetë Ai që ndryshon dhe rrotullohet, por Ai është që bën ndryshimin dhe rrotullimin. Të gjitha këto fakte, tregojnë se koha nuk është prej emrave të bukur të Allahut. Se Allahu xh.sh. është Ai që rrotullon ditën dhe natën, shërben si argument edhe ajeti: **"Allahu bën rrotullimin e natës dhe ditës dhe në të gjitha këto ka fakte për ata që kanë të parit e shëndoshë".**[110]

Allahu xh.sh. është Ai që ka krijuar edhe materien edhe kohën, por në të njëjtën kohë është i pavarur prej të dyjave, sepse Zoti nuk ka nevojë për asgjë.

[110] Kurani, Nur, 44;

HADITHI I DHJETË (10)

حَدَّثنا مُحَمد بن يحيى بن ميمون، قَال: حَدَّثنا عَبد الوهاب بن عطاء بن عوف عَنِ الْحَسَنِ، عَن النَّبِيّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيه وَسَلَّم رفعه قال:" لا أجمع على عَبدي خوفين وأمنين إن أخفته في الدنيا أمنته في الآخرة، وَإن أمنته في الدنيا أخفته في الأخرة".

Transmeton Haseni (Hasan el-Basriu) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë nuk do të bashkoj dy siguri dhe dy frikësime tek robi Im. Kush sigurohet prej Meje në këtë botë, do ta frikësoj në ahiret, e kush frikësohet prej Meje në këtë botë, do ta siguroj në Ahiret".***[111]

Allahu xh.sh. dëshiron që zemra e robit të jetë e lidhur për Të, të ketë në zemër drojë vetëm ndaj Tij dhe të mos i frikësohet dikujt tjetër pos Allahut xh.sh.

Druajtja është ngushtë e ndërlidhur me zemrën e njeriut, pasi aty përqendrohet esenca e saj. Ai që nuk ka frikë nga Zoti, ai është në gjendje të bëjë gjithçka, pasi zemra e tij nuk njeh pushtet dhe nuk shpreson në ringjallje në botën tjetër. Për të arritur frikërespektin në zemër, duhet të njohim Allahun xh.sh. dhe cilësitë e Tij, për të kuptuar Fuqinë Absolute e cila na kontrollon, prej kësaj do të burojë në zemër frikërespekti ndaj Krijuesit.

---

[111] Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", vëll.14, fq.342, nr.8028; Ibni Mubarek-u, "Zuhd", Daru`l-Kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i dytë, 2004, fq.85, nr.157-158; Ibni Hiban-i, "Sahih", sipas radhitjes së Ibni Belbanit në "Ihsan", vëll.2, fq.406, nr.640; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", vëll.1, fq.270 përmes Shedad b. Eusit r.a.; Dejlemi-u, "Firdeus", vëll.3, fq.174, nr.4465; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të librit të Ibni Hibanit, për këtë hadith thotë se e ka zinxhirin e mirë, transmetuesit të besueshëm dhe thotë se ka hadith dëshmi që e përforcon e që gjendet tek Ibni Mubareku me zinxhir Sahih;

Vetë i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë se ai është njeriu që më së shumti i frikohet Allahut xh.sh. e kur ai i cili nuk ka pasur mëkate, është frikësuar aq shumë prej Zotit, atëherë çka ngelë për ne, të cilët jemi të zhytur në mëkate?! Nga kjo, duhet të kuptojmë se frikërespekti është një veti fisnike, që duhet ta posedojë çdo besimtarë, që të jetë zemra e nënshtruar dhe adhuruese.

Në *hadith*-in e lartshënuar, Zoti na tregon se Ai nuk bashkon në zemrën e robit dy frika ose dy sigurime, nëse njeriu frikësohet prej Allahut në këtë botë, ai do të jetë i sigurtë në botën tjetër, pasi ka shpresuar në takim me Zotin dhe ka qenë i përgatitur për atë ditë. Por, personi i cili ndjehet i sigurtë në këtë botë, ai nuk shpreson në ditën e ringjalljes dhe daljes para Zotit, ky do të jetë i trishtuar në atë ditë kur nuk ka ndihmës dhe as ndërmjetësues, pos me lejen e Allahut xh.sh.

Pra, robi nuk do të përjetojë frikë edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, porse vetëm në njërën, ose në këtë botë të ketë frikë prej Zotit që të jetë i sigurtë në botën tjetër, ose të ndjehet i sigurtë në këtë botë dhe të trishtohet në botën tjetër. Nuk mundet të jetë i sigurtë në këtë botë e pastaj të jetë ashtu edhe në botën tjetër, po ashtu nuk mundet ai që ka pas frikë Zotin në këtë botë, të jetë i trishtuar në botën tjetër.

Ky nivel i frikërespektit arrihet përmes diturisë dhe hulumtimit. Pasi edhe Zoti në Kuran, na tregoi që dijetarët dhe të mençurit, janë ata që kanë më së shumti frikë Zotin, sepse e njohin Madhështinë dhe Fuqinë e Tij. Zoti thotë në Kuran: **"Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, All-llahu mbi gjithçka është mëkatfalës".**[112]

Kjo është një cilësi që duhet ta ketë çdo besimtarë i sinqertë që shpreson në Ditën e daljes para Zotit. Zoti thotë: **"Vërtet, ata të cilët ndaj madhërisë së Zotit të tyre kanë frikë. Ata, të cilët u besojnë argumenteve të Zotit të vet dhe ata, të cilët nuk i përshkruajnë shok Zotit të vet, si dhe, ata të cilët japin (sadaka-zeqatë) nga ajo që u është dhënë, sepse e dinë që do të kthehen te Zoti i tyre, andaj zemrat e tyre i kanë të frikësuara, të tillët janë duke nxituar drejt të mirave dhe të parët do t'i arrijnë ato".**[113]

Kurse frikën në zemër të robit, e fut vetëm armiku i tij i përbetuar, *shejtan*-i, i cili dëshiron që të largojë nga zemra e besimtarit frikën ndaj Zotit dhe të

[112] Kurani, Fatir, 28;
[113] Kurani, Mu`minun, 57-61;

fus dyshime në të. Zoti na paralajmëron se *shejtan*-i me ushtrinë e tij dëshiron të mbisundojë mbi robtë e Zotit dhe t`i nënshtrojë, e nëse robi ka frikë vetëm Zotin, këtë *shejtan*-i nuk do ta arrijë kurrë. Zoti thotë: **"Po atë (propagandë) e bëri vetëm shejtani që dëshironte me miqtë e vet (idhujtarët) t'ju frikësojë, po ju mos u frikësoni prej tyre, por frikësohuni vetem prej Meje, nëse jeni besimtar"**.[114] Pra, nëse jemi besimtarë, nuk duhet të kemi frikë prej dikujt tjetër përpos Zotit, e kjo do të na jep fuqi në zemrat tona që të përballojmë çdo armiqësi. Nëse frika ndaj Zotit është në këtë nivel në shpirtërat tanë, atëherë nuk do të njohim frikë prej krijesave, e nëse nuk frikohemi prej Zotit, do të jemi prej atyre që do të kenë frikë edhe prej hijes së vet.

Ebu Umame radijeAllahu anhu transmeton se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush i frikësohet Allahut, çdo gjë do të frikësohet prej tij, e kush nuk i frikësohet Allahut, ai do të frikësohet prej çdo gjëje".*[115]

Këta rob, që patën frikë Zotin në këtë botë, ashtu edhe siç thotë hadithi, do të jenë të sigurtë në botën tjetër prej çdo lloj frike, siç potencon edhe Allahu xh.sh. në Kuran ku thotë: **"A nuk janë vërtet Evlijatë (të dashurit) e All-llahut pa frikë e brengosje? Të cilët besuan dhe ishin (prej atyre) që frikësohen. Atyre u jepen myzhde në jetën e dunjasë dhe në jetën tjetër (për shpëtim në Xhenet). Nuk ndryshojnë fjalët e All-llahut. E, ai është suksesi i madh".[116]**

Këta të cilët do të jenë të sigurt në botën tjetër shkaku se në zemra kishin frikë nga Zoti, do të kenë edhe kulminacionin e shpërblimeve, që Zoti garantoi dhe veçoi me këtë shpërblim vetëm ata që kanë frikë prej Tij, e për ta ka përgatitur dy Xhenete. Zoti thotë: **"E, për atë që i pat frikë paraqitjes para Zotit të vet, janë dy Xhenete".[117]**

Ngjashëm me këtë është edhe *ajet*-i: **"E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, Xheneti është vendi i tij".[118]**

---

[114] Kurani, Ali Imran, 175;

[115] Gazali-u, "Ihja ulumu`d-Din", mektebetu`l-Fejad, vëll.4, fq.234; Irakiu në sqarim të këtij hadithi gjatë korrigjimit të kësaj vepre, thotë: "E përcjell Ebu Shejh Ibni Hajani në "Theuab", përmes Ebu Umames me zinxhir shumë të dobët, po ashtu e përcjell Ibni Ebi Dunja në "Kitab El-Haifin" me zinxhir të dobët";

[116] Kurani, Junus, 62-64;

[117] Kurani, Rahman, 46;

[118] Kurani, Nazijat, 40-41;

Pra, besimtari duhet të ketë frikë nga rënia në mëkat, që mos e hidhërojë Zotin, gjithashtu, nuk duhet të rehatohet dhe të mos kryejë asnjë obligim, duke menduar se gjithqysh Allahu xh.sh. do ta mëshirojë, porse të jetojë në mes frikës dhe shpresës. Besimtari nuk guxon t`i nënshtrohet askujt përpos Allahut xh.sh. dhe vetëm Atij duhet t`i ketë frikë. Zoti thotë në Kuran: **"O robërit e Mi, vetëm ua të më keni frikë".**[119]

Por, këtu nënkuptohet frikërespekti, e jo trishtimi, sepse ne nuk duhet të trishtohemi prej Zotit, sepse Ai është i Dashur dhe i Butë, porse nënkupton frikërespekt, me çka nuk dëshirojmë që Zoti të na sheh në mëkat. Ngjashëm sikur një burrë i rritur, nëse babai i tij plak e qorton, djali edhe pse është burrë, nuk i kthen fjalë, jo se ka frikë se mund ta rreh, sepse ai më nuk ka fuqi për një gjë të tillë, porse nuk i kthen fjalë nga respekti. Ose, nëse një person e dashuron dikë pa masë, e nuk dëshiron që të bëjë ndonjë veprim me të cilin do ta hidhërojë, jo se i frikohet rrahjes së tij, porse frikohet të mos e humb dashurinë e tij.

Tek njeriu mund të gjendet frikë prej disa gjërave që është prej natyrës njerëzore, si frika nga luani ose ujku kur gjendemi në mal, trishtimi nga errësira, nga ngjitja në lartësi, në aeroplan, nga xhinët ose qëndrimi vetëm në dhomë, e shumë lloje të ndryshme të fobive të cilat gjenden tek njerëzit, porse që nuk ndërlidhen me frikën që elaboruam më lart.

Në lidhje me këtë, mund të përmendim edhe *hadith*-in që transmeton Maliku nga Safvan b. Sulejmi se është pyetur Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "A është e mundur që besimtari të jetë frikacak?" Ai ka thënë: *"Po".* Pastaj është pyetur: "Po a është e mundur të jetë besimtari koprac?" *"Po"* tha ai përsëri. Kur u pyet radhën e tretë: "A është e mundur besimtari të jetë gënjeshtar?" Ai tha: *"Jo".*[120]

Shpresojmë se në zemrat tona të ngjallet frikërespekti ndaj Krijuesit tonë absolut që vetëm Atë ta njohim për hyjni e askë tjetër përpos Tij.

[119] Kurani, Zumer, 16;
[120] Malik-u, "Muvetta`", kitab Husnu`l-Huluk, bab ma xhae fi`s-Sidki vel kedhibi, nr.1807;

HADITHI I NJËMBËDHJETË (11)

عبد الله بن عَمْرو: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: قَالَ الله عز وَجل: يَا جِبْرِيل إِنِّي خلقت ألف ألف أمة لَا تعلم أمة أَنِّي خلقت سواهَا لم أطلع عَلَيْهَا اللَّوْح وَلَا صرير الْقَلَم إِنَّمَا أَمْرِي لشَيْء إِذا أردْت أَن أَقُول لَهُ كن فَيكون فَلَا يسْبق الْكَاف وَالنُّون"

Transmeton Abdullah b. Amri (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sellem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"O Xhibril! Unë kam krijuar një milion umete (lloje) që asnjëri nuk dinë se Unë kam krijuar diçka përveç tij. Për këtë nuk i kam treguar Leuhi Mahfudhit e as gërvimës së Lapsit. Kur Unë dua diçka, vetëm i them: "Bëhu!" e ajo bëhet, saqë nuk ia kalon kafi nunit".***[121]

Allahu xh.sh. është i vetmi Krijues i Cili krijon në mënyrën më të përsosur. Ka krijuar njeriun dhe e ka përsosur krijimin e tij. Por, nëse shikojmë krijesat gjigante përreth nesh, do të kuptojmë se nuk jemi të vetmit në këtë gjithësi, porse Allahu xh.sh. ka krijuar edhe shumë krijesa tjera, qofshin ato më të mëdha se njeriu, qofshin edhe më të imta.

Krijesat e Zotit, ndahen në ato që logjikojnë dhe në ato që nuk logjikojnë. Ata që logjikojnë janë njerëzit, xhinët dhe melekët. Kurse bota e cila nuk logjikon, janë të gjitha krijesat tjera të cilat i dijmë.

Edhe krijesat e ndryshme, si shpendët, kafshët, insektet, janë soj në vete, sepse edhe ata kanë sistem të organizimit të jetës. Këtë e potencon edhe Zoti në një shembull, ku i përmend shpendët fluturuese ku thotë: **"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk janë të ndara në grupe (*umemun-lloj*), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi, i pajisi si**

[121] Dejlemi-u, "Firdeus", vëll.3, fq.184, nr.4504; Mutekil el-Hindi, "Kenzu`l-Ummal", Bejtu`l-Ifkar, Jordan, botimi i dytë, 2005, fq.1340, nr.29.844; **(fjala "kun" përbëhet prej këtyre dy shkronjave (Kef dhe nun) pra, e krijoj më shpejt se koha që merr shqiptimi i fjalës "kun");**

juve). Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca. Më në fund te Zoti i tyre do të tubohen".[122]

Por ka edhe shumë prej krijesave tjera që ne nuk e dimë ekzistencën e tyre, pasi Zoti nuk ka folur për ta. Kështu potencon edhe në Kuran: **"...e Ai krijon çka ju nuk dini".[123]**

Zoti më së miri e di atë që ka krijuar dhe e di se çka gjendet në mes qiejve dhe tokës. Thotë në Kuran: **"..A nuk u kam thënë juve, se Unë më së miri e di fshehtësinë e qiejve e të tokës...".[124]**

Sa e sa krijesa janë krijuar që ne nuk e dimë numrin e tyre. Sa *melek* ka në ekzistencë që numri i tyre është i pakapshëm për mendjen e njeriut. Po sa *xhin* e sa njerëz, sa shpezë, sa insekte, sa kafshë e sa yje, të gjitha këto nuk mund t`i përfshijë njeriu me mendjen e tij, edhe pse janë gjëra që duken, por vallë, si është puna me ato që nuk i sheh syri i njeriut?!

Ka gjëra, të cilat Zoti as që i ka shkruar në *Leuhi Mahfudh* e as që Lapsi i ka regjistruar. Por, nëse dëshira e Zotit është që diçka të realizohet, ai vetëm i jep urdhër që të bëhet dhe ajo në atë çast menjëherë bëhet.

Zoti thotë në Kuran: **"Ai është shpikës i qiejve e i tokës (pa kurfar modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: "Bëhu!" në atë moment bëhet".[125]**

Dituri rreth krijesave të Tija, nuk ka as edhe meleku më i dalluar, Xhibrili alejhi`s-selam, andaj këto janë fshehtësitë e Zotit që nuk mundet t`i zbulojë askush.

Zoti thotë në Kuran: **"Vetëm Atij i takon pushteti i qiejve, i tokës dhe ç'ka mes tyre. Ai krijon çdo gjë që dëshiron. All-llahu është i Gjithfuqishëm për çdo gjë".[126]**

Vet fakti që këtu përmendet distanca mes qiejve dhe tokës, tregon se numri i tyre është shumë i madh dhe numërimi i tyre është i pamundshëm.

---

[122] Kurani, En`am, 38;
[123] Kurani, Nahël, 8;
[124] Kurani, Bekare, 33;
[125] Kurani, Bekare, 117;
[126] Kurani, Maide, 17;

Sot shumë shpesh bëhet pyetje se a është e mundur të ekzistojnë UFO-të (Anije kozmike të pa identifikuara) dhe a ka jetë në planete tjera?! Shkenca ende nuk ka zbuluar ndonjë fakt rreth kësaj, porse është logjike që Zoti nuk e ka krijuar gjithë këtë univers gjigant vetëm për njeriun, i cili as që vërehet në univers. Kjo është e ngjashme sikur një njeri të ndërtojë një ndërtesë njëqind katëshe, por të jetojë vetëm në një dhomë, kurse tjerat të jenë të zbrazura. Kështu kot nuk punon Zoti i gjithësisë. Por, as mos harrojmë se iluzioni i UFO-ve është shpikje e kinematografisë amerikane dhe ndoshta edhe një konspiracion nga shoqëritë e fshehta okultiste, për të arritur qëllime të caktuara. Por, është shumë logjike të ketë edhe krijesa tjera në galaktikë dhe kjo nuk është diçka e pamundshme. Thotë Zoti në Kuran: **"Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja; dhe Ai me fuqinë e Tij mund t`i bashkojë kur të dëshirojë".**[127] Shohim se Zoti ka shpërndarë krijesa të ndryshme nëpër qiej dhe Tokë, e askush nuk e dinë se çka mund të ketë krijuar Zoti prej krijesave të ndryshme, kurse bashkimi në mes tyre është i mundshëm, kur atë e dëshiron Zoti.

Pjesa e *hadith*-it ku thuhet se ***"...Për këtë nuk i kam treguar Leuhi Mahfudhit e as gërvimës së Lapsit..."*** bie në kundërshtim me disa tekste tjera të sakta, si p.sh. me *ajet*-in kuranorë ku Zoti thotë: **"A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë që është në qiej dhe në tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër. Me të vërtetë kjo është e lehtë për Allahun".**[128]

Po ashtu, bie në kundërshtim me *hadith*-e të sakta, si përcjellja nga Imran b. Husajni r.a. ku Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...ishte Allahu dhe nuk kishte asgjë tjetër përveç Tij. Arshi i Tij ishte mbi ujë dhe pastaj në "Dhikër" (Leuhi Mahfudh) regjistroi çdo gjë..".*[129] Pra, këtu shohim se asgjë nuk është lënë anash prej evidentimit, prandaj, vije në shprehje dyshimi rreth saktësisë së këtij *hadithi kudsi*, sepse bie në kundërshtim me tekste më të sakta, kështu që kjo pjesë nuk pranohet si e saktë.

Është e vërtetë se vetëm Zoti e di numrin e gjërave që ka krijuar, siç thuhet edhe në *ajet*-in kuranor: **"dhe (Ai) e dinë numrin e çdo sendi".**[130]

---

[127] Kurani, Shura, 29;
[128] Kurani, Haxh, 70;
[129] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Halki, bab 1, nr.3191; etj.
[130] Kurani, Xhin, 28;

HADITHI I DYMBËDHJETË (12)

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ عَمْرٍو الْبَزَّارُ، ثنا حُمَيْدُ بْنُ الرَّبِيعِ، ثنا عَلِيُّ بْنُ عَاصِمٍ، ثنا سُلَيْمَانُ التَّيْمِيُّ، عَنْ أَبِي عُثْمَانَ، عَنْ سَلْمَانَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " يَا ابْنَ آدَمَ ثَلَاثٌ: وَاحِدَةٌ لِي، وَوَاحِدَةٌ لَكَ، وَوَاحِدَةٌ بَيْنِي وَبَيْنَكَ، أَمَّا الَّتِي لِي: تَعْبُدُنِي لَا تُشْرِكُ بِي شَيْئًا، وَأَمَّا الَّتِي لَكَ: فَمَا عَمِلْتَ مِنْ عَمَلٍ جَزَيْتُكَ بِهِ، فَإِنْ أَغْفِرْ فَأَنَا الْغَفُورُ الرَّحِيمُ، وَأَمَّا الَّتِي بَيْنِي وَبَيْنَكَ: فَمِنْكَ الدُّعَاءُ وَالْمَسْأَلَةُ وَعَلَيَّ الِاسْتِجَابَةُ وَالْإِعْطَاءُ "

Transmeton Selmani (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *''(Allahu xh.sh. thotë): **"O biri i Ademit, janë tre gjëra, njëra është për Mua dhe tjetra për ty, kurse e treta është në mes Meje dhe teje. Sa i përket asaj që është për Mua, ajo është të Më adhurosh vetëm Mua e të mos më shoqërosh ndonjë ortak, kurse ajo që është për ty, është që kur të punosh ndonjë punë, të shpërblej për të, e nëse të fal, dije se Unë jam Falësi i Mëshirshëm. Kurse ajo që është mes Meje dhe teje, ty të takon lutja dhe kërkesa, kurse Mua më takon përgjigja ndaj saj dhe dhënia".***[131]

Me këtë *hadith*, e shohim sa shumë na ka nderuar Allahu xh.sh. që i ka ndarë punët me ne, e nëse analizojmë me kujdes, do shohim se në thelb të gjitha këto pika janë në dobi të njeriut. Adhurimi është e drejtë e Zotit, porse prej saj përfiton edhe njeriu, si siguri në shpirt dhe paqe, ka një mbështetje të sigurt dhe e din qëllimin e jetës së vet. Ne kemi folur gjërësisht për njëshmërinë dhe mospërshkrimin e ndonjë idhulli si hyjni, që t`i bëjmë Zotit ndonjë ortak, pasi Ai është i panevojshëm për të dhe njëherit edhe e pamundur të ekzistojë ndonjë ortak i Tij. Por, Allahu xh.sh. në shumë ajete

[131] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.6, fq.253, nr.6137; Ahmed-i, "Ez-Zuhd", Daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1999, fq.42, nr.255; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 1/71, nr.152 thotë: "E transmeton Taberani në "Kebir" e në zinxhir gjendet Humejd b. Rebi`i ku disa e kanë konsideruar të besueshëm, por është *mudeles* dhe në të ka dobësi".

dhe hadithe të ndryshme, kërkon prej neve që të jemi të sinqertë në besim, të mos luhatemi dhe të mos besojmë në ndonjë hyjni tjetër.

Idhujtaria ka qenë fenomen i hershëm në traditën njerëzore, porse edhe sot e kësaj dite ekzistojnë organizata të ndryshme, të cilat thërrasin në idhujtari dhe paganizëm. Allahu xh.sh. i fal të gjitha mëkatet, përpos *shirk*-ut, të cilin assesi nuk e fal, kuptohet nëse njeriu vdes me këtë mëkat, por nëse pendohet gjatë jetës së tij dhe përmirësohet, Zoti ia fal mëkatin.

Pastaj, Zoti nuk është i nevojshëm për adhurimet e njerëzve. Këtë e konfirmon edhe hadithi që e transmeton Shedadi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...thotë Allahu xh.sh.:* ***"Unë jam ndarësi më i mirë ndaj atij që beson se Unë kam ortak, andaj kush më bën ortak diçka, atëherë të gjitha veprat e tija qofshin pak ose shumë do të shkojnë drejt atij që ma ka shoqëruar Mua, ndërsa Unë për të jam i panevojshëm".***[132]

Allahu xh.sh. nuk e realizon *hak*-un e Tij ndaj robit, gjersa robi të kryejë në fillim *hak*-un e vet ndaj Zotit. Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë nuk shikoj në të drejtën (hakun) e robit, gjersa robi të shikojë të drejtat (hakun) e Mia".***[133]

E drejtë e Zotit është që njerëzit ta adhurojnë vetëm Atë, duke mos i përshkruar ortak, pastaj njerëzit për këto adhurime shpërblehen nga Zoti i Madhërishëm. Transmeton Muadh b. Xhebeli r.a. se ishte duke udhëtuar me gomar me Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem të cilin e quanin *Ufejr* dhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka pyetur: *"O Muadh, a e din se cila është e drejta e Allahut ndaj robërve dhe e drejta e robërve ndaj Allahut?"* Muadhi tha: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"E drejta e Allahut ndaj robërve, është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i përshkruajnë diç ortak, kurse e drejta e robërve ndaj Allahut është që të mos i ndëshkojë ata që nuk i bëjnë ortak diçka".* Thash: "O i Dërguari i Allahut, a t`i përgëzojë

[132] Ahmed-i, "Musned", vëll.28, fq.362-364, nr.17.140; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se "është me zinxhir të dobët shkaku i dobësisë së Shehër b. Hausheb-it..."

[133] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.12, fq.212, nr.12.922; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 1/51, nr.151 thotë: "E transmeton Taberani në "Kebir" por në zinxhir gjendet Sel-lam et-Tavili, i cili është i braktisur në hadith dhe nuk kemi parë që dikush e ka konsideruar të besueshëm";

njerëzit?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem më tha: "*Jo, mos i përgëzo sepse pastaj do të mbështeten (vetëm) në të".*[134]

Kurse ajo që i takon robit nga adhurimi i Allahut xh.sh, është që të merr shpërblim dhe të mos dënohet me përjetësi në Zjarr. Pra, Allahu xh.sh. e shpërblen robin e Vet për çdo adhurim të cilin e vepron, e nëse kryen ndonjë mëkat dhe kërkon falje, është Allahu xh.sh. Ai i Cili ia fal mëkatin, pasi Ai është Mëshiruesi Absolut. Kjo është ajo që i takon robit nga gjërat të cilat janë në relacion me Allahun xh.sh.

Në pjesën e tretë, Allahu xh.sh. i bën me dije njeriut, se është edhe një relacion mes tyre, pra mes Allahut xh.sh. dhe besimtarit, ku njeriut i takon të lutet për diçka e cila i nevojitet në jetë, kurse Zotit i takon që ta pranojë atë lutje dhe ta realizojë duke iu përgjigjur pozitivisht.

Ne gjersa bëjmë lutje, njëkohësisht bëjmë edhe adhurim, pasi lutja është thelbi i adhurimit dhe se Zoti dëshiron të dëgjojë zërin e robit të Tij. Transmeton Nu`man b. Beshiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Duaja është ibadet".*[135]

Po ashtu, transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tek Allahu (xh.sh.) nuk ka gjë me më shumë vlerë sesa duaja".*[136]

Allahu xh.sh. dëshiron që robërit e Tij ta lusin për çdo nevojë dhe t`i drejtohen Atij në çdo situatë. Allahu xh.sh. hidhërohet nëse nuk kërkon asgjë prej Tij, sepse me këtë lë të kuptohet sikur njeriu ka arritur të bëhet i pavarur prej Zotit. Andaj duhet t`i lutemi vazhdimisht Atij për çdo gjë. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka

[134] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhihadi ve`s-Sijeri, bab ismi`l-feresi ve`l-himari, nr.2856; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab men mate ale`t-teuhidi dehale`l-xhenete, nr.30; etj.

[135] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 1, nr.3383 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Sahih; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab ed-duau, nr.1479; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ed-Duai, bab fadlu`d-duai, nr.3828; Ahmed-i, "Musned", 30/297, nr.18.352;

[136] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 1, nr.3381 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib (por në disa botime figuron vetëm vlerësimi "Garib"); Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Dua, bab fadlu`d-dua, nr.3829; Ahmed-i, "Musned", vëll.14, fq.360, nr.8748; Shejb Shuajb el-Arnauti në verifikim të "Sunen"-it të Ibni Maxhes (vëll.5, fq.6) thotë se zinxhiri i hadithit është Hasen shkaku i Imran el-Kattanit. Kurse në verifikimin e "Musned"-it të Ahmed-it, thotë se është afër të qënurit Hasen, për shkak të Imranit, kurse transmetuesit tjerë janë të besueshëm, transmetues që gjenden në dy Sahihet.

thënë: *"Allahu është i hidhëruar me atë i cili nuk kërkon asgjë prej Atij".*[137]

Edhe kur të lutet besimtari, duhet të lutet me bindje se do t`i pranohet, e jo të lutet me gojën e pavëmendshme dhe me syrin e përgjumur. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Luteni Allahun duke duke qenë të sigurtë se do t`u pranohet, dijeni se Zoti nuk i përgjigjet një lutjeje nga zemra e pavëmendshme".*[138]

Allahu xh.sh. nuk dëshiron që t`ia kthejë robit prapë *duanë*, porse dëshiron që t`ia plotësojë nevojën, sepse besimtari është i bindur se nuk ka kush tjetër që mund t`ia përmbush kërkesat, përpos Allahut xh.sh. andaj edhe Zoti turpërohet që t`ia kthejë duart bosh një robi i cili ka ngritur duart dhe i lutet vetëm Atij. Transmeton Selman Farisiju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. turpërohet dhe është Fisnik, turpërohet kur njeriu i ngren duart e tij (për dua) që t`ia kthej të zhgënjyera dhe bosh".*[139]

Pra, ne si mysliman dhe besimtarë të vërtetë, duhet të besojmë vetëm në Allahun Një, të mos i shoqërojmë Atij dikë dhe t`i lutemi vetëm Zotit, duke mos qenë të varur prej dikujt tjetër përpos Tij, kjo është esenca e adhurimit në Islam.

[137] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 2, nr.3384;
[138] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 65, nr.3490 dhe thotë se hadithi është Garib;
[139] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 104, nr.3567 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Garib;

HADITHI I TREMBËDHJETË (13)

حَدَّثَنَا يَعْلَى، حَدَّثَنَا عُمَرُ بْنُ ذَرٍّ، عَنِ الْعَيْزَارِ ، مِنْ تِنْعَةَ، أَنَّ ابْنَ مَسْعُودٍ، قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " إِذَا وُجِّهَتِ اللَّعْنَةُ، تَوَجَّهَتْ إِلَى مَنْ وُجِّهَتْ إِلَيْهِ، فَإِنْ وَجَدَتْ فِيهِ مَسْلَكًا، وَوَجَدَتْ عَلَيْهِ سَبِيلًا، أَحَلَّتْ بِهِ، وَإِلَّا حَارَتْ إِلَى رَبِّهَا، فَقَالَتْ: يَا رَبِّ، إِنَّ فُلَانًا وَجَّهَنِي إِلَى فُلَانٍ، وَإِنِّي لَمْ أَجِدْ عَلَيْهِ سَبِيلًا، وَلَمْ أَجِدْ فِيهِ مَسْلَكًا، فَمَا تَأْمُرُنِي؟ فَقَالَ: ارْجِعِي مِنْ حَيْثُ جِئْتِ "

Transmeton Ibni Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur shprehet ndonjë mallkim, ajo shkon drejt atij që i është drejtuar ajo, e nëse gjen aty shteg dhe gjenë rrugë, shkon tek ai, e nëse jo, kthehet tek Zoti i vet dhe thotë: "O Zot, me të vërtetë filani më ka drejtuar për te filani, por unë nuk e gjeta ndonjë rrugë për te ai, e as që gjeta ndonjë shteg, çfarë më urdhëron?" Ai i tha:* ***"Kthehu aty prej nga ke dalur".***[140]

Mallkimi i një besimtari musliman është çështje shumë e rrezikshme dhe e rëndë, andaj asnjë besimtarë nuk duhet nxituar që të akuzojë një musliman

[140] Ahmed-i, "Musned", 7/132, nr.4036; shejh Shuajb el-Arnauti për këtë transmetim thotë se e ka zinxhirin e dobët, shkaku i shkëputjes, pasi Ajzari nuk e ka takuar Ibni Mes`udin r.a.; po ashtu e shënon edhe në 6/420, nr.3876 dhe këtu përmendet transmetuesi i cili qëndron në mes Ajzarit dhe Ibni Mes`udit r.a. i cili quhet Ebu Umejr dhe për këtë transmetim shejh Shuajbi thotë se është afër të qënurit Hasen; Mundhiriu e shënon në "Tergib ve`t-Terhib", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1996, 3/314, nr.4220 dhe thotë: "E transmeton Ahmedi ku gjendet edhe tregimi i plotë, kurse zinxhiri i tij është në rregull (xhejid) inshallah". E shënon edhe Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/90-91, nr.13.019 dhe thotë: "E transmeton Ahmedi por nuk e njoh Ebu Umejrin. Transmetuesit tjerë janë të besueshëm, por është e qartë se shoku i Ibni Mes`udit r.a. të cilin e ka vizituar është i besueshëm, e Allahu e dinë më mirë". Ahmed Shakiri në verifikim të Musned-it, Daru`l-Hadith, Kajro, botimi i parë, 1995, 4/123, nr.4036 thotë se hadithi ka ndërprerje në mes Ajzarit dhe Ibni Mesudit r.a., kurse për transmetimin e plotë, Ahmed Shakiri në 4/67, nr.3876 thotë se zinxhiri i tij është Sahih;

tjetër me dalje prej fesë ose që ta mallkojë atë, sepse nëse ai nuk është meritorë për mallkim, atëherë mallkimi i kthehet atij i cili e ka thënë atë.

Tekfiri nënkupton të akuzuarit e ndonjë muslimani tjetër si pabesimtar, kështu që kur shprehet akuza, ajo fjalë kërkon personin në fjalë, nëse e gjenë të tillë, i shkon atij, por nëse i akuzuari nuk është i tillë, atëherë fjala e *tekfir*-it i kthehet atij që e ka shprehur atë fjalë.

Ashtu si mallkimi, edhe *tekfir*-i janë çështje të rrezikshme që duhet ta ruajmë gjuhën tonë nga një gabim i tillë, sepse shumë lehtë mund të biem viktimë e fjalës sonë.

Neve askujt nuk na lejohet që t`ia mohojmë besimin pa pasur dëshmi të qarta, sepse besimi është çështje e fshehtë në zemër dhe ne nuk mund ta akuzojmë dikë për atë që ka në zemër, përpos kur *kufri* i tij të bëhet i qartë. Zoti thotë në Kuran: **"O ju që besuat, kur marshoni në rrugën e All-llahut (për në luftë), të jeni të matur (të mos nguteni), e mos i thoni atij që ju shpreh selamin (besimin): "Nuk je besimtarë!", duke kërkuar me të mjet (mall) të kësaj bote, pse te All-llahu janë begatitë e mëdha. Ashtu (pabesimtarë) ishit edhe ju më parë, e All-llahu ju dhuroi (besimin), pra sqaroni mirë! All-llahu e di në hollësi çka veproni".[141]**

Pra, Zoti kërkon që të jemi të matur dhe të mos nxitojmë që t`i themi pabesimtarë atij i cili na e shpreh *shehadet*-in dhe besimin, kështu që kërkon të konfirmohet mirë çështja e besimit dhe e fesë së njeriut, e të mos nxitohet në akuza.

Edhe në *hadith*-e tjera, i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka këshilluar që të jemi të matur dhe të mos akuzojmë të tjerët për *kufër*, sepse nëse njeriu nuk është meritorë për atë fjalë, atëherë ajo fjalë i kthehet thënësit. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur i thotë njeriu vëllait të tij: "O kafir" ajo do të jetë meritë për njërin prej tyre".*[142]

Kurse në transmetimin e Ibni Umerit r.a. qëndron se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Cilido që i thotë vëllait të vet: "O kafir" ajo do*

[141] Kurani, Nisa, 94;
[142] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Edebu, bab men keffere ehahu bi gajri te`vilin fe huve kema kale, nr.6103;

të jetë meritë për njërin prej tyre, nëse është ashtu si thotë, e nëse jo, i kthehet atij (që e ka thënë)".[143]

Feja Islame akuzën me mosbesim ndaj muslimanit, e ka krahasuar me vrasjen dhe derdhjen e gjakut të atij personi. Transmeton Thabit ed-Dahaku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush betohet në diçka tjetër jashta Islamit, ai me të vërtetë është i tillë. Biri i Ademit nuk është i detyruar të përmbushë betimin e dhënë për të bërë ndonjë gjë që ai nuk e ka në dorë. Kushdo që vret veten me një send në këtë botë, do të ndëshkohet me atë send në Ditën e Kijametit. Kush mallkon një besimtar, është njëjtë sikur ta ketë vrarë atë. Kush shpif për një besimtar se është pabesimtar, është njëjtë sikur ta ketë vrarë".*[144]

Po ashtu, përcillet nga Abdullah b. Mesudi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Të fyesh muslimanin, është mëkat (fisk), kurse vrasja e tij është mohim (kufër)".*[145]

Feja Islame na ndalon që të akuzojmë dikë me *kufër* për shkak të ndonjë mëkati që e vepron ndonjëri prej muslimanëve, siç transmeton Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre gjëra janë nga thelbi i imanit: Mosakuzimi i atij që thotë: "La ilahe il-lallah" që të mos e akuzojmë me kufër për shkak të ndonjë mëkati e as të mos e nxjerrim nga Islami për shkak të ndonjë vepre...".*[146]

Si dhe *hadith*-i që përcillet nga Ibni Umeri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mos i akuzoni ithtarët e "La ilahe il-lallah" me kufër për shkak të ndonjë mëkati, e kush i akuzon me kufër ithtarët e "La ilahe il-lallah" ai është më afër kufrit".*[147]

Edhe dijetarët e mëdhenj të *umet*-it kanë tërhequr vëmendjen ndaj këtij fenomeni, që të mos bëhet shprehi në gjuhën e muslimanit akuza ndaj të tjerëve. Imam Ebu Hanife thotë: "Asnjë muslimani nuk ia mohojmë besimin e tij, për shkak të ndonjë mëkati të bërë, qoftë ai (mëkat) edhe i madh, nëse ai atë (mëkat) nuk e konsideron të lejueshëm. Ne asnjë besimtari nuk ia

[143] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab men kale li ehihi`l-muslimi: ja kafiru, nr.60; etj.
[144] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Edebu, bab ma junha mines sibabi ve`l-la`ni, nr.6047; etj.
[145] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab haufi`l-mu`mini, nr.48; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 28, nr.64; etj.
[146] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab fi`l-gazvi mea eimeti`l-xheuri, nr.2532;
[147] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 12/272, nr.13.089;

mohojmë besimin e tij dhe vazhdojmë ta quajmë atë vërtetësisht besimtar. Ka mundësi që ai të jetë besimtar mëkatar, e kurrsesi pabesimtar (*kafir*)".[148]

Përderisa nuk bëhet e qartë për ne *kufri* i një njeriu, ne duhet të përbahemi nga akuzimi i tij. Kurse veprat të cilat janë blasfemi, imam Nesefiu i ka përfshirë në shtatë kategori. Ai thotë: "Refuzimi i përmbajtjeve kuranore-sunetike *(en-nusus)* është *kufër*, konsiderimi i mëkatit si i lejueshëm është *kufër*, mburrja me kryerjen e mëkatit është *kufër*, përçmimi i dispozitave të sheriatit është *kufër*, humbja e shpresës në Mëshirën e Zotit është *kufër*, të ndjerit i sigurtë nga dënimi i Zotit është *kufër* dhe besimi se fallxhori e thotë të vërtetën mbi të fshehtën është *kufër*".[149]

[148] Ebu Hanife, "Fikh`ul-Ekber", Zëri Islam, Prizren, 2005, fq.65;
[149] Nesefi-u, "Besimi Islam", Zëri Islam, Prizren, 2003, fq.48;

KRIJIMI I BOTËS

HADITHI I KATËRMBËDHJETË (14)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ صَالِحِ بْنِ هَانِئٍ، وَإِبْرَاهِيمُ بْنُ عِصْمَةَ الْعَدْلُ، قَالَا: ثنا السَّرِيُّ بْنُ خُزَيْمَةَ، ثنا مُحَمَّدُ بْنُ سَعِيدِ بْنِ الْأَصْبَهَانِيِّ، ثنا يَحْيَى بْنُ يَمَانٍ، ثنا سُفْيَانُ، عَنِ ابْنِ جُرَيْجٍ، عَنْ سُلَيْمَانَ الْأَحْوَلِ، عَنْ طَاوُسٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، فَقَالَ لَهَا وَلِلْأَرْضِ: " ائْتِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا. قَالَ لِلسَّمَاءِ: أَخْرِجِي شَمْسَكِ وَقَمَرَكِ وَنُجُومَكِ، وَقَالَ لِلْأَرْضِ: شَقِّقِي أَنْهَارَكِ وَأَخْرِجِي ثِمَارَكِ، فَقَالَتَا: أَتَيْنَا طَائِعِينَ"

Transmeton Ibni Abasi r.a. i cili thotë: "(Zoti) I tha (qiellit) dhe tokës: ***"Nënshtrohuni urdhërit Tim me dëshirë ose me dhunë".*** *I tha qiellit:* ***"Nxirre për Mua Diellin, Hënën dhe yjet tua".*** *Tokës i tha:* ***"Formoi për Mua lumenjtë dhe nxirri për Mua prodhimet tua".*** *Ato thanë: "Po nënshtrohemi me dëshirë".*[150]

Këtë koment Ibni Abasi r.a. e ka bërë në sqarim të *ajet*-it: **"Mandej e mësyu qiellin (krijimin e qiellit) e ai ishte tym dhe atij edhe tokës i tha: "Qasuni urdhërit Tim me dëshirë ose me dhunë!" Ato të dyja thanë: "Po i qasemi me dëshirë!".**[151]

Nesefiu thotë se në bazë të këtij *ajet*-i, përfundojmë se qielli është krijuar pas tokës.[152]

Kurse sa i përket pjesës ku Zoti thotë: **"me dashje ose me dhunë"** Nesefiu thotë: "Ka për qëllim që të tregojë ndikimin e Fuqisë së Allahut xh.sh. ndaj krijesave".[153]

---

[150] Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/79, nr.73 dhe thotë: "Ky hadith është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ato nuk e kanë shënuar. E komentimi i sahabiut, është tek ata musned (i lidhur te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem)"; me të pajtohet edhe Dhehebi-u; Bejheki-u, "El-Esma ve`s-Sifat", Mektebetu`s-Sevadiju, Xhide, Saudi Arabi, botimi i parë, 1993, 2/256, nr.814; Këtë transmetim e ka shënuar më parë edhe Taberi-u në "Xhamiu`l-Bejan fi te`vili`l-Kuran", Hixhër, botimi i parë, 2001, vëll.20, fq.391;

[151] Kurani, Fusilet, 11;

[152] Nesefi-u, "Komentimi i Nesefiut", Tetovë, 2017, vëll.4, fq.187;

Çdo gjë prej qiejve deri në Tokë, i është nënshtruar urdhërit të Zotit dhe lëviz vetëm në bazë të urdhërit të Tij. Allahut xh.sh. i janë nënshtruar të gjitha krijesat, si melekët, Toka, qiejt, planetet, bimët, drunjtë, kafshët, insektet dhe çdo gjë që ekziston, kurse njerëzit dhe xhinët, i la me vullnet të lirë që të zgjedhin vet a do t`i nënshtrohen Zotit ose jo. Për këtë thuhet në Kuran: **"A nuk e di se Allahut i bën sexhde çka ka në qiej e në tokë, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe kodrat, edhe bimët edhe shtazët, e edhe shumë njerëz. Por për shumë të tjerë është meritë dënimi..."**.[154]

Sipas *ajet*-it që potencuam më herët (Fusilet, 11), vërejmë se Zoti ka krijuar edhe krijesat tjera me mundësinë e të folurit dhe bisedës, të cilën nuk munden njerëzit assesi ta dëgjojnë dhe kuptojnë, porse, është një e vërtetë të cilën e potencon *ajet*-i, sepse atyre u dha mundësinë të zgjedhin nënshtrimin me dëshirë ose forcë dhe ata thanë se zgjedhin të nënshtrohen me dëshirë. Në një *ajet* tjetër, po ashtu kuptojmë dëshirën e qiejve dhe tokës ku Zoti thotë: **"Sa kopshte kanë lënë! Edhe ara të mbjellura në vende të bukura. Dhe sa të mira që i kanë përjetuar. Ja, ashtu atë ua lëmë në trashëgim një populli tjetër. Për ta nuk qajtën as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha afat".**[155]

Transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Çdo rob në qiell ka dy dyer: Një derë përmes së cilës hyjnë veprat e tij dhe një derë përmes së cilës dalin veprat dhe fjalët e tij, e kur vdes, ndërpritet kjo dhe ato fillojnë të qajnë".* dhe e lexoi ajetin: **"Për ta nuk qajtën as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha afat".** Dhe përmendi se ata (faraoni dhe populli i tij) nuk punonin në tokë vepra të mira që të qajnë për ta, e as që është ngritur në qiell vepra e mirë dhe puna e tyre".[156]

Është pyetur Aliu r.a. se a qan qielli dhe toka për dikë, e ai ka thënë: "Më ke pyetur për një gjë, për të cilën nuk më ka pyetur askush më parë! Nuk ka njeri që nuk e ka një vend për falje në tokë dhe një vend ku i shkojnë veprat në qiell. Kurse populli i faraonit nuk ka pasur vepra të mira në tokë e as vend në qiell ku kanë shkuar veprat e mira", e pastaj lexoi *ajet*-in: **"Për ta nuk qajtën as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha afat".**[157]

---

[153] Po aty, fq.188;
[154] Kurani, Haxh, 18;
[155] Kurani, Duhan, 25-29;
[156] Ebu Ja`la, "Musned", Daru`l-Ma`rife, Bejrut, botimi i parë, 2005, fq.771, nr.4133;
[157] Ibni Kethir-i, "Tefsiru`l-Kurani`l-Adhim", tixharetu`l-kubra, Egjipt, vëll.4, fq.142;

Dikush e pyeti Ibni Abasin r.a. në lidhje me këtë *ajet* se a qanë toka dhe qielli për dikë, e ai tha: "Po! Për çdo njeri ka në qiell një derë përmes së cilës i zbret furnizimi dhe një derë përmes së cilës ngjiten veprat e tij, e kur vdes besimtari, mbyllen dyert përmes së cilës zbriste furnizimi dhe ngjiteshin veprat e mira, e kur i mungon ai person, për këtë shkak qanë qielli, kurse në tokë, ka pasur vendin ku është falur dhe ku ka përmendur Allahun xh.sh. e kur vdes, për të qajnë këto vende (në tokë). Kurse njerëzit e faraonit nuk kanë pasur në tokë gjurmë të veprave të mira e as vepra të mira që janë ngjitur në qiej, andaj për ta nuk qanë qielli e Toka".[158]

Është fatkeqësi për disa njerëz, kur sheh se në ditën e varrimit të tyre që nuk i qanë as familja më e afërt, as bashkëshortja e as fëmijët. Vallë, çfarë njeriu ka mundur të jetë ai?!

Po ashtu, Allahu xh.sh. i urdhëroi kodrat që të bëjnë *tesbih* bashkë me Davudin a.s. siç përmendet në Kuran: **"Ne i patëm dhënë Davudit dhuratë të madhe nga ana e Jonë: "O male dhe shpezë, lartësoni (me tespih) së bashku me të! Ne ia zbutëm atij edhe hekurin".[159]**

Allahu xh.sh. u flet krijesave të Tia me gjuhë të cilën njerëzit nuk e kuptojnë. Zoti urdhëron qiellin dhe Tokën por ne këtë bisedë nuk e kuptojmë. Zoti thotë në Kuran: **"E iu tha: "Oj tokë përbije ujin tënd dhe o qiell ndërpreje (shiun) e uji u tërhoq, urdhëri u zbatua dhe ajo (anija) u ndal në Xhudije...".[160]**

Ndërsa për faktin se qielli ka qenë tym dhe mjegull, e vërteton edhe shkenca bashkëkohore, të cilët e kanë pranuar teorinë e "Big Bang"-ut si fakt shkencorë, se në fillim ka ekzistuar vetëm një mjegull dhe tym, e më pas ka pasuar një eksplozion i cili ka shkaktuar formimin e universit dhe galaktikave.[161]

[158] Ibni Kethir-i, "Tefsiru`l-Kurani`l-Adhim", vëll.4, fq.142;
[159] Kurani, Sebe`, 10;
[160] Kurani, Hud, 44;
[161] Shih: www.space.com/ what is the Big Bang Theory?

MELEKËT E ZOTIT

HADITHI I PESËMBËDHJETË (15)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْعَبَّاسِ، ثَنَا الْفَضْلُ بْنُ سَهْلٍ الْأَعْرَجُ، ثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مَنْصُورٍ، ثَنَا إِسْرَائِيلُ، عَنْ مُعَاوِيَةَ بْنِ إِسْحَاقَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي سَعِيدٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ اللَّهَ جَلَّ ذِكْرُهُ أَذِنَ لِي أَنْ أُحَدِّثَ عَنْ دِيكٍ قَدْ مَرَقَتْ رِجْلَاهُ الْأَرْضَ، وعُنُقُهُ مُنْثَنِي تَحْتَ الْعَرْشِ، وَهُوَ يَقُولُ: سُبْحَانَكَ مَا أَعْظَمَكَ رَبَّنَا فَرَدَّ عَلَيْهِ: مَا يَعْلَمُ ذَلِكَ مَنْ حَلَفَ بِي كَاذِبًا

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mua më është lejuar të flas mbi një gjel (melek) këmbët e të cilit kanë çarrë tokën tejpërtej, kurse qafën e ka të kërrusur nën Arsh dhe thotë: "Subhaneke (Lartësuar qofsh) o Zoti ynë sa i Madhërishëm që je", kurse Ai ia kthen:* ***"Këtë nuk e di ai që betohet rrejshëm në Mua".***[162]

Në tekstin e *hadith*-it në mënyrë tekstuale përmendet fjala `*dijk*` që në gjuhën arabe i thonë gjelit, por *ulema*-të kanë sqaruar se nuk bëhet fjalë për ndonjë gjel të vërtetë që e njohim në këtë botë, por për një krijesë të Allahut xh.sh, e ngjashme për nga pamja me gjelin. Imam Munaviu thotë: "*Hadithi* flet për një krijesë të Allahut me trup (si) të gjelit, pra, një *melek* të madh i cili duket si gjel, por nuk ka të bëjë me gjel!".[163]

Ky *hadith* flet për madhështinë e këtij *melek*-u i cili këmbët i ka të zhytura në tokë, kurse koka e tij është kërrusur nën *Arsh*-in e Zotit, që tregon për një *melek* të veçantë i cili për kah madhësia, kategorizohet në mesin e melekëve më të mëdhenj. Por, me gjithë këtë madhështi dhe madhësi, ai përsëri nuk

[162] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.7, fq.220, nr.7324; e shënon edhe Hakimi në "El-Mustedrek ale`s-Sahihejn", vëll.4, fq.330, nr.7813 dhe thotë se zinxhiri i hadithit është Sahih, por ato (Buhariu dhe Muslimi) nuk e kanë shënuar; me këtë pajtohet edhe Dhehebiu; e shënon edhe Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid" (4/231, nr.6916) dhe thotë: "E përcjell Taberani në "Euset", kurse transmetuesit e tij janë të besueshëm".

[163] Munavi, "Fejdu`l-Kadir sherh Xhamiu`s-Sagir", Bejrut, botimi i dytë, 1972, vëll.2, fq.208, nr.1680;

ndjehet asgjë në krahasim me *Arsh*-in e Zotit dhe lartmadhëron Zotin dhe tregon se sa madhështor është Ai.

Zoti ia kthen përgjigjen këtij *melek-u* të madh duke i treguar se këtë që flet ti për madhështinë Time, nuk e njeh njeriu i cili rrejshëm betohet në Emër Timin dhe nuk turpërohet fare. Njeriu është krijesë që nuk e njeh madhështinë e Zotit dhe kryen mëkate shumë të rënda karshi Tij. Vetëm njeriu e përdhos Emrin e Allahut duke i bashkangjitur gënjeshtrën, kurse krijesat tjera siç janë *melek*-ët, dridhen nga frika që kanë prej Fjalës së Allahut xh.sh.

Sikur njeriu ta dinte madhështinë e Zotit, kurrë nuk do të betohej rrejshëm, por vetëm sinqerisht.

Në bazë të *hadith*-eve tjera, shohim se nuk është ky i vetmi *melek* që ka madhësi aq të madhe, por ka edhe të tjerë. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tregon se në fillimet e shpalljes, e ka parë Xhibrilin të ulur në karrige në mes qiellit dhe tokës.[164]

Herën e dytë, është momenti kur i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem bëri udhëtimin e natës (*Mi`raxh*-in). Transmeton Abdullah b. Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka parë Xhibrilin a.s. në formën e tij, ndërsa ai kishte gjashtëqind flatra, çdonjëra prej tyre kishte mbuluar horizontin...".[165]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na informoi edhe për madhësinë e melekëve që bartin *Arsh*-in e Zotit, që kanë një madhësi gjigante. Transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më është lejuar që të flas për një nga melekët e Allahut që bartin Arsh-in, ai është aq i madh saqë largësia në mes bulës së veshit dhe supeve të tij, është sa udhëtimi 700 vite".*[166]

Në përgjithësi melekët kanë madhësi të ndryshme, porse ne në bazë të *hadith*-eve, fitojmë njohuri mbi këta që u përmendën më lart.

---

[164] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Halki, bab dhikru`l-melaiketi, nr.3238; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 73, nr.160-161; etj.

[165] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Halki, bab dhikru`l-melaiketi, nr.3232-33; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 76, nr.174; etj.

[166] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Sunneh, bab fi`l-xhehmijeti, nr.4727; shejh Shuajb el-Arnauti thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i mirë (xhejid) dhe shton se Ibni Haxheri në "Fet`h" e saktëson zinxhirin e tij;

Sa i përket betimit të rrejshëm, ajo është prej mëkateve të mëdha në fenë tonë Islame. Transmeton Abdullah b. Amri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mëkatet e mëdha janë: "T`i bësh ortak Zotit, mosrespekti i prindërve, vrasja e njeriut dhe betimi i rrejshëm".*[167]

Përcjell edhe Ebu Dherri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre vetëve, Zoti nuk do t`u flas në Ditën e Gjykimit, e as nuk do t`i shikojë (pastrojë) dhe do të kenë dënim të dhembshëm: "Musbili (atij që tesha i shkon për toke), menani (ai që mburret me atë që jep) dhe ai që e shet mallin duke bërë betim të rrejshëm".*[168]

Në këtë temë, kemi edhe një tjetër *hadith kudsi*. Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu i Madhërishëm ka thënë:* ***"Unë do të jem kundërshtar i tre personave Ditën e Gjykimit: "Njeriut që jep me emrin Tim dhe këtë betim e thyen, njeriut që shet një njeri të lirë dhe i shpenzon paratë që ka marr për të dhe njeriut që merr punëtor dhe nuk ia paguan hakun".***[169]

Si dhe *hadith*-i tjetër *kudsi* që e përcjell Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Janë tri lloje njerëzish, të cilëve Allahu nuk do t`u flas në Ditën e Kijametit, e as që do t`i shikojë: "Njeriu që betohet rrejshëm, duke gënjyer se gjoja i kanë dhënë për mallin e tij më tepër (para) se ç`i kanë dhënë në të vërtetë; një njeri që betohet pas namazit të ikindisë me qëllim që të zhvasë pasurinë e muslimanit dhe një njeri që ndalon ujin e tij të tepërt. Allahu do t`i thotë atij:* ***"Sot Unë do të ndaloj Mirësinë Time, ashtu siç e ndalove ti tepricën e atij (uji), që nuk e ke krijuar vetë".***[170]

Dhe *hadith*-et janë të shumta për këtë temë, por ne do të mjaftohemi me këto që përmendëm më lart, duke shpresuar që të mos e përmendim Emrin e Allahut në betimet tona, në momente kur nuk e flasim të vërtetën, edhe pse gënjeshtra në çdo situatë është mëkat, por kur e keqpërdorim Emrin e Allahut xh.sh. mëkati i tij ritet edhe më shumë.

---

[167] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ejmani ve`n-nudhuri, bab jemini`l-gamusi, nr.6675; etj.
[168] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab tahrimu isbalil izari, nr.106; etj.
[169] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ixharetu, bab 11, nr.2270; etj.
[170] Buhari-u, "Sahih", kitab fi`sh-Shirbi, bab men rea enne sahibe`l-haudi ve`l-kirbeti ehakku bi maihi, nr.2369; etj.

HADITHI I GJASHTËMBËDHJETË (16)

وَقَدْ أَخْبَرَنَا أَبُو طَاهِرٍ الْفَقِيهُ، أخبرنا أَبُو حَامِدِ بْنُ بِلَالٍ، حدثنا أَبُو زُرْعَةَ الرَّازِيُّ، حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ عَمَّارٍ، حدثنا عَبْدُ رَبِّهِ بْنُ صَالِحٍ الْقُرَشِيُّ، حدثنا عُرْوَةُ بْنُ رُوَيْمٍ، عَنِ الْأَنْصَارِيِّ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " لَمَّا خَلَقَ اللهُ آدَمَ عَلَيْهِ السَّلَامُ وَذُرِّيَّتَهُ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ: يَا رَبُّ خَلَقْتَهُمْ يَأْكُلُونَ وَيَشْرَبُونَ، وَيَنْكِحُونَ وَيَرْكَبُونَ فَاجْعَلْ لَهُمُ الدُّنْيَا، وَلَنَا الْآخِرَةَ، فَقَالَ اللهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى: لَا أَجْعَلُ مَنْ خَلَقْتُهُ بِيَدَيَّ، وَنَفَخْتُ فِيهِ مِنْ رُوحِي كَمَنْ قُلْتُ لَهُ كُنْ فَكَانَ "

Transmeton Ensariju (Xhabir b. Abdullahu r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur e krijoi Allahu xh.sh. Ademin a.s. dhe pasardhësit e tij, melekët thanë: "O Zot, ke krijuar ata që hanë, pinë, martohen dhe kalërojnë. Jepju atyre dunjanë, kurse neve Ahiretin?!" kurse Allahu xh.sh. tha:* ***"Nuk e bëjë (të njëjtë) atë që e krijova me "Duart" e Mia dhe i frymova prej "Shpirtit" Tim me atë të cilin u bë pasi i thash "Bëhu" dhe ai u bë".***[171]

Këtë bisedë të melekëve me Zotin, e kemi shënuar edhe disa herë tjera, kur ata kanë kërkuar që të jenë të privilegjuara ndaj njerëzve, sepse melekët adhurojnë dhe madhërojnë Zotin vazhdimisht, kurse njerëzit derdhin gjakun dhe bëjnë *fesad* në tokë. Por, Allahu xh.sh. u tregoi se edhe njeriu mund të ngritet në nivele të larta, pasi ai është i përbërë prej dy komponeteve, asaj shpirtërore dhe materiale, kurse melekët janë vetëm shpirtërore.

Melekët i përmendën komponentët me të cilët njerëzit mashtrohen, kurse melekët nuk i kanë ato, si ushqimi, pija, martesa dhe mjetet bartëse, kurse

[171] Bejheki-u, "Shuabu`l-Iman", vëll.1, fq.308, nr.147; përmes Abdullah b. Amrit r.a. shënon diçka të ngjashme edhe Taberani-u, në "Mu`xhemu`l-Euset", 6/196, nr.6173; Ibni Xheuzi e shënon përmes Ibni Umerit r.a. dhe thotë se ky hadith nuk është Sahih, pasi Humejdiu ka folur për Abdulmexhidin. (shih: Ibni Xheuzi, "El-Ilelu`l-Mutenahije", Iradetul Ulumul etherije, Fejsal Abadi, Pakistan, botimi i dytë, 1981, 1/36, nr.32);

melekët nuk hanë, nuk pinë, nuk martohen e as që kanë nevojë që ndonjë mjet t`i bartë.

Mashtrimi kryesorë i njeriut dhe vrapimi pas kësaj bote, përbëhet pikërisht nga këto komponente, sepse njeriu vazhdimisht vrapon për kënaqësinë e epshit, për të mbushur barkun, për t`u martuar dhe pëlqimi i gjinisë së kundërt, si dhe vrapimi pas luksit dhe krenimi me mjetet bartëse.

Pasi melekët kërkuan që ato të jenë poseduese të botës tjetër, kurse njerëzit të mjaftohen vetëm me këtë botë, Zoti ua refuzoi kërkesën e tyre duke u thënë se njeriu është më i veçantë, sepse njeriun e ka krijuar me "Duart" e Veta, i ka fryrë prej "Shpirtit" të Tij, ndërsa për melekët vetëm ka dhënë urdhër që të bëhen dhe ato janë bërë. Me këtë Zoti e vë njeriun në pozitë më të lartë se të gjitha krijesat tjera.

Për sa i përket teksteve ku Zoti e dallon njeriun besimtar nga melekët, shërbejnë edhe disa *hadith*-e tjera, ku ne do të përmendim disa prej tyre.

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mu`mini është më i respektuar te Allahu sesa disa melek".*[172]

Ebu Hurejre r.a. e përcjell edhe si *hadith kudsij* ku thuhet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu xh.sh.:* ***"Robi im besimtar, është më i dashur tek unë sesa disa prej melekëve".***[173] Imam Munaviu thotë: "Shkaku i kësaj përparësie qëndron në faktin se melekët nuk kanë epshe dhe dëshira të cilat i nxisin për ligësi, as *nefs* i cili i urdhëron ata për atë që është e shëmtuar. Gjersa *mu`mini* mposht epshet e tij dhe *shejtan*-in i cili e çon në shkatërrim, edhe menaxhon epshin e vet, armikun e tij më të madh, i cili vazhdimisht e urdhëron për atë që është e shëmtuar. Në këtë mënyrë, ai është në luftë dhe vështirësi të përhershme, kurse është e ditur që respekti dhe *kerameti* janë në bazë të vështirësive".[174]

Transmeton Abdullah b. Amri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ka diçka më të ndershme tek Allahu sesa biri i Ademit".*

---

[172] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 6, nr.3947, por Busiriju thotë se hadithi është i dobët; Bejhekiu, "Shuabu`l-Iman", vëll.1, fq.311, nr.150; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të "Sunen"-it të Ibni Maxhe-s (5/95), thotë se zinxhiri i këtij hadithi është shumë i dobët, Ebu Muhezim Jezid b. Sufjani është i braktisur (*metruk*);
[173] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.6, fq.367, nr.6634;
[174] Munavi-u, "Fejdu`l-Kadir", vëll.6, fq.256;

Thanë: "O i Dërguari i Allahut, as melekët?" Tha: *"Melekët janë të detyruar si Dielli dhe Hëna".*[175]

Në lidhje me këtë, Abdullah b. Selami r.a. tha: "Krijesa më e ndershme te Allahu është Ebu Kasimi (Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem)". Një njeri tha: "Të mëshiroftë Allahu, po ku janë melekët?" Ai shikoi në mua dhe tha: "O biri i vëllait tim, a nuk e din se çka është krijimi i melekëve? Krijimi i tyre është si krijimi i tokës, qiellit, mjegullat, kodrat, erërat dhe krijesat tjera, kurse krijesa më e ndershme te Allahu është Ebu Kasimi".[176]

Transmeton Ibni Abasi r.a. i cili ka thënë: "Allahu xh.sh. e ka dalluar Muhamedin ndaj banorëve të qiellit dhe ndaj pejgamberëve tjerë". I thanë: "O Ibni Abas, si është dallimi ndaj banorëve të qiellit?" Ai tha: "Sepse Allahu u thotë banorëve të qiellit: **"Ndërsa, kush thotë prej tyre se unë jam zot pos Tij, ndëshkimi për të është Xhehenemi, kështu i ndëshkojmë zullumqarët".**[177] Kurse për Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: **"Ne ty të dhamë një fitore të sigurt. Ashtu që Allahu të liroi ty prej mëkateve të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme...".**[178] Pastaj e pyetën: "Po çka është dallimi i tij ndaj pejgamberëve tjerë?" Ai tha: "Sepse Allahu xh.sh. thotë: **"Ne nuk kemi dërguar asnjë pejgamber përpos se në gjuhën e popullit të vet"**[179] kurse për Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: **"Të kemi dërguar pejgamber për të gjithë njerëzimin".**[180] [181]

Transmeton Seleme b. Ekve`i r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...Melekët janë dëshmitarët e Allahut në qiell, kurse ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë...".*[182]

Zoti thotë në Kuran: **"E kur u tham engjëjve: "Përuluni (bini në sexhde) Ademit, ata menjëherë iu përulën, me përjashtim të Iblisit**

[175] Bejheki-u, "Shuabu`l-iman", vëll.1, fq.312, nr.151, dhe në fund thotë se Buhariu ka thënë që ai përcjell gjëra të çuditshme, e kur përcillet nga Halid b. Hadhai si meukuf (te numri 152), është sahih;
[176] Bejheki-u, "Shuabu`l-iman", vëll.1, fq.308, nr.147;
[177] Kurani, Enbija, 29;
[178] Kurani, Fet`h, 1-2;
[179] Kurani, Ibrahim, 4;
[180] Kurani, Nisa, 79;
[181] Bejheki-u, "Shuabu`l-Iman", vëll.1, fq.310, nr.149;
[182] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 7/23, nr.6262;

(djallit)...".[183] Edhe në këtë *ajet*, shohim se Zoti urdhëroi *melek*-ët që t`i bien në sexhde Ademit a.s., kurse *sexhde*-ja është shenjë prioriteti e atij që i bëhet *sexhde*, ndaj atij i cili e kryen atë.

Po ashtu thotë: **"Allahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit, mbi tërë gjithësinë".** [184] Kurse në nocionin *`alemin`* hyjnë edhe melekët, pra Zoti i dalloi këta pejgamber mbi gjithë *alemin*, ku bëjnë pjesë edhe melekët.

Si dhe *ajet*-i tjetër: **"Ndërsa ata që besuan dhe bënë vepra të mira, të tillët janë krijesa më e dobishme".**[185]

Ose: **"...Unë po caktoi në tokë një halife...".**[186] E titulli *halife* nga ana e Zotit, tregon se nuk ka më të vlefshëm se ai i cili e bart këtë titull. Po ashtu kur kemi parasysh se në *Mi`raxh* Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem u ngrit në nivele që as melekët nuk ishin ngritur, nënkupton se Zoti e ngriti Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem mbi të gjitha krijesat tjera.

Në bazë të këtyre teksteve, dijetarët kanë vlerësuar se disa njerëz si Pejgamberët dhe *evlija*-të janë më të zgjedhur te Zoti sesa *melek*-ët. Këtë mendim e kanë edhe shumica e maturidive dhe një pjesë e esh`arive.

Fahrudin er-Razi thotë se melekët janë më të vlefshëm se njerëzit dhe këtë e mbështet në disa argumente, si *ajet*-i: **"Atë ditë Xhibrili dhe melekët qëndrojnë të rreshtuar, askush nuk flet pos atij që e lejon Mëshiruesi dhe i cili e thotë të vërtetën".**[187] Dhe thotë: "Sikur të mos ishin *melek*-ët më të vlerësuar se krijesat tjera, nuk do të ishte e vërtetë rangimi i tillë". Pastaj thotë: "Zoti thotë: **"Edhe besimtarët, secili i besoi Allahut, melekëve të Tij, shpalljeve të Tij dhe të Dërguarve të Tij".**[188] Ky është rangimi i vërtetë ngase Zoti është Qenia më e Përsosur, e pastaj vijnë melekët". Po ashtu thotë: "Meleku e bartë Librin e shenjtë prej Zotit xh.sh. deri te Pejgamberi dhe me këtë rast rangimi bëhet kështu: Zoti-meleku-

[183] Kurani, Bekare, 34;
[184] Kurani, Ali Imran, 33;
[185] Kurani, Bejine, 7;
[186] Kurani, Bekare, 30;
[187] Kurani, Nebe`, 38;
[188] Kurani, Bekare, 285;

Libri-Pejgamberi. Ky rangim është theksuar në Kuran dhe në të njëjtën kohë konfirmon epërsinë e melekëve mbi njerëzit".[189]

Ata të cilët e kanë këtë mendim, kanë thënë se Zoti në Kuran e përmend mashtrimin e *shejtan*-it ndaj Ademit dhe Havës, kur u tha: **"Zoti juaj nuk ua ndaloi ju dyve atë pemë vetëm që të mos bëheni melekë (engjëj), ose të mos bëheni prej të përjetshmëve".[190]** Pra, duke dëshiruar të arrijnë pozitën e melekëve u mashtruan, e sikur të mos ishte kjo pozitë më e lartë, nuk do të përpiqeshin për ta arritur.

Gjithashtu kur na flet Nuhu a.s. në Kuran, thotë: **"...as nuk u them se unë jam melek...".[191]** Pra, ai me këtë tregon prioritetin e melekëve ndaj tij.

Po ashtu në *hadith kudsi* Zoti thotë: ***"...nëse më kujton në vetvete, edhe Unë e kujtoj atë në Vetvete, nëse më përmend në shoqëri, Unë e përmend në një shoqëri më të mirë se ajo...".[192]*** Edhe këtu, shohim se shoqëria e *melekë*-ve, është më e mirë se *mexhlisi* ku janë tubuar besimtarët për të bërë *dhikër*.

Këtë mendim e përkrahin filozofët musliman, esharitët, mu`tezilët dhe shumica e shiitëve. Kurse Imam Ebu Hanife dhe imam Tahaviu nuk kanë folur për këtë çështje, por disa prej *ehlu-sunet*-it kanë pasur debat në lidhje me këtë rangim.[193]

Ne obligohemi që të besojmë në *melek*-ë dhe në pejgamberë, e nuk kërkohet prej nesh që të vlerësojmë se kush janë më të vlefshëm, pasi sikur t`u kishte kërkuar prej nesh diç e tillë, do të flisnin Kurani ose hadithi drejtpërdrejtë. Andaj, nuk do të zgjerohemi më tepër në këtë debat, por do të mjaftohemi me kaq, ndërsa do të ngelim me shpresë që të jemi në rrugën e të mirëve, e Allahu xh.sh. pastaj e din se si do të na vlerësojë.

---

[189] Dr. Zekerija Bajrami, "Çështjet kelamistike të Fahrudin Raziut në veprën "El-Mealim", Shkup, 2007, fq.273-274;
[190] Kurani, A`raf, 20;
[191] Kurani, En`am, 50;
[192] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab kauli teala: "Ve juhadhirukumullahu nefseh, nr.7405; Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab 1, nr.2675; etj.
[193] Për më gjerësisht rreth këtij debati, mund të shikoni te: Fahrudin Razi-u, "Mefatihu`l-Gajb", Daru`l-Fikër, Bejrut, botimi i parë, 1981, vëll.2, fq.234-255;

PEJGAMBERËT E ZOTIT

HADITHI I SHTATËMBËDHJETË (17)

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ، ثنا مُحَمَّدُ بْنُ أَبِي نُعَيْمٍ الْوَاسِطِيُّ، ثنا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ أَبِي بِشْرٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " لَيْسَ الْمُعَايَنَةُ كَالْخَبَرِ، قَالَ اللهُ لِمُوسَى: إِنَّ قَوْمَكَ قَدْ فُتِنُوا، فَلَمْ يُلْقِ الْأَلْوَاحَ، فَلَمَّا عَايَنَ، أَلْقَى، الْأَلْوَاحَ فَكَسَرَهَا "

Transmeton Ibni Abasi r.a. se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sellem ka thënë: *"Nuk është të shikuarit sikur lajmi, Allahu xh.sh. i tha Musait a.s.: **"Me të vërtetë populli yt janë përçarë",** por ai nuk i hodhi pllakat, e kur i pa ata me sytë e vet, i hodhi pllakat dhe i theu ata".*[194]

Pasi Musai a.s. kaloi detin e hapur enkas për të dhe për popullin e beni Israilëve, dolën në anën tjetër dhe ndaluan në një vend, kurse firaoni dhe ushtria e tij u fundosën në det. Por, me të kaluar detin, filluan të paraqiten gjurmët e idhujtarisë te populli i beni Israilëve, të cilët për vite me radhë kishin qenë nën sundimin e firaonit, i cili i kishte detyruar ta adhurojnë si zot. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **"Beni israilët i kaluam përtej detit, e ata arritën te një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë: "O Musa, na e bën edhe neve një zot (statuj) si zotët që i kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk dini. Vërtet, ai popull (që po adhuron idhuj) është i shkatërruar në atë (adhurim) dhe ajo që vepruan është e**

[194] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.12, fq.54, nr.12.451; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", 14/96, nr.6213; këtë hadith e shënojnë edhe Ahmedi, Bezzari dhe Hakimi, por jo si hadith kudsi, shih: Ahmed-i, "Musned", 4/260, nr.2447; Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", 11/272, nr.5062 dhe thotë se ky hadith nuk përcillet prej dikujt tjetër nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem përpos nga Ibni Abasi r.a.; Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/351, nr.3250 dhe thotë se "hadithi është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ato nuk e kanë regjistruar"; me këtë vlerësim pajtohet edhe Dhehebiu. Kështu e regjistron edhe Taberani në "Mu`xhemu`l-Euset", 1/12, nr.25; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 1/206, nr.687 thotë: "E transmetojnë Ahmedi dhe Taberani në "Kebir" dhe "Euset", kurse transmetuesit janë transmetues të Sahiheve, e Ibni Hibani e ka konsideruar hadithin Sahih". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sahihut të Ibni Hibanit, thotë: "Hadithi është Sahih, transmetuesit janë transmetues të Buhariut dhe Muslimit...".

asgjësuar (s'ka dobi). Musai tha: "Mos deshët, pos All-llahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?".[195]

Këtu dolën në shesh gjurmët e idhujtarisë në mesin e këtij populli. Musa a.s. vërejti se me çfarë sfide do të duhet të angazhohet dhe se durimi duhet të jetë në nivel të lartë. Dhe ata vazhduan rrugën.

Kur arritën në vendin e caktuar, Musa a.s. e la si zëvendës të vetin te beni Israilët vëllanë e tij, Harunin a.s. dhe vet shkoi që të pranojë shpalljen nga Allahu xh.sh. Zoti thotë në Kuran: **"Dhe Ne i caktuam Musait tridhjetë net (afatin për shpallje), e ato i plotësuam edhe me dhjetë dhe kështu u mbush afati për takim Zotin e tij në katërdhjetë net. Ndërsa Musai vëllait të vet Harunit, i tha: "Më zëvendëso mua te populli im dhe rregullo, e mos shko rrugës së të këqinjve".[196]**

Ngjashëm kështu thotë edhe në një vend tjetër: **"O bijt e Israilit, Ne ju shpëtuam prej armikut tuaj, ua përcaktuam anën e djathtë të Turit (për shpalljen e Tevratit), ju furnizuam me rrëshirë (si mjalti) dhe shkurtëza. Hani nga të mirat që u dhuruam, e mos u bëni përbuzës se do t'u godasë hidhërimi Im, e atë që e zë hidhërimi Im, ai ka mbaruar".[197]**

Atje, ai kërkoi prej Zotit që t`i mundësojë ta shoh Atë, por mori këtë përgjigje: **"E kur Musai erdhi në kohën që i caktuam dhe i foli Zoti i vet, ai tha: "Zoti im! Më mundëso pamjen tënde e të shikoj!" Ai (Zoti) i tha: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh, por shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të shohësh Mua. Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (kodrën) thërmi, e Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, tha: "E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari i besimtarëve!". Ai (All-llahu) tha: "O Musa, Unë të gradova ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit tim. Merr atë që të dhash dhe bëhu mirënjohës".[198]**

Zoti i shkruajti në pllaka të gurit urdhërat që duhet t`i zbatojë te populli i beni Israilëve dhe e urdhëroi që të jetë i kujdesshëm ndaj tyre. Kështu thuhet në Kuran: **"Dhe i përshkruan atij në pllaka çdo gjë (që i nevojitej), si këshillim dhe sqarim për secilin send. "Merri këto me seriozitet dhe**

[195] Kurani, A`raf, 138-140;
[196] Kurani, A`raf, 142;
[197] Kurani, Taha, 80-81;
[198] Kurani, A`raf, 143-144;

urdhëroje popullin tënd që t'i përvetësojë më të mirat e tyre (dispozitat me shpërblim më të madh). Unë do t'ua tregoj vendbanimin mëkatarëve".[199]

Musai a.s. duke qëndruar në kodër për të pranuar shpalljen, populli i tij devijuan dhe filluan të dalin prej kontrollit. Një person në mesin e tyre që quhej Samirij, kishte marrë arin prej grave të beni Israilëve, e kishte ndezur një zjarr dhe kishte formuar me arin e shkrirë një skulpturë në formë viçi, i cili edhe pëlliste. Thotë Allahu xh.sh.: **"Populli i Musait, pas tij (kur ai shkoi në kodrën Tur për pranimin e shhpalljes) e mbaroi nga stolitë e tyre një figurë viçi që kishte britmë (të pallme). A nuk e shihnin ata se ai nuk ju fliste as nuk i udhëzonte në ndonjë rrugë të drejtë. E morën atë (e adhuruan si idhull viçin), e ishin të padrejtë ndaj vetes së tyre".**[200] Po ashtu thotë: **"E kur i premtuam Musait katërdhjetë net, pas tij ju e adhuruat viçin, e ishit të padrejtë".**[201]

Edhe në suren Taha thuhet: **"E ai (Samiriju) ua mbaroi atyre një viç me trup që pëlliste, e ata thanë: "Ky është zoti juaj dhe Zoti i Musait, po ai (Musai) e ka harruar". A nuk e kuptonin ata se ai (viç) as nuk u përgjigjej atyre, e as nuk kishte mundësi t'ju sillte ndonjë dobi a dëm. E Haruni atyre u pat thënë më parë: "O populli im, ju vetëm u sprovuat me të, pse Zoti juaj është i Gjithmëshirëshmi, andaj ejani pas meje dhe më dëgjoni për këtë që po ua them". Ata i thanë: "Ne nuk do t'i ndahemi këtij (adhurimit të viçit) derisa të kthehet Musai!"**[202]

Haruni a.s. ishte i pafuqishëm që t`i ndalojë ata nga adhurimi i viçit, kurse Samiriju i bindi se ky është zoti i tyre dhe i Musait a.s. por ai e ka harruar atë. Duke qenë populli në këtë gjendje, Zoti i tregoi Musës a.s. se çka ka ndodhur me popullin e tij. Por, ai nuk shfaqi habi me këtë lajm që dëgjoi. Zoti i tha atij: **"Ai (All-llahu) tha: "Ne sprovuam popullin tënd pas teje dhe ata i hodhi në humbje Samiriju!"**[203]

Kur u kthye Musa a.s. prej kodrës Tur dhe pa se çka kishte ndodhur në popullin e tij, nga hidhërimi i hodhi pllakat dhe filloi të bisedojë me Harunin a.s., Samirijun dhe popullin e tij. Zoti thotë në Kuran: **"E kur u kthye Musai**

[199] Kurani, A`af, 145;
[200] Kurani, A`raf, 148;
[201] Kurani, Bekare, 51;
[202] Kurani, Taha, 88-91;
[203] Kurani, Taha, 85;

shumë i hidhëruar te populli i vet, tha: "Sa keq më paskeni zëvendësuar pas shkuarjes sime! A e ngutët (pritjen) urdhërin e Zotit tuaj?" I hodhi pllakat dhe e zuri për koke (flokë) vëllanë e vet duke e tërhequr kah vetja". Ai (vëllai Harun) tha: "O bir i nënës sime, populli më mundi dhe gati më mbyti, mos i kënaq me mua armiqtë dhe mos më konsidero mua me njerëzit mizorë". (Musai) Tha: "Zoti im, më fal mua dhe vëllanë tim dhe na dhuro mëshirën Tënde, se Ti je Mëshirues i mëshiruesve".[204]

Si dhe: **"Musai u kthye te populli i vet i hidhëruar e i pikëlluar dhe tha: "O populli im, a nuk u premtoi juve Zoti juaj premtim të mirë, a mos u bë kohë e gjatë e ju e harruat premtimin, ose dëshiruat të ju godasë hidhërimi nga Zoti juaj, andaj e thyet besën që ma keni dhënë?" Ata thanë: "Ne nuk e thyem besën tënde me dëshirën tonë, por ne ishim ngarkuar me barrë të rënda nga stolitë e popullit e i hodhëm ato (në zjarr), e ashtu i hodhi edhe Samirija".[205]**

Kur bisedoi me vëllanë e vet i tha: **"Ai (Musai u kthye e) tha: "O Harun ç'të pengoi ty kur i pe se morën rrugën e gabuar. E ti mos u vazhdosh rrugën time? A mos e kundërshtove edhe ti porosinë time?" Ai (Haruni) tha: "O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekrre as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash: i përçave beni Israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?"[206]**

Dhe më pas iu drejtjua Samirijut: **"Ai (Musai) tha: "E çka ishte puna jote, o Samirij?" Tha (Samiriju): "Unë pashë atë që ata nuk panë, e mora një grushtë nga gjurma e të dërguarit (nga fërkemi i kalit të Xhibrilit) dhe ia hodha atij (viçit) dhe kështu më mashtroi vetvetja". Ai (Musai) tha: "Prandaj, largohu sepse sa të jeshë gjallë ke për të thënë: (këdo që e sheh) "Mos m'u afro!" E ty të pret edhe një moment (dënim) i pathyeshëm. E ti tash shikoje zotin tënd që e adhurove bindshëm, e tani atë do ta djegim e do ta bëjmë shkrumb dhe hirin e tij do ta shpërndajmë nëpër det". I adhuruari juaj është vetëm All-llahu, që përveç Tij nuk ka zot tjetër, e dituria e Tij ka përfshirë çdo send".[207]**

Ata të cilët kishin adhuruar viçin, Zoti ua mundësoi pendimin, me kusht që të vriten mes tyre, gjë të cilën e dëshmon Kurani: **"Dhe kur Musai popullit të**

[204] Kurani, A`raf, 150-151;
[205] Kurani, Taha, 86-87;
[206] Kurani, Taha, 92-94;
[207] Kurani, Taha, 95-98;

vet i tha: "O populli im, me adhurimin e viçit (në vend të Zotit), ju i bëtë zullum vetvetes, pra pendohuni para Krijuesit tuaj, dhe mbytne vetveten. Kjo për ju është më së miri te Krijuesi juaj. E Ai ua pranoi pendimin tuaj, Ai është mëshirues, ndaj pranon shumë pendimin".[208]

Ibni Kethiri thotë: "Thuhet se një mëngjes, ata që nuk e kishin adhuruar viçin, i morën shpatat në dorë, e Allahu e lëshoi mjegullën, në mënyrë që mos ta njihte kushëri-kushëririn as miku-mikun, e u sulën në adhuruesit e viçit dhe i vranë që të gjithë. Kështu, thuhet se atë mëngjes janë vrarë 70.000 vetë".[209]

E kur i kaloi hidhërimi Musës a.s. i mori pllakat. Në Kuran thuhet: **"E kur iu ndalë hidhërimi Musait, ai mori pllakat (që i pat hedhur), e në tekstin e tyre ishin (shënuar) udhëzime e mëshirë për ata që kanë frikë ndaj Zotit të tyre".[210]**

Dhe për të kërkuar falje për popullin e tij, Musa a.s. mori shtatëdhjetë burra prej popullit të tij, që t`i bëjnë shoqëri deri në kodrën Turi Sina dhe të kërkojnë falje për adhurimin e viçit. Kur arritën atje, Musa a.s. shkoi në kodër kurse të tjerët u ndalën më poshtë dhe dëgjonin bisedën e tyre. Kur u kthye Musa a.s. i thanë t`ua mundësojë atyre që ta shohin Zotin haptazi, se përndryshe nuk do të besojnë. Zoti thotë: **"Dhe kur i thatë: "O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim All-llahun haptazi, e atëherë juve u rrëmbeu rrufeja (zjarri) dhe ju e shihnit. Pastaj, që të jeni mirënjohës pas vdekjes suaj juve ju ngjallëm".[211]**

Si dhe: **"Musai zgjodhi nga populli i vet shtatëdhjetë veta për kohën që Ne ia caktuam takimin. E pasi i kapi ata dridhja (e tokës), ai tha: "Zoti im! Sikur të kishe dashur Ti, i kishe zhdukur më parë ata dhe mua. A po na zhduk për atë që bënë të marrët nga ne? Kjo është vetëm sprovë e Jotja, që me të e bën të humbur atë që do, dhe e vë në rrugë të drejtë atë që do. Ti je Mbrojtësi ynë, pra falna e mëshirona, se Ti je më i miri që falë (gabimet). Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në dynja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti".[212]** Kjo ishte lutja e Musait a.s. pasi Zoti i dënoi me rrufe parinë e beni Israilëve të cilët kërkuan ta shohin Zotin

[208] Kurani, Bekare, 54;
[209] Ibni Kethir-i, "Rrëfime për të Dërguarit e Allahut", Gjurma Botime, botimi i dytë, Prishtinë, 2007, fq.402;
[210] Kurani, A`raf, 154;
[211] Kurani, Bekare, 55-56;
[212] Kurani, A`raf, 155-156;

haptazi. E Zoti i ringjalli për hir të lutjes së Musait a.s. E Allahu xh.sh. në lutjen e tij u përgjigj kështu: **"Ai (Zoti) tha: "Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët i ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që argumentet Tona i besojnë. Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejenë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmonë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit".[213]**

Ky është tregimi i Musait a.s. me beni Israilët për të cilët aludon ky *hadith kudsij* që trajtuam, kurse sa i përket dëshirës për të parë me sy edhe pse lajmi për të ka arritur, e kemi edhe rastin e Ibrahimit a.s. i cili edhe pse kishte marrë lajmin për mundësinë e Zotit që të ringjallë vdekurit, ai përsëri për t`u bindur më shumë, kërkoi prej Zotit që ta shoh me sy se si e bën atë. Në Kuran thotë: **"Përkujto kur Ibrahimi tha: "Zoti im, më mundëso të shoh se si i ngjallë të vdekurit?" Ai (Zoti) tha: "A nuk beson?" Ai (Ibrahimi) tha: "Po, por desha që zemra e ime të ngopet (bindje)!" Ai (Zoti) tha: "Merri katër shpezë pranë vete (theri e copëtoi), e pastaj në çdo kodër vëne nga një pjesë të tyre, mandej thirri ato, do të vijnë ty shpejt, e dije se All-llahu është i Gjithfuqishmi, i Urti".[214]**

[213] Kurani, A`raf, 156-157;
[214] Kurani, Bekare, 260;

KADAJA DHE KADERI

HADITHI I TETËMBËDHJETË (18)

حَدَّثَنَا جَعْفَرُ بْنُ مُسَافِرٍ الْهُذَلِيُّ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ حَسَّانَ، حَدَّثَنَا الْوَلِيدُ بْنُ رَبَاحٍ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ أَبِي عَبْلَةَ، عَنْ أَبِي حَفْصَةَ، قَالَ: قَالَ عُبَادَةُ بْنُ الصَّامِتِ لِابْنِهِ: يَا بُنَيَّ، إِنَّكَ لَنْ تَجِدَ طَعْمَ حَقِيقَةِ الْإِيمَانِ حَتَّى تَعْلَمَ أَنَّ مَا أَصَابَكَ لَمْ يَكُنْ لِيُخْطِئَكَ، وَمَا أَخْطَأَكَ لَمْ يَكُنْ لِيُصِيبَكَ، سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، يَقُولُ: " إِنَّ أَوَّلَ مَا خَلَقَ اللَّهُ الْقَلَمَ، فَقَالَ لَهُ: اكْتُبْ قَالَ: رَبِّ وَمَاذَا أَكْتُبُ؟ قَالَ: اكْتُبْ مَقَادِيرَ كُلِّ شَيْءٍ حَتَّى تَقُومَ السَّاعَةُ " يَا بُنَيَّ إِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: «مَنْ مَاتَ عَلَى غَيْرِ هَذَا فَلَيْسَ مِنِّي»

Transmetohet se Ubade b. Samiti r.a. i ka thënë birit të tij: "O biri im, nuk do ta arrijsh thelbin e besimit, derisa ta kuptosh se ajo që të ka goditur, nuk ka mundur të shmanget, e ajo që të ka shmangur, nuk ka mundur të të godet, pasi unë e kam dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"E para gjë që ka krijuar Allahu është Lapsi dhe i ka thënë:* ***"Shkruaj".*** *Tha (lapsi): "O Zot! Çka të shkruaj?" Tha:* ***"Shkruaj caktimet për çdo gjë deri në ardhjen e Kijametit".*** O biri im, unë e kam dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"Kush vdes në diçka tjetër jashta kësaj, ai nuk është prej meje (ummetit tim)".*[215]

Ubade b. Samiti r.a. këshillonte birin e tij, vepër që duhet bërë nga çdo prind i ndërgjegjshëm, që të mbjell te fëmija i tij besimin e saktë dhe të

[215] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Sunneh, bab fil Kader, nr.4700; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsir, bab sure Kalem, nr.3330 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahihun-Garib dhe se përcillet ngjashëm edhe nga Ibni Abasi r.a.; Ahmed-i, "Musned", vëll.37, fq.381, nr.22.707; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në "Musned"-in e Ahmedit, thotë se "hadithi është Sahih, kurse zinxhiri i tij është i dobët shkaku i Abdullah ibni Lehiasë..."; kurse në verifikim të "Sunen"-it të Ebu Davud-it (7/86) thotë se hadithi është Hasen..; Hakim-i e përcjell nga Ibni Abasi në "Mustedrek", 2/492, nr.3693 dhe thotë se zinxhiri i hadithit është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar.

paluhatshëm, sepse shumë lehtë njeriu mund të bjerë pre dhe viktimë e ideologjive të devijuara. Sidomos kur është në pyetje *Kaderi* i Zotit, shumë njerëz janë të painformuar dhe gabimisht e besojnë atë.

Birit të tij i bën me dije, se një vepër e cila e godet njeriun, nuk është e mundur t`i shmanget përmes aktiviteteve trupore ose lëvizjeve të caktuara, sepse Zoti ka caktuar që më parë që ajo vepër të ndodh. Zoti thotë në Kuran: **"Thuaj: "Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç asaj që na ka caktuar Allahu, Ai është ndihmëtari ynë". Prandaj, vetëm Allahut le t`i mbështeten besimtarët".[216]**

Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"O djalosh, ruaje Allahun, do të ruajë Allahu ty... Dije që nëse tubohen të gjithë njerëzit për të ndihmuar diç, nuk do të mund të ndihmojnë pos aq sa e ka përcaktuar Allahu. Po ashtu, sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit për të shkaktuar ndonjë dëm ose të keqe, nuk do të mund të të dëmtonin më shumë sesa e ka caktuar Allahu më herët...".[217]*

Fahrudin er-Razi thotë: "Neve nuk na godet e mira ose e keqa, frika ose shpresa, vështirësi ose lehtësi, e ajo të mos jetë e shkruar tek Allahu".[218]

Gjithashtu, dijetarët kanë diskutuar se cila është krijesa e parë që ka krijuar Allahu xh.sh., ku janë paraqitur katër mendime: njëri mendim, bazuar në *hadith*-in e lartëshënuar, thotë se krijesa e parë është lapsi. Disa kanë thënë, se krijesa e parë është "Pllaka e Ruajtur"[219], sepse lapsi duhej të shkruajë, por vendi ku do të shkruajë është Pllaka. Disa po ashtu kanë konstatuar se krijesa e parë ka qenë *Arsh*-i i Zotit, kurse disa të tjerë kanë thënë se është uji. Këto dy mendime kanë buruar si rrjedhojë i *hadith*-it që e transmeton Imran b. Husajni r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...Ishte Allahu dhe nuk kishte asgjë përpos Tij, kurse Arshi i Tij ishte mbi ujë dhe shkroi në përkujtuesin (Leuhi Mahfudh) çdo gjë, pastaj krijoi qiejt dhe tokën...".[220]*

Më herët kuptuam se Zoti krijoi Lapsin dhe e urdhëroi që të shkruajë çdo gjë që do të ndodhë me krijesat deri në ditën e Kijametit dhe këtu është

[216] Kurani, Teube, 51;
[217] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 59, nr.2524 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih;
[218] Fahrudin Razi, "Mefatihu`l-Gajb", vëll.16, fq.87;
[219] "Leuhi Mahfudhi" është ajo që njihet si "Pllaka e Ruajtur";
[220] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-halki, bab 1, nr.3191; etj.

vulosur fati i krijesave. Pra, as Lapsi nuk ka vepruar diçka prej dëshirës së vet, porse ka shkruar vetëm atë që e ka urdhëruar Allahu i Plotëfuqishëm. Kësaj bindjeje, duhet qëndruar deri në fund, sepse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka bojkotuar atë i cili vdes në diçka tjetër jashta kësaj bindjeje Islame.

Duhet ditur mirë se lapsi ka shkruar atë dituri të Allahut xh.sh. që ka të bëjë me krijesat, d.m.th. çdo gjë e cila ndodh, ajo ka qenë e ditur detajisht te Allahu xh.sh. dhe Ai këtë Dituri të Tijën e ka urdhëruar lapsin që ta regjistrojë. Pra, caktimi i Allahut xh.sh. është Dituri e Tij për çdo gjë dhe për çdo imtësi të gjërave.

Çdo besimtar duhet të jetë i kënaqur me atë që na cakton Zoti, pasi Ai e di urtësinë e çdo gjëje. Nuk duhet të tregojmë pakënaqësi ndaj asaj që na godet, se Zoti i dërgon ato për të na forcuar ndaj stuhive të jetës. Transmeton Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. ka thënë:* ***"Kush nuk është i kënaqur me Kadanë dhe Kaderin Tim dhe nuk duron sprovat e Mia (që ia dërgoj) le të gjejë një zot tjetër përveç Meje".***[221]

[221] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.1, fq.377, nr.196; E shënon edhe Taberani në "Mu`xhemu`l-Euset", 7/202, nr.7273 por jo si hadith kudsij; Taberani në "Mu`xhemu`l-Kebir", 22/320, nr.807 e shënon si hadith kudsij por përmes Ebu Hind ed-Dariut, por për këtë hadith, mul-la Ali el-Kari-u thotë se është i dobët (shih: "Ehadith kudsije el-erbainije", fq.38);

HADITHI I NËNTËMBËDHJETË (19)

حَدَّثَنَا عَبْدُ بْنُ حُمَيْدٍ قَالَ: حَدَّثَنَا أَبُو نُعَيْمٍ قَالَ: حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " لَمَّا خَلَقَ اللَّهُ آدَمَ مَسَحَ ظَهْرَهُ، فَسَقَطَ مِنْ ظَهْرِهِ كُلُّ نَسَمَةٍ هُوَ خَالِقُهَا مِنْ ذُرِّيَّتِهِ إِلَى يَوْمِ القِيَامَةِ، وَجَعَلَ بَيْنَ عَيْنَيْ كُلِّ إِنْسَانٍ مِنْهُمْ وَبِيصًا مِنْ نُورٍ، ثُمَّ عَرَضَهُمْ عَلَى آدَمَ فَقَالَ: أَيْ رَبِّ، مَنْ هَؤُلَاءِ؟ قَالَ: هَؤُلَاءِ ذُرِّيَّتُكَ، فَرَأَى رَجُلًا مِنْهُمْ فَأَعْجَبَهُ وَبِيصُ مَا بَيْنَ عَيْنَيْهِ، فَقَالَ: أَيْ رَبِّ مَنْ هَذَا؟ فَقَالَ: هَذَا رَجُلٌ مِنْ آخِرِ الأُمَمِ مِنْ ذُرِّيَّتِكَ يُقَالُ لَهُ دَاوُدُ فَقَالَ: رَبِّ كَمْ جَعَلْتَ عُمْرَهُ؟ قَالَ: سِتِّينَ سَنَةً، قَالَ: أَيْ رَبِّ، زِدْهُ مِنْ عُمْرِي أَرْبَعِينَ سَنَةً، فَلَمَّا قُضِيَ عُمْرُ آدَمَ جَاءَهُ مَلَكُ المَوْتِ، فَقَالَ: أَوَلَمْ يَبْقَ مِنْ عُمْرِي أَرْبَعُونَ سَنَةً؟ قَالَ: أَوَلَمْ تُعْطِهَا ابْنَكَ دَاوُدَ قَالَ: فَجَحَدَ آدَمُ فَجَحَدَتْ ذُرِّيَّتُهُ، وَنُسِّيَ آدَمُ فَنُسِّيَتْ ذُرِّيَّتُهُ، وَخَطِئَ آدَمُ فَخَطِئَتْ ذُرِّيَّتُهُ "

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu i cili thotë që Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur Allahu xh.sh. e krijoi Ademin a.s., ia preku shpinën dhe prej tij dolën të gjithë pasardhësit të cilët Ai do t`i krijojë prej tij deri në Ditën e Gjykimit, kurse në mes të syve të çdo njeriut, ka bërë shkëlqim prej nuri, pastaj i ka paraqitur para Ademit a.s. dhe ai ka thënë: "O Zot, kush janë këta?" Tha:* ***"Këta janë pasardhësit e tu".*** *Ai pa një njeri prej tyre dhe u mahnit prej shkëlqimit në mes të syve që e kishte dhe tha: "O Zot, kush është ky?" Ai tha*: ***"Ky është një njeri prej popujve të fundit nga pasardhësit e tu i cili quhet Davud".*** *Ai (Ademi a.s.) tha: "Zot, sa ia ke përcaktuar jetëgjatësinë?" Tha:* "***Gjashtëdhjetë vjet".*** *Ai përsëri tha: "O Zot, shtoi atij prej jetës sime edhe katërdhjetë". Kur u plotësua jeta e Ademit a.s., i erdhi meleku i vdekjes dhe ai (Ademi a.s.) tha: "A nuk më kanë ngelur nga jeta ime edhe katërdhjetë vite?". Meleku i tha: "A nuk ia ke dhënë ato birit tënd Davudit?" Tha (Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-*

lem): "Polemizoi (kundërshtoi) Ademi a.s. po ashtu polemizojnë edhe pasardhësit e tij, harroi Ademi (a.s.) dhe harrojnë edhe pasardhësit e tij, gaboi Ademi a.s. dhe gabojnë edhe pasardhësit e tij".[222]

Allahu xh.sh. e krijoi njeriun si qenie të zakonshme e të përsosur në formën më të mirë dhe më të bukur, e nuk evuloi nga ndonjë shtazë si majmuni siç pretendojnë darvinistët. Zoti e krijoi që në fillim të aftë për të komunikuar, për të njohur dhe për të ditur, e nuk ka kaluar në faza të paaftësisë dhe primitivizmit.

Allahu xh.sh. i krijoi shpirtërat e të gjithë krijesave në një çast, kurse vijnë në këtë botë sipas radhitjes të cilën e shohim. Allahu xh.sh. në Kuran e konfirmon këtë ngjarje, ku thotë: **"Përkujto kur Zoti yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre (duke thënë): "A nuk jam Unë Zoti i juaj?" Ata thanë: "Po, gjithsesi, dëshmuam!" Të mos thoni në Ditën e Kijametit: "Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur".**[223]

Ngjashëm këtë skenë, ia tregoi edhe Ademit a.s. i cili u habit me këtë pamje dhe parashtroi pyetjen rreth qenies së tyre, se kush janë ata, pasi edhe ai nuk e dinte realitetin e tyre, sepse ishte hera e parë që shihte diçka të tillë. Allahu xh.sh. i bëri me dije se ato janë pasardhësit e tij, të cilët do të vijnë më pas.

Në *hadith*, po ashtu aludohet edhe në dritën (*nur*-in) të cilën Zoti e ka vendosur në mes syve të njerëzve. Ademi a.s. pasi vëzhgoi në fytyrat e tyre, pa një i cili i la mbresa dhe përshtypje, andaj pyeti Zotin se kush është ai?! Allahu xh.sh. e lajmëroi se personi në fjalë, është pejgamberi i Tij, Davudi a.s. Ky është pejgamberi të cilit iu shpall libri hyjnor Zeburi, të cilin kur e lexonte, edhe shpendët ndaleshin dhe dëgjonin se si e reciton atë me zërin e tij të bukur.[224] Kur pyeti rreth jetëgjatësisë së tij, kuptoi nga përgjigjja se ai do të jetojë 60 vjet. Ademi a.s. pasi e pëlqeu shumë bukurinë dhe ndriçimin që vinte nga Davudi a.s. i kërkoi Zotit që të merr prej jetës së tij 40 vite dhe t`ia dhurojë Davudit a.s.

---

[222] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsir, bab min sureti`l-A`raf, nr.3087 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; njashtu Hakim-i, në "El-Mustedrek", 2/355, nr.3257 dhe thotë se ky hadith është Sahih sipas kushteve të Muslim-it, por asnjëri prej atyre dyve nuk e ka shënuar; me këtë konstatim pajtohet edhe Dhehebi-u në "Telhis".
[223] Kurani, A`raf, 172;
[224] Shih: Kurani, Sebe, 10;

Por, kur erdhi koha që të ndërrojë jetë Ademi a.s. ai kishte harruar se nga jeta e tij i kishte dhuruar 40 vite Davudit a.s., me çka i bëri pyetje edhe melekut të vdekjes, se mos është herët që ka ardhur, pasi kanë ngelur edhe katërdhjetë vite nga jeta e tij. Nga kjo, u kuptua se Ademi a.s. lakmoi jetën dhe nuk dëshiroi të vdes.

Kjo jep të kuptohet se caktimi i Allahut ka qenë që jeta e Davudit a.s. të jetë 60 vjeçe dhe hiq më shumë dhe se Ademi a.s. nuk do t`ia dhurojë 40 vitet në mënyrë përfundimtare. Pra, caktimi i Zotit ishte njoftimi që në fillim siç edhe u njoftua Ademi *alejhi selam* dhe ky caktim është dituri paraprake që është e saktë.

Njeriu është krijesë që harron, pasi dhe vet babai ynë Ademi a.s. kishte harruar, siç kishte harruar më herët edhe urdhrin për mos ngrënie nga pema e ndaluar. Ademi a.s. polemizoi me melekun e vdekjes, kurse edhe sot njerëzit i gjenë polemizues në çdo çështje, përpos se njerëzit e rëndomtë, nuk kanë mundësi të bisedojnë dhe polemizojnë me melekun e vdekjes siç veproi Ademi a.s.

Nga ky *hadith*, shohim se jeta e njeriut është përcaktuar që më herët, para se të del njeriu në këtë botë, andaj nuk duhet të mendojë dikush se mund të vdes ndonjë krijesë para se t`i vijë çasti i vdekjes. Ajo as që vjen më herët, por as nuk vjen më vonë, por vetëm se në kohën që ka urdhëruar dhe ka shkruar Zoti. Zoti na thotë në Kuran: **"Çdo popull ka afatin e vet, e kur të vijë afati i tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përshpejtohet më herët".**[225]

Nga *hadith*-i, kuptojmë se njeriu është qenie të cilit i dhimbset jeta, edhe pse e di se një ditë do të vdes, ai përsëri e lakmon jetën e kësaj bote. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Zemra e plakut mbetet e re në dy gjëra: "Lakminë për dynjallëk dhe lakminë për jetë".*[226]

Nga ky *hadith*, kuptojmë se Davudi a.s. ka jetuar 100 vite.

[225] Kurani, A`raf, 34, ngjashëm është edhe në ajetin 49 të sures Junus, shih edhe Hixhër, 5; Nahël, 61; Mu`minun, 43; Munafikun, 11; Nuh, 4;
[226] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 5, nr.6420; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 38, nr.1046; etj.

Nga ky *hadith* kuptojmë se edhe Ademi a.s. i ka llogaritur vitet dhe i ka mbajtur mend se sa vite kanë kaluar prej ditës së krijimit të tij dhe sa i kanë ngelur.

Ky *hadith*, vjen edhe përmes disa transmetimeve tjera, në të cilët ka edhe disa detaje tjera, të cilat ndoshta do të jenë të dobishme në kontekst të temës.

Tirmidhiu e sjell edhe përmes një teksti tjetër, në të cilën shtohet edhe rasti i teshtitjes së Ademit a.s. dhe çka thuhet pas saj. Edhe ky transmetim është nga Ebu Hurejre r.a. ku Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Pasi Allahu xh.sh. e krijoi Ademin alejhi`s-selam dhe ia dha shpirtin, ai teshtiu dhe tha: "Elhamdulilah". Në këtë rast, Zoti i tha:* ***"Jerhamukallah ja Adem (Të mëshiroftë Allahu o Adem). Shko dhe atë grup të melekëve që janë ulur, përshëndeti me fjalën `Es`selamu alejkum`.*** *Ata (melekët) ia kthyen: "Ve alejke selam ve rahmetullah". Pastaj, u kthye te Zoti dhe Ai i tha:* ***"Me të vërtetë, kjo përshëndetje, do të jetë përshëndetja jote dhe përshëndetja e pasardhësve tu..".***[227]

Pra, nga ky tekst, shohim se në bisedën e parë që ndodhi në mes Zotit dhe njeriut, fjala e parë ishte "Mëshira", që nënkupton se njeriu është krijuar në bazë të Mëshirës së Zotit.

Imam Buhariu e shënon përmes Ebu Hurejres r.a. me këtë shtojcë në fillim shton se: *"Allahu xh.sh. e krijoi Ademin a.s. në pamjen e tij, të gjatë 60 kut, e kur e krijoi, i tha:* ***"Shko dhe përshëndete atë grup të melekëve që janë ulur dhe dëgjo se si do të përshëndesin, sepse ajo do të jetë përshëndetja yte dhe e pasardhësve të tu".*** *Ai u tha: "Es-Selamu Alejkum", kurse ata ia kthyen: "Es-selamu alejke ve rahmetullahi" duke e shtuar edhe fjalën `ve rahmetullahi`. Të gjithë që do të hyjnë në Xhenet, do të jenë në pamjen e Ademit a.s. dhe kanë vazhduar të shkurtohen krijesat deri sot".*[228]

Ky *hadith* vjen edhe me një tregim tjetër që nuk përmendet tek transmetimet e mëparshme, e ai është *hadith*-i nga Umer b. Hattabi r.a. i cili kur është pyetur rreth *ajet*-it që përmendëm në fillim të temës, ai ka treguar se

[227] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsir, bab 94, nr.3379 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; etj.

[228] Buhari-u, "Sahih", kitab Isti`dhanu, bab 1, nr.6227; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhenetu, bab 11, nr.2841; Abdurezak-u, "Musannef", Mexhlisu`l-ilmi, botimi i parë, 1972, 10/384, nr.19.435; Kur i kanë kërkuar sqarim imam Malikut rreth këtij hadithi dhe disa të tjerëve që janë muteshabih, ai ka refuzuar dhe ka shprehur pakënaqësi të madhe, si dhe ka ndaluar që ato t`i përcillen dikujt (shih: Ibni Abdulberi, "Temhid", vëll.7, fq.150);

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. kur e krijoi Ademin a.s. e preku shpinën e tij me "Jemin-in"*[229] *e Tij, kurse prej tij (Ademit a.s) dolën pasardhësit e tij dhe tha (Zoti):* ***"Këto i kam krijuar për në Xhenet dhe këta do të punojnë punë të banorëve të Xhenetit".*** *Pastaj e preku përsëri shpinën e tij dhe dolën përsëri pasardhësit e tij dhe tha:* ***"Këto i kam krijuar për në Zjarr dhe do të veprojnë punë të banorëve të Zjarrit".*** Një njeri pyeti: "O i Dërguari i Allahut, po përse atëherë të punojmë?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Allahu xh.sh. kur e krijon një rob për në Xhenet, ia lehtëson veprimin e punëve të banorëve të Xhenetit derisa të vdes në atë gjendje, e kur e krijon një njeri për në Zjarr, e bën që të jepet pas veprave që bëjnë banorët e Zjarrit derisa t`i vijë vdekja me veprat e banorëve të Zjarrit, e kështu të përfundojë në Zjarr".*[230]

Shumë hulumtues bëjnë hulumtime dhe gërmime për të gjetur zanafillën e popullit dhe prejardhjen e tyre, për të ditur të kaluarën, kurse edhe ne në këtë *hadith* u njoftuam për një pjesë të jetës së babait tonë, njeriut të parë Ademit a.s.

---

[229] *"Jemin"* nuk potencohet se çka është konkretisht, edhe pse në aspektin gjuhësorë d.m.th. `e djathtë`, e çka është ky *"Jemin"* Allahu e di më së miri, pra, e besojmë ashtu siç ka ardhur pa e komentuar.

[230] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Sunneh, bab fi`l-Kader, nr.4703; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsir`ul-Kurani, bab min suretil A`raf, nr.3075 dhe thotë se ky hadith është Hasen, kurse Muslim b. Jesari nuk ka dëgjuar hadithe prej Umerit e disa kanë përmendur në mes tyre një transmetues të panjohur; Malik-u, "Muvetta", kitab Xhami, bab nehju anil kauli bil kader, nr.2617; Ahmed-i, "Musned", 1/399, nr.311; Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.1, fq.80, nr.74 dhe thotë se "hadithi është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar", ndërsa Dhehebiu thotë se hadithi është Mursel; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të "Sunen"-it të Ebu Davud-it, (7/90) thotë se hadithi është Sahih li gajrihi (i saktë në bazë të provave tjera që janë dëshmi) por zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, sepse Muslim b. Jesari nuk ka dëgjuar hadithe prej Umerit r.a. si dhe atë (Muslim b. Jesarin) nuk e kanë konsideruar të besueshëm tjerë përveç Ibni Hibanit dhe Ixhliut. Prej Muslim b. Jesarit hadithin e përcjell Abdulhumejd b. Abdurahman b. Zejd b. Hatabi, i cili numërohet prej të panjohurve. Shejh Shuajbi potencon se edhe Ibni Abdulberi në "Temhid" vëll.6, fq.3 thotë se hadithi është i ndërprerë në këtë zinxhir, pasi Muslim b. Jesari nuk e ka takuar Umerin r.a., por kuptimi i hadithit është i saktë në bazë të haditheve tjera.

HADITHI I NJËZETË (20)

حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ مُحَمَّدٍ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ هَمَّامِ بْنِ مُنَبِّهٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لاَ يَأْتِ ابْنَ آدَمَ النَّذْرُ بِشَيْءٍ لَمْ يَكُنْ قَدْ قَدَّرْتُهُ، وَلَكِنْ يُلْقِيهِ القَدَرُ وَقَدْ قَدَّرْتُهُ لَهُ، أَسْتَخْرِجُ بِهِ مِنَ البَخِيلِ»

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: ***"Përbetimi nuk i sjell birit të Ademit ndonjë gjë, që Unë nuk e kam caktuar për të. Përkundrazi, është kaderi i përcaktuar ai që e shtyn atë për t`u betuar. (Nëpërmjet betimit) Unë e bëj kopracin të shpenzojë nga pasuria e tij".***[231]

Ky *hadith* është i ndërlidhur me temën e caktimit të Zotit dhe ndërlidhshmëria e caktimit të Zotit me zotimin që e bën njeriu në lidhje me ndonjë çështje. Në vijim do të mundohemi t`i qartësojmë këto dy aspekte.

Fjala `*en-nudhur*` është shumësi i fjalës `*nedhër*`, ndërsa në aspektin gjuhësor, nënkupton obligim me diçka të mirë ose të keqe. Në *sheriat*, zotimi nënkupton vetobligim të obliguesit sheriatik (*mukelef*) me diçka për të cilën nuk është i obliguar.[232]

Dijetarët e kanë ndarë zotimin në dy lloje, mund të jetë zotim i pakushtëzuar dhe i kushtëzuar. I pakushtëzuar është nëse njeriu thotë: "Obligohem se për hatër të Allahut do të agjëroj kaq ditë", kurse i kushtëzuar është kur njeriu thotë: "Nëse më kthehet ai që mungon" ose "nëse Allahu më shëron, apo më ruan nga armiqtë e mi, do të agjëroj kaq ditë".[233]

---

[231] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Kaderu, bab ilkai`n-nedhri`l-abde ilel-kader, nr.6609; Muslim-i, "Sahih", kitab Nedhër, bab 2, nr.1640; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Ejmanu ve`n-nudhuru, bab 18, nr.3288; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Nudhur ve`l-ejman, bab fi kerahijeti`n-nudhur, 1543 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Ejmani ve`n-nudhuri, bab 25, nr.3835;

[232] Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, "Fikhu Hanefi", Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, 2011, vëll.2, fq.491;

[233] Po aty;

Edhe Allahu xh.sh. kërkon që t`i përmbushim zotimet tona, nëse për to kemi dhënë fjalë. Allahu xh.sh. thotë: **"...le t`i përmbushin zotimet (premtimet) e veta...".**[234] Po ashtu thotë: **"Ata i zbatonin zotimet dhe i frikësoheshin ditës, kobi i së cilës do të jetë prezent gjithandej".**[235]

Ibni Haxheri kur sqaron këto *hadith*-e, thotë: "Dijetarët nuk janë unanim në aspektin e këtij ndalimi, andaj ka të atillë që e kuptojnë në kuptimin e jashtëm, por ka edhe të atillë që e kuptojnë në aspektin figurativ. Ibni Ethiri në "Nihaje" thotë: "Në *hadith* është përsëritur ndalesa e zotimit, theksohet rëndësia e tij dhe tërhiqet vërejtja për atë që ndaj tij të mos tregohet shpërfillje pasi të jetë urdhëruar. Kurse domethënia e këtij ndalimi është vetëm paralajmërimi për të, në mënyrë që të mos bëhet. Me këtë trajtimi i tij do të eliminohej dhe do të rrëzohej obligimi i përmbushjes së zotimit, sepse me ndalesë do të bëhej gjunah dhe nuk do të ishte i obligueshëm. Mirëpo, *hadith*-i nënkupton që i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka lajmëruar se zotimi është diçka që në këtë botë nuk u sjell kurrfarë dobie, nuk eliminon prej tyre dëmin, as e ndërron përcaktimin, andaj u thotë: "Mos u zotoni me qëllim që përmes tij të realizoni diçka që Allahu nuk ua ka përcaktuar, ose që me të nga vetvetja ta largoni atë që Allahu ua ka përcaktuar. Prandaj, kur të zotoheni, lirohuni nga zotimi ashtu që do ta përmbushni, ngase jeni të detyruar ta përmbushni atë për çka zotoheni". Domethënia e *hadith*-it është theksimi i rëndësisë së zotimit, në mënyrë që të mos injorohet dhe në mënyrë që të mos paraqitet neglizhencë në përmbushjen e zotimit dhe kështu të lihet anash realizimi i tij".[236]

Mos mbajtja e zotimit, është e qortuar sipas parimeve Islame, nga shkaku se njeriu duhet të zbatojë atë për të cilën vet e ka obliguar vetveten. Ata që nuk e përmbushin zotimin, kritikohen nga ana e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Transmeton Imran b. Husajni r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më të mirët prej jush, janë ata të gjeneratës sime (sahabët), pastaj ata që vijnë pas tyre (tabiinët) e më pas ata që vijnë pas tyre (etbai tabiinët). Pastaj, do të vijnë njerëz, të cilët do të zotohen dhe nuk do ta përmbushin zotimin, do të tradhtojnë dhe nuk do t`u besohet asgjë, do*

[234] Kurani, Haxh, 29;
[235] Kurani, Insan, 7;
[236] Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari", Daru Tajbeh, Rijad, botimi i parë, 2005, vëll.15, fq.350-351;

të dëshmojnë, kurse dëshmia e tyre nuk do të kërkohet dhe në mesin e tyre do të paraqitet trashësia".[237]

Zotimi bën pjesë në shkaktarët e caktuar me *kader* dhe për ta ka paraprirë Dituria e Lavdiplotit dhe me ta është i lidhur vullneti i Tij".[238]

Zotimi duhet të jetë në përputhje me kënaqësinë e Zotit e jo të zotohet njeriu për mëkat dhe devijim. Transmeton Aishja r.a.h. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush zotohet se do t`i bindet Allahut, le të jetë i bindur, ndërsa kush zotohet të kryejë mëkat, le të mos e kryejë mëkatin".*[239]

Zotimi ka aq rëndësi saqë edhe kur ndodh që njeriu të jetë zotuar para se të bëhet musliman, këtij pas pranimit të Islamit i preferohet realizimi dhe zbatimi i premtimit të bërë gjatë kohës së *kufri*-t, kuptohet nëse i është zotuar Zotit të vetëm dhe jo idhujve tjerë. Këtë e argumentojmë me transmetimin kur Umeri r.a. i ka thënë Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "O i Dërguari i Allahut, unë në periudhën e injorancës jam zotuar se do të bëj *itikaf* një natë në *Mesxhidi`l-haram*?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Zbatoje zotimin tënd".*[240]

Ibni Bettali thotë: "Ky urdhër sipas fukahave kuptohet si nxitje dhe preferim, ngase pranimi i Islamit shlyen të kaluarën".[241]

Nuk duhet njeriu të zotohet për veprime të cilat nuk janë adhurim dhe të cilat nuk shtojnë devotshmërinë, porse vetëm mundimin dhe lodhjen e njeriut. Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke mbajtur *hutbe-n*, pa një njeri i cili qëndronte në këmbë. Ai pyeti për të dhe i thanë se ai është Ebu Israili, i cili është zotuar se do të qëndrojë në këmbë dhe se nuk do të ulet, as që do të hyjë nën hije si dhe që nuk do t`i flas askujt, e gjithë këtë duke qenë agjërueshëm. Pejgamberi sal-lallahu

[237] Buhari-u, "Sahih", kitab esh-Shehadatu, bab la jeshhedu ala shehadeti xheurin idha ushhide, nr.2651; Muslim-i, "Sahih", kitab Fadailu`s-Sahabeti, bab fadlu sahabeti r.a., nr.2535; etj.
[238] Tuhmaz, "Fikhu Hanefi", vëll.2, fq.496;
[239] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ejmani ve`n-nudhuri, bab 28, nr.6696, etj;
[240] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ejmani ve`n-nudhuri, bab 29, nr.6697; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Ejmanu, bab nedhru`l-kafiri ve ma jefalu fihi idha esleme, nr.1656; etj.
[241] Bedrudin el-Ajni, "Umdetu`l-Kari", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2001, vëll.11, fq.141;

alejhi ve sel-lem tha: *"Urdhërojeni atë që të flas, që të hyjë nën hije dhe të ulet, e më pas të vazhdojë me agjërimin".*[242]

Nuk ka nevojë njeriu ta torturojë vetveten, sepse tortura nuk është adhurim, por malltretim i panevojshëm.

Nga ky *hadith*, shohim se Zoti është shumë i Mëshirshëm ndaj krijesave të Tij, saqë nuk dëshiron askë ta privojë nga mirësitë e Tija, kështu që i mundëson edhe koprracit që të përfitojë nga mirësitë e *sadaka*-së dhe të ketë dobi në botën tjetër.

Ibni Haxheri thotë: "Ky *hadith* është *hadith kudsij*, por është lëshuar pjesa ku i mbështetet fjala Allahut".[243]

[242] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ejmani ve`n-nudhuri, bab 31, nr.6704, etj;
[243] Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari", vëll.15, fq.354;

HADITHI I NJËZETENJËTË (21)

حَدَّثَنَا زَكَرِيَّا بْنُ يَحْيَى السَّاجِيُّ، ثنا أَحْمَدُ بْنُ سَلْمٍ الْعُمَيْرِيُّ، ثنا مَالِكُ بْنُ يَحْيَى بْنِ عَمْرِو بْنِ مَالِكٍ النُّكْرِيُّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ عَمْرِو بْنِ مَالِكٍ، عَنْ أَبِي الْجَوْزَاءِ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " إِنَّ اللهَ قَالَ: أَنَا خَلَقْتُ الْخَيْرَ، وَالشَّرَّ فَطُوبَى لِمَنْ قَدَرْتُ عَلَى يَدِهِ الْخَيْرَ، وَوَيْلٌ لِمَنْ قَدَرْتُ عَلَى يَدِهِ الشَّرَّ "

Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë e kam krijuar të mirën (hajrin) dhe të keqen (sherrin), lum për atë në dorën e të cilit kam caktuar (mundësuar) të mirën dhe mjerë për atë në dorën e të cilit kam caktuar (mundësuar) të keqen".***[244]

Edhe ky është një *hadith kudsij* i cili flet për çështjen e paracaktimit dhe diturisë së pakufishme të Allahut xh.sh. Nga kjo, bëhet me dije se Allahu xh.sh. ka krijuar të mirën dhe të keqen, pasi Allahu xh.sh. është Krijues i çdo gjëje. Zoti thotë në Kuran: **"Ky është Allahu Zoti i juaj, nuk ka hyjni tjetër përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhuronie Atë...".**[245]

Çdo gjë nga e mira ose e keqja që ndodhë në gjithësi, rrjedh me caktim, drejtësi, program dhe me shkaqe të cilat i realizon Allahu xh.sh. me urtësinë e Tij të pafund. Çdo gjë në univers ndodh në dijen dhe me lejen e Zotit. Allahu xh.sh. thotë: **"A nuk e ke ditur se Allahu di çka ekziston në qiell dhe në tokë, e tërë ajo është e shënuar në Libër, ajo për Allahun është shumë e lehtë".**[246]

---

[244] Taberani-u, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.12, fq.173, nr.12.797; Hadithi për nga rrugët e transmetimit është i dobët. Këtë e deklaron Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid" vëll.8, fq.192 i cili thotë: "E transmeton Taberaniu dhe në të ndodhet Malik b. Jahja që është i dobët".

[245] Kurani, En`am, 102; ngjashëm përmendet edhe në sure Ra`d, 16, Zumer, 62, Gafir, 62;

[246] Kurani, Haxh, 70;

Zoti na qartëson fjalët e njerëzve të cilët thonë gjëra të ndryshme për ndodhitë, por në fakt të gjitha janë prej Zotit. Allahu xh.sh. thotë: **"Kudo që të jeni vdekja do t`ju gjejë, po edhe në qoftë se jeni në pallate të fortifikuara. E nëse i qëllon ata ndonjë e mirë, thonë: "Kjo është nga Allahu". E nëse i qëllon ndonjë e keqe, thonë: "Kjo është prej teje (o Muhamed)". Thuaju: "Të gjitha janë prej Allahut" ç`është me këtë popull që nuk kupton asnjë send?!".**[247]

Mund të përmendim edhe ajetin: **"E Allahu ju krijoi juve dhe atë që e punoni".**[248]

Në këtë drejtim, mund të përmendim edhe *hadith*-in që e përcjell Hudhejfe r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu ka krijuar çdo vepërbërës dhe atë që ai e bën".*[249]

Imam Ebu Hanife kur sqaron gjashtë kushtet e *iman*-it, thotë: "...besimi në caktimin e të mirës dhe të keqes, të gjitha janë nga Allahu...".[250] kurse në një vend tjetër thotë: "Edhe e mira edhe e keqja janë të përcaktuara nga Zoti. Nëse dikush pretendon se hajri (e mira) dhe sherri (e keqja) janë nga dikush tjetër e jo prej Allahut, ky njeri konsiderohet kafir dhe i shkatërrohet imani në besimin në një Zot po që se ka besim".[251]

Kjo ka bazë edhe në *hadith*-in e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të cilën e përcjellë Ibni Umeri r.a. se Xhibrili a.s. ka ardhur në pamje njerëzore në *mexhlisin* e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe e ka pyetur se çka është Imani? Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është përgjigjur: *"Imani është të besosh Allahun, melekët e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, të besosh në Xhenetin dhe Xhehenemin, në Kijametin dhe në Kaderin (përcaktimin) se e mira dhe e keqja, e ëmbla dhe e hidhura janë prej Allahut...".*[252]

---

[247] Kurani, Nisa, 78;
[248] Kurani, Safat, 96;
[249] Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", vëll.7, fq.258, nr.2837; Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.1, fq.85, nr.85-86 dhe thotë se hadithi është Sahih sipas kushteve të Muslimit por atë nuk e ka shënuar" me këtë pajtohet edhe Dhehebiu;
[250] Ebu Hanife, "Fikhu`l-Ekber", fq.35;
[251] Ebu Hanife, "El-Vesijjetu", Daru Ibni Hazëm, Bejrut, botimi i parë, 1997, fq.34;
[252] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab bejanu`l-Iman, nr.8; Taberani-u, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.12, fq.430-431, nr.13.581 tekstin që kemi shënuar është i tij;

Edhe imam Tahaviu thotë: "Hajri (e mira) dhe Sherri (e keqja) janë të caktuara për robërit".[253]

Gjithashtu, ne e dimë se mëkatet të cilat kryhen nga njerëzit, kanë dy shtytës kryesorë, *shejtan*-i dhe epshi i njeriut. Që të dyja këto, janë krijesa të krijuara nga ana e Allahut xh.sh. dhe nuk kemi të drejtë të pretendojmë se ato janë të krijuara vetvetiu.

Për këtë, Ebu Davudi ka shënuar një transmetim nga Hasan el-Basriu, i cili kur erdhi në Meke dhe mbajti ligjërim, dikush e pyeti: "O Ebu Seid, kush e ka krijuar *shejtan*-in?" Ai tha: "Subhanallah, a ka krijues tjetër përpos Allahut?!" Allahu e ka krijuar *shejtan*-in, e ka krijuar të mirën dhe e ka krijuar të keqen". Njeriu tha: "I vraftë Allahu, si shpifin për këtë dijetar!".[254]

Allahu xh.sh. krijon çka të dojë dhe njeriut nuk i takon të përzihet në kompetencat e Zotit. Një transmetim thotë: "Çka do Allahu bëhet, e çka nuk do, ajo nuk mund të bëhet".[255]

Por, Allahu xh.sh. edhe pse i ka krijuar sendet, qofshin të mira ose të këqija, nuk do të thotë se neve na ka detyruar që të kryejmë të keqen, porse Zoti na ka sqaruar rrugën e mirë dhe të keqe e pastaj na ka lënë të lirë. Edhe pse Allahu Fuqiplotë që në pafillimësi e ka ditur se çka do të zgjedhim, ngase Dituria e Tij është e pafund, por përsëri na ka urdhëruar për të mirën dhe na ka ndaluar që të pasojmë të keqen. Zoti thotë në Kuran: **"Allahu ju urdhëron për drejtësi, bëmirësi dhe ndihmë të afërmve, kurse ju ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim".**[256] Po ashtu thotë në *ajet* tjetër: **"...thuaj: "Allahu nuk urdhëron të shëmtuarën, a thoni për Allahun atë që nuk e dini?!".**[257] Kurse për *shejtan*-in, thotë: **"Shejtani ju frikëson me varfëri dhe ju urdhëron për punë të këqija...".**[258]

Pra, Allahu xh.sh. urdhëron për të mira, ndalon nga të këqijat, kurse *shejtan*-i për ta devijuar njeriun, e urdhëron dhe këshillon për vepra të këqija dhe e

[253] Tahavi-u, "Akidja e Tahavit", Qendra Studimore Fetare Erasmus, Tiranë, 2014, fq.88;
[254] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Sunneh, bab luzumu`s-sunneti, nr.4618; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikimin (*tahkikun*) e Sunen-it të Ebu Davud-it (vëll.7, fq.27) thotë se senedi i këtij *etheri* në fjalë është i saktë (*Sahih*);
[255] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Sunneh, bab luzumu`s-sunneti, nr.4612;
[256] Kurani, Nahël, 90;
[257] Kurani, A`raf, 28;
[258] Kurani, Bekare, 268;

ndalon nga të mirat, që ta bëjë atë banorë të Zjarrit. Por, *shejtan*-i nuk ka forcë që ta detyrojë njeriun të kryejë një akt të caktuar, porse njeriu mashtrohet prej fjalëve të tij dhe me vullnetin e vet e kryen një mëkat.

Çdo gjë ekziston në saje të Vullnetit të Zotit dhe asgjë nuk mund të ndodh në gjithësi pa vullnetin e Tij. Por, siç thotë Imam Ebu Hanife: "Të gjitha punët e njerëzve, si lëvizja dhe heshtja, janë fitim i mirëfilltë i njerëzve, kurse Allahu është Krijues i tyre. Të gjitha ato ndodhin sipas vullnetit, diturisë, caktimit (*kada*-së) dhe përcaktimit (*kader*-it) të Tij. Të gjitha detyrat fetare janë të obligueshme me urdhërin e Allahut, me dashurinë, kënaqësinë, dijen, vullnetin, caktimin dhe përcaktimin e Tij. Të gjitha veprat e këqija ndodhin sipas dijes, caktimit, përcaktimit dhe vullnetit (*Irade*-s) të Tij, por pa dashurinë, kënaqësinë (*Rida*-në) dhe urdhërin e Tij".[259]

imam Tahavi-u thotë: "Veprimet njerëzore janë krijime të Zotit, por përvetësime (*kesb*) të njerëzve".[260]

Edhe imam Nesefi-u thotë: "Allahu i madhëruar është Krijuesi i veprave njerëzore, ato të cilat janë shprehje të *kufri*-t dhe besimit, përkushtimit dhe mëkatit. Krijimi zhvillohet sipas vullnetit, dashjes, urtësisë, përcaktimit dhe caktimit të Tij. Njerëzit veprojnë sipas lirisë vetjake, për ç`arsye do të jenë të shpërblyer ose ndëshkuar. Veprat e mira të bëra janë me pëlqimin e Zotit, ndërsa të këqijat jo".[261]

Njeriu në bazë të angazhimit të tij, mund të arrijë të bëhet besimtar por edhe të refuzojë besimin. Zoti nuk e ka detyruar askë që të jetë i tillë.

Allahu xh.sh. ka krijuar krijesat dhe veprat, por njeriu zgjedh se cilat do t`i realizojë, të mirat ose të këqijat. Allahu xh.sh. dëshiron që të kryhen veprat e mira dhe nuk është *razi* të kryhen veprat e këqija. Edhe pse Zoti ynë nuk është *razi* (i kënaqur) me veprat e këqija, por Ai përsëri jep leje në ndodhjen-krijimin dhe daljen e tyre në ekzistencë. Ose thënë me terminologjinë fetare: Zoti ynë ka *iradet* për çdo gjë që ndodh në gjithësi, ngase gjithçka ndodh me lejen e Tij, por nuk është *razi* me punët tona të këqija, për atë edhe na dënon për to.

[259] Ebu Hanife, "Fikhu`l-Ekber", fq.57-58;
[260] Tahavi-u, "Akidja e Tahavit", fq.90;
[261] Nesefi-u, "Besimi Islam sipas imam Nesefiut", fq.21;

Ta thjeshtësojmë edhe më shumë: edhe pse shkolla është ajo që ka paraparë notën njësh për nxënësin e dobët, përsëri arsimtari nuk është i kënaqur me këtë notë për nxënësin e tij. Pra, e keqja është e krijuar nga Zoti, por nuk është i kënaqur dhe nuk e urdhëron njeriun për një veprim të tillë. Pra, mëkati është përfitim i njeriut dhe dëshirë e tij, e nuk është me urdhërin e Zotit.

Ja edhe një shembull më konkret: Allahu xh.sh. e ka krijuar derrin, por nuk është i kënaqur që njeriu ta konsumojë mishin e tij; Allahu xh.sh. ka krijuar *shejtan*-in, por ka ndaluar të ndiqen rrugët e tij; Allahu ka krijuar rrushin, por ka ndaluar që ai të shndërrohet në alkool. Shohim se ka dallim në mes krijimit të gjërave nga ana e Zotit që ndodhin me *Iraden* e Tij dhe kënaqësisë dhe pajtimit të Tij për t`u vepruar ato.

Do të përmendim edhe një ilustrim tjetër të cilin e përmend Hisham el-Humsij për të kuptuar sa më qartë këtë dilemë. Ai thotë: "Çdo prind e do fëmijën e vet, atij i dëshiron sukses dhe lumturi në jetë. Por, nëse fëmija është i padëgjueshëm dhe kryeneç, prindi e këshillon atë dhe duron padëgjueshmërinë e tij. Mirëpo, nëse fëmija tejkalon kufijtë e mosrespektit dhe padëgjueshmërisë, prindi do ta nxjerrë atë nga shtëpia me dëshirën e tij. Megjithatë, kur fëmija largohet nga shtëpia, prindi fillon të qajë dhe të ndjehet keq për të, për arsye se edhe pse e nxori me dëshirën e tij, ai nuk është i kënaqur dhe nuk pajtohet me veprimet e fëmijës".[262]

Çdo gjë është e kufizuar tek dëshira e Zotit, siç thuhet në Kuran: **"Po ju nuk mund të doni gjë, pos nëse do Allahu".[263]** Prej veprimeve të njeriut, nuk mund të ndodh diç e që Allahu xh.sh. të mos ketë vullnet për të, kur njeriu dëshiron diç, Ai i krijon fuqinë për ta realizuar atë. Pra, njeriu nuk e krijon aktin e vet por e vepron.

Nëse njeriu dëshiron të kryejë vetvrasje, Allahu xh.sh. e ka ditur që në *Ezel* se çka do të veprojë njeriu, Ai nuk e ka urdhëruar për një gjë të tillë, por njeriu e kryen atë me dëshirën e vet. Duhet të kemi të qartë një gjë, se te Allahu xh.sh. nuk ekziston koha dhe vendi që janë kufizime për krijesat, andaj për Zotin nuk ka nevojë që të ndodh diçka që Ai ta mësojë ndodhjen e saj, porse te Zoti çdo gjë, si fillimi si fundi janë të njëjta dhe të njohura, pasi Zoti nuk vepron në kuadër të kohës dhe vendit.

[262] Hisham A. El-Humsij, "Kadaja dhe kaderi", Kibla, Gostivar, 2003, fq.15;
[263] Kurani, Insan, 30;

MENDIMI I MIRË

PËR ALLAHUN

HADITHI I NJËZETEDYTË (22)

حَدَّثَنَا أَبُو الْمُغِيرَةِ، قَالَ: حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ الْغَازِ، قَالَ: حَدَّثَنِي أَبُو النَّضْرِ، قَالَ: دَعَانِي وَاثِلَةُ بْنُ الْأَسْقَعِ، وَقَدْ ذَهَبَ بَصَرُهُ فَقَالَ: يَا حَيَّانُ ، قُدْنِي إِلَى يَزِيدَ بْنِ الْأَسْوَدِ الْجُرَشِيِّ – فَذَكَرَ الْحَدِيثَ –، فَقَالَ: أَبْشِرْ، فَإِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ عَنِ اللهِ عَزَّ وَجَلَّ: " أَنَا عِنْدَ ظَنِّ عَبْدِي بِي، فَلْيَظُنَّ بِي مَا شَاءَ "

Transmeton Vathile b. Eska` (r.a) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë jam në të menduarit (imagjinuarit) e robit Tim ashtu siç më mendon Mua, prandaj le të mendojë për Mua si të dojë".***[264]

Allahu xh.sh. është vazhdimisht me robin e Tij, e ka nën mbikëqyrje dhe kujdeset për të, i ka caktuar furnizimin, i ka dhënë begati dhe mirësi të shumta. Andaj, robi duhet të ketë mendim të mirë për Zotin, e jo të jetë mos mirënjohës dhe mosfalënderues, sepse asgjë nuk posedon prej mundit të vet, porse gjithçka është prej mirësisë së Zotit ndaj tij.

Dhann – nënkupton bindjen e cila përfitohet prej diturisë. Kjo është kur njeriu e din se do të realizohet një qëllim i caktuar. Në këtë kontekst, është edhe fjala në *ajet*-in kuranor: **"Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time".** [265] Ngjashëm është edhe *ajet*-i: **"..dhe menduan se u**

[264] Ahmed-i, "Musned", 25/398, nr.16.016 dhe 28/186, nr.16.979; Ibni Mubarek-u, "Zuhd", fq.272, nr.909; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 22/87, nr.209; Hakim-i, "El-Mustedrek", 4/268, nr.7603 dhe thotë se "zinxhiri është Sahih, por Buhari-u dhe Muslim-i nuk e kanë shënuar", kurse me të pajtohet edhe Dhehebiu duke thënë se është sipas kushteve të imam Muslimit; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 2/318, nr.3887 thotë se e transmetojnë Ahmedi dhe Taberani në "Euset", e transmetuesit e Ahmedit janë të besueshëm; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se është me zinxhir Sahih;
[265] Kurani, Hakka, 20;

përgënjeshtruan (pse ende nuk i kapi dëninmi), e atëherë u erdhi atyre (të dërguarve) ndihma Jonë...".[266]

Në këtë rast, nuk duhet të mendojmë se bëhet fjalë në lidhje me mendimin e njeriut, që mund të paramendojë për Zotin ndonjë pamje fizike, pasi Zoti nuk ka cilësi njerëzore dhe as pamje fizike, sepse kufijtë nuk e përfshijnë atë. Këtë e thotë qartë Zoti: **"Asnjë send nuk është si Ai..".**[267] Por, në këtë *hadith*, aludohet në mendimin e njeriut rreth gjykimit të Zotit për të, se a do ta fal apo jo.

Pra, Zoti i drejtohet robit në këtë *hadith* duke i thënë se do ta llogarit në bazë të asaj që ai ka menduar për Të, nëse e ka menduar të Mëshirshëm dhe ka shpresuar në faljen e Tij, atëherë ashtu do ta gjejë Atë, Mëshirues dhe Falës, por nëse ka menduar se Zoti nuk ka mundësi që ta fal, atëherë ai edhe nuk do të falet, sepse nuk ka arrit ta njohë Zotin dhe fuqinë e Tij si duhet. Pra, nëse mendon mirë, do të gjejë mirë, nëse mendon keq, do të gjejë keq.

Hasan el-Basriu ka thënë: "Besimtari ka mendim të mirë, andaj i ka të mira edhe veprat, kurse mynafiku ka mendim të keq, andaj i ka të këqija edhe veprat".[268]

Në këtë kuptim, është edhe *hadith*-i nga Xhabir b. Abdullahu radijeAllahu anhu i cili e ka dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem tre ditë para vdekjes duke thënë: *"Askush të mos vdes prej jush, përpos se të ketë mendim të mirë për Allahun xh.sh."*.[269] Në lidhje me këtë mund të ndërlidhim edhe hadithin tjetër kudsi i cili përcillet nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë jam ashtu siç më mendon robi Im, nëse mendon për Mua mirë është për të, e nëse mendon për Mua keq, është prap për të".***[270]

---

[266] Kurani, Jusuf, 110;
[267] Kurani, Shura, 11;
[268] Ahmed b. Hanbel, "Zuhd", fq.231, nr.1647;
[269] Muslim-i, "Sahih", kitab Xhenet ve sifeti neimiha ve ehliha, bab 19, nr.2877; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhenaizu, bab 12, nr.3113; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 14, nr.4167;
[270] Ahmed-i, "Musned", 15/35, nr.9076; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se është Sahih, kurse për zinxhirin e këtij hadithi thotë se është i dobët shkaku se në të gjendet Ibni Lehia; hadithin e regjistron edhe Ibni Hibani, në "Sahih" me tjetër zinxhir. (shih: "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", 2/405, nr.639; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi që e shënon Ibni Hibani thotë se zinxhiri i hadithit është Sahih sipas kushteve të Muslimit);

Në *hadithin kudsij* që e përcjell Ebu Hurejre r.a. thuhet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. urdhëroi që dy robër të dërgohen për në Zjarr, e kur arritën në buzë të greminës dhe i ndaluan, njëri prej tyre, u kthye dhe tha: "Pasha Allahun, nuk ka qenë mendimi ynë për Ty kështu, ne kemi menduar për Ty mirë", atëherë Zoti tha:* ***"Ktheni ata, sepse Unë jam ashtu siç më mendon Mua robi Im"*** *dhe i fali ata".*[271]

Po ashtu, edhe *hadith*-i tjetër, që përcillet nga Ebu Hurejre *r.a.* se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, të keshë mendim të mirë për Allahun, është zbukurim i adhurimit".*[272]

Kur njeriu bën një punë të mirë dhe mendon mirë se Allahu xh.sh. do t`ia pranon atë, Allahu i Gjithëmëshirshëm edhe ia pranon dhe e shpërblen për të. E nëse mendon keq, se Allahu xh.sh. nuk ia pranon punët e tija të mira, atëherë nuk duhet të pres shpërblim për punën e tij.

Gjithashtu, kur lutet, duhet të jetë i bindur se Allahu xh.sh. i përgjigjet lutjes së robit, nëse i ka plotësuar kushtet e lutjes, ngase siç edhe transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Luteni Allahun duke duke qenë të sigurtë se do t`u pranohet, dijeni se Zoti nuk i përgjigjet një lutjeje nga zemra e pavëmendshme".*[273]

Pra, njeriu në fakt, është i lidhur ngushtë për mendimet e tija, si ndaj Zotit, si ndaj krijesave tjera. Njeriu funksionon në jetë në bazë të asaj që mendon, nëse ka mendime pozitive, ai do të reflektojë pozitivitet edhe tek të tjerët, e nëse mbanë mendime negative ndaj shoqërisë, familjes, punës, gjërave që e rrethojnë, atëherë ai nuk do të mund të gjejë lumturinë e vërtetë dhe do të jetë vazhdimisht i rrethuar me errësirë në jetë. Kjo do të jetë ardhmëria e tij edhe në raport me Krijuesin Absolut.

---

[271] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 2/323-324, nr.985; Mundhiri-u në "Tergib", 4/136, nr.5132 dhe thotë se "e përcjell një prej fëmijëve të Ubade b. Samitit nga Ebu Hurejre r.a., por ai nuk ka dëgjuar nga Ebu Hurejre";

[272] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 136, nr.3620 dhe thotë se është Garib përmes kësaj rruge; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab 81, nr.4993; Ahmed-i, "Musned", 13/338, nr.7956;

[273] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 65, nr.3490 dhe thotë se hadithi është Garib;

HADITHI I NJËZETETRETË (23)

حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ، حَدَّثَنِي مَالِكٌ، عَنْ أَبِي الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " قَالَ اللَّهُ: إِذَا أَحَبَّ عَبْدِي لِقَائِي أَحْبَبْتُ لِقَاءَهُ، وَإِذَا كَرِهَ لِقَائِي كَرِهْتُ لِقَاءَهُ "

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Kur robi Im e dëshiron takimin me Mua, edhe Unë e dëshiroj takimin me të, e nëse ai e urren takimin me Mua, edhe Unë e urrej takimin me të".***[274]

Raporti i Zotit me njeriun, do të jetë në atë mënyrë si do ta manifestojë vetë njeriu, nëse ai do të dëshirojë që Zoti ta dojë, duhet edhe ky ta dojë Zotin, nëse dëshiron që Zoti të dojë takimin me të, edhe ky duhet të dëshirojë takimin me Zotin. Vallë, a nuk keni vërejtur edhe në mesin e njerëzve se si largohen prej njëri-tjetrit në moment kur nuk e dëshirojnë takimin me mes vete?!

Njeriu duhet të shpresojë në takimin me Zotin dhe të mbajë mendim pozitiv se Zoti do ta takojë me mëshirë dhe falje, sepse kush bën mirë, ai duhet të mbajë shpresë në takimin e këndshëm me Allahun xh.sh., e kush nuk shpreson këtë takim, le të përgatitet për përfundimin e hidhur. Allahu xh.sh. thotë: **"Thuaj: "Unë jam vetëm njeri, sikurse ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askë".**[275]

Po ashtu thotë: **"Kush shpreson takimin me Allahun, afati i caktuar nga Zoti do të vijë, kurse Ai është Dëgjuesi i Dijshëm".**[276]

---

[274] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab 35, nr.7504; Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab 5, nr.2683-85 duke e përcjellë edhe nga Ubade b. Samit r.a., nga Aishja r.a.h., nga Ebu Musa r.a. dhe nga Ebu Hurejre r.a., por jo si hadith kudsij; Ahmedi, "Musned", 15/240, nr.9410; Dejlemi-u, "Firdeus", vëll.3, fq.172, nr.4460; etj.

[275] Kurani, Kehf, 110;

[276] Kurani, Ankebut, 5;

Kurse, për ata që janë bërë mospërfillës ndaj këtij takimi, nuk shpreson se do të ringjallet dhe nuk mendon se një ditë do të vdes dhe i cili është i pasionuar pas kënaqësive të kësaj bote, ai do të ketë meritë për punët e tija Zjarrin. Allahu xh.sh. thotë: **"Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dynjasë dhe kanë gjetur prehje në të, dhe ata që janë indiferentë ndaj argumenteve Tona. Vendi për të tillët është Zjarri, për shkak të asaj që punuan".**[277]

Gjithashtu thotë: **"E ata që nuk besuan argumentet e Allahut dhe takimin me Të, të tillët kanë humbur shpresën nga Mëshira Ime dhe ata i pret dënim i hidhur".**[278]

Se shumica e njerëzve e mohojnë takimin me Zotin, është dëshmi edhe *ajet-i* ku Zoti thotë: **"...por shumë prej njerëzve e mohojnë takimin me Zotin".**[279]

Njeriu që ka jetuar me devotshmëri, jetën e tij është munduar ta përputh me mësimet Islame, ka kryer adhurimet vetëm për hir të Allahut xh.sh., ky person nuk ka edhe pse të mos shpresojë në takimin me Zotin, sepse ai për këtë çast jeton, kurse shikimi në Allahun xh.sh. i zhduk të gjitha kënaqësitë tjera.

Në këtë drejtim, mund të përmendim edhe një *hadith* tjetër *kudsi*, i cili sqaron raportin e Zotit ndaj besimtarit dhe pabesimtarit, ku për besimtarin dëshiron që t`i shtohet dëshira për ta takuar Zotin, kurse pabesimtarit ia shton dëshirën për këtë botë dhe ta urrejë takimin me Zotin. Transmeton Katade b. Nu`mani r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu e dërgoi Xhibrilin në pamjen më të mirë që mund të më vinte dhe më tha: "Me të vërtetë, Allahu të dërgon ty selam o Muhamed dhe të thotë:* ***"Unë i kam shpallë botës të jetë e idhët, e mërzitshme, e ngushtë dhe e vështirë për të dashurit e Mi, që të dëshirojnë takimin me Mua dhe e kam lehtësuar, zgjeruar dhe zbukuruar për armiqtë e Mi, gjersa të urrejnë takimin me Mua, pasi Unë e kam bërë (këtë botë) burg për të dashurit e Mi dhe parajsë për armiqtë e Mi".***[280]

Ne mund të themi që besimtari nuk duhet të frikohet nga vdekja, porse, frika është ndjenjë natyrore, por mospasja dëshirë për të takuar Zotin është element

[277] Kurani, Junus, 7-8;
[278] Kurani, Ankebut, 23;
[279] Kurani, Rum, 8;
[280] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.19, fq.7, nr.11; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.12, fq.243-244, nr.9343; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/374, nr.18.082 thotë: "E transmeton Taberani, por aty (në zinxhir) ka shumë të cilët nuk i njoh".

tjetër i ndjenjave njerëzore. Aishja radiaAllahu anha edhe ajo e kishte kuptuar këtë *hadith kudsi* sikur mos pasja dëshirë për të vdekur, sepse është në natyrën e njeriut që ta dëshirojë jetën. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i bëri me dijen se ky *hadith* nuk trajton urrejtjen e vdekjes, porse urrejtja e takimit me Zotin shkaku i mos përgatitjes për atë ditë.

Aishja radiaAllahu anha kur e dëgjoi këtë *hadith*, tha: "O i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, a flet për urrejtjen e vdekjes? Sepse ne të gjithë e urrejmë vdekjen?" Ai tha: *"Nuk është kështu, porse kur besimtari përgëzohet me mëshirën, kënaqësinë dhe Xhenetin e Allahut xh.sh. (në momentin e vdekjes) ai e dëshiron takimin me Allahun xh.sh. si dhe Allahu e dëshiron takimin me të, kurse pabesimtari kur përgëzohet me dënimin dhe hidhërimin e Allahut xh.sh., ai e urren takimin me Allahun dhe Allahu do ta urrejë takimin me të".*[281]

Pra, ky *hadith* e sqaron *hadith-in kudsij*, për ta kuptuar se nuk bëhet fjalë për besimtarin, porse për pabesimtarin i cili në momentin e daljes së shpirtit e urren takimin me Zotin shkaku se sheh që do ta kap dënimi, andaj edhe Zoti nuk e donë takimin me të. Kurse, ka pasur edhe prej njerëzve të zgjedhur, të cilët nuk e kanë dashur vdekjen në momentin kur u është afruar ajo. Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur Allahu xh.sh. e krijoi Ademin, e fërkoi atë pas shpine, e nga korrizi i dolën të gjithë pasardhësit, të cilët Allahu xh.sh. do t`i krijojë si pasardhës të tij deri në Ditën e Kijametit. Allahu bëri që secili prej tyre të ketë nur (shndritje) në mes syve. Pastaj, i shfaqi ato para Ademit alejhi`s-selam e ai pyeti: "O Zot, kush janë këta?". I tha:* ***"Këta janë pasardhësit e tu".*** *Atëherë ai vërejti një njeri, drita e të cilit i pëlqeu shndritja në mes syve, më pas pyeti: "O Zot, kush është ky?" Ai iu përgjigj*: ***"Ky është njeriu që do të jetë ndër brezat e fundit të pasardhësve të tu, me emrin Davud".*** *(Ademi) tha: "O Zot, sa i ke caktuar të jetojë?" Zoti iu përgjigj:* ***"gjashtëdhjetë (60) vjet".*** *Ademi tha: "O Zot, jepja nga jeta ime edhe katërdhjetë". Kur Ademit i kaloi jeta, erdhi meleku i vdekjes dhe (Ademi) pyeti: "A nuk më kanë mbetur edhe katërdhjetë vjet?!" (Zoti) i tha:* ***"A nuk ia fale ato pasardhësit tënd, Davudit?!"*** *Kështu, ai polemizoi (kundërshtoi) dhe sot e kësaj dite polemizojnë (kundërshtojnë) pasardhësit e tij, harroi Ademi dhe harrojnë edhe pasardhësit e tij, gaboi Ademi dhe gabojnë edhe pasardhësit e tij".*[282]

---

[281] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab 5, nr.2684; etj.

[282] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiru`l-Kuran, bab min sureti`l-A`raf, nr.3087 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih;

Kështu përcillet edhe ngjarja e Musës alejhi`s-selam i cili nuk e dëshiroi vdekjen, porse në moment kur erdhi meleku i vdekjes, ai rezistoi që të shpëtojë prej tij. Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Meleku i vdekjes u dërgua te Musa alejhi`s-selam. Kur i erdhi atij, ai e qëlloi melekun e vdekjes në sy. Meleku u kthye tek Allahu xh.sh. dhe i tha: "Më ke dërguar tek një rob që nuk e do vdekjen", e Allahu ia ktheu në vend syrin melekut dhe i tha:* ***"Kthehu tek robi im dhe thuaj atëherë le të vendos dorën e tij mbi shpinën e një kau dhe aq qime sa do të prek dora e tij, aq vjet do të ketë".*** *(Musa alejhi`s-selam) tha: "O Zot, po më pas çfarë do të ndodhë?".* ***"Më pas do të vdesësh",*** *i tha Ai. Musa alejhi`s-selam tha: "Atëherë le të jetë tani" dhe e luti Allahun që ta afronte kah vendi i shenjtë, aq sa të arrijë guri ku hidhet".* Pastaj, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: "*Sikur të isha afër, do t`ua tregoja varrin e tij anash rrugës te Kethibi i kuq (Kethibi* është kodër prej zalli (dunë)*".*[283]

Nga *hadith*-i për vdekjen e Ademit a.s. dhe Musait a.s. vërejmë se Zoti ua ka dhënë pejgamberëve mundësinë e zgjedhjes në mes jetës së kësaj bote dhe botës tjetër.

Në kontekst të këtyre haditheve, mund të përmendim edhe *hadithin kudsij* ku Zoti thotë: ***"...Asnjë punë nga punët e Mia nuk nguroj ta bëj, sa nguroj ta marr shpirtin e një besimtari, që nuk e donë vdekjen, ngaqë nuk dua ta lëndoj".***[284]

Pra, Zoti dëshiron të takohet me robin e Tij të mirë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër, në këtë botë përmes namazit dhe veprave që e afrojnë tek Ai, kurse në botën tjetër përmes shikimit në Të, kurse Zoti nuk dëshiron të takohet me jobesimtarin i cili është larg rrugës së Zotit dhe jeton me vepra që e hidhërojnë Atë.

[283] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 68, nr.1339; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Fadailu, bab min fadaili Musa alejhi`s-selam, nr.2372; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab neun ahar, nr.2089; Ahmed-i, "Musned", 13/84, nr.7646 dhe 13/506, nr.8172;
[284] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 38, nr.6502;

MËSHIRA

DHE

FALJA E ALLAHUT

HADITHI I NJËZETEKATËRTË (24)

حَدَّثَنَا أَبُو اليَمَانِ، أَخْبَرَنَا شُعَيْبٌ، حَدَّثَنَا أَبُو الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، قَالَ: " إِنَّ اللَّهَ لَمَّا قَضَى الخَلْقَ، كَتَبَ عِنْدَهُ فَوْقَ عَرْشِهِ: إِنَّ رَحْمَتِي سَبَقَتْ غَضَبِي "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *"Allahu xh.sh. pasi e përfundoi krijimin, e shkroi te Ai mbi Arshin e Tij:* ***"Mëshira Ime ka tejkaluar hidhërimin Tim".***[285]

Në këtë *hadith* njoftohemi me dy cilësi të Zotit tonë të madhëruar, i Cili është i Mëshirshëm ndaj robërve të Tij, kurse hidhërohet me ata të cilët nuk përfillin urdhrat e Tij. Mëshira e Tij ka kapluar çdo gjë, siç potencohet në *ajet*: **"Mëshira Ime ka përfshirë çdo gjë".**[286] Mu në këtë *ajet*, Zoti gjithashtu thotë: **"Dënimi Im do ta përfshijë atë që dua Unë".**

Kurse për Mëshirën e Zotit, flasin shumë *ajet*-e dhe *hadith*-e, në të cilat na bëhet e qartë se Zoti është pronar i mëshirës së pakufishme. Thotë Zoti: **"Zoti yt është falës dhe pronar i Mëshirës..".**[287]

Prej *hadith*-eve, kemi transmetimin e Selman Farisiut radijeAllahu anhu se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: *"Allahu xh.sh. ka 100 mëshira, përmes një mëshire mëshirohet çdo gjë në tokë në mes tyre, kurse 99 tjerat do të manifestohen në Ditën e Kiametit".*[288]

Prej mëshirës hyjnore është që na furnizon me të gjitha mirësitë, na ka udhëzuar në rrugë të drejtë dhe ka shpallur Libra, që të na shpie në drejtimin

[285] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab ve kane arshuhu alel ma, nr.7422; Muslim-i, "Sahih", kitab Teube, bab 4, nr.2751; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 99, nr.3554 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 35, nr.4295; etj.
[286] Kurani, A`raf, 156;
[287] Kurani, Kehf, 58;
[288] Muslim-i, "Sahih", kitab Fadailu`s-Sahabeti, bab min fadli Talha ve Zubejr, nr.2753; Ahmed-i, "Musned", 39/124, nr.23.720;

e duhur. Kulmi i gjithë kësaj është dërgimi i Muhamedit alejhi selam si mëshirë për të gjitha botërat.

Zoti është i Gjithmëshirshëm ndaj të gjitha krijesave, sepse edhe pabesimtarëve u jep mundësi furnizimi dhe begatie, kurse mëshira do të jetë e veçantë në ditën e llogarisë ndaj bëmirësve. Zoti thotë në Kuran: **"Me të vërtetë mëshira e Allahut është afër bëmirësve".**[289]

Kurse ata që janë të humbur dhe të mallkuar, ne kërkojmë mbrojtje që Zoti të na mbroj prej asaj rruge. Kështu ne lutemi gjatë çdo namazi kur themi: **"E jo në rrugën e atyre me të cilët je i hidhëruar e as në rrugën e atyre që kanë devijuar".**[290]

Por besimtarit nuk i lejohet të humb asesi shpresat në mëshirën e Zotit, sepse kjo nuk është cilësi e tyre. Zoti thotë në Kuran: **"O robërit e Mi që keni ngarkuar veten me mëkate, mos i humbni shpresat në mëshirën e Allahut, sepse me të vërtetë Allahu i fal të gjitha mëkatet…".**[291]

E gjithë kjo është një tregues shpresdhënës për çdo besimtar, sepse Zoti është më i mëshirshëm ndaj njeriut, sesa që është nëna ndaj foshnjes së saj. Transmeton Umer b. Hatabi radijeAllahu anhu se një grua kishte humbur foshnjën në një turmë dhe kur e gjeti e përqafoi atë me mall dhe i dha për të pirë. Pejgamberi alejhi selam na tha neve: *"A do ta kishte hedhur kjo nënë foshnjen e saj në zjarr?"* Të gjithë u përgjigjëm që jo! Atëherë Pejgamberi alejhi selam tha: *"Allahu është më i mëshirshëm për robërit e Tij sesa kjo me foshnjën e saj".*[292]

[289] Kurani, A`raf, 56;
[290] Kurani, Fatiha, 7;
[291] Kurani, Zumer, 53;
[292] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Edebu, bab 18, nr.5999; Muslim-i, "Sahih", kitab Teubeh, bab 4, nr.2754;

HADITHI I NJËZETEPESTË (25)

حَدَّثَنَا عُثْمَانُ بْنُ أَبِي شَيْبَةَ، حَدَّثَنَا جَرِيرٌ، عَنْ مَنْصُورٍ، عَنْ رِبْعِيٍّ، عَنْ حُذَيْفَةَ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " كَانَ رَجُلٌ مِمَّنْ كَانَ قَبْلَكُمْ يُسِيءُ الظَّنَّ بِعَمَلِهِ، فَقَالَ لِأَهْلِهِ: إِذَا أَنَا مُتُّ فَخُذُونِي فَذَرُّونِي فِي البَحْرِ فِي يَوْمٍ صَائِفٍ، فَفَعَلُوا بِهِ، فَجَمَعَهُ اللَّهُ ثُمَّ قَالَ: مَا حَمَلَكَ عَلَى الَّذِي صَنَعْتَ؟ قَالَ: مَا حَمَلَنِي إِلَّا مَخَافَتُكَ، فَغَفَرَ لَهُ "

Transmeton Hudhejfe (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ka qenë një njeri që ka jetuar para jush, i cili ka pasur mendim të keq për veprat e veta dhe u tha antarëve të familjes së vet: "Kur të vdes unë, më merrni dhe më shpërndani në det edhe atë në një ditë përvëluese (me erë)" dhe kështu vepruan, por Allahu xh.sh. e tuboi dhe i tha:* ***"Përse veprove në këtë mënyrë?!"*** *Ai thotë: "Nuk më ka detyruar të veproj kështu diç tjetër, vetëm se frika prej Teje" dhe (Zoti) e fali atë".*[293]

Ky *hadith*, përcillet edhe në një formë tjetër, përmes Ebu Seid el-Hudrijut radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu i dha pasuri një burri që jetonte para jush dhe kur i erdhi agonia e vdekjes, ai u tha fëmijëve të vet: "Çfarë babai kam qenë për ju?" Ata i thanë: "Ke qenë babai më i mirë". Ai tha: "Por unë nuk kam punuar asnjëherë ndonjë të mirë, prandaj kur të vdes, më digjni dhe më thërrmoni, më pas më shpërndani në një ditë me erë të fortë". Ata vepruan siç i urdhëroi i ati, por Allahu e ringjalli dhe e pyeti*: ***"Çfarë të shtyri të veprosh kështu?"*** *Ai i tha: "Frika prej Teje", kurse Allahu xh.sh. e përfshiu me Mëshirën e Tij".*[294]

---

[293] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 25, nr.6480; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 117, nr.2082; Ahmed-i, "Musned", 28/296, nr.17.064 dhe 38/289, nr.23.253;
[294] Buhari-u, "Sahih", kitab Ehadithu`l-Enbija, bab 54, nr.3478; Muslim-i, "Sahih", kitab Teubeh, bab 4, nr.2757; Ahmed-i, "Musned", 17/160, nr.11.096, etj; Tahavi-u, "Sherh Mushkilu`l-Athar", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1994, 2/32, nr.559;

Këtu bëhet fjalë për një person i cili jetonte në kohët e më hershme, ka qenë i begatuar me shumë mirësi dhe begati, ka pasur pasuri dhe fëmijë, porse nuk ka vepruar punë të mira dhe ka qenë i zhytur në jetë me mëkate, ndërsa kur i erdhi fundi i jetës së tij, ai filloi të mendojë se si do të del para Zotit, kur nuk ka asnjë punë të mirë?! Ai filloi të merr mendimin e fëmijëve të tij, se çfarë prindi ka qenë dhe çfarë mendimi kanë ata për të?! Kurse, ata iu përgjigjën se ka qenë prind i mirë dhe i drejtë. Por, përsëri ai nuk u rehatua me këto fjalë, por kërkoi nga fëmijët e tij që kur të vdes, ta djegin trupin e tij dhe ta shpërndajnë hirin e thërrmuar në deti në ndonjë ditë kur do të ketë erë të fortë, me qëllim që mos të del para Zotit. Porse, fuqia e Allahut xh.sh. është absolute, Ai e tuboi të gjithë hirin që ishte shpërndarë nëpër deti dhe e pyeti për veprimin e tij, edhe pse Ai e di shumë më mirë se përse veproi kështu. Njeriu do të jep arsyetimin e vet, se këtë e ka vepruar nga frika ndaj Allahut, sepse ai nuk ka pasur asnjë vepër të mirë me të cilën do të del para Tij, kurse për shkak të këtij arsyetimi, Zoti e fali atë dhe e mëshiroi.

Këtu, nuk bëhet fjalë se personi ka mohuar Caktimin e Zotit ose ringjalljen, por që ai ka pasur frikë të del para Zotit me mëkate të tilla dhe pa asnjë të mirë, kështu ai ka shpresuar që mos ringjallet, sepse e ka ditur se me vepra të tilla, ai do të meritojë ndëshkimin. Sikur të kishte qenë prej atyre të cilët e mohojnë ringjalljen, ai nuk do të ishte mysliman, porse këtu aludon në frikën nga ringjallja dhe dalja para Zotit. Kjo arrihet të kuptohet me faktin se ai ka qenë prej atyre që kanë frikë prej Allahut xh.sh, kurse pabesimtari nuk ka frikë Zotin dhe nuk shpreson të ringjallet dhe të jep llogari.

Po ashtu, mund që këtë fjalë ta ketë thënë si lapsus, siç veproi njeriu i cili nga gëzimi i madh që gjeti devenë, tha: "Falënderimi të takon ty o Zot, Ti je robi im dhe unë jam Zoti yt".[295] Këtë e tha nga hutia dhe gëzimi, porse kishte për qëllim të thotë "Ti je Zoti im dhe unë jam robi yt". Po ashtu, ka mundësi që afër përfundimit të jetës dhe pleqërisë që e ka kapluar, të jetë matufosur dhe të mos ketë pasur kontroll mbi fjalët e tija.

Vet fakti që tregohet se njeriu në fjalë ka qenë prej të devijuarve që nuk ka vepruar asnjë të mirë, na jep të kuptojmë se ky person nuk e ka njohur në mënyrë të duhur Allahun xh.sh. andaj është logjike që prej këtyre individëve, të dalin fjalë dhe veprime që ndoshta nuk përputhen me kriteret fetare.

[295] Shih: Muslim-i, "Sahih", kitab et-Teubetu, bab fi`l-haddi ale`t-teubeti ve`l-ferehi biha, nr.2747;

Mendimi i këtij personi ka qenë mjaft naiv dhe i dëmshëm, porse ai frikësohej prej Zotit. Të keshë frikë Zotin konsiderohet prej ibadeteve, kurse injoranca ndaj Fuqisë absolute të Zotit, konsiderohet mëkat i madh, e këtë person, Zoti e fali për shkak injorancës së tij dhe e mëshiroi për hir të frikës që kishte nga Ai. Pra, shohim se Zoti i fal personat të cilët veprojnë ndonjë vepër nga padituria dhe naiviteti.

Nga ky *hadith* mësojmë se mëshira e Allahut xh.sh. është e pakufishme, saqë e mbulon me mëshirë edhe njeriun i cili nuk ka vepruar punë të mira nga neglizhenca. Kur frika dhe ndrojtja prej Zotit depërtojnë në një zemër, Allahu xh.sh. nuk e dënon atë zemër me Zjarr. Andaj, shpresohet se kjo frikë dhe drojë prej Zotit, ta shpëtojnë njeriun në Ditën e Gjykimit. Mëkati nuk vërehet, kur vëndohet përballë mëshirës së Zotit, sado që të jetë mëkati i madh, nuk mund ta tejkalojë shumësinë e mëshirës hyjnore.

Gjithsesi, ne nga ky *hadith* përjetojmë Fuqinë absolute të Allahut xh.sh. i Cili ka mundësi ta tubojë trupin e njeriut pa marrë parasysh se ku gjendet dhe ku është shpërndarë. Edhe nëse njeriu gjendet në thellësi të detit dhe në barqet e peshqve ose kafshëve të egra, Zoti do ta tubojë trupin e tij në Ditën e Gjykimit dhe do ta sjell aty.

Nga ky *hadith*, po ashtu kuptojmë se njerëzit nuk duhet të nxitojnë që t`i quajnë pabesimtarë injorantët të cilët janë të painformuar qartë mbi fenë dhe flasin ndonjë fjalë të keqe, këtyre duhet shpjeguar parimet e fesë dhe të mos nxitojmë që t`i gjykojmë me pabesim. Edhe nëse një mëkatar ka vdekur në gjendje mëkati, ne çështjen e tij e lëmë në gjykim të Zotit, Ai do t`i llogarit krijesat dhe do të vendosë për faljen ose dënimin e tij.

Nga ky *hadith*, shohim se njeriu mund të jetë i mirë për familjen e tij, edhe nëse vet ka kryer jetë të shfrenuar dhe pa asnjë të mirë. Po ashtu, kuptojmë se prindi është element shumë i rëndësishëm në raportin familjar, kështu që edhe nëse ai kryen ndonjë të keqe, fëmija përsëri e konsideron të mirë dhe e shikon me syrin e mëshirës.

Edhe pse testamenti është i realizueshëm dhe duhet njeriu të lë testament, ai nuk duhet të realizohet nëse aty urdhërohet për mëkat dhe mos nënshtrim ndaj Zotit. Në këtë rast, nëse dikush lë testament që të digjet trupi i tij, ky testament nuk duhet të realizohet nga familjarët, nga shkaku se në fenë tonë, trupi duhet të varroset e jo të digjet.

HADITHI I NJËZETEGJASHTË (26)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الصَّبَّاحِ بْنِ سُفْيَانَ، أَخْبَرَنَا عَلِيُّ بْنُ ثَابِتٍ، عَنْ عِكْرِمَةَ بْنِ عَمَّارٍ، قَالَ: حَدَّثَنِي ضَمْضَمُ بْنُ جَوْسٍ، قَالَ: قَالَ أَبُو هُرَيْرَةَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " كَانَ رَجُلَانِ فِي بَنِي إِسْرَائِيلَ مُتَوَاخِيَيْنِ، فَكَانَ أَحَدُهُمَا يُذْنِبُ، وَالْآخَرُ مُجْتَهِدٌ فِي الْعِبَادَةِ، فَكَانَ لَا يَزَالُ الْمُجْتَهِدُ يَرَى الْآخَرَ عَلَى الذَّنْبِ فَيَقُولُ: أَقْصِرْ، فَوَجَدَهُ يَوْمًا عَلَى ذَنْبٍ فَقَالَ لَهُ: أَقْصِرْ، فَقَالَ: خَلِّنِي وَرَبِّي أَبُعِثْتَ عَلَيَّ رَقِيبًا؟ فَقَالَ: وَاللَّهِ لَا يَغْفِرُ اللَّهُ لَكَ، أَوْ لَا يُدْخِلُكَ اللَّهُ الْجَنَّةَ، فَقَبَضَ أَرْوَاحَهُمَا، فَاجْتَمَعَا عِنْدَ رَبِّ الْعَالَمِينَ فَقَالَ لِهَذَا الْمُجْتَهِدِ: أَكُنْتَ بِي عَالِمًا، أَوْ كُنْتَ عَلَى مَا فِي يَدِي قَادِرًا؟ وَقَالَ لِلْمُذْنِبِ: اذْهَبْ فَادْخُلِ الْجَنَّةَ بِرَحْمَتِي، وَقَالَ لِلْآخَرِ: اذْهَبُوا بِهِ إِلَى النَّارِ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Te beni Israilët, jetonin dy burra të vëllazëruar. Njëri prej tyre ishte mëkatar, ndërsa tjetri ishte i zellshëm në adhurim. Ai që ishte i zellshëm në adhurim, kur e shihte tjetrin në mëkate, i thoshte: "O njeri, ndalo (nga mëkatet)". Dhe një ditë e gjeti në mëkat dhe i tha: "Ndalo më!". Ndërsa ai ia ktheu: "Më lër mua me Zotin tim, a mos të ka dërguar Zoti mbikëqyrës mbi mua?". Atëherë ai i tha: "Betohem në Allahun, se Allahu nuk do të fal ty"* ose *"as që do të fus në Xhenet". (Allahu) Ua mori shpirtrat dhe ata dy u takuan tek Zoti i botërave, i Cili i tha atij të zellshmit në adhurim:* ***"Vallë, a ishe i dijshëm për Mua? Apo kishe pushtet mbi gjërat që kam Unë në dorë?"*** *Zoti i tha mëkatarit:* ***"Shko në Xhenet me mëshirën Time",*** *kurse për tjetrin tha:* ***"Merreni dhe futeni në Xhehenem".***[296]

[296] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab fi`n-nehji ani`l-begji, nr.4901; Ahmed-i, "Musned", 14/46, nr.8292 dhe 14/361, nr.8749; etj. Imam Muslim-i e shënon shumë shkurtë në "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 39, nr.2621 nga Xhundubi r.a. si dhe Dejlemiu, në "Firdeus", vëll.3, fq.184, nr.4501 e përcjell nga Ebu Katade. Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të hadithit në "Sunen"-in e Ebu Davud-it (7/262) thotë se zinxhiri i hadithit është Hasen, por teksti i tij është i panjohur (Garib), me të cilën veçohet

Ky *hadith* përshkruan gjendjen e dy personave të cilët kanë jetuar në kohën e beni Israilëve. Ata jetonin në mënyra të ndryshme, njëri ishte i dhënë pas adhurimit, kryente ibadete të ndryshme dhe përpiqej për punë të mira. Kurse tjetri, ishte i dhënë pas mëkateve dhe jetonte jetë të shfrenuar. Personi i cili kryente adhurim, nuk ishte i durueshëm në thirrjen drejt rrugës së Allahut xh.sh. andaj edhe shpejtoi kur tha se Zoti nuk do të fal, nga shkaku se ndërhyri në punët e Zotit dhe e kufizoi mëshirën e Allahut, aty ku ky njeri nuk ka kompetenca dhe nuk ka të drejtë të gjykojë. Personi tjetër mëkatar, edhe pse i zhytur në mëkate, përsëri e dinte se Zoti është Ai që do ta gjykojë për veprat e tija dhe nuk nguronte që t`ia përmend çdoherë kur i tërhiqej vëmendja.

Por vallë, përse personi që këshillonte u dënua me Zjarr? Nga shkaku se ai ua humbte shpresat njerëzve, ai fliste për Allahun xh.sh. pa dituri, vepër që është e barazuar me *shirk*-un. Njeriut nuk i lejohet të përzihet në kompetencat e Zotit, porse duhet të mendojë mirë dhe të ketë mendim të mirë për njerëzit, të shpresojë për përmirësim dhe të lutet që Zoti t`i udhëzojë. Pra, nuk i lejohet askujt, sado shkallë të larta që të ketë arritur në adhurime, që të përzihet në punët e Zotit dhe ta konsiderojë vetveten si mbikqyrës i njerëzve, sepse Zoti është mbikqyrësi dhe gjykuesi i njerëzve. Pra, Zoti urren arrogancën dhe nënçmimin e njerëzve.

Ah sa shumë njerëz që kanë punuar vepra të mira, i kanë shkatërruar ato në fund të jetës, e sa mëkatarë janë falur me Mëshirën e Zotit! Transmeton Abdullah b. Mes`udi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...Njeriu do të punojë punë të xhenetlive, derisa të mos ngelet në mes tij dhe Xhenetit sa një krah, e pastaj vjen caktimi që është shkruar për të dhe ai fillon të punojë punë të banorëve të Zjarrit dhe të përfundojë aty, ndërsa dikush do të punojë punë të cilat çojnë në Xhehenem, porse kur të ngelet në mes tij dhe Zjarrit sa një krah, vjen caktimi që është shkruar për të dhe ai fillon të bëjë vepra të banorëve të Xhenetit dhe do të përfundojë në të".*[297]

---

vetëm Ikrime b. Amari i cili edhe pse është sipas kritereve të Muslimit, përsëri bie nga shkalla Sahih kur përcjell transmetime të çuditshme, atëherë nuk e ndjek askush;

[297] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Halki, bab 6, nr.3208; Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab teavvudh minel axhzi vel kesli, nr.2643; etj.

Kërkohet nga adhuruesi i cili i bindet Zotit, që të mos nënçmojë askënd prej të shkujdesurve dhe mëkatarëve, të mos i shoh ata me syrin e poshtërsimit, kurse veten ta sheh me syrin e mburrjes dhe madhështisë.

Gjithashtu, nga ky *hadith* kuptojmë edhe metodën pedagogjike të thirrësit, i cili duhet të thirr në rrugën e Allahut me butësi dhe mirësi, e jo të flet me mburrje dhe ofendim. Thirrësi nuk duhet të largohet nga mëkatari vetëm për shkakun se ai është mëkatar, sepse së fundi, të gjithë njerëzit kanë mëkate dhe gabojnë, porse thirrësi duhet të mundohet që ta afrojë atë dhe ta zbusë, që të fillojë të kthehet në rrugë të Zotit.

Nga këtu, kuptojmë se njeriut i mjafton edhe një fjalë e gabuar dhe e nxituar, që ta çojë në zjarrin e Xhehenemit. Me një fjalë, e shkatërroi *dunja*-në dhe *ahiret*-in e tij. Kështu që, çdokush duhet të ketë kujdes në fjalët e tij dhe të mos ndërhyjë në kompetencat e huaja.

Njeriu ngel në Mëshirën e Allahut xh.sh. nëse për mëkatet e tij nuk është penduar, njëjtë siç vdiq ky mëkatarë në gjendje mëkati pa u penduar, por në fund Allahu xh.sh. me Mëshirën e Tij e fali atë, sepse Atij askush nuk mund t`i përzihet në vendimet e Tija.

HADITHI I NJËZETESHTATË (27)

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ إِسْحَاقَ، حَدَّثَنَا عَمْرُو بْنُ عَاصِمٍ، حَدَّثَنَا هَمَّامٌ، حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ، سَمِعْتُ عَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنَ أَبِي عَمْرَةَ، قَالَ: سَمِعْتُ أَبَا هُرَيْرَةَ، قَالَ: سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " إِنَّ عَبْدًا أَصَابَ ذَنْبًا – وَرُبَّمَا قَالَ أَذْنَبَ ذَنْبًا – فَقَالَ: رَبِّ أَذْنَبْتُ – وَرُبَّمَا قَالَ: أَصَبْتُ – فَاغْفِرْ لِي، فَقَالَ رَبُّهُ: أَعَلِمَ عَبْدِي أَنَّ لَهُ رَبًّا يَغْفِرُ الذَّنْبَ وَيَأْخُذُ بِهِ؟ غَفَرْتُ لِعَبْدِي، ثُمَّ مَكَثَ مَا شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ أَصَابَ ذَنْبًا، أَوْ أَذْنَبَ ذَنْبًا، فَقَالَ: رَبِّ أَذْنَبْتُ – أَوْ أَصَبْتُ – آخَرَ، فَاغْفِرْهُ؟ فَقَالَ: أَعَلِمَ عَبْدِي أَنَّ لَهُ رَبًّا يَغْفِرُ الذَّنْبَ وَيَأْخُذُ بِهِ؟ غَفَرْتُ لِعَبْدِي، ثُمَّ مَكَثَ مَا شَاءَ اللَّهُ، ثُمَّ أَذْنَبَ ذَنْبًا، وَرُبَّمَا قَالَ: أَصَابَ ذَنْبًا، قَالَ: قَالَ: رَبِّ أَصَبْتُ – أَوْ قَالَ أَذْنَبْتُ – آخَرَ، فَاغْفِرْهُ لِي، فَقَالَ: أَعَلِمَ عَبْدِي أَنَّ لَهُ رَبًّا يَغْفِرُ الذَّنْبَ وَيَأْخُذُ بِهِ؟ غَفَرْتُ لِعَبْدِي ثَلاَثًا، فَلْيَعْمَلْ مَا شَاءَ"

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Një njeri bëri një mëkat dhe tha: "O Zot, unë bëra një mëkat, prandaj më fal". Zoti i thotë*: ***"A e kuptoi robi Im që ka një Zot që fal mëkatet dhe të dënon për ta? Ia kam falur robit Tim".*** *Më pas u kthye dhe bëri një mëkat dhe përsëri tha: "O Zot, unë bëra një mëkat tjetër, prandaj më fal". Zoti i thotë*: ***"A e kuptoi robi Im që ka një Zot që fal mëkatet dhe të dënon për ta? Ia kam falur robit Tim".*** *Më pas u kthye dhe bëri një mëkat dhe përsëri tha: "O Zot, unë bëra një mëkat, prandaj më fal". Zoti i thotë*: ***"A e kuptoi robi Im që ka një Zot që fal mëkatet dhe të dënon për ta? Ia kam falur robit Tim tre herë, andaj le të veprojë robi Im çka të dojë".***[298]

[298] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab 35, nr.7507; Muslim-i, "Sahih", kitab Teube, bab 5, nr.2758; Ahmed-i, "Musned", 13/329, nr.7948;

Mëshira e pakufishme e Zotit përfshin gjithë besimtarët mysliman, të cilët u kthehen mëkateve, porse përsëri janë këmbëngulës në kërkim të faljes dhe pendimit. Kështu që, për shkak të kërkimit të faljes dhe pranimit të gabimit, Zoti ia fal mëkatin e atij veprimi. Pra, pendimi i fshin mëkatet sikur ato të mos kishin qenë më parë, prandaj duhet çdokush të shpejtojë në kërkimin e faljes nga ana e Zotit, sepse Ai fal shumë. Shkaku i mëshirës së pakufishme që posedon Zoti, ia fal gabimin që ka bërë robi, edhe pse ka qenë e përsëritur disa herë me radhë.

Kurtubiu ka thënë: "Prej këtij *hadith*-i duhet të kuptojmë se përsëritja e mëkatit është shumë më e rëndë sesa kryerja e saj fillimisht, ngase përsëritja është zhvlerësim i *teubes*, mirëpo nuk duhet harruar se përsëritja e *teube*-s është më e vlefshme sesa bërja e saj fillimisht, pasi me përsëritjen e saj del në pah përulja dhe këmbëngulja në kërkimin e faljes prej të Gjithëmëshirshmit. Kjo është njëkohësisht edhe pranim se nuk ka kush i fal mëkatet përveç Tij".[299]

Imam Nevevi-u thotë: "Sikur mëkati të përsëritej qindra ose mijëra herë, bile edhe më shumë, por pas çdo mëkati të pasonte pendimi, do t`i pranohej. Edhe sikur pas gjithë atyre mëkateve njeriu të pendohej vetëm një herë në mënyrë të përgjithshme, prapë do t`i pranohej pendimi. Ndërsa kuptimi i fjalëve të Tij: ***"Bëj çka të duash"*** është se Unë të fal derisa ti mëkaton dhe kërkon falje për mëkatet e bëra".[300]

E kanë pyetur Hasan el-Basriun: "Si mundet dikush prej nesh të turpërohet prej Zotit të vet, të lutet për faljen e Tij, e pastaj sërish i kryen dhe sërish lutet që T`ia falë?" Hasani është përgjigjur: "*Shejtan*-i do të donte t`u mposhtë me këtë. Prandaj, mos t`u vijë vështirë kërkimi i faljes". Kurse një herë tjetër ka thënë: "Këtë nuk e shoh si diç tjetër, përpos se nga morali i besimtarit".[301] Pra, besimtari i vërtetë, pendohet çdoherë pasi të kryejë mëkat.

Transmeton Ukbe b. Amiri r.a. se një njeri erdhi dhe e pyeti Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "O i Dërguari i Allahut, çka nëse dikush prej nesh kryen mëkat?!" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"I shkruhet atij mëkati".* Tha: "Por pastaj kërkon falje për të dhe pendohet?!"

[299] Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari bi sherh Sahihu`l-Buhari", vëll.17, fq.514-515;
[300] Nevevi-u, "Sahih Muslim bi sherh Nevevi", vëll.5, fq.602-603;
[301] Ibni Rexheb el-Hanbeli, "Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem", Daru`s-Selam, Kajro, botimi i dytë, 2004, vëll.2, fq.485;

Tha: *"I falet dhe i pranohet pendimi".* Tha: "Po nëse e përsërit dhe bën mëkat?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"I shkruhet atij dhe Zoti nuk lodhet nga kjo derisa të lodheni ju".*[302]

Transmeton Aishja r.a.h. se Habib b. Harith r.a. erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, unë jam njeri që e kam bërë shprehi mëkatin". I tha Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Pendohu te Allahu o Habib".* Ai tha: "O i Dërguari i Allahut, unë pendohem, por pastaj përsëri e përsëris?!" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Çdo herë që të bësh mëkat, pendohu".* Ai tha: "O i Dërguari i Allahut, po nëse shtohen mëkatet e mia?!" Ai iu përgjigj: *"Falja e Zotit është më e madhe se mëkatet e tua o Habib b. Harith".*[303]

Transmeton Aliu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më i miri prej jush është ai i cili pendohet pas vazhdimësisë në mëkat".*[304] Kurse Taberani e shënon përmes Enesit r.a. se një njeri erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, unë kam bërë mëkat". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha atij: *"Kur të bësh mëkat, kërko falje prej Zotit xh.sh.".* Njeriu tha: "Unë i kërkoj falje Zotit, por përsëri e kryejë atë mëkat?!" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Kur të bësh mëkat, kërko falje prej Zotit xh.sh.".* Kurse në herën e katërt, i tha: *"Kërko falje prej Zotit, derisa shejtani të jetë i dëshpëruari".*[305]

Në këtë drejtim është edhe një *hadith kudsij* që përcillet nga Aliu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu "habitet" me robin e Tij kur ai thotë: "O Zoti im mi fal mëkatet e mia", e Zoti thotë:* ***"Robi Im e din që nuk ia fal mëkatet tjetërkush përpos Meje".***[306]

Në këtë kontekst, Omer b. Abulazizi ka thënë: "O ju njerëz, kush e kryen një mëkat, le të pendohet dhe të kërkojë falje nga Allahu. Nëse bën sërish

---

[302] Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.4, fq.285, nr.7658 dhe thotë se hadithi është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar" e me këtë pajtohet edhe Dhehebiu.
[303] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.5, fq.122-123, nr.4854;
[304] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.9, fq.327, nr.6719;
[305] Taberani, "Ed-Dua", Daru`l-kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1992, vëll.1, fq.504, nr.1782;
[306] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab me jekulu`r-rexhulu idha rekibe, nr.2602; Ahmed-i, "Musned", 2/148, nr.753; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", 6/415, nr.2698; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi të Ibni Hibanit, thotë se transmetuesit janë të besueshëm, të cilët gjenden edhe në dy sahihet..".

mëkat, le të kërkojë falje dhe të pendohet; nëse sërish bën mëkat, le të pendohet dhe të kërkojë falje nga Allahu. Këta janë vetëm mëkate që u janë varur në qafët e njerëzve, ndërsa shkatërrimi përkufizohet në këmbëngulësi në to".[307]

Ibni Mes`udi r.a. përcjell se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"I penduari nga mëkati, është sikur të mos e kishte kryer atë mëkat".*[308]

[307] Ibni Rexheb el-Hanbeli, "Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem", vëll.2, fq.486;
[308] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab dhikru`t-teubeti, nr.4250;

HADITHI I NJËZETETETË (28)

حَدَّثَنَا أَبُو سَلَمَةَ، أَخْبَرَنَا لَيْثٌ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ الْهَادِ، عَنْ عَمْرٍو، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " إِنَّ إِبْلِيسَ قَالَ لِرَبِّهِ: بِعِزَّتِكَ وَجَلَالِكَ لَا أَبْرَحُ أُغْوِي بَنِي آدَمَ مَا دَامَتِ الْأَرْوَاحُ فِيهِمْ، فَقَالَ لَهُ اللهُ: فَبِعِزَّتِي وَجَلَالِي لَا أَبْرَحُ أَغْفِرُ لَهُمْ مَا اسْتَغْفَرُونِي "

Transmeton Ebu Seid el-Hudriju (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, Iblisi ka thënë: "Betohem në Fuqinë dhe Madhështinë Tënde, se do të vazhdojë t`i josh njerëzit, derisa t`i kenë shpirtërat në trup". Allahu i tha*: ***"Betohem në Fuqinë dhe Madhështinë Time, se Unë do t`ua falë gjynahet përderisa më kërkojnë falje".***[309]

Hadith-i në fjalë vërtetohet edhe me *ajete* kuranore, ku dëshmohet se Iblisi i mallkuar, dëshiron devijim dhe shkatërrimin e llojit njerëzorë. Zoti e përshkruan në Kuran kështu: **"(Iblisi) Tha: "Për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre (do t'u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë. Mandej, do t'ju sillem atyre para dhe prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjesh që të falënderohen (të besojnë)!" (All-llahu) Tha: "Dil nga ai (Xheneti) i urrejtur dhe i dëbuar. Kush prej tyre vjen pas teje, Unë kam për ta mbushur Xhehenemin me të gjithë ju".**[310]

Si dhe në një vend tjetër, e përshkruan të njëjtën bisedë të zhvilluar në mes Zotit dhe Iblisit të mallkuar, ku thuhet: **"(Iblisi) Tha: "Zoti im, për shkak se më dëbove (më largove), unë do t'ua zbukurojë (të këqiat) atyre sa të jenë në tokë (në botë) dhe të gjithë ata do t'i largojë nga rruga e drejtë! Përveç**

---

[309] Ahmed-i, "Musned", 17/344, nr.11.244; Hakim-i, "El-Mustedrek", 4/290, nr.7672 dhe thotë se zinxhiri i hadithit është Sahih por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar; Ebu Nuajm-i, "Hilje", 8/332; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/250, nr.17.573 thotë: "...njëri zinxhir i Ahmedit i ka transmetuesit që gjeden edhe në Sahihe, kështu është edhe njëri zinxhir që e shënon Ebu Ja`la". shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, thotë se hadithi është Hasen, ky zinxhir i ka transmetuesit të besueshëm, janë transmetues që gjenden te Buhariu dhe Muslimi, përpos Amrit...".

[310] Kurani, A`raf, 16-18;

robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sinqertë". (Madhëria e Tij) Tha: "Kjo është rruga Ime e drejtë (e qartë). Se ndaj robëve të Mi (të sinqertë) nuk ke kurrëfarë force (as fizike as mendore), përveç atyre të humburve që vijnë pas teje. E s'ka dyshim se Xhehenemi është vendpremtimi i të gjithë atyre".[311]

Iblisi mendoi se nëse i vëndon njerëzit në pozitën e mëkatit, ata do të shkatërrohen, porse Zoti i bëri me dije, se nga robërit e sinqertë, nuk pritet të devijojnë dhe të shkojnë pas Iblisit, pasi ata janë të sinqertë në besim dhe të përmbajtur, edhe nëse kryejnë mëkate, i kthehen Zotit me pendim dhe kërkim falje, kurse Zoti i siguron se do t`ua falë, përderisa ata kërkojnë falje.

Nga ky *hadith kudsij* kuptojmë se shejtani e njeh Fuqinë e Zotit dhe Pushtetin e Tij, ai betohet në Emrin e Zotit dhe Madhështisë së Tij, por vazhdimisht e tregon mendjemadhësinë e tij dhe sillet me arrogancë. Gjithashtu kuptojmë se lufta e Iblisit ndaj llojit njerëzor, do të vazhdojë derisa të ketë në trupin e njeriut shpirt, pra, deri në çastet e fundit të jetës njeriu është në betejë me armikun e tij, Iblisin.

[311] Kurani, Hixhër, 39-43;

HADITHI I NJËZETENËNTË (29)

حَدَّثَنِي إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ إِدْرِيسَ، قَالَ: سَمِعْتُ حُصَيْنَ بْنَ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ سَعْدِ بْنِ عُبَيْدَةَ، عَنْ أَبِي عَبْدِ الرَّحْمَنِ السُّلَمِيِّ، عَنْ عَلِيٍّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: بَعَثَنِي رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَأَبَا مَرْثَدٍ الغَنَوِيَّ، وَالزُّبَيْرَ بْنَ العَوَّامِ، وَكُلُّنَا فَارِسٌ، قَالَ: «انْطَلِقُوا حَتَّى تَأْتُوا رَوْضَةَ خَاخٍ، فَإِنَّ بِهَا امْرَأَةً مِنَ المُشْرِكِينَ، مَعَهَا كِتَابٌ مِنْ حَاطِبِ بْنِ أَبِي بَلْتَعَةَ إِلَى المُشْرِكِينَ» فَأَدْرَكْنَاهَا تَسِيرُ عَلَى بَعِيرٍ لَهَا، حَيْثُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقُلْنَا: الكِتَابُ، فَقَالَتْ: مَا مَعَنَا كِتَابٌ، فَأَنَخْنَاهَا فَالْتَمَسْنَا فَلَمْ نَرَ كِتَابًا، فَقُلْنَا: مَا كَذَبَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، لَتُخْرِجِنَّ الكِتَابَ أَوْ لَنُجَرِّدَنَّكِ، فَلَمَّا رَأَتِ الجِدَّ أَهْوَتِ الى حُجْزَتِهَا، وَهِيَ مُحْتَجِزَةٌ بِكِسَاءٍ، فَأَخْرَجَتْهُ، فَانْطَلَقْنَا بِهَا إِلَى رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ عُمَرُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، قَدْ خَانَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالمُؤْمِنِينَ، فَدَعْنِي فَلِأَضْرِبَ عُنُقَهُ، فَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «مَا حَمَلَكَ عَلَى مَا صَنَعْتَ» قَالَ حَاطِبٌ: وَاللَّهِ مَا بِي أَنْ لاَ أَكُونَ مُؤْمِنًا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، أَرَدْتُ أَنْ يَكُونَ لِي عِنْدَ القَوْمِ يَدٌ يَدْفَعُ اللَّهُ بِهَا عَنْ أَهْلِي وَمَالِي، وَلَيْسَ أَحَدٌ مِنْ أَصْحَابِكَ إِلَّا لَهُ هُنَاكَ مِنْ عَشِيرَتِهِ مَنْ يَدْفَعُ اللَّهُ بِهِ عَنْ أَهْلِهِ وَمَالِهِ، فَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «صَدَقَ وَلاَ تَقُولُوا لَهُ إِلَّا خَيْرًا» فَقَالَ عُمَرُ: إِنَّهُ قَدْ خَانَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالمُؤْمِنِينَ، فَدَعْنِي فَلِأَضْرِبَ عُنُقَهُ، فَقَالَ: «أَلَيْسَ مِنْ أَهْلِ بَدْرٍ؟» فَقَالَ: " لَعَلَّ اللَّهَ اطَّلَعَ إِلَى أَهْلِ بَدْرٍ؟

فَقَالَ: اعْمَلُوا مَا شِئْتُمْ، فَقَدْ وَجَبَتْ لَكُمُ الجَنَّةُ، أَوْ: فَقَدْ غَفَرْتُ لَكُمْ " فَدَمَعَتْ عَيْنَا عُمَرَ، وَقَالَ: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ".

Transmeton Aliu radijeAllahu anhu i cili thotë: "Më dërgoi mua Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem bashkë me Ebu Merthedin dhe Zubejrin dhe ne të gjithë ishim kalorës dhe na tha: *"Nisuni deri në "Reudatu`l-Hah" sepse aty është një grua prej idhujtareve, e cila ka me vete një letër prej Hatib b. Ebi Belteah për tek idhujtarët".* Ne e arritëm atë tek vendi ku na tha Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe ajo ishte duke ecur mbi një deve. I thamë asaj: `Letrën`. Ajo tha: "Nuk kemi letër". E ulëm në gjunjë (devenë) dhe e kërkuam, porse nuk e gjetëm letrën. Pastaj i tham: "Nuk ka gënjyer Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, për atë do ta nxjerrish letrën ose do të të zhveshim!". Kur ajo e pa seriozitetin tonë, e nxori atë nga gërshetat e flokëve. Ne ia dërguam letrën Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem kurse Umeri radijeAllahu anhu tha: "Ai (Hatib-i) ka tradhtuar Allahun, Pejgamberin e Tij dhe besimtarët, më lejo t`ia pres kokën". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e pyeti: *"Çka të shtyri në këtë që veprove?"* Hatibi tha: "Pasha Allahun, nuk është kjo që s`jam besimtarë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, por unë dëshirova që të kem te populli ndonjë ndihmesë, me të cilën Allahu do të ma mbrojë familjen dhe pasurinë time dhe s`ka asnjë prej shokëve tu që nuk ka atje dikë prej fisit të tij, me të cilin Allahu do t`ia mbrojë familjen dhe pasurinë". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Të vërtetën e thotë, andaj edhe ju mos thoni për të asgjë tjetër përpos se mirë".* Umeri radijeAllahu anhu përsëri tha: "Ai ka tradhtuar Allahun dhe besimtarët, më lejo t`ia këpus kokën?!". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"A nuk ishte ai pjesëmarrës në Bedër?! Ku e din ti, ndoshta Allahu i ka shikuar (me Mëshirën e Tij) luftëtarët e Bedrit duke u thënë:* ***"Bëni çka të doni, sepse Unë e kam bërë obligim për ju Xhenetin (apo ua kam falur çdo gjë)".*** Nga kjo lotuan sytë e Umerit radijeAllahu anhu dhe tha: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë".[312]

[312] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Megazi, bab fadlu men shehide Bedren, nr.3983; Muslim-i, "Sahih", kitab Fadailu`s-Sahabeti, bab min fadaili ehli Bedrin, nr.2494; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab fi hukmi`l-xhasusi idha kane muslimen, nr.2650; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiru`l-Kurani, bab min sureti`l-Mumtehineti, nr.3316 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Ahmed-i, "Musned", 2/37, nr.600;

Lufta e Bedrit është nga ngjarjet më madhështore në Islam, e cila i dha historisë së saj një kahje tjetër. Kjo luftë ishte vendimtare për zhvillimet e ardhshme. Përmes kësaj lufte, u qartësua e vërteta prej të kotës, triumfoi Islami ndaj idhujtarisë dhe myslimanët fituan krenarinë. Në këtë luftë u vranë shumë prej parisë idhujtare, të cilët përpiqeshin me të gjitha forcat ta pengojnë Islamin. Në këtë luftë, edhe pse myslimanët të dobët me paisje luftarake dhe me numër, përsëri triumfuan kundrejt pabesimtarëve, të cilët ishin tre fish më shumë sesa myslimanët. Në këtë luftë, morën pjesë rreth 313 ose 315 ushtarë mysliman, kurse nga ana tjetër ishin mbi 1000 idhujtarë. Kjo luftë, ka ndodhur në vitin e dytë hixhri, në ditën e 17 të muajit Ramazan.

Allahu xh.sh. e përmend në Kuran ndihmën e Tij në Bedër, ku thotë: **"Allahu u ndihmoi juve edhe në Bedër kur ju ishit pak në numër, e për të qenë mirënjohës, keni frikë Allahun. Kur ti u thoshe besimtarëve: "A nuk mjafton për ju që Zoti juaj t`ju vazhdojë ndihmën me tremijë melek të zbritur?" Po, nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata t`u vijnë tash në moment, Zoti juaj ua vazhdon ndihmën me pesë mijë prej melekëve të ushtruar ose të shënuar".**[313]

Nga mesi i myslimanëve u vranë 14 ushtarë, kurse nga ana e pabesimtarëve u vranë 70 veta. Për besimtarët që luftuan në Bedër, Allahu xh.sh. dha përgëzime të shumta, ku atyre që kanë luftuar në këtë betejë, ua ka falur mëkatet dhe ua ka mundësuar Xhenetin.

Kurse, nga *hadithi* në fjalë, shohim se Hatibi radijeAllahu anhu edhe pse kishte bërë një gabim, duke u munduar të informojë për strategjinë e myslimanëve, me qëllim që kurejshët për këtë shërbim, t`ia kursejnë familjen dhe pasurinë, porse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem u lajmërua përmes shpalljes se çka është duke u tentuar të bëhet nga ana e Hatibit, saqë e kapën bartësen e letrës në rrugë, duke ia marr asaj porosinë e Hatibit që kishte shkruar. Umeri radijeAllahu anhu deshi që ta ekzekutojë për spiunim, porse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i bëri me dije se ai edhe përskaj këtij gabimi, posedon një vlerë të veçantë në mesin e myslimanëve, e ajo është pjesmarrja në Bedër.

Ka edhe raste tjera, ku shohim se disa nga pjesëmarrësit në luftën e Bedrit kanë gabuar dhe kanë mëkatuar pas kësaj lufte, sepse me marrjen pjesë atje, nuk janë bërë imun ndaj mëkatit, pasi njeriu pa marrë parasysh nivelin e devotshmërisë, përsëri është e mundshme të gabojë.

[313] Kurani, Ali Imran, 124-126;

Prej pjesëmarrësve në Bedër të cilët kishin bërë mëkate më pas, ishte edhe Nuajmani. Transmeton Ukbe b. Harith r.a. i cili thotë: "E sollën Nuajmanin ose birin e Nuajmanit të dehur, e Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem urdhëroi ata që ishin në shtëpi me të që ta rahin ndërsa edhe unë isha prej atyre që i sollëm, duke i mëshuar me nalle dhe thupra".[314]

Ngjashëm ndodhi edhe në kohën e sundimit të Umerit r.a. i cili në Bahrein caktoi si guvernator Kudame b. Medh`unin, i cili po ashtu ka qenë pjesmarrës në Bedër, por kishte gabuar pasi kishte konsumuar alkool dhe ishte dehur, kurse ndaj tij dëshmuan Xharudi, Ebu Hurejre dhe Hind b. Velid, bashkëshortja e Kudames.[315]

Kemi edhe rastin e Mistah b. Uthathe b. Abad b. Mutalib b. Abdulmenaf, i cili ishte përfshirë në shpifjen ndaj Aishes r.a.h. gruas së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ajo kishte dalë me nënën e Mistahut, ku ajo u pengua dhe e mallkoi Mistahun. Aisha r.a.h. i tha: "Fjalë e keqe është kjo që thua, ai ka marr pjesë në Bedër!" Në këtë moment ajo i tregoi për shpifjen në të cilën kanë përhapur njerëzit për të.[316]

Po ashtu, jo vetëm myslimanët që luftuan në Bedër kanë vlerë dhe meritë të veçantë, ngjashëm është edhe pozita e melekëve të cilët morën pjesë në këtë luftë. Transmeton Rifa` b. Rafiu radijeAllahu anhu i cili ka qenë nga luftëtarët e Bedrit, se Xhibrili alejhi`s-selam ka ardhur te i Dërguari i Allahut e i tha: *"Si i llogaritni ju në mesin tuaj pjesëmarrësit në Bedër?" Ai i tha: "Nga besimtarët më të vlefshëm"* ose diç të ngjashme. Tha: *"Po ashtu konsiderohen më të mirë edhe melekët që morën pjesë në Bedër".*[317]

[314] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Vekaletu, bab el-Vekaleti fi`l-hududi, nr.2316 dhe Ahmed-i në "Musned", 26/73, nr.16.150; se Nuajmani ishte pjesmarrës në Bedër, shih: Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edebi, bab el-Mezahu, nr.3719;

[315] Shih hadithin e plotë te: Bejheki-u, "Sunen`ul-Kubra", tahkik Muhamed Abdulkadir Ata, Darul-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i dytë, 2003, vëll.8, fq.547-548, nr.17.516; se Kudame ka marr pjesë në Bedër, shih: Buhari-u, "Sahih", kitab el-Megazi, bab tesmijetu men summije min ehli bedrin;

[316] Shih hadithin e plotë te: Buhari-u, "Sahih", kitab esh-Shehadatu, bab ta`dili`n-nisai ba`dihinne ba`dan, nr.2661; Muslim-i, "Sahih", kitab et-Teubetu, bab fi hadithi`l-ifki ve kabuli teubeti`l-kadhifi, nr.2770; etj.

[317] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Megazi, bab shuhudi`l-melaiketi Bedren, nr.3992;

HADITHI I TRIDHJETË (30)

حَدَّثَنَا مُؤَمَّلٌ، حَدَّثَنَا حَمَّادٌ، حَدَّثَنَا ثَابِتٌ، عَنْ أَنَسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " مَا مِنْ مُسْلِمٍ يَمُوتُ فَيَشْهَدُ لَهُ أَرْبَعَةٌ أَهْلُ أَبْيَاتٍ مِنْ جِيرَانِهِ الْأَدْنَيْنَ، إِلَّا قَالَ: قَدْ قَبِلْتُ عِلْمَكُمْ فِيهِ، وَغَفَرْتُ لَهُ مَا لَا تَعْلَمُونَ "

Transmeton Enes b. Maliku (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"S`ka mysliman që vdes dhe pastaj për të, të dëshmojnë katër persona nga fqinjët e tij të afërt (se është i mirë), e të mos thotë (Zoti):* ***"Unë ua pranova dijen tuaj për të, kurse ia kam falur atë që ju nuk e dinit për të".***[318]

Allahu xh.sh. e ka lidhur ngushtë raportin e njerëzve në mes tyre, pasi dëshiron që ata të jetojnë në harmoni dhe mirësi, e nuk dëshiron që në mesin e njerëzve të mbizotërojë anarkia dhe padrejtësia. Kështu që, Zoti e ka pranuar si të vlefshme, dëshminë e njerëzve në mes tyre, qoftë ajo dëshmi për të mirë, ose për të keq. Këtë na e dëshmoi edhe përmes disa haditheve të të Dërguarit të Tij. Pra, shohim se nëse një person mysliman vdes, kurse për të dëshmojnë katër persona nga fqinjët e tij se ai ka qenë i mirë, Zoti e pranon dëshminë e tyre, ndërsa ia fal mëkatet për të cilat njerëzit nuk kanë qenë të informuar për to.

Ky *hadith* përforcohet edhe me rastin tjetër, në *hadith*-in të cilin e transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se "Pranë të Dërguarit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka kaluar një *xhenaze* dhe është përmendur për të mirë, kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"E meritoi, e meritoi, e meritoi".* Pastaj, pranë tij kaloi një tjetër *xhenaze* dhe u përmend për të keq, e ai tha përsëri tre herë: *"E meritoi".* Umeri radijeAllahu anhu

[318] Ahmed-i, "Musned", 21/174, nr.13.541; Ebu Ja`la, "El-Musned", 6/199 nr.3481; Ibni Hibban-i, "Sahih", 7/295 nr.3026; Hakim-i, "Mustedrek", 1/534, nr.1398 dhe thotë se "ky hadith është Sahih sipas kushteve të Muslimit", e me këtë pajtohet edhe Dhehebiu; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në Musned-in e Ahmedit, thotë se zinxhiri i hadithit është i dobët, shkaku i Mu`mel b. Ismailit i cili ka pasur memorie të dobët, me këtë mënyrë nuk është e ruajtur përmes Enesit r.a.

tha: "O i Dërguari i Allahut, sakrifikofsha babanë dhe nënën për ty, kaloi një *xhenaze* dhe për të u fol mirë dhe ju thatë: *"E meritoi, e meritoi, e meritoi"* dhe kur kaloi *xhenazja* tjetër për të cilën u fol keq, ju thatë *"E meritoi, e meritoi, e meritoi".* Atëherë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Për personin (xhenazen) që ju e lavdëruat për të mirë, ai e meritoi Xhenetin. Për atë që folët fjalë të liga, ai e meritoi Xhehenemin. Ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë".*[319]

Ngjashëm transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se erdhi një njeri te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më trego një vepër, të cilën nëse e veproj, do të hyj në Xhenet?" Ai i tha: *"Bëhu mirëbërës".* I tha: "Si ta di se unë jam mirëbërës?" I tha: *"Pyeti fqinjët e tu, nëse ato thonë se je mirëbërës, atëherë ti je mirëbërës, e nëse ato thonë se je keqbërës, atëherë ti je keqbërës".*[320]

Shohim se dëshmia e njerëzve mes tyre është valide dhe njeriu nuk duhet të përqëndrohet shumë në parullën që qarkullon shpesh në mes njerëzve se `nëse i kam punët mirë me Allahun, nuk më intereson për njerëzit`, pra, duhet llogaritur edhe në vlerësimin e njerëzve, sepse ai që ka raport të mirë me Allahun, ai ka raport të mirë edhe me njerëzit, kurse ai që nuk ka raport të mirë me njerëzit, ai edhe me Zotin nuk ka raporte të tilla.

Nëse dikush do të thoshte: `po si të dëshmohet për dikë se ka qenë i keq, kur neve na është ndaluar t`i përmendim për të keq të vdekurit?` Në këtë *hadith*, bëhet fjalë të përmendurit e të këqijave të atyre që i kanë kryer ato haptazi dhe kanë qenë të njohur me ato vepra, si për shembull *mynafik*-ët, nga veprimet e të cilëve duhet paralajmëruar njerëzit. Kurse, për ata të cilët punët i kanë pasur të ndryshme, kurse janë munduar të jenë të mirë dhe të punojnë punë të mira, për to duhet heshtur dhe nuk duhet folur.

Gjithashtu, nuk duhet të flitet negativisht për ndonjë të vdekur, në prezencë të pasardhësve ose familijarëve të të ndjerit, sepse me këtë lëndojmë ndjenjat e tyre, kurse i vdekuri e ka marr atë që ka merituar. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ndaloi të shahet dhe ofendohet i vdekuri, që to mos lëndohet i gjalli. Këtë e aplikoi edhe në rastin e vdekjes së Ebu Xhehlit, kur

[319] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 85, nr.1367; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab fijmen juthna alejhi...nr.949 dhe në tekst është shkruar versioni i Muslimit;
[320] Hakim-i, "Mustedrek", 1/534, nr.1399, dhe thotë se "ky hadith është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ato nuk e kanë shënuar", me të pajtohet edhe Dhehebiu;

njerëzit filluan ta shajnë, kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem për të mbrojtur Ikrimen nga ofendimet që dëgjonte, e tha *hadith*-in siç e transmeton Aishja radijeAllahu anhuh. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mos i shani të vdekurit, sepse ata e kanë gjetur atë çka e kanë punuar".*[321] Si dhe ajo që transmetohet ngjashëm edhe nga Mugire b. Shu`be radijeAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mos i shani të vdekurit, e t`i shqetësoni të gjallët".*[322]

Duhet pasur kujdes se si shprehemi dhe sillemi në vende publike, si dhe duke marr parasysh ndjenjat e njerëzve që të mos i lëndojmë ata.

[321] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 97, nr.1393; etj.

[322] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 51, nr.1989 dhe ka heshtur për kategorinë e këtij hadithi; Ahmed-i, "Musned", 4/252, nr.18.235 dhe 18.236;

HADITHI I TRIDHJETËENJËTË (31)

سَمِعْتُ الْفَضْلَ بْنَ الْحُبَابِ يَقُولُ سَمِعْتُ عَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنَ بَكْرِ بْنِ الرَّبِيعِ بْنِ مُسْلِمٍ يَقُولُ سَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَقُولُ سَمِعْتُ أَبَا هُرَيْرَةَ يَقُولُ مَرَّ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَى رَهْطٍ مِنْ أَصْحَابِهِ يَضْحَكُونَ فقال: لَوْ تَعْلَمُونَ مَا أَعْلَمُ لَضَحِكْتُمْ قليلا ولبكيتم كثيرا" فأتاه جبريل فقال: إن اللَّهَ قَالَ لَكَ لِمَ تُقَنِّطُ عِبَادِي قَالَ فرجع إليهم وقال: "سددوا وأبشروا"

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kaloi pranë disa shokëve të tij të cilët qeshnin, dhe tha: *"Sikur ta dinit atë që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë"* pas kësaj, i erdhi Xhibrili a.s. dhe i tha: *"Zoti thotë:* ***"Pse ua humb shpresat robërve të Mi?"*** *Thotë:* ***"Kthehu tek ata dhe thuaju përgëzime dhe myzhde".***[323]

Dituria e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka qenë shumë më e zgjeruar se e njerëzve tjerë, po ashtu, atij Zoti ia bëri të mundshme natën e *Miraxh*-it t`i sheh disa gjëra prej botës së fshehtë, siç është Xheneti dhe Xhehenemi, pa njerëzit duke u dënuar në forma të ndryshme, edhe duke u frikësuar nga këto gjendje, ai këshilloi shokët e tij, që të mos mashtrohen shumë nga kjo botë, të mos jetojnë sikur janë të sigurtë nga ndëshkimi dhe dënimi, por të kenë drojë nga neglizhenca e zemrës. Kjo fjalë i mërziti shumë shokët e tij, siç tregohet në disa transmetime se ata bile kanë filluar të qajnë nga këto fjalë, duke menduar se e qeshura e tyre, mund të jetë shkak për dënim, prandaj, në këtë reagoi vet Zoti i gjithësisë, i cili e dërgoi melekun e zgjedhur, Xhibrilin a.s. që t`i bëjë me dije të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, se vërejtja e tij nuk ishte në vend, porse duhet stimuluar që të punojnë vepra të mira, e jo t`u humben shpresat dhe të dëshpërohen, pasi njeriu i dëshpëruar, edhe humb energjinë për të realizuar vepra të mira.

[323] Ibni Hiban-i, "Sahih", 2/73, nr.358; Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", nr.254;

Me këtë, kuptojmë se nuk duhet përdorur kundër besimtarëve, *ajet*-et që u drejtohen pabesimtarëve, sepse këto *ajet*-e u shpallën për pabesimtarët dhe *munafik*-ët, kurse personat që ishin aty prezent, nuk ishin të tillë.

Zoti i bëri me dije Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të mos i trishtojë njerëzit në këtë mënyrë, por që t`u jep myzhde dhe t`i stimulojë, që të shpresojnë në mëshirën e Zotit. Zoti thotë në Kuran: **"Thuaj: "O robërit e Mi të cilët e keni ngarkuar veten me mëkate, mos i humbni shpresat nga mëshira e Zotit..."."**[324]

Ekziston edhe një *ajet* në Kuran, i ngjashëm me këtë formulim që përmban teksti i hadithit, se nuk duhet qeshur shumë, ku thuhet: **"Le të qeshin pak dhe le të qajnë shumë.."."**[325] Ibni Kethiri për këtë ajet thotë: "Ky *ajet* nuk ka të bëj me të qeshurit për disponim, por për dyfytyrëshat *mynafik*, të cilët nuk dolën në luftën e Tebukut dhe për këtë u gëzuan, ku Zoti i kërcënoi hipokritët me këtë *ajet* duke u thënë që le të qeshin në këtë botë, por do të qajnë shumë në *ahiret*.[326] Ibni Abasi r.a. në koment të këtij *ajet*-i, thotë se ka të bëjë me *munafik*-ët dhe pabesimtarët, të cilët e morën fenë për tallje dhe lojë, Allahu u thotë atyre qeshni pak në këtë botë, por do të qani shumë në botën tjetër".[327]

Këtë *hadith*, e regjistrojnë edhe Buhariu dhe Muslimi, porse ato e regjistrojnë vetëm pjesën e parë, konkretisht tekstin: *"Sikur ta dinit atë që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë",*[328] kurse, tekstin në vijim, nuk e regjistrojnë. Kurse imam Muslimi, e shënon në temën e mos parakalimit të *imam*-it gjatë shkuarjes në *ruku* ose *sexhde*, duke treguar edhe atë që ka parë, në tekstin në vijim: *"Pasha Atë në Duart e të Cilit është shpirti i Muhamedit, sikur të shihnit atë që kam parë unë, do të qeshnit shumë pak dhe do të qanit shumë".* I thanë: "Çka ke parë, o i Dërguari i Allahut?" Tha: *"Pashë Xhenetin dhe Zjarrin".*[329]

Më pas, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur i dërgonte *sahab*-ët e tij me ndonjë mision, i urdhëronte që të kenë këtë parim, pra, lehtësimin dhe përgëzimin. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve

[324] Kurani, Zumer, 53;
[325] Kurani, Teube, 82;
[326] Ibni Kethir-i, "Tefsiri i Ibni Kethirit", Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, 2008, vëll.3, fq. 601;
[327] Taberi-u, "Xhamiu`l-Bejan an Te`vili`l-Kuran", vëll.11, fq.607;
[328] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 27, nr.6485-6486;
[329] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 25, nr.426;

sel-lem ka thënë: *"Feja është e lehtë, në këtë fe askush nuk stërngarkohet e që ajo mos ta mundë. Bëhuni të matur dhe punoni drejt, përgëzoni dhe kërkoni ndihmë prej Allahut në mëngjes, në drekë dhe kah fundi i natës".*[330]

Transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Lehtësoni, e mos vështirësoni, përgëzoni e mos i largoni".*[331]

Ky duhet të jetë parimi i thirrësit mysliman dhe besimtarit të sinqertë, që të thërras në rrugë të Allahut me sjellje të mirë dhe moral të lartë, të largohet nga gjuha e ashpër dhe irrituese, të ketë për qëllim afrimin e njerëzve dhe t`ua paraqes Islamin me mënyra të buta, e jo ta paraqesë fenë të dhunshme dhe të rëndë, që njerëzit të ikin prej sajë.

Nga ky *hadith*, kuptojmë se kur pejgamberët kanë paraqitur ndonjë vlerësim dhe mendim të vetin i cili nuk ka qenë në përputhje me urtësinë e fesë, janë korrigjuar përmes shpalljes dhe inspirimit të Zotit.

[330] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 29, nr.39; etj.
[331] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 11, nr.69; Muslimi, "Sahih", kitab el-Xhihadu ve`s-sijeru, bab fi`l-emri bi`t-tejsiri ve terki`t-tenfiri, nr.1734; Ahmedi, "Musned", 19/341, nr.12.333;

HADITHI I TRIDHJETËEDYTË (32)

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ الْخَلَّالُ قَالَ: حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ قَالَ: أَنْبَأَنَا ابْنُ أَبِي سَبْرَةَ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ مُحَمَّدٍ، عَنْ مُعَاوِيَةَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ جَعْفَرٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " إِذَا كَانَتْ لَيْلَةُ النِّصْفِ مِنْ شَعْبَانَ، فَقُومُوا لَيْلَهَا وَصُومُوا نَهَارَهَا، فَإِنَّ اللَّهَ يَنْزِلُ فِيهَا لِغُرُوبِ الشَّمْسِ إِلَى سَمَاءِ الدُّنْيَا، فَيَقُولُ: أَلَا مِنْ مُسْتَغْفِرٍ لِي فَأَغْفِرَ لَهُ أَلَا مُسْتَرْزِقٌ فَأَرْزُقَهُ أَلَا مُبْتَلًى فَأُعَافِيَهُ أَلَا كَذَا أَلَا كَذَا، حَتَّى يَطْلُعَ الْفَجْرُ "

Transmeton Aliu (r.a.) biri i Ebu Talibit se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur të vijë nata e mesme e muajit Shaban, kaloni natën e saj në namaz dhe agjëroni ditën e saj, ngase Allahu atë natë me të perënduar Dielli, zbret në qiellin e Tokës dhe thërret:* ***"A ka kush që kërkon falje mëkatesh, që ta fal?! A ka kush që kërkon furnizim, që ta furnizoj?! A ka të sprovuar që kërkon ndihmë, që ta shëroj?! A ka kështu e ashtu",*** *derisa të agoi mëngjesi".*[332]

Këtë *hadith*, Ibni Maxhe-ja e ka rënditur në *hadith*-et që flasin mbi vlerën e mesit të muajit Sha`ban. Kjo natë gjendet në mesin e këtij muaji, që është në prag të muajit më të madh të vitit (muajit Ramazan), që besimtari musliman të hyjë në këtë muaj përafërsisht i pastër prej mëkateve.

---

[332] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Salatu, bab 191, nr.1388; Bejhekiu, "Shu`abu`l-Iman", 5/354, nr.3542; por për Ibni Ebi Sebrete, dijetarët kanë pasur kritika dhe e kanë konsideruar transmetues të dobët; Busiriu në "Zevaid" thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, shkaku i Ibni Ebi Sebretes, për të cilin Ahmed b. Hanbeli dhe Ibni Meini kanë thënë se falsifikon hadithe; Buhariu e ka konsideruar të dobët, Nesaiu thotë se është i refuzuar. Ali b. Medeni thotë se ka qenë i dobët në hadith. Për këto vlerësime ndaj Ibni Ebi Sebretes, shih: Mizziu, "Tehdhibu`l-Kemal", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i dytë, 1983, 33/102-108, nr.7240;

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na këshilloi që mbrëmjen e kësaj nate, ta kalojmë në namaz vullnetarë, kurse ditën me agjërim, i cili po ashtu është vullnetarë, kuptohet për atë i cili ka mundësi.

Kur jemi te "zbritja" e Zotit, disa dijetarë e kanë interpretuar, kurse disa e kanë lënë ashtu siç është duke mos e hulumtuar esencën e saj, por duke e besuar ashtu siç është pa formë dhe mënyrë, andaj edhe ne nuk do të zgjerohemi në këtë pikë, nga arsyeja se është temë shumë e gjërë dhe do të merrte shumë hapësirë.

Në këtë natë, na jepet një mundësi që me përfundimin e asaj dite, në kohën kur perëndon Dielli, Allahu xh.sh. hap dyert e faljes dhe kërkon prej besimtarëve që të pendohen dhe të kërkojnë falje, që Allahu xh.sh. t`ua fal dhe të kërkojnë shërim për sëmundjet e tyre e Allahu xh.sh. t`i shërojë. Ne mëkatojmë, përsëri është Zoti që kërkon prej nesh që të kthehemi kah Ai dhe të dijmë se dyert e faljes i kemi të hapura, sidomos në këtë natë të madhe dhe të begatshme.

Se në këtë natë falen mëkatet, dëshmon edhe *hadith*-i tjetër që e transmeton Aishja r.a.h. e cila thotë: "Një natë, vërejta se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk ishte afër meje, dola të shohë se ku gjendet dhe e vërejta se ai qëndronte në varrezat Beki`. Duke shikuar kah unë, më tha: *"A u frikove se Allahu dhe i Dërguari i Tij do të bëjnë padrejtësi?"* Ajo tha: "O i Dërguari i Allahut, mendoja se ndoshta keni shkuar te ndonjëra prej grave tuaja". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Allahu zbret në natën e 15 të muajit Shaban, në qiellin e kësaj bote dhe fal më shumë se numri i qimeve të deleve të fisit Kelb*[333]*"*.[334]

Po ashtu *hadith*-i tjetër që e transmeton Ebu Musa Eshariu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu i vështron të*

[333] Fisi Kelb, ka pasur dhenë më shumë se të gjitha fiset tjera arabe.

[334] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Saumi, nr.739; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Salatu, bab 191, nr.1389; Ahmed-i, "Musned", 6/238, nr.26.077; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/355, nr.3543-3544; Begavi-u, "Sherhu`s-Sunneh", tahkik Shuajb el-Arnauti, Mektebetu`l-Islamije, botimi i dytë, Bejrut, 1983, 4/126, nr.992; Tirmidhiu thotë se e ka dëgjuar Buhari-un, duke thënë për këtë hadith se është i dobët, pasi Jahja b. Ebi Kethiri nuk ka dëgjuar hadithe nga Urve, po ashtu, Haxhaxh b. Ertati, nuk ka dëgjuar hadithe nga Jahja b. Ebi Kethiri, me këtë formë, është i ndërprerë (Munkati) në dy vende në sened"; edhe Shejh Shuajb el-Arnauti, në verifikim të "Sunen Ibni Maxheh", tahkik Shuajb Arnauti, vëll.2, fq.400, nr.1389, thotë se hadithi është i dobët, po ashtu edhe për hadithet që i shënon Bejheki-u në këtë temë, janë të dobëta;

gjitha krijesat e Tij në natën e gjysmës së muajit Shaban dhe i fal të gjitha krijesat e Tij, me përjashtim të atij i cili i bën shok Allahut dhe atij që urren".[335]

Hadith-i na këshillon që të kërkojmë dhe të bëjmë lutje për furnizim, që t`na jep furnizim dhe bereqet në pasurinë tonë, e jo të ngurojë besimtari dhe të tregohet modest duke menduar se kërkimi i shtimit të *risk*-ut, është vepër e qortuar dhe jo ligjore.

Gjithashtu, u jep hapësirë edhe atyre të cilët janë të sprovuar me sprova të ndryshme, që të kërkojnë nga Zoti që t`ua largojë apo t`ua lehtësojë sprovën, sepse natyra e njeriut është e dobët dhe lodhet shpejt nga problemet e ndryshme, sidomos nga ato gjëra të cilat prekin zemrën e njeriut, si sprova në fëmijë, në shëndet ose në pasuri. Prandaj, luteni Zotin në këtë mbrëmje, sepse Allahu xh.sh. kërkon prej neve të lutemi dhe të kërkojmë ndihmë prej Tij.

Dhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk përmendi gjëra tjera, por tha `kështu e ashtu` me çka kuptojmë se hapësira e kësaj mundësie është e gjërë dhe lë vend edhe për kërkesa tjera dhe nevoja të ndryshme të cilat mund të ketë nevojë njeriu. Kjo mundësi për besimtarët, zgjat deri në mëngjesin e asaj nate.

Nga *hadith*-i në fjalë, kuptojmë Mëshirën e pakufishme të Zotit tonë Bujar dhe Mëshirues, i Cili nuk dëshiron që besimtarët të vazhdojnë me barrën e mëkatit në shpirtin e tyre, por dëshiron që t`i pastrojë dhe t`ua largojë mëkatet.

[335] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Salatu, bab 191, nr.1390; Ibn Hibbân-i, "Sahîh", tahkik: Shu'ajb el-Arnaûtî, Muessesetu`r-Risâle, I-XIIX, Bejrût 1993, vëll.22, fq.481, nr.5665; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 3834; Busiri-u në "Zevaid", thotë: "Zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, shkaku i Ibni Lehi`asë, si dhe *tedlis-it* që bënte Ibni Muslimi". Sindi thotë: "Ibni Arzebi, nuk e ka takuar Ebu Musanë, kështu thotë edhe Mundhiri-u; po ashtu për Dahhak b. Ejmenin, Dhehebiu thotë se nuk e di kush është ky; Shejh Shuajb Arnauti, në verifikim të "Sunen-it të Ibni Maxhes, vëll.2, fq.400, thotë se hadithi është i dobët, por është *hasen* në bazë të haditheve tjera;

HADITHI I TRIDHJETËETRETË (33)

أَخْبَرَنِي أَحْمَدُ بْنُ مُحَمَّدِ بْنِ سَلَمَةَ الْعَنَزِيُّ، ثَنَا عُثْمَانُ بْنُ سَعِيدٍ الدَّارِمِيُّ، ثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ صَالِحٍ الْمُقْرِئُ، ثَنَا سُلَيْمَانُ بْنُ هَرِمٍ الْقُرَشِيُّ، وَحَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حَمْشَاذَ الْعَدْلُ، ثَنَا عُبَيْدُ بْنُ شَرِيكٍ، ثَنَا يَحْيَى بْنُ بُكَيْرٍ، ثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ سُلَيْمَانَ بْنِ هَرِمٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْمُنْكَدِرِ، عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: خَرَجَ عَلَيْنَا النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ: " خَرَجَ مِنْ عِنْدِي خَلِيلِي جِبْرِيلُ آنِفًا فَقَالَ: يَا مُحَمَّدُ، وَالَّذِي بَعَثَكَ بِالْحَقِّ إِنَّ لِلَّهِ عَبْدًا مِنْ عَبِيدِهِ عَبَدَ اللَّهَ تَعَالَى خَمْسَ مِائَةِ سَنَةٍ عَلَى رَأْسِ جَبَلٍ فِي الْبَحْرِ عَرْضُهُ وَطُولُهُ ثَلَاثُونَ ذِرَاعًا فِي ثَلَاثِينَ ذِرَاعًا وَالْبَحْرُ مُحِيطٌ بِهِ أَرْبَعَةَ آلَافِ فَرْسَخٍ مِنْ كُلِّ نَاحِيَةٍ وَأَخْرَجَ اللَّهُ تَعَالَى لَهُ عَيْنًا عَذْبَةً بِعَرْضِ الْأُصْبَعِ تَبَضُّ بِمَاءٍ عَذْبٍ فَتَسْتَنْقِعُ فِي أَسْفَلِ الْجَبَلِ وَشَجَرَةَ رُمَّانٍ تُخْرِجُ لَهُ كُلَّ لَيْلَةٍ رُمَّانَةً فَتُغَذِّيهِ يَوْمَهُ، فَإِذَا أَمْسَى نَزَلَ فَأَصَابَ مِنَ الْوضُوءِ وَأَخَذَ تِلْكَ الرُّمَّانَةَ فَأَكَلَهَا ثُمَّ قَامَ لِصَلَاتِهِ، فَسَأَلَ رَبَّهُ عَزَّ وَجَلَّ عِنْدَ وَقْتِ الْأَجَلِ أَنْ يَقْبِضَهُ سَاجِدًا وَأَنْ لَا يَجْعَلَ لِلْأَرْضِ وَلَا لِشَيْءٍ يُفْسِدُهُ عَلَيْهِ سَبِيلًا حَتَّى بَعَثَهُ وَهُوَ سَاجِدٌ قَالَ: فَفَعَلَ فَنَحْنُ نَمُرُّ عَلَيْهِ إِذَا هَبَطْنَا وَإِذَا عَرَجْنَا فَنَجِدُ لَهُ فِي الْعِلْمِ أَنَّهُ يُبْعَثُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَيُوقَفُ بَيْنَ يَدَيِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ فَيَقُولُ لَهُ الرَّبُّ: أَدْخِلُوا عَبْدِي الْجَنَّةَ بِرَحْمَتِي، فَيَقُولُ: رَبِّ بَلْ بِعَمَلِي، فَيَقُولُ الرَّبُّ: أَدْخِلُوا عَبْدِي الْجَنَّةَ بِرَحْمَتِي، فَيَقُولُ: يَا رَبِّ، بَلْ بِعَمَلِي، فَيَقُولُ الرَّبُّ: أَدْخِلُوا عَبْدِي الْجَنَّةَ بِرَحْمَتِي، فَيَقُولُ: رَبِّ بَلْ بِعَمَلِي، فَيَقُولُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ لِلْمَلَائِكَةِ: قَايِسُوا عَبْدِي بِنِعْمَتِي عَلَيْهِ وَبِعَمَلِهِ فَتُوجَدُ نِعْمَةُ الْبَصَرِ قَدْ

أَحَاطَتْ بِعِبَادَةِ خَمْسِ مِائَةِ سَنَةٍ وَبَقِيَتْ نِعْمَةُ الْجَسَدِ فَضْلًا عَلَيْهِ فَيَقُولُ: أَدْخِلُوا عَبْدِي النَّارَ قَالَ: فَيُجَرُّ إِلَى النَّارِ فَيُنَادِي: رَبِّ بِرَحْمَتِكَ أَدْخِلْنِي الْجَنَّةَ، فَيَقُولُ: رُدُّوهُ فَيُوقَفُ بَيْنَ يَدَيْهِ فَيَقُولُ: يَا عَبْدِي، مَنْ خَلَقَكَ وَلَمْ تَكُ شَيْئًا؟ فَيَقُولُ: أَنْتَ يَا رَبِّ، فَيَقُولُ: كَانَ ذَلِكَ مِنْ قِبَلِكَ أَوْ بِرَحْمَتِي؟ فَيَقُولُ: بَلْ بِرَحْمَتِكَ. فَيَقُولُ: مَنْ قَوَّاكَ لِعِبَادَةِ خَمْسِ مِائَةِ عَامٍ؟ فَيَقُولُ: أَنْتَ يَا رَبِّ، فَيَقُولُ: مَنْ أَنْزَلَكَ فِي جَبَلٍ وَسَطَ اللُّجَّةِ وَأَخْرَجَ لَكَ الْمَاءَ الْعَذْبَ مِنَ الْمَاءِ الْمَالِحِ وَأَخْرَجَ لَكَ كُلَّ لَيْلَةٍ رُمَّانَةً وَإِنَّمَا تَخْرُجُ مَرَّةً فِي السَّنَةِ، وَسَأَلْتَنِي أَنْ أَقْبِضَكَ سَاجِدًا فَفَعَلْتُ ذَلِكَ بِكَ؟ فَيَقُولُ: أَنْتَ يَا رَبِّ، فَقَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: فَذَلِكَ بِرَحْمَتِي وَبِرَحْمَتِي أُدْخِلُكَ الْجَنَّةَ، أَدْخِلُوا عَبْدِي الْجَنَّةَ فَنِعْمَ الْعَبْدُ كُنْتَ يَا عَبْدِي فَيُدْخِلُهُ اللَّهُ الْجَنَّةَ، قَالَ جِبْرِيلُ عَلَيْهِ السَّلَامُ: إِنَّمَا الْأَشْيَاءُ بِرَحْمَةِ اللَّهِ تَعَالَى يَا مُحَمَّدُ «هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحُ الْإِسْنَادِ، فَإِنَّ سُلَيْمَانَ بْنَ هَرِمٍ الْعَابِدَ مِنْ زُهَّادِ أَهْلِ الشَّامِ، وَاللَّيْثَ بْنَ سَعْدٍ لَا يَرْوِي عَنِ الْمَجْهُولِينَ»

Transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili thotë: “Doli te ne Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem dhe tha: *“Tash sa doli prej tek unë dosti (i dashuri) im Xhibrili a.s. dhe më tha: “O Muhamed! Pasha Atë i Cili të ka dërguar me të vërtetën, Allahu kishte një rob prej robërve të Tij i cili pesëqind vite qëndroi në majë të kodrës që gjendej në një ishull. Gjatësia dhe gjerësia e tij ishte tridhjetë parakrahë (arshin), ndërsa deti e rrethonte atë katër milje nga çdo anë. Allahu i nxori atij një burim të thellë sa një gisht, i cili nxirrte ujë të ëmbël dhe rridhte pak në pjesën e poshtme të malit. Gjithashtu i dha edhe një pemë shege, e cila çdo natë nxirrte nga një frut, e ajo i mjaftonte si ushqim për gjithë ditën. Kur zgjohej, ai zbriste, merrte abdes, e këpuste shegën dhe e hante, e më pas ngrihej e falej. Ai iu lut Allahut, që kur t`ia merrte shpirtin, t`ia merrte në sexhde dhe të mos e lërë tokën* ose *ndonjë gjë tjetër ta prish trupin e tij, derisa të ringjallej duke qenë në sexhde. E kështu Allahu (xh.sh.) ia plotësoi dëshirat e tij. Ndërkohë që ne zbrisnim dhe ngjiteshim në qiell, lexonim për të në dijen e hershme, se ai do të ringjallet*

Ditën e Gjykimit dhe do të qëndrojë përpara Allahut të Madhëruar. Allahu do t`i thotë atij: ***"Futeni robin Tim në Xhenet me Mëshirën Time".*** *Ai do të thotë: "O Zoti im! Jo, por me punën time". Zoti përsëri do të thotë:* ***"Futeni robin Tim në Xhenet me Mëshirën Time".*** *Dhe ai do të thotë: "O Zoti im! Jo, por me punën time". Herën e tretë thotë:* ***"Futeni robin Tim në Xhenet me Mëshirën Time".*** *Dhe ai do të thotë: "O Zoti im! Jo, por me punën time". Atëherë Allahu do t`u thotë melekëve:* ***"Matni mes një mirësie që i kam dhuruar dhe punës së tij".*** *Por vunë re se vetëm mirësia e shikimit e kishte mbuluar gjithë adhurimin e pesëqind viteve, ndërsa mirësia e gjithë trupit ishte shtesë për të. Më pas Allahu u tha:* ***"Futeni robin Tim në Zjarr".*** *E kështu ai do të tërhiqet për në Zjarr, duke thirrur: "O Zoti im, më fut në Xhenet më Mëshirën Tënde" dhe Allahu urdhëron që ta kthejnë prapë. Ai qëndron para Allahut dhe Ai i thotë:* ***"O robi Im! Kush të krijoi në një kohë kur nuk ishe asgjë?!".*** *Ai thotë: "Ti o Zoti im". Allahu i thotë:* ***"Kjo ndodhi prej vetes tënde apo prej Mëshirës Time".*** *Ai i thotë: "Përkundrazi, me Mëshirën Tënde". Allahu i thotë:* ***"Kush të forcoi për adhurim pesëqind vite me radhë?!".*** *Ai thotë: "Ti o Zoti im". Allahu i thotë:* ***"Kush të zbriti nga mali që ndodhej midis dallgëve dhe të nxori një burim uji të ëmbël në mes të atij uji të kripur dhe çdo natë të dhuroi nga një shegë, ndërkohë që t`i dilje vetëm një herë në vit? Gjithashtu më kërkove të ta merrja shpirtin në sexhde dhe Unë kështu veprova me ty".*** *Ai thotë: "Ti o Zoti im". Atëherë Allahu i thotë:* ***"Të gjitha këto ishin me Mëshirën Time, me të cilën të fus në Xhenet. Merreni robin Tim dhe futeni në Xhenet! Sa rob i mirë që ishe, o robi Im".*** *E kështu Allahu e fut në Xhenet. Pastaj Xhibrili tha: "Vërtet se gjërat ndodhin me Mëshirën e Allahut të Madhëruar o Muhamed".*[336]

---

[336] Hakimi, "El-Mustedrek", vëll.4, fq.278-279, nr.7637 dhe thotë se "hadithi është me zinxhir Sahih, kurse Sulejman b. Herim është adhurues, *zahid* prej Shami, ndërsa Lejth b. Sa`di nuk ka përcjellur prej të panjohurve", por Dhehebiu nuk pajtohet me këtë vlerësim dhe thotë: "Them jo, pasha Allahun që nuk është ashtu, sepse Sulejmani nuk është i besueshëm"; Bejhekiu, "Shu`abu`l-Iman", vëll.6, fq.341-342, nr.4300; Muhtar Ahmed en-Nedeviu në verifikim të veprës "Shu`ab", thotë se hadithi është shumë i dobët; imam Dhehebiu për njërin prej transmetuesve i cili quhet Sulejman b. Herim el-Kurejshiu i cili përcjell prej Muhamed b. Munkedirit, thotë se Ezdiu për të ka thënë se "hadithet prej tij nuk janë Sahih". Ukajli thotë se "ai është i panjohur, kurse hadithet e tija nuk janë të ruajtura". Më pas Dhehebi-u e shënon hadithin prej tij (që e kemi në trajtim) dhe thotë: "Kjo nuk është Sahih, sepse Allahu xh.sh. thotë: **"Hyni në Xhenet për hir të asaj që keni punuar". (Nahël, 32)** porse askë nuk e shpëton prej Xhehenemi vepra e tij siç është saktësuar (në hadith), por gjithsesi veprat tona të mira janë prej Mirësisë së Zotit ndaj nesh dhe prej begative të Tij, nuk është prej fuqisë sonë, kurse Atij i takon tërë falënderimi". (Dhehebi-u, "Mizanu`l-I`tidal", Daru`l-Ma`rife, Bejrut, vëll.2, fq.227-228, nr.3523) shih kritikën e Ukajlit në librin e tij "Kitab ed-Duafau`l-Kebir", vëll.2, fq.144, nr.638; po ashtu këto

Ky është një *hadith* i njohur dhe i popullarizuar, që shpesh përmendet nëpër ligjerata dhe këshilla, porse për këtë *hadith* janë shprehur kritika nga dijetarët e *hadith*-it, pasi në zinxhirin e *hadith*-it, ka transmetues të dobët, si dhe teksti i *hadith*-it, siç potencon edhe Dhehebiu, bie në kundërshtim me ajetet e Kuranit, ku thuhet se besimtarët do të mund të hyjnë në Xhenet me veprat e tyre. Në këtë konstatim, imam Dhehebiu e përmend *ajet*-in: **"Hyni në Xhenet për hir të asaj që keni punuar".**[337]

Këtë konstatim, e mbështesin edhe *ajet*-e tjera, ku Zoti thotë: **"Hani e pini shijshëm si shpërblim për atë që keni punuar".**[338] Po ashtu thotë: **"Ky është Xheneti të cilin e trashëguat si shpërblim për atë që keni punuar".**[339]

Sa i përket hadithit që e përcjell Ebu Hurejre r.a. ku Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Askënd prej jush nuk e shpëtojnë veprat e tija".* Këtu ndërhynë shokët e tij dhe thanë: "As ti, o i Dërguari i Allahut?" Ai tha*: "As unë, pos nëse më merr Allahu në Mëshirën e Tij. Prandaj bëni punë të mira me saktësi, çiltërsi e maturi dhe adhurojeni Allahun paradite dhe pasdite dhe gjatë një pjese të natës! Gjithnjë zgjidhni e bëni të mesmen, të maturën dhe të vazhdueshmen, pa iu ndarë, me anë të së cilës do të arrini qëllimin tuaj: Xhenetin".*[340] Në këtë *hadith* shohim se vepra nuk mund ta shpëtojë askë nga Xhehenemi, nëse nuk është Mëshira e Zotit, kurse hyrjen në Xhenet, në *ajet*-e kuranore Zoti e ndërlidhi edhe me kryerjen e veprave të mira.

Por, ky *hadith Sahih* (i vërtetë) ka shkaktuar që dijetarët të merren më shumë me këtë temë, sepse në shikim të parë duket sikur *hadith*-et në fjalë bien në kundërshtim me *ajet*-et që u përmendën. Në këtë drejtim janë potencuar shumë mendime të dijetarëve, ku disa kanë thënë se *hadith*-i i Ebu Hurejres r.a. që e shënojnë Buhariu dhe Muslimi i sqaron dhe i

---

vlerësime gjenden edhe te Ibni Haxher-i, "Lisanu`l-Mizan", Mektebetu`l-Metbuatil islamijeti, Bejrut, botimi i parë, 2002, vëll.4, fq.180, nr.3655;

[337] Kurani, Nahël, 32;

[338] Kurani, Tur 19 dhe Murselat, 43;

[339] Kurani, Zuhruf, 72;

[340] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab el-kasdi vel mudavemeti alel ameli, nr.6463; Muslim-i, "Sahih", kitab Sifetul Kijameti.., bab len jed`hule ehadun el-xhenete bi amelihi, nr.2816; etj.

komenton *ajet*-et e Kuranit. Pra, njeriu shkon në Xhenet me punën e tij, por pasi ta meritojë Mëshirën e Zotit.

Disa kanë thënë se në Xhenet do të hyjnë njerëzit me Mëshirën e Zotit, kurse do t`i meritojnë pallatet dhe nivelet e Xhenetit me veprat të cilat i kanë vepruar.

Disa kanë thënë se edhe mundësia për të vepruar është prej Mëshirës së Zotit, kështu që përsëri edhe vepra e tij kthehet dhe kryhet prej Mëshirës së Zotit ndaj tij. Nëse nuk do të ishte Mëshira e Zotit që ta udhëzojë atë, kush do t`i mundësonte atij që të ketë *iman* dhe të punojë punë të mira?!

Disa kanë thënë se vepra nuk mundet ta fus në Xhenet askë i cili nuk e ka kryer atë me sinqeritet dhe nuk ia ka pranuar Zoti, por nëse Zoti ia ka pranuar atë vepër, atëherë me të mund të hyjë në Xhenet.[341]

Është e vërtetë se nëse qëndrojmë duar kryq dhe nuk bëjmë asgjë, nuk meritojmë aspak hise në Xhenet, por nëse punojmë punë të mira dhe mundohemi për të fituar kënaqësinë e Zotit, atëherë do jemi meritorë për të fituar Mëshirën e Zotit, e në këtë rast puna do të jetë arsye edhe e hyrjes në Xhenet, kurse Mëshira e Zotit ka përfshirë çdo send dhe është mbi të gjitha.

Pasi *hadithi kudsi* që e kemi shënuar është i dobët, ne nuk do të zgjerohemi shumë në kuptimin e tij të brendshëm, pasi Mëshira e madhe e Zotit ndaj robërve të Tij vërtetohet edhe përmes shumë *ajet*-eve dhe *hadith*-eve tjera.

[341] Për këto dhe mendime tjera, shih Ibni Haxheri, "Fet`hu`l-Bari", vëll.14, fq.597-600;

HADITHI I TRIDHJETËEKATËRTË (34)

قَالَ: أَخْبَرَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ بْنُ عَطَاءٍ الْعِجْلِيُّ، عَنْ سَعِيدٍ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنِ الْحَسَنِ، عَنْ عُتَيٍّ، عَنْ أُبَيِّ بْنِ كَعْبٍ، عَنِ النَّبِيِّ عَلَيْهِ السَّلَامُ أَنَّهُ قَالَ: " إِنَّ آدَمَ كَانَ رَجُلًا طُوَالًا كَأَنَّهُ نَخْلَةٌ سَحُوقٌ، كَثِيرَ شَعْرِ الرَّأْسِ، فَلَمَّا رَكِبَ الْخَطِيئَةَ بَدَتْ لَهُ عَوْرَتُهُ وَكَانَ لَا يَرَاهَا قَبْلَ ذَلِكَ، فَانْطَلَقَ هَارِبًا فِي الْجَنَّةِ فَتَعَلَّقَتْ بِهِ شَجَرَةٌ فَقَالَ لَهَا: أَرْسِلِينِي، فَقَالَتْ: لَسْتُ بِمُرْسِلَتِكَ، قَالَ: وَنَادَاهُ رَبُّهُ: يَا آدَمُ، أَمِنِّي تَفِرُّ؟ قَالَ: «رَبِّ إِنِّي اسْتَحْيَيْتُكَ»

Transmeton Ubejje b. Ka`bi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, Ademi (a.s.) ishte njeri i gjatë, sikur të ishte trungu i një palme dhe kishte shumë flokë. Kur e kreu mëkatin, iu shpalos atij pjesa intime, e ai kurrë më parë nuk e kishte parë atë. Ai filloi të vrapojë nëpër Xhenet, por (flokët) iu kapën për degët e një druri dhe i tha asaj: "Më lësho". Ajo i tha: "Jo nuk të lëshojë". Tha (Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem): "Atë e thirri Zoti (duke i thënë): **"O Adem, a prej Meje po ik?!".** Ai tha: "Zoti im, po më vjen turp prej Teje".*[342]

Këtu flitet për një pjesë të jetës së njeriut dhe pejgamberit të parë mbi rruzullin tokësorë, Ademit a.s. E dimë se gjeneza e njeriut ishte e pastër kurse fillimi i tij ishte në Xhenet. Njeriu ishte në Xhenet, sepse për të e krijoi Allahu xh.sh. e jo për Xhehenem, mu për këtë Zoti vazhdimisht i thirrë njerëzit që të bëjnë vepra të mira dhe të kthehen në thelbin e tyre dhe

[342] Ibni Sa`d-i, "Tabekatu`l-Kebir", tahkik dr. Ali Muhamed Umer, Kajro, botimi i parë, 2001, vëll.1, fq.15; Ahmed-i, "Zuhd", fq.43, nr.265; Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/288, nr.3038 dhe thotë se "hadithi është me zinxhir Sahih por Buhari-u dhe Muslim-i nuk e kanë shënuar". Ibni Kethir-i në "El-Bidaje ve`n-Nihaje", Vizaretu`l-Eukaf vesh-Shu`unu`l-Islamijeti, Katar, 2015, vëll.1, fq.183-184 thotë se zinxhiri është Sahih, por ngjanë sikur është i marrur prej ithtarëve të Librit", po ashtu e sjell me një zinxhir tjetër ku në mes Hasanit dhe Ubejit është edhe një transmetues dhe thotë se ky është më i saktë, pasi siç thotë ai, Hasan el-Basriu nuk e ka takuar Ubejje b. Ka`bin r.a.;

në vendbanimin e parë të tyre në Xhenet, por shumë njerëz e kundërshtojnë Atë dhe bëjnë vepra të liga, me çka e meritojnë dënimin e Zotit.

Në këtë *hadith* i Dërguari i Allahut na tregon se babai i njerëzimit kishte qenë shumë i lartë, që për njerëzit e kohës së sodit, është diçka e paimagjinueshme një lartësi e tillë. Këtë pjesë të *hadith*-it, e vërteton në mënyrë konkrete edhe *hadith*-i që e shënon Imam Buhariu përmes Ebu Hurejres r.a. me këtë shtojcë në fillim: *"Allahu xh.sh. e krijoi Ademin a.s. në pamjen e tij, të gjatë 60 kut (arshin)..."*.[343]

Ai duke ecur nëpër Xhenet, i urdhëruar nga Zoti që të mos i afrohet njërës pemë, Iblisi i mallkuar arriti që t`i bëjë përshpëritje dhe dyshime, kështu që e bindi për ta provuar pemën e ndaluar, me çka në moment, atyre iu shpalos pjesa intime e trupit.

Për shpalosjen e *auret*-it të Ademit a.s. dhe turpërimin e tij, flet edhe Kurani ku thotë: **"Atëherë me mashtrim i zbriti (në nivel të palakmueshëm). E kur e shijuan pemën u zbulua vendturpi i tyre dhe filluan të mbulojnë atë (duke vënë gjeth mbi gjeth) nga gjethet e (pemëve të) Xhenetit. Zoti i tyre i thirri (duke u thënë): "A nuk ua ndalova ju dyve atë pemë dhe a nuk ju thashë ju dyve se shejtani është armik i haptë për ju?!".**[344] Si dhe ajeti tjetër ku thotë: **"O bitë e Ademit, të mos u mashtrojë kurrsesi shejtani sikurse i nxori prindërit tuaj nga Xheneti, zhveshi prej tyre petkun e tyre që t'ju dalë në shesh lakuriqësia e tyre. Vërtet ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk i shihni. Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë".**[345]

Njeriu ndonjëherë mendon se mund të ik prej Allahut xh.sh, por ky është mashtrim i vetvetes, sepse ku do që të jesh, Ai të sheh dhe e dinë se çka vepron. Por, ne në rast të gabimit, nuk duhet të mundohemi të ikim prej Zotit, por duhet të shkojmë drejt Tij me pendim dhe kërkimfalje. Siç thotë Zoti në Kuran: **"Pra, ikni (e mbështetuni) te Allahu...".**[346] Zoti e dinte shumë më mirë se çka ishte duke vepruar Ademi a.s. dhe çka ishte qëllimi i tij gjatë ikjes, por këtë ia bëri si formë rikujtimi që nuk duhet të jetë i

[343] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Isti`dhanu, bab bedvi`s-selami, nr.6227; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhenetu ve sifetu neimiha ve ehliha, bab jed`hulu`l-xhenete ekvamun ef`idetuhum mithlu ef`ideti`t-tajri, nr.2841; etj.
[344] Kurani, A`raf, 22;
[345] Kurani, A`raf, 27;
[346] Kurani, Dharijat, 50;

padëgjueshëm dhe se kthimi do të jetë përsëri te Ai, e prej Tij nuk ka ku të iket.

Rrjedhimisht duhet të kuptojmë se njeriu duhet të ketë turp nga shfaqja e padëgjueshmërisë dhe mëkatimit përmes zhveshjes së turpit. Ademi a.s. u turpërua aq shumë saqë nuk dinte çka të vepron, pasi iu shfaq pjesa e turpshme e trupit, edhe pse askush nuk ishte aty, përpos gruas së tij Havasë dhe *shejtan*-it të mallkuar Iblisit. Nëse bëjmë një krahasim me gjendjen e sotme, ku shohim se sa vajza muslimane nuk i nënshtrohen Zotit në urdhrin e Tij për mbulesën, sa vajza dalin duke e zbuluar trupin për provokim, sa prej tyre nuk turpërohen aspak që dalin para njerëzve të huaj, duke zbuluar pjesë të trupit që edhe para babait nuk lejohet të zbulohen, e jo më para njerëzve të panjohur. Sa burra dhe gra muslimane sot shkojnë nëpër plazhet e deteve dhe zhvishen gati plotësisht para njerëzve që nuk i kanë të afërm?! Ku është turpi i muslimanit që të turpërohet para Zotit?! Apo pret Ditën e Gjykimit kur do të turpërohet para të gjitha krijesave, kur më nuk vlen pendimi?!

Ne do të përmendim disa *hadith*-e të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem përmes së cilave duhet të kuptojmë se turpi duhet të jetë pjesë e pandashme e besimtarit, sidomos gjatë zhveshjes. Transmeton Abdullah b. Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kini turp prej Allahut me një turp të vërtetë".* Ne thamë: "Ne kemi turp prej Allahut elhamdulilah". Ai tha: *"Nuk është kjo, porse turpi i vërtetë prej Allahut është të keshë kujdes kokën dhe atë që ndodh në të (si shikimi, dëgjimi, të folurit), të keshë kujdes barkun dhe hamendjen, të përkujtosh vdekjen dhe sprovën, e kush e donë ahiretin, e braktis bukurinë e kësaj bote, e kush vepron kështu, ai ka me të vërtetë turp prej Allahut".*[347]

Duhet të kemi turp në çdo gjendje sepse në shoqërimin tonë janë edhe melekët e Zotit të cilat na përcjellin në çdo lëvizje. Transmeton Ibni Umeri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kini kujdes nga lakuriqësia, sepse me ju janë ata që nuk largohen kurrë, përpos se kur*

[347] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab, nr.2458 dhe thotë se hadithi është Garib; Ahmed-i, "Musned", 6/187, nr.3671; Hakim-i, "El-Mustedrek", 4/359, nr.7915 dhe thotë se hadithi është me zinxhir Sahih por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, thotë se zinxhiri i hadithit është i dobët, shkaku i dobësisë së Sabbah b. Muhamedit..." për më shumë analiza të detajuara, shiko aty;

kryeni nevojën dhe kur burri afrohet tek gruaja e tij (për akt intim), andaj keni turp prej tyre dhe nderoni ata".[348]

Po ashtu, mësuesi i njerëzimit, Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na mësoi se ndonjëherë edhe kur të jemi të vetmuar, nuk duhet të jemi të zhveshur plotësisht, sepse njeriu duhet të turpërohet edhe prej Zotit, por fatkeqësisht sot shumë pak njerëz mendojnë rreth kësaj. Transmeton Muavije b. Hajde r.a. se e ka pyetur Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "O i Dërguari i Allahut, prej *auret*-it tonë, çka na lejohet të shpalosim e çka jo?" Ai tha: *"Ruaje auretin tënd, përpos se ndaj gruas dhe atyre që ke në pronësi (robëreshat)".* Ky tha: "Po nëse janë njerëzit e përzier?" Ai tha: *"Nëse ka mundësi që asnjëri mos të të sheh, atëherë mos të të sheh askush!".* Ky tha: "Po nëse dikush është vetëm?" Ai tha: *"Allahu është më meritorë që ndaj Tij të kemi turp sesa ndaj njerëzve".*[349]

Këtë këshillë, le ta marrin të gjithë ata që lejojnë të përhapet devijimi në familjet e tyre, duke lejuar që gratë dhe vajzat të zbulojnë *auret*-in e vet, të dalin në rrugë sikur që dalin pabesimtaret, e kështu duke larguar edhe Mëshirën e Zotit prej vetes duke tërhequr mbi vete mallkimin dhe dënimin i cili nuk ngel vetëm për botën tjetër, por ndodh edhe në këtë botë.

[348] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Edebi, bab ma xhae fil istitari indel xhima, nr.2800 dhe thotë se është garib;

[349] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Hammamu, bab ma xhae fi`t-tearri, nr.4017; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Edebi, bab ma xhae fi hifdhi`l-aureti, nr.2769 dhe thotë se hadithi është Hasen; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab en-Nikahi, bab tesetturu indel-xhima, nr.1920; Ahmed-i, "Musned", 33/235, nr.20.034; e shënon edhe Buhariu si *mualek* në titullin meni`g-tesele urjanen vahdehu fil halveti në kapitullin e Guslit; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, thotë se ky hadith është me zinxhir Hasen;

HADITHI I TRIDHJETËEPESTË (35)

حَدَّثَنَا زِيَادُ بْنُ أَيُّوبَ قَالَ: حَدَّثَنَا مُبَشِّرُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ الحَلَبِيُّ، عَنْ تَمَّامِ بْنِ نَجِيحٍ، عَنْ الحَسَنِ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " مَا مِنْ حَافِظَيْنِ، رَفَعَا إِلَى اللَّهِ مَا حَفِظَا مِنْ لَيْلٍ أَوْ نَهَارٍ، فَيَجِدُ اللَّهُ فِي أَوَّلِ الصَّحِيفَةِ وَفِي آخِرِ الصَّحِيفَةِ خَيْرًا، إِلَّا قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: أُشْهِدُكُمْ أَنِّي قَدْ غَفَرْتُ لِعَبْدِي مَا بَيْنَ طَرَفَيِ الصَّحِيفَةِ "

Transmeton Enes b. Maliku (r.a.) se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Çdo herë që dy melekët shkrues ngriten për tek Allahu me atë që kanë regjistruar, qoftë natën* ose *ditën, e Allahu gjen të shkruar në fletën e parë dhe të fundit vepër të mirë, e të mos thotë Allahu xh.sh.:* ***"Ju marrë dëshmitarë se Unë ia kam falur robit Tim atë që është e shkruar në mes këtyre fletëve".***[350]

[350] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 9, nr.983; Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", 13/218, nr.6696 dhe thotë se e përcjell përmes Hasenit nga Enesi vetëm Temam b. Nexhihu të cilit i vlen hadithi; Ebu Ja`la, "Musned", fq.570, nr.2776; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 9/273, nr.6652; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/251, nr.17.580 thotë: "E përcjell Bezzari, aty gjendet Temam b. Nexhihu të cilin e ka konsideruar të besueshëm Ibni Meini dhe të tjerë, kurse të dobët e kanë konsideruar Buhariu dhe të tjerë, kurse transmetuesit tjerë, janë transmetues që gjenden në Sahihe"; Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sunenit të Tirmidhiut (2/472), për këtë hadith thotë se e ka zinxhirin e dobët, shkaku i dobësisë së Temam b. Nexhihut..". Ibni Xheuzi në "Ilel`ul-Mutenahije" (1/33, nr.28) thotë se "ky hadith nuk është Sahih. Ibni Hibani thotë se Temami përcjell hadithe të falsifikuara nga transmetues të besueshëm. Dhe Ibni Adij thotë se ai nuk është i besueshëm"; Ebu Hatim er-Razi thotë se "është i refuzuar në hadith dhe i mbaruar. Po ashtu thotë se Ebu Zur`a e ka konsideruar jo të fuqishëm dhe të dobët. Gjithashtu kur është pyetur imam Ahmedi për të ka thënë se nuk ia njeh gjendjen e tij të vërtetë. (Ebu Hatim er-Razi, "Xherh ve ta`dil", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1952, 2/445, nr.1788); Ibni Adij ka thënë: "Buhariu ka thënë se ndaj Temam b. Nexhihut ka pasur rezerva". Kurse Jahja b. Meini ka thënë se është i besueshëm. (Ibni Adij, "El-Kamil fi duafa", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, 2/279) Dhehebi-u e konsideron të dobët (shih: Dhehebi-u, "Kashif", Muessesetu`l-ulumi`l-Kuran, Xhide, botimi i parë, 1992, 1/279, nr.671); edhe Ibni Haxheri thotë se është i dobët (shih: Ibni Haxher-i, "Tekribu`t-Tehdhib", Bejtul Ifkar, Jordan, 2000, fq.181, nr.798).

Ky *hadith* përcillet edhe nga *sahabi*-të tjerë. Prej tyre është edhe *hadith*-i që e transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e fillon ditën me të mira dhe e mbaron me të mira, Allahu xh.sh. u thotë melekëve:* ***"Fshijeni dhe mos ia shkruani robit Tim mëkatet që ka kryer në mes tyre".***[351]

Edhe pse këto dy *hadith*-e kanë pasur vërejtje nga ana e kritikëve të *hadith*-it, përsëri përmbajtja e tij vërtetohet me tekste tjera autentike. Se njeriut i shkruhen veprat nga ana e dy melekëve regjistrues, vërteton *ajet*-i kuranor: **"Kurse ndaj jush janë përcjellësit (*Hafidhin)*! Janë shkrues të ndershëm te All-llahu. Ata e dinë se çka punoni".**[352]

Po ashtu, do të përmendim më vonë edhe *hadith*-in tjetër *kudsij* i cili dëshmon se melekët ndërrohen ditën dhe natën dhe dërgojnë veprimtarinë e njerëzve brenda ditës, e ky ndërrim bëhet gjatë namazit të sabahut dhe të ikindisë.

Por, në bazë të këtij *hadith*-i që kemi në shtjellim, shohim se Zoti shikon se si njeriu e ka filluar ditën dhe si e ka mbaruar. Nëse e ka filluar me të mirë dhe e ka mbaruar po ashtu me vepra të mira, atëherë Zoti ia fal atij njeriu veprat tjera të cilat janë kryer brenda asaj dite.

Nga ky transmetim, kuptojmë se sa i mëshirshëm është Zoti me robërit e Vet, saqë për pak vepra të mira, ia fshin veprat e këqija.

Ka shumë vepra të mira, të cilat janë arsyeja që njeriu të fitojë faljen e Allahut xh.sh. dhe të fitojë shpërblime të shumta, edhe pse puna është e paktë. Prej këtyre veprave me të cilat ne e fillojmë ditën mbarë, është falja e namazit të sabahut dhe në fundin e ditës duke falur namazin e jacisë. Këto janë vepra me të cilat njeriu e fillon dhe e mbaron ditën me vepra të mbara.

Kërkimi i faljes prej Zotit në përfundim të ditës, është prej veprave që ka vlerë të madhe tek Zoti dhe është shkak për faljen e mëkateve. Transmeton Ebu Seidi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë kur të shkojë në shtratin e tij tri herë: "Estagfirullahe`l-ledhi la ilahe il-la huvel hajjul kajjum ve etubu ilejhi" do t`i falen mëkatet po edhe sikur të jenë sa shkuma e detit, edhe sikur të jenë sa numri i drunjëve (në botë) dhe*

[351] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 9/273, nr.6651; Muhtar Ahmed en-Nedevij në verifikim të veprës së Bejheki-ut, për këtë hadith thotë se nuk është i fortë;
[352] Kurani, Infitar, 10-12;

të ketë mëkate sa rëra në shkretëtirë, ose *të ketë mëkate sa numri i ditëve të kësaj bote".*[353]

Edhe *dhikr*-i i mëngjesit dhe mbrëmjes është prej veprave që në fillim dhe në mbarim të ditës është *hajr.*

Transmeton Shedad ibn Eusi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Istigfari më i mirë është: "Allahumme ente rabbi, la ilahe il-la ente, halaktenij, ve ene abduke, ve ene ala ahdike, ve va`dike mes-teta`tu, eudhu bike min sherri ma sana`tu, ebu`u leke bi ni`metike alejje, ve ebu`u leke bi dhenbij, fagfirlij, feinnehu la jagfirudh`dh-dhunube il-la ente*". Tha: *"Kush e thotë këtë kur të shkojë të flejë dhe vdes po atë natë, do të jetë prej banorëve të Xhenetit, kush e thotë këtë kur të zgjohet në mëngjes dhe vdes atë ditë, do të jetë prej banorëve të Xhenetit"*.[354]

Po ashtu përcjell Theubani r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë në mbrëmje: Jam i kënaqur që Zoti im është Allahu, feja ime është Islami dhe Pejgamberi im është Muhamedi", është obligim i Zotit që ta kënaq atë".*[355]

Dhe *hadith*-e të kësaj natyre ka shumë, por ne nuk mund t`i përmendim të gjitha këtu që mos e humb libri tematikën e vet.

Pra, të jemi të kujdesshëm se si e fillojmë ditën dhe si e mbarojmë. Të mundohemi që veprat e para të ditës të jenë adhurimet si namazi, dhikri, leximi i Kuranit, lutjet dhe të ngjashme, si dhe të tilla të jenë veprat e fundit të ditës. Të mundohemi që veprat tona në fillim dhe në mbarim të ditës të jenë të mira, që të meritojmë faljen e Zotit për mëkatet tona.

---

[353] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 17, nr.3408 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib;

[354] Buhari-u, "Sahih", kitab ed-Da`avatu, bab efdalil istigfar, nr.6306; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Davat an Resulilah, bab 15, nr.3404; Nesai-u, "Sunen", kitab El-Istiadhetu, bab el istiadhetu min sherri ma sana`tu, nr.5524;

[355] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab ed-dua`u idha asbaha ve idha emsa, nr.3389 dhe thotë se është Hasenun-Garib;

DASHURIA E ALLAHUT PËR ROBËRIT E TIJ

HADITHI I TRIDHJETËEGJASHTË (36)

حَدَّثَنَا زُهَيْرُ بْنُ حَرْبٍ، حَدَّثَنَا جَرِيرٌ، عَنْ سُهَيْلٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " إِنَّ اللهَ إِذَا أَحَبَّ عَبْدًا دَعَا جِبْرِيلَ فَقَالَ: إِنِّي أُحِبُّ فُلَانًا فَأَحِبَّهُ، قَالَ: فَيُحِبُّهُ جِبْرِيلُ، ثُمَّ يُنَادِي فِي السَّمَاءِ فَيَقُولُ: إِنَّ اللهَ يُحِبُّ فُلَانًا فَأَحِبُّوهُ، فَيُحِبُّهُ أَهْلُ السَّمَاءِ، قَالَ ثُمَّ يُوضَعُ لَهُ الْقَبُولُ فِي الْأَرْضِ، وَإِذَا أَبْغَضَ عَبْدًا دَعَا جِبْرِيلَ فَيَقُولُ: إِنِّي أُبْغِضُ فُلَانًا فَأَبْغِضْهُ، قَالَ فَيُبْغِضُهُ جِبْرِيلُ، ثُمَّ يُنَادِي فِي أَهْلِ السَّمَاءِ إِنَّ اللهَ يُبْغِضُ فُلَانًا فَأَبْغِضُوهُ، قَالَ: فَيُبْغِضُونَهُ، ثُمَّ تُوضَعُ لَهُ الْبَغْضَاءُ فِي الْأَرْضِ "

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, kur Allahu e donë një rob, e thërret Xhibrilin dhe i thotë:* ***"Unë e dua filanin, andaj duaje edhe ti"*** dhe thotë: "*Më pas do ta dojë Xhibrili i cili do të thirr në qiell dhe do të thotë: "Me të vërtetë, Allahu e do filanin dhe unë e dua", e do ta dojnë edhe banorët e qiellit"* dhe thotë: "*E ai do të jetë i pranuar edhe në Tokë, e kur e urren një rob, e thirr Xhibrilin dhe i thotë:* ***"Unë e urrej filanin, andaj urreje edhe ti"*** dhe thotë: *"Fillon ta urrejë Xhibrili dhe thirr në banorët e qiellit se Zoti e urren filanin, andaj ta urreni edhe ju"* dhe thotë: "*Fillojnë ta urrejnë dhe ai bëhet i urryer edhe në tokë".*[356]

Theubani r.a. e përcjell një *hadith* të ngjashëm nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili ka thënë: *"Me të vërtetë, robi do të kërkojë kënaqësinë e Zotit dhe nuk do të ndalojë nga kjo, derisa Zoti do t`i thotë Xhibrilit:* ***"Filan robi Im kërkon që të Jem i kënaqur me të, me të vërtetë atij i takon Mëshira Ime".*** *Atëherë, Xhibrili thotë: "Mëshira e Allahut është*

[356] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 48, nr.2637; me tekst më të shkurtë e shënon edhe Buhari-u në "Sahih", kitab el-Edebu, bab 41, nr.6040; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsir`ul-Kuran, bab sure Merjem, nr.3172 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih;

mbi filanin". Këtë e thonë edhe bartësit e Arshit, e më pas ata që janë afër tyre, gjersa kjo thuhet në banorët e shtatë qiejve, e më pas zbret në tokë".[357]

Dashuria e Zotit për robërit e tij të mirë, është e vërtetë dhe ai i do ata të cilët janë të dëgjueshëm dhe të nënshtruar vetëm Atij. Mu për këtë shkak, Ai thërret Xhibrilin a.s. melekun më të zgjedhur, që t`ia kumtojë dhe t`ia tregojë këtë dashuri për këtë rob. M`u thirrja e *melek*-ut më të zgjedhur, tregon për pozitën e këtij robi tek Allahu xh.sh. Kur Xhibrili a.s. kupton dashurinë e Zotit për këtë rob të mirë, atëherë bëhet i dashur edhe tek ai dhe fillon ta dojë, saqë shkon dhe thirr tek banorët e qiellit, e bëhet i dashur edhe tek ata. Kur të ndodh kjo, atëherë bëhet i dashur edhe në tokë tek njerëzit tjerë, kështu e duan këtë njeri të gjithë.

Njeriu i tillë bëhet i dashur në zemrat e besimtarëve të sinqertë, kurse tek pabesimtarët dhe munafikët, ai ngelet i urrejtur, sepse ata kanë mllef në zemrat e tyre për besimtarët e vërtetë. Kjo kategori, kanë pasur urrejtje edhe ndaj krijesave më të mira, ndaj pejgamberëve. Thotë Zoti në Kuran: **"Kështu Ne kemi bërë për çdo pejgamber armiq nga ana e zullumqarëve...".**[358]

Apo *ajet*-i: **"Kështu Ne kemi bërë armiq për çdo pejgamber armiq prej shejtanëve, nga mesi i njerëzve dhe xhinëve...".**[359]

Imam Tirmidhi-u kur e shënon këtë *hadith,* e sjell me një shtesë në tekst, në të cilin gjendet edhe *ajet*-i: **"Nuk ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t`u krijojë dashuri".**[360]

Taberi-u në koment të këtij *ajeti*, thotë se Zoti do të krijojë në këtë botë dashuri në zemrat e besimtarëve për ata të cilët besuan dhe vepruan punë të mira. Për këtë, është edhe transmetimi nga Ibni Abasi r.a. i cili në lidhje me

[357] Ahmed-i, "Musned", 37/87, nr.22.401; Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", 2/57-58, nr.1240 dhe thotë se ky hadith nga Theubani nuk përcillet me ndonjë rrugë tjetër përpos kësaj, me këtë veçohet Mejmuni; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/242, nr.17.539 thotë: "E transmeton Ahmedi, e transmetuesit e tij janë transmetues të Sahihut, përpos Mejmun b. Axhlan-it, i cili është i besueshëm"; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmed-it, për këtë hadith thotë se zinxhiri i tij është Hasen;
[358] Kurani, Furkan, 31;
[359] Kurani, En`am, 112;
[360] Kurani, Merjem, 96;

këtë *ajet*, ka thënë se do të krijojë dashuri tek njerëzit për ta.[361] Kjo përcillet nga Muxhahidi, Katade dhe nga të tjerë.[362]

Sa i përket dashurisë së Zotit ndaj robërve të mirë, vërtetohet edhe me *ajet*-e të shumta. Prej tyre mund të përmendim *ajet*-in: **"Bëni vepra të mira, sepse me të vërtetë Allahu i do bamirësit".[363]** Po ashtu thotë: **"...Me të vërtetë, Allahu i do ata që pendohen dhe i donë ata që pastrohen".[364]** Në ndërlidhje me këtë *ajet*, është edhe *ajeti*: **"..me të vërtetë, Allahu i donë të devotshmit".[365]** Këtë e thotë edhe për durimtarët: **"...Allahu i donë durimtarët".[366]** Kështu është edhe me ata që i mbështeten Atij plotësisht: **"...Allahu i donë ata që i mbështeten Atij".[367]** Po ashtu edhe me atë që mban drejtësi është dashuria e Allahut. Thotë Zoti në Kuran: **"...Allahu i donë ata që gjykojnë me drejtësi".[368]** Dhe *ajet*-e tjera. Prej gjithë kësaj, mësojmë se me çfarë e meriton njeriu dashurinë e Zotit, pra, me besim dhe bëmirësi, me moral, përqëndrueshmëri dhe vepra me të cilat Zoti është i kënaqur.

Besimtari mysliman, duhet të bëjë përpjekje maksimale që ta fitojë këtë dashuri, sepse është dashuri e cila meriton që për të të jepet edhe jeta. A nuk keni parë se si njerëz të ndryshëm vriten dhe japin jetën për ndonjë vajzë ose djalë, kurse ne habitemi se si myslimanët sakrifikojnë jetën dhe pasurinë në luftë për hir të Allahut, kjo sakrificë vjen vetëm në sajë të dashurisë së zjarrtë për Zotin. Dikush lufton për hir të shtetit dhe kryetarit, e askush nuk e kritikon, por kur dikush lufton për kënaqësinë e Zotit, ai kritikohet dhe nënçmohet nga disa njerëz.

Për të arritur Dashurinë e Zotit, duhet të largohemi edhe nga kënaqësitë dhe mashtrimet e shumta të kësaj bote dhe Ai do të na dojë. Në këtë drejtim ia vlen të përmendim hadithin që e transmeton Sehël b. Sa`di r.a. se një njeri erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më udhëzo në atë punë, e cila nëse e punoj, do të më dojë Allahu

[361] Taberi-u, "Xhamiu`l-Bejan an Te`vili`l-Kuran", vëll.15, fq.642;
[362] Po aty;
[363] Kurani, Bekare, 195;
[364] Kurani, Bekare, 222;
[365] Kurani, Ali Imran, 76;
[366] Kurani, Ali Imran, 146;
[367] Kurani, Ali Imran, 159;
[368] Kurani, Maide, 42;

dhe do të më duan njerëzit?!" Ai tha: *"Mos e lakmo këtë botë, do të dojë Allahu, e mos lakmo në atë që kanë njerëzit, do të duan njerëzit".*[369]

Zoti kur dëshiron të ngrejë lart ndonjë besimtar, e ngrit atë pa ndihmën e njerëzve, por edhe atë të cilin Zoti e nënçmon, s`ka kush që i jep vlerë më pas. Transmeton Umeri r.a. se Allahu xh.sh. thotë: ***"Kush tregon ndaj Meje modesti kështu*** (Umeri kishte dorën e tij në tokë) ***Unë e ngrej kështu*** (Umeri e ngriti dorën drejt prej tokës në drejtim të qiellit)".[370]

Si dhe transmetimi nga Enes b. Maliku r.a. që Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu më ka shpallur mua:* ***"Tregoni modesti dhe mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit".***[371]

Vetë i Dërguari i Zotit sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur iu ofrua mundësia të zgjedh në mes të qënurit pejgamber mbret apo pejgamber rob, ai zgjodhi këtë të dytën nga modestia dhe dëshira për të fituar Kënaqësinë dhe Dashurinë e Zotit. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"U ul Xhibrili te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe shikoi kah qielli, kur zbriti një melek, e Xhibrili tha: "Ky melek nuk ka zbritur që kur është krijuar, përpos në këtë çast", e kur zbriti tha: "O Muhamed, më dërgoi Zoti tek ti (me porosinë):* ***"A donë të jesh pejgamber mbret, do ta mundësojë, apo dëshiron të jesh rob dhe i dërguar?!"*** *Xhibrili tha: "Trego modesti ndaj Zotit o Muhamed".* Ai tha: *"Jo, por dua të jem rob dhe i dërguar".*[372]

---

[369] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab zuhdu fi`d-dunja, nr.4102;

[370] Ahmed-i, "Musned", 1/399, nr.309; Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", 1/278, nr.175; Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", 8/172, nr.8307; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.10, fq.453, nr.7786; por ky *hadith* me këtë formë është *meukuf* (hadith i ndalur tek sahabiu, pa u përmendur Pejgamberi salallahu alejhi ve selem). Hadith të ngjashëm shënon edhe Muslimi në "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 19, nr.2588 nga Ebu Hurejre r.a. por jo si hadith kudsij; Mundhiri-u, "Tergib ve`t-Terhib", 3/351, nr.4393 dhe thotë: "E transmeton Ahmedi dhe Bezzari, përmes transmetuesve që gjenden në Sahihe..."; Hejthemiu, "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/102, nr.13.067 thotë: "E transmeton Ahmedi, Bezzari dhe Taberani në "Euset"... e transmetuesit te Ahmedi dhe Bezzari janë transmetues të Sahiheve, kurse te transmetimi i Taberanit gjendet Seid b. Selam el-Atari i cili është gënjeshtar"; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmedit, për këtë hadith thotë se është me zinxhir Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit...".

[371] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab beg`j, nr.4214; Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", nr.426; Busiri-u në "Zevaid", thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Hasen, shkaku i emrit të Sinan b. Sa`dit apo Sa`d b. Sinan;

[372] Ahmed-i, "Musned", 12/76, nr.7160; Hejthemi-u, "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/417, nr.14.209 dhe thotë: "E transmeton Ahmedi, Bezzari dhe Ebu Ja`la, e transmetuesit e të parit janë transmetues të Sahiheve". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të

Ngjashëm është edhe puna me atë të cilin Zoti e urren, e në këtë rast, përsëri e thirr Xhibrilin a.s. dhe i tregon për urrejtjen që ka ndaj atij personi, e ai bëhet i urrejtur edhe tek Xhibrili a.s. dhe tek banorët e qiellit, e kur të vijë në këtë pozitë, atë do ta urrejnë edhe njerëzit tjerë.

Shkaqet e urrejtjes së Zotit ndaj këtij njeriut mund të jenë të ndryshme, porse Kurani na shpjegon se kush janë këta fatkqinjë. Thotë Zoti: **"...me të vërtetë, Allahu nuk i donë kafirët".**[373] Kësaj grupe i bashkangjiten ata që bëjnë *fesad*, çrregullime, padrejtësi, e vepra tjera të këqija, siç thotë Zoti: **"...Allahu nuk i donë zullumqarët".**[374] dhe thotë: **"...Allahu nuk i donë ata që bëjnë çrregullime".**[375] Ngjashëm me ta janë edhe ata që kalojnë kufitë dhe zhyten në mëkate. Thotë Zoti: **"...Allahu nuk i donë ata që kalojnë kufijtë (e fesë)"** [376] po ashtu thotë: **"...Allahu nuk i donë pabesimtarët mëkatarë".**[377]

Për të shpëtuar nga kjo fatkeqësi, duhet njeriu të largohet nga veprat të cilat Zoti i ka ndaluar dhe nuk është i kënaqur me to. Përndryshe, do të jemi të urryer në qiej e në tokë.

Nga ky *hadith*, po ashtu kuptojmë se Zoti posedon cilësinë e Kënaqësisë dhe Hidhërimit, siç thotë imam Ebu Hanife: "..Hidhërimi i Tij dhe Kënaqësia e Tij janë dy cilësi prej cilësive të Tij pa modalitetin `si`".[378] Edhe imam Tahaviu thotë: "Zoti ka zemërim dhe kënaqësi, por jo si ato të ndonjë qenieje njerëzore".[379]

Ahmedit, për këtë hadith thotë: "Zinxhiri i hadithit është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit...";

[373] Kurani, Ali Imran, 32;
[374] Kurani, Ali Imran, 57;
[375] Kurani, Maide, 64;
[376] Kurani, Bekare, 190;
[377] Kurani, Bekare, 276;
[378] Ebu Hanife, "Fikhu`l-Ekber", fq.49;
[379] Tahavi-u, "Akidja e imam Tahavit", fq.92;

HADITHI I TRIDHJETËESHTATË (37)

أَخْبَرَنَا أَبُو عَبْدِ اللهِ الْحَافِظُ، نا أَبُو الْفَضْلِ مُحَمَّدُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، نا إِسْمَاعِيلُ بْنُ يَحْيَى بْنِ حَازِمٍ السُّلَمِيُّ، نا الْحُسَيْنُ بْنُ مَنْصُورٍ، حَدَّثَنَا مُبَشِّرُ بْنُ عَبْدِ اللهِ، عَنْ نَهْشَلٍ، عَنْ دَاوُدَ بْنِ أَبِي هِنْدٍ، عَنِ الْحَسَنِ، " أَنَّ بَنِي إِسْرَائِيلَ، سَأَلُوا مُوسَى عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالُوا: سَلْ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا عَلَمَ رِضَاهُ، عَنَّا وَعَلَمَ سَخَطِهِ؟ فَسَأَلَهُ فَقَالَ: يَا مُوسَى، أَبْلِغْهُمْ أَنَّ رِضَايَ عَنْهُمْ أَنْ أَسْتَعْمِلَ عَلَيْهِمْ خِيَارَهُمْ وَأَنَّ سُخْطِيَ عَلَيْهِمْ أَنْ أَسْتَعْمِلَ عَلَيْهِمْ شِرَارَهُمْ "

Transmeton Haseni se beni Israilët e pyetën Musën a.s. duke i thënë: "Pyete për ne Zotin që të na qartësojë neve shenjën e kënaqësisë së Tij ndaj nesh dhe shenjën e pakënaqësisë së Tij". (Musai a.s.) e pyeti, kurse Ai i tha: **"*O Musa, lajmëroi ata se kënaqësia Ime ndaj tyre tregohet kur e bëj të mundur që në krye të tyre të vijnë njerëzit më të mirë, ndërsa pakënaqësia Ime ndaj tyre është kur të udhëhiqen nga njerëzit më të këqinj".***[380]

Ky *hadith* është i shkëputur (*mursel*) në zinxhirin e tij, pasi Hasen el-Basriu e përcjell këtë lajm pa e përmendur *sahab*-iun dhe Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem, porse ne e shënojmë pasi në të ka urtësi, të cilën shpresojmë që ta marrim nga ky tekst i përcjellur. Edhe pse *hadith*-i është i dobët, përsëri dijetarët kanë lejuar të përdoren këto *hadith*-e nëse nuk janë prej *hadith*-eve që flasin për besimin ose për hallallin dhe haramin, porse flasin vetëm për nxitje, stimulim dhe qortim.

Beni Israilët i kanë parashtruar pyetje të ndryshme Musait a.s. që në disa raste ishin provokative, ndonjëherë për të marr mësim dhe dije. Në këtë tekst, shohim se pyetja nuk ka konotacion provokativ, porse aludohet në

[380] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.9, fq.491, nr.7003; Muhtar Ahmed Nedeviu në verifikim të kësaj vepre, thotë se hadithi është shumë i dobët, pasi Nehshel i cili quhet Ibni Seid el-Verdani është *metruk* dhe Is`hak b. Rehevejhi e ka përgënjeshtruar atë;

përfitimin e diturisë në lidhje me shenjat e kënaqësisë së Zotit ndaj robërve të Tij.

Pasi Musa a.s. ishte bashkbisedues me Zotin i Cili i fliste pa ndërmjetësim, e mori përgjigjen menjëherë, duke ia bërë me dije se shenjë e kënaqësisë së Zotit ndaj tyre, është kur udhëheqës i tyre do të vijë njeriu më i mirë në mesin e tyre, më i ndershmi dhe i drejti. Kështu në mes tyre më pas u dërgua Taluti si mbret,[381] pas tij Davudi a.s. dhe Sulejmani a.s. të cilët ishin edhe mbretër edhe pejgamberë.

Kurse për shenjën e pakënaqësisë së Zotit ndaj tyre, Musa a.s. mori lajmin se kur të vijë udhëheqës i tyre njeriu më i keq në mesin e tyre, atëherë kjo është shenjë e hidhërimit të Zotit ndaj tyre.

Nuk është habi që sot shohim se shumica e udhëheqësve janë zullumqarë dhe të këqinj, të cilët nuk kanë asnjë meritë për atë pozitë, porse janë udhëheqës të popullit, e kjo është një shenjë e qartë se Zoti është i hidhëruar me këta njerëz, të cilët kanë lejuar në mesin e tyre të përhapet e keqja dhe të dominojë padrejtësia.

Në histori, shohim udhëheqës të cilët kanë qenë të drejtë me popullatën, si rasti i Ebu Bekrit r.a., Umerit r.a., Uthmanit r.a., Aliut r.a. Umer b. Abdulazizit e të tjerë, por edhe të padrejtë dhe tiran si Jezidi, Haxhaxhi dhe shumë të tjerë.

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na ka paralajmëruar për ardhjen e njerëzve të padrejtë në pozita udhëheqësie. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Do të ketë në kohën e fundit udhëheqës të padrejtë, vezirë të prishur, gjykatës të korruptuar, juristë gënjeshtar..."*.[382]

Por, padrejtësia të cilën e bëjnë këta njerëz, do të paguhet në Ditën e Gjykimit, qofshin ata kryetarë, gjykatës, juristë, e pozita tjera udhëheqësie. Kemi edhe një *hadith kudsi* i cili flet për rrezikun e gjykimit në mesin e njerëzve. Transmeton Abdullah b. Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ka gjykatës, i cili gjykon në mesin e njerëzve, e të mos vijë në Ditën e Kijametit duke u mbajtur për qafe nga ana*

[381] Shih: Kurani, Bekare, 246-251;
[382] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.4, fq.277, nr.4190;

e një meleku, i cili mbanë kokën (shikimin) lart në qiell, e nëse i thuhet: ***"Hidhe",*** *ai e hedh atë në një greminë të thellë katërdhjetë vite".*[383]

Këta udhëheqës, do të jenë njerëzit më të urryer në Ditën e Kijametit, kurse të mirët, përkundrazi, do të jenë më të dashurit. Për këtë, shërben hadithi nga Ebu Seid el-Hudriju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njerëzit më të dashur në Ditën e Kijametit tek Allahu dhe më afër meje, do të jenë udhëheqësit e drejtë, kurse njerëzit më të urryer tek Zoti në Ditën e Kijametit dhe që do të kenë dënim më të ashpër, do të jenë udhëheqësit e prishur".*[384]

Siç thamë edhe më herët, ndonjëherë njerëzit janë meritor që të vjen një udhëheqës i padrejtë dhe zullumqarë. Transmeton Ebu Is`haku se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Si do të jeni, ashtu edhe do të udhëhiqeni".*[385]

Kurse udhëheqësi i drejtë, do të ketë mirësi dhe atij i pranohet lutja te Zoti. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre personave, Zoti nuk ua refuzon lutjen: "Ai që bën shumë dhikër, lutjen e atij që i është bërë padrejtësi dhe lutjen e udhëheqësit të drejtë".*[386]

Një ditë e vetme e udhëheqësit të drejtë, bart me vete mirësi të shumta. Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Një ditë e udhëheqësit të drejtë, është më e mirë sesa 60 vjet adhurim, kurse zbatimi i një vendimi fetar (hadd) në tokë, është më i pastër ose më i dobishëm sesa të bie shi 40 mëngjese".*[387]

---

[383] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ahkam, bab et-taglidhu fi`l-hajfi ve`r-reshveti, nr.2311; Ahmed-i, "Musned", 7/173, nr.4097; Busiri-u thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, shkaku i dobësisë së Muxhalid b. Seidit; Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sunenit të Ibni Maxhes dhe Musnedit të Ahmedit, thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, shkaku i Muxhalidit; për Muxhalidin, Nesaiu thotë: "I dobët". (Nesai-u, "Duafau vel metrukin", Bejrut, botimi i parë, 1985, fq.223, nr.579); Buhari-u thotë: "Jahja el-Kattani e ka konsideruar të dobët, Ibni Mehdiu nuk ka përcjellur prej tij kur përcjell prej Sha`biut dhe Kajsit... Ahmedi thotë se ai nuk është asgjë". (Buhari-u, "Duafau`s-Sagir", Daru`l-Ma`rife, Bejrut, 1986, fq.116, nr.368);

[384] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Ahkami, bab ma xhae fil imamil adil, nr.1334 dhe thotë se është Hasen; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.9, fq.474, nr.6981;

[385] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.9, fq.492, nr.7006;

[386] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.9, fq.469, nr.6973;

[387] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.9, fq.482, nr.6995;

Por, kur Zoti dëshiron të shkatërrojë një popull, urdhëron parinë e atij vendi që të jenë kundërshtues, atëherë mbi ta vjen caktimi i Zotit. Allahu xh.sh. thotë në Kuran: **"Kur duam ta shkatërrojmë ndonjë vend, i urdhërojmë parisë së tyre, e ata kundërshtojnë, atëherë zbatohet dënimi i merituar kundër tyre dhe i shkatërrojmë krejtësisht".**[388] Po ashtu thotë: **"Dhe ashtu në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari...".**[389]

Nga kjo shohim se Zoti ka bërë që kur të prishet morali i popullatës dhe të devijojnë nga rruga e drejtë, të udhëhiqen nga paria e padrejtë dhe tirane. Allahu xh.sh. i shkatërron njerëzit kur ato bëhen të këqinj, ose përmes fatkeqësive natyrore, ose përmes udhëheqësve tiran. Zoti thotë në Kuran: **"...dhe Ne nuk shkatërruam vendbanimet, por vetëm kur banorët e tyre ishin zullumqarë".**[390]

Nga i gjithë ky elaborim, kuptojmë se duhet të kryejmë vepra që janë në kënaqësinë e Zotit, që Zoti të na jep të mira, përndryshe, do ta kemi fatin fatal sikur të shumë popujve tjerë të mëhershëm.

[388] Kurani, Isra, 16;
[389] Kurani, En`am, 123;
[390] Kurani, Kasas, 59;

HADITHI I TRIDHJETËETETË (38)

حَدَّثَنَا مِقْدَامٌ، ثَنَا عَلِيُّ بْنُ مَعْبَدٍ الرَّقِّيُّ، ثَنَا وَهْبُ بْنُ رَاشِدٍ، ثَنَا مَالِكُ بْنُ دِينَارٍ، عَنْ خِلَاسِ بْنِ عَمْرٍو، عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «إِنَّ اللَّهَ يَقُولُ: أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا، مَالِكُ الْمُلُوكِ وَمَلِكُ الْمُلُوكِ، قُلُوبُ الْمُلُوكِ فِي يَدِي، وَإِنَّ الْعِبَادَ إِذَا أَطَاعُونِي حَوَّلْتُ قُلُوبَ مُلُوكِهِمْ عَلَيْهِمْ بِالرَّأْفَةِ وَالرَّحْمَةِ، وَإِنَّ الْعِبَادَ إِذَا عَصَوْنِي حَوَّلْتُ قُلُوبَهُمْ عَلَيْهِمْ بِالسَّخْطَةِ وَالنِّقْمَةِ فَسَامُوهُمْ سُوءَ الْعَذَابِ، فَلَا تَشْغَلُوا أَنْفُسَكُمْ بِالدُّعَاءِ عَلَى الْمُلُوكِ، وَلَكِنِ اشْتَغِلُوا بِالذِّكْرِ وَالتَّضَرُّعِ إِلَيَّ أَكْفِكُمْ مُلُوكَكُمْ»

Transmeton Ebu Derda r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë jam Allahu, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje, jam Mbreti i mbretërve dhe Udhëheqësi i sunduesve, zemrat e mbretëve janë në "Dorën" Time, e nëse robërit më nënshtrohen Mua, Unë i zbus zemrat e mbretërve ndaj tyre që të jenë të sjellshëm dhe të mëshirshëm, e nëse robërit mëkatojnë ndaj Meje, e kthej zemrën e (mbretërve) kundër tyre me hidhërim dhe hakmarrje, e ndaj tyre kryejnë dënime të dhembshme, andaj mos u preokuponi ndaj mbretërve tuaj me lutje, por preokuponi me dhikër dhe nënshtrim ndaj Meje, do t`ju mjaftojë ndaj mbretëve tuaj".***[391]

Ky *hadith* ka ndërlidhshmëri me *hadith*-in e mëparshëm, në të cilin vërehet se Allahu xh.sh. bën që bazuar në sjelljen e njerëzve, do të vijnë edhe prijësit e tyre.

[391] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.9, fq.9, nr.8962; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", vëll.2, fq.388 dhe thotë se është Garib përmes Malikut kur përcillet si *Merfu,* e me këtë transmetim veçohet Ali b. Ma`bed nga Vehb b. Rashidi; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 5/322, nr.9272 thotë: "E transmeton Taberani në "Euset", por në zinxhir gjendet Vehb b. Rashidi, i cili është i braktisur (metruk)".

Në fillim Zoti na bën të qartë se Ai është meritori për adhurim, në vend të Tij nuk duhet të marrim askë për zot, qoftë ai melek, xhin ose mbret. Njerëzit në kohën e kaluar i kanë konsideruar udhëheqësit e tyre për zota. Siç edhe tha faraoni: **"Unë jam zoti juaj më i lartë".**[392] E Allahu xh.sh. na bën me dije se nuk duhet marrë askë për hyjni dhe adhurim përpos Tij, sepse Ai është Krijuesi dhe Furnizuesi jonë.

Udhëheqësit janë një pjesë nga populli, ato janë pasqyrë e popullit dhe populli është pasqyrë për to. Mbretërit dhe pushtetarët realisht nuk kanë në sundim asgjë, por aq sa ka dashur Allahu xh.sh. sepse Ai është që cakton kush do të jetë prijës. Atij i takon pushteti suprem dhe Ai është që prej robërve të Tij i jep sundimin në tokë për një kohë, e kur të dëshirojë Ai, e përmbys sundimin e tiranit. Siç thuhet në Kuran: **"O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përul atë që do dhe e lartëson atë që do. Çdo e mirë është në Dorën Tënde, vërtet Ti ke mundësi për çdo gjë".**[393]

Nëse pushteti do të ishte në duart e njerëzve, nuk do ta ndanin atë në mënyrë të drejtë dhe nuk do t`ia jepnin atë askujt përveç vetes, por Allahu xh.sh. cakton se sa do të zgjasë sundimi dhe mbretëria e tyre, e kur i vjen afati, ndoshta edhe në kulmin e fuqisë, i vjen vdekja dhe nuk mund ta shijojë kënaqësinë e sundimit të tij. Zoti thotë në Kuran: **"A mos kanë ata ndonjë pjesë të pushtetit? Ata nuk do t`u jepnin njerëzve as sa grimca".**[394]

Pushteti i njerëzve është tokësorë, kurse i Zotit është tokësorë dhe qiellorë, i kësaj bote dhe botës tjetër, siç thotë në Kuran: **"(Allahut) Të Cilit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës, e Allahu është dëshmitar i çdo sendi".**[395]

Në Ditën e Gjykimit do të humbin të gjithë zërat dhe askush nuk do të guxojë të flas, atë Ditë nuk krenohet askush me pushtetin e tij dhe nuk ka guxim të thotë se ai është mbret, por të gjithë do të pranojnë përgjigjen e njëjtë, kur Zoti do të pyes se kush është Mbreti i Vërtetë?! Të gjithë do të thuan "Allahu". Thuhet në Kuran: **"...Ditën kur ata do të dalin (prej varrezave) në shesh, e Allahut nuk mund t`i fshihet asgjë. (bëhet pyetja)**

[392] Kurani, Naziat, 24;
[393] Kurani, Ali Imran, 26;
[394] Kurani, Nisa, 53;
[395] Kurani, Buruxh, 9;

i kujt është pushteti sot? I Allahut, i Atij që është Një dhe i Fuqiplotë”.[396]

Pushteti i njerëzve është kalimtar, kurse pushteti i Zotit është i përhershëm. Pushteti i Zotit është i amshueshëm dhe nuk përfundon asnjëherë.

Kur njerëzit janë të dëgjueshëm dhe të nënshtrueshëm ndaj urdhërave të Allahut xh.sh., Ai u jep pushtet njerëzve të mirë dhe bën që në mesin e tyre të sundohet me drejtësi, atyre Zoti u mbjell mëshirë në zemër dhe ua japin të drejtat e tyre që u takojnë. Kështu ishin udhëheqësit e drejtë në kohën e *halif*-eve, të cilët nuk dëshironin të devijonin, por kërkonin nga ana e popullit që nëse shohin ndonjë vërejtje, t`i këshillojnë dhe t`i drejtojnë.

Por nëse njerëzit janë mëkatar dhe rebelohen kundër fesë dhe ligjit, atëherë Zoti bën që në mesin e tyre, të sundojë i padrejti dhe tirani, i cili pastaj do t`i shpërdorojë dhe nëpërkëmbë të drejtat e njerëzve, kështu që mosdëgjimi dhe mosnënshtrimi i tyre do të dënohet me tiraninë e udhëheqësve. Ata më pas do t`i dënojnë në mënyra çnjerrëzore dhe do t`i nënçmojnë, kështu që do të dënohen për largimin e tyre ndaj urdhrave të fesë.

Pra, si do të jenë populli, ashtu edhe do të vijë udhëheqësi i tyre, si shpërblim ose si dënim për sjelljen e tyre.

[396] Kurani, Gafir, 16;

HADITHI I TRIDHJETËENËNTË (39)

حَدَّثَنَا مِقْدَامٌ، ثَنَا أَسَدٌ، ثَنَا أَبُو بَكْرٍ الدَّاهِرِيُّ، نا ثَوْرُ بْنُ يَزِيدَ، عَنْ خَالِدِ بْنِ مُهَاجِرٍ، عَنْ عُمَرَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «ابْنَ آدَمَ عِنْدِكَ مَا يَكْفِيكَ وَأَنْتَ تَطْلُبُ مَا يُطْغِيكَ؟ ابْنَ آدَمَ لَا بِقَلِيلٍ تَقْنَعُ، وَلَا مِنْ كَثِيرٍ تَشْبَعُ؟ ابْنَ آدَمَ، إِذَا أَصْبَحْتَ مُعَافًى فِي جَسَدِكَ، آمِنًا فِي سِرْبِكَ، عِنْدِكَ قُوتُ يَوْمِكَ فَعَلَى الدُّنْيَا الْعَفَاءُ»

Transmeton Umeri (r.a.) se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"O biri i Ademit, ti ke atë që të mjafton, kurse ti kërkon atë që do të bëjë kryelartë?! O biri i Ademit, nuk kënaqesh me pak, e as nuk ngopesh me shumë?! O biri i Ademit, nëse zgjohesh i shëndoshë në trupin tënd, i sigurt në vendbanimin tënd, ke ushqimin e ditës tënde, atëherë mos kërko më shumë nga bota (dunjaja)".*[397]

Në këtë *hadith* të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na bëhet thirrje që të vlerësojmë atë që e posedojmë, e të mos synojmë atë që nuk mund ta arrijmë dhe që nuk na takon neve. Njeriu pranë vetes ka të gjitha gjërat që i mjaftojnë për një jetë normale, porse njeriu vazhdimisht është në kërkim të pasurisë, saqë harxhon tërë energjinë e tij për të arritur luksin në këtë jetë, por harron se ajo mund ta çojë në mendjemadhësi dhe të bëhet i padrejtë dhe i dhunshëm.

Njeriu nuk kënaqet me pak dhe vazhdon të kërkojë edhe *risk*-un e të ardhmes, edhe pse e ka *risk*-un e ditës së sotme. Disa njerëz aq shumë janë të dhënë pas kërkimit të pasurisë, saqë dëshirojnë që edhe stërnipërve të tyre t`ua sigurojnë jetën luksoze, kështu që harrojnë *ahiret*-in, nën preteksin se

[397] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.8, fq.361, nr.8875; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.13, fq.8, nr.9876; këta dy nuk e shënojnë këtë hadith si kudsij, por në disa transmetime, përmendet si i tillë andaj edhe duke e parë të nevojshëm për ta shënuar, e regjistruam në këtë koleksion; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/374, nr.18.086 thotë: "E shënon Taberani në "Euset", por në zinxhir gjendet Ebu Bekër ed-Dahiriju i cili është i dobët";

edhe puna është obligim, ndërsa atyre nuk u gjendet kohë asnjëherë për të kryer një *farz* që do ta shpëtojë në botën tjetër. Kjo është pasojë e kapitalizmit, i cili njerëzit i ka shndërruar në kërkues të materializmit dhe luksit të kësaj bote. Mu për këtë njerëzit e tillë, e ndiejnë veten të varfër, jo të varfër për ushqim, por të varfër për jetë luksoze. Këta njerëz, janë që kërkojnë vetëm të mirat e kësaj bote, siç thotë Zoti në Kuran: **"Ka disa prej njerëzve që thonë: "Zoti ynë, na jep Ti neve në këtë botë" për të nuk ka asgjë në botën tjetër".**[398]

Njeriu duhet ta ketë të qartë se në botën tjetër, pasuria nuk mund t`i ndihmojë asgjë, përpos atë që e ka shpenzuar për kënaqësinë e Zotit. Atje nuk ka ryshfet që të mendojë se përmes pasurisë do të shpëtojë. Është besimi dhe vepra e mirë ajo që e shpëton, siç thotë Zoti: **"Nuk janë as pasuria juaj e as fëmijët tuaj ajo që ju afron pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira...".**[399]

Njeriut kur i jepet pak, nuk është i kënaqur dhe vrapon tërë jetën duke u munduar të arrijë të tjerët. Por ky është një gabim që ndodh nga shumica e njerëzve, sepse vazhdimisht krahasohen me të tjerët në pasuri, famë e gjëra tjera, e harrojnë se me këtë veprim, ulin pozitën e tyre, ndërpresin mundësitë e zhvillimit të personalitetit të tyre dhe harrojnë të falënderojnë për atë që e posedojnë. Njeriu nuk ka nevojë të arrijë të tjerët që të jetojë i lumtur, mjafton t`ia dijë vlerën asaj që posedon, do të gjejë lumturinë. Sot shumë njerëz kanë arritur pasuri por nuk kanë gjetur lumturi. Me këtë kuptojmë se nuk është lumturia e njeriut në pasurinë e shumtë, por kënaqësi e vërtetë është të dish vlerën e asaj që posedon.

Njeriu kur posedon shumë, atëherë përsëri harron të falënderojë Zotin për atë të mirë dhe bie në nivelin e Karunit, i cili në kohën e Musës a.s. u krenua me pasurinë e tij dhe pretendoi se ajo nuk është arritur në saje të Mëshirës së Zotit por mendoi se dituria e vet e ka sjellë aty. Zoti e dënoi saqë e bëri shembull për të gjithë njerëzit në histori.[400]

Të gjithë pejgamberët e Zotit patën problem me pasanikët e vendbanimit ku ishin dërguar, pasi të pasurit mendonin se ata janë të privilegjuar shkaku i pasurisë së shumtë dhe se ata janë meritorët për të kontrolluar të gjitha ndodhitë në vend. Ata mendonin se pasi janë të pasur, do të mund të

[398] Kurani, Bekare, 200;
[399] Kurani, Sebe`, 37;
[400] Shih: Kurani, Kasas, 76-82;

mbrohen edhe prej dënimit të Zotit. Zoti thotë në Kuran: **"Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjë nga pejgamberët e që pasanikët e tij të mos i thonin: "Ne nuk i besojmë asaj me çka jeni dërguar". Ata thoshin: "Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e ne nuk do të jemi të ndëshkuar".**[401]

Njerëzit në këtë botë, harrojnë se pasuria është një mjet për të fituar botën tjetër, e nuk është qëllim për të cilin duhet harxhuar jetën. Pasuria është sprovë e Zotit për njerëzit, se cili do të jetë bujar, e cili do të jetë koprrac. Zoti thotë në Kuran: **"Dhe dine mirë se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë dhe se te Allahu është shpërblimi i madh".**[402] Pasuria është një stoli e kësaj bote, por nuk duhet të preokupohemi aq shumë me të, saqë të na bëhet barrë dhe dënim në botën tjetër. Zoti thotë në Kuran: **"Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, kurse veprat e mira janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë".**[403]

Zoti është Ai i Cili ka dalluar robërit mbi njëri-tjetrin, por që askujt nuk i ka bërë padrejtësi, sepse është Dëshira e Tij se kujt sa dhe çka do t`i jep. Njeriu nuk është furnizues i familjes së vet që të vrapojë tërë jetën që t`u sigurojë jetesën, por është Allahu xh.sh. që kujdeset për çdo krijesë. Zoti thotë në Kuran: **"Allahu favorizoi disa prej jush mbi disa të tjerë në furnizim. Atyre që u është dhënë përparësia (në furnizim), nuk janë furnizues të atyre që posedojnë, ata (të gjithë) në të janë të barabartë (furnizues kryesorë është Allahu). A mos duan të mohojnë dhuntinë e Allahut?".**[404]

Po ashtu thotë: **"Thuaj: "Allahu ia shumon begatinë atij që do, e edhe ia pakëson, por shumica e njerëzve nuk e dinë".**[405] Pra, nëse Allahu xh.sh. do, ia shton pasurinë dikujt, por kjo nuk do të thotë se e donë më shumë se të tjerët, por edhe dikujt ia pakëson, edhe kjo nuk nënkupton se Zoti atë e urren. Dikujt Zoti i jep pasuri dhe e sprovon se si do të sillet me të, më pas përsëri ia pakëson pasurinë dhe e lë të dëshpëruar. Thotë Zoti në Kuran: **"E njeriu kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, ai thotë: "Zoti**

[401] Kurani, Sebe`, 34-35;
[402] Kurani, Enfal, 28 dhe Tegabun, 15;
[403] Kurani, Kehf, 46;
[404] Kurani, Nahël, 71;
[405] Kurani, Sebe`, 36;

im më ka nderuar". Por kur për ta sprovuar ia pakëson furnizimin, ai thotë: "Zoti im më ka nënçmuar".[406]

Jeta e kësaj bote dhe pasuria pas së cilës vrapojmë tërë kohën, është vetëm një iluzion, i cili do të shkatërrohet në momentin e parë që do të shohim realitetin e botës tjetër. Kjo botë është një lojë dhe një mashtrim, saqë mendojmë se do të ngelemi në këtë botë përgjithmonë, e harrojmë se është jetë e shkurtë dhe kalimtare. Zoti thotë në Kuran: **"Ju njerëz dinie se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtim të pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë verdhë, mandej bëhet e thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga Allahu, pra, jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues".[407]**

Zoti tregon se kush e jep pasurinë për hir të Allahut, do të jetë larg Zjarrit të Xhehenemit dhe do të gëzojë kënaqësitë e Xhenetit. Zoti thotë në Kuran: **"Ndërsa ai që është më i devotshëm, do të jetë larg tij. Ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet. E jo për ta shpërblyer dikë që i ka bërë mirë më parë, por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të lartit".[408]**

Kurse ai i cili vetëm e tubon pasurinë dhe mundohet ta shumëzojë, kurse aspak nuk e kujton Allahun xh.sh. dhe botën tjetër, nuk jep zekat e sadaka e as që ndihmon nevojtarin, ai do të jetë prej të dëshpëruarve në botën tjetër. Zoti na bëri me dije se njeriu harron të shpenzojë për të varfërit dhe jetimët, pasi i ka hyrë në zemër dashuria ndaj pasurisë dhe kësaj bote. Zoti thotë në Kuran: **"...ju nuk e përfillnit jetimin. Nuk e nxitni njëri-tjetrin për ta ushqyer të varfërin. Dhe ju hani me të madhe trashëgiminë. Dhe pasurinë e doni së tepërmi".[409]** Zoti na bën me dije se kjo është një cilësi që fundin e ka në Zjarr. Zoti thotë në Kuran: **"Juve u preokupoi përpjekja për shumimin (e pasurisë, fëmijëve, pozitës). Derisa të mos i vizitoni varezat. Jo nuk është ashtu! Gjithsesi këtë do ta kuptoni më vonë! Përsëri jo, jeni gabim! Më vonë do ta kuptoni! Jo, pse, sikur ta dinit me një dije të sigurt. Ju patjetër do ta shihni Xhehenemin. Mandje atë do**

[406] Kurani, Fexhër, 15-16;
[407] Kurani, Hadid, 20;
[408] Kurani, Lejl, 17-20;
[409] Kurani, Fexhër, 17-20;

ta shihni të bindur plotësisht. Pastaj, në atë ditë do të pyeteni për të mirat".[410] Po ashtu thotë: **"Mjerë për secilin që ofendon e përqesh. Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet. E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm. Jo, të mos mendojë ashtu! Sepse ai patjetër do të hidhet në Hutame, e çka din ti se ç`është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fortë".**[411]

Në *hadithin kudsi* që kemi në trajtim, Zoti pasi na bën me dije për cilësitë e ulta njerëzore, na rikujton që të jemi të kujdesshëm dhe të vlerësojmë jetën me atë që kemi, duke na thënë se jo vetëm pasuria materiale është vlerë, por pasuri edhe më e madhe është shëndeti i njeriut, sepse nëse njeriu sëmuret, e jep të gjithë pasurinë, vetëm e vetëm ta kthejë shëndetin në trup, edhe pse e ka harxhuar trupin për të fituar pasurinë, sepse në moment kur e humb shëndetin, fillon të vlerësojë se sa peshon pasuria e sa peshon jeta. Kështu që, nëse zgjohemi në mëngjes duke qenë të shëndetshëm, shkojmë në shtrat duke qenë të shëndoshë në trup, kjo është begati e madhe nga Zoti, sepse ka të tjerë të cilëve dita u fillon dhe u mbaron me sëmundje. Duhet të jemi falënderues ndaj Zotit pasi na ka dhënë shëndet dhe rehati në trup dhe na ka kursyer nga sëmundjet dhe vizitën në spital.

Më pas, Zoti na rikujton edhe një begati tjetër, e cila nuk fitohet me para dhe nuk është materiale, por nëse njeriut i mungon, jeta e tij do të jetë e vështirë edhe nëse ka shumë pasuri, e ajo është siguria. Nëse njeriu nuk është i sigurtë në vendbanimin e tij, atëherë nuk do të gjente rehati në shtëpinë dhe vendin e vet, me çka përsëri edhe në këtë rast, do të humbte kuptimi i pasurisë materiale. Sa shumë të pasur ka që jetojnë në frikë nga humbja e pasurisë dhe vjedhja e saj nga hajnat e ndryshëm. Sa ka të pasur, të cilët nuk flejnë qetë, duke u frikësuar për bizneset e tyre dhe tregtinë. Sa ka të tillë që frikësohen që mos kidnapohen ata ose ndonjë anëtar i familjes, me çka do të humbte pasurinë. Në të gjitha këto situata, shohim se njeriu nuk është i qetë dhe i mungon siguria, saqë shumë prej të tillëve, harxhojnë para të shumta në shoqata të sigurimeve, porse ato nuk mund të mbjellin në zemrën e njeriut sigurinë dhe largimin e frikës. Mu për këtë duhet kërkuar prej Zotit qetësi dhe siguri, të falënderojmë për atë që na ka bërë të sigurt në vendin tonë dhe nuk kemi frikë për jetën.

Një begati tjetër që Zoti e vë në fokus në këtë *hadith*, është edhe racioni ditor që konsumon njeriu. Shumë njerëz harrojnë të falënderojnë Zotin për

[410] Kurani, sure Tekathur;
[411] Kurani, Humeze, 1-6;

ushqimin të cilin e kanë në sofër të siguruar për atë ditë, por nxitojnë të sigurojnë ushqimin edhe për muajt e ardhshëm. Njeriu duhet të jetë falënderues fillimisht për atë që ka para vetes, e pastaj të mundohet ta sigurojë atë të ditës tjetër. Njerëzit sot lodhen psiqikisht duke punuar në dy ndërrime, duke punuar vetë ai, bashkëshortja, babai, nëna, djali dhe vajza, dhe përsëri në fund nuk është i kënaqur me atë që ka dhe nuk i kujtohet të bjer në *sexhde* për Allahun i Cili i dha mundësinë që të punojë, të hajë dhe të jetojë.

Pra, duhet të vlerësojmë drejt, nëse kemi shëndet, kemi siguri, kemi ushqim të një dite, kjo është e mjaftueshme që njeriu të falënderojë Zotin, kurse mbi këto, njeriu do të fillojë të harrojë *ahiret*-in dhe mund të përfundojë në mendjemadhësi dhe lakmi pas botës (dunjasë).

HADITHI I KATËRDHJETË (40)

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرٍ مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ الشَّافِعِيُّ مِنْ أَصْلِ كِتَابِهِ، ثنا مُحَمَّدُ بْنُ شَدَّادٍ الْمِسْمَعِيُّ، ثنا أَبُو نُعَيْمٍ، وَحَدَّثَنِي أَبُو مُحَمَّدٍ الْحَسَنُ بْنُ مُحَمَّدٍ السَّبِيعِيُّ الْحَافِظُ، ثنا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُحَمَّدِ بْنِ نَاجِيَةَ، ثنا حُمَيْدُ بْنُ الرَّبِيعِ، ثنا أَبُو نُعَيْمٍ، وَأَخْبَرَنَا أَبُو مُحَمَّدٍ الْحَسَنُ بْنُ مُحَمَّدِ بْنِ يَحْيَى ابْنُ أَخِي طَاهِرٍ الْعَقِيقِيّ الْعَلَوِيّ فِي كِتَابِ النَّسَبِ، ثنا جَدِّي، ثنا مُحَمَّدُ بْنُ يَزِيدَ الْآدَمِيُّ، ثنا أَبُو نُعَيْمٍ، وَأَخْبَرَنِي أَبُو سَعِيدٍ أَحْمَدُ بْنُ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو الْأَحْمَسِيُّ مِنْ كِتَابِ التَّارِيخِ، ثنا الْحُسَيْنُ بْنُ حُمَيْدِ بْنِ الرَّبِيعِ، ثنا الْحُسَيْنُ بْنُ عَمْرٍو الْعَنْقَزِيُّ، وَالْقَاسِمُ بْنُ دِينَارٍ قَالَا: ثنا أَبُو نُعَيْمٍ، وَأَخْبَرَنَا أَحْمَدُ بْنُ كَامِلٍ الْقَاضِي، حَدَّثَنِي يُوسُفُ بْنُ سَهْلٍ التَّمَّارُ، ثنا الْقَاسِمُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ الْعَزْرَمِيُّ، ثنا أَبُو نُعَيْمٍ، وَأَخْبَرَنَا أَحْمَدُ بْنُ كَامِلٍ الْقَاضِي، ثنا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ إِبْرَاهِيمَ الْبَزَّارُ، ثنا كَثِيرُ بْنُ مُحَمَّدٍ أَبُو أَنَسٍ الْكُوفِيُّ، ثنا أَبُو نُعَيْمٍ، ثنا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ حَبِيبِ بْنِ أَبِي ثَابِتٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا قَالَ: " أَوْحَى اللَّهُ تَعَالَى إِلَى مُحَمَّدٍ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: إِنِّي قَتَلْتُ بِيَحْيَى بْنِ زَكَرِيَّا سَبْعِينَ أَلْفًا، وَإِنِّي قَاتِلٌ بِابْنِ ابْنَتِكَ سَبْعِينَ أَلْفًا وَسَبْعِينَ أَلْفًا "

Transmeton Ibni Abasi r.a. i cili ka thënë: "Allahu xh.sh. i ka shpallur Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"**Unë për Jahjanë birin e Zekerijas kam vrarë 70.000, kurse për birin e bijës tënde, do të vrasë 70.000 dhe 70.000".***[412]

[412] Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.3, fq.195-196, nr.4822 dhe thotë se "zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, por ato (Buhariu dhe Muslimi) nuk e kanë shënuar", kurse imam Dhehebi-u në "Telhis" thotë se hadithi është sipas kushteve të imam Muslim-it; Ibni Xheuzi në "El-Mauduat", me verifikim të Abdurahman Muhamed Uthman, Mektebetu Selefije, Medine, botimi i parë, 1966, 1/408 thotë se ky hadith nuk është Sahih;

Allahu xh.sh. i donë robërit e Tij, sidomos ata të cilët janë të nënshtruar tërësisht, kurse kjo dashuri, është e pakufishme kur janë në pyetje pejgamberët e Zotit. Prej pejgamberëve që e përmend në këtë rast, është i Dërguari i Zotit, Jahja a.s. biri i Zekerijas a.s.

Allahu xh.sh. e pranoi lutjen e Zekerijas a.s. për të pasur fëmijë dhe e përgëzoi me lindjen e një djali me emrin Jahja, emër që nuk është përdorur më parë.[413] Ai ka qenë prej pejgamberëve të dalluar dhe të matur. Zoti thotë në Kuran: **"E duke u falur ai në faltore, melekët e thërrasin: "Allahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga Allahu, e që do të jetë prijës i matur dhe pejgamber nga të dalluarit".[414]**

Zoti e përmend se dita në të cilën është lindur ai dhe që ka vdekur i është dërguar selam dhe paqë. Ai thotë në Kuran: **"Dhe selam atij ditën kur u lind, ditën kur vdes dhe ditën kur do të ringjallet përsëri".[415]**

Allahu xh.sh. i dha urtësi Jahjasë që si fëmijë. Zoti thotë në Kuran: **"O Jahja, merre librin me shumë kujdes dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë".[416]**

Kur u rrit, iu dha nga ana e Zotit butësi, pastërti, respekt dhe të jetë i sjellshëm. Zoti thotë në Kuran: **"Dhe nga ana e Jonë i mundësuam të jetë i butë, i pastër dhe respektues. Edhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, e nuk ishte kryelartë dhe i padëgjueshëm".[417]**

Aq i pastër ka qenë prej mëkateve Jahja a.s. saqë i Dërguari i jonë sal-lallahu alejhi ve sel-lem e përshkruajti si njeriu i cili nuk ka pasur kontakt asnjëherë me mëkatin. Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ka asnjë prej bijve të Ademit e të mos ketë gabuar ose të ketë pasur për synim të bëjë mëkat, përpos Jahja b. Zekerijas a.s..."*.[418]

---

[413] Shih Kurani, ajetin: Merjem, 7;
[414] Kurani, Ali Imran, 39;
[415] Kurani, Merjem, 15;
[416] Kurani, Merjem, 12;
[417] Kurani, Merjem, 13-14;
[418] Ahmed-i, "Musned", vëll.4, fq.144-145, nr.2294, kurse shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se hadithi është i dobët shkaku i Ali b. Zejdit i cili gjendet në zinxhirin e transmetimit;

Përcillet se një herë *sahab*-ët ishin duke biseduar rreth vlerës së pejgamberëve, e dikush potencoi se Musa a.s. është bashkbisedues i Zotit, e dikush e përmendi Isaun a.s. si Fjalë e Zotit, kurse njëri përmendi se Ibrahimi a.s. është *halilullah*. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur i dëgjoi këto biseda, u tha: *"E ku është shehidi, biri i shehidit, i cili duke u frikësuar mëkatit, vishte rroba nga këmenda*[419] *dhe ushqehej me gjethe drunjsh".* Ibni Vehbi thotë se me këtë aludonte Jahjanë a.s.[420]

Ebu Seidi r.a. transmeton se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Pas tezakëve Jahjas dhe Isaut a.s., Hasani dhe Husejni do të jenë prej prijësve të rinisë së Xhenetit".*[421]

Rreth vdekjes së tij tregohen disa variante, sipas njërit version, një mbret kishte dëshiruar të martohet me vajzën e vëllait të vet, kurse Jahja a.s. e ka kundërshtuar këtë martesë, andaj ai ka urdhëruar që t`i pritet koka. Kurse versioni i dytë, është se gruaja e mbretit të Izraelit u dashurua në Jahjanë, por ai nuk ndiente nevojë për gra, e kur ajo pa refuzimin e tij, kërkoi prej burrit të saj që t`ia sjell kokën e Jahjas a.s., e ai ashtu veproi.[422]

Për vendin e vrasjes së tij ka dy mendime, njëri mendim thotë se është vrarë në Mesxhidu`l-Aksa, siç përcjell Theuriu nga A`meshi, e ky nga Shemre b. Atije i cili ka thënë: "Në shkëmbin e Bejtu`l-Makdisit janë vrarë 70 pejgamberë, prej tyre është edhe Jahja biri i Zekerijas a.s.". Kurse Seid b. Musejebi thotë: "Kur erdhi Buhtunasri në Damask, pa gjakun e Jahjas a.s. ende duke rrjedhur, e kur pyeti për të, atëherë dha urdhër që 70.000 njerëz të vriten, pastaj gjaku pushoi së rrjedhuri".[423]

Nuk thuhet rastësisht se historia përsëritet. Dhe zakonisht viktimë janë njerëzit e mirë dhe të drejtë. Fat të ngjashëm me atë të Jahjasë a.s. pati edhe nipi i Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Huseini r.a. biri i Aliut r.a. dhe Fatimes r.a.h.

Pas vdekjes së Muavijut, njerëzit deshën t`ia besojnë Husejnit r.a. postin e *halife*-s, kurse ai mori garancë nga banorët e Kufës që të transferohet tek

[419] Këmendë - tesha të përpunuara nga leshi i dhive;
[420] Ibni Kethir-i, "El-Bidaje ve`n-Nihaje", vëll.2, fq.403;
[421] Ibni Kethir-i, po aty, fq.405;
[422] Për këto versione, shih: Ibni Kethir-i, "El-Bidaje ve`n-Nihaje", vëll.2, fq.411-413;
[423] Ibni Kethir-i, po aty, fq.413-414 dhe thotë se zinxhiri është Sahih deri te Seid b. Musejebi;

ata. Në vitin 60 h. ai doli prej Meke për të shkuar në Kufe. Ai pasi kishte marrë garancë se 30.000 veta do ta mbështesin atë, u nis me 72 antar të familjes së vet për në Irak. Kur arriti Huseini r.a. në afërsi të lumit Eufrat, në vendin e quajtur Kerbela, Zijadi dërgoi 4000 ushtarë që ta rrethojnë atë dhe ta sjellin të robëruar në Medine.

Pasi Huseini r.a. nuk pranoi të dorëzohet, ata e sulmuan dhe i vranë të gjithë që ishin me të, kurse disa i robëruan. Huseinit r.a. ia prenë kokën dhe ia dërguan mëkëmbësit Jezid b. Muavije. Ngjarja e Kerbelasë ka ndodhur më 10 Muharem, të vitit 61 h (680 m) në Irak.[424]

Zuhriu ka thënë: "Kur është vrarë Husejni r.a. biri i Aliut r.a. nuk ka ndodhur që të ngritësh ndonjë gurë në Bejtul Makdis e të mos kishte nën të gjak".[425] Edhe Ibni Shihabi thotë se ditën që është vrarë Husejni r.a. biri i Aliut r.a. në Damask çdo gurë që ngritnim, nën të gjenim gjak".[426] Muhamed b. Sirini r.a. thotë se nuk ka ndodhur të skuqet qielli derisa ndodhi vrasja e Husejnit r.a.[427]

Por, nuk regjistrohet ndonjë luftë ose murtajë e cila ka marrë jetën e 140.000 njerëzve pas vrasjes së Husejnit r.a., edhe pse ka pasur luftëra pas kësaj dite, por jo të kësaj përmase. Është e mundur teksti i *hadith*-it të jetë i dobët edhe pse zinxhiri i hadithit të jetë i saktë. Nga ana tjetër, dihet se personat të cilët kanë qenë të involvuar në vrasjen e Husejnit r.a. pas asaj ndodhie kanë pësuar prej sëmundjeve ose vrasjeve të ndryshme.

[424] Për tregimin e plotë të vrasjes së Husejnit r.a. shih: Taberi-u, "Tarih", tahkik Ebu Fadël Muhamed Ibrahim, Daru`l-Muarif, botimi i dytë, vëll.5, fq.347-470; Ibni Ethir-i, "Kamil fi Tarih", Daru`l-kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1987, vëll.3, fq.407-440; Ibni Kethir-i, "El-Bidaje ve`n-Nihaje", vëll.11, fq.569-600;
[425] Taberani, "Mu`xhem`ul-Kebir", vëll.3, fq.120, nr.2834;
[426] Taberani, "Mu`xhem`ul-Kebir", vëll.3, fq.120, nr.2835;
[427] Taberani, "Mu`xhem`ul-Kebir", vëll.3, fq.122, nr.2840;

HADITHI I KATËRDHJETËENJËTË (41)

حَدَّثَنَا جبرونُ بْنُ عِيسَى الْمُقْرِئُ، ثنا يَحْيَى بْنُ سُلَيْمَانَ الْحُفْرِيُّ، ثنا فُضَيْلُ بْنُ عِيَاضٍ، عَنْ مَنْصُورٍ، عَنْ عِكْرِمَةَ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «إِنَّ مُوسَى بْنَ عِمْرَانَ مَرَّ بِرَجُلٍ وَهُوَ يَضْطَرِبُ فَقَامَ يَدْعُو اللهَ لَهُ أَنْ يُعافِيَهُ فَقِيلَ لَهُ يَا مُوسَى إِنَّهُ لَيْسَ الَّذِي يُصِيبُهُ حَظٌّ مِنْ إِبْلِيسَ، وَلَكِنَّهُ جَوَّعَ نَفْسَهُ لِي فَهُوَ الَّذِي يَرَى أَنِّي أَنْظُرُ إِلَيْهِ كُلَّ يَوْمٍ مَرَّاتٍ أَتَعَجَّبُ مِنْ طَاعَتِهِ لِي فَمُرْهُ فَلْيَدْعُو لَكَ، فَإِنَّ لَهُ عِنْدِي كُلَّ يَوْمٍ دَعْوَةً»

Transmeton Ibni Abasi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Musa biri i Imranit kaloi pranë një njeriu i cili përpëlitej (dridhej), e ai (Musa) u ngrit që të bëjë lutje për të që të shërohet, por atij iu tha:* ***"O Musa, ai nuk është prej atyre që e ka sulmuar (prekur) Iblisi, por është prej atyre që e kanë të urritur shpirtin për Mua e kjo është ajo që e shikon. Unë e shikoj atë për çdo ditë nga disa herë dhe kënaqem me adhurimin e Tij ndaj Meje. Urdhëroje atë që të bëjë lutje për ty sepse ai tek Unë ka çdo ditë nga një lutje (që i pranohet)".***[428]

Njeriu i cili e adhuron Allahun xh.sh. në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme, ka një pozitë të veçantë te Allahu xh.sh. dhe mund të arrijë në shkallën e *evlia*-ve të Zotit. Ata në sytë e të tjerëve mund të duken si të çmendur ose siç lëvizet njeriu nën ndikimin e prekjes së djallit, porse ata nga adhurimi i shumtë duken në atë gjendje. Mund të përmendim edhe *hadith*-in tjetër, që e transmeton Ebu Seid el-Hudriju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Shtonie të përmendurit e Allahut*

[428] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.11, fq.268, nr.11.695; Ebu Nuajm-i, në "Hiljetu`l-Evlija", vëll.8, fq.127 dhe thotë se është Garib përmes Fudajlit, Mensurit dhe Ikrimes, veçohet me këtë transmetim Jahja b. Sulejman..". Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid" vëll.10, fq.339, nr.17.930 thotë se "e përcjell Taberani, kurse transmetuesit janë të besueshëm".

(dhikrit) derisa të të thonë i çmendur".[429] Disa kanë thënë se *munafik*-ët thonë për ata që e adhurojnë Allahun xh.sh. shumë se janë njerëz të çmendur.

Kështu kanë qenë edhe disa prej *sahab*-ëve gjatë ndjekjes së *sunet*-it të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Nafiu thotë: "Sikur të shihnit Ibni Umerin r.a. se si i ndiqte gjurmët e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do të thonit: "Ky është i çmendur".[430]

Pasi Musa a.s. vërejti gjendjen e personin dhe dëshiroi që t`i lutet Zotit që ta shërojë personin e tillë, pasi besimtari duhet të lutet për të mirën e tjetrit dhe ta ndihmojë, qoftë edhe me *dua*, në këtë rast Zoti i tha: ***"O Musa, ai nuk është prej atyre që e ka sulmuar (prekur) Iblisi...".*** Pra, njeriu nga të prekurit e djallit, mund të shfaq lëvizje të pakontrolluara dhe të çuditshme, siç edhe e përmendi në Kuran: **"Ata që e hanë kamatën nuk çohen ndryshe pos siç çohet i çmenduri nga të prekurit e djallit. (Bëjnë) kështu ngase thanë: "Shitblerja nuk është pos kamatë!" e All-llahu ka lejuar shitblerjen, ndërsa ka ndaluar kamatën...".**[431]

Pra, njeriu kishte rënë në atë gjendje shkaku se ishte i uritur për adhurim dhe për dashurinë e Zotit, e kush e do Zotin, përmallohet për të Dashurin e Vet. Vallë, a nuk keni parë se si bëjnë njerëzit pas atyre që i duan në këtë botë?! Si bën prindi si fëmijë kur lozë me fëmijën, e si do të reagojë prindi nëse e humb fëmijën e tij?! Si bën burri kur dashurohet pas ndonjë femre, e si bëjnë simpatizuesit e ndonjë këngëtari apo sportisti pas atij që e simpatizojnë?! E Allahut i takon shembulli më i lartë, por përse të gjitha reagimet e njerëzve tjerë janë të kuptueshme, e të mos jetë e kuptueshme dhe normale edhe reagimi i një *ashiku* i cili ka rënë në gjendjen e përmallimit për Krijuesin e vet?!

Adhuruesin e tillë, Zoti tregoi se e "shikon" për çdo ditë dhe se është i kënaqur me adhurimin që e shfaq. Zoti pohon në Kuran: **"...të dashurit e Tij janë të devotshmit...".**[432]

---

[429] Ahmed-i, "Musned", 18/195, nr.11.653 dhe 18/212, nr.11.674; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", 3/99, nr.817; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/677, nr.1839 dhe thotë se "zinxhiri i hadithit është Sahih", e me të pajtohet edhe Dhehebiu; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmedit, thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët për shkak dobësisë së Deraxhit;

[430] Hakimi, "El-Mustedrek", 3/647, nr.6376;

[431] Kurani, Bekare, 275;

[432] Kurani, Enfal, 34;

Nuk mund të jetë dikush *evlija* nëse nuk beson ose nuk është i devotshëm. Zoti thotë: **"Me të vërtetë për të dashurit e Allahut nuk ka frikë e as pikëllim. Janë ata që besuan dhe që ishin të devotshëm".**[433]

Besimtarëve të tillë, Zoti ua pranon lutjet dhe nuk ua refuzon atyre *dua*-të që i bëjnë për vete ose për të tjerët. Më vonë do ta përmendim të plotë edhe *hadith*-in tjetër *kudsi*, të cilin e transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xhele she`nuhu thotë se:* ***"...Nuk do të më afrohet robi Mua me diçka më të dashur sesa me atë që ia kam bërë farz. Kështu robi Im vazhdon të më afrohet me nafile derisa ta dua, e kur Unë ta dua, atëherë bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën mbahet dhe këmba e tij me të cilën ecën. Nëse më kërkon do t`i përgjigjem, e nëse mbrohet me Mua, atëherë do ta mbrojë atë..."***.[434]

[433] Kurani, Junus, 62-63;
[434] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab et-tevadui, nr.6502;

HADITHI I KATËRDHJETËEDYTË (42)

حَدَّثَنَا عَفَّانُ، حَدَّثَنَا وُهَيْبٌ، حَدَّثَنَا عَطَاءُ بْنُ السَّائِبِ، عَنْ يَعْلَى بْنِ مُرَّةَ الثَّقَفِيِّ، قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " قَالَ اللهُ: لَا تُمَثِّلُوا بِعِبَادِي "

Transmeton Ja`la b. Murre eth-Thekafiju (r.a.) i cili thotë: "E kam dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"Thotë Allahu:* ***"Mos gjymtoni (masakroni) me robërit i Mi".***[435]

Këtu kemi një urdhër dhe mësim të madh për muslimanët, që të kenë kujdes në raportet e tyre ndërnjerëzore dhe mos tejkalimit të kufijve, sepse Zoti nuk e do atë që e tepron dhe atë që kalon në ekstrem. Zoti u drejtohet njerëzve me urdhërin që mos të masakrohen robërit e Tij. Edhe pse ky *hadith* sipas disa dijetarëve është me zinxhir të dobët, përsëri ai forcohet me tekste tjera të cilat tregojnë për ndalesën e masakrimit, qoftë në luftë ose jashtë saj, qoftë njeriu i gjallë ose i vdekur.

Sipas mësimeve Islame nuk lejohet të torturohet dhe të maltretohet krijesa e gjallë, sidomos qenia njeri, e cila është krijesa më e dalluar e Zotit. Zoti i kufizoi besimtarët që nëse duan të marrin *hak* për padrejtësinë dhe vrasjen që u është bërë, të mos tejkalojnë kufijtë dhe t`i përmbahen devotshmërisë. Zoti thotë në Kuran: **"Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ku, e nëse duroni pa dyshim ai është më i mirë për ata që durojnë".**[436] Disa komentues të Kuranit kanë thënë se ky *ajet* u zbrit me rastin e luftës së Uhudit, kur idhujtarët kishin masakruar disa prej muslimanëve, e në mesin e tyre edhe Hamzanë, mixhën e Pejgamberit

[435] Ahmedi, "Musned", vëll.29, fq.109, nr.17.568; Ibni Ebi Shejbe, "Musannef", Daru`t-Taxh, Bejrut, botimi i parë, 1989, 5/456, nr.27.936; e shënon edhe Taberani, në "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.22, fq.272, nr.697-699 por nuk e sjell si hadith Kudsi; shejh Shuajb el-Arnauti dhe recenzuesit e Musned-it, thonë se ky hadith është i dobët shkaku i ndërprerjes, pasi Ata` b. Saibi nuk ka dëgjuar hadithe prej Ja`lasë; edhe Ahmed Shakiri në verifikim të Musned-it të Ahmedit (13/419, nr.17.498) thotë se zinxhiri i hadithit është i ndërprerë (munkati`) në mes Ataut dhe Ja`lasë;

[436] Kurani, Nahël, 126;

sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që pas kësaj, muslimanët bashkë me Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem thanë se do të hakmirren ndaj kësaj duke vrarë nga shtatëdhjetë për çdo musliman të vrarë, por pastaj u zbrit ky ajet dhe ata thanë se do të durojnë.[437]

Po ashtu u tha në një vend tjetër në Kuran: **"Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju luftojnë e mos e teproni, se Allahu nuk i donë ata që e teprojnë".[438]**

si dhe tha: **"...e mos e kaloni kufirin në vrasje..."[439]** kurse në koment të këtij ajeti, Talk b. Hubejbi ka thënë se nuk lejohet të vrasësh dikë tjetër në vend të vrasësit ose të masakrosh të vrarin.[440]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem vazhdimisht është munduar që t`i nxit besimtarët që të mos bëjnë padrejtësi dhe tejkalim gjatë luftërave. Nëse është nxituar, Allahu xh.sh. menjëherë i ka tërhequr vërejtjen që ta përmirësojë vendimin. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem urdhëroi që nëse kapen dy persona nga mesi i Kurejshëve, të cilët ai i përmendi me emër, të digjen me zjarr. Por, më pas erdhi përsëri dhe tha: *"Më herët ju urdhërova që nëse kapen filani dhe filani, të digjen me zjarr, por me zjarr nuk dënon askush përpos Allahut, andaj nëse i kapni, vritni ata".[441]*

Pra, edhe djegja e armikut është masakrim dhe torturim, kështu që edhe nëse ai meriton të vritet, nuk do të thotë se duhet t`i nxirret shpirti me torturë, por kjo të bëhet në mënyrën më të butë. Edhe gjatë jetës së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ndodhi një rast kur ai urdhëroi që fajtorët të dënohen në mënyrën më të ashpër, por më pas e ndryshoi mendimin dhe i urdhëronte shokët e tij që të largohen nga masakrimi. Transmeton Enesi r.a. se disa njerëz prej Ukli dhe Urejne kanë ardhur në Medine te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të tregojnë se e kanë pranuar Islamin. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem urdhëroi që t`u japin deve dhe barinjë, me të cilat do të kthehen te populli i tyre. Por kur arritën në Harre, disa prej tyre mohuan Islamin. Barinjtë e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i vranë në mënyrë mizore dhe i morën devetë. Pejgamberi sal-

[437] Shih: Taberi-u, "Xhamiu`l-Bejan fi te`vili`l-Kuran", vëll.14, fq.401-404;
[438] Kurani, Bekare, 190;
[439] Kurani, Isra, 33;
[440] Ibni Ebi Shejbe, "Musannef", 5/456, nr.27.937;
[441] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhihadi ve`s-sijeri, bab teudi`i, nr.2954; etj.

lallahu alejhi ve sel-lem kur mori vesh për këtë, dërgoi dikë që t`i ndjekin. Pasi i gjetën, dha urdhër që t`ua nxjerrin sytë, t`ua presin duart dhe i lëshuan në anën e Harrasë derisa vdiqën në këtë gjendje". Katade thotë se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem pas kësaj i nxiste që të japin sadaka dhe e ndaloi masakrimin".[442]

Më pas, çdoherë kur i niste ushtarët e tij për në ekspedita luftarake, i urdhëronte që të mos masakrojnë. Transmeton Burejde r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nisuni në Emër të Allahut, për Allahun dhe sipas fesë që predikon Pejgamberi i Allahut! Luftoni ata që mohojnë Allahun, luftoni ata dhe mos tradhtoni, mos vidhni plaçkën e luftës, mos i masakroni dhe mos vrisni fëmijë".*[443]

Edhe shokët e tij më pas i mësonin të tjerët mbi këtë parim, që të mos masakrojnë dikë. Transmeton Mugire b. Shu`be r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka ndaluar masakrimin.[444]

Po ashtu, transmeton Hejaxh b. Imrani i cili thotë: "Imranit i kishte ikur një rob dhe betohej se nëse do ta kapte, do t`ia priste dorën. Ai më dërgoi që të pyesja për këtë gjë (për prerjen e dorës). Unë shkova te Semure b. Xhundub dhe e pyeta. Ai më tha: "Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na urdhëroi që të japim sadaka dhe na ka ndaluar që të masakrojmë". Unë shkova edhe te Imran b. Husajni r.a. dhe e pyeta të njëjtën gjë edhe ai më tha: "Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na urdhëroi që të japim sadaka dhe na ka ndaluar që të masakrojmë".[445]

Besimtari i vërtetë është i dhimbshëm, nuk dëshiron të sheh vuajtje e as torturë, vepron aq sa është i urdhëruar, realizon urdhrin e fesë dhe nuk i tejkalon kufijtë. Transmeton Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Vrasjen më të lehtë e bëjnë ata që janë besimtarë me iman".*[446]

---

[442] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Megazi, bab kisatu Uklin ve Urejnete, nr.4192; etj;

[443] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab fi dua`il-mushrikin, nr.2613; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Dijatu, bab ma xhae fi`n-nehji anil muthleti, nr.1408 dhe thotë se "ky hadith është Hasenun-Sahih, kurse dijetarët e kanë urryer masakrimin";

[444] Ahmed-i, "Musned", 30/86, nr.18.152; Ibni Ebi Shejbe, "Musannef", 5/455, nr.27.930;

[445] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab fi nehji anil muthleti, nr.2667;

[446] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab fi nehji anil muthleti, nr.2666; Ibni Ebi Shejbe, "Musannef", 5/455, nr.27.927;

Feja na urdhëroi që jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj kafshëve të shprehim mëshirë dhe dhembshuri, e të mos bëhemi të ashpër dhe të vrazhdë, që të jemi të pamëshirshëm. Zoti e qortoi një pejgamber i cili dha urdhër që të digjet foleja e disa milingonave, shkaku se njëra prej tyre e pickoi. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Një milingonë e kafshoi njërin prej pejgamberëve dhe ai urdhëroi që të gjithë foletë e milingonave të digjeshin. Por Allahu xh.sh. i shpalli dhe i tha:* ***"Të kafshoi një milingonë dhe urdhërove të digjej një prej popujve që madhërojnë Allahun?!".***[447]

Edhe gjatë therjes së kafshës, jemi të obliguar që t`i përmbahemi mirësisë dhe të therim në mënyrën më të mirë, pa i shkaktuar kafshës dhimbje dhe torturë. Kështu që besimtari duhet ta përgatit vendin, të mpreh thikën dhe të jetë i shpejtë në therje, pa e keqtrajtuar kafshën. Transmeton Shedad b. Evsi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. ka caktuar mirësinë në çdo gjë. Kur të vritni, vritni me mirësi. Kur të therni kurban, therni me mirësi. Andaj mprehni thikat dhe qetësonie kurbanin".*[448]

Pra, muslimani duhet të largohet nga çdo formë e masakrimit, qoftë ndaj njerëzve, kafshëve ose edhe natyrës, duke shkatërruar gjelbërimin. Edhe format më të lehta të masakrimit, janë të ndaluara në legjislacionin Islam. Në këtë kontekst, do të dëshiroja të shtojë disa citime të dijetarëve hanefi, të cilët edhe rruajtjen e mjekrës e kanë cilësuar si gjymtim dhe masakrim. Në vijim, do të përmendim disa referenca të këtyre dijetarëve eminent të kësaj shkolle juridike.

Imam Kasani (vd.587/1191) në veprën e tij të shkëlqyer "Bedaiu`s-Sanai" pohon: "Haxhiu gjatë rruarjes së kokës nuk ka të drejtë të presë asgjë nga mjekra e tij. Ndërsa sipas Shafiut gjatë rruarjes së kokës duhet të presë edhe diç nga mjekra e tij dhe këtë e bën për hir të Allahut. Mirëpo ky qëndrim i tij nuk është aspak në rregull (*lejse bi shejin*) ngase vaxhib është rruajtja e kokës edhe atë me tekstin që përmendëm, si dhe duke shtuar se rruarja e

[447] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhihadi ves-sijeri, bab, nr.3019; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Selamu, bab nehju an katli`n-nemli, nr.2241; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab fi katli`dh-dherri, nr.5266; Nesai-u, "Sunen", kitab Sajdi vedh-dhebaih, bab katlu`n-nemli, nr.4358; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Sajdi, bab ma junha an katlihi, nr.3225;

[448] Muslim-i, "Sahih", kitab Sajdu ve`dh-dhebaihu, bab el-emru bi`ihsani`dh-dhebhi, nr.1955; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Dahaja, bab fi nehji en tusberel behaimu, nr.2815; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Dijat, bab ma xhae fi nehji anil muthleti, nr.1414; Nesai-u, "Sunen", kitab Dahaja, bab el emru bi ihdadi`sh-shefreti, nr.4405; Ibn Maxheh, "Sunen", kitab Dhebaih, bab 3, nr.3170; Ahmed-i, "Musned", 28/353, nr.17.128 etj.;

mjekrës futet në rangun e gjymtimeve (*muthleti*), ngase Allahu i ka zbukuruar burrat me mjekra ashtu siç i ka zbukuruar gratë me gërsheta..".[449]

Imam Merginani (vd.593/1197) në veprën e tij "El-Hidaje", kur flet për qethjen dhe rruajtjen e flokëve gjatë haxhit thotë: "Gruaja nuk i rruan flokët e saja, por i shkurton ato. Ngase Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i ka ndaluar gratë nga rruajtja e flokëve dhe i ka urdhëruar me shkurtimin e tyre. Pastaj, rruajtja e flokëve për gruan është gjymtim (*muthletun*) sikurse rruarja e mjekrës për burrat".[450]

Imam Nesefiu (vd.710/1310) gjersa komenton fjalën e imam Samerkandit në "Fikhu`n-Nafi": *"...ngase rruarja për gruan është gjymtim..."* thotë: "Kjo ngase gruaja është zbukuruar me flokët e kokës, siç është zbukuruar burri me mjekër. Pastaj, rruarja e mjekrës për burrin është gjymtim, për atë edhe rruarja e flokëve të saja për të është gjymtim. Gjymtimi është haram. Imran b. Husajni r.a. ka thënë: "S`ka ndodhur të ngrihet Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem për fjalim e të mos na nxit për lëmoshë dhe të mos na ndalojë nga gjymtimi...".[451]

Imam Bedrudin el-Ajni (vd.855/1451) gjersa komenton fjalën e Merginanit: *"Pastaj, rruajtja e flokëve për gruan është gjymtim (muthletun) sikurse rruarja e mjekrës për burrat"* thotë: "Gjymtimi (*el-muthletu*) është haram dhe nuk lejohet të realizohet një sunet duke bërë një haram dhe për gruan është sunet vetëm shkurtimi. Mutarriziu thotë: "Gjymtimi (*el-muthletu*) është këputje e disa pjesëve, (dëmtimi) prishja e fytyrës dhe ndryshimi i formës".[452]

Shohim se sa të kujdesshëm janë treguar dijetarët musliman, që t`i mbrojnë muslimanët nga rënia në veprime të liga dhe që nuk i ngjajnë fesë tonë të pastër Islame. Në temën e masakrimit, ekzistojnë edhe disa debate tjera, porse ne nuk do të zhytemi në to, por nëse dëshiron për hulumtime më të gjerësishme në këtë temë, mund të konsultohen librat e fikhut dhe të njihen me të gjitha mendimet e dijetarëve, kurse ne do të mjaftohemi me këtë, duke mbështetur fuqishëm se masakrimi është në kundërshtim me moralin dhe edukatën që na mëson feja Islame.

---

[449] Kasani, "Bedaiu`s-Sanai", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, 1986, vëll.2, fq.141;
[450] Merginani, "El-Hidaje", Daru Ihjai Turath el-arabi, Bejrut, vëll.1, fq.149;
[451] Nesefi-u, "El-Mustesfa", universiteti Ummu`l-Kura, Meke, 2011, vëll.1, fq.886;
[452] Ajni, "El-Binaje fi sherhi`l-Hidaje", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 2000, vëll.4, fq.274;

PENDIMI

HADITHI I KATËRDHJETËETRETË (43)

حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ سَلَمَةَ بْنِ كُهَيْلٍ، عَنْ عِمْرَانَ أَبِي الْحَكَمِ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ: قَالَتْ قُرَيْشٌ لِلنَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: ادْعُ لَنَا رَبَّكَ أَنْ يَجْعَلَ لَنَا الصَّفَا ذَهَبًا، وَنُؤْمِنُ بِكَ، قَالَ: " وَتَفْعَلُونَ؟ " قَالُوا: نَعَمْ، قَالَ: فَدَعَا، فَأَتَاهُ جِبْرِيلُ فَقَالَ: " إِنَّ رَبَّكَ يَقْرَأُ عَلَيْكَ السَّلامَ، وَيَقُولُ: إِنْ شِئْتَ أَصْبَحَ لَهُمُ الصَّفَا ذَهَبًا، فَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ مِنْهُمْ عَذَّبْتُهُ عَذَابًا لَا أُعَذِّبُهُ أَحَدًا مِنَ العَالَمِينَ، وَإِنْ شِئْتَ فَتَحْتُ لَهُمْ بَابَ التَّوْبَةِ وَالرَّحْمَةِ "، قَالَ: " بَلْ بَابُ التَّوْبَةِ وَالرَّحْمَةِ "

Transmeton Ibni Abasi (r.a.) i cili thotë: "Kurejshët i thanë Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Lute Zotin që për ne ta shndërrojë (kodrën) Safa në ari, atëherë do të besojmë ty". (Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem) tha: *"A do ta bëni këtë?"* Ata thanë: "Po". Ai u lut, por i erdhi Xhibrili a.s. dhe i tha: "Zoti xh.sh. të çon ty selam dhe thotë*: **"Nëse donë, kur të zgjohen ata, do ta gjejnë Safanë të shndërruar në ari, por kush mohon prej tyre pas kësaj, do ta dënojë me një dënim që nuk e kam dënuar asnjë prej krijesave, e nëse do, do t`ua hap derën e pendimit dhe mëshirës".*** (Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem) tha: *"Më mirë derën e pendimit dhe të mëshirës".*[453]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dëshironte me gjithë qenien e tijë të arrijë udhëzimi tek paria e Kurejshëve, sepse ata ishin familja e tij, por edhe nga fakti se nëse ata e pranonin Islamin, do të hynin në fe edhe shumë të

[453] Ahmed-i, "Musned", 4/60, nr.2166; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 12/152, nr.12.736; Hakim-i, "El-Mustedrek", 4/268, nr.7601 dhe thotë se hadithi është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar; Hejthemi-u, në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/232, nr.17.496 thotë: "E transmeton Taberani, kurse transmetuesit janë transmetues të dy Sahiheve"; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të veprës së Ahmedit, thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Sahih sipas kushteve të Muslimit;

tjerë dhe do lehtësohej procesi i përhapjes së Islamit në mesin e arabëve dhe të tjerëve. Kurejshët kishin kërkuar shpesh prej Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem nëpër tubimet e tyre disa kërkesa, që në realitet, nuk janë arsye dhe pengesë që ata të hyjnë në Islam, porse thjesht kanë kërkuar alibi për të mos e pranuar fenë.

Në një rast, idhujtarët kishin kërkuar që t`i largojë prej tubimeve të varfërit si Bilali, Amari dhe Suhejbi, e pastaj këta do të qëndrojnë në tubime me të. Por, këtu i bëri vërejtje Zoti duke i thënë: **"Përkufizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij, e mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar".**[454]

Në rastin konkret, ata i kërkuan Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që ta shndërojë kodrën Safa në ari, sepse dëshira e materialistëve, është vetëm shtimi i pasurisë dhe kënaqësive të kësaj bote, ndërsa Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem pa rast të mirë këtu që ti tërheq në Islam, ku u bëri pyetje konfirmuese se vallë, nëse ajo bëhet, a do të bëhen me të vërtetë mysliman?! Kur mori përgjigje pozitive, iu lut Zotit që ta realizojë këtë, sepse do ishte një mënyrë e shpejtë e konvertimit të tyre në Islam, por Zoti i ktheu përgjigje përmes melekut Xhibril a.s. dhe duke e përshëndetur me *selam*, se kjo nuk është hera e parë që një pejgamberi i kërkohet diçka e tillë, pasi ka pasur edhe më herët të tillë që kanë kërkuar mrekulli, por kur ka ndodhur mrekullia, ata kanë deklaruar se janë të magjepsur dhe se është duke ndodhur magji e vërtetë.

Këtë përvojë e ka pasur Isa a.s. i cili foli që në djep, merte baltë dhe bënte diçka të ngjashme me shpendin dhe ajo u shndërofte në zog, kur shëronte të verbërit dhe të sëmurët në lëkurë dhe ngjallte të vdekurin me lejen e Zotit, pabesimtarët i thanë se kjo është magji e qartë.[455]

Pabesimtarët kërkuan prej Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që t`u zbret edhe një libër prej qielli dhe ta shohin me sytë e tyre zbritjen dhe ta prekin atë, por edhe në këtë iu përgjigj Zoti duke i thënë: **"Edhe sikur të zbritnim ty një libër të shkruar në letër, e ta preknin atë me duart e**

[454] Kurani, Kehf, 28;
[455] shih: Kurani, Maide, 110;

tyre, ata që mohuan do të thoshin: "Kjo nuk është tjetër përveç një magji e qartë".[456]

Këta kishin kërkuar më herët edhe prej Musës a.s. diç edhe më të rëndë, saqë deshën që ta shohin Zotin haptazi, por për këtë i kapi dënimi. Zoti thotë në Kuran: **"Ithtarët e librit kërkojnë prej teje që t`u sjellësh një libër nga qielli. Por ata patën kërkuar prej Musaut edhe në tepër se kjo, saqë i thanë: "Ta shohim Zotin haptazi". E për shkak të mizorisë së tyre, i kapi rrufeja...".[457]**

Pra, Zoti ia dha këto *ajet*-e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të mos e lodh veten e të mendojë se nëse u paraqet argumente dhe mrekulli, do të besojnë, sepse edhe këta janë njëjtë sikur ata të mëparshmit, të cilët i shihnin mrekullitë para syve, por përsëri e mohonin fjalën e Zotit. Ai i tha Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Kuran: **"Neve nuk na pengoi gjë të sjellim shenja, por të parët i përgënjeshtruan. Themudëve u dhamë devenë në mënyrë të dukshme dhe ata e dhunuan. I sollëm shenjat vetëm për frikësim".[458]**

Isaut a.s. i patën kërkuar edhe më çuditshëm, saqë lypën të zbres një tryezë e mbushur me ushqime prej qielli dhe të hanë prej saj. Kjo na tregohet në Kuran, ku thuhet: **"Dhe (përkujto) kur Havarijunët thanë: "O Isa, biri i Merjemes, a mundet Zoti ta zbresë një tryezë nga qielli?" (Isa) tha: "Keni frikë Allahun nëse jeni besimtarë". (Ata) Thanë: "Ne dëshirojmë të hamë nga ajo dhe të na binden (edhe më shumë) zemrat tona dhe të vërtetojmë bindshëm se na e the të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj!" Isai, bir i Merjemes, tha: "O All-llah, Zoti ynë, zbritna nga qielli një tryezë, të jetë festë (gëzim) për ne dhe për ata (që vijnë) pas nesh, të jetë argument prej Teje dhe dhurona se Ti je Furnizuesi më i mirë!" All-llahu tha: "Unë atë ua zbres, e kush prej jush mohon pastaj, atë e dënoj me një dënim që nuk e dënoj asnjë nga njerëzit".[459]**

Edhe ndaj këtyre Zoti u kërcënua njëjtë siç u kërcënua për Kurejshët të cilët kërkuan të shndërohet kodra në ari, por Zoti i bëri me dije se ata nuk do të besojnë, e pas mohimit, do të pasojë dënim i dhimbshëm për ta, ngase edhe këta janë injorant sikur ata të mëhershmit, pa marrë parasysh se çfarë

[456] Kurani, En`am, 7;
[457] Kurani, Nisa, 153;
[458] Kurani, Isra, 59;
[459] Kurani, Maide, 112-115;

mrekullie do të shohin. Zoti thotë në Kuran: **"E edhe sikur t'ju zbritnim Ne atyre engjëjt, t'ju flitnin të vdekurit, t'ju tubonin atyre çdo send (gjallesë) konkretisht, ata nuk kishin për të besuar, vetëm po të donte All-llahu, por shumica e tyre nuk dinë (se besimi është dhuratë nga Zoti)".**[460]

Por, Zoti nuk e la pa mrekulli, i dha edhe Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem mrekulli, që ta sheh se përsëri, edhe pas mrekullisë, ata përsëri do të kthejnë shpinën dhe do të mohojnë. Në periudhën gjersa ishte në Meke, i kërkuan Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem mrekulli dhe Zoti i mundësoi që ta çajë Hënën në gjysmë. Këtë mrekulli e panë me sytë e tyre, por përsëri ata thanë se kjo është *sihër* (magji). Zoti thotë në Kuran: **"Momenti (i katastrofës së përgjithshme) është afruar dhe Hëna është çarë. Po ata, edhe nëse shohin mrekulli, zbrapsen e thonë: "Kjo është magji e vazhdueshme".**[461]

Transmeton Enes b. Maliku r.a. se Mekasit i kërkuan Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem një mrekulli dhe në atë moment, u ça Hëna në dy pjesë".[462]

Ata ishin të vendosur në mohim, kurse Zoti përsëri, u la hapësirë për pendim dhe falje, nëse ata kthehen dhe largohen prej mohimit të tyre dhe kjo derë e pendimit dhe faljes, nuk ka qenë enkas për ata, por për të gjithë njerëzit deri në momentin e daljes së shpirtit ose lindjes së Diellit nga perëndimi. Kur të vijë ky moment, atëherë më askujt nuk i bën dobi pendimi dhe kërkimi i faljes, nëse më parë nuk ka qenë besimtarë i mirë.

[460] Kurani, En`am, 111;
[461] Kurani, Kamer, 1-2;
[462] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Menakibi, bab su`alu`l-mushrikin en jurijehumu`n-nebijju ajeten, nr.3637; Muslim-i, "Sahih", kitab Sifeti`l-Kijame, bab inshikaku`l-kameri, nr.2802; etj.

HADITHI I KATËRDHJETËEKATËRTË (44)

حَدَّثَنَا أَبُو الْعَبَّاسِ مُحَمَّدُ بْنُ يَعْقُوبَ، ثنا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيِّ بْنِ عَفَّانَ، ثنا الْحَسَنُ بْنُ عَطِيَّةَ، ثنا الْحَسَنُ بْنُ صَالِحٍ، عَنِ الْمِنْهَالِ بْنِ عَمْرٍو، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا، فَتَلَقَّى آدَمُ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ فَتَابَ عَلَيْهِ قَالَ: أَيْ رَبِّ أَلَمْ تَخْلُقْنِي بِيَدِكَ؟ قَالَ: «بَلَى» . قَالَ: أَيْ رَبِّ، أَلَمْ تَنْفُخْ فِيَّ مِنْ رُوحِكَ؟ قَالَ: «بَلَى» . قَالَ: أَيْ رَبِّ، أَلَمْ تُسْكِنِّي جَنَّتَكَ؟ قَالَ: «بَلَى» . قَالَ: أَيْ رَبِّ أَلَمْ تَسْبِقْ رَحْمَتُكَ غَضَبَكَ؟ قَالَ: «بَلَى» . قَالَ: أَرَأَيْتَ إِنْ تُبْتُ وَأَصْلَحْتُ أَرَاجِعِي أَنْتَ إِلَى الْجَنَّةِ؟ قَالَ: «بَلَى» . قَالَ: فَهُوَ قَوْلُهُ {فَتَلَقَّى آدَمُ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ} [البقرة: 37] «هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحُ الْإِسْنَادِ وَلَمْ يُخَرِّجَاهُ»

Transmeton Ibni Abasi r.a. i cili (në lidhje me ajetin kuranor): **"E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë, prandaj Ai ia fali"** *(Ademi a.s.) tha: "O Zot, a nuk më krijove me Dorën Tënde?" Tha:* ***"Po, gjithsesi".*** *(Ademi a.s.) tha: "O Zot, a nuk më fryve prej Shpirtit Tënd?" Tha:* ***"Po, gjithsesi".*** *(Ademi a.s.) tha: "O Zot, a nuk më vendove në Xhenetin Tënd?". Tha:* ***"Po, gjithsesi".*** *(Ademi a.s.) tha: "O Zot, a nuk e ka tejkaluar Mëshira Yte Hidhërimin Tënd?". Tha:* ***"Po, gjithsesi".*** *(Ademi a.s.) tha: "Si thua, nëse pendohem dhe përmirësohem, a do të më kthesh në Xhenet?" Tha:* ***"Po, gjithsesi".*** (Ibni Abasi r.a.) tha: "Kjo është kuptimi i fjalës: **"E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë...". (Bekare, 37).**[463]

Në lidhje me fjalët të cilët i pranoi Ademi a.s. kur gaboi dhe hëngri prej pemës së ndaluar, ka pasur mendime të ndryshme në mesin e dijetarëve dhe komentuesve të Kuranit, por disa kanë thënë se fjalët dhe lutja të cilën e pranoi

[463] Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.2, fq.594, nr.4002 dhe thotë se "zinxhiri i hadithit është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë regjistruar" me këtë pajtohet edhe Dhehebi-u; Hadithin më parë, e ka shënuar edhe Taberi-u në "Xhamiu`l-Bejan fi tevil`il-Kuran", vëll.1, fq.580-581;

Ademi a.s. prej Zotit, ishte: **"Ata dy thanë: "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetvetes sonë, e në qoftë se nuk na mbulon (mëkatin) dhe nuk na mëshiron, ne me siguri jemi prej të shkatërruarve".**[464]

Këtë mendim e përkrahin Muxhahidi, Seid b. Xhubejri, Ebu Alije, Rebi b. Enesi, Haseni, Katade, Muhamed b. Ka`b el-Kuredhiju, Halid b. Ma`dani, Ata b. Hurasani dhe Abdurahman b. Zejd b. Eslemi.[465] Kështu e përcjell edhe Sujutiu prej Ibni Abasit r.a.[466]

Taberani, shënon një *hadith* përmes Aishes r.a.h. e cila thotë se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur Zoti e lëshoi Ademin a.s. në tokë, ai shkoi afër Qabesë dhe fali dy rekate (namaz), e Allahu e frymëzoi me këtë lutje: "O Zot Ti e din të fshehtën time dhe atë që është e shfaqur, pranoje arsyetimin tim, Ti e din nevojën time andaj më plotëso kërkesën time, e din se çka kam në vete, andaj më fal mëkatet, o Zoti im, kërkoj prej Teje që të më japësh iman e cila do të më pastroj zemrën dhe bindje të sinqertë gjersa të bindem se nuk më godet asgjë përpos asaj që më ke shkruar Ti, të jem i kënaqur me atë që më ke caktuar", e Allahu i shpalli atij:* ***"O Adem, Unë e kam pranuar pendimin tënd, e të kam falur mëkatin tënd, e nuk ndodh që dikush të më lutet me këtë lutje, e të mos ia fal atij mëkatin, do ta largojë prej tij shejtanin...".***[467]

Ebu Nuajmi shënon përmes Ubejd b. Umejr el-Lejthit se Ademi a.s. tha: "O Zot, Ti e dinë atë që më ndodhi, a mos është diçka të cilën ma ke caktuar para se të më krijosh apo është diçka që e shkaktova vet?" Tha: ***"Jo, po është diçka të cilën ta kam caktuar para se të të krijojë"*** e kjo është kuptimi i *ajet*-it: **"E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë...".**[468]

Edhe Taberi-u në koment të këtij *ajet*-i, shënon transmetimin se Ademi a.s. fjalët të cilat i ka pranuar, kanë qenë: *"Allahumme la ilahe il-la ente subhaneke ve bi hamdike estagfiruke ve etubu ilejke fe tub alejje inneke ente`t-tevvabu`r-rahim" (O Allahu im, nuk ka zot tjetër përpos Teje, i*

---

[464] Kurani, A`raf, 23;

[465] Ibni Kethir-i, "Tefsiri i Ibni Kethirit", vëll.1, fq.179, Zurich, 2007;

[466] Sujuti-u, "Durru`l-Menthur fi`t-Tefsir bi`l-Me`thur", tahkik Abdulmuhsin et-Turki, botimi i parë, 2003, vëll.1, fq.317;

[467] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.6, fq.118, nr.5974; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/213-214, nr.17.426 thotë: "E transmeton Taberani në "Euset", në zinxhir gjendet Nadër b. Tahiri, i cili është i dobët;

[468] Abdurezak-u, "Tefsir Abdurezak", daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, 1999, vëll.1, fq.267, nr.44; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", vëll.3, fq.273;

Lartmadhërishëm je Ti dhe Ty të takon falënderimi, kërkoj falje dhe pendohem tek Ti andaj pranoje pendimin tim, sepse Ti je Ai që pranon pendimin dhe je i Mëshirshëm).[469]

Edhe pejgamberët tjerë janë lutur me lutje të ngjashme duke e pranuar fajin e tyre, si shembulli i Musës a.s. i cili tha: **"O Zoti im, unë i kam bërë padrejtësi vetes time, andaj më fal".**[470] Kurse Junusi a.s. tha: **"Nuk ka zot tjetër pos Teje, i Lartmadhëruar je, unë isha prej të padrejtëve".**[471]

Ademi a.s. kërkoi falje dhe Zoti ia dha faljen, Iblisi kërkoi afatin deri në Ditën e Kijametit dhe Zoti edhe atij ia dha afatin, kështu që çdonjërit i dha atë që kërkoi. Ai që kërkon *Ahiret*-in, Zoti ia jep *Ahiret*-in, ai që kërkon këtë botë, Zoti ia jep këtë botë, por në botën tjetër nuk do të ketë hise.

Nga *hadith*-i kuptojmë se Ademi a.s. kërkoi falje, u pendua për lëshimin e vet dhe Allahu xh.sh. e pranoi pendimin e tij, kështu Zoti e pranon pendimin e robërve të Tij pasi Zoti është i Gjithmëshirshëm dhe pranues i pendimit.

Përpos pendimit, Ademi a.s. theksoi edhe përmirësimin, e jo vetëm pendimin, sepse njeriu duhet të largohet nga vetia e keqe dhe të rregullojë raportin e tij me Zotin. Njeriu duhet të pranojë fajin e tij dhe të mos sillet me arrogancë.

Pa marrë parasysh nivelin shoqërorë dhe devotshmërinë në zemër, askush nuk është imun ndaj gabimit, kështu që çdo njeri mundet të gabojë dhe të bëjë ndonjë lëshim, kështu që çdonjëri prej njerëzve duhet të pendohet dhe të kërkojë falje, kurse Allahun xh.sh. do ta gjejë Falës.

[469] Taberi-u, "Xhamiu`l-Bejan fi tevil`il-Kuran", vëll.1, fq.584;
[470] Kurani, Kasas, 16;
[471] Kurani, Enbija, 87;

HADITHI I KATËRDHJETËEPESTË (45)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، وَحَجَّاجٌ، قَالَا: حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ بَهْدَلَةَ، عَنْ زِرِّ بْنِ حُبَيْشٍ، عَنْ أُبَيِّ بْنِ كَعْبٍ، قَالَ: إِنَّ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: "إِنَّ اللهَ أَمَرَنِي أَنْ أَقْرَأَ عَلَيْكَ الْقُرْآنَ " قَالَ: فَقَرَأَ: {لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ} [البينة: 1] قَالَ: فَقَرَأَ فِيهَا: وَلَوْ أَنَّ ابْنَ آدَمَ سَأَلَ وَادِيًا مِنْ مَالٍ فَأُعْطِيَهُ، لَسَأَلَ ثَانِيًا وَلَوْ سَأَلَ ثَانِيًا فَأُعْطِيَهُ، لَسَأَلَ ثَالِثًا، وَلَا يَمْلَأُ جَوْفَ ابْنِ آدَمَ إِلَّا التُّرَابُ، وَيَتُوبُ اللهُ عَلَى مَنْ تَابَ، وَإِنَّ ذَلِكَ الدِّينَ الْقَيِّمَ عِنْدَ اللهِ الْحَنِيفِيَّةُ، غَيْرُ الْمُشْرِكَةِ، وَلَا الْيَهُودِيَّةِ، وَلَا النَّصْرَانِيَّةِ، وَمَنْ يَفْعَلْ خَيْرًا، فَلَنْ يُكْفَرَهُ "

Transmeton Ubej b. Ka`bi (r.a.) që ka thënë: "Me të vërtetë i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu më ka urdhëruar që të të lexoj ty Kuran".* Tha: "Dhe lexoi: **"Ata nga ithtarët e Librit dhe idhujtarët të cilët nuk besuan, nuk iu ndanë (besimit të tyre) derisa atyre u erdhi argumenti i qartë". (Bejine, 1).** Tha: "E pas saj tha: ***"Nëse biri i Ademit do të kërkonte një luginë me pasuri, do t`i jepej, por do të kërkonte të dytën, e nëse do kërkonte të dytën, do t`i jepej, por do të kërkonte të tretën, por nuk e mbush gojën e birit të Ademit (asgjë tjetër) përpos dheut, e Allahu ia pranon pendimin atij që pendohet, feja te Zoti është ajo e pastra, e jo ajo e idhujtarëve, jehudëve apo e krishterëve, e kush bën mirë, nuk do t`i mohohet".***[472]

[472] Ahmed-i, "Musned", 35/129-130, nr.21.202 dhe në 35/131, nr.21.203; e shënon edhe Tajalis-i, në "Musned", 1/435-36, nr.541; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Menakibi, bab 106, nr.3818 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/244, nr.2889 dhe thotë se hadithi është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë regjistruar", kështu e vlerëson edhe Dhehebi-u; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të "Musned"-it të Ahmed-it, thotë se zinxhiri i hadithit është *Hasen*, shkaku se aty është Asim b. Behdele, i cili është i sinqertë, kurse transmetuesit tjerë janë të besueshëm;

Sa i përket pjesës ku fillon si *hadith kudsi*, në mes dijetarëve ka pasur divergjenca se ky *hadith* a bën pjesë në *hadith*-et *kudsi* apo jo, pasi nuk ka ndonjë aludim se ku fillon të folurit e Zotit, por disa dijetarë këtë *hadith* e kanë radhitur në koleksionet e tyre si *hadith*-et *kudsi.*

Në këtë *hadith,* Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tregon se është urdhëruar t`i lexojë Kuran Ubeje b. Ka`bit r.a. njërit ndër lexuesit më të mirë të Kuranit dhe njëkohësisht edhe shkrues i tij. Emri i tij është Ubeje b. Ka`b b. Kajs b. Abid b. Zejd b. Muavije b. Amër b. Malik b. Nexhar el-Ensariju, i cili njihet edhe me nofkën `Ebu Mundhir`. Është ndër lexuesit më të mirë të Kuranit. Ka marrë pjesë në besëlidhjen e dytë, ka qenë prezent në Bedër, kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është lutur për të t`i lehtësohet dituria. Umeri r.a. e ka quajtur atë "zotëria i muslimanëve". Ka vdekur në vitin 19 ose 20 h. disa kanë thënë se ka vdekur në vitin 30 gjatë sundimit të Uthmanit r.a.[473]

Transmeton Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më i mëshirshmi i umetit tim është Ebu Bekri, kurse më i ashpri në çështjen e Zotit është Umeri, ai që më së shumti turpërohet është Uthman b. Afani, më i dituri për hallallin dhe haramin është Muadh b. Xhebeli, ai që më së miri e dinë trashëgiminë është Zejd b. Thabiti, më i miri që e lexon Kuranin është Ubeje b. Ka`bi, çdo popull ka besnikun e tij, kurse besniku i këtij umeti është Ebu Ubejde b. Xherahu".*[474]

Mesruku ka thënë: "Gjykatësit prej shokëve të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem kanë qenë: "Umeri, Aliu, Abdullahu, Ubeji, Zejdi dhe Ebu Musa".[475]

Nga *hadith-i kudsi* dhe nga këto transmetime që i shënuam më lart, kuptojmë se nuk i është drejtuar Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem rastësisht këtij *sahab*-iu, porse ai ka qenë i dalluar në shkencat e Kuranit, në njohjen e thellësishme të tij dhe ka qenë prej atyre që më së miri e ka lexuar atë. Sipas një transmetimi që e shënon Ahmedi dhe Taberani, kur ia ka thënë

[473] Ibni Haxher-i, "El-Isabe fi temijizi`s-sahabe", tahkik Abdullah b. Abdulmuhsin et-Turki, Kajro, botimi i parë, 2008, vëll.1, fq.57-60, nr.32;

[474] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Menakibi, bab menakib Muadh b. Xhebel.., nr.3815 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; e shënon edhe në nr.3816 dhe thotë se është hadith Hasenun-Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Sunneh, bab 16, nr.154; Ahmed-i, "Musned", 20/252, nr.12.904;

[475] Ibni Ethir-i, "Usdu`l-Gabe", Daru Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1996, vëll.1, fq.170, nr.34;

këtë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ai ka thënë: "O i Dërguari i Allahut, a më ka përmendur mua me emër?" Ai i tha: *"Po"* me këtë rast Ubeji filloi të qajë".[476]

Kur iu shpall Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem *sure*-ja Bejineh, ai e thirri Ubejin r.a. dhe i tha se Zoti e ka urdhëruar atë që t`ia lexojë këtë *sure* atij në fillim. Arsyeja është se Ubeji ka qenë më i dituri rreth Kuranit dhe se ka qenë prej shkruesve të tij.

Kjo *sure* sipas Ibni Abasit r.a. u shpall në Medine. Kurse sipas Aishes r.a.h. është shpallur në Meke.[477] Por, mendimi se është shpallur në Medine është më i qëndrueshëm, sepse Ubeji është prej *ensar*-ëve, e nuk ka mundësi që të ketë mësuar këtë *sure* në Meke.

Për këtë *sure*, Ebu Nuajmi e përcjell një *hadith* tjetër *kudsi*, përmes Ismail b. Ebu Hakim el-Medeniut, se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. e dëgjon leximin e sures "**Lem jekuni`l-ledhine..**" dhe thotë: **"Përgëzoi robërit e Mi, se pasha Madhërinë Time që do të vëndojë në Xhenet derisa të kënaqesh".**[478]*

Pasi ia lexoi këtë *sure* Ubejit r.a. i tregoi për njeriun, se ai është i pangopur, pa marrë parasysh se sa të mira posedon, ai vazhdimisht do të synojë atë që nuk e ka, edhe pse duart e tij janë të mbushura me mirësi të ndryshme. Njeriu nëse do të posedonte edhe një kodër me ari, do të kërkonte të dytën, e nëse do kishte dy kodra me ari, do të kërkonte të tretën, kështu ai do të lakmojë deri në pafundësi, e kënaqësitë dhe lakmitë e njeriut, i ndërpret vetëm dheu kur do t`i hidhet përmbi në varr, atëherë marrin fund të gjitha ëndërrat dhe kënaqësitë e kësaj bote.

Por, Zoti përsëri tregon se biri i Ademit derën e pendimit do ta ketë hapur, pa marrë parasysh se çfarë mashtrimesh përjeton në jetë, përderisa nuk e pret fundin e tij dhe daljen nga kjo botë, kur më nuk mundet të pendohet dhe të kthehet prapa.

---

[476] Ahmed-i, "Musned", 25/381-382, nr.16.000-16.001; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 22/327, nr.823;

[477] Sujuti-u, "Durru`l-Menthur", vëll.15, fq.570;

[478] Ebu Nuajm-i, "Ma`rifetu`s-Sahabe", Rijad, botimi i parë, 1998, fq.350, nr.1083, por thotë se ky Ismaili nuk është përmendur nga të tjerët se i takon gjeneratës së sahabëve;

Feja e vetme e pranuar te Zoti është feja Islame, e cila fe është më e qëndrueshme, përpos së cilës Zoti nuk pranon asnjë tjetër. Në lidhje me kontekstin e fundit të këtij *hadith*-i, do përmendim disa *ajet*-e ku Zoti tregon për pranimin e fesë Islame dhe refuzimin e religjioneve tjera. Thotë Zoti në Kuran: **"Pa dyshim feja te All-llahu është Islami...".**[479] si dhe thotë: **"E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk do t`i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dështpruarit".**[480]

Ose ajeti: **"Kjo feja juaj është e vetmja fe e Unë jam Zoti juaj, ruajuni dënimit Tim".**[481] Si dhe thotë: **"Përqëndrohu në vetveten tënde sinqerisht në fenë (hanif), i larguar prej çdo të kote, (e ajo fe), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Përqëndrohu në atë fe) Të kthyer sinqerish te Ai, kini frikë prej Atij dhe falnie namazin e mos u bëni nga idhujtarët".**[482]

Për religjionet e devijuara thotë: **"Ata që adhuroni përveç All-llahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që i pagëzuat ju dhe prindërit tuaj. All-llahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos All-llahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë".**[483] Si dhe: **"Ibrahimi nuk ka qenë as jehudi as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota, ishte musliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve".**[484]

Te Zoti këto religjione nuk kanë asnjë peshë, por e vetmja fe e pranuar është feja e Allahut xh.sh., feja Islame. E kush largohet nga këto devijime dhe i kthehet fesë Islame, Allahu xh.sh. ia pastron të gjitha mëkatet dhe e pastron nga e kaluara e tij e errtë.

[479] Kurani, Ali Imran, 19;
[480] Kurani, Ali Imran, 85;
[481] Kurani, Mu`minun, 52;
[482] Kurani, Rum, 30-31;
[483] Kurani, Jusuf, 40;
[484] Kurani, Ali Imran, 67;

DËSHMIA

LA ILAHE IL-LALLAH

MUHAMEDUN RESULULLAH

HADITHI I KATËRDHJETËEGJASHTË (46)

حَدَّثَنَا أَبُو سَعِيدٍ عَمْرُو بْنُ مُحَمَّدِ بْنِ مَنْصُورٍ الْعَدْلُ، ثنا أَبُو الْحَسَنِ مُحَمَّدُ بْنُ إِسْحَاقَ بْنِ إِبْرَاهِيمَ الْحَنْظَلِيُّ، ثنا أَبُو الْحَارِثِ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُسْلِمٍ الْفِهْرِيُّ، ثنا إِسْمَاعِيلُ بْنُ مَسْلَمَةَ، أَنْبَأَ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " لَمَّا اقْتَرَفَ آدَمُ الْخَطِيئَةَ قَالَ: يَا رَبِّ أَسْأَلُكَ بِحَقِّ مُحَمَّدٍ لَمَا غَفَرْتَ لِي، فَقَالَ اللَّهُ: يَا آدَمُ، وَكَيْفَ عَرَفْتَ مُحَمَّدًا وَلَمْ أَخْلُقْهُ؟ قَالَ: يَا رَبِّ، لِأَنَّكَ لَمَّا خَلَقْتَنِي بِيَدِكَ وَنَفَخْتَ فِيَّ مِنْ رُوحِكَ رَفَعْتُ رَأْسِي فَرَأَيْتُ عَلَى قَوَائِمِ الْعَرْشِ مَكْتُوبًا لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ فَعَلِمْتُ أَنَّكَ لَمْ تُضِفْ إِلَى اسْمِكَ إِلَّا أَحَبَّ الْخَلْقِ إِلَيْكَ، فَقَالَ اللَّهُ: صَدَقْتَ يَا آدَمُ، إِنَّهُ لَأُحِبُّ الْخَلْقِ إِلَيَّ ادْعُنِي بِحَقِّهِ فَقَدْ غَفَرْتُ لَكَ وَلَوْلَا مُحَمَّدٌ مَا خَلَقْتُكَ «

Transmeton Umer b. Hattabi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur Ademi alejhi`s-selam bëri gabimin e tij, ai tha: "O Zot, të lutem të më falësh për hir të Muhamedit". Allahu e pyeti:* ***"O Adem, si e njohe Muhamedin kur Unë atë ende nuk e kam krijuar?"*** *Ai tha: "O Zot, kur Ti më krijove mua me dorën Tënde dhe më ke fryrë nga Shpirti Yt, unë ngrita kokën time dhe pashë të shkruar mbi shtyllat e Arshit: "La ilahe il-lallah Muhamedun Resulullah" (Nuk ka hyjni tjetër pos Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Tij). Këtu e kuptova se Ti nuk e vëndon afër Emrit Tënd vetëm se më të dashurën krijesë te Ti". Atëherë Allahu tha:* ***"E ke thënë të vërtetën o Adem! Ai është krijesa më e dashur për Mua. Më lut Mua për hir të tij dhe Unë do ta fali, se sikur të mos ishte Muhamedi, nuk do të krijoja as ty".***[485]

[485] Hakim-i, "El-Mustedrek ale`s-Sahihejn", vëll.2, fq.672, nr.4228, Hakimi thotë se ky hadith është me zinxhir Sahih. Por me këtë mendim nuk pajtohet Dhehebiu, pasi ai thotë se "ky hadith është i shpikur, si dhe Abdur-Rahman b. Zejdi është i dobët, kurse Abdullah b. Muslim el-Fehri nuk e di kush është ky". Të dobët e kanë konsideruar Jahja b. Meini, Imam

Ky transmetim forcohet edhe përmes një transmetimi tjetër, ku përcjell Ibni Abasi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu i ka shpallur Isaut alejhi`s-selam duke i thënë:* ***"O Isa, beso në Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe e urdhëro që të besojë në të çdo person që do ta takojë atë nga populli yt. Sikur të mos ishte Muhamedi, nuk do ta krijoja Ademin, si dhe sikur të mos ishte Muhamedi, nuk do të krijoja Xhenetin dhe Xhehenemin. Kur e krijova Arshin mbi ujë, ai u dridh, e më pas shënova në të La ilahe il-lallah Muhamedun Resulullah, e pastaj u qetësua".***[486]

Është edhe një *hadith* tjetër në të cilin shohim se mbi derën e Xhenetit është e shkruar kjo dëshmi. Transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Është e shkruar mbi derën e Xhenetit njëmijë vite para se të krijohen qiejt e toka: "Muhamedi është i dërguari i Allahut, Aliu është vëllai i të Dërguarit të Allahut".*[487]

Edhe në Kuran vërtetohet se Ademi alejhi`s-selam pranoi prej Zotit disa fjalë, me çka ia fali gabimin e tij, sepse ishte i urdhëruar të mos i afrohet një peme, kurse ai harroi dhe hëngri prej saj. Zoti thotë në Kuran: **"E Ademi**

Ahmedi, Nesaiu, Ukajli, Darimiju, Buhariu, shih për këto vlerësime te Dhehebi-u, "Mizanu`l-I`tidal", vëll.2, fq.564. Ndërsa Ibni Adij në "Kamil" 4/1585 thotë se disa e kanë konsideruar të besueshëm; hadithin e regjistron edhe Taberani-u, në "Mu`xhemu`s-Sagir", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, 1983, vëll.2, fq.82-83 dhe në "Mu`xhemu`l-Eusat", vëll.6, fq.314, nr.6502; Këtë hadith e shënon edhe Sujuti në koment të ajetit 37 të sures Bekare (Sujuti, "Durru`l-Menthur", vëll.1, fq.313); Tekijudin es-Subki e përkrah këtë hadith dhe thotë se në bazë të saj lejohet tevessuli, (shih: Subki, "Shifau`s-Sikam fi zijareti hajri`l-Enam", daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2008, fq.359-360); e regjistron edhe Bejhekiu, në "Delailu`n-Nubuvve", Daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1988, 5/489 dhe thotë se Abdur-Rahman b. Zejdi është i dobët; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/253 thotë se "në këtë hadith ka njerëz që nuk i njoh"; Kadi Ijadi në librin e tij "Esh-Shifa" e shënon këtë hadith në kapitullin për të cilin thotë se hadithet në të janë Sahih dhe Meshhur, shih: Kadi Ijad, "Esh-Shifa bi ta`rifi hukuki`l-mustafa", botimi i parë, 2013, fq.213-223, nr.425;

[486] Hakim-i, "El-Mustedrek ale`s-Sahihejn", vëll.2, fq.671, nr.4227 dhe thotë se "hadithi është me zinxhir Sahih por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar". Ndërsa Dhehebi-u nuk është edhe aq i sigurtë në fabrikimin e këtij transmetimi, ku thotë: "Mendoj se është i fabrikuar në emër të Seidit".

[487] Taberani, "Mu`xhemu`l-Eusat", vëll.5, fq.343, nr.5498 dhe thotë se nuk e dimë që ky hadith përcillet nga dikush tjetër përmes Mis`arit përpos Esh`ath e prej tij Jahja b. Salimi, me këtë veçohet Zekerija b. Jahja;

prej Zotit të vet pranoi disa fjalë (lutje), prandaj Ai ia fali (gabimin), s'ka dyshim se Ai është Mëshiruesi, Pendimpranuesi".[488]

Sipas këtij *hadith*-i, shohim se Ademi alejhi`s-selam në moment kur i është dhënë jeta, ka shikuar në shtyllat e *Arsh*-it dhe ka parë aty të shkruar fjalët e dëshmisë, ku i është bërë e qartë se vetëm dikush i cili është shumë i rëndësishëm mund të ketë të shkruar emrin e tij afër Emrit të Zotit. Për këtë edhe Ademi alejhi`s-selam iu lut Zotit për hir të Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që t`i falet gabimi. Lutja e tyre ishte ashtu siç përmendet edhe në Kuran ku thuhet: **"Ata të dy thanë: "Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë vetvetes, në qoftë se nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!"**[489] Prandaj Zoti ua fali gabimin dhe i zbriti në tokë ku do të jenë ata dhe njerëzit deri në një afat të caktuar.

Disa dijetarë, të mbështetur në këtë *hadith* dhe në disa argumente, kanë thënë se lejohet të bëhet *tevessul* me emrin e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe të kërkohet diçka nga Allahu xh.sh. me ndërmjetësimin e tij.

Në fund të *hadith*-it, Zoti na bën me dije se Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është krijesa më e dashur e Tij, shkaku i të cilit edhe ka krijuar krijesat tjera, se sikur të mos ishte ai, nuk do të krijonte diç tjetër. Zoti është betuar vetëm në te në Kuran dhe në asnjë tjetër prej pejgamberëve ose njerëzve. Zoti thotë në Kuran: **"Pasha jetën tënde (o Muhammed), s'ka dyshim se ata (Populli i Lutit) ishin të humbur në dehjen e tyre".**[490]

Zoti është betuar vetëm në gjëra të rëndësishme e nuk është betuar për gjëra të thjeshta. Kështu që, Zoti vetëm në jetën e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem është betuar në Kuran, me çka nënkuptojmë veçorinë që ia dha Zoti atij. Ai është i veçuar nga të gjithë pejgamberët tjerë, sepse është vula e Pejgamberisë, është mëshirë dërguar njerëzisë dhe i pari që do të ringjallet në Ditën e Llogarisë.

Ai ishte më i mëshirshëm ndaj njerëzve sesa edhe vet ata ndaj vetvetes. Ai u torturua nga populli i tij, kurse nuk bëri lutje siç bëri lutje Nuhu alejhi`s-selam: **"E Nuhu tha: "O Zoti im, mos lë mbi tokë asnjë nga jobesimtarët!"**[491] Kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"O Zot*

[488] Kurani, Bekare, 37;
[489] Kurani, A`raf, 23;
[490] Kurani, Hixhër, 72;
[491] Kurani, Nuh, 26;

mos i dëno sepse ata nuk e dinë se çka po bëjnë". Zoti e quajti Ibrahimin alejhi`s-selam *Halilullah* (dost i Zotit), porse Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte i vetmi që u ngrit në shkallët më të larta në *Miraxh.* Ibrahimi alejhi`s-selam shikoi qiejt nga toka, kurse Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i pa ato nga afër natën e *Miraxh*-it. Zoti bëri që Sulejmani alejhi`s-selam të udhëtojë me ndihmën e erës, që të gjithë e dimë se çka është era, por Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i mundësoi të udhëtojë me *Burak* që askush pas tij nuk ka mundur të udhëtojë me të. Sulejmani alejhi`s-selam udhëtonte distanca udhëtimi me muaj për një kohë të shkurtër, kurse Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem udhëtoi distanca me miliona vite drite për një çast shumë të shkurtë.

Musës alejhi`s-selam Zoti i foli në tokë, kurse Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i foli në qiell. Zoti mundësoi që nga guri të del ujë për Musën alejhi`s-selam kurse Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i mundësoi që përmes gishtave të tij të ndershëm t`u jep njerëzve të pinë ujë të freskët. Zoti mundësoi që atij t`i flasin edhe gjërat e ngurta, ta përshëndesin drunjtë, të bëjnë *tespih* gurët në duart e tij dhe të flet qengji i përgatitur në zjarr për ta helmuar atë.

Allahu xh.sh. e dalloi mbi të gjitha krijesat dhe e ngriti atë në këtë botë dhe në botën tjetër, për të cilin edhe përgatiti një vend të veçantë, që nuk do ta ketë nderin ta ketë asnjë krijesë tjetër përpos tij, që quhet *Mekami Mahmud (Pozita e nderit).*

Allahu xh.sh. na mundësoftë të jetojmë në bazë të mësimeve të tij, jetën e tij ta kemi shembull për ne dhe fëmijët tanë dhe të na mundësojë *shefatin* e tij në Ditën e Gjykimit, që të jemi afër tij në Xhenetet më të larta. Amin.

HADITHI I KATËRDHJETËESHTATË (47)

حَدَّثَنَا سُوَيْدُ بْنُ نَصْرٍ قَالَ: أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ، عَنْ لَيْثِ بْنِ سَعْدٍ قَالَ: حَدَّثَنِي عَامِرُ بْنُ يَحْيَى، عَنْ أَبِي عَبْدِ الرَّحْمَنِ المَعَافِرِيِّ ثُمَّ الحُبُلِيِّ، قَالَ: سَمِعْتُ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ عَمْرِو بْنِ العَاصِ، يَقُولُ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " إِنَّ اللَّهَ سَيُخَلِّصُ رَجُلًا مِنْ أُمَّتِي عَلَى رُءُوسِ الخَلَائِقِ يَوْمَ القِيَامَةِ فَيَنْشُرُ عَلَيْهِ تِسْعَةً وَتِسْعِينَ سِجِلًّا كُلُّ سِجِلٍّ مِثْلُ مَدِّ البَصَرِ، ثُمَّ يَقُولُ: أَتُنْكِرُ مِنْ هَذَا شَيْئًا؟ أَظَلَمَكَ كَتَبَتِي الحَافِظُونَ؟ فَيَقُولُ: لَا يَا رَبِّ، فَيَقُولُ: أَفَلَكَ عُذْرٌ؟ فَيَقُولُ: لَا يَا رَبِّ، فَيَقُولُ: بَلَى إِنَّ لَكَ عِنْدَنَا حَسَنَةً، فَإِنَّهُ لَا ظُلْمَ عَلَيْكَ اليَوْمَ، فَتَخْرُجُ بِطَاقَةٌ فِيهَا: أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، فَيَقُولُ: احْضُرْ وَزْنَكَ، فَيَقُولُ: يَا رَبِّ مَا هَذِهِ البِطَاقَةُ مَعَ هَذِهِ السِّجِلَّاتِ، فَقَالَ: إِنَّكَ لَا تُظْلَمُ "، قَالَ: «فَتُوضَعُ السِّجِلَّاتُ فِي كَفَّةٍ وَالبِطَاقَةُ فِي كَفَّةٍ، فَطَاشَتِ السِّجِلَّاتُ وَثَقُلَتِ البِطَاقَةُ، فَلَا يَثْقُلُ مَعَ اسْمِ اللَّهِ شَيْءٌ»

Transmeton Abdullah b. Amër el-Asi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Në Ditën e Gjykimit, Allahu xh.sh. do ta shpëtojë një njeri prej umetit haptazi para të gjithë krijesave. Do t`ia hapë 99 regjistra, që secili prej tyre është (i madh) sa të shohin sytë dhe i thotë:* ***"A mohon diç prej këtyre? A mos të kanë bërë padrejtësi Shkruesit e Mi?"*** *Ai thotë: "Jo o Zoti im". Allahu i thotë:* ***"A ke ndonjë arsye?"*** *Ai thotë: "Jo o Zoti im". Atëherë (Allahu) thotë:* ***"Gjithësesi se ti e ke një të mirë tek ne dhe ty sot nuk do të bëhet padrejtësi".*** *Atëherë, i nxirret një fletë në të cilën shkruan: "ESHHEDU EN-LA ILAHE IL-LALLAH VE ESHHEDU ENNE MUHAMEDEN ABDUHU VE RESULUHU". Më pas thotë:* ***"Sjelli matësit e tu".*** *Ai thotë: "Ç`është kjo fletë përballë këtyre regjistrave!" Ai thotë:* ***"Ty nuk të bëhet padrejtësi".*** *Të gjitha regjistrat vëndohen në njërën anë të*

peshores, kurse fleta në anën tjetër. Rëndon fleta dhe i fluturon regjistrat. Asgjë nuk peshon më shumë se Emri i Allahut".[492]

Këtu shohim rëndësinë e madhe që i është dhënë dëshmisë *La ilahe il-lallah* dhe se kjo fjalë pronarin e vet e pozicionon në Xhenet dhe e shpëton nga Zjarri. Në këtë *hadith* shohim se në Ditën e Llogarisë, kur do të dalin të gjithë njerëzit para Zotit dhe do të maten punët e tyre, do të paraqitet edhe një person i cili ka pasur shumë mëkate, ndërsa veprat e mira kanë qenë të pakta, saqë mëkatet e tij janë regjistruar në 99 regjistra të mëdhenj që nuk i zë as syri i njeriut. Njeriu do të shikojë në to dhe do të shoh se të gjitha mëkatet që ka kryer gjatë jetës së tij janë të shënuara aty dhe asgjë nuk i është mangësuar apo shtuar. Zoti do ta pyesë se nëse mohon diç prej tyre, apo vallë mos të është shkruar diç që nuk e ke kryer? Njeriu nuk mund të mohojë këto, sepse e din shumë mirë se ai është autori i të gjithë atyre veprave negative. Vëren se melekët nuk i kanë bërë asnjë padrejtësi dhe nuk i kanë shkruar asgjë më tepër sesa ka bërë.

Nga ana e Zotit do të pyetet nëse ka ndonjë arsyetim për të gjitha këto mëkate, por njeriu nga turpi do të hesht dhe nuk do të ketë guxim të flet para madhërisë së Zotit. Njeriut nuk i kujtohet që ndonjëherë ka kryer ndonjë punë të mirë. Në këtë rast, Zoti i thotë se Ne nuk të bëjmë padrejtësi ty, pasi ti e ke një të mirë. Kur do të sjellin një fletë të vogël, do të mendojë me vete se çka mund të bëjë kjo fletë e vogël në krahasim me ato 99 regjistrat gjigant, por në moment kur do të vëndohen në peshojë regjistrat dhe fleta e vogël, do të rëndojë fleta e vogël, kurse regjistrat do të humben nga shikimi. Njeriu në këtë habi, do të pyet se çka ka të shënuar në këtë fletë, që i rëndoi të gjitha ato regjistra? Kur në të do të vërejë se ka qenë e shkruar fjala *La ilahe il-lallah.* Pra, duhet të dimë se asgjë nuk mund të jetë më e rëndë sesa Emri i Allahut dhe se mëkatet e shumta, nuk mund të peshojnë më shumë se Emri i Allahut xh.sh.

[492] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Imanu, bab 17, nr.2648 dhe thotë se është Hasenu-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 35, nr.4300; Ahmed-i, "Musned", 11/570, nr.6994; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/710, nr.1937 dhe thotë se "hadithi është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar", e me të pajtohet edhe Dhehebiu; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i fortë, transmetuesit janë të besueshëm, transmetues që gjenden në dy Sahihet, përpos Ibrahim b. Is`hakut, prej të cilit përcjell vetëm Muslimi në hyrje, Ibni Meini e ka konsideruar të besueshëm...".

Zoti i garanton falje mëkatesh dhe hyrje në Xhenet, atij i cili e ka shoqërues të vetin këtë fjalë dhe vdes si musliman.

Transmeton Ebu Derda radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë `La ilahe il-lallah vahdehu la sherike leh`, do të hyj në Xhenet".* I thashë: "Edhe nëse bën zina dhe vjedh?" Tha: *"Edhe nëse bën zina dhe vjedh!"* I thashë: "Edhe nëse bën zina dhe vjedh?" Tha: *"Edhe nëse bën zina dhe vjedh*!" I thashë: "Edhe nëse bën zina dhe vjedh?" Tha: *"Edhe nëse bën zina dhe vjedh, pavarësisht se Ebu Derdasë nuk i bëhet qejfi...".*[493]

Transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Do të nxirret nga Zjarri, secili që ka thënë La ilahe il-lallah dhe në zemrën e tij ka ndonjë vepër të mirë sa pesha e një grimce..".*[494]

Transmeton Ebi Shejbe el-Hudriju radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë La ilahe il-lallah, do të hyj në Xhenet".*[495]

Në një transmetim, tregohet biseda e Musës alejhi`s-selam me Zotin kur ai kërkoi që t`i mësojë Zoti ndonjë fjalë e cila do të jetë e rëndë në peshojë dhe do të jetë fjalë që do ketë rëndësi të madhe. Zoti i bëri me dije se nuk ka asgjë më të rëndë sesa *Shehadeti*.

Transmeton Ebu Seid el-Hudriju radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Musa alejhi`s-selam tha: "O Zot, më mëso diçka përmes së cilës të përkujtoj dhe të të lutem!". Zoti i tha:* ***"O Musa, La ilahe il-lallah".*** *Musa tha: "O Zot, por të gjithë njerëzit e thonë këtë?" I tha:* ***"O Musa, La ilahe il-lallah".*** *Musa tha: "Nuk ka zot tjetër përpos Teje! Unë desha diçka me çka të arrij shpërblime?" Zoti i tha:* ***"O***

---

[493] Ahmed-i, "Musned", 45/483, nr.27.561; Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", 1/11, nr.5; Nesai-u, "Amelu Jaumi ve lejleti", Muessesetu`r-Risale, nr.1124; Begavi-u, "Sherhu`s-Sunneh", 1/99, nr.54; Hejthemi-u, "Mexhmeu`z-Zevaid", vëll.1, fq.29, nr.8; dhe thotë: "E transmeton Ahmedi, Bezzari, Taberani në "Kebir" dhe "Euset", e zinxhiri i Ahmedit është më i saktë, aty gjendet Ibni Lehia, me të cilin kanë argumentuar edhe të tjerë; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi, thotë se është Sahih;

[494] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, nr.7410; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, nr.325; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, nr.4312; etj.

[495] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 22/313, nr.790; Taberani thotë: "Nuk përcillet diçka tjetër nga Ebi Shejbe, përpos këtij zinxhiri, e me këtë veçohet vetëm Ebu Asimi (njëri nga përcjellësit e hadithit)";

Musa, sikur shtatë qiejt dhe çka ka në to, shtatë tokat dhe çka ka në to, të vihen në njërën anë të peshojës dhe fjala La ilahe il-lallah në anën tjetër, do të peshonte shehadeti".[496]

Nuk mund të peshojë asgjë më rëndë në *Mizan* sesa emri i Zotit dhe fjala e Tij, prandaj duhet ta themi sa më shumë brenda ditës. Kjo është fjala që më së shumti e urren *shejtan*-i, sepse njerëzit që janë të lidhur me këtë fjalë, nuk do të arrijë t`i bëjë banorë të Zjarrit.

Sufjan eth-Theuri ka thënë: "Nuk ka fjalë më të rëndë për Iblisin sesa fjala La ilahe il-lallah".[497]

[496] Nesai-u, "Amelu jaumi ve lejleti", fq.482, nr.834; Ebu Ja`la, "Musned", fq.305, nr.1394; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/710, nr.1936 dhe thotë se është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar". Me këtë pajtohet edhe Dhehebiu; Ibni Haxher el-Askalani e ka konsideruar Sahih këtë zinxhir të hadithit që e ka shënuar Nesaiu, (shih: Ibni Haxheri, "Fet`hul-Bari", 13/464); Në zinxhir gjendet Derraxhe, për të cilin Ebu Hatimi, Nesaiu, Darekutni, Berkani e disa të tjerë thonë se është i dobët, por të besueshëm e konsideron Ibni Meini, Darimiju etj. (Për vlerësimin e Deraxhit shih më shumë në: Miziu, "Tehdhibu`l-Kemal", vëll.8, fq.477-485, nr.1797).

[497] Dhehebi-u, "Sijeru`l-A`lam en-Nubela", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i dytë, 1982, vëll.7, fq.260;

HADITHI I KATËRDHJETËETETË (48)

ثَنَا عَلِيُّ بْنُ مُوسَى الرِّضَا، حَدَّثَنِي أَبِي مُوسَى بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنِي أَبِي جَعْفَرُ بْنُ مُحَمَّدٍ، حَدَّثَنِي أَبِي مُحَمَّدُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنِي أَبِي عَلِيُّ بْنُ الْحُسَيْنِ بْنِ عَلِيٍّ، حَدَّثَنِي أَبِي الْحُسَيْنُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنِي أَبِي عَلِيُّ بْنُ أَبِي طَالِبٍ رَضِيَ اللهُ تَعَالَى عَنْهُمْ، حَدَّثَنَا رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ جِبْرِيلَ عَلَيْهِ السَّلَامُ، قَالَ: " قَالَ اللهُ عَزَّ وَجَلَّ: «إِنِّي أَنَا اللهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِي، مَنْ جَاءَنِي مِنْكُمْ بِشَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللهُ بِالْإِخْلَاصِ دَخَلَ فِي حِصْنِي , وَمَنْ دَخَلَ فِي حِصْنِي أَمِنَ مِنْ عَذَابِي»

Transmeton Ali b. Ebu Talibi radijeAllahu anhu se I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më ka thënë Xhibrili a.s.: "Allahu xhele she`nuhu ka thënë*: ***"Padyshim se Unë jam Allahu nuk ka zot tjetër përpos Meje, andaj më adhuroni vetëm Mua! Kush prej jush vjen tek Unë me dëshminë La ilahe il-lallah (duke e pohuar) me sinqeritet, do të hyj në mbrojtjen Time, e kush hyn në mbrojtjen Time, ai është i siguruar nga dënimi Im".***[498]

Zoti vazhdimisht na bën me dije se çdo i adhuruar tjetër përpos Allahut xh.sh. është i rrejshëm dhe i kotë, andaj ne duhet të drejtojmë adhurimin tonë vetëm ndaj Zotit të botëve, i Cili krijon dhe furnizon të gjitha krijesat. Ky ishte edhe misioni i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem gjersa ishte në Meke, përgjatë 13 viteve ai bëri thirrje për të besuar vetëm Allahun xh.sh. si Zot ndërsa të mohohen idhujt. Kush prej njerëzve e pohon *shehadetin* me zemër, fjalë e cila ngërthen njëshmërinë e Zotit dhe mohimin e idhujve, Allahu xh.sh. do ta merr atë rob në mbrojtjen e Tij, e kush futet

[498] Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", vëll.3, fq.191-192 dhe thotë se ky hadith është i verifikuar me këtë sened, i cili përcillet prej të pastërve, nga prindërit e tyre të mirë, e disa prej gjeneratës së parë kanë thënë për këtë sened kur e kanë përcjellë se nëse i lexohet edhe një të çmenduri, do ta pranonte".

në mbrojtjen e Tij, e cila është mbrojtja më e mirë dhe nuk mund të dëmtohet ai i cili hyn në këtë mbrojtje, atëherë Zoti do ta sigurojë edhe nga dënimi i Tij në Ditën e Kijametit, kur nuk ka dobi prej askujt, përpos se daljes para Zotit me zemër të pastër dhe me vepra të sinqerta.

Ky *hadith* përcillet edhe përmes një rruge tjetër, deri diku të ngjashëm për nga përmbajtja, të cilën e transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ka thënë Zoti:* ***"La ilahe il-lallah është Fjala Ime dhe Unë jam Ai, kur e shqipton atë robi Im, e fus në Xhenetin Tim dhe ai është i sigurtë, Kurani është Fjala Ime dhe prej Meje ka dalë".***[499]

Fundja, na bëhet me dije se kush e shqipton me sinqeritet dëshminë, do të jetë i mbrojtur nga zjarri i Xhehenemit. Pra, sinqeriteti është prej kushteve kryesore, sepse edhe *mynafik*-ët e kanë deklaruar *shehadet*-in, por nuk e kanë besuar atë me zemër, po vetëm me gjuhë. Ka edhe nga pabesimtarët që e shprehin dëshminë me gjuhët e tyre për të debatuar, porse ata nuk e besojnë, këtyre nuk do ju bëjë dobi dëshmia, pasi për të qenë i vlefshëm besimi, kërkohet sinqeritet, me çka arrihet mbrojtja nga dënimi i përhershëm.

Imam Ebu Hanife thotë: "Imani është deklarimi me gjuhë dhe besimi me zemër".[500] Përderisa nuk e beson atë që e flet, ajo është e pavlefshme. Allahu xh.sh. na bëftë të sinqertë në fjalët tona dhe të jetë kjo dëshmi shkak që të jemi të mbrojtur nga zjarri i Xhehenemit.

[499] Dejlemi-u, "Firdeus", vëll.3, fq.173, nr.4464; por ky hadith është klasifikuar si i falsifikuar nga disa dijetarë.
[500] Ebu Hanife, "Fikhu`l-Ekber", fq.76;

HADITHI I KATËRDHJETËENËNTË (49)

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرٍ قَالَ: حَدَّثَنَا الْحُسَيْنُ بْنُ عَلِيٍّ، عَنْ حَمْزَةَ الزَّيَّاتِ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنِ الْأَغَرِّ أَبِي مُسْلِمٍ، أَنَّهُ شَهِدَ عَلَى أَبِي هُرَيْرَةَ، وَأَبِي سَعِيدٍ، أَنَّهُمَا شَهِدَا عَلَى رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " إِذَا قَالَ الْعَبْدُ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، قَالَ يَقُولُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: صَدَقَ عَبْدِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا وَأَنَا أَكْبَرُ، وَإِذَا قَالَ الْعَبْدُ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ، قَالَ: صَدَقَ عَبْدِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا وَحْدِي، وَإِذَا قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، قَالَ: صَدَقَ عَبْدِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا وَلَا شَرِيكَ لِي، وَإِذَا قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، قَالَ: صَدَقَ عَبْدِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا، لِي الْمُلْكُ، وَلِيَ الْحَمْدُ، وَإِذَا قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، قَالَ: صَدَقَ عَبْدِي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِي "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) dhe Ebu Seidi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "*Kur robi thotë La ilahe il-lallahu vallahu ekber, tha: "Zoti thotë:* ***"Të vërtetën e ka thënë robi Im, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje dhe Unë jam më i Madh".*** *Kur robi thotë La ilahe il-lallahu vahdehu, Zoti thotë:* ***"Të vërtetën e ka thënë robi Im, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje të Vetmit".*** *Kur thotë: "La ilahe il-lallahu la sherike lehu, thotë:* ***"Të vërtetën e ka thënë robi Im, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje dhe Unë nuk kam ortak".*** *Kur thotë "La ilahe il-lallahu lehu`l-mulku ve lehu`l-hamdu", thotë:* ***"Të vërtetën e ka thënë robi Im, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje dhe vetëm Mua më takon sundimi dhe falënderimi".*** *Kur thotë "La ilahe il-lallahu ve la hauvle ve la kuvete il-la bil-lah", thotë:* ***"Të vërtetën e***

ka thënë robi Im, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje dhe nuk ka forcë dhe fuqi tjetër përpos Meje".[501]

Të përkujtuarit e Allahut xh.sh. është prej veprave më madhështore në fenë tonë, njeriu që zemrën e tij e ka të lidhur për Zotin, do të jetë gjithmonë e qetë dhe e nënshtruar. Zoti dëshiron që besimtarët sa më tepër të bëjnë *dhikr* dhe të përmendin Emrin e Tij, ku ndër *dhikr*-et më të preferuara, është shqiptimi i *shehadet*-it, i cili është ripërtërirës i besimit.

Në këtë *hadith*, janë përmbledhur disa veçori të *dhikr*-it, siç është shqiptimi i *shehadet*-it dhe madhnimi i Zotit me *tekbir*, me çka ne vërtetojmë se nuk ka askush më shumë meritë për adhurim sesa Allahu xh.sh. dhe se vetëm Ai meriton të lartësohet me *tekbir*, pasi nuk ka gjë më madhështore në jetën tonë sesa Allahu xh.sh. Gjatë çdo shqiptimi të *dhikr*-it, Zoti e konfirmon pohimin e robit të Vet, me çka tregohet se Zoti është përcjellës i veprave të njerëzve dhe se Ai e shikon adhurimin e besimtarit dhe nuk e lë anash.

Po ashtu, në këtë *dhikr*, përfshihet edhe mohimi i çdo idhulli apo hyjnie tjetër përpos Zotit dhe se Ai nuk ka ortak në krijimin dhe sundimin e Tij. Besimtari me bindje dhe shqiptim deklaron se vetëm Zotit i takon sundimi absolut dhe vetëm Ai është meritor për falënderim. Pra, në këtë *dhikër*, përfshihet edhe falënderimi i Zotit, si dhe përshkrimi i Fuqisë Absolute vetëm Zotit, me çka tregojmë bindjen e pastër Islame se me Allahun xh.sh. askush nuk është i barabartë.

Prej *dhikre*-ve që më së shumti përdoren janë edhe *tespihu*, *shehadeti*, falënderimi (*hamdi*), shqiptimi *la haule ve la kuvete il-la bilah*, ku të gjitha këto janë përfshirë në këtë *hadith* madhështorë. Nëse një rob është i shoqëruar nga këto fjalë gjatë jetës së vet, pastaj kur të vijë çasti i fundit dhe i shqipton këto fjali dhe vdes, ky njeri do të ketë mbrojtjen e Zotit nga zjarri i Xhehenemit.

Kjo shtesë gjendet tek Sunen-i i Tirmidhi-ut ku thuhet në fund të këtij *hadith*-i: ***"...Dhe tha: "Kush e thotë këtë gjatë sëmundjes dhe vdes, nuk do ta prek Zjarri".***

[501] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edebi, bab 54, nr.3794; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 36, nr.3441 dhe thotë se hadithi është Hasen; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/46, nr.8 dhe thotë se hadithi është Sahih por nuk e kanë regjistruar në dy Sahihet...". etj.

Edhe i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem na mësoi që njerëzve që janë në prag të vdekjes, t`ua përkujtojmë dëshminë. Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Përkujtoni ata që janë duke vdekur me fjalën La ilahe il-lallah".*[502]

Për atë që e thotë këtë fjalë para se të vdes, do të ketë shpërblim Xhenetin e Zotit. Transmeton Muadh b. Xhebeli radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ai që fjalën e tij të fundit e ka `LA ILAHE IL-LALLAH`, do të hyjë në Xhenet".*[503]

Të jemi sa më shumë të lidhur me këtë fjalë gjatë ditëve dhe netëve tona, ta përsërisim sa më shpesh, që të ngulitet në zemrat tona, të jetë shoqëruesi i jonë në çastet e vështira dhe të jetë pohimi i jonë gjatë dhënies së shpirtit, që ta takojmë Zotin me këto shprehje madhështore.

[502] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 1, nr.917; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhenaizu, bab fi telkin, nr.3117 nga Ebu Seid El-Hudriju r.a.;

[503] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhenaizu, bab 20, nr.3116; Ahmed-i, "Musned", 36/329, nr.22.003; Hakim-i në "Mustedrek", vëll.1, fq.503, nr.1299 dhe Hakimi këtë hadith e konsideron se ka zinxhir Sahih, e me këtë pajtohet edhe Dhehebiu;

VEÇORITË E MUHAMEDIT ALEJHI SELAM

HADITHI I PESËDHJETË (50)

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ، ثنا عَارِمٌ أَبُو النُّعْمَانِ، ثنا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ السَّائِبِ، قَالَ حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، أَظُنُّهُ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: ح. وَحَدَّثَنَا الْحُسَيْنُ بْنُ إِسْحَاقَ التُّسْتَرِيُّ، ثنا أَبُو الرَّبِيعِ الزَّهْرَانِيُّ، ثنا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ السَّائِبِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللهُ عَنْهُمَا، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " سَأَلْتُ رَبِّي مَسْأَلَةً وَدِدْتُ أَنِّي لَمْ أَسْأَلْهُ، قُلْتُ: يَا رَبِّ كَانَتْ قَبْلِي رُسُلٌ، مِنْهُمْ مَنْ سَخَّرْتَ لَهُمُ الرِّيَاحَ، وَمِنْهُمْ مَنْ كَانَ يُحْيِي الْمَوْتَى، قَالَ: أَلَمْ أَجِدْكَ يَتِيمًا فآوَيْتُكَ؟ أَلَمْ أَجِدْكَ ضَالًّا فَهَدَيْتُكَ؟ أَلَمْ أَجِدْكَ عَائِلًا فَأَغْنَيْتُكَ؟ أَلَمْ أَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ، وَوَضَعْتُ عَنْكَ وِزْرَكَ؟ قَالَ: قُلْتُ: بَلَى يَا رَبِّ "

Transmeton Ibni Abasi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"E kam pyetur Zotin për një çështje, që kam premtuar se më nuk do ta pyesë. Thashë: "O Zoti im, para meje kanë jetuar pejgamberë të cilët i ka bartur era, po ashtu prej atyre që kanë ngjallur të vdekurit?!". Tha:* ***"A nuk të gjeta jetim dhe të strehova? A nuk të gjeta të humbur dhe të udhëzova? A nuk të gjeta të varfër dhe të pasurova? A nuk ta kam hapur gjoksin? A nuk ta kam hequr barrën?"*** Tha: *"Thashë: "Po gjithsesi o Zot"*.[504]

[504] Taberani-u, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.11, fq.455, nr.12.289; e shënon edhe Hakim-i, në "El-Mustedrek", vëll.2, fq.573, nr.3944 dhe thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar; edhe Dhehebi-u në "Telhis" thotë se është Sahih; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/324, nr.13.921 thotë: E shënon Taberani në "Kebir" dhe "Euset" por në zinxhir gjendet Ata` b. Saib i cili kah fundi i jetës është bërë konfuz dhe ka ngatërruar hadithet", Prej Ata` b. Saibit përcjell hadithe edhe Buhari-u në librin e tij "Es-Sahih" (shih nr.6578) dhe të tjerët. Hamad b. Zejdi, i cili e përcjell këtë hadith prej tij, e ka dëgjuar hadithin para se të bëhet konfuz Ata`i. Për vlerësimet dhe kritikat ndaj Ata` b. Saibit, shiko më shumë te: Miziu, "Tehdhibu`l-Kemal", vëll.20, fq.86-93, nr.3934;

Të gjithë pejgamberët, kanë pasur veçoritë dhe specifikat e tyre. Të gjithë pejgamberët, kanë qenë të dërguar me mrekulli dhe cilësi të përsosura. Por, thirrja e tyre ka qenë e kufizuar vetëm në popujt e tyre dhe për kohën kur janë dërguar. Kurse, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është pejgamber për gjithë popujt deri në Ditën e Fundit.

Veçoritë e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem janë të shumta, siç edhe flet vet ai në *hadith*-in të cilin e transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mua më janë dhënë pesë veçori, të cilat nuk i janë dhënë askujt para meje: "Jam ndihmuar me forcën e frikësimit të armikut në një distancë prej një muaj ecje; e tërë toka më është bërë mesxhid dhe pastrim, kështu që cilin burrë prej ummetit tim e zë koha e namazit, le të falet aty; më është lejuar plaçka e luftës, e cila nuk i është lejuar askujt para meje; më është dhënë mundësia e shefatit dhe secili pejgamber ka qenë i dërguar vetëm për popullin e tij, ndërsa unë jam dërguar për mbarë njerëzimin".*[505]

Në këtë *hadith*, numri pesë nuk është i fiksuar, sepse ka shumë transmetime të cilat tregojnë për veçori tjera, ku San`ani thotë se janë 21, ndërsa Ebu Seid en-Nisaburi e rit numrin deri në 60 veçori, kurse imam Sujuti mbi 100.[506]

Në disa transmetime përmendet se e ka dalluar edhe me fjalimin e përmbledhur, që në fjalë të shkurtra, ka përmbledhur kuptime të mëdha. Po ashtu, se është vula e Pejgamberisë, që nuk janë përmendur në këtë *hadith*. Në një transmetim tjetër tek Muslimi, thuhet se ky *umet* është i dalluar edhe me rreshtat e namazit, që nuk i kanë të tjerët. Gjithashtu, dy *ajet*-et e fundit të sures Bekare, janë ajete që nuk i kanë zbritur ngjashëm me ta asnjë pejgamberi më parë. Në një transmetim të Ahmedit, thuhet se është i dalluar me tre veçori, me atë që Zoti i ka dhënë çelësat e tokës, e ka quajtur Ahmed dhe *umet*-in e tij e ka dalluar nga të gjithë të tjerët. Tek Bezari, në një transmetim nga Ebu Hurejre r.a. thuhet se e ka dalluar me faljen e mëkateve të më hershme dhe të më vonshme, se e ka bërë *umet*-in e tij *umeti* më i *hajrit*, se Zoti i ka dhënë lumin *Keuther*, kurse në transmetimin nga Ibni

[505] Buhari-u, "Sahih", kitab Tejemmumu, bab 1, nr.335; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu, bab 1. nr.521; Nesai-u, "Sunen", kitab Tahareti, bab Tejemum bi`s-Sajd, nr.432 dhe në kitab el-Mesaxhidi, bab 42, nr.737; Ahmed-i, "Musned", 22/165, nr.14.264; Darimi-u, "Sunen", kitab es-Salati, Daru`l-Hadith, Kajro, botimi i parë, 2000, bab 111, nr.1389;

[506] Kashmiri, "Fejdu`l-Bari ala Sahih el-Buhari", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2005, vëll.1, fq.515;

Abasi r.a. thotë se e ka dalluar me atë që *shejtan*-i i tij ka qenë pabesimtarë, kurse i ka mundësuar që ta pranojë Islamin.[507]

Prej veçorive të pejgamberëve të mëhershëm që i potencoi Pejgamberi jonë sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte fluturimi me ndihmën e erës. Kjo veçori, i ka takuar Sulejmanit a.s. i cili ka qenë i dalluar me shumë veçori. Zoti thotë në Kuran: **"Ndërsa Sulejmanit (ia nënshtruam) erën e fortë që sipas dëshirës së tij ecte me të deri te toka të cilën e kemi bekuar Ne. Ne jemi të Gjithëdijshëm për çdo gjë".[508]**

Ngjashëm thotë: **"Edhe Sulejmanit ia nënshtruam erën që paraditja (e udhëtimit me të duke shkuar) ishta sa një muaj dhe pasditja e saj (në të kthyer) ishte sa një muaj (udhëtimi). I bëmë që atij t`i rrjedhë burim i remit dhe me urdhrin e Zotit të tij, ia nënshtruam xhinët që punonin sipas dëshirës së tij, e kush largohet prej tyre nga urdhëri i Jonë, atij do t`ia shijojmë zjarrin e fortë".[509]**

Kjo përsëritet edhe në një vend tjetër ku thuhet: **"Ne ia nënshtruam erën që sipas urdhrit të tij, ajo të ecën lehtë dhe nga të dëshirojë ai".[510]**

Kjo ishte veçoria e Sulejmanit a.s., kurse për veçorinë e Pejgamberit tjetër të cilin e përmendi në *hadith*, ku thotë se i ngjallte të vdekurit, është e Isaut a.s. i cili po ashtu ka qenë i dalluar me shumë veçori. Thotë Zoti në Kuran: **"Allahu i thotë: "O Isa biri i Merjemes, përkujto të mirat e Mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate, kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin), e ti u fole njerëzve që kur ishe në djep dhe kur ishe i pjekur, kur ta mësova ty librin dhe urësinë, Tevratin dhe Inxhilin, kur me lejen Time formove nga balta si formë shpeze dhe i fryve asaj dhe me urdhërin Tim u bë shpend, kur e shërove të verbërin dhe të sëmurin nga sëmundja e lëkurës me dëshirën Time, kur me urdhërin Tim i nxore (të gjallë) të vdekurit, kur i zbrapsa beni Israilët prej teje (që dëshiruan të të vrasin) atëherë kur erdhe me argumente, e disa prej tyre që nuk besuan, thanë: "Kjo nuk është tjetër vetëm se magji e qartë".[511]**

---

[507] Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari", vëll.2, fq.18;
[508] Kurani, Enbija, 81;
[509] Kurani, Sebe`, 12;
[510] Kurani, Sad, 36;
[511] Kurani, Maide, 110;

Por, mrekullia e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk duhej të ishte e përkohshme, porse e përhershme. Mrekullitë e tilla që u kanë ndodhur pejgamberëve të mëhershëm, i kanë dëshmuar vetëm popujt e tyre, kurse për to na ka lajmëruar vet Zoti, sepse përndryshe ne nuk do të dinim për ngjarjet e tilla, ndërsa, mrekullia e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem është e përhershme, sepse gjendet në duart tona, e lexojmë atë për çdo ditë dhe dëshmojmë mrekullinë e tij.

Zoti në këtë pyetje, i bëri me dije edhe shumë të mira të tjera, të cilat janë më meritore për t`u përmendur, sesa ato që i kanë tërhequr vëmendjen. Zoti tregon në Kuran, për këto që i përmendi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në këtë *hadith*. Allahu xh.sh. thotë: **"Pasha paraditën. Pasha natën kur shtrinë errësirën. Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të ka përbuzur (nënvlerësuar). Dhe se (bota) e ardhëshme është shumë më e mirë për ty sesa e para. E Zoti yt do të jep ty, e ti do të jesh i kënaqur. A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri strehim?! Dhe të gjeti të humbur, e Ai të udhëzoi?! Dhe të gjeti të varfër, e Ai të pasuroi?! Pra, mos e përul jetimin. As lypësin mos e përzë. E me të mirat që të dha Zoti yt, tregohu".**[512]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem mbeti jetim që në moshë të hershme. Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i vdiq babai i tij Abdullahu, duke qenë nëna e tij shtatzënë, kurse nëna e tij, Eminja, i vdiq duke qenë ky në moshën gjashtë vjeçare. Më pas, përkujdesin ndaj tij e mori mixha i tij, Abdulmutalibi.[513]

I përmendi edhe gjendjen e humbjes dhe më pas udhëzimin pas saj. Katade thotë se këto tre gjendje që i përmend *ajet*-i kuranorë, ishin para se të dërgohet pejgamber.[514]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem gjersa ishte në Meke, shpesh vetmohej në shpellën Hira, ku shkonte të meditonte dhe të largohej nga mosbesimtarët dhe ideologjitë pagane që gjendeshin në Meke. Pas kësaj gjendjeje, Zoti e udhëzoi duke i shpallur Kuranin. Zoti thotë në Kuran: **"Ne me të shpallur të këtij Kurani, po të rrëfejmë ty më të bukurin tregim,**

[512] Kurani, Duha, 1-11;
[513] Ibni Hisham-i, "Siretu Nebevije", Daru Ibni Hazëm, Bejrut, botimi i dytë, 2009, fq.76 dhe 80;
[514] Taberi-u, "Xhamiu`l-Bejan fi te`vili`l-Kuran", vëll.24, fq.489;

edhe pse para kësaj ti ishe nga të painformuarit".[515] Po ashtu i thotë: **"Po kështu me urdhërin Tonë, Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kuranin). Ti nuk ke ditur çka është Libri dhe besimi. Por, Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve Tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë".**[516]

Imam Kurtubiu thotë: "Ne të gjetëm ty në mesin e popullit të humbur dhe i udhëzuam përmes teje".[517] Gjithashtu, përmend se ka qenë i humbur nga njohuria kur u pyet për as`habu`l-Kehf-in, Dhulkarnejn-in dhe shpirtin, e Allahu e udhëzoi në njohurin rreth tyre.[518] Po ashtu, thuhet se ka të bëjë në lidhje me *kible*-n, se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte në kërkim të kibles, e Allahu e udhëzoi drejt saj.[519]

Seid b. Xhubejri thotë se Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem doli me xhaxhanë e tij Ebu Talibin në një udhëtim, e Iblisi kapi kapistrin e kafshës së tyre dhe i devijoi në një rrugë gjatë errësirës, por atyre u erdhi në ndihmë Xhibrili a.s. dhe i frymëzoi në rrugën e drejtë.[520]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte i varfër, por Zoti e pasuroi, duke e martuar me Hadixhen r.a.h.[521] Atau thotë se ka qenë me zemër të varfër, por Zoti ia mbushi shpirtin me të mira.[522]

Gjithashtu, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i përmendi në këtë *hadith kudsi* edhe dy vargjet e para të *sures* Inshirah. Zoti në to thotë: **"A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd?! Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde!".**[523] Zoti ia hapi gjoksin dhe zemrën për udhëzimin, Islamin, Imanin dhe njohjen e të vërtetës.[524] Kurse në lidhje me barrën që përmendet në *hadith*, nënkupton se Zoti ia largoi dhe e pastroi prej të gjitha mëkateve të mëhershme dhe të mëvonshme.

---

[515] Kurani, Jusuf, 3;
[516] Kurani, Esh-Shura, 52;
[517] Kurtubi-u, "Xhamiu`l-Ahkami`l-Kuran", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 2006, vëll.22, fq.343;
[518] Po aty;
[519] Po aty;
[520] Po aty;
[521] Po aty, fq.346;
[522] Po aty;
[523] Kurani, Inshirah, 1-2;
[524] Taberi-u, po aty, vëll.24, fq.492;

Me këtë, Zoti i bëri me dije Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të vlerësojë atë që posedon dhe të mos kërkojë dhe lakmojë ato që nuk i ka. Duhet ditur vlerën gjërave që i kemi dhe të jemi të kënaqur me atë që na ka caktuar Zoti. Edhe Musa a.s. kërkoi të sheh Zotin, porse Zoti i bëri me dije se kjo për të nuk është e mundur dhe të mos kërkojë gjëra të tilla. Zoti thotë në Kuran: **"E kur Musa erdhi në kohën që i caktuam dhe i foli Zoti i vet, ai tha: "Zoti im, më mundëso të të shoh". Ai i tha: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh..."** Më pas i tha: **"O Musa, Unë të dallova ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit Tim. Merr atë që të dhash dhe bëhu mirënjohës".**[525]

Ka edhe shumë interpretime tjera, porse me këto plotësohet kuptimi i përafërt i këtij *hadith*-i.

[525] Kurani, A`raf, 143-144;

HADITHI I PESËDHJETËENJËTË (51)

حَدَّثَنَا أَبُو سَلَمَةَ مَنْصُورُ بْنُ سَلَمَةَ الْخُزَاعِيُّ، حَدَّثَنَا لَيْثٌ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ الْهَادِ، عَنْ عَمْرِو بْنِ أَبِي عَمْرٍو، عَنْ أَبِي الْحُوَيْرِثِ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ جُبَيْرِ بْنِ مُطْعِمٍ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ، قَالَ: خَرَجَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَاتَّبَعْتُهُ حَتَّى دَخَلَ نَخْلًا فَسَجَدَ، فَأَطَالَ السُّجُودَ حَتَّى خِفْتُ – أَوْ خَشِيتُ – أَنْ يَكُونَ اللهُ قَدْ تَوَفَّاهُ – أَوْ قَبَضَهُ – قَالَ: فَجِئْتُ أَنْظُرُ فَرَفَعَ رَأْسَهُ، فَقَالَ: " مَا لَكَ يَا عَبْدَ الرَّحْمَنِ " قَالَ: فَذَكَرْتُ ذَلِكَ لَهُ، قال: فَقَالَ: " إِنَّ جِبْرِيلَ عَلَيْهِ السَّلامُ قَالَ لِي: أَلا أُبَشِّرُكَ إِنَّ اللهَ عَزَّ وَجَلَّ يَقُولُ لَكَ: مَنْ صَلَّى عَلَيْكَ صَلَّيْتُ عَلَيْهِ، وَمَنْ سَلَّمَ عَلَيْكَ سَلَّمْتُ عَلَيْهِ "

Transmeton Abdurrahman b. Aufi (r.a.) i cili thotë: "Doli i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe unë fillova ta ndjek derisa hyri në një kopsht me hurma, ra në sexhde dhe e zgjati atë aq shumë, saqë u frikësova se mos Zoti ia ka marr shpirtin. U nisa për te ai derisa e arrita, ula kokën dhe e shikoja në fytyrën e tij. Ai tha: *"Çfarë ke o Abdurahman?"* I thashë: "Ia tregova rastin dhe ai tha: *"Me të vërtetë Xhibrili alejhi`s-selam më tha mua: "Të përgëzoj (o Muhamed) se Allahu xh.sh. të thotë:* ***"Kush të dërgon selam ty edhe Unë i dërgoj atij selam, e kush të dërgon salavat ty edhe Unë atij i dërgoj salavat".***[526]

[526] Ahmed-i, "Musned", 3/200, nr.1662; Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.1, fq.344-345, nr.810 dhe thotë se hadithi është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ata nuk e kanë shënuar..."; Disa dijetarë kanë bërë vërejtje në zinxhirin e këtij hadithi, pasi në të gjendet Abdurahman b. Muavije b. Huvejrith Ensariju, i cili i takon gjeneratës së Tabiinëve apo Etbai Tabiinëve, kurse Darimiju dhe Ibni Mediniu thonë se është i besueshëm (*thikah*), si dhe Ibni Hiban-i e shënon në librin e tij "Eth-Thikat". Kurse Jahja b. Meini thotë se nuk argumentohet me hadithet e tija. Ebu Hatim er-Razi-u thotë se nuk është i fortë, shkruhet hadithi prej tij, por nuk argumentohet me to. Maliku nuk e ka konsideruar të besueshëm, kurse Ahmedi po. Edhe Nesai-u në librin e tij "Ed-Duafa", ka thënë se nuk është i besueshëm. Dhehebiu në "Kashif" thotë se është i dobët, kurse Ibni Haxher-i në "Tekribu`t-Tehdhib" thotë se është i sinqertë (saduk) por ka mangësi në mbamendje dhe është akuzuar me *irxha* (anues kah Murxhitë). Pra, shohim se dijetarët kanë pasur mendime të ndryshme

Allahu xh.sh. e nderoi Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke e ngritur në pozitë shumë të lartë, saqë edhe i tha: **"Dhe Ne e kemi ngritur lart famën tënde"**[527] e kjo është shumë e qartë, pasi emri i Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem është në dëshminë e *shehedetit*, që çdo mysliman e shqipton mbarë rruzullit tokësorë, emri i tij përmendet gjatë çdo thirrje të *ezan*-it në gjithë botën, emri i tij përmendet nga çdo mysliman i cili fal namaz dhe dërgon *salavat* mbi të gjatë *etehijat*-it dhe në shumë vende të tjera.

Këtu vlen të përmendim edhe *hadith*-in që përcillet prej Ebu Seidit r.a. si *hadith kudsi* ku Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Më erdhi Xhibrili a.s. dhe më tha: "Zoti im dhe i yti thotë se si e ka ngritur famën tënde?!" Unë thashë: "Allahu e dinë më mirë". Ai më tha:* ***"Kur përmendem Unë, do të përmendesh edhe ti bashkë me Mua".***[528]

Allahu xh.sh. e nderoi edhe me dërgimin e *salavat*-eve mbi të nga të gjithë myslimanët e botës, si në të kaluarën ashtu edhe në të ardhmen.

Allahu xh.sh. edhe me Kuran, na obligoi që të dërgojmë *salavat* mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kur tha: **"Është e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhëronie pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam".**[529]

Kur është shpallur ky *ajet*, shokët e tij janë interesuar për formën se si të dërgojnë *salavat* mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të zbatojnë këtë urdhër të Zotit.

---

rreth tij, andaj nuk lihet anash tërësisht; Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi, thotë se hadithi është Hasen li gajrihi (i mirë në bazë të argumenteve tjera), por zinxhiri i këtij hadithi është i dobët; për vlerësimin dhe kritikat ndaj këtij transmetuesi, shiko më shumë: Miziu, "Tehdhibu`l-Kemal", 17/414, nr.3962; Dhehebiu, "Kashif", vëll.1, fq.644, nr.3316;

[527] Kurani, Inshirah, 4;

[528] Ebu Ja`la, "Musned", fq.304, nr.1381; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", 8/175, nr.3382; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/324, nr.13.922 dhe thotë: "E transmeton Ebu Ja`la, kurse zinxhiri i tij është i mirë". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sahihut të Ibni Hibanit, thotë se zinxhiri i hadithit është i dobët shkaku i Deraxhit.

[529] Kurani, Ahzab, 56;

Transmeton Talha b. Ubejdullahu r.a. se kur i zbriti ky *ajet* Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: "O i Dërguari i Allahut, e dëgjuam këtë ajet, por si duhet të dërgojmë ty salavat?" Ai tha: *"Thoni: `Allahumme Sali ala Muhamedin ve ala ali Muhamed, kema salejte ala Ibrahime inneke Hamidun Mexhid, ve barik ala Muhamedin ve ala ali Muhamed, kema barekte ala Ibrahime inneke Hamidun Mexhid".*[530]

Transmeton Ebu Humejd es-Saidiju r.a. se ata kanë thënë: "O i Dërguari i Allahut, si të çojmë *salat* ty?" Ai ka thënë: *"Thuani: "Allahumme sali ala Muhamedin ve ezvaxhihi ve dhurrijetihi kema salejte ala ali Ibrahime ve barik ala Muhamedin ve ezvaxhihi ve dhurijetihi kema barekte ala ali Ibrahime inneke Hamidun Mexhid".*[531]

Salat-i i Zotit për Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem nënkupton Mëshirën dhe Kënaqësinë e Tij mbi te, ndërsa *salavat*-i i engjëjve mbi Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem nënkupon lutjen dhe kërkimin e faljes mbi të, kurse nga ana e njerëzve, nënkupon lutje dhe madhërim të pozitës së tij. Një koment i ngjashëm, përcillet edhe nga Ibni Abasi r.a.[532]

Salavat-i ndaj Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka shumë vlera dhe veçori, që i bëjnë dobi njeriut në botën tjetër. Është e rëndësishme të përmendim se *salavat*-et të cilat ia dërgojmë Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ditën e *xhuma*, i paraqiten në mënyrë të drejtpërdrejtë pa ndërmjetësim të ndonjë *melek*-u. Transmeton Eus b. Eusi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Dita më e zgjedhur e javës është dita e xhuma. Në këtë ditë u krijua Ademi a.s. dhe në këtë ditë ka vdekur, në këtë ditë do të bëhet fryerja (në Sur) dhe në këtë ditë do të jetë ringjallja. Përpiquni që në këtë ditë të më përcjellni sa më shumë salavate ngase ato salavate do të më prezantohen".* Të pranishmit e pyetën o Pejgamber i All-llahut: "Si do të prezentohet, kur trupi yt atëherë do të jetë i shndërruar në pluhur?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha*: "All-llahu ia ka ndaluar tokës t'i dëmtojë trupat e pejgamberëve të All-llahut*".[533]

Një element tjetër shumë i rëndësishëm që është edhe parim në të gjitha veprat e mira, është se Zoti i shpërblen me dhjetë të tilla, kështu që, nëse

[530] Nesai-u, "Sunen", kitab Sehvi, nr.1290-91; Ahmed-i, "Musned", 3/16, nr.1396;
[531] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab salatu alen nebij ba`de teshehud, nr.979;
[532] Sujuti-u, "Durru`l-Menthur", vëll.12, fq.117;
[533] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 201, nr.1047; etj.

njeriu e bën një vepër të mirë, Zoti ia regjistron sikur të njëjtën e ka kryer dhjetë herë. Transmeton Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush dërgon mbi mua një herë salavat, Allahu do të dërgoj mbi të 10 herë".*[534]

I ngjashëm me këtë *hadith* dhe në kontekst të *hadith*-it *kudsi* që jemi duke e sqaruar, është edhe transmetimi tjetër, ku përcjell Ebu Talha el-Ensari r.a. se një ditë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem erdhi pranë nesh. U kuptonte nga fytyra e tij se ishte i gëzuar. Shokët i thanë: "O i Dërguari i Allahut, nga fytyra e juaj kuptohet se jeni shumë të gëzuar!" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Po. Me të vërtetë jam shumë i gëzuar. Pasi erdhi një melek dhe më tha: "O Muhamed, me të vërtetë Zoti yt thotë:* ***"A do të jesh i kënaqur nëse të çon dikush salavat prej popullit, e Unë t`ia kthej atij me dhjetë, e nëse të përshëndet ai ty, Unë ta përshëndes atë me dhjetë".***[535]

Besimtari i cili i dërgon *salavat* Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem është meritorë për fitimin e ndërmjetësimit të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Ditën e Gjykimit. Transmeton Abdullah b. Amër ibn Asi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur ta dëgjoni ezanin, edhe ju thuani ashtu siç thotë myezini, e pastaj bëni salavatë për mua, se me të vërtetë kush bën salavatë për mua, Allahu do t`i bëjë 10 salavate mbi të. Pastaj luteni për mua "Vesileh" se ajo është një pozitë në Xhenet, e cila është caktuar vetëm për një nga robërit e Tij. Shpresoj që unë jam ai rob. Ai që lut Allahun për mua që të më jep "Vesilen", do të më lejohet ndërmjetësimi për të".*[536]

Salavat-i mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe angazhimi i kohës me *salavat* mbi të, është edhe shkak për faljen e mëkateve të besimtarit. Transmeton Ubeje b. Ka`bi r.a. se një ditë e pyeti Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "O i Dërguari i Allahut! Unë bëj shumë *salavat* për ty. Por dua të di, se sa duhet të bëj *salavat* për ty?" Ai tha: *"Bëj salavatë për mua, sa të duash!".* Tha: "Nëse e veçoj ¼ e lutjeve të mia për *salavat*-e, a është e mjaftueshme?" Ai tha: *"Veço sa të duash, por nëse bën më shumë*

[534] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 17, nr.408; Nesai-u, "Sunen", kitab Sehvi, bab 55, nr.1297; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Vitër, bab ma xhae fi fadli`s-salati ale`n-nebij, nr.485 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih;

[535] Ahmed-i, "Musned", 26/280, nr.16.361; Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/456, nr.3575 dhe thotë se hadithi është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar;

[536] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab kaulu mithlu ma jekulul muedhinu, nr.384; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Menakibi, bab 3, nr.3634;

se kjo, është më e mirë për ty". Tha Ubeje: "Atëherë a të veçoj gjysmën e duave të mia për *salavat*-e?" Ai i tha: *"Veço sa të duash, por nëse bën më shumë se kjo, është më e mirë për ty".* Tha Ubeje: "Atëherë a të veçoj 2/3 e duave të mia për salavate?" Ai i tha: *"Veço sa të duash, por nëse bën më shumë se kjo, është më e mirë për ty".* Tha: "E nëse e veçoj të gjithë kohën që e kam veçuar për lutje, të bëj salavate për ty?" Ai tha: *"Në këtë rast, Allahu t`i largon gjithë mundimet dhe t`i fal të gjitha mëkatet".*[537]

Kur të fillohet të bëhet lutje, duhet të paraprihet prej *salavat*-eve, sepse përndryshe do të jetë *dua*-ja e mangët. Transmeton Fadale b. Ubejdi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dëgjoi dikë i cili në lutje nuk dërgoi salavatë për të, dhe tha: *"U nxitua ky".* Pastaj e thirri dhe i tha: *"Nëse dikush prej jush fal namaz dhe bën dua, le të fillojë me falënderim ndaj Allahut, më pas le të sjell salavat për Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe pastaj le të kërkojë për vete atë që dëshiron, sepse në këtë mënyrë i pranohet ajo që kërkon".*[538]

I mangët do të jetë edhe tubimi në të cilin tubohen njerëzit por në të nuk përmendin Allahun xh.sh. dhe nuk dërgojnë salavat mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem, pasi aty nuk zbret Mëshira Hyjnore dhe begatia e Tij. Transmeton Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur një popull ulet në një kuvendim, në të cilin nuk përmendet Allahu dhe nuk dërgojnë salavat mbi të dërguarin e tyre, ndeja e tyre është e mangët, nëse do (Allahu) i dënon, e nëse do, ua fal".*[539]

Njeriu nuk duhet shfaqur koprraci në lëvizjen e buzëve për të dërguar *salavat* mbi krijesën më të ndershme. Kjo është më e pakta që mundet të bëjë njeriu për të. Besimtari i vërtetë duhet të jetë i lidhur edhe me zemër për të Dërguarin e Allahut e jo vetëm me lëvizje buzësh, e nëse edhe këtë nuk e bën, atëherë ai është me të vërtetë koprrac. Transmeton Husejn b. Aliu r.a, Ebu Hurejre r.a. dhe Aliu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Koprrac është ai në praninë e të cilit përmendet emri im, e ai nuk dërgon salavat mbi mua".*[540]

---

[537] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, 23, nr.2465 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Sahih;

[538] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 64, nr.3488 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; etj.

[539] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 8, nr.3391 dhe thotë se është Hasen; etj.

[540] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, nr.3557 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Ahmed-i, "Musned", 1/201, nr.1736; Taberani-u, "Mu`xhemu`l-Kebir" vëll.3, fq.137, nr.2885;

Ai që nuk shpreh *salavat* mbi Pejgamberin e Allahut kur dëgjon emrin e tij, është i nënçmuar te Zoti dhe do të jetë i mjerë. Transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është ngjitur në *minber* (foltorja e ditës xhuma) dhe ka thënë "Amin, amin, amin". E kanë pyetur: "O i Dërguari i Allahut, pse the Amin?" Ai i ka thënë: *"Më erdhi Xhibrili e më tha: "Muhamed, le të jetë i nënçmuar personi tek i cili përmendesh e ai nuk të çon salavat mbi ty. Thuaj Amin!" Unë thash amin. Pastaj më tha: "Le të jetë i nënçmuar personi i cili e arrin muajin e Ramazanit, e agjëron dhe nuk i falen mëkatet. Thuaj Amin!" Unë thash amin. Pastaj më tha: "Le të jetë i nënçmuar personi i cili i arrin të dy prindërit ose njërin prej tyre dhe ata nuk e çojnë në Xhenet. Thuaj Amin!" Unë thash amin".*[541]

Besimtari i mirë dhe i sinqertë i cili është i lidhur me Pejgamberin e Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem mundohet në çdo kohë ta përmend dhe të dërgojë *salavat* mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Kjo duhet të praktikohet edhe kur hyjmë dhe kur dalim prej xhamisë. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur ndonjëri prej jush hyn në xhami, le t`i çojë selam të Dërguarit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe le të thotë: "Allahumme`ftahli ebvabe rahmetike", e kur të del prej xhamie, le të thotë selam mbi të pastaj le të thotë: "Allahumme a`simni minesh-shejtan".*[542]

Allahu xh.sh. e ka bërë shkak *salavat*-in mbi Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të jetë zëvendësim për shpërblimin e sadakasë, për atë i cili nuk ka kushte që të jep lëmoshë dhe të ndihmojë të varfërit. Transmeton Ebu Seid el-Hudriju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nëse myslimani nuk ka çka të jep sadaka, atëherë në lutjet e tij le të thotë: "Allahumme Sali ala Muhamedin abdike ve resulike, ve Sali alel mu`minine vel mu`minat, vel muslimine vel muslimat. Kjo do të jetë pastrim (zekat) për të".*[543]

Të jemi vazhdimisht të lidhur për Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe ta përkujtojmë me *salavate* në gjitha gjendjet tona, sepse ai është mësuesi i jonë në këtë botë dhe ndërmjetësuesi në Ditën e Llogarisë.

---

[541] Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", nr.644 dhe nr.646 përmes Ebu Hurejres r.a. dhe aty përmendet: "turp për atë person që dëgjon...";
[542] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Mesaxhidu, bab duau inde duhulil mesxhid, nr.773;
[543] Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", nr.640;

HADITHI I PESËDHJETËEDYTË (52)

حَدَّثَنَا حَفْصُ بْنُ عُمَرَ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ قَتَادَةَ، ح وقَالَ لِي خَلِيفَةُ: حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، عَنْ سَعِيدٍ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ أَبِي العَالِيَةِ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِيمَا يَرْوِيهِ عَنْ رَبِّهِ، قَالَ: " لاَ يَنْبَغِي لِعَبْدٍ أَنْ يَقُولَ: إِنَّهُ خَيْرٌ مِنْ يُونُسَ بْنِ مَتَّى " وَنَسَبَهُ إِلَى أَبِيهِ

Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka transmetuar prej Zotit të i Cili ka thënë: ***"Nuk i takon asnjë robi që të thotë se ai (Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem) është më i mirë se Junusi biri i Meta`ut".***[544]

Para se të sqarojmë këtë *hadith,* do të përmendim tregimin e këtij pejgamberi të Zotit, me emrin Junus a.s. sipas të cilit e ka marr edhe emrin *sure*-ja e dhjetë në Kuran. Junusi a.s. përmendet në Kuran në gjashtë vende. Ky ka qenë prej pejgamberëve të Zotit. Allahu xh.sh. thotë në Kuran: **"Dhe me të vërtetë Junusi ka qenë njëri prej pejgamberëve".**[545] Po ashtu thotë: **"Ne të kemi dërguar ty shpalljen ashtu siç i kemi dërguar shpallje Nuhut dhe pejgamberëve pas tij. E Ne i dërguam shpallje Ibrahimit, Imailit, Is`hakut, Ja`kubit, Isaut, Ejubit, Junusit, Harunit dhe Sulejmanit. E Davudit ia kemi dhënë Zeburin".**[546]

Në *hadith* u përmend Junusi a.s. me prindin e tij Meta. Por, ka mendime të ndryshme, se ky vallë ishte emri i babait apo nënës së tij. Ibni Ethiri thotë: "Nuk është quajtur me emrin e nënës së tij asnjë pejgamber përpos Isaut a.s. me nënën e tij Merjemen dhe Junusit a.s. me nënën e tij Meta".[547]

---

[544] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab dhikri`n-nebijji salallahu alejhi ve selem ve rivajetihi an rabbihi, nr.7539; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Fadailu, bab fi dhikri Junus a.s…, nr.2377 por Muslimi nuk e shënon si hadith kudsij; etj.

[545] Kurani, Saffat, 139;

[546] Kurani, Nisa, 163;

[547] Ibni Ethir-i, "Kamil fi`t-Tarih", vëll.1, fq.278;

Junusi a.s. u dërgua pejgamber te populli i Ninivës që është në afërsi të Mosul-it (në Irak). Ky popull adhuronte idhujt.[548] Niniva ka qenë kryeqytet i Asirisë. Ky qytet u përmend edhe nga ana e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur shkoi në Taif. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur ishte në Taif dhe u prit keq nga ana e banorëve të saj, u strehua nën një hije. Dy djemtë e Rebia-s, Utbe dhe Shejbe, ndjenë keqardhje për atë që panë dhe dërguan shërbëtorin e tyre të krishterë Addas-in, që t`i dërgojë një kalavesh me rrush. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur filloi të hajë, tha: *"Bismilah".* Djaloshi u habit dhe tha se kjo fjalë nuk përdoret në këto anë. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Nga cili vend je o Addas dhe çfarë feje ke?"* Ai tha: "Unë jam krishter nga Niniva". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Ti qenke nga fshati i njeriut të mirë, Junus b. Metas".* Addasi e pyeti: "A e di ti se kush është Junus b. Meta?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem iu përgjigj: *"Po, ai është vëllai im. Ai ishte pejgamber edhe unë jam pejgamber!..."*.[549]

Niniva në atë kohë ka pasur më shumë se 100.000 banorë. Kështu thuhet edhe në Kuran: **"Ne e dërguam atë (Junusin) te njëqindmijë e më shumë vetë".**[550]

Por Junusi a.s. pasi i thirri për një kohë dhe nuk iu përgjigjën thirrjes së tij, ai i paralajmëroi se do t`i kap dënim nga ana e Zotit, e pas kësaj u largua dhe shkoi hypi në një anije duke qenë i hidhëruar me gjendjen e tyre. Por ai u largua nga populli i tij pa lejen dhe pa urdhrin e Zotit. Më pas, ai hypi në anije, por anija filloi të tundet, kështu që njerëzit u frikësuan se do të mbyten në ujë. Allahu xh.sh. e tregon këtë skenë në Kuran ku thotë: **"Kur ai iku në anijen e mbushur përplot. Dhe hodhi shortin, e shorti i ra atij".**[551] Pra, njerëzit pasi hodhën short se fajtori duhet të hidhet prej anijes, shorti tri herë radhazi i ra Junusit a.s. dhe ai u hodh nga anija, por e priti balena në gojën e së cilës qëndroi disa ditë. Ebu Maliku thotë se ka qëndruar në barkun e peshkut për 40 ditë.[552]

Gjersa ai qëndroi në barkun e balenës, bënte adhurim dhe i lutej Zotit. Në lidhje me këtë pjesë, përcillet edhe një *hadith kudsi*, ku transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur*

[548] Taberi-u, "Tarih", vëll.2, fq.11;
[549] Ibni Hisham-i, "Biografia e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem", Logos A, Shkup, 2017, fq.118;
[550] Kurani, Saffat, 147;
[551] Kurani, Saffat, 140-141;
[552] Ahmed-i, "Zuhd", fq.31, nr.187;

Allahu deshi ta mbyllte Junusin a.s. në barkun e balenës, shpalli: ***"Përpije atë, por mos ia ha mishin e as mos ia thyej eshtrat".*** *Kur e çoi në fund të detit, Junusi a.s. dëgjoi disa fjalë dhe pyeti: "Çka është kjo?". Atëherë, derisa Junusi a.s. ishte ende në barkun e balenës, i shpalli:* ***"Kështu më madhërojnë kafshët e detit".*** *Pastaj, edhe ai në barkun e peshkut filloi ta madhërojë Allahun. Kur melekët dëgjuan madhërimin (tesbihun) e tij, thanë: "Prej ku nga brendia e tokës jemi duke dëgjuar një zë të dobët?" Ai u përgjigj:* ***"Ky është robi Im, Junusi. Ka gabuar ndaj Meje, andaj e kam mbyllur në barkun e një balene në det".*** *Ata pyetën: "A është ai robi i mirë, prej të cilit për çdo ditë dhe për çdo natë Të ngriheshin veprat e mira?!" Tha:* ***"Po".*** *Atëherë, ata ndërmjetësuan te Allahu dhe Ai i urdhëroi balenës, e ajo e nxori në breg, siç thotë Allahu:* **"..e ishte i sëmurë".**[553]

Lutja me të cilën u lut Junusi a.s. në barkun e balenës dhe në thellësinë e detit tregohet në *ajet*-in kuranor, ku Zoti thotë: **"Dhe Dhenunin (Junusin) kur u largua i hidhëruar dhe mendoi se Ne nuk do ta arrijmë dot, e pastaj thirri nga errësirat: "Nuk ka zot tjetër përveç Teje, qofsh i lavdëruar Ti sepse unë me të vërtetë kam bërë padrejtësi". Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuam atë nga vështirësia. Kështu Ne i shpëtojmë besimtarët".**[554]

Në koment të këtij *ajet*-i, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tregoi se kjo lutje është e vlefshme për çdo besimtar dhe Zoti i përgjigjet nëse lutet me këtë lutje. Transmeton Sa`d b. Ebu Vekasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Lutja e Dhenunit (Junusit) kur ka qenë në barkun e balenës, ka qenë: `La ilahe il-la ente subhaneke inni kuntu mine`dh-dhalimin` (Nuk ka zot tjetër përveç Teje, qofsh i lavdëruar Ti sepse unë me të vërtetë kam bërë padrejtësi) e nuk ndodh të lutet ndonjë musliman me të për diçka, e Allahu të mos ia pranojë".*[555]

Pasi Junusi a.s. është larguar nga vendi, populli është penduar dhe është ndër popujt e parë që kanë shpëtuar nga dënimi pasi u është afruar, sepse ata e panë gabimin e tyre dhe u penduan që të gjithë. Thotë Allahu xh.sh. në Kuran: **"Përse nuk ka pasur asnjë qytet i cili ka besuar dhe të cilit besimi i tij i ka bërë dobi, përveç popullit të Junusit, të cilit pasi besoi,**

---

[553] Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", vëll.15, fq.34, nr.8227; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 7/157, nr.11.302 thotë: "E transmeton Bezari nga njerëzit e tij por nuk ua përmend emrat, por në zinxhir gjendet edhe ibni Is`haku i cili është *mudelis,* kurse pjesa tjetër e transmetuesve janë transmetues që gjenden në dy librat e Sahihut";

[554] Kurani, Enbija, 86-88;

[555] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab, nr.3516;

Ne ia larguam atyre ndëshkimin poshtërues në jetën e kësaj bote dhe ia vazhduam jetën edhe për një kohë".[556]

Junusi a.s. pasi e bëri këtë lutje, Allahu xh.sh. e urdhëroi balenën dhe ajo e nxori në breg. Ai më pas u kthye te populli i tij dhe ata e pasuan thirrjen e tij. Thotë Zoti në Kuran: **"Sikur të mos ishte prej atyre që e lavdërojnë Allahun. Me siguri do të mbetej në barkun e tij deri në Ditën kur do të ringjallen të gjithë. Dhe Ne e nxorëm atë në një vend të shkretë e ishte i sëmurë. Dhe bëmë që përmbi të të mbijë një lozë kungulli. Dhe e dërguam atë te njëqindmijë njerëz apo më tepër. Ata besuan andaj u dhamë që të kënaqeshin deri në kohën e caktuar".**[557]

Pasi e sqaruam në pika të shkurtra historinë e Junusit a.s. do të përqëndrohemi edhe te arsyeja e thënies së këtij *hadithi kudsij* që e kemi në trajtim. Që në fillim të sqarojmë se jo të gjithë transmetuesit e përcjellin këtë *hadith* si *kudsij*, porse disa e përcjellin si *hadith* prej Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke mos e përmendur në fund se ka thënë Allahu xh.sh. Por, ky version i Ibni Abasit r.a. vjen i përshkruar si *hadith kudsij*.

Arsyeja e mos mbivlerësimit mund të ketë dy konotacione. E para është që asnjë njeri të mos mendojë se është më i mirë se Junusi a.s. duke e nënçmuar për shkak të këtij lëshimi që ka bërë, sepse atij i është falur nga ana e Zotit dhe e ka zgjedhur për pejgamber. Pra, asnjë musliman mos ta konsiderojë vetveten më të mirë se Junusi a.s. e të mendojë se mund të arrijë vlerën e ndonjërit prej pejgamberëve. Askush nuk mund të matet me vlerën e pejgamberëve dhe asnjë njeri nuk mund të ngritet në pozitat e tyre, pa marrë parasysh se sa i devotshëm mund të jetë.

Konteksti i dytë që mund ta ketë *hadith*-i, është që të mos mbivlerësohet Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem mbi Junusin a.s. e të mendohet se ai ka pozitë më të ultë te Zoti shkaku i lëshimit që ka bërë. Allahu xh.sh. kërkon prej neve që të mos bëjmë dallim në mes shkallëve të pejgamberëve, sepse të gjithë kanë pasur misionin e njëjtë. Allahu xh.sh. thotë: **"...Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij...".**[558]

Edhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk ka pëlqyer që të ngritet nga ana e shokëve të tij mbi pejgamberët tjerë, sepse me këtë bëjmë

[556] Kurani, Junus, 98;
[557] Kurani, Saffat, 143-148;
[558] Kurani, Bekare, 285;

degradim në pozitat e tyre, që në fund, të gjithë kanë qenë të zgjedhur prej Allahut xh.sh. dhe secili ka pasur meritat e veta.

Transmeton Enes b. Maliku r.a. se një njeri erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe iu drejtua me fjalën "*Ja hajrel-berijje" (O njeriu më i mirë).* Por Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem iu përgjigj: *"Ai që përmende është Ibrahimi alejhi selam".*[559]

Në kohën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem një musliman kishte ngritur Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem mbi Musain a.s. për çka edhe i bëri korrigjim atij besimtari. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se dy vetë u grindën në mes tyre, njëri musliman e tjetri jehudi. Muslimani tha: "Pasha Atë i Cili e ka zgjedhur Muhamedin mbi të gjithë njerëzimin". Jehudiu tha: "Pasha Atë i Cili e ka zgjedhur Musain a.s. mbi të gjithë njerëzimin". Nga kjo muslimani ngriti dorën dhe e qëlloi jehudiun në fytyrë. Jehudiu shkoi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tregoi se çka ka ndodhur mes tij dhe muslimanit. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e çoi një njeri që ta thirr muslimanin dhe e pyeti për këtë çështje. Muslimani ia tregoi atij ndodhinë. Pas kësaj, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Mos më vlerësoni mua mbi Musaun a.s. pasi Ditën e Ringjalljes gjithë njerëzimi do të alivanosen, edhe unë bashkë me ta, por do të jem i pari që do të vij në vete dhe do shoh Musain a.s. në këmbë të kapur për një anë të Arshit, por nuk e di, a ka qenë Musai nga ata që u alivanosën dhe është ngrit para meje, apo Allahu e ka kursyer atë nga kjo".*[560]

Me këtë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe me *hadithin* mbi Junusin a.s. na mësoi që të vlerësojmë të gjithë pejgamberët, të besojmë në pejgamberinë e tyre, të mos nënçmojmë asnjërin dhe të jemi të bindur se të gjithë ata kanë qenë vëllezër dhe se me përpikmëri e kanë përcjellur shpalljen e Zotit deri tek popullata. Ne duhet të mësohemi që të respektojmë punën e të gjithëve dhe të mos kategorizojmë të zgjedhurit e Zotit. Nuk na lejohet të flasim për nderin e njerëzve të mirë dhe të devotshëm, por duhet të heshtim kur është puna në kategorizimin e njerëzve.

Nga e gjithë kjo, kuptojmë se duhet të pranojmë fajin kur jemi gabim e jo të këmbëngulim në gabimin tonë dhe ta mbrojmë atë në çdo mënyrë. Në

[559] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Fadailu, bab fadailu Ibrahim s.a.s., nr.2369; etj.
[560] Buhari-u, "Sahih", kitab Husumatu, bab fi`l-eshhasi ve`l-melazemeti ve`l-husumati bejne`l-muslimi ve`l-jehudi, nr.2411; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Fadailu, bab min fadaili Musa sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nr.2373; etj.

moment kur Junusi a.s. e pranoi se kishte nxituar, Zoti e fali dhe e nxori në sipërfaqe. Edhe Ademi a.s. e pranoi fajin dhe u fal. Zoti thotë në Kuran: **"Ata të dy (Ademi dhe Hava) thanë: "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes, në qoftë se nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve".**[561] Pas kësaj Zoti i fali, kurse Iblisi gaboi dhe nuk kërkoi falje, por u tregua mendjemadh, andaj Zoti e mallkoi. Nga kjo mësojmë që pas gabimit, të pendohemi e jo të krenohemi.

[561] Kurani, A`raf, 23;

HADITHI I PESËDHJETËETRETË (53)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ سِنَانٍ، حَدَّثَنَا فُلَيْحٌ، حَدَّثَنَا هِلاَلٌ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ، قَالَ: لَقِيتُ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ عَمْرِو بْنِ العَاصِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا، قُلْتُ: أَخْبِرْنِي عَنْ صِفَةِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي التَّوْرَاةِ؟ قَالَ: " أَجَلْ، وَاللَّهِ إِنَّهُ لَمَوْصُوفٌ فِي التَّوْرَاةِ بِبَعْضِ صِفَتِهِ فِي القُرْآنِ: {يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا} [الأحزاب: 45] ، وَحِرْزًا لِلْأُمِّيِّينَ، أَنْتَ عَبْدِي وَرَسُولِي، سَمَّيْتُكَ المتَوَكِّلَ لَيْسَ بِفَظٍّ وَلاَ غَلِيظٍ، وَلاَ سَخَّابٍ فِي الأَسْوَاقِ، وَلاَ يَدْفَعُ بِالسَّيِّئَةِ السَّيِّئَةَ، وَلَكِنْ يَعْفُو وَيَغْفِرُ، وَلَنْ يَقْبِضَهُ اللَّهُ حَتَّى يُقِيمَ بِهِ المِلَّةَ العَوْجَاءَ، بِأَنْ يَقُولُوا: لاَ إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَيَفْتَحُ بِهَا أَعْيُنًا عُمْيًا، وَآذَانًا صُمًّا، وَقُلُوبًا غُلْفًا "، تَابَعَهُ عَبْدُ العَزِيزِ بْنُ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ هِلاَلٍ، وَقَالَ سَعِيدٌ: عَنْ هِلاَلٍ، عَنْ عَطَاءٍ، عَنْ ابْنِ سَلاَمٍ غُلْفٌ: كُلُّ شَيْءٍ فِي غِلاَفٍ، سَيْفٌ أَغْلَفُ، وَقَوْسٌ غَلْفَاءُ، وَرَجُلٌ أَغْلَفُ: إِذَا لَمْ يَكُنْ مَخْتُونًا".

Transmeton Ata` b. Jesari i cili thotë: "E takova Abdullah b. Amër el-Asin r.a. dhe i thash: "Më informo se si është përshkruar Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Teurat?!" Ai u përgjigj: "Po, gjithsesi. Pasha Allahun ai është përshkruar në Teurat me disa atribute të tij nga Kurani si: ***"O ti Pejgamber! Ne të kemi dërguar dëshmitar, por edhe si përgëzues dhe qortues, edhe si mbrojtës i të paditurve. Ti je robi dhe i dërguari Im. Të dhashë emrin El-Mutevekil, i cili s`ka ashpërsi, s`ka vrazhdësi, nuk bërtet nëpër tregje, të keqen nuk ta kthen me të keq, fal dhe i mbulon (ofendimet). Allahu nuk do ta merr derisa ta drejtojë fenë e shtrembëruar dhe derisa nuk thonë njerëzit: "La ilahe il-lallah" dhe me këtë do t`ua hap sytë e verbër, veshët e shurdhuara dhe zemrat e vulosura".***[562]

[562] Buhari-u, "Sahih", kitab Buju, bab kerahijeti`s-Sehabi fi`s-suki, nr.2125; Ahmed-i, "Musned", 11/193, nr.6622; Darimi-u, "Sunen", kitab Mukadime, bab sifetu nebiji

Në këtë rast, është pyetur Abdullah b. Amri r.a. në lidhje me përshkrimin e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Teurat, shkaku se ai kishte njohuri të thella mbi librat e shpallura. Ai tregoi se në Teurat, është përshkruar Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ngjashëm si në Kuran.

Prej këtyre cilësive, është edhe se ai është dërguar dëshmitar, përgëzues dhe qortues. Këtë e dëshmon *ajet*-i kuranor ku thotë: **"O ti pejgamber! Ne të dërguam ty dëshmitar, përgëzues dhe qortues".**[563]

Me cilësi të ngjashme, e përshkruan edhe në *ajet*-in: **"Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërngurtë, ata do të largoheshin prej teje, andaj ti fali ata dhe kërko ndjesë për ta. Konsultohu me ta për të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun sepse Allahu i donë ata që mbështeten te Ai (Mutevekkilin)".**[564]

Dhe të gjitha cilësitë tjera të cilat i përshkruan ky lajm, janë të sakta dhe të vërteta, sepse mu ashtu ka qenë Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ai ka qenë rob dhe i dërguari i Tij, siç e shprehim çdoherë kur e themi *shehadet*-in.

Ai ka ecur qetë dhe nuk ka bërtitur nëpër rrugë apo në betejë, e për ngritjen e zërit, ua tërhoqi vërejtjen edhe shokëve të tij.

Ai qëndroi në mesin e njerëzve gjersa Zoti përmes tij e përhapi Islamin, ua mësoi njerëzve fenë, ua hapi sytë, veshët dhe zemrat të cilat më parë i kishin të mbyllura. Dëshmia *La ilahe il-lallah* u përhap në gjithë botën dhe njerëzit e përqafuan të vërtetën.

Jehudët e kishin të qartë pejgamberinë e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe nuk ishte diçka e panjohur për ta, porse e refuzonin nga mendjemadhësia. Hipokritët e Medines kuvendonin me jehudët dhe i qortonin për faktin se ua vërtetojnë fjalën muslimanëve për faktin që emri

---

salallahu alejhi ve selem fi`l-kutubi kable meb`athihi, nr.6 e shënon përmes Abdullah b. Selamit r.a.;

[563] Kurani, Ahzab, 45 dhe Fet`h, 8;

[564] Kurani, Ali Imran, 159;

dhe cilësitë e tij, përmenden në Teurat. Këtë e tregon edhe Kurani ku thotë: **"E kur takonin ata që kishin besuar (muslimanët) thonin: "Ne kemi besuar!" E kur veçoheshin ata mes veti thonin: "A po ju tregoni atyre (muslimanëve) për atë që All-llahu ua shpalli juve (në Tevrat rreth Muhammedit a. s.) që ata para Zotit tuaj të kenë argumente kundër jush. A nuk jeni duke kuptuar".**[565]

Jehudët i lexonin cilësitë e tij në Teurat dhe ishin në pritje të pejgamberit të fundit, udhëzues për njerëzimin, por kur erdhi, ata e refuzuan. Zoti thotë në Kuran: **"Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit".**[566]

Kurani na njofton se ata e njohin Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe pejgamberinë e tij siç i njohin edhe fëmijët e tyre. Thuhet në Kuran: **"Atyre që u kemi dhënë librin, ata e njohin ate (Muhammedin) siç i njohin bijtë e vet, e një grup pre tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke e fshehur të vërtetën".**[567]

Në lidhje me këtë *ajet*, dijetarët kanë shprehur mendime për arsyen e zbritjes së tij. Ky *ajet* është zbritur në vazhdim të *ajet*-eve ku bëhet fjalë për ndërrimin e *kibles* prej xhamisë Aksa, në drejtim të Qabesë. E kur morën vesh për këtë jehuditë, e kritikuan Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe se e ka ndërruar *kiblen* e pejgamberëve të mëparshëm, por harruan se Qabeja ka qenë *kibla* e Ibrahimit a.s. dhe Ismailit a.s. dhe pejgamberëve tjerë. Ata këto lajme i dinin më mirë sesa dinin për fëmijët e tyre, por e mbulonin të vërtetën.[568]

Imam Nesefiu ka thënë: "Ehlu Kitabët e njohin Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Kuranin dhe ndërrimin e kibles siç i njohin bijtë e vet,

[565] Kurani, Bekare, 76;
[566] Kurani, A`raf, 157;
[567] Kurani, Bekare, 146;
[568] Shih: Mukatil b. Sulejman, "Tefsir", muessesetu`t-tarihu`l-arabij, Bejrut, botimi i dytë, 2002, vëll.1, fq.148; Taberi-u, "Xhamiu`l-Bejan fi te`vili`l-Kuran", 2/146;

madje edhe më mirë. Abdullah b. Selami thotë: "Unë e njoh atë më mirë sesa njoh fëmijët e mi". Umeri r.a. i tha: "Si ashtu?" Ai u përgjigj: "Sepse për Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk kam dyshim se është pejgamber, ndërsa në djalin tim kam dyshim, ndoshta nëna e tij më ka tradhtuar". E Umeri r.a. ia puthi kokën".[569]

Se jehudët kishin njohuri mbi pejgamberinë e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e vërtetojnë edhe shumë raste tjera. Jehudët u kërcënoheshin fisit Eus dhe Hazrexh në Medine duke u thënë: "Së shpejti do të shfaqet një pejgamber, koha e tij tashmë ka ardhur. Ne do ta pasojmë atë dhe së bashku me të do t`ju luftojmë juve, ashtu siç është luftuar populli i Ad-it dhe Irem-it". E kur medinasit e fisit Hazrexh biseduan me Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem thanë: "Ky, vallahi është ai pejgamberi me të cilin hebrenjtë po na kërcënojnë. Ata në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë më të shpejtë se ne".[570]

Në momentet kur Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i kishte rrethuar jehudët e Beni Kurejdhas, u çua Ka`b b. Esedi në mesin e tyre dhe tha: "Ta pasojmë këtë njeri dhe ta pranojmë, sepse vallahi ju u bindët se ai është Pejgamber i dërguar e për këtë tregon edhe libri juaj i shenjtë! Do ta shpëtoni veten, pasurinë, fëmijët dhe gratë tuaja".[571]

Këtu kuptojmë se jehudët nga armiqësia dhe inati nuk e pranonin Islamin, sepse ai nuk ishte pejgamber me gjenezë nga bijtë e Is`hakut por të Ismailit, e urryen aq shumë dhe e kundërshtuan, edhe pse e dinin se ai është pejgamber. Tregon gruaja e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Safija r.a.h. se kishte dëgjuar babanë e saj Hujej b. Ahtabin dhe axhën e saj Jasir b. Ahtabin, të cilët ishin prej krerëve të jehudëve, se kishin shkuar të konfirmojnë se a është me të vërtetë pejgamber Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem apo jo! Kur ishin kthyer Jasiri i kishte thënë Hujejit: "A është ai (pejgamberi i pritur)?" Hujeji tha: "Po pasha Allahun". E pyeti: "A e njohe dhe e konfirmove?" Tha: "Po". Pastaj e pyeti: "E çka mendon ti të bësh?" Hujeji tha: "Pasha Allahun, do të jem armiku i tij derisa të jem gjallë".[572]

Kur u bë musliman Abdullah b. Selami, një rabin hebre, i tha Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Jehudët janë popull i çoroditur, nëse do ta

[569] Nesefi-u, "Komentimi i Nesefiut", vëll.1, fq.91;
[570] Ibni Hisham-i, "Biografia e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem", fq.122;
[571] Ibni Hisham-i, po aty, fq.218;
[572] Ibni Hisham-i, "Siretu Nebevije", fq.241;

konfirmosh, thirri disa prej tyre këtu". Abdullahu i tha Pejgamberit sallallahu alejhi ve sel-lem që t`i pyesë për të, e kur erdhën, Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem i pyeti se çka mendojnë për Abdullah b. Selamin, e ata thanë: "Ai është zotëria i jonë, bir i zotërisë, është prej më të informuarve dhe më të diturve tanë". Pas këtyre fjalëve, doli para tyre Abdullah b. Selami dhe u tha: "O ju grup i jehudëve! Keni frikë Allahun dhe pranonie atë që u ka ardhur, sepse pasha Allahun, ju e dini se ai me të vërtetë është i Dërguari i Allahut, pasi këtë e gjeni të shkruar në Teurat, me emër dhe cilësi, kurse unë dëshmoj se ai është i Dërguari i Allahut, e besoj dhe konfirmoj atë që thotë". Ata thanë: "Gënjen!" e më pas u larguan prej meje. I thashë: "O i Dërguari i Allahut! A të thash se jehudët janë popull i çoroditur, gënjeshtar dhe të fëlliqur".[573]

[573] Ibni Hisham-i, "Siretu Nebevije", fq.241;

MORALI

HADITHI I PESËDHJETËEKATËRTË (54)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ دَاوُدَ، ثَنَا عَمْرُو بْنُ سَوَادٍ السَّرْحِيُّ، ثَنَا مُؤَمَّلُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الثَّقَفِيُّ، عَنْ أَبِي أُمَيَّةَ بْنِ يَعْلَى، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي سَعِيدٍ الْمَقْبُرِيُّ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «أَوْحَى اللَّهُ إِلَى إِبْرَاهِيمَ: يَا خَلِيلِي، حَسِّنْ خُلُقَكَ، وَلَوْ مَعَ الْكَافِرِ تَدْخُلُ مَدْخَلَ الْأَبْرَارِ، فَإِنَّ كَلِمَتِي سَبَقَتْ لِمَنْ حَسُنَ خُلُقُهُ أَنْ أُظِلَّهُ تَحْتَ عَرْشِي، وَأَنْ أَسْقِيَهُ مِنْ حَظِيرَةِ قُدْسِي، وَأَنْ أُدْنِيَهُ مِنْ جِوَارِي»

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu (xh.sh.) i ka shpallur Ibrahimit (a.s.):* ***"O dosti Im! Zbukuroje moralin tënd, edhe nëse bëhet fjalë ndaj ndonjë pabesimtari, (e nëse vepron kështu) do të fus në vendin e Ebrarëve, sepse Fjala Ime ka marrë fund se për ata të cilët e zbukurojnë moralin e tyre, do t`i strehoj nën Arshin Tim, do t`i jap të pijë prej kopshteve të Xhenetit dhe do t`ia ofrojë fqinjësinë Time".***[574]

Morali ka qenë pika e përbashkët e të gjithë pejgamberëve që u dërguan te popujt e tyre, duke filluar prej te Ademi a.s. deri te Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Në një *hadith* që e përcjell Ukbe b. Amri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Atë që e kanë gjetur njerëzit nga fjalët e shpalljeve të mëhershme ishte: "Nëse nuk turpërohesh, vepro çka të duash".*[575]

Ibrahimi a.s. po ashtu u karakterizua me moral të lartë dhe sjellje të mirë, saqë vazhdimisht qëndronte në mesin e njerëzve dhe duronte fjalët dhe ofendimet e tyre. Por, përmes shpalljes që mori nga Zoti, ai e përmirësoi

[574] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.6, fq.315, nr.6506; por në zinxhirin e këtij hadithi ka transmetues të dobët (shih: Hejthemi-u, "Mexhmea`l-Bahrejn fi zevaidi`l-mu`xhemejn", mektebetu`r-Rushd, Rijad, botimi i parë, 1992, vëll.5, fq.237, nr.2983);
[575] Buhari-u, "Sahih", kitab Ehadithu`l-enbija, bab, nr.3483; etj.

sjelljen ndaj të gjithë njerëzve pa përjashtim. Shkaku i këtij niveli të lartë shpirtërorë, ishte edhe prej pejgamberëve të zgjedhur dhe të vendosur, saqë e meritoi edhe titullin "dosti i Zotit". Kështu e emërtoi edhe në Kuran, ku thotë: **"...Allahu e zgjodhi Ibrahimin të dashurin më të ngushtë".**[576]

Zoti e mësoi Ibrahimin a.s. që të mos e kufizojë moralin e tij vetëm ndaj besimtarëve, por të jetë i sjellshëm edhe ndaj pabesimtarëve, sepse sjellja e mirë mund të bëhet shkak për ndryshimin e zemrës së tij dhe kthimin kah rruga e Zotit. Ibrahimi a.s. e aplikoi këtë urdhër të Zotit dhe ishte i sjellshëm ndaj të gjithëve, sidomos ndaj babait të tij idhujtarë. Këtë e vërejmë të zbatuar në rrëfimin kuranor ku Zoti thotë: **"Ai (babai i tij) tha: "A ti Ibrahim i refuzon zotat e mi? Nëse nuk ndalesh (së fyeri zotat e mi), unë do të gurëzoj, ndaj largohu prej meje për një kohë të gjatë". Ai (Ibrahimi) tha: "Paqja qoftë për ty, unë do të lus Zotin tim për të të falur ty, ai ishte ndaj meje i kujdesshëm".**[577]

Jo vetëm Ibrahimi a.s. por të gjithë besimtarët urdhërohen që të jenë të sjellshëm ndaj pabesimtarëve të përgjithësi. Zoti thotë në Kuran për ata të cilët kanë familjarë pabesimtarë: **"E nëse ata dy (prindërit) tentojnë që ti të më përshkruash ortak Mua, për çka ti nuk ke asnjë fakt, atëherë mos i respekto ata, por në çështjet e kësaj bote, të keshë mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë...".**[578]

Sa i përket rasteve të mirësjelljes së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem me të huajt, do të duhej të shkruajmë një punim në vete, pasi ai që në ditët e para të shpalljes, u prit keq nga mekasit, por nuk e prishi sjelljen e vet ndaj tyre në asnjë moment.

Zoti i premtoi Ibrahimit a.s. se shpërblimi për mirësjelljen dhe edukatën e mirë, është shoqërimi në Xhenet me *Ebrar*-ët. Kurse pozitën e tyre e sqaron Zoti në Kuran në disa vende, të cilat do t`i përmendim në vijim: **"Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): "Të besoni Zotin tuaj!" E ne besuam! Zoti ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët (*Ebrar*)!"**[579] Sa i përket shpërblimit të atyre që hyjnë në këtë grup, Zoti tregon: **"Por ata që ia patën frikën Zotit të tyre, ata i kanë Xhenetet nëpër të cilat rrjedhin lumenj**

[576] Kurani, Nisa, 125;
[577] Kurani, Merjem, 46-47;
[578] Kurani, Lukman, 15;
[579] Kurani, Ali Imran, 193;

dhe aty janë përgjithmonë. Ajo është pritje nga ana e All-llahut, e për të mirët (*Ebrar*-ët) më e dobishmja është ajo që është te All-llahu".[580]

Për gjendjen e *Ebrarëve* në Xhenet, flet më detajisht sureja Insan, ku Zoti thotë: **"S'ka dyshim se të devotshmit (*Ebrar*-ët) do të pijnë nga gota që përzierja brenda saj është nga kafuri (aromatik). Është një burim prej të cilit pijnë robërit e All-llahut dhe e bartin atë ku të duan. Ata janë që zbatojnë premtimet e tyre dhe i frikësohen një dite dëmi i së cilës ka përmasa të mëdha. Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po All-llahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me Xhenet dhe me petka mëndafshi. Aty janë të mbështetur në kolltukë dhe aty nuk shohin as diell (vapë) e as të ftohtë. Hijet e tyre (të pemëve) janë afër mbi ta dhe kalaveshët e pemëve janë të qasur shumë afër. Dhe atyre u bëhet shërbim me enë të argjendta dhe me gota të tejdukshme. Të tejdukshme nga argjenti që ata (shërbëtorët) i përcaktuan të jenë sa duhet (të mëdha ose të vogla). Dhe u jepet të pijnë aty gota të verës të përzier me zenxhebilë (bimë aromatike). (Nga) Burim aty që quhet selsebil (i lehtë në të pimë). Dhe atyre u sillen për shërbim djelmosha që përherë janë të tillë sa që kur t'i kundrosh të duken si margaritarë të derdhur. Dhe kur të shikosh aty, sheh begati të mëdha e zotërim (pronë, pasuri) të madh. Kanë të veshura rrobe mëndafshi të hollë e të gjelbër (atllas) dhe të mëndafshit të trashë (brokat); janë të stolisur me bylyzykë të argjentë dhe Zoti i tyre u jep të pijnë pije të pastër. Ky është shpërblimi juaji, sepse angazhimi juaji ka qenë i pranishëm".[581]**

Dhe thotë: **"E s'ka dyshim se të mirët (*Ebrar-ët)* janë në kënaqësinë e përjetimeve (në Xhenetin Neim)".** Dhe në suren Mutafifin për ta thotë: **"Jo, nuk janë të njejtë! Se libri i të mirave (*Ebrar-ëve)* gjendet në Il-lijjinë! E ku e di ti se çka është Ilijunë? Është një libër i qendisur qartë. Të cilin e dëshmojnë engjëjt që janë më të afërmit. E s'ka dyshim se vepërmirët janë në përjetime e kënaqësi (Xhenet). Të mbështetur në kolltukë vështrojnë. Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve. U jepet të pijnë pije në enë të mbyllura. Pije që në fund asaj i vjen era**

[580] Kurani, Ali Imran, 198;
[581] Kurani, Insan, 5-22;

misk! E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën. Dhe përzierja e asaj pije është në *tesnim* (uji më i mirë). Krua nga i cili do të pijnë më të afërmit e Zotit".[582]

Pra, kjo është pozita e ndershme e *Ebrar*-ëve, ku do të jenë ata të cilët kanë moral të mirë në këtë botë dhe ndjekin shembullin e pejgamberëve. Vend ku do të jetë Ibrahimi a.s. dhe të dërguarit tjerë.

Përpos kësaj pozite që është pozitë nderi në Xhenet, *Ebrar*-ët dhe ata që ishin të moralshëm, do të jenë nën hijen e *Arsh*-it në Ditën e Llogarisë, atë ditë kur nuk ka hije tjetër përpos asaj Hije dhe të gjithë njerëzit do të lakmojnë atë vend, por vetëm një grupi të caktuar do t`i mundësohet ky nder, e prej tyre do të jenë edhe ata që kishin sjellje të mirë ndaj të gjithë njerëzve në këtë jetë.

Kur përmendet në tekstin e *hadith*-it termi ***`Fjala Ime`*** ka për qëllim caktimin e Zotit, se Zoti ka vendosur ashtu dhe është çështje e prerë. Po ashtu shprehja e përdorur në *hadith* **"hadhijreti kudsi"** nënkupton Xhenetin.[583] Sa i përket pijeve që do t`i ofrohen aty, u trajtua detajisht në *ajet*-et kuranore që u përmendën më lart.

Kurse sa i përket shprehjes në *hadith:* ***"Do t`ia ofrojë fqinjësinë Time"*** nënkupton do ta nderojë me nderimet më të larta dhe do të meritojë kënaqësinë e Tij, por nuk guxon asesi të interpretohet me vend dhe pozitë, sepse Zoti nuk posedon trup që të zë vend në hapësirë e dikush të pozicionohet afër Tij.

Morali është vepra që njerëzit më shumë i shpëton në botën tjetër, kurse për këtë ka shumë *hadith*-e nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, por ne nuk kemi mundësi t`i sjellim të gjitha këtu, por do të mjaftohemi me një përcjellje, që e transmeton Ebu Hurejre r.a. se e kanë pyetur Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem çka i çon njerëzit më së shumti në Zjarr? Ai tha: *"Dy gjëra: "Gjuha dhe organi gjenital".* Pastaj e pyetën se çka i çon njerëzit më së shumti në Xhenet?" Ai tha: *"Frika ndaj Allahut dhe morali i mirë".*[584]

[582] Kurani, Mutafifin, 18-28;
[583] Isa Memishi, "Fjalor arabisht-shqip", vëll.1, fq.349;
[584] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 10/370, nr.7642; Ngjashëm edhe Tirmidhi-u në "Sunen", kitab el-Edebi, bab 62, nr.2011;

Të përsosim moralin tonë, të jemi të mirë me të gjithë për t`i dhënë një pasqyrë të përsosur fesë sonë, se përmes moralit të mirë, ne paraqesim edhe fenë para të tjerëve, prandaj duhet çdo besimtar të përsos moralin e vet.

DITURIA

HADITHI I PESËDHJETËEPESTË (55)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُحَمَّدٍ، قَالَ: حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، قَالَ: حَدَّثَنَا عَمْرٌو، قَالَ: أَخْبَرَنِي سَعِيدُ بْنُ جُبَيْرٍ، قَالَ: قُلْتُ لِابْنِ عَبَّاسٍ: إِنَّ نَوْفًا البَكَالِيَّ يَزْعُمُ أَنَّ مُوسَى لَيْسَ بِمُوسَى بَنِي إِسْرَائِيلَ، إِنَّمَا هُوَ مُوسَى آخَرُ؟ فَقَالَ: كَذَبَ عَدُوُّ اللَّهِ حَدَّثَنَا أُبَيُّ بْنُ كَعْبٍ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: قَامَ مُوسَى النَّبِيُّ خَطِيبًا فِي بَنِي إِسْرَائِيلَ فَسُئِلَ أَيُّ النَّاسِ أَعْلَمُ؟ فَقَالَ: أَنَا أَعْلَمُ، فَعَتَبَ اللَّهُ عَلَيْهِ، إِذْ لَمْ يَرُدَّ العِلْمَ إِلَيْهِ، فَأَوْحَى اللَّهُ إِلَيْهِ: أَنَّ عَبْدًا مِنْ عِبَادِي بِمَجْمَعِ البَحْرَيْنِ، هُوَ أَعْلَمُ مِنْكَ. قَالَ: يَا رَبِّ، وَكَيْفَ بِهِ؟ فَقِيلَ لَهُ: احْمِلْ حُوتًا فِي مِكْتَلٍ، فَإِذَا فَقَدْتَهُ فَهُوَ ثَمَّ، فَانْطَلَقَ وَانْطَلَقَ بِفَتَاهُ يُوشَعَ بْنِ نُونٍ، وَحَمَلاَ حُوتًا فِي مِكْتَلٍ، حَتَّى كَانَا عِنْدَ الصَّخْرَةِ وَضَعَا رُءُوسَهُمَا وَنَامَا، فَانْسَلَّ الحُوتُ مِنَ المِكْتَلِ فَاتَّخَذَ سَبِيلَهُ فِي البَحْرِ سَرَبًا، وَكَانَ لِمُوسَى وَفَتَاهُ عَجَبًا، فَانْطَلَقَا بَقِيَّةَ لَيْلَتِهِمَا وَيَوْمَهُمَا، فَلَمَّا أَصْبَحَ قَالَ مُوسَى لِفَتَاهُ: آتِنَا غَدَاءَنَا، لَقَدْ لَقِينَا مِنْ سَفَرِنَا هَذَا نَصَبًا، وَلَمْ يَجِدْ مُوسَى مَسًّا مِنَ النَّصَبِ حَتَّى جَاوَزَ المَكَانَ الَّذِي أُمِرَ بِهِ، فَقَالَ لَهُ فَتَاهُ: (أَرَأَيْتَ إِذْ أَوَيْنَا إِلَى الصَّخْرَةِ فَإِنِّي نَسِيتُ الحُوتَ وَمَا أَنْسَانِيهِ إِلَّا الشَّيْطَانُ) قَالَ مُوسَى: (ذَلِكَ مَا كُنَّا نَبْغِي فَارْتَدَّا عَلَى آثَارِهِمَا قَصَصًا) فَلَمَّا انْتَهَيَا إِلَى الصَّخْرَةِ، إِذَا رَجُلٌ مُسَجًّى بِثَوْبٍ، أَوْ قَالَ تَسَجَّى بِثَوْبِهِ، فَسَلَّمَ مُوسَى، فَقَالَ الخَضِرُ: وَأَنَّى بِأَرْضِكَ السَّلاَمُ؟ فَقَالَ: أَنَا مُوسَى، فَقَالَ: مُوسَى بَنِي إِسْرَائِيلَ؟ قَالَ: نَعَمْ، قَالَ: هَلْ أَتَّبِعُكَ عَلَى أَنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عُلِّمْتَ رَشَدًا قَالَ: إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا، يَا مُوسَى إِنِّي عَلَى عِلْمٍ مِنْ عِلْمِ اللَّهِ عَلَّمَنِيهِ

لاَ تَعْلَمُهُ أَنْتَ، وَأَنْتَ عَلَى عِلْمٍ عَلَّمَكَهُ لاَ أَعْلَمُهُ، قَالَ: سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ اللَّهُ صَابِرًا، وَلاَ أَعْصِي لَكَ أَمْرًا، فَانْطَلَقَا يَمْشِيَانِ عَلَى سَاحِلِ البَحْرِ، لَيْسَ لَهُمَا سَفِينَةٌ، فَمَرَّتْ بِهِمَا سَفِينَةٌ، فَكَلَّمُوهُمْ أَنْ يَحْمِلُوهُمَا، فَعُرِفَ الخَضِرُ فَحَمَلُوهُمَا بِغَيْرِ نَوْلٍ، فَجَاءَ عُصْفُورٌ، فَوَقَعَ عَلَى حَرْفِ السَّفِينَةِ، فَنَقَرَ نَقْرَةً أَوْ نَقْرَتَيْنِ فِي البَحْرِ، فَقَالَ الخَضِرُ: يَا مُوسَى مَا نَقَصَ عِلْمِي وَعِلْمُكَ مِنْ عِلْمِ اللَّهِ إِلَّا كَنَقْرَةِ هَذَا العُصْفُورِ فِي البَحْرِ، فَعَمَدَ الخَضِرُ إِلَى لَوْحٍ مِنْ أَلْوَاحِ السَّفِينَةِ، فَنَزَعَهُ، فَقَالَ مُوسَى: قَوْمٌ حَمَلُونَا بِغَيْرِ نَوْلٍ عَمَدْتَ إِلَى سَفِينَتِهِمْ فَخَرَقْتَهَا لِتُغْرِقَ أَهْلَهَا؟ قَالَ: أَلَمْ أَقُلْ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا؟ قَالَ: لاَ تُؤَاخِذْنِي بِمَا نَسِيتُ وَلاَ تُرْهِقْنِي مِنْ أَمْرِي عُسْرًا – فَكَانَتِ الأُولَى مِنْ مُوسَى نِسْيَانًا –، فَانْطَلَقَا، فَإِذَا غُلاَمٌ يَلْعَبُ مَعَ الغِلْمَانِ، فَأَخَذَ الخَضِرُ بِرَأْسِهِ مِنْ أَعْلاَهُ فَاقْتَلَعَ رَأْسَهُ بِيَدِهِ، فَقَالَ مُوسَى: أَقَتَلْتَ نَفْسًا زَكِيَّةً بِغَيْرِ نَفْسٍ؟ قَالَ: أَلَمْ أَقُلْ لَكَ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا؟ – قَالَ ابْنُ عُيَيْنَةَ: وَهَذَا أَوْكَدُ – فَانْطَلَقَا، حَتَّى إِذَا أَتَيَا أَهْلَ قَرْيَةٍ اسْتَطْعَمَا أَهْلَهَا، فَأَبَوْا أَنْ يُضَيِّفُوهُمَا، فَوَجَدَا فِيهَا جِدَارًا يُرِيدُ أَنْ يَنْقَضَّ فَأَقَامَهُ، قَالَ الخَضِرُ: بِيَدِهِ فَأَقَامَهُ، فَقَالَ لَهُ مُوسَى: لَوْ شِئْتَ لاَتَّخَذْتَ عَلَيْهِ أَجْرًا، قَالَ: هَذَا فِرَاقُ بَيْنِي وَبَيْنِكَ" قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «يَرْحَمُ اللَّهُ مُوسَى، لَوَدِدْنَا لَوْ صَبَرَ حَتَّى يُقَصَّ عَلَيْنَا مِنْ أَمْرِهِمَا»

Transmeton Seid b. Xhubejri (r.a.) i cili thotë: “I thashë Ibni Abasit (r.a.) se Neufa el-Bekalij, pohon se Musa, bashkudhëtari i Hidrit, nuk ka qenë Musa i Beni Israilëve. Ibni Abasi tha: “Ka gënjyer armiku i Allahut. Më ka thënë Ubej b. Ka`bi se e ka dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *“Kur Musa a.s. u ngrit të mbante ligjëratë para beni Israilëve, ata e pyetën: “Cili njeri është më i dituri?” Ai tha: “Unë jam më i dituri”. Allahu e qortoi atë, pse nuk ia atribuoi dijen Allahut. Kështu, Allahu i shpalli atij:*

"Është një rob nga robërit e Mi, aty ku bashkohen dy dete, ai është më i ditur se ti". *Musa a.s. tha: "O Zot, si ta takoj?" I tha atij:* ***"Merre një peshk dhe ec, e kur ta humbësh atë (peshkun) aty do ta gjeshë (Hidrin)".*** *Musai a.s. u nis për në udhëtim, bashkë me shërbyesin e vet Jusha b. Nun, derisa arritën te një shkëmb, ku të dy mbështetën kryet dhe fjetën. Peshku lëvizi fort në çantë dhe doli prej saj duke kërcyer në det. Atje ai mori rrugën e vet drejt si në tunel (shih:Kehf 61). Kjo ishte e çuditshme për Musaun dhe shokun e tij. Ata vazhduan rrugën gjatë pjesës tjetër të natës dhe ditës, e kur Musau i tha djaloshit: "Na jep ushqimin tonë, sepse jemi lodhur nga ky udhëtimi i jonë" (Kehf, 62). Musai nuk u lodh aspak, derisa kaloi vendin, të cilin Allahu e kishte urdhëruar ta kalonte. Djaloshi i tha: "E sheh, kur arritëm te shkëmbi, unë harrova peshkun, e nuk më bëri të harroj kush tjetër pos shejtanit". Musa a.s. tha: "Kjo është ajo që kërkojmë, ata u kthyen prapë, duke ndjekur gjurmët e kaluara". (Kehf, 64). Ata të dy u kthyen duke ecur deri te shkëmbi. Kur arritën, gjetën një njeri, të mbuluar me rrobë. Musau i dha selam, kurse Hidri i tha: "Prej nga në tokën tënde selami?" I tha: "Unë jam Musa!" Ai tha: "Musau, i beni Israilëve?" Tha: "Po". Dhe tha: "A mund të ndjek ty, që të më mësosh nga dija që të është dhënë?" Hidri tha: "Ti nuk mund të durosh me mua! (Kehf, 67). O Musa, unë kam dije nga dija e Allahut, të cilën ma ka dhënë, që ti nuk e dinë. Edhe ti ke dije, të cilën unë nuk e di". Tha: "Do të më gjesh mua inshallah nga durimtarët dhe unë nuk do të kundërshtoj në asgjë". Ata vazhduan rrugën dhe ecën bregut të detit. Ata nuk kishin anije. Atëherë përskaj tyre erdhi një anije dhe ata biseduan me njerëzit e anijes, që edhe ata të shkojnë me ta. Hidrin e njohtën dhe i bartën pa pagesë. Më vonë erdhi një harabel, ra në skaj të anijes dhe mori një apo dy gëllënka ujë në det. Hidri tha: "O Musa, dituria ime dhe e jotja në krahasim me diturinë e Allahut, është sa sasia që mori ky harabel prej detit". Më pas, Hidri iu rrek një dërrase të anijes dhe e nxori nga vendi. Musai tha: "Njerëzit na bartën neve pa pagesë, ndërsa ti iu rreke anijes së tyre dhe e shpove, që t`i fundosësh udhëtarët e saj?!" Hidri i tha: "A të thash, se ti nuk mund të kesh durim me mua!". Musa i tha: "Mos më qorto për atë që kam harruar". Kjo ishte harresa e parë e Musait. Më pas vazhduan dhe takuan një djalosh që luante me fëmijët. Hidri e kapi për koke dhe me duart e tij, ia këputi kokën. Musa a.s. i tha: "Vallë, e mbyte një person të pafajshëm në mënyrë të padrejtë?!" Hidri i tha: "A të thash, se ti nuk mund të kesh durim me mua?!" Ata vazhduan udhëtimin dhe arritën deri te një vendbanim, prej banorëve të të cilit kërkuan ushqim. Banorët nuk deshën që t`i gostisin. Ata panë në fshat një murë që ishte gati të rrëzohet dhe Hidri e drejtoi atë me duart e tij. Musa i tha: "Sikur të kishe dashur, do të kishe marrë diçka si shpërblim për këtë punë?!". Hidri i tha: "Kjo është ndarja mes nesh".* Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Allahu e*

mëshiroftë Musaun a.s.! Shumë do të kishim dëshiruar sikur ai të ishte më i durueshëm e që t`na tregohej ngjarja e atyre të dyve".[585]

Dituria është një vlerë e madhe e njeriut, sepse përmes saj arrin të kuptojë shumë të vërteta, të cilat e udhëzojnë në rrugën e drejtë. Përmes diturisë, Zoti ka ngritur njerëzit nga gjallesat tjera, sepse logjika është një mirësi dhe mrekulli të cilën Zoti e vëndoi te njeriu. Ne si mysliman, në jetën tonë duhet ta kemi prioritet arritjen e diturisë, sepse përmes saj, ne arrijmë të njohim Zotin e botrave.

Në këtë *hadith*, gjejmë të përshkruar ngjarjen e Musaut a.s. me Hidrin. Gjersa Musai a.s. ishte duke ligjëruar para bijve të Israilit, një person i mahnitur nga fjalimi i Musait a.s. e pyeti se a gjendet dikush më i ditur në botë se ai, ku në këtë rast, Musau a.s. nuk ia mbështeti diturinë Allahut xh.sh. porse pretendoi se ai është njeriu më i ditur. Nga kjo, ne përfitojmë një vërejtje, që duhet ta marrin të gjithë njerëzit, se dituria nuk ka kufi, se Zoti ngrit disa njerëz në nivele të larta të diturisë, andaj askush nuk mundet të pretendojë se i din të gjitha dhe që është njeriu më i ditur në botë. Zoti thotë në Kuran: **"...Atë që duam Ne e lartësojmë shumë në dituri, e mbi secilin të dijshëm, ka edhe më të dijshëm".**[586]

Njeriu nuk duhet të krenohet me diturinë e tij, por duhet ta shpërndajë atë që edhe të tjerët të përfitojnë prej asaj që e ka begatuar Zoti. Njeriu i cili e mëson diturinë për t`u krenuar para njerëzve, nuk do të ketë dobi prej saj në botën tjetër. Është fakt se Musai a.s. ka qenë ndër njerëzit më të ditur në kohën e tij, por Zoti i bëri me dije se nuk duhet njeriu të bie në vetpëlqim dhe duhet ditur se dituria është një mirësi që Zoti ia jep kujt të dojë. Po ashtu, rruga e diturisë është e shtruar me vështirësi, andaj kërkuesi i diturisë duhet të jetë i durueshëm, sepse përndryshe, nuk do të arrijë përfundimin e studimeve.

Për rastin konkret, flet Zoti në Kuran, në *sure*-n Kehf, prej ajetit 60 deri në ajetin 82. Aty Zoti na rrëfen për këtë takim, ku Zoti e udhëzoi në vendin ku takohen dy dete, që të shkojë aty dhe të takojë Hidrin, një rob të cilin Zoti e dalloi me dituri të shumtë.

---

[585] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab 44, nr.122; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Fadailu, bab min fadaili`l-Hadiri alejhi selamu, nr.2380; etj.
[586] Kurani, Jusuf, 76;

Për Hidrin është diskutuar se vallë është pejgamber (nebij) apo është vetëm një rob i mirë?! Zoti në suren Kehf, i rreferohet atij si `rob`, por nuk e përmend se është pejgamber.

Po ashtu, rreth emërtimit të tij `Hidër`, ka një transmetim në *Sahih*-un e Buhariut, ku transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Hidri është quajtur kështu, sepse kur u ul në një vend të shkretë të bardhë, pas uljes së tij vendi u bë i gjelbëruar".*[587] Imam Neveviu thotë se emri i tij i vërtetë, është Belja b. Melkan.

Po ashtu, në mesin e dijetarëve ka pasur diskutim, se a është ende gjallë Hidri apo ka vdekur?! Disa prej dijetarëve, si imam Kurtubiu, imam Neveviu, Ibën Salahu dhe disa të tjerë, pretendojnë se Hidri a.s. është ende gjallë, për shkak se ka pirë ujë prej *burimit të Jetës*, por është i fshehur nga sytë e njerëzve të rëndomtë. Kurse Buhariu, Ibrahim el-Harbi dhe të tjerë thonë se ai është i vdekur.

Imam Neveviu përcjell fjalët e *mufessir*-it të njohur Tha'lebiut, i cili ka thënë: "Hidri është një i dërguar i Allahut, me jetë të gjatë, dhe sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, atë nuk mund ta shohin sytë e njerëzve të rëndomtë dhe thuhet se ai do të vdesë nga fundi i Botës, kur të ngritet Kur'ani".[588]

Transmetohet nga Harith ibn Usame, autor i *Musned*-it, nga Enesi r.a. e ky nga Resulullahu sal-lallahu alejhi ve sel-lem të ketë thënë: *"Hidri qëndron (jeton) në det e Iljasi në tokë. Ata të dy takohen çdo natë tek penda (diga) të cilën e ka ndërtuar Dhulkarnejni në mes njerëzve dhe Jexhuxhit e Mexhuxhit. Ata kryejnë umren dhe haxhin për çdo vit dhe pinë prej ujit të Zemzemit, që u mjafton deri në vitin e ardhshëm.. ".*[589]

Po ashtu transmetohet se, pasi kishte ndërruar jetë i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem, as`habët kishin parë një plak me mjekër të thinjur, fytyra e të cilit rrezatonte dritë, i cili i këshillonte për durim *as`habët* e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Pasi kishte dalë plaku, njerëzit kishin pyetur:

[587] Buhari-u, "Sahih", kitab Ehadithu`l-Enbija, bab hadithu`l-Hadiri mea Musa alejhima`s-selam, nr.3402; etj.
[588] Nevevi-u, "Tehdhibu`l-Esmai ve`l-Lugati", Darul Kutubi`l-Ilmije, Bejrut, vëll. 1. f. 177;
[589] Mul-la Ali el Kari-u, "El Hadheru fi emri`l-Hadiri", Damask-Bejrut, 1991, fq. 117;

"Kush ishte ky njeri?" e Ebu Bekri r.a. dhe Aliu r.a. ishin përgjigjur: "Ky ishte vëllai i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Hidri a.s.".[590]

Ata që pretendojnë se Hidri është gjallë, thonë se pasi Zoti i dha armikut të tij Iblisit jetë të gjatë që zgjat deri në ndodhinë e Kijametit, atëherë përse të mos i jep edhe ndonjërit prej robërve të Tij të dashur jetë të gjatë?!

Por, dijetarët tjerë e refuzojnë këtë mendim, duke thënë se Zoti askujt nuk i ka dhënë jetë të përhershme, siç është *ajet*-i: **"Ne asnjë njeri para teje nuk e kemi bërë të përjetshëm...".**[591] Po ashtu, mbështeten në *hadith*-in që e transmeton Abdullah b. Umeri r.a. i cili ka thënë: "Fali namazin e jacisë me ne Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ditën e fundit të jetës së tij, e pasi dha *selam*, u ngrit dhe tha: *"A e shihni këtë natë? Me të vërtetë, në krye të njëqind viteve, pas kësaj nate, nuk do të mbetet gjallë asnjë nga të gjithë ata që janë në faqe të dheut".*[592]

Është e sigurtë, se Hidri posedonte dituri të cilën nuk arriti as Musai a.s. ta kuptojë dhe të përballojë atë që i ofronte ai. Ai bëri disa veprime, që në sytë e Musës a.s. dhe të një njeriu të rëndomtë, do të dukeshin të pa logjikshme, por Zoti ia dha një dije të cilën nuk mundte ta kuptojë çdonjëri, vetëm se pasi ta sqarojë ai. Hidri e kishte parasysh se ai nuk do të mund të ballafaqohet me atë lloj dije dhe do t`i shteret durimi, por e lejoi që ta ndjek, për t`i bërë me dije se Zoti kujt të do, i jep dituri të jashtme e cila është e kuptueshme nga masa e gjërë por edhe dituri të brendshme dhe të fshehtë e cila është vetëm për një rreth të ngushtë të njerëzve të caktuar.

[590] Mul-la Ali el Kari-u, "El Hadheru fi emri`l-Hadiri", Damask-Bejrut, 1991, fq. 117;
[591] Kurani, Enbija, 34;
[592] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab semeri fil ilm, nr.116; etj.

HADITHI I PESËDHJETËEGJASHTË (56)

أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُحَمَّدِ بْنِ سَلْمٍ، بِبَيْتِ الْمَقْدِسِ، حَدَّثَنَاحَرْمَلَةُ بْنُ يَحْيَى، حَدَّثَنَا ابْنُ وَهْبٍ، أَخْبَرَنِي عَمْرُو بْنُ الْحَارِثِ، أَنَّ أَبَا السَّمْحِ، حَدَّثَهُ، عَنِ ابْنِ حُجَيْرَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ قَالَ: «سَأَلَ مُوسَى رَبَّهُ عَنْ سِتِّ خِصَالٍ، كَانَ يَظُنُّ أَنَّهَا لَهُ خَالِصَةً، وَالسَّابِعَةُ لَمْ يَكُنْ مُوسَى يُحِبُّهَا، قَالَ: يَا رَبِّ أَيُّ عِبَادِكَ أَتْقَى؟ قَالَ: الَّذِي يَذْكُرُ وَلَا يَنْسَى، قَالَ: فَأَيُّ عِبَادِكَ أَهْدَى؟ قَالَ: الَّذِي يَتْبَعُ الْهُدَى ، قَالَ: فَأَيُّ عِبَادِكَ أَحْكَمُ؟ قَالَ: الَّذِي يَحْكُمُ لِلنَّاسِ كَمَا يَحْكُمُ لِنَفْسِهِ، قَالَ: فَأَيُّ عِبَادِكَ أَعْلَمُ؟ قَالَ: عَالِمٌ لَا يَشْبَعُ مِنَ الْعِلْمِ، يَجْمَعُ عِلْمَ النَّاسِ إِلَى عِلْمِهِ، قَالَ: فَأَيُّ عِبَادِكَ أَعَزُّ؟ قَالَ: الَّذِي إِذَا قَدَرَ غَفَرَ، قَالَ: فَأَيُّ عِبَادِكَ أَغْنَى؟ قَالَ: الَّذِي يَرْضَى بِمَا يُؤْتَى، قَالَ: فَأَيُّ عِبَادِكَ أَفْقَرُ؟ قَالَ: صَاحِبٌ مَنْقُوصٌ» ، قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَيْسَ الْغِنَى عَنْ ظَهْرٍ، إِنَّمَا الْغِنَى غِنَى النَّفْسِ، وَإِذَا أَرَادَ اللَّهُ بِعَبْدٍ خَيْرًا جَعَلَ غِنَاهُ فِي نَفْسِهِ وَتُقَاهُ فِي قَلْبِهِ، وَإِذَا أَرَادَ اللَّهُ بِعَبْدٍ شَرًّا جَعَلَ فَقْرَهُ بَيْنَ عَيْنَيْهِ»

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Musa a.s. e pyeti Zotin për gjashtë gjëra, për të cilat ka menduar se janë vetëm për të dhe për një gjë, për të cilën nuk i kishte pëlqyer përgjigja. Musa a.s. pyeti: "O Zoti im, cili prej robërve Tu është më i devotshmi?" Tha:* ***"Ai i cili vazhdimisht më kujton dhe nuk më harron".*** *(Musa a.s.) pyeti: "Cili prej robërve Tu është më i udhëzuari?" Tha:* ***"Ai që ndjek udhëzimin".*** *(Musa a.s.) pyeti: "Cili prej robërve Tu është më i drejti?" Tha:* ***"Ai që u gjykon njerëzve sikurse vetes".*** *(Musa a.s.) pyeti: "Cili prej robërve Tu është më i ditur?" Tha:* ***"Dijetari i cili nuk mund të ngopet me dituri dhe që prej tjerëve merr dituri për të shtuar dijen".*** *(Musa a.s.) pyeti: "Cili prej robërve Tu është më i fuqishmi?" Tha:* ***"Ai i cili fal kur ka mundësi të ndëshkojë".*** *(Musa a.s.) pyeti: "Cili prej robërve Tu është më i*

pasur?" Tha: ***"Ai i cili është i kënaqur me atë që i është dhënë".*** *(Musa a.s.) pyeti: "Cili prej robërve Tu është më i varfër?" Tha:* ***" Sahibun Menkus (Ai i cili nuk është i kënaqur me atë që posedon)".*** *Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Nuk është pasuri të kesh pasuri të madhe, por pasuria është në pasurinë e shpirtit. Kur Allahu ia do të mirën dikujt, i jep pasuri në shpirt dhe devotshmëri në zemër, e kur nuk e do, i jep varfëri në sy".*[593]

Allahu xh.sh. e zgjodhi Musain a.s. si bashkëbisedues të vetin dhe bisedonte me të pa ndërmjetësimin e *melek*-ut. Musa a.s. i ka parashtruar shumë pyetje, prej të cilave ka marr shpallje dhe dituri, e këto fjalë, janë përcjellë në shumë raste përmes *hadith*-eve *kudsij*. Zoti thotë në Kuran: **"E kur Musai erdhi në kohën që i caktuam dhe i foli Zoti i vet...".**[594] Po ashtu thotë: **"..e Musait i foli Allahu me fjalë".**[595] Ngjashëm është edhe *ajeti*: **"Ai (Allahu) tha: "O Musa, Unë të ngrita ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit Tim...".**[596]

Për mënyrën e komunikimit në mes tyre, nuk kemi ndonjë transmetim i cili na qartëson se si ishte forma konkrete. Për *hadith*-in që e përcjell Xhabiri r.a. se kur Allahu xh.sh. i foli Musës a.s. në kodrën Tur, i foli me një të folur ndryshe nga të folurit në ditën kur e thirri dhe i thotë: ***"O Musa, të kam folur me forcën e dhjetëmijë gjuhëve, ndërsa e kam forcën e të gjitha gjuhëve dhe jam ende më i fuqishëm se aq".*** Kur kthehet Musa a.s. te beni Israilët, ata i thonë: "Na përshkruaj të folurit e Allahut". Ai tha: "Nuk mundem". Ata i thanë: "Përafërsisht". Ai tha: "Imagjinoni zërin e bubullimave të ju drejtohen me të folurit më të kthjellët që e keni dëgjuar".[597] Ky *hadith* nuk është i vërtetë dhe nuk duhet të merret për bazë në lidhje me këtë temë për të argumentuar mënyrën e të folurit të Allahut xh.sh. me Musain a.s.

---

[593] Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belban-it në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", vëll.14, fq.100, nr.6217; Shuajb el-Arnauti në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", në vlerësim të këtij hadithi thotë se zinxhiri është Hasen, kurse transmetuesit janë të besueshëm sipas kushteve të Muslimit, përpos Ebu Sem`hit, i cili është i sinqertë;
[594] Kurani, A`raf, 143;
[595] Kurani, Nisa, 164;
[596] Kurani, A`raf, 144;
[597] Ibni Xheuzi, "Meuduat", vëll.1, fq.113;

Musa a.s. në *hadith-in kudsij* që e kemi në trajtim, i parashtroi Zotit shtatë pyetje, për të kuptuar se cili besimtar dhe rob është më i miri. Në pikën e parë, parashtroi pyetje për devotshmërinë, pasi devotshmëria është mbi të gjitha veprat, sepse nëse njeriu nuk posedon devotshmëri, nuk i bën dobi dituria dhe pasuria. Zoti i tregoi se njeriu më i devotshëm në mesin e njerëzve, është personi i cili e kujton dhe e përmend vazhdimisht Zotin dhe nuk e largon prej mendjes së vet. Për këtë edhe thotë Zoti: **"Më kujtoni Mua, edhe Unë do t`ju kujtoj juve".**[598] Kurse, për ata që e harrojnë Zotin, thotë: **"...e harruan Allahun, prandaj Ai i harroi (nga mëshira e Tij)...".**[599]

Më pas, e pyeti për udhëzimin, se cili prej njerëzve është më i udhëzuari? Zoti iu përgjigj se i udhëzuar është ai që ndjek udhëzimin e Zotit, shkon rrugës së Tij dhe nuk e ndjek epshin e vet. Zoti thotë në Kuran: **"...Thuaju: Udhëzimi i Allahut është udhëzimi i drejtë...".**[600] Udhëzimi i Zotit, është ndjekja e asaj që ka ardhur përmes Kuranit, sepse Zoti thotë aty: **"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim, është udhëzim për të devotshmit".**[601]

Pasi kuptoi pozitën e të udhëzuarit, atëherë parashtroi pyetje në lidhje me njerëzit e drejtë, kurse Zoti iu përgjigj, se më i drejtë është ai i cili u gjykon njerëzve sikur që gjykon për veten. Nëse për vete donë mirë, t`ua dojë të mirën edhe të tjerëve, nëse për vete nuk e dëshiron të keqen, atë të mos ua dëshirojë as të tjerëve. Nëse duhet të gjykojë për ndonjë çështje, atëherë duhet të gjykojë me drejtësi, edhe nëse është në pyetje interesi i tij personal. Zoti thotë në Kuran: **"...e kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me drejtësi në mes njerëzve...".**[602] Po ashtu thotë: **"O ju që keni besuar, bëhuni vazhdimisht të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër jush, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai pasanik apo i varfër, pasi Allahu e di më mirë për ta, e mos e ndiqni epshin e t`i shmangeni drejtësisë...".**[603] Pra, njeriu duhet të gjykojë drejt, pa marrë parasysh se për kë bëhet fjalë.

Kur pyeti se cili është më dijetar, Zoti iu përgjigj se më i dishëm është ai i cili kërkon vazhdimisht diturinë dhe nuk mjaftohet me atë të cilën e ka arritur. Edhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na ka stimuluar që të

[598] Kurani, Bekare, 152;
[599] Kurani, Teube, 67;
[600] Kurani, Bekare, 120;
[601] Kurani, Bekare, 2;
[602] Kurani, Nisa, 58;
[603] Kurani, Nisa, 135;

jemi vazhdimisht në kërkim të diturisë, e të mos mjaftohemi me atë që e dimë. Njeriu gjatë tërë jetës është kërkues i diturisë, prej fëmijërie deri në pleqëri dhe momentet e fundit të jetës. Në moment që njeriu mendon se ka arritur gjithë dijen, ai me këtë i ka mbyllur vetes derën e diturisë dhe e ka hapur derën e mendjemadhësisë.

Më pas, Musa a.s. ka pyetur se cili njeri është më i fuqishëm në mesin e njerëzve?! Zoti tha se njeriu më i fuqishëm është personi i cili fal kur ka mundësi të ndëshkojë. Pra, njeriu kur është në pozitë që i ka të gjitha mundësitë për të ndëshkuar, ka pozitë dhe pushtet, apo ka fuqi trupore dhe mund të mposhtë një të dobët, në këtë rast, njeriu konsiderohet i fortë, sepse është në gjendje të kontrollojë emocionet e tia më shumë se fuqinë e vet. Në lidhje me këtë temë, përcillet një *hadith* i përafërt, të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a. ku Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka pyetur: *"Cilin e konsideroni ju të fuqishëm në mesin tuaj?"* Njerëzit u përgjigjën se i fuqishëm është ai i cili i mund njerëzit. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"I fuqishëm është ai i cili arrin të kontrollojë vetveten gjatë hidhërimit".*[604]

Kur Musa a.s. pyeti se cili njeri është më i pasur, Zoti i tha se më i pasur është njeriu i cili është i begatuar nga Zoti me mirësi dhe është mirënjohës për të dhe e vlerëson atë që posedon. Ky njeri nuk lakmon në pasurinë dhe begatitë e huaja, porse është falënderues për të mirat që ka në pronën e vet. Njeriu duhet çdoherë ta vlerësojë atë që ka, e jo atë që nuk e ka. Në një fjalë popullore thuhet se për njeriun, është më e mirë një zog në duar, sesa njëqind në ajër. Pra, njeriu të jetë i kënaqur me atë që ka në duar, e të mos shikojë ata që janë mbi të me pasuri dhe të mira, sepse është e mundur ta humb edhe atë që posedon, prandaj nuk duhet shumë të lakmojmë dhe të jemi të pangopur, por të mjaftohemi me pak, që ta vlerësojmë mirësinë e Zotit.

E kundërta e këtij personi, është ai i cili nuk e vlerëson atë që posedon, e ky është njeriu më i varfër sipas përgjigjes të cilën e mori Musa a.s. kur pyeti se cili është njeriu më i varfër. Pra, i varfër nuk është ai i cili nuk posedon shumë pasuri, por ai i cili nuk mjaftohet me asgjë dhe vazhdimisht frikësohet që të mos i pakësohet dhe të mos e humb atë të cilën e ka në posedim. Ky njeri edhe pse posedon të mira materiale, përsëri është i varfër,

[604] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Edebu, bab el-hadheri mine`l-gadabi, nr.6114; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab fadlu men jemliku nefsehuinde`l-gadabi, nr.2609; etj.

sepse nuk din të shijojë mirësinë e kësaj begatie. Frika prej varfërisë, është më e keqe sesa vet varfëria. Andaj ai i cili frikësohet nga varfëria, ai është i varfër, edhe nëse posedon pasuri të shumtë. Mu për këtë edhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem këshilloi që njeriu të jetë i pasur në shpirt dhe bujar, e kur të jetë kështu, nuk e lakmon të huajën dhe nuk xhelozon për të tjerët.

Edhe Buhariu dhe Muslimi këtë pjesë të fundit të hadithit e përcjellin prej Ebu Hurejres r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk është pasuria në mallin e shumtë, por pasuri është pasuria e shpirtit".*[605]

Me këtë kuptojmë përgjigjet të cilat i mori Musau a.s. në lidhje me ato që i interesonin atij, sepse njerëzit për këto gjëra kanë perceptime të ndryshme, por Zoti na mësoi të shohim ndryshe në gjërat të cilat janë bërë të zakonshme në mesin tonë.

[605] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab el-gina gine`n-nefsi, nr.6446; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab lejse`l-gina en kethreti`l-aradi, nr.1051; etj.

HADITHI I PESËDHJETËESHTATË (57)

أَخْبَرَنَا مَخْلَدُ بْنُ مَالِكٍ، عَنْ حَجَّاجِ بْنِ مُحَمَّدٍ، عَنْ لَيْثِ بْنِ سَعْدٍ، عَنْ مُعَاوِيَةَ بْنِ صَالِحٍ، عَنْ أَبِي الزَّاهِرِيَّةِ، يَرْفَعُ الْحَدِيثَ أَنَّ اللَّهَ قَالَ: «أَبُثُّ الْعِلْمَ فِي آخِرِ الزَّمَانِ حَتَّى يَعْلَمَهُ الرَّجُلُ وَالْمَرْأَةُ، وَالْعَبْدُ وَالْحُرُّ، وَالصَّغِيرُ وَالْكَبِيرُ، فَإِذَا فَعَلْتُ ذَلِكَ بِهِمْ، أَخَذْتُهُمْ بِحَقِّي عَلَيْهِمْ»

Transmeton Ebu Zahirije se (Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë): *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Da ta përhap diturinë në Kohën e Fundit, saqë do ta mësojnë atë burri dhe gruaja, i robëruari dhe i liri, i vogli dhe i madhi. E kur ta bëj këtë me ta, do t`i marr (dënoj) me drejtësinë Time".***[606]

Ky *hadith* fillimisht është *Mursel*, që përcillet nga *tabiiu* në mënyrë direkte nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem pa e përmendur *sahab*-iun, por që përforcohet kuptimi i tij nga *hadith*-et tjera që vërtetojnë se në kohën e fundit, si shenjë e afrimit të kijametit, do të ngritet dituria e vërtetë dhe do të përhapet në mesin e njerëzve injoranca, njerëz jo kompetent do të flasin për gjëra madhore të fesë Islame, edhe pse për të nuk kanë njohuri.

Po përmendim disa *hadith*-e që flasin mbi diturinë dhe afrimin e kijametit dhe na bëjnë me dije se në kohën e fundit nuk do të ketë dituri të mirëfilltë, edhe pse mund të ketë shkolla të shumta.

---

[606] Darimij-u, "Sunen", kitab Mukadime, bab el ameli bil ilmi ve husni`n-nijeti fihi, nr.253; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", 6/100; Mizzi-u thotë: "Ebu Zahirije është Hudejr b. Kurejb el-Hadremiju. Jahja b. Meini, Ixhliu dhe Nesaiu thonë se është besueshëm. Ebu Hatimi thotë se nuk ka të keqe te ai. Kështu thotë edhe Darekutni, duke kushtëzuar transmetimin prej tij nga të besueshmit. Edhe Ibni Sa`di thotë që ka vdekur në vitin 129 h. dhe se është i besueshëm inshallah dhe ka pëcjellë shumë hadithe". (shih: Mizzi-u, "Tehdhibu`l-Kemal", 5/491-492, nr.1144; Dhehebiu, "Sijeru`l-A`lam en-Nubela", 5/193, nr.71; Ibni Haxher-i, "Tehdhibu`t-Tehdhib", tahkik Ibrahim Zejbik dhe Adil Murshid, Muessesetu`r-Risale, Bejrut, 1/366-367); Edhe Ibni Hiban-i e shënon në librin e tij "Eth-Thikat", Indi, botimi i parë, 1973, vëll.4, fq.183 në gjeneratën e tabiinëve dhe thotë se ka vdekur gjatë sundimit të Abdulmelikut; por Ebu Zahirije sipas Ibni Haxher-it, shohim se nuk është sahabi, kështu që hadithi me këtë status ngelet Mursel;

Transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nga shenjat e Kijametit, është se do të ngritet dituria, do të përhapet injoranca, do të pihet alkooli dhe do të shfaqet amoraliteti".*[607]

Ngjashëm si ky *hadith*, është edhe transmetimi tjetër, ku përcillet prej Enesit r.a. i cili thotë: "Do t`u tregoj një *hadith*, të cilin askush nuk do t`ua tregojë më pas meje, e kam dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"Nga shenjat e Kijametit është se do të pakësohet dituria, do të përhapet injoranca, do të shfaqet imoraliteti, do të shtohet numri i grave dhe do të pakësohet numri i burrave, saqë do të ketë pesëdhjetë gra vetëm për një burrë".*[608]

Transmeton Abdullah b. Amër el-Asi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu nuk do ta merr diturinë me rëmbim, duke e rëmbyer atë para njerëzve, por do ta merr diturinë përmes vdekjes së dijetarëve. Dhe kur nuk do ta lërë asnjë dijetar, bota do t`i zgjedh të paditurit për udhëheqës. Populli do t`i pyes ata, ndërsa ata do të përgjigjen pa asnjë dituri. Kështu, ata vetë do të devijojnë dhe po ashtu do t`i devijojnë edhe të tjerët".*[609]

Po ashtu është pyetur Seid b. Xhubejri r.a. se cila është shenja e afrimit të shkatërrimit të njerëzve? Ai tha: "Kur të shkatërrohen dijetarët e tyre".[610]

Nga *hadith*-i të cilin e kemi në trajtim, shohim se nga dijetarët kërkohet sinqeritet në punën e tyre, e jo vetëm grumbullim të dijes. Dituria do të bëhet lehtë e arritshme, atë do ta mësojnë burra e gra, porse pak do të punojnë me të. Sot edhe shumë gra janë duke studiuar nëpër shkolla dhe universitete, porse mungon cilësia e mësimit.

Diturinë e mësojnë të lirët dhe robërit, e sot shohim se edhe nëpër burgje u mundësohet njerëzve të përfundojnë shkolla, të vazhdojnë studimet, të arrijnë shkallë të larta në dije, përfundojnë me magjistratura dhe doktoratura.

---

[607] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab ref`il-ilmi ve dhuhuri`l-xhehli, nr. 80; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab ref`ul ilmi, nr.2671; etj.

[608] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab ref`il-ilmi ve dhuhuri`l-xhehli, nr. 81; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab ref`ul ilmi, nr.2671; etj.

[609] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab kejfe jukbedu`l-ilm, nr.100; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab ref`ul ilmi, nr.2673; etj.

[610] Ibni Ebi Shejbeh, "El-Musannef", vëll.7, fq.458, nr.37.206;

Lehtë konstatohet se tek një numër i njerëzve që diplomojnë nuk ka sinqeritet, dituria nuk mësohet për kënaqësinë e Zotit, por mësohet për të arritur pozita, për vende pune, për rritje të pagës mujore, për t`u krenuar para tjerëve, apo për të gjetur bashkëshort/e për martesë dhe nuk mësohet që të lartësohet feja e Zotit. Pastrimi i *nijet*-it gjatë studimit është shumë i rëndësishëm, sepse nëse qëllimin e studimit nuk e ka të pastër, ai do të shpërblehet te Zoti në bazë të qëllimit që ka në zemër.

Të gjithë këta, do të kenë llogari para Zotit për mësimin që kanë arritur, siç tregohet edhe në *hadith*-in që e përcjell Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk do të lëviz këmba e njeriut Ditën e Gjykimit (para Zotit) derisa të përgjigjet për katër gjëra: Jetën e tij si e ka kaluar, me diturinë e tij se si ka vepruar, për pasurinë e tij se si e ka fituar dhe ku e ka harxhuar dhe trupin e tij (në rini) se si ka vepruar dhe e ka harxhuar".*[611]

Pra, e shohim se edhe për diturinë do të ketë llogari dhe njeriu do të merret në pyetje se si ka vepruar me diturinë dhe si e ka pasur qëllimin.

Darimiju shënon edhe një *hadith kudsij* përmes *tabiin*-it Muhasir b. Habibi se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë nuk e pranoj çdo fjalë të njeriut të urtë, por e pranoj atë që ka për qëllim dhe që e donë, e nëse qëllimi dhe dëshira e tij janë për Kënaqësinë Time, atëherë e konsideroj heshtjen e tij si falënderim ndaj Meje, edhe nëse nuk ka folur asgjë".***[612]

Pra, gjatë mësimit kërkohet sinqeritet dhe *nijet* i pastër, gjë që duhet ta kenë parasysh të gjithë të cilët ecin rrugës së diturisë.

---

[611] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab fil kijame, nr.2425, nga Ebu Berze el-Eslemij-u; Ebu Isa thotë: Ky hadith është Hasenu-Sahih; Taberani-u, "Mu`xhem`ul-Kebir", 8/10, nr.9722; Bejheki-u, "Shuab`ul-Iman", 2/284, nr.1785; Emri i vërtetë i Ebu Berze el-Eslemiju është Nadletu b. Ubejdi;

[612] Darimij-u, "Sunen", kitab Mukadime, bab el ameli bil ilmi ve husni`n-nijeti fihi, nr.252; Sujut-i, "Xhamiu`s-Sagir", 1/3675, nr.3675 dhe vëndon shenjë për dobësinë e këtij hadithi; Muhasir b. Habibi, është konsideruar i besueshëm nga Ibni Hiban-i, i cili e regjistron në librin e tij "Eth-Thikat", 5/427, 454 dhe 7/525 në gjeneratën e tabiinëve dhe të etbai tabiinëve.

KURANI

HADITHI I PESËDHJETËETETË (58)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللهِ بْنِ نُمَيْرٍ، حَدَّثَنَا أَبِي، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ أَبِي خَالِدٍ، عَنْ عَبْدِ اللهِ بْنِ عِيسَى بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى، عَنْ جَدِّهِ، عَنْ أُبَيِّ بْنِ كَعْبٍ، قَالَ: كُنْتُ فِي الْمَسْجِدِ، فَدَخَلَ رَجُلٌ يُصَلِّي، فَقَرَأَ قِرَاءَةً أَنْكَرْتُهَا عَلَيْهِ، ثُمَّ دَخَلَ آخَرُ فَقَرَأَ قِرَاءَةً سِوَى قِرَاءَةِ صَاحِبِهِ، فَلَمَّا قَضَيْنَا الصَّلَاةَ دَخَلْنَا جَمِيعًا عَلَى رَسُولِ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقُلْتُ: إِنَّ هَذَا قَرَأَ قِرَاءَةً أَنْكَرْتُهَا عَلَيْهِ، وَدَخَلَ آخَرُ فَقَرَأَ سِوَى قِرَاءَةِ صَاحِبِهِ، فَأَمَرَهُمَا رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَرَآ، فَحَسَّنَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ شَأْنَهُمَا، فَسَقَطَ فِي نَفْسِي مِنَ التَّكْذِيبِ، وَلَا إِذْ كُنْتُ فِي الْجَاهِلِيَّةِ، فَلَمَّا رَأَى رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مَا قَدْ غَشِيَنِي، ضَرَبَ فِي صَدْرِي، فَفِضْتُ عَرَقًا وَكَأَنَّمَا أَنْظُرُ إِلَى اللهِ عَزَّ وَجَلَّ فَرَقًا، فَقَالَ لِي: " يَا أُبَيُّ أُرْسِلَ إِلَيَّ أَنِ اقْرَأِ الْقُرْآنَ عَلَى حَرْفٍ، فَرَدَدْتُ إِلَيْهِ أَنْ هَوِّنْ عَلَى أُمَّتِي، فَرَدَّ إِلَيَّ الثَّانِيَةَ اقْرَأْهُ عَلَى حَرْفَيْنِ، فَرَدَدْتُ إِلَيْهِ أَنْ هَوِّنْ عَلَى أُمَّتِي، فَرَدَّ إِلَيَّ الثَّالِثَةَ اقْرَأْهُ عَلَى سَبْعَةِ أَحْرُفٍ، فَلَكَ بِكُلِّ رَدَّةٍ رَدَدْتُكَهَا مَسْأَلَةٌ تَسْأَلُنِيهَا، فَقُلْتُ: اللهُمَّ اغْفِرْ لِأُمَّتِي، اللهُمَّ اغْفِرْ لِأُمَّتِي، وَأَخَّرْتُ الثَّالِثَةَ لِيَوْمٍ يَرْغَبُ إِلَيَّ الْخَلْقُ كُلُّهُمْ، حَتَّى إِبْرَاهِيمُ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ".

Transmeton Ubejje b. Ka`bi (r.a.) i cili thotë: "Isha në xhami dhe erdhi një njeri për t`u falur dhe filloi të lexojë Kuran me një lexim që nuk e pëlqeva. Pastaj erdhi një tjetër dhe ai lexoi me një lexim tjetër nga i mëparshmi. Pasi e përfunduan namazin, hymë bashkë te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i thashë: "Ky lexoi me një lexim të cilin nuk e pëlqeva, pastaj hyri tjetri dhe lexoi me lexim tjetër nga shoku i tij". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i urdhëroi që të lexojnë dhe e miratoi leximin e tyre. Pas kësaj në

shpirtin tim më erdhi një përgënjeshtrim, sikur të isha në kohën e injorancës. Kur Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem më pa se si u ndikova nga ajo, më mëshoi në gjoks, kurse unë u mbulova në djersë dhe u bëra sikur e shikoj Allahun me frikë. Ai më tha: *"O Ubejje, më është shpallur mua që të lexoj Kuranin me një harf, kurse unë e refuzova duke kërkuar që t`i lehtësohet ummetit tim. Më është shpallur herën e dytë që të lexoj me dy harfe, përsëri e kam refuzuar duke kërkuar që t`i lehtësohet ummetit tim. Më është shpallur herën e tretë, që të lexoj në shtatë harfe duke më thënë:* ***"Për çdo refuzim që ke bërë, në çdonjërën ke nga një lutje (të pranuar)".*** *Unë thash: "`O Allahu im, fale ummetin tim`, `O Allahu im, fale ummetin tim`, kurse të tretën (lutje), e kam shtyrë për Ditën kur krijesat do të drejtohen kah unë (për ndërmjetësim) saqë edhe Ibrahimi a.s. (do të drejtohet kah unë)".*[613]

Këtë *hadith* na e sjell *sahabi*-u i cili ka qenë prej lexuesve të dalluar të Kuranit dhe prej atyre që më mirë e ka njohur atë. Ai thotë se ka dëgjuar në xhaminë e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem një person duke u falur, porse leximin e Kuranit nuk e kishte në mënyrën se si e kishte dëgjuar Ubejje r.a. prej të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Më pas edhe një tjetër kishte ardhur dhe kishte lexuar me tjetër mënyrë leximi, që edhe këtë nuk e kishte dëgjuar Ubejje r.a. andaj edhe i ftoi që të shkojnë te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe të konsultohen për këtë mënyrë të leximit, të cilën nuk e kishte dëgjuar më herët.

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i urdhëroi që të lexojnë dhe të dëgjojë se vallë mos ishte ndonjë lexim i gabuar, por kur dëgjoi se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë, e informoi Ubejjin r.a. se nuk ka asgjë për t`u shqetësuar. Por, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është kujdesur që në zemrën dhe mendjen e shokëve të tij, të mos ngel ndonjë dyshim ose ndonjë keqkuptim i vogël, i cili do të shfrytëzohet nga ana e *shejtan*-it për të devijuar besimtarin. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem me mirësi dhe urtësi, i sqaroi për diçka që ai nuk e kishte ditur më herët, se Kurani ka edhe dialekte dhe mënyra tjera të leximit, të cilat nuk e dëmtojnë esencën e kuptimit të Kuranit.

[613] Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab bejanu ennel Kurane ala seb`ati ahrufin ve bejanu ma`nahu, nr.820; etj.

Për Ubejjin ky ishte një lajm i ri, sepse ashtu siç sqaroi edhe vet, në atë çast u ndje sikur të ishte kthyer në kohën e injorancës kur e kundërshtonin dhe luftonin Islamin shkaku i këtyre keqkuptimeve. Por, pas sqarimit të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem iu qetësua zemra e tij. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i sqaroi se Xhibrili a.s. i ka ofruar leximin e Kuranit me një *harf*, por këtë shkaku i vështirësisë, e ka refuzuar Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kurse radhën e dytë, i ka ofruar që të lexojë me dy *harf*-e, por përsëri ka kërkuar që të shtohet, andaj radhën e tretë ia dha mundësinë e leximit me shtatë *harf*-e.

Pas kësaj, Zoti i dha mundësinë që të ketë tre lutje të pranuara, ndërsa Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të gjitha ato, i shfrytëzoi për dobi të umetit të vet, që Zoti t`ua fal gabimet atyre dhe që t`i mundësohet ndërmjetësimi në Ditën e Gjykimit. Kjo pjesë vërtetohet edhe me hadithin e saktë, ku tregon se të gjithë popujt do të kërkojnë ndonjë ndërmjetës për të lutur Allahun xh.sh. që të fillojë gjykimi, kurse të gjithë pejgamberët do të refuzojnë të ndërmjetësojnë, kurse i vetmi që do të merr përsipër këtë, është Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili është i autorizuari i vetëm për këtë qëllim. Në tekst ka një veçim të Ibrahimit a.s. i cili është i dalluar në mesin e të gjithë pejgamberëve, porse Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem është më i dalluar nga ana e Zotit sa edhe vet Ibrahimi a.s. i cili është quajtur *Halilu`r-Rahman* (dost i Zotit).

Sa u përket *harf*-eve që përmenden në këtë *hadith*, ato kanë ngelur enigmë për shumë studiues të Kuranit, edhe pse ato përcillen përmes *hadith*-eve të besueshme. Në lidhje me këtë *hadith*, ka edhe shumë *hadith*-e tjera, që argumentojnë ekzistencën e këtyre shtatë *harfeve.* Prej atyre haditheve, është edhe rasti i Umerit r.a. i cili pati një përvojë të ngjashme sikur të Ubejjit r.a. Këtë *hadith* e transmeton Umer b. Hattabi r.a. i cili ka thënë: "E kam dëgjuar Hisham b. Hakim b. Hizamin duke lexuar suren Furkan me një lexim të ndryshëm nga ai që e lexoja unë, të cilën ma kishte lexuar vetë i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Për pak sa nuk e ndërpreva, por e lashë atë, derisa përfundoi (namazi). Më pas e kapa për rrobe dhe bashkë me të shkova tek i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i thashë: "O i Dërguari i Allahut, këtë person e kam dëgjuar duke lexuar suren Furkan me një lexim të ndryshëm nga ai që ma ke lexuar mua?!" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha atij: *"Lexoje atë"* dhe ai e lexoi me atë lexim që e dëgjova unë në namaz. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Kështu është zbritur".* Pastaj më tha mua: *"Lexoje ti"* dhe unë e lexova ashtu siç e dija. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Kështu është zbritur".* Më pas tha: *"Vërtet, ky Kuran është zbritur në*

shtatë harfe (leksime), prandaj lexojeni atë me atë leksim që ju vjen më lehtë".[614]

Ubejji r.a. e sjell edhe në një transmetim tjetër, ku thotë: "Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem më ka thënë: *"O Ubeje, mua ma ka lexuar Kuranin (Xhibrili a.s.) dhe më është thënë:* **"Me një leksim apo me dy?"** *Meleku që ishte me mua më tha: "Thuaj: "Me dy leksime" dhe unë thash: "Me dy leksime". M`u tha përsëri:* **"Me dy apo me tri leksime?"** *Meleku i cili ishte afër meje më tha: "Thuaj: "Me tre leksime". Kjo gjë vazhdoi kështu, derisa arriti në shtatë leksime dhe pastaj më tha: "Çdonjëri prej këtyre shtatë leksimeve është shërim prej injorancës dhe është i mjaftueshëm për çdo sfidë. Nëse në fund të ajetit thua:* ***"Semian alimen"*** *në vend të* ***"Azizen Hakimen"*** *kjo nuk të prish punë, me kusht që ajetin e ndëshkimit të mos e përfundosh me mëshirë, ndërsa ajetin e mëshirës, të mos e përfundosh me ndëshkim".*[615]

Ngjashëm është edhe transmetimi tjetër prej Ubejjit r.a. se Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem ishte në tokat e benu Giffarit, kur Xhibrili a.s. erdhi dhe i tha: *"Allahu të urdhëron që t`ia lexosh Kuranin ummetit tënd vetëm me një shkronjë (lloj leksimi)".* Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Kërkoj nga Allahu shpëtim dhe falje, sepse umeti im nuk mund ta përballojë atë (do ta ketë shumë të vështirë)".* Xhibrili a.s. erdhi për së dyti, derisa u bënë shtatë leksime dhe pastaj tha: *"Allahu të urdhëron që t`ia lexosh Kuranin umetit tënd në shtatë leksime dhe çdonjërin prej leksimeve që ta përdorin, ata kanë vepruar drejt".*[616]

Zuhriju ka thënë: "Këto leksime urdhërojnë dhe ndalojnë për të njëjtën gjë. Ata ndryshojnë vetëm në shqiptime, por nuk ndryshojnë në lejime e as në ndalime".[617]

Në këtë temë, përcillet një *hadith* edhe nga Abdullah b. Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Është shpallur Kurani në*

---

[614] Buhari-u, "Sahih", kitab Fadailu`l-Kuran, bab unzile`l-Kuran ala seb`ati ahrufin, nr.4992; Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 48, nr.818; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 22, nr.1475; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 37, nr.937-939;

[615] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 22, nr.1477;

[616] Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 48, nr.821; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 22, nr.1478;

[617] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 22, nr.1476; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 37, nr.940;

shtatë harf-e, çdo ajet prej tyre ka anën e jashtme (dhahir) dhe anën e brendshme (batin)".[618]

Po çka në fakt janë këto *harf-e*? Çka në esencë e ndërlikon këtë *hadith*? Në këtë *hadith*, përmendet fjala *harf* që në përkthim do të thotë shkronjë, por edhe fjalë, dialekt, anë, breg, skaj, mënyrë, e shumë kuptime tjera,[619] andaj është e rëndë të përkufizohet se me cilin kuptim vjen. Edhe numri shtatë e vështirëson çështjen, sepse në gjuhën arabe në shumë raste, numri shtatë nuk vjen për të përkufizuar numrin, porse sasinë, pra, tregon një sasi e cila numëron diçka që është shumë, por nuk ka për qëllim numrin shtatë.

Disa kanë thënë se këto shtatë *harfe*, kanë për qëllim shtatë *kiraet*-et e njohura të leximit të Kuranit, por këtë mendim e kanë refuzuar dijetarët. Shumica e dijetarëve thonë se shtatë harfe, nënkuptojnë shtatë dialektet e njohura të fiseve arabe. Sipas tyre, në këtë kategorizim, bëjnë pjesë dialektet e fiseve Kurejsh, Hudhejl, Thekif, Havazin, Kinane, Temim dhe Jemen. Por, edhe në këtë mendim, ka pasur kundërshtime, sepse disa kanë numëruar në Kuran edhe dialekte tjera të cilat nuk bëjnë pjesë në këto shtatë që u përmendën më lart. Po ashtu, kur të kihet parasysh fakti se Umeri r.a. dhe Hishami r.a. të cilët patën divergjencë në leximet e tyre, që të dy ishin Mekas dhe që të dy ishin të fisit Kurejsh, atëherë vijmë në pyetjen logjike, se nëse do të ishte në pyetje dialekti, atëherë përse këta dy u konfrontuan me leximet e tyre?! Pra, ka mundësi që me *harf*-et e përmendura, të mos jenë për qëllim dialektet.

Mund të ketë edhe kuptimin e mënyrave të leximit të Kuranit, ku ndryshon mënyra e vokalizimit, ose ndërrimi i shkronjave, por kuptimi të ngelet i njëjtë.

Ka pasur dijetarë që kanë thënë se qëllimi me këto shtatë *harf*-e, janë shtatë shkenca të cilat i ngërthen Kurani, siç janë shkenca mbi krijimin dhe ekzistencën, mbi teuhidin, mbi *sifat*-et Dhatije e Zotit, mbi *sifat*-et *Fi`lije* të Zotit, mbi sifatet e faljes dhe dënimit, mbi ringjalljen dhe llogarinë dhe mbi pejgamberinë. Por, edhe ky mendim hedhet poshtë nga dijetarët, sepse thonë që në Kuran nuk përmblidhen vetëm këto shkenca, por edhe shumë të tjera, andaj si mendim është i mangët.[620]

---

[618] Tahavi-u, "Sherh Mushkilu`l-Athar", vëll.8, fq.87, nr.3077;
[619] Shih: Isa Memishi, "Fjalor arabisht-shqip", vëll.1, fq.322-324;
[620] Shih për më shumë mendime: Kurtubiu, "El Mufhemu lima eshkele min telhisi kitabi Muslim", Damask, botimi i parë, 1996, vëll.2, fq.447-451;

Imam Tahaviu në sqarim të këtyre shtatë shkronjave, thotë se këto kanë qenë për t`ua lehtësuar mundësinë e mësimit të Kuranit, pasi në fillim ishin të pafuqishëm sepse ishin analfabet, e pasi u shtuan shkruesit dhe gjersa iu mundësua të përputhen me gjuhën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, atëherë filluan ta mësojnë Kuranin me gjuhën e tij, e sa u përket këtyre shtatë shkronjave, këto kanë qenë veçmas për kohën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem shkaku i nevojës për to, por më pas kjo nevojë u zhduk, e u ngrit edhe dispozita për këto shtatë *harf*-e dhe filloi të lexohet Kurani vetëm me një mënyrë.[621]

Imam Sujuti në sqarim të *hadith*-it të Umerit r.a. që e përmendëm më lart, thotë: "Tek unë mbizotëron mendimi se ky *hadith* është *muteshabih* të cilit nuk i dihet interpretimi".[622]

Shkaku i vërtetë për këtë mospërputhje të sqarimit të këtij *hadith*-i dhe vështirësisë së kuptimit të tij, është se nuk ka ndonjë tekst nga Kurani ose *hadith*-i, që e sqarojnë në mënyrë të thuktë.

Uthmani r.a. e tuboi Kuranin dhe i unifikoi myslimanët në një lexim, që të mos ndodhin përrçarje dhe mosmarrëveshje në mesin e myslimanëve. Ai kodifikoi Kuranin me pëlqimin e të gjithë *sahab*-ëve duke shmangur çdo keqkuptim që mund të lind si pasojë e leximeve të ndryshme, andaj edhe shtatë *harfet* më nuk ishin të nevojshme. Të gjithë librat të cilët kishin kundërshtim me librin bazë të cilën e kodifikoi Uthmani r.a. u dogjën dhe u zhdukën dhe mbeti vetëm moduli i cili sot lexohet me *kiraet*-et të cilat janë të transmetuara në mënyrë të plotbesueshme.

[621] Tahavi-u, "Sherh Mushkilu`l-Athar", vëll.8, fq.125;
[622] Sujut-i, "Sunen Nesai bi sherh hafidh Xhelaludin es-Sujuti", Darul Ma`rife, Bejrut, vëll.1, fq.489;

HADITHI I PESËDHJETËENËNTË (59)

حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ قَالَ: حَدَّثَنَا ابْنُ فَضَالَةَ، عَنْ عَاصِمٍ، عَنْ زِرٍّ، قَالَ: قَالَ لِي أُبَيُّ بْنُ كَعْبٍ: «يَا زِرُّ» كَأَيِّنْ تَقْرَأُ سُورَةَ الْأَحْزَابِ؟ قَالَ: قُلْتُ: كَذَا وَكَذَا آيَةً قَالَ: " إِنْ كَانَتْ لَتُضَاهِي سُورَةَ الْبَقَرَةِ، وَإِنْ كُنَّا لَنَقْرَأُ فِيهَا: وَالشَّيْخُ وَالشَّيْخَةُ إِذَا زَنَيَا فَارْجُمُوهُمَا أَلْبَتَّةَ نَكَالًا مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ، فَرُفِعَ فِيمَا رُفِعَ "

Transmeton Zirr-i i cili thotë: "Më tha mua Ubejje b. Ka`bi (r.a.): "O Zirr, sa (*ajet*-e) lexoni ju suren Ahzab?". Thashë: "Kaq dhe kaq ajete". Ai tha: "Ajo ishte e barabartë me suren Bekare, e në të lexonim: ***"I moshuari (i martuari) dhe e moshuara (e martuara) nëse kryejnë amoralitet, gurëzoni ata, si dënim nga Allahu dhe i Dërguari i Tij".*** Dhe u abrogua prej saj ajo që u abrogu".[623]

Në këtë transmetim, përcillet biseda e një prej shokëve të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili ishte i njohur për leximin dhe njohuritë e Kuranit, me njërin prej *tabi`inëve*, të cilin e pyeti se sa ajete numërojnë ata në suren Ahzab? Zirri iu përgjigj se numërojnë aq sa edhe sot figurojnë në këtë sure, pra 73 *ajet*-e. Kjo nuk përmendet në këtë transmetim, por është në disa koleksione tjera. Ubeji r.a. i tregoi se kjo *sure* në kohën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka numëruar më shumë *ajet*-e, saqë ka qenë e barabartë me suren Bekare (286 *ajet*-e), porse një numër i madh i ajeteve që kanë qenë në këtë sure janë deroguar (*nes`h)* e prej atyre teksteve që ka mbajtur mend Ubeji, ka qenë edhe teksti për dënimin e të martuarve nëse kryejnë amoralitet.

[623] Sulejman b. Davud et-Tajalis-i, "Musned", vëll.1, fq.436-437, nr.542; Abdurezak-u, "Musannef", vëll.7, fq.329-330, nr.13.363; Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.4, fq.332, nr.4352; Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.2, fq.450, nr.3554 dhe thotë se "hadithi ka zinxhirin Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar" kështu thotë edhe Dhehebiu; etj. Muhamed b. Abdulmuhsin et-Turki në verifikim të këtij hadithi në veprën e Tajalisit, thotë se hadithi është me zinxhir Hasen, shkaku i gjendjes së Asimit;

Këtu shohim se gjatë jetës së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka pasur tekste të Kuranit të cilat kanë zbritur vetëm për një periudhë të cakuar dhe të cilat më pas janë ngritur, e të tillat Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk ka lejuar të shkruhen dhe të regjistrohen në *Mus`haf*.

Argument se në Kuran ekzistojnë *ajet*-e që janë deroguar nga ana e Zotit, është *ajet*-i: **"Ne nuk abrogojmë asnjë nga ajetet tona ose ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send?!".**[624]

E kemi edhe Fjalën tjetër të Allahut xh.sh. ku thotë: **"Kur Ne e zëvendësojmë një ajet me një tjetër, kurse Allahu e di më së miri se çka shpallë, ata thonë: ""Ti vetëm trillon". E nuk është ashtu, por shumica sish nuk dinë".**[625]

Se ka *ajet*-e që Zoti i ka deroguar, dëshmon edhe *ajet*-i: **"Ne do të lexojmë ty e nuk do të harrosh. Përveç asaj që Allahu dëshiron. Ai e di të haptën e të fshehtën".**[626]

Po ashtu, ndryshimin ose abrogimin e *ajet*-it, e ka bërë Zoti e jo Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem prej dëshirës së vet, pasi nuk i takon atij që të ndërhyjë në Librin e Zotit. Thotë Allahu xh.sh. në Kuran: **"Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, ata që nuk besojnë në takimin me Ne thonë: "Sillna një Kuran tjetër, ose ndryshoje këtë!". Thuaj: "Mua nuk më takon që ta ndryshojë vetë, unë përcjelli vetëm atë që më shpallet, unë nëse kundërshtoj Zotin tim, i frikësohem dënimit në një Ditë të Madhe".**[627]

Të gjithë dijetarët të cilët kanë shkruar mbi shkencat e Kuranit, kanë përmbledhur në veprat e tyre edhe sqarimin e *Nasih* dhe *Mensuh* (ajetet që derogojnë të tjerët dhe ajetet e deroguara). Arsyeja se përse disa *ajet*-e janë shpallur e pastaj janë tërhequr përsëri, është në faktin se Zoti ka dëshiruar në mënyrë graduale ta shpallë ligjin e Tij dhe të mos ua vështirësojë njerëzve.

Po ashtu, në disa raste teksti i shpallur është deroguar, por vendimi ka ngelur në fuqi, i këtij lloji është ajeti i dënimit të zinaqarëve të martuar, që e

[624] Kurani, Bekare, 106;
[625] Kurani, Nahël, 101;
[626] Kurani, A`la, 6-7;
[627] Kurani, Junus, 15;

kemi në *hadith*-in që po e trajtojmë. Ky *ajet* si tekst nuk ekziston më në Kuran, por vendimi dhe ligji i tij janë në fuqi dhe aplikohen.

Në disa raste, ngel teksti, por norma dhe ligji i atij *ajet*-i, nuk janë në fuqi. Shembull *ajet*-i ku Zoti thotë: **"Ata që vdesin nga mesi i juaj dhe lënë pas vete gra, le të testamentojnë (lënë porosi) për gratë e tyre, furnizimin për një vit, duke mos i nxjerrë prej shtëpisë. E nëse (me dëshirën e vet) dalin, nuk është mëkat për ju për atë punë të lejueshme që bëjnë ato me vetveten. All-llahu është më i fuqishmi, më i dituri".[628]** Ky *ajet* është deroguar me *ajet*-in tjetër ku Zoti thotë: **"E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë. E kur ta kryejnë ato afatin e tyre, nuk është mëkat për ju (familja kujdestare) për atë që bëjnë ato në mënyrë të njerëzishme më veten e tyre. All-llahu hollësisht e di çka veproni".[629]**

Imam Buhariu shënon edhe një *ajet* i cili është shpallur në lidhje me 70 *hafiz*-at e vrarë në Bi`ri maune, por që më pas është deroguar, ku në të thuhej: ***"Ne e takuam Zotin tonë, i Cili është i kënaqur me ne dhe ne jemi të kënaqur me Atë".[630]***

Sa i përket tekstit të këtij *hadithi kudsij* ku potencohet dënimi me *Hadd* (me gurëzim) i të martuarve që kryejnë amoralitet, e konfirmojnë edhe *sahabi*-të tjerë. Prej tyre është edhe Zejd b. Thabiti r.a. i cili thotë se kur kanë qenë duke shkruar *Mus`haf*-in, kur ka arritur te ky *ajet*, Zejdi r.a. ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: ***"I moshuari (i martuari) dhe e moshuara (e martuara) nëse kryejnë amoralitet, gurëzoni ata, si dënim nga Allahu dhe i Dërguari i Tij".[631]***

Në përforcim të këtij vendimi sheriatik, nuk është vetëm ky *hadith kudsi*, por edhe shumë *hadith*-e tjera e përforcojnë vendimin për këtë dënim.

Juristët muslimanë janë të pajtimit se personi i martuar që kryen mëkatin e imoralitetit duhet të ndëshkohet me vdekje duke e gjuajtur me gurë. Ky gjykim vlen si për burrin ashtu edhe për gruan. Ky është qëndrimi edhe i

---

[628] Kurani, Bekare, 240;
[629] Kurani, Bekare, 234;
[630] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Megazi, bab gazvetu rexhi`i ve ri`lin ve dhekvanin ve bi`ri maune, nr.4090; etj.
[631] Tajalis-i, "Musned", vëll.1, fq.503, nr.615; etj. Muhamed b. Abdulmuhsin et-Turki në verifikim të këtij hadithi në këtë vepër, thotë se hadithi është Sahih.

dijetarëve hanefi.[632] Ata këtë qëndrim e kanë ndërtuar në bazë të disa argumenteve që burojnë nga *hadith*-et e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Prej tyre është *hadith*-i ku tregon Ebu Seidi r.a. se një burrë musliman i quajtur Maiz b. Malik erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe tha: "Unë kam kryer veprim të ligë, andaj zbatoje ndaj meje dënimin". Ai e largoi një herë, e pastaj i pyeti njerëzit e tij, e ata thanë se nuk dinë diçka keq, por ai ka kryer një veprim, i cili nuk pastrohet përpos se me *hadd.* Më pas ndaj tij u zbatua dënimi me gurëzim.[633]

Imam Muslimi dhe të tjerë, kanë shënuar edhe pjesën tjetër të ngjarjes së dënimit të Maizit. Përcjell Burejde r.a. se pasi ishte dënuar Maizi dhe njerëzit kërkuan falje për të, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke kuvenduar me shokët e tij, erdhi një grua prej Gamidive të Ezdit, e cila tha: "O i Dërguari i Allahut, më pastro (nga mëkati)". Ai i tha: *"Mjer për ty, shko dhe kërko falje dhe pendohu tek Ai".* Ajo tha: "Dëshiroj që të më pastrosh siç e pastrove Maiz b. Malikun". Hadithi është i gjatë, por Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka kthyer derisa ka lindur fëmijën dhe është plotësuar periudha e gjidhënies, e kur fëmiju është bërë i aftë për të ngrënë ushqime, atëherë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka dënuar me gurëzim edhe këtë grua".[634]

Ebu Davudi dhe të tjerë e sjellin një *hadith* përmes *sahab*-iut Imran b. Husajnit r.a për dënimin e një gruaje nga Xhuhejna.[635]

Imam Ahmedi e sjell një *hadith* ku tregohet se në kohën e Aliut r.a. e kanë sjellur tek ai një grua e cila kishte kryer *zina* dhe ai e dënoi me njëqind kamxhik ditën e enjte, kurse ditën e premte e gurëzoi deri në vdekje, e më pas tha: "*Rexhmi* (gurëzimi) është një sunet që na e bëri traditë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem...".[636]

---

[632] Shih: Muhamed b. Hasen esh-Shejbani, "El-Aslu", Daru Ibni Hazëm, Katar, botimi i parë, 2012, vëll.7, fq.180;

[633] Hadithin e plotë mund ta lexoni te Muslim-i, "Sahih", kitab el-Hududu, bab meni`terefe ala nefsihii bi`z-zina, nr.1694; këtë hadith e përcjell prej Ebu Hurejres r.a. edhe Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ahkami, bab men hakeme fi`l-mesxhidi, nr.7167; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Hududi, bab rexhmu Maizi b. Malikin, nr.4428; etj.

[634] Shih për këtë ngjarje te Muslim-i, "Sahih", kitab el-Hududu, bab meni`terefe ala nefsihii bi`z-zina, nr.1695; etj.

[635] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Hududi, bab el-mer`etu leti emere`n-nebiju bi rexhmiha, nr.4440; shih edhe: Muslim-i, "Sahih", kitab el-Hududu, bab meni`terefe ala nefsihii bi`z-zina, nr.1696; etj.

[636] Ahmed-i, "Musned", 2/278, nr.978; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi, thotë se është Sahih, transmetuesit janë të besueshëm, janë transmetues prej të cilëve kanë

Edhe pse gjenden këto *hadith*-e që e dëshmojnë dënimin me vdekje për personin që kryen amoralitet, ka të tillë që e mohojnë urdhin e tillë, duke mohuar *hadith*-et që përmendëm më lart. Këtë frikë e kishte edhe Umeri r.a. Ai një ditë duke qenë në xhami në *minber*-in e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: "Me të vërtetë Allahu e dërgoi Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem me të vërtetën dhe ia shpalli atij Librin, e prej asaj që u shpall, ishte edhe ajeti i *Rexhm*-it, të cilin e lexonim, e praktikoi atë i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe e praktikuam edhe ne pas tij, por kam frikë se do të vijë një kohë kur mes njerëzve dikush do të thotë se nuk e gjejmë *rexhm*-in në Librin e Allahut, e do të devijojnë duke e braktisur *farz*-in që e ka shpallur Allahu xh.sh.. *Rexhmi* është obligim në Librin e Zotit ndaj çdokujt i cili kryen *zina*, qoftë ai mashkull ose femër, nëse ajo dëshmohet...".[637]

Pra, këtë vendim fetar e miratojnë dispozitat e *sheriat*-it dhe e kanë aplikuar gjykatat nëpër shtetet Islame gjatë historisë, kështu që ky vendim nuk mund të anulohet shkaku se dikush nuk dëshiron t`i pranojë *hadith*-et si burim i sheriatit.

Sa i përket *hadith*-it që e shënon imam Ahmedi se Aishja r.a.h. ka thënë: "Ishte shpallur *ajet*-i i *Rexhmit* dhe mëkimi me gji i foshnjes dhjetë herë, ajo ka qenë e shkruar në një gjeth nën dyshek në dhomën time, e pasi shkoi (vdiq) Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ne ishim habitur (me përgatitjen e varrimit të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem) dhe e kishim harruar këtë (fletë), e hyri një dhi te ne dhe e kishte ngrënë (fletën)".[638]

---

përcjellë Buhariu dhe Muslimi, përpos Muxhalidit, i cili i plotëson kushtet e Muslimit, por Hafidhi për të ka thënë se nuk është i fortë".

[637] Buhari-u, "Sahih", kitab Muharibin min ehlil kufri ve`r-rideti, bab el-i`tirafi bi`z-zina, nr.6829; Muslim-i, "Sahih", kitab Hudud, bab rexhmu`th-thejibi fi`z-zina, nr.1691; etj.

[638] Ahmed-i, "Musned", 43/342, nr.26.316; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab en-Nikahi, bab ridau`l-kebir, nr.1944; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në Musnedin e Ahmedit, thotë se është me zinxhir të dobët, pasi me këtë veçohet Ibni Is`haku si dhe në tekst ka diçka që refuzohet, kurse transmetuesit tjerë janë të besueshëm, transmetues të Buhariut dhe Muslimit. Edhe në verifikimin e Sunen-it të Ibni Maxhes, thotë se ky hadith nuk është Sahih (shih: vëll.3, fq.125, nr.1944). Në zinxhir gjendet Abdula`la, i cili është etiketuar si kaderi, ndërsa Ibni Sa`di ka thënë se nuk është i fuqishëm (shih: Ibni Haxheri, "Tehdhibu`t-Tehdhib", 2/465) edhe për transmetuesin tjetër Muhamed b. Is`hak ka mendime të ndryshme, ku disa e kanë vlerësuar pozitivisht e disa e kanë konsideruar të dobët (shih: Mizziu, "Tehdhibu`l-Kemal", vëll.24, fq.405-429, nr.5057);

Ky *hadith* sipas dijetarëve është i dobët si dhe është i çuditshëm, pasi tregon një shkujdesje të tepërt ndaj Kuranit, saqë një dhi të han kopjen e saj dhe të mos e dijë askush më pas, me çka fut dyshim në Librin e Zotit, kështu që ky tekst, si në zinxhir si në tekst është i dobët dhe i refuzuar.

Ky *hadith* bie në kundërshtim edhe me *ajet*-in kuranor ku Zoti garanton se do ta mbrojë Kuranin ku thotë: **"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne gjithsesi jemi Mbrojtës të tij".**[639]

[639] Kurani, Hixhër, 9;

HADITHI I GJASHTËDHJETË (60)

حَدَّثَنَا مَحْمُودُ بْنُ غَيْلَانَ قَالَ: حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الحَفَرِيُّ، وَأَبُو نُعَيْمٍ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ أَبِي النَّجُودِ، عَنْ زِرٍّ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " يُقَالُ – يَعْنِي لِصَاحِبِ الْقُرْآنِ –: اقْرَأْ وَارْتَقِ وَرَتِّلْ كَمَا كُنْتَ تُرَتِّلُ فِي الدُّنْيَا، فَإِنَّ مَنْزِلَتَكَ عِنْدَ آخِرِ آيَةٍ تَقْرَأُ بِهَا "

Transmeton Abdullah b. Amër (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sellem ka thënë: *"I thuhet lexuesit të Kuranit:* ***"Lexo dhe ngritu, recito ashtu siç recitoje në dunja, sepse me të vërtetë, vendi yt në botën tjetër do të jetë në ajetin e fundit që do ta lexosh".***[640]

Kjo i thuhet kur të hyjë në Xhenet.[641] Besimtari i cili ka lexuar Kuranin dhe ka vepruar sipas tij, kur do të hyjë në Xhenet, Zoti do t`i drejtohet atij me këto fjalë. Kjo nuk do të jetë fat për atë i cili e ka lexuar Kuranin por nuk ka punuar me të.[642] Njeriu i tillë, do të lexojë Kuranin dhe atë që di prej saj, derisa të ndalojë në ajetin e fundit që ka ditur, e aq sa do të dijë prej Kuranit, aq shkallë do të ngritet në Xhenet. Pra, me çdo *ajet* të cilin e lexon, do të ngritet nga një shkallë në Xhenet.

Nga *hadith*-i po ashtu shohim vlerën e leximit të Kuranit me *tertil*, ku lexuesi mundohet sa më tepër që të shqiptojë dhe të nxjerrë shkronjat ashtu siç janë, duke mos i ikur ndonjë shkronjë ose rregull i leximit. Zoti thotë në Kuran: **"Ti (Muhammed) mos shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe**

---

[640] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Kurani, bab 18, nr.2923 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab istihbabu`t-tertili fi`l-kiraeti, nr.1464; Ahmed-i, "Musned", vëll.6, fq.313-314, nr.6799 me verifikim të Ahmed Shakir-it, i cili thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Sahih. Në verifikimin e Musned-it të Ahmedit nga shejh Shuajb Arnauti (vëll.11, fq.403-404, nr.6799) thotë se hadithi është Sahih li gajrihi, kurse zinxhiri i këtij hadithi është Hasen shkaku i Asimit, kurse të tjerët janë të besueshëm prej të cilëve përcjellin edhe Buhariu dhe Muslimi.

[641] Adhim Abadi, "Aunu`l-Ma`bud ala sherhi Suneni Ebu Davud", daru Ibni Hazëm, Bejrut, botimi i parë, 2005, fq.709;

[642] Po aty;

leximin e tij! E kur ta lexojnë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij. Dhe pastaj është obligim i yni që ta shkoqisim atë". [643]

Kur jemi te leximi i Kuranit me *tertil*, duhet të potencojmë edhe *ajet*-et tjera, ku Zoti thotë: **"E ata që nuk besuan thanë: "Përse të mos i ketë zbritur atij Kurani përnjëherë?" (E zbritëm pjesë-pjesë) ashtu që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajeti (Tertil)".[644]** Po ashtu thotë: **"Ose shto diç prej saj dhe Kuranin lexoje me vëmendje (tertil)".[645]**

Gjithashtu shohim se njeriut në botën tjetër, do t`i ndihmojë vepra e tij të cilën e ka kryer me përpikëri në këtë botë.

Dijetarët në bazë të këtij *hadith*-i, janë unanim se shkallët e Xhenetit janë në përputhje me numrin e ajeteve të Kuranit, kurse numri i tyre është 6000 e diçka.[646]

Disa dijetarë kanë thënë se të veprosh me Kuranin, është sikur ta lexosh atë gjatë tërë kohës, edhe pse nuk je duke lexuar. Kurse ai i cili nuk punon sipas tij, nuk konsiderohet se është lexues i Kuranit, edhe nëse e lexon atë vazhdimisht.[647]

Pra, lidhshmëria e jonë me Kuranin duhet të jetë e vazhdueshme, të jemi të lidhur me zemër e me vepra me këtë libër të shenjtë, të përpiqemi të jetojmë sipas urdhrave të tij dhe të largohemi nga veprimet që na urdhëron të largohemi, do të jetojmë të lumtur dhe do të ngritim nivelin tonë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Në drejtim të kësaj teme, e kemi edhe një *hadith kudsij* që e transmeton Fadale b. Ubejdi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush lexon dhjetë ajete në mbrëmje, do të regjistrohet prej namazlive, e nuk do të shënohet prej neglizhentëve, e kush lexon pesëdhjetë ajete, do të regjistrohet në nivelin e hafizëve dhe kjo do të vazhdojë deri në mëngjes. Kush i lexon treqind ajete, do të thotë i Plotëfuqishmi:* ***"U lodh robi Im për Mua".*** *Kush i lexon njëmijë ajete, do t`i shkruhet atij një "kintar"[648], e një*

[643] Kurani, Kijame, 16-19;
[644] Kurani, Furkan, 32;
[645] Kurani, Muzemil, 4;
[646] Adhim Abadi, "Aunu`l-Ma`bud ala sherhi Suneni Ebu Davud", fq.709;
[647] Po aty;
[648] *Masë për matje të peshave;*

kintar është më e dobishme se e gjithë bota dhe çka ka në të. E kur të ndodh Dita e Kijametit, Zoti do të thotë: ***"Lexo dhe ngrihu për çdo ajet një shkallë, derisa të ndalesh në ajetin e fundit që e din".***[649]

[649] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 3/495, nr.2006-2007; verifikuesi i kësaj vepre Abdulali Abdulhumejd el-Hamid, për këtë hadith thotë se zinxhirin e ka të mirë (xhejid), por nuk është i mirë kur përcillet i lidhur te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem (merfu).

HADITHI I GJASHTËDHJETËENJËTË (61)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ قَالَ: حَدَّثَنَا شِهَابُ بْنُ عَبَّادٍ العَبْدِيُّ قَالَ: حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الحَسَنِ بْنِ أَبِي يَزِيدَ الهَمْدَانِيُّ، عَنْ عَمْرِو بْنِ قَيْسٍ، عَنْ عَطِيَّةَ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " يَقُولُ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ: مَنْ شَغَلَهُ الْقُرْآنُ عَنْ ذِكْرِي وَمَسْأَلَتِي أَعْطَيْتُهُ أَفْضَلَ مَا أُعْطِي السَّائِلِينَ، وَفَضْلُ كَلَامِ اللَّهِ عَلَى سَائِرِ الكَلَامِ كَفَضْلِ اللَّهِ عَلَى خَلْقِهِ "

Transmeton Ebu Seidi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Zoti i Lartësuar: "**Kush preokupohet me leximin e Kuranit për të më përkujtuar dhe lutur Mua, do t`i jap më mirë sesa atë që më ka kërkuar, kurse Fjala e Allahut në krahasim me fjalët tjera, është sikur përparësia e Allahut ndaj krijesave".***[650]

Preokupimi me leximin e Kuranit është prej angazhimeve më të vlefshme në të cilat besimtari mund të kalojë kohën e tij, sepse asnjë fjalë nuk mund të krahasohet me Fjalën e Zotit. Njeriu nuk duhet ta çojë kohën e tij kotë, por le të angazhohet dhe preokupohet me gjëra të cilat do t`i bëjnë dobi në botën tjetër.

Leximi i Kuranit është prej *dhikr*-eve më të lavdëruara dhe të preferuara, sepse me lexim të Kuranit adhurojmë Zotin dhe arrijmë shpërblime të shumta. Pasi përcjell Abdullah b. Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush lexon një shkronjë nga Kurani, ai ka një të*

[650] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kurani, bab 25, nr.2935 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; Edhe Darimij-u e shënon në "Sunen", kitab Fadailu`l-Kuran, bab fadli kelamil`-lahi ala sairi`l-kelami, nr.3356, por Darimiju nuk e shënon si hadith kudsij; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", 5/106; e regjistron edhe Bejheki-u në "Shuabu`l-Iman", 2/93, nr.567 nga Umer b. Hatabi r.a. por pa pjesën e fundit dhe thotë se e regjistron edhe Buhari-u në "Tarih". (shih: Buhariu, "Tarih`ul-Kebir", tahkik Hashim Nedevi, Daru`l-Kutubi`l-ilmijje, Bejrut, 2/115, nr.1879); Sujuti në "Kutul Mugtedhi ala xhami`it-Tirmidhi", tahkik Nasir b. Muhamed el-Garibi, xhamiatu Ummul Kura, Meke, 2004; fq.741 përcjell fjalën e Ibni Haxherit i cili për këtë hadith thotë se është Hasen.

mirë, e çdo e mirë shpërblehet me 10 të tilla, nuk them "elif-lam-mim" një shkronjë, por elif-i shkronjë, lam-i shkronjë, mim-i shkronjë".[651]

Leximi i Kuranit është edhe një mënyrë për të fituar ndërmjetësimin në botën tjetër dhe të arrijë Xhenetin, e gjithë kjo me kusht që njeriu të jetojë me këtë Libër madhështorë. Transmeton Ali b. Ebu Talibi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon Kuranin dhe punon sipas tij, e lejon atë që Zoti e ka bërë hallall dhe e ndalon atë që Zoti e ka bërë haram, Zoti për shkak të kësaj do ta fus në Xhenet dhe do t`i mundësoj të ndërmjetësojë për 10 antarë të familjes së tij të cilëve u është caktuar Zjarri".*[652]

Përpos mirësisë së shpërblimeve të shumta, me leximin e Kuranit kemi edhe mundësinë që ta lusim Allahun xh.sh. sepse leximi i tij njëkohësisht është edhe lutje, sidomos në ajetet në të cilat ka *dua.* Nëse besimtari e lut Allahun xh.sh. dhe nuk i lutet dikuj tjetër, kërkon prej Zotit për nevojën e tij dhe atë që synon, Allahu xh.sh. për hir të leximit të Kuranit do t`ia plotësojë lutjen dhe do t`i jep edhe më shumë sesa që ka kërkuar në lutjen e tij.

Në pjesën e fundit, potencohet se Fjala e Allahut xh.sh. është më e Larta dhe nuk mund të krahasohet asnjë fjalë tjetër me fjalën e Tij. Siç thuhet në Kuran: **"...kurse Fjala e Allahut është më e larta...".**[653]

Ebu Bekër el-Arabiu në sqarim të kësaj pjese të *hadith*-it, thotë: "Allahu nuk u ngjan krijesave, kështu është edhe Fjala e Tij, ajo nuk u ngjanë fjalëve të tyre (krijesave), sepse Atij nuk i ngjanë asgjë, e asgjë nuk mund t`u ngjajë cilësive të Tij e as që mund të përngjasohet me krijesat e Tij...".[654]

Me këtë aludohet se asgjë nuk mund të krahasohet me Kuranin dhe sa është përparësia e Zotit ndaj krijesave, aq është edhe përparësia e Kuranit ndaj fjalëve tjera, sepse Kurani është Fjalë e Zotit, e fjala e njerëzve nuk mund të matet me Fjalën e Zotit.

---

[651] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kurani, bab 16, nr.2919 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahihun-Garib;

[652] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kurani, bab ma xhae fi fadli kari`il-Kuran, nr.2914 dhe thotë se është Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Mukadime, bab fadlu teal-lemel Kurane ve alemehu, nr.216;

[653] Teube, 40;

[654] Ebu Bekër el-Arabi-u, "Aridetu`l-Ahvedhij bi sherhi Sahih et-Tirmidhi", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 1997, vëll.11, fq.35-36;

HADITHI I GJASHTËDHJETËEDYTË (62)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ مَرْزُوقٍ البَصْرِيُّ قَالَ: حَدَّثَنَا حَاتِمُ بْنُ مَيْمُونٍ أَبُو سَهْلٍ، عَنْ ثَابِتٍ البُنَانِيِّ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «مَنْ قَرَأَ كُلَّ يَوْمٍ مِائَتَيْ مَرَّةٍ قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ مُحِيَ عَنْهُ ذُنُوبُ خَمْسِينَ سَنَةً إِلَّا أَنْ يَكُونَ عَلَيْهِ دَيْنٌ» وَبِهَذَا الإِسْنَادِ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " مَنْ أَرَادَ أَنْ يَنَامَ عَلَى فِرَاشِهِ فَنَامَ عَلَى يَمِينِهِ ثُمَّ قَرَأَ قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ مِائَةَ مَرَّةٍ فَإِذَا كَانَ يَوْمُ القِيَامَةِ يَقُولُ لَهُ الرَّبُّ: يَا عَبْدِيَ ادْخُلْ عَلَى يَمِينِكَ الجَنَّةَ "

Transmeton Enes b. Maliku (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon çdo ditë dyqind (200) herë* **"Kul hu vallahu Ehad"**[655] *do t`i fshihen atij mëkatet e pesëdhjetë (50) viteve, përpos nëse ka ndonjë borxh".* Me po këtë zinxhir, përcillet nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem se ka thënë: *"Kush donë të flejë në shtratin e tij dhe shtrihet në krahun e djathtë pastaj e lexon* **"Kul hu vallahu Ehad"** *njëqind (100) herë, kur do të bëhet Kijameti, do t`i thotë Zoti atij:* ***"O robi Im, hyn në anën e djathtë të Xhenetit".***[656]

Sure-ja Ihlas është e 112-ta sipas radhitjes në Mus`haf. Është prej *sure*-ve që është shpallur në Meke sipas mendimit të disa prej *sahab*-ëve dhe flet për Qenien e Zotit dhe Cilësitë e Tij. Po ashtu ngërthen në vete edhe dy Emra të Zotit që nuk përmenden diku tjetër në Kuran.

---

655 Kurani, Ihlas, 1;

656 Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Kurani, bab ma xhae fi sureti`l-Ihlas, nr.2907 dhe thotë se hadithi është Garib përmes Thabitit prej Enesit, kurse hadith-i ka edhe tjetër rrugë përmes Thabitit; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 4/150, nr.2317; verifikuesi i kësaj vepre Abdulali Abdulhumejd el Hamid thotë se hadithi është i dobët; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në Sunen-in e Tirmidhi-ut (5/166, nr.3121) thotë se hadithi është me zinxhir të dobët, dhe thotë se e regjistron edhe Ibni Adij në "Kamil", 2/845; edhe Mubarekfuri në "Tuhfetu`l-Ahfedhij sherh Xhami`it-Tirmidhi", Bejtu`l-Ifkar, Aman, fq.2150, nr.2898 thotë se hadithi është i dobët;

Për arsyen e shpalljes së kësaj *sure*, tregohet në një *hadith* të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur një grup idhujtarësh kanë ardhur dhe kanë kërkuar prej tij që të përshkruajë Zotin e vet. Transmeton Ubeje b. Ka`bi r.a. se idhujtarët i janë drejtuar Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i kanë thënë: "O Muhamed, na trego gjenezën e Zotit tënd?" Për këtë Allahu xh.sh. e shpalli *sure*-n Ihlas".[657]

Sipas *hadith*-it që e kemi në trajtim, shohim se me të njëjtin zinxhir, përcillen dy tekste të *hadith*-it, ku çdo njëra flet për vlerën e madhe të kësaj *sure*-je. Teksti i parë kërkon prej besimtarit që sipas mundësisë brenda ditës ta lexojë dyqind herë *sure*-n Ihlas, me çka ai fiton faljen e mëkateve të pesëdhjetë viteve të kaluara, që është gati një jetë e plotë e njeriut. Këtu bën përjashtim personi i cili ka borxh ndaj dikujt, ai nuk mund ta gëzojë këtë mirësi, derisa ta kthejë borxhin.

Kurse në tekstin e dytë me po të njëjtin zinxhir transmetuesish, na vjen *hadith*-i me tekstin se kjo sure po ashtu është prej veprave të cilat besimtarit ia mundësojnë shijimin e kënaqësive të veçanta në Xhenet. Sipas hadithit, kështillohet që kur të shkojmë të flejmë në shtratin tonë, kur të shtrihemi në krahun e djathtë, të lexojmë suren Ihlas njëqind herë për atë që ka mundësi dhe që dëshiron të përfundojë ditën me përkujtim të Zotit, ky person do të ketë mirësinë e madhe, që kur të ndodh fundi i botës dhe njerëzit të ndahen për në Xhenet dhe Xhehenem, këtij Zoti t`i thotë në mënyrë të veçantë: ***"O robi Im, hyn në anën e djathtë të Xhenetit".*** Pra, do të hyjë në një pjesë të veçantë të Xhenetit, që nuk është i paraparë për çdokënd prej myslimanëve.

Për vlerën e madhe të kësaj sureje, flasin edhe një mori *hadith*-esh, të cilat tregojnë për llojllojshmërinë e vlerave të shumta që përfiton besimtari nëse e lexon këtë *sure*.

Se besimtari mysliman ka mundësi që përmes kësaj sureje të fitojë Xhenetin, dëshmojnë edhe disa *hadith*-e tjera, në të cilat e kuptojmë këtë përgëzim të madh të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Transmeton Ebu Hurejre r.a. i cili thotë: "Ishim duke ecur me Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe dëgjuam dikë duke lexuar suren **"Kul huvallahu ehad"** deri në fund të sures dhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem me

[657] Ahmed-i, "Musned", 35/143, nr.21.219; Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi, thotë se është i dobët, shkaku i dobësisë së Ebu Sa`d Muhamed b. Mejsere dhe Ebu Xha`fer er-Razit i cili quhet Isa b. Mahan;

këtë rast tha: *"U bë obligim"*. I thashë: "Çka o i Dërguari i Allahut?" Ai tha: *"Xheneti"*.[658]

Po ashtu e kemi dëshmi *hadith*-in që e transmeton Xhabiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon "**Kulhuvallahu ehad**" për çdo ditë pesëdhjetë herë, Ditën e Kijametit do të thirret prej varrit të tij: "Çohu dhe hy në Xhenet"*.[659]

Nga Muadh b. Enes el-Xhuheniju r.a. dhe Sejjid b. Musejjebi se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë*: "Kush e lexon **Kul Huvallahu Ehad** dhjetë herë, do t`ia ndërtojë Allahu atij një shtëpi në Xhenet. Kush e lexon atë 20 herë, do t`i ndërtojë atij dy pallate në Xhenet, e kush e lexon 30 herë, do t`i ndërtojë atij 3 pallate në Xhenet"*.[660]

Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush i fal dy rekate dhe në to lexon **Kul huvallahu ehad** tridhjetë herë, Allahu do t`ia ndërtojë atij njëmijë (1000) pallate të arit në Xhenet, e kush e lexon atë jashtë namazit, Zoti do t`ia ndërtojë atij njëqind (100) pallate prej arit në Xhenet, e kush e lexon kur të hyjë te familja e tij, do të përfitojnë të mira familja dhe fqinjët e tij prej atij leximi"*.[661]

Transmeton Ebu Umame r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon ajetin Kursij dhe kul huvallahu ehad në fund të çdo namazi, nuk e pengon nga hyrja në Xhenet diçka tjetër përpos vdekjes"*.[662]

---

[658] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kurani, bab ma xhae fi sureti`l-Ihlas, nr.2906 dhe thotë se është hadith Hasenu-Sahih-Garib; Ahmed-i, "Musned", vëll.36, fq.620-621, nr.22.289; Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se është Sahih li gajrihi, kurse zinxhiri i këtij hadithi është i dobët;

[659] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.9, fq.171, nr.9446;

[660] Ahmed-i, "Musned", 24/376, nr.15.610 përmes Muadh b. Enesit r.a.; Darimij-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kuran, bab fi fadli kulhuvallahu ehad, nr.3472 por si hadith Mursel nga Seid b. Musejjebi; Taberani, "Mu`xhem`ul-Euset", vëll.1, fq.93, nr.281 përmes Ebu Hurejres r.a.; Shuajb el-Arnauti në recensimin e këtij hadithi thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët për shkak të Zejan b. Faideh, po ashtu Ibni Lehije dhe Rishdejni janë të dobët, kurse transmetuesit tjerë janë të besueshëm;

[661] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.4, fq.156, nr.2324; Abdulalij Abdulhumejd el-Hamidi në verifikim të veprës së Bejhakiut, për këtë hadith thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët dhe në të ka ndërprerje. Abdulkerimin e kanë konsideruar të dobët, ai nuk ka takuar asnjë sahabi;

[662] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.8, fq.134, nr.7532;

Transmeton Abdullah b. Shehiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon* ***kul Huvallahu ehad*** *gjatë sëmundjes prej së cilës do të vdes, nuk do të sprovohet në varrin e vet, e as që do t`i ngushtohet varri, melekët në Ditën e Kijametit do ta bartin me krahët e tyre gjersa ta kalojnë Siratin dhe ta çojnë në Xhenet".*[663]

Këtë e përforcon edhe *hadith*-i të cilin e transmeton Enesi r.a. se një nga *ensar*-ët u printe në namaz në xhaminë *Kuba*. Sa herë që e lexonte ndonjë *sure* në namaz, së pari e fillonte me *sure*-n Ihlas e pastaj lexonte *sure* tjetër. Ai kështu vepronte në çdo *rekat*. Ata që faleshin pas tij, reaguan e i thanë: "Ti së pari e lexon këtë *sure*, pastaj nuk mjaftohesh dhe lexon edhe *sure* tjetër. Prandaj, ose lexoje vetëm këtë *sure* dhe mjafton, ose lëre këtë *sure* dhe lexo diçka tjetër". Personi u tha: "Unë nuk e lë këtë *sure*, nëse doni t`u prijë në namaz në këtë mënyrë do të vazhdoj, e nëse nuk pajtoheni, atëherë unë nuk do të dal *imam*". Ata e konsideronin këtë më të mirin në mesin e tyre dhe nuk deshën dikë tjetër t`u bëhet *imam*. Kur erdhi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e lajmëruan për këtë e ai i tha personit: *"O ti filan, çka të pengon të veprosh ashtu si të thonë shokët e tu? Dhe çka të shtyn që këtë sure ta lexosh patjetër në çdo rekat?"* Njeriu tha: "Unë vërtet e dua këtë *sure*". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Dashuria e jote ndaj saj, do të çojë në Xhenet".*[664]

Lexuesi i kësaj *sure*-je madhështore, jo vetëm që do të fitojë Xhenetin, por do t`i mundësohet që të zgjedh se nga cila derë dëshiron të hyjë aty dhe cilën prej *hyri*-ve të Xhenetit e donë për vete. Transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush vjen me tre gjëra përpos imanit, do të hyj përmes cilës derë të Xhenetit të dojë dhe do të martohet me cilën hyri të donë: "Ai i cili ia fal vrasësit, ai i cili e fal borxhin dhe ai i cili e lexon pas namazit farz dhjetë herë* ***"Kul hu vallahu ehad".*** Ebu Bekri r.a. pyeti: "Po nëse e bën njërën prej tyre, a mundet t`i fitojë këto?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Ose me njërën prej tyre".*[665]

Në këtë *hadith* kuptojmë se preferohet të lexohet pas namazit *farz* kjo *sure* dhjetë herë, kurse në një transmetim tjetër, kuptojmë se po ashtu preferohet

---

[663] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.6, fq.57, nr.5785; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", 2/213;

[664] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Edhani, bab el-xhem`i bejne`s-suretejni fi`r-rek`ati, nr.774; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kurani, bab ma xhae fi sureti`l-ihlas, nr.2901; Ahmed-i, "Musned", 19/421, nr.12.432;

[665] Ebu Ja`la, "Musned", 1/417, nr.1794;

që të lexohet pas namazit të *xhuma*-së. Ai që e lexon këtë *sure*, do të jetë nën mbrojtjen e Zotit me bereqetin e këtij leximi deri në javën e ardhshme. Transmeton Aishja r.a.h. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon pas namazit të xhumasë* ***kulhuvallahu ehad, kul eudhu bi rabbil felek*** *dhe* ***kul eudhu bi rabbin nas*** *shtatë herë, Allahu do ta mbrojë atë prej së keqës deri në xhumanë e ardhshme".*[666]

Kjo *sure* është e preferuar të lexohet edhe në raste tjera brenda jetës së përditshme të një besimtari. Është zëvendësuese e besmeles në rast se njeriu harron ta shqipton atë para ngrënies. Transmeton Xhabiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nëse dikush harron të thotë bismilah para se të fillojë ushqimin, le të këndojë (suren)* ***kul Huvallahu ehad****, kur t`i kujtohet".*[667]

Po ashtu, preferohet që të lexohet kjo *sure* gjatë hyrjes në shtëpi, me qëllim që të shtojë bereqetin e shtëpisë së vet me mirësinë e madhe që ngërthen në vete kjo *sure*. Transmeton Xherir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon* ***kul Huvallahu ehad*** *kur të hyj në vendbanimin e tij, do të largojë varfërinë nga banorët e asaj shtëpie dhe fqinjët e saj".*[668]

Gjithashtu preferohet që të lexohet si mbrojtje para gjumit, e mirësia e saj do ta mbrojë nga çdo e keqe që mund ta godet njeriun gjatë natës. Vetë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i bënte *rukje* vetvetes me këtë *sure*. Përcillet nga Aisha r.a.h. e cila thotë: "Me të vërtetë, kur Pejgamberi salallahu alejhi ve selem shkonte në shtratin e tij në mbrëmje, i bashkonte duart e tij dhe frynte në to, pastaj lexonte: "***kulhuvallahu ehad, kul eudhu bi rabbil felek*** *dhe* ***kul eudhu bi rabbin nas"***, pastaj e prekte të gjithë trupin duke filluar prej kokës, këtë e përsëriste tre herë".[669]

---

[666] Ibni Sunnij, "Amelu`l-Jaumi ve`l-lejleti", Daru Erkam b. Ebi Erkam, Bejrut, botimi i parë, 1998, fq.228, nr.375; Ashik Ilahi el-Bureniju në recensim të kësaj vepre përcjell fjalën e Munavit, se Ibni Haxheri për zinxhirin e këtij hadithi ka thënë se është i dobët, por që përforcohet me transmetimin Mursel të Mekhulit, të cilin e shënon Sejid b. Mensuri në "Sunen"-in e tij".

[667] Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", 10/114;

[668] Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.2, fq.340, nr.2419. Ibni Kethir-i në Tefsirin e tij (4/569) thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët;

[669] Buhari-u, "Sahih", kitab Fadailul Kuran, bab 14, nr.5017; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Selamu, bab 20, nr.2192; etj.

Lexuesin e kësaj sureje të shkurtë por madhështore, e don Zoti i gjithësisë dhe e merr nën mbrojtjen e Tij. Edhe *sahab*-ët me të kuptuarit e tyre, përfunduan se kjo *sure* ka një vlerë të veçantë, andaj në çdo rast që iu jepej, e lexonin dhe e përsëritnin atë. Transmeton Aishja r.a.h. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka dërguar një person t`i prijë një ekspedite dhe ai kur falej si *imam* me shokët e tij, namazin e përfundonte me *sure*-n Ihlas. Kur u kthyen, shokët e tij ia treguan ngjarjen Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe ai u tha: *"Pyeteni pse e bën këtë?"* Ata e pyetën, e ai u tha: "Kjo *sure* flet për vetitë e Bëmirësit të Përgjithshëm, për atë dua ta lexoj". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Lajmërojeni se Allahu xh.sh. e do atë".*[670]

Po ashtu, lexuesit të kësaj *sure*-je dhe atij që lutet me atë që përmban kjo *sure,* Allahu xh.sh. do t`ia pranojë lutjet dhe do t`ia përmbush nevojat. Nuk ka lutje më të madhe sesa kur në të përmendet Emri më i madh i Zotit, e kjo *sure* e përmban këtë Emër madhështorë. Transmeton Burejde r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka dëgjuar një njeri duke thënë: *"Allahumme inni es`eluke enni esh`hedu enneke ente Allahu la ilahe il-la ente`l-ehadu`s-samedu`l-ledhi lem jelid ve lem juled ve lem je kul-lehu kufuven ehad" (O Zoti im, unë të lutem Ty dhe dëshmoj se Ti je Allahu dhe nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti je Një dhe çdo krijesë të drejtohet Ty për çdo nevojë, as ke lindur kë, e as nuk je i lindur nga dikush dhe me Ty askush nuk është i barabartë).* Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"I je lutur Allahut me një Emër (madhështor) që kur i kërkon Atij me këtë Emër, Ai të jep dhe ku i lutesh me të, Ai të përgjigjet".*[671]

Çka e bën kaq unike këtë *sure* dhe të ketë vlerë kaq të madhe? Ka një numër të madh të *hadith*-eve, ku shohim krahasimin e kësaj *sure*-je me 1/3 e Kuranit. Në vijim do t`i përmendim këto *hadith*-e, që të shohim se si është përshkruar kjo *sure* e shkurtë, por e barabartë me një pjesë të Kuranit.

Nga Ebi Seid el Hudriju r.a. përcillet se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem u ka thënë shokëve të tij: *"A nuk dëshiron dikush prej jush që të lexon 1/3 e Kuranit brenda një nate?"* U habitën shokët dhe thanë: "Kush mund që ta

[670] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab ma xhae fi dual`n-nebiji sal-lallahu alejhi ve sel-lem umetehu ila teuhidil-lahi, nr.7375; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu, bab fadlu kiraeti kul huvallahu ehad, nr.813; etj.

[671] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab dua, nr.1493; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab xhamiu`d-da`avati, nr.3475 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Dua, bab Ismullahi`l-a`dham, nr.3857;

bëjë këtë o i Dërguari i Allahut?" Ai tha: ***"Kul Huvallahu ehad, Allahu Samed*** *është 1/3 e Kuranit".*[672]

Transmeton Ebu Ejjubi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"A nuk ka mundësi dikush prej jush që të lexon 1/3 e Kuranit në një natë? Kush e lexon "**Kul Huvallahu ehad"** ka lexuar 1/3 e Kuranit".*[673]

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"**Kul Huvallahu ehad**, është e barabartë me 1/3 e Kuranit".*[674]

Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sureja Zilzal ka vlerë sa gjysma e Kuranit, sureja Ihlas ka vlerë sa një e treta e Kuranit, kurse sureja Kafirun, ka vlerë sa një e katërta e Kuranit".*[675]

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lexon Kulhuvallahu Ehad dymbëdhjetë herë pas namazit të sabahut, do të jetë sikur ta ketë lexuar katër herë gjithë Kuranin, ai do të jetë atë ditë prej njerëzve më të mirë mbi tokë nëse do të ruhet (prej mëkateve)".*[676]

Arsye kryesore për këtë vlerë të madhe të kësaj *sure*-je, dijetarët kanë përmendur disa mendime, por ne do të veçojmë dy prej tyre. Prej tyre është edhe Kurtubiu. Ai potencon se "Emri i Zotit **Ehad** dhe **Samed**, gjenden vetëm në këtë *sure*, andaj edhe është e barabartë me 1/3 e Kuranit.[677]

---

[672] Buhari-u, "Sahih", kitab Fadailu`l-Kuran, bab 13, nr.5015; Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 45, nr. 811; etj.

[673] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Kurani, bab 11, nr.2905. Ebu Isa Tirmidhi-u thotë se ky hadith është Hasen; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 69, nr.997; Ahmed-i, "Musned", 5/418, nr.23.444;

[674] Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 45, nr. 812; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edebi, bab 52, nr.3787-89; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailul Kurani, bab 11, nr.2908-09; etj.

[675] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadaili`l-Kurani, bab ma xhae fi idha zulzilet, nr.2902 dhe thotë se është hadith Garib pasi e përcjell vetëm Hasen b. Selmi; Hakim-i në "Mustedrek", 1/754, nr.2078 dhe thotë që senedi i tij është i Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar;

[676] Taberani, "Mu`xhemu`s-Sagir", vëll.1, fq.61; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.4, fq.136, nr.2298; Abdulalij Abdulhumejd el-Hamidi në verifikim të veprës së Bejhakiut, për këtë hadith thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët shkaku i Zekerija b. Atijes;

[677] Kurtubi-u, "Xhamiu`l-Ahkami`l-Kuran", vëll.22, fq.562;

Po ashtu thuhet se një pjesë e Kuranit është me rregulla, një pjesë me këshilla dhe një pjesë me Emrat dhe Cilësitë e Tij.[678]

Pasi e kuptuam vlerën e madhe të kësaj *sure*-je, duhet ta bëjmë praktikë leximin sa më të shpeshtë të saj dhe të kuptojmë përmbajtjen që ka, në mënyrë që jetën tonë ta orientojmë në ato kuptime madhore që ngërthen dhe mëson kjo *sure*.

Edhe pse *hadith*-i qëndrorë i kësaj teme është i dobët tek dijetarët, përsëri kuptimi i tij mbështetet nga të gjitha këto *hadith*-e tjera që u përmendën më lart.

[678] Kurtubi-u, "Xhamiu`l-Ahkami`l-Kuran", vëll.22, fq.562;

HADITHI I GJASHTËDHJETËETRETË (63)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ مَنْصُورٍ، قَالَ سَمِعْتُ رِبْعِيَّ بْنَ حِرَاشٍ، يُحَدِّثُ عَنْ زَيْدِ بْنِ ظَبْيَانَ، رَفَعَهُ إِلَى أَبِي ذَرٍّ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: "ثَلَاثَةٌ يُحِبُّهُمُ اللهُ، وَثَلَاثَةٌ يُبْغِضُهُمُ اللهُ، أَمَّا الثَّلَاثَةُ الَّذِينَ يُحِبُّهُمُ اللهُ: فَرَجُلٌ أَتَى قَوْمًا فَسَأَلَهُمْ بِاللهِ وَلَمْ يَسْأَلْهُمْ بِقَرَابَةٍ بَيْنَهُمْ فَمَنَعُوهُ، فَتَخَلَّفَ رَجُلٌ بِأَعْقَابِهِمْ فَأَعْطَاهُ سِرًّا لَا يَعْلَمُ بِعَطِيَّتِهِ إِلَّا اللهُ وَالَّذِي أَعْطَاهُ، وَقَوْمٌ سَارُوا لَيْلَتَهُمْ حَتَّى إِذَا كَانَ النَّوْمُ أَحَبَّ إِلَيْهِمْ مِمَّا يُعْدَلُ بِهِ، نَزَلُوا فَوَضَعُوا رُءُوسَهُمْ فَقَامَ يَتَمَلَّقُنِي وَيَتْلُو آيَاتِي، وَرَجُلٌ كَانَ فِي سَرِيَّةٍ فَلَقَوْا الْعَدُوَّ فَهُزِمُوا، فَأَقْبَلَ بِصَدْرِهِ حَتَّى يُقْتَلَ أَوْ يَفْتَحَ اللهُ لَهُ. وَالثَّلَاثَةُ الَّذِينَ يُبْغِضُهُمُ اللهُ: الشَّيْخُ الزَّانِي، وَالْفَقِيرُ الْمُخْتَالُ، وَالْغَنِيُّ الظَّلُومُ "

Transmeton Ebu Dherri (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre persona i donë Allahu dhe i urren tre të tjerë. Sa u përket tre personave të cilët i donë Allahu: Është njeriu i cili shkon tek një popull dhe u kërkon atyre (që ta ndihmojnë) për hir të Allahut dhe nuk u kërkon atyre diçka në bazë të ndonjë afërsie që kanë në mes tyre, por ata e refuzuan. Një njeri prej tyre qëndroi më pas dhe i dha atij fshehurazi, kurse dhënien e tij nuk e din askush përpos Allahut dhe ai të cilit i është dhënë; (i dyti) është një grup njerëzish të cilët udhëtojnë natën, gjersa gjumi të bëhet më i dashur për ta sesa çdo gjë tjetër që mund të barazohet me të, ata shtrihen dhe vëndojnë kokat (për të flejtur),* ***e njëri çohet për t`mu afruar dhe të lexojë ajetet e Mia,*** *si dhe një njeri i cili është në një ekspeditë dhe takon armikun, e më pas shpartallohen, por ky ballafaqohet me ta derisa të vritet ose Zoti t`u jep fitore. Tre të tjerë të cilët Zoti i urren (janë): "Plaku zinaqarë, i varfëri arrogant dhe i pasuri i padrejtë".*[679]

[679] Ahmed-i, "Musned", 35/285, nr.21.355; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Xheneti, bab, nr.2568 dhe thotë se ky hadith është Sahih; Nesaiu, "Sunen", kitab ez-Zekati, bab thevabu men ju`tij, nr.2570; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/577, nr.1520 dhe thotë se "ky hadith është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ata dy nuk e kanë shënuar"

Dashuria e Zotit për besimtarin është gjëja më e shtrenjtë që mundohet vazhdimisht ta arrijë. Kështu që i Dërguari i Zotit sal-lallahu alejhi ve sellem na mëson se cilat vepra mund të na afrojnë tek Ai, që të meritojmë Dashurinë e Tij xh.sh.

Në këtë *hadith* janë përmendur tri elemente të cilat e bëjnë të mundur që të arrihet Dashuria e Zotit, të cilat janë: lëmosha e dhënë fshehurazi, adhurimi që bëhet në vetmi dhe duke lexuar ajetet e Zotit dhe *xhihadi* në rrugë të Allahut xh.sh.

Sa i përket të parës, që njeriu të jep lëmoshë fshehurazi, shohim në këtë transmetim se njeriu i cili arrin dashurinë e Zotit është ai që jep fshehurazi, e jo ai i cili kërkon nga këta njerëz që ta ndihmojnë. Edhe pse antarët tjerë të grupit refuzuan që ta ndihmojnë këtë njeri, i cili u kërkoi për hir të Zotit, por nuk mori përgjigje pozitive, kështu që njëri antarë i grupit u nda anash dhe i dhuroi një ndihmë këtij nevojtari, kështu që antarët tjerë të grupit nuk e kuptuan këtë gjë, me këtë veprim, e meritoi Dashurinë e Zotit. Ne e kemi të njohur edhe parimin se te Zoti është shumë e dashur lëmosha e dhënë fshehurazi, saqë edhe dora e majtë, mos e kupton se çka ka dhuruar dora e djathtë, që është simbolikë e fshehjes së lëmoshës, duke mos e bërë atë publike, për të mos humbur shpërblimi shkaku i ndonjë lakmie për famë që mund të lind në zemrën e njeriut.

Për këtë grup njerëzish, Zoti thotë: **"Ata të cilët pasurinë e tyre e shpërndajnë gjatë natës dhe ditës, fshehurazi dhe haptazi, ata shpërblimin e vet e kanë te Zoti i tyre dhe për ta nuk ka as frikë e as pikëllim".**[680]

Në grupin e dytë, bëjnë pjesë ata të cilët gjatë natës çohen dhe e adhurojnë Allahun xh.sh. me adhurime të ndryshme, prej të cilave është edhe leximi i Kuranit. Në këtë shembull që përmendet në këtë tekst, shohim se një grup i cili ka qenë në udhëtim dhe kur vjen nata, e ata janë të lodhur aq shumë, saqë gjumi është gjëja më e dashur për ta, njëri prej tyre nuk bie të flejë, por çohet dhe fillon të adhurojë Allahun dhe të lexojë Kuranin.

---

me të pajtohet edhe Dhehebiu; shejh Shuajb el-Arnauti dhe recenzuesit tjerë në verifikim të Musnedit të Ahmed-it, për këtë hadith thonë se është Sahih;

[680] Kurani, Bekare, 274; shih edhe Rra`d, 22, Ibrahim, 31, Nahël, 75 dhe Fatir, 29;

Mu tek kjo pjesë është edhe aspekti hyjnorë (*kudsije*) i këtij *hadith*-i. Zoti e urdhëroi edhe Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të çohet të falet gjatë natës ku i tha: **"Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj".**[681] Po ashtu thotë: **"Dhe falu (bjer në sexhde) për hir të Tij gjatë natës dhe madhëroje Atë natën më gjatë".**[682]

Ky person i cili e ngrit nivelin shpirtërorë gjatë natës me adhurim dhe lexim të Fjalëve të Zotit, do të meritojë Dashurinë e Tij dhe do të jetë prej të dashurve të Zotit.

Kurse në grupin e tretë, bën pjesë personi i cili lufton për hir të Zotit dhe e flijon jetën e tij për idealin Islam. Ky person është një ushtarë i cili i është bashkëngjitur grupit për në ekspeditë dhe brenda kohës, sulmohen nga armiku dhe fillon të shpartallohet grupi i tij, por ai përkundrazi, qëndron i fortë dhe i durueshëm ndaj kësaj sfide, e përballon armikun me jetën e vet duke luftuar me ta, derisa të bie dëshmorë ose të fitojë me ndihmën e Zotit.

Ky person i cili vepron në këtë mënyrë, është prej njerëzve të cilët e meritojnë Dashurinë e Zotit dhe do të kenë vende të lavdëruara tek Ai. Zoti thotë në Kuran: **"Po ata që besuan, migruan dhe luftuan për rrugën e All-llahut, dhe ata që strehuan dhe ndihmuan, janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falje (e mëkateve) dhe furnizimi në mënyrë të ndershme".**[683] Dhe thotë: **"Ata të cilët besuan, migruan dhe luftuan me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e All-llahut, ata kanë pozitë më të lartë te All-llahu dhe vetëm ata janë të shpëtuarit. Zoti i tyre i përgëzon ata me mëshirë nga Ai, me Kënaqësinë e Tij ndaj tyre dhe me Xhenete ku ata do të kenë nimet (hirësi-mirësi) të pandërprerë. Ata aty do të jenë përgjithmonë e te All-llahu është shpërblim i madh".**[684]

Këto janë tri grupet e njerëzve të cilët Zoti i do, edhe pse nuk janë të vetëm këta, porse nëpër *ajet*-e dhe *hadith*-e të ndryshme, na bëhet e qartë se edhe shumë vepra tjera bamirësie tërheqin pas vetes Dashurinë e Zotit.

Më pas, përmenden tri kategori tjera, me të cilët Zoti është i hidhëruar shkaku i veprimeve të liga të cilat i kryejnë. Zoti me këta njerëz është i hidhëruar dhe këta nuk e meritojnë Dashurinë e Zotit.

---

[681] Kurani, Muzemil, 2;
[682] Kurani, Insan, 26;
[683] Kurani, Enfal, 74;
[684] Kurani, Teube, 20-22;

I pari që përmendet në *hadith* është plaku i cili kryen amoralitet. Edhe pse në parim *zina*-ja është e keqe sidoqoftë, por kur ajo kryhet nga plaku, atëherë atij mëkati barra i shtohet. Plaku duhet të jetë shembull për të tjerët dhe të jep mësimin jetësorë ndaj të rinjëve, por kur ai shndërrohet në plak pervers dhe jepet pas epshit të tij, ai do të jetë njeriu më i urryer te Zoti. Devotshmëria duhet të jetë pjesë e pandashme e të moshuarve, e jo dhënia pas anomalive të ndryshme, sepse ai më është kah fundi i jetës së tij dhe nuk duhet ta përfundojë jetën me mëkate, por të pendohet dhe të kthehet rrugës së Zotit që Ai ta mëshirojë dhe ta fal.

Këta persona, do të kenë dënim të ashpër në botën tjetër, Zoti do t`i braktis dhe nuk do të gjejnë ndihmë. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre personave, Allahu xh.sh. nuk do t`ju flasë në Ditën e Gjykimit, as që do t`i shikojë, e as nuk do t`i pastrojë, por do t`i dënojë ashpër: "Plaku zinaxhi, mbreti gënjeshtarë dhe i varfëri mendjemadh".*[685]

Kuptojmë që i varfëri i cili është mendjemadh dhe arrogant, do të përfshihet nga ky dënim, shkaku se ai në vend që të shfaq nevojën e tij dhe të kërkojë ndihmën e njerëzve, ai përkundrazi fillon t`i nënçmojë njerëzit dhe të sillet ashpër ndaj tyre duke i nënçmuar.

Dhe gupi i tretë të cilët do të meritojnë hidhërimin e Zotit, do të jenë edhe pasanikët të cilët me pasurinë e tyre sillen në mënyrë të padrejtë ndaj të tjerëve, nuk japin zekat, nuk japin sadaka, nuk ndihmojnë nevojtarët dhe të ngratët, nuk e shpenzojnë pasurinë e tyre për interesat publike, por vetëm e tubojnë atë për interesa të ngushta private, kështu që vazhdojnë në këtë gjendje derisa të meritojnë Hidhërimin e Zotit dhe të bëhen prej njerëzve më të urryer në tokë.

Këta janë tre grupet të cilët do të meritojnë Hidhërimin e Zotit, përballë atyre të cilët do të meritojnë Dashurinë e Tij. Shohim se nëse njeriu jep prej pasurisë së tij fshehurazi, do të meritojë Dashurinë e Zotit, e nëse bëhet prej të pasurve koprac dhe të padrejtë, do të meritojë Hidhërimin e Zotit, sepse këta nuk ndihmojnë që të përmirësohet gjendja e njerëzve. Po ashtu, ata që e kalojnë natën në vetmi për të adhuruar Zotin, do të jenë prej të dashurve të Zotit, krahas atij i cili vetmohet me ndonjë grua dhe bën amoralitet, person i cili meriton Hidhërimin e Zotit, sidomos kur këtë akt e kryen ai që është në

[685] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 46, nr.107; etj.

moshë të vjetër. Si dhe personi i cili e sakrifikon veten për hir të Zotit, është shumë i dashur tek Ai, krahas atij i cili jo që nuk kontribuon në shoqëri, sillet me arrogancë, edhe pse ka nevojë për ndihmën e të tjerëve, veprim që shkakton Hidhërimin e Zotit.

URDHËRIMI PËR PUNË TË MIRA DHE NDALIMI NGA PUNËT E KËQIJA

HADITHI I GJASHTËDHJETËEKATËRTË (64)

حَدَّثَنَا ابْنُ نُمَيْرٍ، أَخْبَرَنَا الْأَعْمَشُ، عَنْ عَمْرِو بْنِ مُرَّةَ، عَنْ أَبِي الْبَخْتَرِيِّ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " لَا يَحْقِرَنَّ أَحَدُكُمْ نَفْسَهُ أَنْ يَرَى أَمْرًا لِلَّهِ عَلَيْهِ فِيهِ مَقَالًا، ثُمَّ لَا يَقُولُهُ، فَيَقُولُ اللهُ: مَا مَنَعَكَ أَنْ تَقُولَ فِيهِ، فَيَقُولُ: رَبِّي خَشِيتُ النَّاسَ، فَيَقُولُ: وَأَنَا أَحَقُّ أَنْ تَخْشَى "

Nga Ebu Seid el-Hudriju (r.a.) përcillet se i Dërguari i All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Asnjëri prej jush le të mos e nënçmojë veten! Kur të sheh diçka, për të cilën Allahu ka folur dhe ai nuk e flet atë, atëherë do ta takojë Allahun xh.sh. dhe atë (që duheshte ta thotë) nuk e ka, i thotë*: ***"Ç'të pengoi (ta thuash të vërtetën rreth asaj çështjeje)?"*** *Ai do të thotë: "U frikësova prej njerëzve". All-llahu do t'i thotë:* ***"Më me të drejtë, isha Unë për t`mu frikësuar!".***[686]

Islami dallon me fetë e tjera, nga shkaku se obligon urdhërimin për vepra të mira dhe ndalimin nga të këqijat, me çka ndërton një shoqëri të shëndoshë e cila bartë përgjegjësi, e cila nuk anashkalon rolin e personit në shoqëri, por çdonjëri mundohet të kontribuojë në aspekt pozitiv për të ndërtuar një jetë sa më të mirë dhe me vlera të shëndosha. Ata që nuk dëshirojnë të kontribuojnë për mirëqenien e shoqërisë së vet, ata nuk mund të quhen pjesëtar të asaj shoqërie.

---

[686] Ahmed-i, "Musned", 17/357, nr.11.255; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 20, nr.4008; Busiri-u në "Ez-Zevaid" thotë: "Zinxhiri i hadithit është Sahih, kurse transmetuesit janë të besueshëm. Kurse Ebu Bahterij është Seid b. Fejruz et-Tai". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët; Në zinxhirin e këtij hadithi ka dobësi, shkaku se Ebu Bahterij nuk e ka takuar Ebu Seidin r.a. pasi në njërin transmetim vjen përcjellja e drejtpërdrejt e këtij transmetuesi nga Ebu Seidi, kurse në transmetimin që është shënuar në këtë hadith, në mes Ebu Bahterij dhe Ebu Seidit ka transmetues të panjohur. Në veprën "Tehdhib" thuhet: "Ebu Davud-i ka thënë: "Nuk ka dëgjuar ai prej Ebu Seidit. Ndërsa Ibni Ebi Hatim në "Merasil" nga babai i tij thotë: "Ebu Bahterij nuk e ka takuar Ebu Seidin e as Ebu Dherin". Për vlerësimin dhe kritikat ndaj Ebu Bahterijut, shih: Miziu, "Tehdhibu`l-Kemal", 11/32-35, nr.2342 dhe Dhehebiu, "Sijeru A`lam en-Nubela", vëll.4, fq.279-280, nr.101;

Në këtë shoqëri, çdo pjesëtar kur sheh ndonjë vepër të ligë, reagon për të ndryshuar atë fenomen dhe nuk mund të pajtohet që të shikojë përhapjen e saj e ky të qëndrojë i heshtur, nga shkaku se kush e sheh të ligën dhe nuk e kundërshton, ai është pjesëmarrës pasiv në përhapjen e asaj të keqeje.

Kjo fe madhështore që punon në bazë të një sistemi të përsosur, angazhon të gjithë fuqinë e vet për të ndryshuar rrethin shoqërorë në aspekt pozitiv, duke eliminuar çdo veti negative që dëmton shoqërinë dhe i jep asaj një pamje të shëmtuar.

Besimtari gjatë këtij aktiviteti, nuk duhet të angazhohet me mendimin se çka do të thonë njerëzit për të, ose vallë, a do ta dëgjojnë apo jo, porse ky obligohet që për hir të Allahut xh.sh. t`ua thotë të vërtetën, bile nëse ka forcë që ta kundërshtojë, atëherë obligohet që ta ndryshojë edhe me forcë.

Këtë e dëshmojmë edhe me një *hadith* të cilin e transmeton po ashtu Ebu Seidi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush prej jush e sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e vet, e nëse nuk mundet ta bëjë, atëherë me gjuhën e vet, e nëse edhe këtë nuk mundet, atëherë le ta urrejë me zemër, porse ky është besimi më i dobët".*[687]

Si zakonisht, është shteti ai i cili ka mundësinë e përdorimit të forcës për të ndryshuar diçka me dorë, sepse në shumicën e rasteve njerëzit janë të pafuqishëm për të ndryshuar diçka me forcë, por nëse i jepet rasti dhe sheh se ka mundësi ta ndryshojë, atëherë obligohet që ta ndryshojë edhe me dorë, por nëse në rast se nuk ka fuqi për këtë dhe sheh se mund të shkaktojë dëm më të madh, siç veproi Haruni alejhi`s-selam kur pa bijtë e Israilit të ndërtojnë viçin, ai nuk ndërmori asnjë hap, nga shkaku se u frikësua që mos të shkaktojë përçarrje në mesin e popullit, andaj priti të kthehet Musa alejhi`s-selam dhe të vendos për gjendjen e shkaktuar. Këtë e përshkruan edhe Kurani i madhëruar: **"Ai (Haruni) tha: "O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekrre as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash: "i përçave beni Israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?"**[688]

---

[687] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 20, nr.49; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 11, nr.2179 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Sahih; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Melahimi, bab 17, nr.4340; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Imanu, bab 17, nr.5011; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 20, nr.4013; Ahmed-i, "Musned", 17/126, nr.11.073 dhe 18/67, nr.11.492;

[688] Kurani, Taha, 94;

Nëse njeriu nuk posedon fuqinë e ndryshimit të fenomenit me dorë, atëherë duhet të flet kundër asaj çdoherë që i jepet mundësia, derisa të sheh se ka filuar të ndryshohet gjendja, por nëse edhe këtë nuk mund ta arrijë, atëherë duhet ta urrejë me zemër, edhe pse kjo është besimi më i dobët.

Por kur kihet parasysh rrethana dhe mundet që të shkaktohet gjakderdhje dhe fesad i madh në mesin e njerëzve, atëherë është më logjike edhe të heshtet për një periudhë siç veproi edhe shoku i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem Ebu Hurejre radijeAllahu anhu i cili thotë: "Kam mbajtur në mend nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dy lloje të diturisë. Sa për të parën, unë e kam përcjellë atë, e sa për tjetrën, sikur ta tregoja, atëherë do të më pritej fyti (koka)".[689]

Seid b. Xhubejri i ka thënë Ibni Abasit radijeAllahu anhu: "A duhet ta urdhëroj sundimtarin për mirë dhe ta ndaloj nga të këqijat?" Ai tha: "Nëse ke frikë se mund të të vras, atëherë nuk lejohet".[690]

E nëse dikush posedon guximin që edhe në raste të tilla ta thotë të vërtetën, ajo do të konsiderohet *xhihadi* më i mirë. Të thuash të vërtetën edhe ndaj udhëheqësve të cilët janë të padrejtë dhe kriminel, kjo është lufta e vërtetë, e nëse bie dëshmorë me këtë rast, atëherë te Zoti do të ketë shkallë të larta dhe merita të mëdha. Përcjell Ebu Seid el-Hudriju radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Xhihadi më i mirë, është të thuhet fjala e vërtetë para udhëheqësit të prishur".*[691] Pra, frika nuk duhet të jetë arsye e heshtjes permanente, sepse siç edhe kuptojmë nga *hadith-i kudsi* që kemi në trajtim, Ditën e Llogarisë njeriu do të pyetet për heshtjen e vet dhe për arsyen e mos thënies së vërtetës.

Frika ndaj Zotit duhet të jetë më parësore sesa frika ndaj njerëzve. Kështu që për shkak të frikës ndaj Zotit, njeriu duhet ta thotë të vërtetën, edhe nëse njerëzve nuk u pëlqen. Siç ndodhi një herë me një këshilltarë i cili i tha mbretit: "Ai i cili të thotë ke frikë Allahun, është më i mirë sesa ai i cili të thotë se mbreti me gjithë familjen do të jenë në Xhenet". Ose siç i tha një tjetër mbretit: "Do t`i jap përparësi frikës për ty, ndaj frikës prej teje dhe do të them `Ke frikë Allahun`".

---

[689] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab Hifdhi`l-Ilm, nr.120;
[690] Ibni Rexheb, "Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem", vëll.3, fq.954;
[691] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 13, nr.2181 dhe thotë se është hadith Hasenu-Garib përmes kësaj forme; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Melahimi, bab 17, nr.4344; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 20, nr.4011-12; Ahmed-i, "Musned", 18/131, nr.11.587;

Nëse dikush nuk e urren të keqen as me zemër, porse dëshiron të përhapen të këqijat në mesin e myslimanëve, atëherë ata janë zemërsëmurë që ndoshta nuk u ka ngelë edhe një grimcë besimi në zemër. Zoti thotë në Kuran: **"Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk e dini".**[692]

Ky fenomen është i rrezikshëm, kur në një shoqëri do të pranohet si diç normale e keqja, atëherë do të merret e keqja si vlerë shoqërore dhe nuk do të kundërshtohet nga askush, bile ai që e kundërshton atë akt, do të konsiderohet i prapambetur, siç ndodh edhe sot, që nëse dikush i kritikon veshjet e të rinjëve, në kohën kur shohim se si vajzat zbulojnë pjesët e trupit, askush nuk reagon, saqë edhe për prindërit është bërë gjë e zakonshme dhe askush nuk e kundërshton një veprim të tillë.

Dikush mund të thotë `po çdokush e ka për vehte` si dhe `nuk duhet me u përzier në punët private të dikujt!` Por, kur një punë e shëmtuar do të fillojë të paraqitet publikisht dhe të kryhet pa turp edhe në rrugë, atëherë më nuk është problem privat dhe personal i dikujt, por është problem shoqërorë dhe kolektiv, që duhet t`i jepet një zgjidhje urgjente. Ne të gjithë konsiderohemi sikur jemi në një anije, nëse lejojmë që dikush ta shpojë anijen për të marr ujë drejtpërdrejt nga deti, atëherë do të jemi të gjithë fajtor për fundosjen tonë, sepse të gjithë jemi në të njëjtën anije dhe nuk duhet të lejojmë të qëndrojmë indiferent ndaj shkatërrimit të mjetit të udhëtimit.

Nëse lejojmë që të përhapet e keqja në mesin tonë, atëherë kur të godasin dënimet e Zotit, ata nuk selektojnë të mirët e të keqinjtë, porse dënimi i kap të gjithë. Zoti thotë në Kuran: **"Ruajuni nga sprovimi (fitneja) që nuk godet vetëm ata që bënë mizori prej jush, dhe ta dini se All-llahu është Ndëshkues i Rreptë".**[693] Pra, anija kur fundoset, të gjithë pasagjerët do të kenë fatin e njëjtë.

Në një rast, u ngrit Ebu Bekri radijeAllahu anhu dhe falënderoi Allahun xh.sh. pastaj tha: "O ju njerëz! Ju e lexoni këtë *ajet*: **"O ju që besuat, ruane veten tuaj! Ai që ka humbur, nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu dhe Ai ju njohton për atë**

[692] Kurani, Nur, 19;
[693] Kurani, Enfal, 25;

që vepruat”.[694] Kurse ne e kemi dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *“Njerëzit, kur do të shohin të keqen dhe nuk do ta kundërshtojnë, edhe pse kanë mundësi ta pengojnë, kam frikë se do t`i kap dënim nga ana e Allahut”.*[695]

Në rrethana të tilla, Zoti as që u përgjigjet lutjeve të tyre, kështu që kjo do të jetë një dhimbje e rëndë për myslimanët, prandaj, para se të vije kjo gjendje, duhet të kemi kujdes që mos lejojmë që të përhapen të ligat në mesin tonë, sepse pastaj do të lutemi, kurse lutjet do të na refuzohen. Transmeton Aishja radiaAllahu anha se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Urdhëroni për të mira dhe ndaloni prej të këqijave, para se të vijë momenti që të luteni, kurse nuk do të merrni përgjigje”.*[696]

Populli i bijve të Israilit u mallkuan me gjuhën e pejgamberëve të tyre, nga shkaku se e braktisën urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, me çka edhe u erdhi dënimi i Zotit. Këtë qartë e tregon Kurani ku thuhet: **“Ata që mohuan të vërtetën nga beni Israilët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe të Isait, të birit të Mejremës. Kështu u veprua sepse kundërshtuan dhe e tepruan. Ata ishin që nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënin ishte e shëmtuar”.**[697]

Ai person i cili merr përsipër që të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, nuk duhet të dëshpërohet pse njerëzit nuk e pasojnë në fjalët e tij, sepse nëse askush nuk e ndjek, së paku do të ngel shpërblimi tek Zoti. Thotë Allahu xh.sh. në Kuran: “**Përse kështilloni një popull që Allahu do ta shkatërrojë ose dënojë me një dënim të ashpër? Thanë (këshilluesit): “Arsyetim para Zotit tuaj dhe me shpresë që t`u largohen gabimeve”.**[698]

Po ashtu, ai që këshillon për vepra të mira dhe ndalon nga të këqijat, duhet të ketë kujdes në sjelljen e vet, që të mos i largojë njerëzit, porse t`i afrojë. Duhet ta trajtojë mëkatarin sikur mjeku pacientin, pasi duhet luftuar sëmundjen e jo të sëmurin.

---

[694] Kurani, Maide, 105;
[695] Tirmidhi-u, “Sunen”, kitab el-Fiteni, bab 8, nr.2175 dhe thotë se hadithi është Sahih; Ebu Davud-i, “Sunen”, kitab el-Melahimi, bab el-emru ve`n-nehju, nr.4338; Ibni Maxheh, “Sunen”, kitab el-Fiteni, bab 20, nr.4005; Ahmed-i, “Musned”, 1/177, nr.1;
[696] Ibni Maxheh, “Sunen”, kitab el-Fiteni, bab 20, nr.4004;
[697] Kurani, Maide, 78-79;
[698] Kurani, A`raf, 164;

Sufjan eth-Theuri thotë: “Nuk duhet askush të urdhërojë për të mirë dhe ta ndalojë të keqen, pos atij që posedon tre virtyte: “I mirë në rastin e urdhërimit, i mirë në rastin e ndalimit, i drejtë në rastin e urdhërimit dhe i drejtë në rastin e ndalimit, si dhe i ditur për atë që urdhëron dhe për atë që ndalon”.[699]

Ahmed b. Hanbeli ka thënë: “Njerëzit duhet të kenë diplomaci dhe mirësi me rastin e urdhërimit për të mirë dhe të largojnë çdo ashpërsi”. Po ashtu ka thënë: “Shokët e Ibni Mes`udit radijeAllahu anhu kur kalonin pranë njerëzve që bënin diç të qortuar, thoshin: “Ngadalë Allahu ju mëshiroftë, ngadalë Allahu ju mëshiroftë”.

Dhe ka thënë: “Të mirën duhet urdhëruar butësisht dhe me të mirë. Andaj, nëse ata që i këshillon i thonë diç që nuk i pëlqen, të mos zemërohet, që të mos kuptohet se këtë e bën për vete”.[700]

[699] Ibni Rexhebi, “Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem”, vëll.3, fq.963;
[700] Po aty;

HADITHI I GJASHTËDHJETËEPESTË (65)

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ إِسْحَاقَ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ الْمُبَارَكِ، أَخْبَرَنَا يَحْيَى بْنُ أَيُّوبَ، عَنْ عُبَيْدِ اللهِ بْنِ زَحْرٍ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ يَزِيدَ، عَنِ الْقَاسِمِ، عَنْ أَبِي أُمَامَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: قَالَ اللهُ: " أَحَبُّ مَا تَعَبَّدَنِي بِهِ عَبْدِي إِلَيَّ: النُّصْحُ لِي "

Transmeton Ebu Umame radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu xh.sh.:* ***"(Vepra) më e dashur tek Unë me të cilën mund të më adhuroj robi, është këshillimi për Mua".***[701]

Të këshillosh për hir të Zotit, është një prej adhurimeve të shumta që janë të dashura për Zotin e gjithësisë, nga shkaku se përmes kësaj, dëshirojmë mirëqenien e të tjerëve, duke i këshilluar që të jetojnë në principe të kënaqësisë së Zotit, duke realizuar ato vepra që Ai do dhe duke u larguar prej veprave negative.

Këshillat e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem janë po ashtu shembull për ne, se si ai vazhdimisht këshillonte për rrugën e Zotit, që të arrijë kënaqësinë e Tij, saqë libra të tërë dhe vëllime të shumta janë mbushur duke regjistruar këshillat e të dashurit tonë, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Sikur të kishim marr parasysh disa vërejtje të dijetarëve rreth dobësisë së disa transmetuesve të këtij *hadith*-i, ajo aspak nuk ndikon në rregullin e

[701] Ibni Mubarek-u, në "Zuhd", fq.97, nr.204; Ahmed-i, "Musned", 36/529, nr.22.191 dhe teksti është i tij; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", 8/175; Mundhiri-u e përmend në "Tergib", 2/362, nr.2732 me shprehjen `*ruvije*` që jep të kuptohet se ka dobësi; Hejthemi-u po ashtu e shënon në "Mexhmeu`z-Zevaid", vëll.1, fq.113, nr.289 dhe thotë se e transmeton Ahmedi, por në zinxhir gjenden Ubejdullah b. Zahr nga Ali b. Jezid, ku që të dy janë të dobët". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmed-it, thotë se zinxhiri i këtij hadithi është shumë i dobët;

përgjithshëm fetar, që të jemi vazhdimisht këshillues për rrugën e vërtetë. Pasi nga ana tjetër, ka një numër të madh të hadithe, që janë të sakta, ku na urdhërohet të jemi këshillues për mirësi dhe ndalues nga veprat e këqija.

Shembull konkret kemi *hadith*-in që e transmeton Temim ed-Dari radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Feja është këshillë".* I thanë: "Për kë o i Dërguari i Allahut (sal-lallahu alejhi ve sel-lem)?" Ai tha: *"Për Zotin, për Librin e Tij, për të Dërguarit e Tij, për udhëheqësit e muslimanëve dhe njerëzit e rëndomtë".*[702]

Për rëndësinë e madhe të këtij *hadith*-i që e përcjell Temim ed-Dari, shkaku i përmbajtjes së saj, nxiti Muhamed b. Eslem et-Tusin që të deklarojë: "Ky hadith paraqet një të katërtën e fesë".[703]

Mund të potencojmë edhe *hadith*-in që e transmeton Xherir b. Abdullahu radijeAllahu anhu i cili thotë se i kanë dhënë besën të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem se do të falin namazin, do të japin zekatin dhe do të këshillojnë çdo musliman".[704]

Ky është edhe një obligim me të cilin obligohet muslimani ndaj muslimanit tjetër, sepse besimtarët janë një trup, nuk do të kishin lejuar të prishet një pjesë e tyre duke qenë kjo me vetëdijen e tyre, porse do të ndërmarrin masa për të përmirësuar aq sa kanë mundësi.

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Obligimet e muslimanit ndaj muslimanit janë gjashtë: "...nëse prej teje kërkon këshillë, ta këshillosh".*[705]

Nuk mund të konsiderohet pjesë e një tërësie, ai i cili nuk kujdeset për atë tërësi. Çdo trup është i angazhuar për mirëqenien e përgjithshme, siç

[702] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 23, nr.55; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 17, nr.1932 e shënon përmes Ebu Hurejres r.a. dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Nesai-u, "Sunen", kitab Beja, bab 31, nr.4202-03; Ahmed-i, "Musned", 28/138, nr.16.940; po ashtu edhe Buhari-u e shënon në "Sahih", kitab el-Imanu, bab 42, në titullin e hadithit 57, por pa zinxhir;

[703] Ibni Rexheb, "Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem", vëll.1, fq.226;

[704] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 42, nr.57; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 23, nr.56; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 17, nr.1933 dhe thotë se hadithi është Sahih; Nesai-u, "Sunen", kitab Beja, bab 17, nr.4180-83; Ahmed-i, "Musned", 31/489, nr.19.152;

[705] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Selamu, bab 3, nr.2162; etj.

funksionon edhe trupi, kur një pjesë e tij lëndohet, i gjithë imuniteti i trupit aktivizohet për të mbyllur plagën dhe të përshpejtohet shërimi. Transmeton Hudhejfe b. Jemani radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush nuk brengoset për hallet e myslimanëve, ai nuk është prej tyre. Ai i cili nuk zgjohet dhe nuk shtrihet, pos se duke qenë i angazhuar të këshillojë për Allahun, Pejgamberin e Tij, Librin e Tij, për kryetarin dhe popullin, ai nuk është prej tyre".*[706]

Kjo është esenca e fesë, sepse nëse ia do të mirën dikujt atëherë e këshillon. El-Hattabi ka thënë: "*Nasihat* (këshillë) do të thotë t`ia duash çdo të mirë atij që e këshillon".[707]

Feja jonë Islame është këshillë, sepse përmes këshillave arrihet deri në njohjen e besimit dhe rregullave të fesë, ndërsa pa këshillë, ka vetëm injorancë dhe errësirë. Të përgatitim kuadro në nivel shoqëror që të prezantojmë Islamin në mënyrën siç i takon kësaj feje madhore, e jo njerëz që do të keqpërdorin fenë për interesa personale. Të ngritim fjalën e Allahut xh.sh. përmes këshillave tona, e jo të mundohemi të ngrejmë vetëm përmes fesë së Tij.

[706] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.1, fq.279, nr.471; Hejthemi-u në "Mexhme`uz-Zevaid", 1/114 thotë se në sened gjendet Abdullah b. Ebi Xhafer er-Razi i cili sipas Muhamed b. Humejdit është i dobët, kurse të besueshëm e kanë konsideruar Ebu Hatimi, Ebu Zur`a dhe Ibni Hibani.

[707] Ibni Rexhebi, "Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem", vëll.1, fq.229;

HADITHI I GJASHTËDHJETËEGJASHTË (66)

حَدَّثَنَا أَبُو عَامِرٍ، حَدَّثَنَا هِشَامٌ يَعْنِي ابْنَ سَعْدٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ عُثْمَانَ بْنِ هَانِئٍ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ عُمَرَ بْنِ عُثْمَانَ، عَنْ عُرْوَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ: دَخَلَ عَلَيَّ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَعَرَفْتُ فِي وَجْهِهِ أَنْ قَدْ حَفَزَهُ شَيْءٌ، فَتَوَضَّأَ، ثُمَّ خَرَجَ فَلَمْ يُكَلِّمْ أَحَدًا، فَدَنَوْتُ مِنَ الْحُجُرَاتِ، فَسَمِعْتُهُ يَقُولُ: " يَا أَيُّهَا النَّاسُ، إِنَّ اللهَ عَزَّ وَجَلَّ يَقُولُ: مُرُوا بِالْمَعْرُوفِ، وَانْهَوْا عَنِ الْمُنْكَرِ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَدْعُونِي فَلَا أُجِيبُكُمْ، وَتَسْأَلُونِي فَلَا أُعْطِيكُمْ، وَتَسْتَنْصِرُونِي، فَلَا أَنْصُرُكُمْ "

Transmeton Aishja (r.a.h) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka hyrë tek ajo dhe se ka vërejtur në fytyrën e tij brengosje. Më pas ka marr abdes dhe ka hyrë në dhomë dhe nuk ka folur me askë dhe dëgjova të thoshte: *"O ju njerëz, me të vërtetë Allahu xh.sh. thotë:* ***"Urdhëroni për punë të mira dhe ndaloni nga të këqijat, para se të vijë çasti kur do të më luteni, e nuk do t`u përgjigjem, do të më kërkoni e nuk do ua plotësoj, do të kërkoni ndihmë, e nuk do t`u ndihmojë".***[708]

Në vazhdimësi të këtij *hadith*-i, do të kishim ndërlidhur edhe kuptimin e *ajet*-it kuranor, ku Zoti lavdëron *ummet*-in tonë shkaku i thirrjes në rrugë të Allahut xh.sh. ku thotë: **"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë dhe të ndaloni nga veprat e këqija..".**[709]

Lavdrimi i tillë si popull më i zgjedhur, vjen e ndërlidhur me thirrjen për në rrugë të Allahut, përndryshe, do të humbet ky vlerësim dhe meritë për këtë

[708] Ahmed-i, "Musned", vëll.42, fq.149, nr.25.255; Ebu Ja`la, "Musned", fq.894, nr.4911; Ibni Hiban-i, "Sahih", sipas radhitjes së Ibni Belbanit në "Ihsan", vëll.1, fq.526, nr.290; Shejh Shuajb el-Arnauti dhe recenzentët tjerë të Musned-it të Ahmed-it, thonë se hadithi është Hasen li gajrihi, kurse zinxhiri i këtij hadithi është i dobët; e shënon edhe Ibni Maxheh në "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 20, nr.4004 por jo si hadith kudsij;
[709] Kurani, Ali Imran, 110;

titull. Kjo është veçori e këtij *umet*-i, sepse fetë tjera nuk e kanë këtë institucion. Të krishterët dalin dhe thërrasin për në fenë e tyre, porse ato vetëm mundohen që t`i fusin në fenë e tyre, e më pas nuk këshillojnë që të përmbahen në udhëzimet e fesë dhe të qëndrojnë larg të këqijave. Kurse në fenë tonë, jo që vetëm duam të depërtojë besimi në zemrat e njerëzve, porse edhe të qëndrojnë të devotshëm dhe të ruajtur nga haramet.

Për këtë qëllim, duhet të angazhohet një grup i cili do të përgatitet profesionalisht në këtë lëmi dhe do të thërras në rrugën e Zotit me urtësi. Zoti thotë në Kuran: **"Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është më e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë të shpëtuarit".**[710]

Po ashtu, Zoti i dallon këtë kategori njerëzish edhe prej krijesave të Tija dhe duke u krenuar me të, thotë: **"E ndër ata që krijuam Ne, ka njerëz që urdhërojnë në të drejtën dhe veprojnë me të".**[711]

Gjithashtu, Zoti i ndihmon ata të cilët kur vendosen në një vend, falin namazin, japin zekatin dhe urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga të këqijat. Kështu thotë Zoti në Kuran: **"(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve".**[712]

Duhet të kihet shumë kujdes, që të thërrasim në rrugë të Allahut xh.sh. me urtësi dhe butësi, sepse ne dëshirojmë që të tregojmë mirësinë e kësaj feje dhe depërtimin e saj në zemrat e njerëzve, e jo që njerëzit të largohen dhe të dëshpërohen.

Metoda më e mirë se si të kryhet thirrja Islame, qartësohet nga vetë Kurani ku thuhet: **"Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me një mënyrë sa më të mirë...".**[713]

Allahu xh.sh. urdhëron urtësinë gjatë thirrjes me të gjithë njerëzit, e jo vetëm me muslimanët, pasi Allahu xh.sh. Musaun alejhi`s-selam me

[710] Kurani, Ali Imran, 104. Ngjashëm është edhe ajeti 122 në suren Teube;
[711] Kurani, A`raf, 181;
[712] Kurani, Haxh, 41;
[713] Kurani, Nahël, 125;

Harunin alejhi`s-selam kur i dërgoi te Faraoni u tha: **"Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet".**[714] Pra, edhe me njeriun më mizorë kërkon që t`i flitet me fjalë të buta, e jo me ashpërsi, kurse disa janë më të ashpër me muslimanët sesa që ishte Musai alejhi`s-selam me faraonin. Vallë, a nuk i thotë Allahu xh.sh. Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Kuran: **"Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje...".**[715]

Zoti e lavdëron fjalën e atij që thërret në Islam duke e konsideruar fjalën e tij si fjala më e mirë që mund të del, duke thënë: **"E kush ka fjalën më të mirë prej atij që thërret te All-llahu, vepron (punë) të mira dhe thotë: "Unë jam prej muslimanëve?".**[716]

Po ashtu, na tregon, se fjala e askujt nuk është më e mirë, se fjala e atij që thërret në rrugë të drejtë, siç potencon *ajet*-i kuranorë: **"Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve, e kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e All-llahut, Ne do ti japim më vonë (në botën tjetër) shpërbllim të madh".**[717]

Ndërsa, Ummu Habibe radijeAllahu anha thotë se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Çdo fjalë e birit të Ademit, është kundër tij, përpos kur urdhëron në të mirë, ndalon nga e keqja dhe e përmend Allahun".*[718]

Pra, kështu do të jetë shpërblimi për thirrësin në vepra të mira dhe që ndalon nga të ligat, duke qenë i butë, i dijshëm dhe i matur. T`i jep shpirt thirrjes së tij e mos e lë të thatë e me fjalë boshe, të mos përdorë fjalë të vrazhda dhe vullgare, të mos e pëlqejë vetveten mbi të tjerët dhe të mendojë se ai është i pagabueshëm, të jetë tolerant ndaj mendimit ndryshe dhe të mos mundohet me dhunë të imponojë mendimin e vet. Gjithashtu, nuk duhet të kultivohet mendimi negativ ndaj të gjithë të tjerëve që nuk mendojnë ngjashëm si ti, porse të dijmë se Zoti na urdhëron në Kuran duke thënë: **"Ju keni fenë tuaj**

[714] Kurani, Taha, 43-44;
[715] Kurani, Ali Imran, 159;
[716] Kurani, Fusilet, 33;
[717] Kurani, Nisa, 114;
[718] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ez-Zuhd, bab 63, nr.2420 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Garib, pasi nuk e dimë përmes ndonjë rruge tjetër përpos Muhamed b. Jezid b. Hunejs; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Fiteni, bab 12, nr.3974;

ata kanë fenë e tyre".[719] Thirrësi po ashtu duhet të jetë vizionarë dhe largpamës, të lehtësojë e jo të vështirësojë, sepse ashtu urdhëronte Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem delegatët e tij: *"Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos i largoni".*[720]

Sidomos thirrësi duhet të dijë prioritetet fetare e të mos merret me çështjet dytësore duke anashkaluar ato parësore dhe bazore, përndryshe thirrja e tij do të ketë efekt të kundërt. Nëse do të mirren parasysh këto kritere në thirrje, atëherë thirrja Islame do të ketë bereqet dhe do të përfitohen rezultate pozitive në kohë më të shkurtë.

[719] Kurani, Kafirun, 6;
[720] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ilmu, bab 11, nr.69 nga Enes b. Maliku r.a.;

HADITHI I GJASHTËDHJETËESHTATË (67)

حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ سُهَيْلٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " إِذَا سَمِعْتُمْ رَجُلًا يَقُولُ: قَدْ هَلَكَ النَّاسُ، فَهُوَ أَهْلَكُهُمْ، يَقُولُ : إِنَّهُ هُوَ هَالِكٌ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *''Nëse dëgjoni një njeri duke thënë `u shkatërruan njerëzit`, ai është më i shkatërruari, sepse (Allahu) thotë:* ***"Mu ai është shkatërruesi (ose i shkatërruari)".***[721]

Njeriu nuk duhet të jetë pesimist dhe të mbjellë dëshpërim në zemrat e njerëzve, porse duhet të jetë pozitiv dhe të sheh me syrin e optimizmit, që të mos e humb kreativitetin, të jetë prej atyre që do të gjejë mirësi, edhe në njerëzit e dobët moralisht. Njeriu i cili e konsideron veten besimtarë i mirë, assesi nuk duhet të vijë në pozitë të nënçmojë njerëzit tjerë, të cilët i mendon se janë të prishur dhe nuk janë në nivel me të për bamirësi dhe punë të mira, sepse kjo është esenca e mendjemadhësisë, kurse në këtë mënyrë, vetëm se i largon më tepër njerëzit prej vetes, e assesi nuk i afron.

Njeriu nuk duhet të paraqitet para njerëzve kinse e do të mirën e tyre dhe brengoset për ta, gjersa në esencë ai kënaqet kur sheh devijimin e tyre dhe largimin nga rruga e Zotit.

E nëse e thotë këtë fjalë prej mërzisë dhe pikëllimit që sheh tek njerëzit, kur vëren se ata bëjnë harame të ndryshme dhe largohen sa më shumë prej rrugës së Zotit, në këtë rast nuk bën pjesë në këtë qortim.

---

[721] Ahmed-i, "Musned", 13/114, nr.7685; Këtë hadith përmes Ebu Hurejres r.a. e regjistron edhe Muslimi, por jo si hadith kudsi, shih: Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab 41, nr.2623 si dhe Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab 77, nr.4983; Malik-u, "Muvetta", kitab Husnu`l-Huluk, bab ma jukrehu minel kelami, nr.1790; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, për këtë hadith thotë se e ka zinxhirin Sahih sipas kushteve të Muslimit;

Ebu Davudi thotë se Maliku ka thënë: "Nëse e thotë këtë fjalë prej mërzisë që e sheh tek njerëzit (pra, në lidhje me fenë, si ndonjë haram, vepër të ligë etj), kjo nuk është e qortuar, por nëse e thotë këtë fjalë duke u mahnitur me veten e vet dhe duke nënvlerësuar njerëzit, kjo është e qortuar dhe hyn në këtë ndalesë (që përmend hadithi)".[722]

Në këtë rast, njeriu edhe pse e konsideron veten më të mirë se të tjerët, ai është më i shkatërruari në moral dhe ai bën shkatërrim me fjalët dhe sjelljet e tij. Askush nuk i din fshehtësitë që të gjykojë për zemrat e njerëzve, sepse çdo bir i Ademit është mëkatarë.

Njeriu nuk duhet të mësojë gjuhën e tij me fjalë negative dhe poshtëruese, sepse poshtërsimi i të tjerëve, nuk ia ngren nivelin atij. Përcillet se Isa biri i Merjemes a.s. hasi në rrugë një derr dhe i tha: "Ec në paqe (selam)". I thanë atij: "Kështu i flet derrit?!" Ai tha: "Kam frikë që mos mësohet gjuha ime të flet fjalë të këqija".[723]

Ende më keq, do të jetë kur njeriu të kënaqet me të këqijat që sheh duke u përhapur në mesin e myslimanëve, sepse kjo tregon për gjendjen faktike të tij, se ai është duke u distancuar nga rrethi i tyre dhe pëlqen shkatërrimin që përhapet. Zoti thotë në Kuran: **"Ata që dëshirojnë të përhapet e keqja në mesin e atyre që kanë besuar, ata do të kenë dënim të dhimbshëm në këtë botë dhe në botën tjetër, Allahu e dinë kurse ju nuk e dini".[724]**

Prandaj, nëse nuk mund të kontribuojmë me vepra për përmirësimin e gjendjes, së paku të mos pengojmë të tjerët me gjuhë dhe fjalë negative.

[722] Ebu Davud-i, "Sunen", në sqarim të hadithit me numër 4983;
[723] Malik-u, "Muvetta", kitab Husnu`l-Huluk, bab ma jukrehu minel kelami, nr.1792;
[724] Kurani, Nur, 19;

HADITHI I GJASHTËDHJETËETETË (68)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ مُوسَى الْإِصْطَخْرِيُّ، ثَنَا أَبُو أُسَامَةَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ أُسَامَةَ الْكَلْبِيُّ، نَا عُبَيْدُ بْنُ إِسْحَاقَ الْعَطَّارُ، ثَنَا عَمَّارُ بْنُ سَيْفٍ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ أَبِي سُفْيَانَ، عَنْ جَابِرٍ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «أَوْحَى اللَّهُ إِلَى مَلَكٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ أَنِ اقْلِبْ مَدِينَةَ كَذَا وَكَذَا عَلَى أَهْلِهَا قَالَ: إِنَّ فِيهِ عَبْدَكَ فُلَانًا لَمْ يَعْصِكَ طَرْفَةَ عَيْنٍ قَالَ: اقْلِبْهَا عَلَيْهِ وَعَلَيْهِمْ، فَإِنَّ وَجْهَهُ لَمْ يَتَمَعَّرَ لِي سَاعَةً قَطُّ»

Transmeton Xhabiri (r.a.) i cili thotë: "I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. i shpalli një meleku prej melekëve që të përmbysë këtë e këtë qytet mbi banorët e saj e ai tha: "Po në të është robi Yt filani i cili asnjëherë nuk ka kryer mëkat?!" Tha:* ***"Përmbyse mbi të dhe mbi ata, sepse fytyra e tij asnjëherë për asnjë çast nuk është skuqur për hir Timin (nga turpi)".***[725]

Këtu kuptojmë rolin e brengës kolektive që duhet të mbizotërojë në shoqëritë myslimane, sepse derisa nuk e mbajmë dertin kolektiv dhe lejojmë të humbet morali i shoqërisë, atëherë në ato vende do të pasojnë shkatërrime.

Allahu xh.sh. në shumë vende në Kuran na paralajmëron mbi fatin e atyre popujve të cilët kundërshtuan ligjet dhe urdhrat e Zotit, se si ato u shkatërruan pasi neglizhuan Fjalën e Tij, e ky ligj është i përhershëm i Zotit, nëse nuk janë të nënshtrueshëm, atëherë do të pasojë dënimi i hidhur.

---

[725] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.7, fq.336, nr.7661; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.10, fq.74, nr.7188-7189; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 7/377-378, nr.12.156 thotë: "E transmeton Taberani në "Euset", përmes Ubejd b. Is`hak el-Atarit nga Amar b. Sejfit, por që të dy janë të dobët, por Amar b. Sejfin e ka konsideruar të besueshëm Ibni Mubareku dhe të tjerë, kurse Ebu Hatimi ka qenë i kënaqur (me transmetimet) e Ubejd b. Is`hakut"; Muhtar en-Nedeviu në verifikim të veprës "Shuab" të Bejhekiut, për këto dy transmetime thotë se janë të dobët shkaku se ka transmetues të dobët;

Nga *hadith*-i po ashtu kuptojmë se Zoti ka *melek* të caktuar i cili kryen dënimet mbi popujt zullumqarë, siç ishte rasti me Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili kur u torturua nga populli i Taifit, erdhi *melek*-u i kodrave dhe i ofroi mundësinë për të zgjedhur në mes dënimit të atij populli dhe faljes.[726]

Këtu nuk nënkuptohet se meleku ka kundërshtuar urdhrin e Zotit apo se nuk ka dashur ta realizojë urdhrin, porse është habitur se si filani duke qenë në atë vend, të bëhet dënimi i atij populli? Pra, e kuptojmë se edhe melekët ngurojnë të dënojnë ndonjë vend kur në mesin e tyre gjendet ndonjë i devotshëm dhe besimtar i sinqertë. Por, Zoti i bëri me dije se personi në fjalë nuk është në brendësinë e vet siç është jashtësia e tij, sepse ai nuk kundërshton aspak të këqijat që paraqiten në vendin e vet dhe nuk turpërohet aspak nga ajo që bëjnë njerëzit. Siç ishte rasti edhe me Iblisin, të cilin melekët e konsideronin si adhurues të rregullt, por Zoti në fund ua shfaqi brendësinë e tij të prishur dhe egoiste.

Zoti thotë në Kuran: **"Ata të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. Me të vërtetë Allahu e din e ju nuk e dini".[727]**

Njeriu duhet të kundërshtojë të keqen në bazë të mundësisë dhe kapacitetit të vet, e nuk duhet dorëzuar kundrejt të keqes dhe amorales, por vazhdimisht duhet të jetë në betejë, e jo të lejojë që e keqja të triumfojë. Nuk është valide brenga ndaj vetes dhe shpëtimi i vetes, kur të tjerët janë të zhytur në harame dhe ndalesa të ndryshme.

Njeriu duhet të turpërohet kur e sheh të keqen dhe ta luftojë me fuqi, me fjalë dhe me zemër, e jo të pajtohet dhe ta konsiderojë të keqen si diç normale, sepse atëherë mbi të gjithë ata do të bie dënimi i Zotit, edhe pse në mesin tyre mund të ketë edhe ndonjë njeri të mirë.

[726] Shih: Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Halki, bab idha kale ehadukum amin… nr.3231; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhihadu ve`s-Sijeru, bab ma lekije`n-nebiju salallahu alejhi ve selem min edha, nr.1795;
[727] Kurani, Nur, 19;

SHUMËZIMI I PUNËVE TË MIRA

HADITHI I GJASHTËDHJETËENËNTË (69)

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا الْمُغِيرَةُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ أَبِي الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " يَقُولُ اللَّهُ: إِذَا أَرَادَ عَبْدِي أَنْ يَعْمَلَ سَيِّئَةً، فَلاَ تَكْتُبُوهَا عَلَيْهِ حَتَّى يَعْمَلَهَا، فَإِنْ عَمِلَهَا فَاكْتُبُوهَا بِمِثْلِهَا، وَإِنْ تَرَكَهَا مِنْ أَجْلِي فَاكْتُبُوهَا لَهُ حَسَنَةً، وَإِذَا أَرَادَ أَنْ يَعْمَلَ حَسَنَةً فَلَمْ يَعْمَلْهَا فَاكْتُبُوهَا لَهُ حَسَنَةً، فَإِنْ عَمِلَهَا فَاكْتُبُوهَا لَهُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا إِلَى سَبْعِ مِائَةِ ضِعْفٍ"

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu (xh.sh.):* ***"Nëse robi Im synon ta veprojë një punë të keqe, mos ia shkruani derisa ta veprojë, e nëse e vepron, shkruani të tillë, e nëse e braktis për hir Timin, shkruani për të një të mirë, e nëse donë të veprojë një të mirë e nuk e vepron, shkruani për të një të mirë, e nëse e vepron, shkruani atë dhjetë deri në shtatëqind".***[728]

Te Muslimi (nr.129) vjen me shtesën në fund: *"Melekët thonë: "O Zoti ynë, ky është robi yt i cili dëshiron të kryejë një të keqe" Zoti thotë:* ***"Pritni, nëse ai e vepron atë, shkruajeni vetëm një, e nëse e braktis, atëherë shkruajeni për të një të mirë nëse e le për hir Timin".***[729]

Nga Ibni Abbasi radijeAllahu anhu përcillet se i Dërguari i All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"All-llahu i ka shkruar (përcaktuar) veprat e mira dhe ato të këqija. Pastaj ka shpjeguar se ai që ka pasur për qëllim ta kryejë një vepër të mirë dhe nuk e ka kryer All-llahu do t'ia shkruajë një vepër të mirë të plotë, e nëse e ka kryer, atëherë All-llahu do t'ia shkruajë si dhjetë të mira deri në shtatëqind fish, e madje edhe më*

[728] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab kauli lahi teala: juridune ej jubedilu kelamallahi, nr.7501; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 59, nr.128-130; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiri`l-Kurani, bab min sureti`l-En`ami, 10, nr.3084 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; etj.

[729] E shënon edhe Ahmed-i, në "Musned", 13/531, nr.8219;

tepër. Nëse njeriu ka pasur për qëllim një vepër të keqe dhe nuk e ka kryer, All-llahu do t'ia shkruajë një vepër të mirë të plotë, por nëse e ka kryer, All-llahu do t'ia shkruajë vetëm një vepër të keqe".[730]

Gjithashtu në këtë drejtim, shërben edhe *hadith*-i tjetër që e transmeton Ebu Dherri radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu xh.sh.:* ***"E mira shtohet dhjetëfish e më shumë, kurse e keqja shkruhet një dhe atë e fshijë. Nëse më takon me mëkate sa gjerësia e tokës, por duke mos më përshkruar ortak, do të më takojë me aq falje".***[731]

Të gjitha këto *hadith*-e dhe të tjera, dëshmojnë se Allahu xh.sh. i shumëfishon veprat e mira dhe me këtë tregon Mëshirën e Vet të pakufishme ndaj robërve të Tij, kurse mëkatin e shënon vetëm në sasinë e saj dhe nuk e shumëfishon, këtu Zoti tregon drejtësinë e Tij, sepse Ai nuk i bën padrejtësi asnjë krijese.

Njeriu në këtë *hadith*, përshkruhet në disa gjendje. E para, është shënimi i veprës së mirë kur e kryen në mënyrë të shumëfishuar. Niveli më i ulët në të cilën e regjistron veprën e mirë, është dhjetëfish. Thotë Allahu xh.sh.: **"Kush vjen me një punë të mirë, ai shpërblehet dhjetëfish...".**[732] Ndërsa, kjo sasi varet edhe prej qëllimit dhe gjendjes së zemrës së besimtarit, sepse kjo sasi mund të arrijë edhe deri në shtatëqind shpërblime për një vepër të vetme. Edhe kjo dëshmohet me ajetin kuranor, ku thuhet: **"Shembulli i pasurisë së atyre që japin në rrugë të Allahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon atij që dëshiron. Allahu është Bujar i madh dhe i di qëllimet".**[733]

Në mbështetje të këtij *ajet*-i, është edhe *hadith*-i ku Ebu Mes`ud el-Ensariu radijeAllahu anhu tregon se një njeri e solli një deve me kapistër dhe kishte thënë: "O i Dërguari i Allahut, le të përdoret kjo në rrugë të Allahut". Kurse

[730] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 31, nr.6491; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 59, nr.131; etj.
[731] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab fadlu`dh-dhikri, nr.2687; Ahmed-i, "Musned", 35/243, nr.21.315; Dejlemi-u, "Firdeus", vëll.3, fq.177, nr.4479;
[732] Kurani, En`am, 160;
[733] Kurani, Bekare, 261;

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Për shkak të kësaj, në Ditën e Gjykimit do t`i fitosh shtatëqind deve".*[734]

Të gjitha këto *ajet-e,* tregojnë se e mira shtohet, ndërsa e keqja ngelet në sasinë e vet. Në këtë kontekst, është edhe *ajet*-i tjetër, ku thotë Zoti**: "Kush sjell me vete punë të mirë, atij do t'i takojë shpërblimi edhe më i madh, ndërsa ai që paraqitet me punë të këqija, do t'i jepet dënim vetëm aq sa e ka merituar".**[735] Si dhe *ajet*-i: **"...e nëse ajo vepër është e mirë, Ai e shumëfishon atë dhe Vetë Ai i jep shpërblim të madh".**[736] Po ashtu kemi edhe *ajet*-in: **"Që Allahu t`i shpërblejë më së miri për atë që punuan dhe për t`ua shtuar të mirat nga Ai. Allahu i dhuron pa masë atij që do".**[737]

Për disa vepra tjera, shpërblimi është pa kufi dhe pa numër të definuar, ndërsa për sasinë e saj e dinë vetëm Allahu xh.sh. **"...ndërsa durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!".**[738] Në këtë kontekst, është edhe *hadith*-i që e transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"All-llahu xh.sh. thotë:* ***"Çdo punë e birit të Ademit është për të, përpos agjërimit, ai është Imi dhe Unë jam Ai që jep shpërblimin për të...".***[739] Edhe këtu shohim se shpërblimi për të nuk ka numër të caktuar, por vetëm Zoti e dinë se sa do llogaritet.

Ndonjëherë shtimi i veprave të mira, varet edhe prej periudhës kohore në të cilën kryhet vepra. Një e tillë, është edhe koha e muajit të dhul-Hixhes. Ibni Umeri radijeAllahu anhu dhe Ibën Abbasi radijeAllahu anhu tregojnë se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ka ditë, në të cilën veprat e mira janë më të dashura te All-llahu sesa këto ditë* (pra, dhjetë ditët e muajit Dhul-hixhe)". Të pranishmit e pyetën: "O i Dërguari i Allahut, as xhihadi në rrugën e Allahut?" Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem u përgjigj: *"As xhihadi në rrugën e Allahut, përveç nëse njeriu del vet dhe me pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asgjë".*[740]

---

[734] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imaretu, bab 37, nr.1892; etj.
[735] Kurani, Kasas, 84;
[736] Kurani, Nisa, 40;
[737] Kurani, Nur, 38;
[738] Kurani, Zumer, 10;
[739] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab 35, nr.7492; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab 30, nr.1151; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Saum, bab 55, nr.764; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 42, nr.2215; Ibn Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 1, nr.1638 dhe nr.3823; Ahmed-i, "Musned", 12/96, nr.7174; Ibni Huzejme, "Sahih", tahkik Dr. Mustafa Adhmij, Mektebetul Islamije, 2003, kitab Saum, bab 19, nr.1900;
[740] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Ijdejni, bab 11, nr.2475; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Saumu, bab 61, nr.2438; Ahmed-i, "Musned", vëll.2, f.224; etj.

Ngjashëm është edhe shtimi i shpërblimit të atij që namazin e falë në Qabe, në xhaminë e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Medine, apo namazi në xhaminë e Aksasë në Palestinë. Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Namazi në xhaminë time është më i mirë se 1000 namaze në xhamitë tjera, përpos Mesxhidu`l-Haramit (Qabes)".*[741] Kështu është edhe vlera e faljes së namazit në xhaminë Kuba. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem për këtë xhami tha: *"Namazi në xhaminë Kuba, e ka vlerën e umres".*[742]

Këto janë disa *hadith*-e të cilat tregojnë se vepra shtohet në vlerë edhe në rastin e vendit dhe kohës kur kryhet ajo. Të gjitha këto dëshmuan për faktin se vepra shtohet në vlerë nëse ajo kryhet dhe realizohet.

Por, nëse njeriu synon ta kryejë një vepër, por nuk arrin ta bëjë atë, atëherë sipas *hadith-it kudsij* që e kemi në trajtim, atij i shkruhet shpërblimi i plotë, edhe pse nuk e ka kryer. Këtë e vërtetojnë edhe *hadith*-e tjera dëshmi, siç është transmetimi i Umer b. Hattabit radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe çdokush do të merr atë që ka pasur për qëllim...".*[743]

Të kësaj natyre, janë edhe shumë transmetime, porse ne do të sjellim *hadith*-in që e transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, në Medine ka pasur njerëz që kanë qenë me ju në çdo luginë që keni kaluar".* Ata thanë: "O i Dërguari i Allahut, ata duke qenë në Medine?" Tha: *"Po, duke qenë në Medine, sepse i ka penguar nevoja (apo sëmundja)".*[744]

Si dhe *hadith*-i që e transmeton Ebu Derda radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush shkon në shtratin e tij duke*

---

[741] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Haxhu, bab fadlu salat bi mesxhidij mekete vel medine, nr.1394; etj.

[742] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 125, nr.324; Ibn Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti salat, bab 197, nr.1411;

[743] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-Vahji, bab 1, nr.1; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imaretu, bab 45, nr.1907; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab et-Talaku, bab 11, nr.2201; Nesai-u, "Sunen", kitab et-Tahareti, bab 6, nr.75; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab 16, nr.1653; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 26, nr.4227; Ahmed-i, "Musned", 1/303, nr.168;

[744] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Megazi, bab 81, nr.4423; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imaretu, bab 348, nr.1911; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Xhihadi, bab 6, nr.2764; etj.

pasur për qëllim që të zgjohet natën për t`u falur, por e mbizotëron gjumi deri në mëngjes, do t`i shkruhet atij sikur të ishte falur, kurse gjumi do të jetë për të sadaka nga ana e Zotit xh.sh.".[745]

Nga ana tjetër, nëse njeriu kryen një vepër të keqe, ajo nuk shkruhet menjëherë, por *melek*-ët e regjistrojnë në fund të ditës, e nëse për të kërkon falje, bën pendim dhe kryen vepra të mira, ajo aspak nuk shënohet, e nëse ai nuk i realizon këto gjëra, atëherë i shkruhet vetëm një mëkat. Për këtë, janë dëshmi *ajet*-e dhe *hadith*-e të ndryshme. Allahu xh.sh. thotë: **"..e kush vjen me një vepër të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të".**[746]

E nëse njeriu synon ta kryejë një vepër të keqe dhe nuk e kryen, ai nuk ndëshkohet për të, po as që i regjistrohet mëkat, përkundrazi, ajo i shënohet si vepër e mirë dhe shpërblim, për shkak se largimi nga mëkatet është punë e mirë. Njeriut nuk i regjistrohet mëkat derisa nuk e ka folur apo nuk e ka kryer me trupin e tij.

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu ia ka falur umetit tim atë që i pëshpërit vetvetja, gjersa nuk e ka folur apo nuk e ka vepruar".*[747]

Por, në këtë segment, ka përjashtime, nga shkaku se thamë edhe më lart, varësisht prej kohës dhe vendit, ndryshon edhe gjendja e peshës së mëkatit. Edhe tek mëkatet, ka shtim të madhësisë së tyre, por jo edhe të numrit, nëse kryhen në vende të shenjta apo në muaj të shenjtë.

Shembull konkret, kemi *ajet*-in në Kuran i cili u drejtohet grave të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, sepse statusi i tyre nuk është sikur i çdo gruaje tjetër, andaj mëkati i tyre, do të ishte skandal dhe tmerr, kështu që për to, nëse do ta kryenin mëkatin, do të kishte dënim të shtuar. Thotë Allahu xh.sh.: **"O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimi i shtohet dyfish e kjo për All-llahun është shumë lehtë".**[748]

---

[745] Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 63, nr.1788; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab 177, nr.1344;
[746] Kurani, En`am, 160;
[747] Buhari-u, "Sahih", kitab Itk, bab 6, nr.2528; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 58, nr.127; etj.
[748] Kurani, Ahzab, 30;

Apo *ajet*-i tjetër, ku Zoti tregon për personat që dëshirojnë tek njerëzit të përhapet imoraliteti, ata do të kenë dënim të dyfishuar dhe të stërmadhuar, sepse janë nxitës të së keqes. Pra, mëkati i tyre nuk bie vetëm mbi ata, porse ka efekt edhe tek tjerët, nga shkaku se dëshiron të përhapet e liga në mesin e myslimanëve dhe shkaktojnë që tjerë të mëkatojnë me punën apo fjalën që këta kanë filluar, me çka do të përfshihen një numër i madh i njerëzve. Zoti thotë në Kuran: **"Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk e dini".**[749] Duhet të kihet parasysh se ky *ajet* u zbrit për dyfytyrëshat e Medines, të cilët dëshironin të përhapnin të pavërteta në lidhje me shpifjen që iu bë gruas së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Aishes radijeAllahu anha.

Po ashtu, mëkati që kryhet në *harem*-in e Mekes, nuk është i barabartë për nga madhësia sikur mëkati që kryhet diku tjetër. Prandaj edhe thotë Zoti në Kuran: **"Haxhi është në muaj të caktuar e kush e bën haxhin në këtë muaj, nuk duhet afruar gruas, nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje...".**[750]

Po ashtu, mëkati që kryhet në muajt e shenjtë, është më i rëndë, sesa në muajt tjerë. Thotë Zoti në Kuran: **"Te Allahu numri i muajve është dymbëdhjetë ashtu siç është në Librin e Allahut prej ditës kur ka krijuar qiejt e tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë. Kjo është feja e drejtë. Pra, mos ngarkoni (me mëkat) veten tuaj në ata (katër muaj)".**[751]

Ka raste dhe situata, kur njeriu do të merret në përgjegjësi edhe për aspektet e brendshme shpirtërore, edhe pse nuk ka folur apo nuk ka vepruar me gjymtyrë. Shembull konkret kemi dyshimin në njëshmërinë e Allahut ose *kufr*-in, nëse njeriu nuk e shpreh me gojë apo me vepra, llogaritet mysliman në mesin e myslimanëve, edhe pse në brendi është jomysliman, ky edhe pse nuk e shfaq mosbesimin, do të merret në llogari për të. Apo edhe më qartë, kemi shembullin e mynafikëve, të cilët me gjuhë dhe vepra bëjnë atë që nuk e kanë në zemër, porse Zoti do t`i gjykojë sipas asaj që kanë pasur të fshehur në gjoksa, e jo sipas asaj që kanë shfaqur para njerëzve. Pra, veprën e keqe duhet ta braktis për hir të Zotit, e jo prej turpit dhe frikës nga njerëzit, sepse përndryshe nuk i shkruhet vepër e mirë braktisja e saj.

---

[749] Kurani, Nur, 19;
[750] Kurani, Bekare, 197;
[751] Kurani, Teube, 36;

Zoti në Kuran na tregon edhe për disa vepra tjera të cilat mund t`i ketë në shpirtë njeriu, që mund të konsiderohen mëkat, sepse janë të rrezikshme, ato janë vendime të forta dhe të përqendruara të cilat e pushtojnë shpirtin e njeriut me qëllime të tilla, siç janë mendjemadhësia, egoizmi, syefaqësia, etj. Allahu xh.sh. thotë: **"O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat ..."**.[752]

Kurse nga *hadith*-et, kemi rastin ku transmeton Ebu Bekrete radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur dy myslimanë ndeshen me shpatat e tyre, edhe vrasësi edhe i vrari janë në Zjarr".* I thanë: "E kemi të qartë për vrasësin, por përse edhe i vrari?" Tha: *"Edhe ai do ta kishte vrarë po t`i jepej mundësia".*[753] Pra, ai ka dalë në dyluftim me qëllim për të vrarë tjetrin, edhe pse nuk është realizuar qëllimi, ai ka dalur me qëllim për ta realizuar atë plotësisht.

Por, nëse nuk janë qëllimet prej këtyre mëkateve të mëdha dhe nuk synohet realizimi i tyre, atëherë Zoti i falë ato. Siç edhe erdhi në fillim, me *ajet* kuranorë ku Zoti tha: **"Të All-llahut janë ç'ka në qiell dhe ç'ka në tokë, e për atë që e keni në veten tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët fshehtë, All-llahu do t'ju marr në llogari, e Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do. All-llahu ka mundësi për çdo send".[754]** Por, kjo u erdhi shumë vështirë shokëve të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe menduan se nuk do të ngelet asgjë pa u llogaritur, atëherë Zoti zbriti ajetet tjera, ku na tregon se njeriu nuk ngarkohet dhe nuk i llogaritet ajo që kanë në brendësi, me përjashtim të rasteve që u theksuan më sipër. Zoti thotë: **"All-llahu nuk ngarkon askë përtej mundësive të veta, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. "Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën nuk kemi fuqi! Na i mbulo të këqiat, na fal dhe na mëshiro. Ti je Mbrojtësi ynë, pra na ndihmo kundër popullit pabesimtar".[755]** Dhe Allahu e dinë më mirë.

---

[752] Kurani, Huxhurat, 12;
[753] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Fiteni, bab 10, nr.7083; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Fitenu ve eshratu`s-Sa`ati, bab 4, nr.2888; etj.
[754] Kurani, Bekare, 284;
[755] Kurani, Bekare, 286; shih për këtë sqarim: Sujuti, "Ed-Durru`l-Menthur", vëll.3, fq.411;

HADITHI I SHTATËDHJETË (70)

أَخْبَرَنَا أَبُو عَبْدِ اللَّهِ مُحَمَّدُ بْنُ يَعْقُوبَ الشَّيْبَانِيُّ، ثَنَا يَحْيَى بْنُ مُحَمَّدٍ الذُّهْلِيُّ، ثَنَا مُسَدَّدٌ، ثَنَا الْمُعْتَمِرُ، قَالَ: سَمِعْتُ الْحَكَمَ، يُحَدِّثُ عَنِ الْغِطْرِيفِ، عَنْ جَابِرِ بْنِ زَيْدٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنِ الرُّوحِ الْأَمِينِ قَالَ: قَالَ: " قَالَ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ: يُؤْتَى بِحَسَنَاتِ الْعَبْدِ وَسَيِّئَاتِهِ فَيَقُصُّ بَعْضَهَا بِبَعْضٍ فَإِنْ بَقِيَتْ حَسَنَةٌ وَسَّعَ اللَّهُ لَهُ فِي الْجَنَّةِ " قَالَ: فَدَخَلْتُ عَلَى يَزْدَادَ فَحَدَّثَنَا بِمِثْلِ هَذَا الْحَدِيثِ، قُلْتُ لَهُ: فَإِنْ ذَهَبَتِ الْحَسَنَةُ؟ قَالَ: {أُولَئِكَ الَّذِينَ نَتَقَبَّلُ عَنْهُمْ أَحْسَنَ مَا عَمِلُوا} [الأحقاف: 16]– وَقَرَأَ إِلَى قَوْلِهِ – {يُوعَدُونَ} [الأحقاف: 16] قُلْتُ لَهُ: فَرَأَيْتُ قَوْلَهُ عَزَّ وَجَلَّ {فَلَا تَعْلَمُ نَفْسٌ مَا أُخْفِيَ لَهُمْ مِنْ قُرَّةِ} [السجدة: 17] أَعْيُنٍ وَقَالَ: «الْعَبْدُ يَعْمَلُ سِرًّا أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ فَلَا تَعْلَمُ بِهِ النَّاسُ فَأَسَرَّ اللَّهُ لَهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ قُرَّةَ عَيْنٍ»

Transmeton Ibni Abasi r.a. nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ky nga Shpirti Besnik (Xhibrili a.s.) i cili ka thënë: *"Ka thënë Zoti xh.sh.:* ***"Do t`i sillen të mirat dhe të këqijat robit në Ditën e Kijametit, të cilat do të pakësojnë njëra-tjetrën, e nëse ngel një e mirë, Allahu do ta fus në Xhenet".*** *Tha: "E nëse nuk i mbetet edhe ajo e mirë?" Tha:* **"Të tillët janë ata që Ne ua pranojmë në mënyrë më të mirë atë që punuan, ua kapërcejmë të këqijat e tyre duke i radhitur me banorët e Xhenetit...". (Ahkaf, 16)** A nuk e keni lexuar fjalën e Zotit: **"Pra, për ata që kanë vepruar nuk di askush për atë kënaqësi të fshehtë që u është caktuar atyre si shpërblim". (Sexhde, 17).** Tha: *"Ky është robi i cili ka punuar një*

të mirë fshehtas, kurse Zoti do t`ia shfaq në Ditën e Kijametit e ai do të përjetojë kënaqësi".[756]

Në Ditën e Gjykimit, kur krijesat të dalin në llogari para Zotit dhe do të maten veprat e tyre të cilat i kanë vepruar në këtë botë. Njeriut do t`i sillen shënimet me veprat e mira dhe veprat e liga, përmes së cilave do të varet edhe përfundimi dhe fati i njeriut në botën e amshueshme. Por, siç përmendet edhe në fillim të hadithit, tregohet se veprat do të pakësojnë prej njëra-tjetrës, pasi ndonjëherë, kryejmë vepra të mira të cilat na i fshijnë mëkatet, por ndonjëherë bëjmë ndonjë mëkat i cili na i fshin punët e mira. Kjo dëshmohet edhe me shumë argumente fetare.

Njeriu ndonjëherë përpiqet të jetë i përmbajtur dhe të ketë frikë Zotin nga gjërat të cilat i janë ndaluar, por ndonjëherë edhe mashtrohet nga intrigat e kësaj bote dhe mashtrimet e *shejtan*-it, andaj edhe mund të kryejë ndonjë mëkat, apo duke braktisur ndonjë urdhër fetar, por nëse njeriut i ndodh diç nga këto vepra, duhet pas kryerjes së mëkatit të pasojë me ndonjë vepër të mirë, që ajo ta shlyejë veprën e keqe.

Puna e parë që e fshin të gjithë të kaluarën e zymtë, është pranimi i Islamit, e nëse një njeri që nuk ka qenë musliman, e pranon Islamin, i fshihen të gjitha mëkatet që ka kryer deri në atë moment. Zoti thotë në Kuran: **"Thuaju atyre që nuk besuan se nëse heqin dorë (nga rruga e tyre e gabuar) do t`u falet e kaluara...".**[757]

Amër b. Asi r.a. kur shkoi të pranojë Islamin, kërkoi si kusht që t`i falen mëkatet e kaluara, kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"A nuk e di se Islami i fshin veprat (e këqija) të mëhershme, hixhreti i fshin veprat e mëhershme dhe haxhi i fshin veprat e mëhershme".*[758]

Zoti thotë në Kuran: **"Dhe fale namazin në dy skajet e ditës e edhe në orët e afërta (me ditën) të natës. S`ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat. Kjo është një këshillë për ata që i pranojnë këshillat".**[759]

---

[756] Hakim-i, "El-Mustedrek", vëll.4, fq.280, nr.7641 dhe thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, me këtë pajtohet edhe Dhehebiu; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.12, fq.183, nr.12.832;
[757] Kurani, Enfal, 38;
[758] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab keun`ul-Islami jehdimu ma kablehu, nr.121; etj.
[759] Kurani, Hud, 114;

Nga ky *ajet* kuranor, shohim se namazi është faktor për faljen e mëkateve dhe lëshimeve të cilat mund t`i kryejmë brenda ditës apo natës, porse falen nëse pas veprës së ligë falim namazin.

Po ashtu Zoti thotë: **"Përpos kush bën mëkat, pastaj e zëvendëson me të mirë pasi ka bërë keq, atëherë s`ka dyshim se Unë jam që fali shumë dhe jam Mëshirues".**[760]

Nga këto *ajet*-e, shohim Mëshirën e pakufishme të Zotit i Cili i fshin mëkatet e robërve të Tij pasi ato kanë gabuar dhe kanë kërkuar falje. Edhe në këtë *ajet*, shohim se njeriu, nëse e pason mëkatin me ndonjë vepër të mirë, atëherë do ta gjejë Zotin Falës.

Në *ajet* tjetër, Zoti thotë: **"Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre, e kush i fal mëkatet përveç Allahut? Dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilat rrjedhin lumenj e aty do të jenë përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë".**[761]

Nga kjo, kuptojmë se njeriu i cili kryen mëkate dhe i bën padrejtësi vetes duke u ngarkuar me të këqija, rrugëdalje është kthimi në të përmendurit e Zotit dhe *istigfari* (kërkimi i faljes prej Zotit), duke qenë i bindur se mëkatet nuk ka kush që i fal përpos Allahut xh.sh. Po ashtu, mësojmë se kërkohet që njeriu pasi të përmirësohet, të mos vazhdojë rrugën e shumtuar me vetëdije, e nëse përmirësohen në këtë mënyrë, të tillëve Zoti u ka përgatitur shpërblime të shumta, duke filluar me falje të mëkateve dhe Xhenete të përhershme. A ka diçka më shpresdhënëse për mëkatarin e penduar sesa këto *ajet*-e?!

Pendimi është prej faktorëve që i fshin veprat e këqija dhe e pastron shpirtin e njeriut prej gjurmëve të mëkatit. Zoti thotë në Kuran: **"O ju që keni besuar, pendohuni te Zoti sinqerisht, në mënyrë që Zoti t`ua fshijë mëkatet".**[762] Po ashtu thotë: **"Përveç atij që është penduar dhe ka bërë**

[760] Kurani, Nemël, 11;
[761] Kurani, Ali Imran, 134-136;
[762] Kurani, Tahrim, 8;

vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është Mëshirues ndaj Ai falë shumë".[763]

Falja e Allahut i fshin mëkatet, ndërsa Mëshira e Tij i zëvendëson mëkatet me vepra të mira. Zoti edhe atyre të cilët i përziejnë veprat e tyre, që ndonjëherë kryejnë të mira e ndonjëherë të këqija, të tillët do të përfshihen në Mëshirën e Zotit. Thotë Allahu xh.sh.: **"Ka edhe të tjerë që i kanë pranuar mëkatet e veta: ata i përzien veprat e mira e edhe të tjera të këqija. Atyre do t`ua fal Allahu, se Ai i fal atij që pendohet, e mëshiron atë që përmirësohet".**[764]

Prej gjërave që fshijnë mëkatet, bën pjesë edhe largimi nga mëkatet e mëdha, e nëse njeriu vepron kështu, Zoti ia fal mëkatet e vogla. Thotë Zoti në Kuran: **"Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndaluara, Ne ju shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm".**[765]

Edhe frika prej Zotit, është shkak që të falen mëkatet e njeriut. Thotë Zoti në Kuran: **"..e nëse e keni frikë Allahun, Ai do të vërë udhëzim për ju, do t`ua mbulojë të këqijat dhe do t`ua falë mëkatet.."**[766] dhe thotë: **"..e kush ka frikë Allahun, Ai atij ia shlyen të këqijat dhe ia rrit shpërblimin".**[767]

Prej *ajet*-eve që do të përmendim në këtë drejtim, është edhe Fjala e Allahut: **"Allahu do t`ua shlyejë atyre edhe më të keqen që e punuan dhe do t`u jap shpërblime më të mira për atë që punuan".**[768]

Ajet-et në këtë temë janë të shumta dhe nuk mund të përfshihen të gjitha, pasi do të zgjerohej tepër ky shkrim, porse mjaftojnë këto, për të parë se Allahu xh.sh. i fshin mëkatet e besimtarit dhe nuk lë gjurmë të tyre në fletoren e veprave të tij.

Po ashtu, ka edhe vepra tjera të mira, të cilat i fshijnë mëkatet, e këto janë të përmendura nëpër disa *hadith*-e. Ne do të përmendim disa, sa për të na u qartësuar tema në fjalë. Prej veprave që i fshin mëkatet e robit, është marja e abdesit dhe plotësimi i saj. Transmeton Humrani, rob i liruar i Uthman b.

[763] Kurani, Furkan, 70;
[764] Kurani, Teube, 102;
[765] Kurani, Nisa, 31;
[766] Kurani, Enfal, 29;
[767] Kurani, Talak, 5;
[768] Kurani, Zumer, 35;

Affanit r.a. se e ka parë Uthmanin r.a. të kërkojë një enë me ujë (për të marrë abdes). Ai hodhi ujë në duar dhe i lau ato tri herë, pastaj futi dorën e djathtë në enë, (mori ujë) dhe e shpërlau gojën tri herë, lau edhe hundën duke tërhequr ujë dhe pastaj duke shfryrë tri herë. Pastaj lau fytyrën tri herë edhe parakrahët bashkë me bërrylat tri herë, pastaj i kaloi duart e lagura mbi të gjithë kokën, pastaj i lau këmbët bashkë me nyjet tri herë dhe pastaj tha: "Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush merr abdes si ky abdesi që mora unë, pastaj falë dy rekate, gjatë të cilit koncentrohet e nuk mendon në vete diç tjetër, do t`i falen të gjitha mëkatet e tij të mëparshme".*[769]

Prej veprave të cilat i fshijnë mëkatet e robit, është edhe falja e namazit të xhumasë. Transmeton Selman Farisiju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush pastrohet ditën e Xhuma dhe parfymoset, shkon në xhami dhe nuk ndan dy veta në saff, fal atë që është caktuar dhe kur del imami në hutbe e dëgjon dhe hesht, i falen mëkatet që i ka bërë në mes dy xhumave".*[770]

Jo vetëm namazi, por edhe disa elemente brenda namazit janë shkak për faljen e mëkateve. Prej tyre mund të përmendim përputhjen e shqiptimit të fjalës `Amin` në fund të recitimit të *sure*-s Fatiha, ku gjatë këtij momenti, edhe *melek*-ët e shprehin të njëjtën. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur të thotë imami `amin` thoni edhe ju, sepse amin-i i kujt përputhet me amin-in e melekëve, do t`i falen mëkatet e tij të mëparshme".*[771] Këtu është edhe shprehja *`rabena lekel hamd`* e cila thuhet pasi çohemi prej *ruku*-së. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur të thotë imami `semiallahu limen hamideh`, ju thoni:` Allahumme rabena lekel hamd` sepse fjala e kujt përputhet me fjalën e melekëve, do t`i falen mëkatet e mëparshme".*[772]

Në këtë grup të veprave, bën pjesë edhe agjërimi. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e agjëron Ramazanin me iman dhe duke shpresuar në shpërblim, do t`i falen mëkatet e*

[769] Buhari-u, "Sahih", kitab Vudu, bab 24, nr.159; Muslim-i, "Sahih", kitab Tahare, bab 3, nr.226-227; etj.
[770] Buhari-u, "Sahih", kitab Xhumuati, bab duhni lil xhumuati, nr.883; etj.
[771] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab xhehri`l-imami bi`t-te`mini, nr.780; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab tesmiu ve`t-tahmidu ve te`minu, nr.410; etj.
[772] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab fadli Allahume rabena lekel hamd, nr.796; etj.

mëparshme".[773] E tillë është edhe falja e namazeve vullnetare gjatë netëve të Ramazanit. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush bën nijet dhe falë namaz vullnetar gjatë netëve të Ramazanit nga besimi dhe duke shpresuar në shpërblim nga Allahu, do t`i falen mëkatet e mëparshme".*[774]

Jo vetëm agjërimi i obliguar, por edhe agjërimi vullnetar është shkak për faljen e mëkateve. Prej tyre, është agjërimi i ditës së Ashurasë dhe ditës së Arafat-it. Transmeton Ebu Katade r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Për agjërimin e ditës së Ashurasë, shpresoj se Allahu do t`i fshij mëkatet e një vitit".*[775] po ashtu transmeton Ebu Katade el Ensariu: "E pyetën Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem për vlerën e agjërimit në Arafat, e ai tha: *"(Agjërimi në atë ditë) i fal mëkatet për vitin e kaluar dhe vitin e ardhshëm".*[776]

Kryerja e haxhit si obligim i fesë, është prej shkaqeve që muslimanit t`i falen mëkatet e mëparshme. Në këtë temë ka disa hadithe, por ne e sjellim atë që transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e kryen haxhin duke mos kryer marrdhënie intime me gruan dhe nuk flet fjalë të ndyta, do t`i falen mëkatet e mëparshme".*[777] Po ashtu, transmeton Ummu Seleme r.a.h. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush hyn në ihram duke pasur për qëllim haxhin apo umren prej Mesxhidi Aksas e deri në Qabe, do t`i falen të gjitha mëkatet e mëparshme".*[778]

Prej veprave tjera të cilat i fshijnë mëkatet e robit, është edhe përmendja e Allahut (*dhikr*-i). Transmeton Sa`d b. Ebu Vekkasi r.a. se një ditë ishin pranë Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ai na tha: *"A doni që çdo ditë të fitoni nga njëmijë sevape?* Ne thamë: "O i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, si është e mundur kjo?" Ai tha: *"Nëse dikush thotë*

---

[773] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 28, nr.38, Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu, bab tergibu fi kijami ramadane vehuve teravih, nr.760; etj.

[774] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 27 nr.37; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu mysafirin ve kasruha, bab 25, nr. 759; etj.

[775] Tirmidhi-u, "Sunen", kitabu Saum, bab 48, nr.752; Ibn Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 41, nr. 1738;

[776] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab istihbabu sijami thelatheti ejjamin min kuli shehër, nr.1162; etj.

[777] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Haxhi, bab fi theuabi`l-haxhi ve`l-umreti, nr.811 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih;

[778] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Menasiki, bab fi`l-mevakit, nr.1741;

në ditë njëqind herë `subhanallah`, atij i shkruhen njëmijë sevape dhe i fshihen njëmijë mëkate".[779]

Po ashtu, transmeton Ebu Hurejre r.a. se Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë LA ILAHE LI-LALLAH VAHDEHU LA SHERIKE LEHU, LEHUL MULKU VE LEHUL HAMDU VE HUVE ALA KULI SHEJIN KADIR" kush e thotë këtë 100 herë në ditë, ka shpërblimin sikur t'i ketë liruar 10 robër. Atij i shkruhen 100 të mira, i fshihen 100 mëkate (gjynahe) dhe është i mbrojtur nga djalli deri në mbrëmje, askush nuk ka vepruar më mirë se ky person, me përjashtim të atij që ka vepruar më tepër. E kush thotë `Subhanallahi ve bi hamdihi` njëqind herë në ditë, do t`i fshihen mëkatet po edhe nëse janë sa shkuma e detit".*[780]

Si dhe përcjellja e Enesit r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem mori një degë me gjethe të thara dhe e shkundi e pastaj tha: *"El-Hamdulilahi, Subhanallahi, La ilahe il-lallahu dhe Allahu ekber, i rëzojnë mëkatet e robit, siç bien gjethet nga kjo degë".*[781] Që të tre këto transmetime na bëjnë me dije se si Zoti i fal mëkatet përmes *dhikr*-it. Por kjo nuk është e tëra, mëkatet falen edhe përmes bërjes së *duas*-ë pas bukës dhe pas veshjes së teshave të reja. Transmeton Muadh b. Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush han ushqim e pastaj thotë: "El-hamdulilahi ledhi etamenij hadha`t-ta`ame ve rezekanihi min gajri haulin minni ve la kuvvetin" do t`i fshihen mëkatet të cilat i ka bërë dhe do t`i bëjë. E kush thotë kur të vesh tesha:"El-hamdulilahi ledhi kesani hadhe`th-theube ve rezekanihi min gajri haulin minni ve la kuvvetin" do t`i fshihen mëkatet të cilat i ka bërë dhe do t`i bëjë".*[782]

Kur jemi te përkujtimi i Allahut, edhe *dhikri* dhe *duaja* e mëngjesit dhe mbrëmjes, bën pjesë në veprat e mira të cilat kontribuojnë në faljen e mëkateve të muslimanit. Transmeton Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë në mëngjes: "Allahumme inni esbahtu ush`hiduke ve ush`hidu hamelete arshike ve melaiketeke ve xhemia halkike enneke entallahu la ilahe il-la ente vahdehu la sherike leke*

[779] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab 10, nr.2698; etj.
[780] Buhari-u, "Sahih", kitab ed-Da`avatu, bab fadli`t-tehlili, nr.6403 dhe bab fadli tesbihi, nr.6405; Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab 10, nr.2691; etj.
[781] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 97, nr.3544 dhe thotë se është Garib;
[782] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Libasu, bab, nr.4023; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Et`imeh, bab ma jukalu idha ferega mine`t-ta`ami, ne.3285; etj.

ve enne Muhameden abduke ve resuluke" atij do t`i falen mëkatet e asaj dite, e nëse e thotë atë në mbrëmje, do t`i falen ato që i bën gjatë natës".[783]

Edhe ngritja prej një *mexhlis*-i, në të cilin kemi kuvenduar, nëse bëjmë *dua* pas saj, Zoti na i fal mëkatet të cilat i kemi kryer gjatë asaj ndeje. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *"Kush ulet në ndonjë mexhlis dhe e shtojnë në të bisedimin, para se të çohen duhet të thonë: "Subhaneke Allahumme ve bi hamdike, eshhehu en la ilahe il-la ente estagfiruke ve etubu ilejke` e kush e thotë këtë, do t`i falen mëkatet që ka bërë në atë mexhlis".*[784]

T`u japësh ujë të tjerëve është prej veprave të dashura të Zotit, po sikur edhe një kafshës nëse i jep ndihmë, do të shpërblehesh për të. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Iu fal një gruaje mëkatare njëherë për shkak se një qenit të etur, i cili hante dheun nga etja, i dha ujë me këpucën e saj".*[785]

Ngjashëm me këtë rast, kemi edhe personin tjetër, i cili ndihmoi të tjerët, duke larguar një pengesë prej rrugës kalimtare, e për këtë vepër, Zoti ia fali mëkatet. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Një njeri ishte duke ecur në rrugë dhe pa një degë në rrugë, ai e largoi atë, Allahu e falënderoi për të dhe ia fali mëkatet".*[786]

Kurora e të gjithë këtyre veprimeve të mira, është edhe morali i mirë i njeriut, i cili pastron mëkatet e njeriut. Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Morali i vyeshëm i shkrin mëkatet siç e shkrin uji borën, ndërkaq morali i prishur i deformon veprat ashtu siç e prish uthulla mjaltin".*[787]

Nuk do ta kishim plotësuar mirë temën, nëse nuk do të kishim përmendur në këtë listë të veprave të mira, edhe dhënien e sadakasë, e cila i shlyen mëkatet e njeriut. Transmeton Muadh b. Xhebeli r.a. se Pejgamberi sal-

[783] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab ma jekulu idha esbaha, nr.5078;
[784] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab ma jekulu idha kame minel mexhlisihi, nr.3433 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahihun-Garib;
[785] Buhari-u, "Sahih", kitab Bed`ul-halki, bab idha vekaa`dh-dhubabu fi sherabi ehadikum fel jagmis`hu, nr.3321; etj.
[786] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab fadli tahxhiri ile`dh-dhuhri, nr.652; etj.
[787] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 10/388, nr.7673-74;

lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...Sadakaja i fshin mëkatet, siç e fik uji zjarrin..."*.[788]

Pra, nga kjo që u tha deri këtu, kuptuam se pasi të kryejmë vepra të këqija, duhet shpejtuar që të kryejmë ndonjë vepër të mirë, që ajo të jetë shkak për fshirjen e veprës së lig, e për ta realizuar këtë, pamë disa vepra të cilat kanë shpërblim të madh te Zoti. Mu për këtë, duhet nxituar vazhdimisht në vepra të mira, që të mbulojmë të këqijat që kemi bërë. Transmeton Muadhi r.a. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ke frikë All-llahut kudo që të jesh, të keqen pasoje me një të mirë, e cila do ta shlyen mëkatin dhe sillu me njerëzit me moral të mirë"*.[789]

Deri këtu, pamë se si Zoti ka caktuar që vepra e mirë, të jetë shkak për fshirjen e mëkatit, por në disa raste, edhe mëkati bëhet shkak që të fshihen punët e mira. Prej këtyre veprave, është *kufr*-i dhe *shirk*-u, të cilat ia fshijnë njeriut të gjitha të mirat dhe e dërgojnë atë në zjarr të Xhehenemit. Zoti thotë në Kuran: **"...E kush mohon besimin, ai ka asgjësuar veprat e veta dhe ai në botën tjetër është prej të shkatërruarve".**[790]

Zoti sjell shembull për të treguar punët e pabesimtarëve, të cilët edhe pse kanë punuar në këtë botë, ata përsëri do të jenë prej të dëshpëruarve në botën tjetër. Zoti thotë: **"E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t'i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen All-llahun dhe ai do t'ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje. Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit All-llahu nuk jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë".**[791]

Në këtë kontekst është edhe *ajet*-i tjetër, ku Zoti thotë: **"E Ne i kthehemi ndonjë vepre që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur".**[792]

---

[788] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Imanu, bab 8, nr.2625 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 22, nr.4210 e përcjell nga Enesi r.a.;
[789] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Edebi, bab 55, nr.1994; Taberani, "Mu`xhem`ul-Kebir", 20/145, nr.298; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 10/380, nr.7660;
[790] Kurani, Maide, 5;
[791] Kurani, Nur, 39-40;
[792] Kurani, Furkan, 23;

Po ashtu, Zoti tregon se ata që përgënjeshtrojnë pejgamberët dhe thirrjen e tyre, do të jenë prej më të dëshpëruarve në botën tjetër dhe punëve të tyre, nuk do t`u jepet asnjë vlerë. Thotë Zoti në Kuran**: "Thuaj: "A t'ju tregojmë për më të dëshpruarit në veprat e tyre?". Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë. Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre as takimin (ringjalljen) e Tij, andaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t'u jepet kurrfarë vlere. Këtë, ngase shpërblimi i tyre është Xhehennemi, për shkak se nuk besuan dhe argumentet e Mia e të dërguarit e Mi i morën për tallje".**[793]

Po ashtu, thotë: **"E atyre që nuk besuan, ata qofshin të përmbysur, Ai atyre ua ka asgjësuar veprat. Këtë për shkak se ata e urrejtën atë që e zbriti All-llahu, prandaj atyre ua zhduk veprat".**[794]

Prej veprave të cilat kanë rrezikuar të mirat e myslimanëve, ka qenë edhe ngritja e zërit mbi zërin e Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem gjatë bisedave, por në shenjë respekti edhe sot e kësaj dite, nuk duhet ngritur zëri afër varrit të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, mu edhe për këtë shkak, në derën e varrit të tij, është regjistruar ky *ajet*: **"O ju që keni besuar, mos ngritni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos iu gërmoni atij si i ngërmoheni njëri-tjetrit, e të zhduken veprat tuaja duke mos ditur ju".**[795]

Prej veprave të këqija, që zhdukin veprat e mira, bën pjesë edhe krenimi dhe lavdërimi me atë që bën njeriu, sepse Zoti dëshiron nga njeriu sinqeritet dhe devotshmëri, e jo lavdata dhe krenim. Nëse njeriu jep sadaka për t`u lavdëruar nga njerëzit, atëherë ajo aspak nuk do t`i bëjë dobi. Zoti thotë në Kuran: **"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që ia jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk beson All-llahun dhe botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar mbi të cilin ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk udhëzon popullin pabesimtar".**[796]

---

[793] Kurani, Kehf, 103-106;
[794] Kurani, Muhamed, 8-9;
[795] Kurani, Huxhurat, 2;
[796] Kurani, Bekare, 264; ajete në të cilat Zoti potencon zhdukjen e veprave të mira, mund të gjeni edhe në: Bekare, 217; Ali Imran, 22; Maide, 53; A`raf, 147; En`am, 88; Teube, 17 dhe 69; Hud, 16; Ahzab, 19; Zumer, 65;

Këtu mund të përmendim edhe *hadith*-in *kudsij*, të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Prej njerëzve të parë të cilët do të gjykohen në Ditën e Gjykimit do të jetë dëshmori (shehidi). Ai do të afrohet (dhe All-llahu) do t'ia bëjë të njohura të mirat që i ka bërë dhe do t'i njohë ato. (All-llahu i Madhëruar) do t'i thotë:* ***"Çfarë bëre me këto?"*** *Ai do t'i përgjigjet: "Luftova për hir Tëndin derisa rashë dëshmor". (All-llahu) do t'i thotë:* ***"Gënjen! Luftove që të tjerët të thonë: "Është guximtar!"*** *Dhe vërtet ashtu ishte. Pastaj do t'u urdhërohet (engjëjve të rreptë) që ta tërheqin zvarrë me fytyrë përtokë derisa të hidhet në Zjarr. Njeriu tjetër do të jetë dijetari, i cili ka studiuar diturinë, e ka mësuar dhe gjithashtu e ka lexuar Kuranin. Ai do të afrohet dhe All-llahu do t'ia bëjë të njohura të mirat që i ka bërë, dhe ato do t'ia pranojë. (All-llahu i Madhëruar) do të thotë:* ***"Çfarë bëre me këto?"*** *Ai do të thotë: "Studiova diturinë dhe ua mësova të tjerëve, e gjithashtu edhe e lexova Kuranin për hir Tëndin". All-llahu do t'i thotë:* ***"Gënjen! Studiove diturinë vetëm që të tjerët të thonë: "Ky është njeri i ditur". Lexove Kuranin që të thonë për ty: "E lexon Kuranin"****. Dhe vërtet ashtu ishte. Pastaj do t'u urdhërohet (engjëjve të rreptë) që ta tërheqin zvarrë me fytyrë përtokë derisa të hidhet në Zjarr. Njeriu i tretë do të jetë pasaniku, të cilin All-llahu e kishte bërë të pasur duke ia dhënë të gjitha llojet e pasurisë. Ai do të afrohet dhe All-llahu do ta njoftojë me veprat që i ka bërë. I Madhëruari do t'i thotë:* ***"Çfarë bëre me këto?"*** *Ai do të përgjigjet: "Nuk lash vend pa e shpenzuar pasurinë time për hir Tënd". All-llahu do t'i thotë:* ***"Gënjen! E ke shpenzuar pasurinë vetëm që të thonë për ty se je dorëdhënë!"*** *Dhe vërtet ashtu ishte. Pastaj do t'u urdhërohet (engjëjve të rreptë) që të tërhiqet zvarrë me fytyrë përtokë derisa të hidhet në Zjarr*".[797]

Edhe në rastin e këtyre tre personave, shohim se vepra e mirë të cilën e kanë realizuar, do t`u fshihet dhe nuk do t`u bëjë dobi assesi, pasi nuk ka qenë e sinqertë për Allahun xh.sh. Prej këtyre veprave, mund të përmendim edhe shpifjen, ngrënien e pasurisë dhe vepra tjera të liga. Kurse këtu, do të sjellim *hadith*-in nga Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"A e dini kush është i falimentuar?"* Ata thanë: "Tek ne i falimentuar është ai që nuk ka as *derhem* e as pasuri tjetër!". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Me të vërtetë, i falimentuar (`muflis`) është ai që vjen Ditën e Gjykimit me namaz, me agjërim, me zekat, porse dikë e ka sharë, për dikë ka shpifur, dikujt i ka ngrënë pasurinë, ka derdhur gjakun e dikujt,*

[797] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imaretu, bab 43, nr.1905; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 48, nr.2389 dhe thotë se ky hadith është Hasenun-Garib, por e përcjellë me tjetër zinxhir të transmetuesve;

dikë e ka rahur, këtij do t`i merren prej veprave të mira, e nëse do t`i harxhohen të mirat para se të shpaguajë të bëmat e tij, do të merren prej mëkateve të tyre dhe do t`i ngarkohen këtij dhe kështu do të futet në Zjarr".[798]

Ngjashëm përcillet nga Salimi, robi i liruar i Hudhejfes, se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Do të vijnë disa popuj në Ditën e Kijametit, të cilët do të kenë me vete veprat e mira të mëdha sikur kodra Tihame, e kur t`u afrohen atyre, do të shndërrohen në pluhur dhe pastaj do të përfundojnë në Zjarr".* Salimi ka thënë: "Sakrifikofsha babanë dhe nënën për ty o i Dërguari i Allahut, na i përshkruaj këta njerëz?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Këta ishin që faleshin dhe agjëronin dhe kanë qëndruar një pjesë të natës (në adhurim), por kur u paraqitej ndonjë haram, ata vraponin pas saj, prandaj Allahu ua shkatërroi veprat".* Malik b. Dinari tha: "Kjo pasha Allahun është nifaku (dyfytyrësia)".[799]

Nga kjo, shohim se të tillëve, nuk do t`u bëjnë dobi punët e mira, edhe pse i kanë pasur të shumta, e veprat e tyre do t`u shpërndahen të tjerëve, të cilët kanë qenë të dëmtuar nga ligësitë e tyre.

Përmes haditheve, kuptojmë edhe disa vepra tjera të cilat shkatërrojnë punët e njeriut. Prej tyre është edhe trrishtimi i njerëzve dhe shkaktimi i humbjes së shpresës nga Mëshira e Zotit. Transmeton Xhundubi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Një njeri ka thënë: "Vallahu, Zoti nuk do ta fal filanin" kurse Allahu thotë:* ***"Kush është ai që betohet se Unë nuk do t`ia fali filanit? Unë ia kam falur filanit, kurse veprat tua i kam shkatërruar".***[800]

Lënia e namazit të ikindisë, është prej veprave të cilat rrezikojnë veprat e mira të njeriut. Nëse njeriu e braktis namazin e ikindisë, i fshihen të mirat që ka bërë. Transmeton Burejde r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e lë namazin e ikindisë, puna e tij është asgjësuar".*[801]

Zilia është po ashtu prej veprave të këqija, e cila rrezikon të mirat e njeriut të cilat i ka kryer. Transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve

[798] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab tahrimu`dh-dhulm, nr.2581; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab ma xhae fi she`nil hisabi vel kisas, nr.2418; Ahmed-i, "Musned", 13/399, nr.8029;
[799] Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", vëll.1, fq.177-178;
[800] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab nehju an tekniti`l-insani min rahmetilahi teala, nr.2621;
[801] Buhari-u, "Sahih", kitab Mevakitu`s-Salat, bab men tereke`l-asr, nr.553; etj.

sel-lem ka thënë: *"Zilia (Hasedi) i fshin punët e mira, siç i djeg zjarri drunjt..."*.[802]

Kur është pyetur imam Ebu Hanife nga nxënësi i tij se cilat vepra i fshijnë të mirat, imami është përgjigjur: "Ato mund të fshihen për shkak të njërit nga këto shkaqe: "Për shkak të *shirk*-ut të cilin mund ta bëjë njeriu, siç thotë Allahu në Kuran: **"Kush bën kufër në Allahun, të gjitha ato që ka bërë deri atëherë i shkojnë huq". (Maide, 5).** Kur një njeri në emër të Zotit liron një rob ose ndihmon një të afërm, edhe nëse ndihmon dikë materialisht, kur hidhërohet e kthehet kah ai të cilit i ka ndihmuar dhe i thotë: "Po a nuk jam unë ai që të ndihmova më parë, a nuk jemi farefis?" me një fjalë `ia nxjerr për hunde` atë që më parë i ka ofruar, kjo sjellje ia fshin sevapin e fituar më parë. Për këtë thotë Zoti: **"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim..." (Bekare, 264).** Nëse dikush bën një vepër vetëm që ta shohin njerëzit, Allahu xh.sh. assesi nuk do ta pranojë punën të cilën njeriu e bën me qëllim që të lavdërohet e të fitojë autoritet. Përveç këtyre tri shkaqeve, nuk ekziston asnjë rregull tjetër që tregon se veprat e njeriut mund të humbin nga vlera e tyre".[803]

Në tekstin e *hadith*-it *kudsi* që kemi në trajtim, tregohet se pasi veprat të barazohen dhe të marrin nga njëra-tjetra, nëse njeriut i ngel një e mirë në fund, ajo do të jetë shkak që të hyjë në Xhenet. Kur u parashtrua pyetja, se: *"E nëse nuk i mbetet edhe ajo e mirë?" Tha:* **"Të tillët janë ata që Ne ua pranojmë në mënyrë më të mirë atë që punuan, ua kapërcejmë të këqijat e tyre duke i radhitur me banorët e Xhenetit...".[804]**

Ibni Kethiri në koment të këtij *ajet*-i, thotë: "Ata që posedojnë cilësitë të cilat i përmendëm, të cilët kthehen dhe pendohen tek Allahu xh.sh. dhe mundohen t`i përmirësojnë lëshimet e bëra me pendim dhe kërkim të faljes nga Allahu, janë **ata që Ne ua pranojmë në mënyrë më të mirë atë që punuan, ua kapërcejmë të këqijat e tyre,** do t`u falen shumë nga gabimet e bëra dhe do t`iu pranohen edhe të mirat e pakta që i kanë bërë".[805]

---

[802] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 22, nr.4210; Busirij-u në Zevaid thotë: "Në zinxhirin e këtij hadithi gjendet Isa b. Ebu Isa, e ai është i dobët në hadith"; por këtë hadith e përcjell edhe Ebu Davud-i në "Sunen", kitab el-Edebi, bab fi`l-hased, nr.4903 përmes Ebu Hurejres r.a.;

[803] Ebu Hanife, "El-Alim ve`l-Mutealim", cituar nga vepra e doc.dr.Ibrahim Emiroglu, "Pesë kryeveprat e Ebu Hanifes", Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2000, fq.64;

[804] Kurani, Ahkaf, 16;

[805] Ibni Kethir-i, "Tefsiri i Ibni Kethirit", FRI, Zyrich, 2011, vëll.7, fq.177;

Po ashtu e lexoi ajetin: **“Pra, për ata që kanë vepruar nuk di askush për atë kënaqësi të fshehtë që u është caktuar atyre si shpërblim”.**[806] Ibni Kethiri në koment të këtij *ajeti* thotë: “Askush nuk e di madhështinë e begative dhe kënaqësive të përhershme që i ka përgatitur Allahu xh.sh. në xhenete e që janë të fshehta për syrin e njeriut. Begati të ngjashme njeriu asnjëherë nuk ka parë. Pasi ata i fshehën veprat e veta, Allahu e fsheh shpërblimin, si kompensim adekuat për atë që kanë bërë. Shpërblimi është nga vet lloji i punës. Hasen el-Basriu ka thënë: “Njerëzit i fshehin veprat e veta, e Allahu ka fshehur për ata, atë që syri nuk e ka parë dhe as që ka mundur ta paramendojë dikush”.[807]

*Kurrete a`jun* – përkthehet si kënaqësi e syrit, që d.m.th. syri i kënaqet me atë që sheh ose kur do t`i jep Zoti, do t`i ngopet syri dhe nuk do të lakmojë diç tjetër.

[806] Kurani, Sexhde, 17;
[807] Ibni Kethir-i, “Tefsiri i Ibni Kethirit”, FRI, Zyrich, 2010, vëll.6, fq.246;

HADITHI I SHTATËDHJETËENJËTË (71)

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ أَبِي شَيْبَةَ، وَأَبُو كُرَيْبٍ، وَإِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، وَاللَّفْظُ لِأَبِي بَكْرٍ، قَالَ إِسْحَاقُ: أَخْبَرَنَا، وَقَالَ الْآخَرَانِ: حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ آدَمَ بْنِ سُلَيْمَانَ، مَوْلَى خَالِدٍ، قَالَ: سَمِعْتُ سَعِيدَ بْنَ جُبَيْرٍ، يُحَدِّثُ عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ: لَمَّا نَزَلَتْ هَذِهِ الْآيَةُ: {وَإِنْ تُبْدُوا مَا فِي أَنْفُسِكُمْ أَوْ تُخْفُوهُ يُحَاسِبْكُمْ بِهِ اللهُ} [البقرة: 284] ، قَالَ: دَخَلَ قُلُوبَهُمْ مِنْهَا شَيْءٌ لَمْ يَدْخُلْ قُلُوبَهُمْ مِنْ شَيْءٍ، فَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " قُولُوا: سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا وَسَلَّمْنَا " قَالَ: فَأَلْقَى اللهُ الْإِيمَانَ فِي قُلُوبِهِمْ، فَأَنْزَلَ اللهُ تَعَالَى: {لَا يُكَلِّفُ اللهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا} [البقرة: 286] " قَالَ: قَدْ فَعَلْتُ " {رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إِصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا} [البقرة: 286] " قَالَ: قَدْ فَعَلْتُ " {وَاغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا} [البقرة: 286] " قَالَ: قَدْ فَعَلْتُ"

Transmeton Ibni Abasi (r.a.) se kur është zbritur *ajet*-i: **"...e për atë që e keni në shpirtin tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët fshehtë, Allahu do t`ju marr në përgjegjësi (llogari)...".** tha: "Zemrat e tyre (*sahab*-ëve) u prekën prej kësaj, kurse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Thoni `dëgjuam, respektuam dhe u nënshtruam`".* Tha: "E kur Zoti e forcoi *iman*-in në zemrat e tyre, atëherë zbritën *ajet*-et: **"Allahu nuk obligon asnjë njeri përtej mundësive të tij, atij i takon ajo që fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që meritoi. Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë...".** (Kur thotë besimtari kështu, *Zoti) thotë: **"Veç e bëra".*** (pastaj ajetin) **"Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh".** (Kur thotë besimtari kështu, *Zoti) thotë: **"Veç e bëra".*** (pastaj *ajet*-in) **"..Na**

i fal mëkatet dhe na mëshiro. Ti je Mbrojtësi ynë...” (Kur thotë besimtari kështu, *Zoti) thotë:* ***“Veç e bëra”.***[808]

Allahu xh.sh. tregoi kujdes të veçantë ndaj këtij *umeti,* sepse nuk dëshiroi t`i rëndojë ashtu siç u rënduan popujt e mëhershëm. Popujt e mëhershëm, ishin të gjykuar me vetvrasje, nëse pendohen nga mëkati i realizuar. Kështu Zoti thotë në Kuran: **“...pendohuni para Krijuesit tuaj dhe mbyteni vetveten. Kjo është më së miri te Krijuesi i juaj...”.**[809]

Kurse për këtë *umet*, u bë lehtësim dhe tolerancë, saqë nuk u merret në llogari përshpëritja e mendjes dhe shpirtit, porse vetëm ajo që shprehet dhe veprohet. Për këtë, kemi dëshmi edhe *hadith*-in që e transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Me të vërtetë, Allahu xh.sh. nuk i llogarit ato që i përshpërit mendja, gjersa të mos fliten ose të veprohet sipas tyre”.*[810]

Për marrjen në llogari për përshpëritjet e *nefs*-it, aludon edhe një *ajet* tjetër, ku thuhet: **“Thuaj: “Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja, ose e publikoni, Allahu e di atë, Ai di gjithçka ka në qiej e çka ka në tokë. Allahu është i Plotëfuqishëm për çdo send”.**[811]

Një gjë e tillë, u erdhi shumë rëndë *sahab*-ëve dhe kështu do të ishte edhe për të gjithë njerëzit deri në fundin e kësaj bote, pasi do ishte vështirë të përballohet një gjë e tillë, por Zoti bëri lehtësim, sepse për këtë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dha këshillat e veta, ku u tha shokëve të vet, të cilët thanë se mund t`i kryejnë detyrat si namazi, agjërimi, *xhihad*-i dhe *sadaka*-ja, porse nuk mund ta përballojnë shfaqjen dhe llogaritjen për ato që kanë në shpirtra. Për këtë, i qetësoi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke iu thënë: *“A doni të thoni, siç thanë ithtarët e dy librave para jush: Dëgjuam dhe kundërshtuam?”*[812] *Jo, por thoni: “Dëgjuam dhe respektuam. Kërkojmë faljen Tënde o Zoti ynë dhe vetëm te Ti është ardhmëria jonë”.*

[808] Muslim-i, “Sahih”, kitab el-Imanu, bab 57, nr.126; Tirmidhi-u, “Sunen”, kitab Tefsir`ul-Kuran, bab min suretil-Bekare (3/40), nr.3003 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Imam Muslim-i e shënon këtë hadith (në nr.125) edhe përmes Ebu Hurejres r.a.;
[809] Kurani, Bekare, 54;
[810] Buhari-u, “Sahih”, kitab el-Itku, bab 6, nr.2528; Muslim-i, “Sahih”, kitab el-Imanu, bab 58, nr.127; etj.
[811] Kurani, Ali Imran, 29;
[812] Në lidhje me këtë deklaratë të pabesimtarëve, shih ajetet: Bekare, 93 dhe Nisa 46;

Kur e pranuan njerëzit këtë dhe e lexuan me gjuhët e tyre, Allahu xh.sh. shpalli *ajet*-et e fundit të *sure*-s Bekare.[813]

Dy *ajet*-et e fundit të sures Bekare, kanë anuluar dhe deroguar *ajet*-et e mëhershme, që flasin për llogaritjen e përshpëritjes së shpirtit dhe mendjes. Taberiu shënon në tefsir-in e tijë mendimet e atyre që e përkrahin këtë mendim.[814]

Kurse për vlerën e këtyre dy *ajet*-eve, flasin *hadith*-e të shumta, ku do të përmendim disa prej tyre.

Transmeton Ebu Mes`ud el-Ensariju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush i lexon dy ajetet e fundit të sures Bekare në mbrëmje, do t`i mjaftojë ajo".*[815]

Transmeton Abdullah b. Mes`udi r.a. se kur i Dërguari i Allahut ishte në *Isra*, ka përfunduar në *Sidretu-l-Munteha*, që është në qiellin e gjashtë, tek ai arrin çdo gjë që ngrihet nga toka dhe aty miratohet, po ashtu në Sidre arrin çdo gjë që zbret prej asaj që është më lart saj dhe aty miratohet, pastaj citoi (ajetin e 16 të sures Nexhëm) tha: "Aty janë shtrojat prej ari". Atëherë Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem iu dhanë 3 gjëra: `Pesë namazet, *ajet*-et e fundit të *sure*-s Bekare dhe premtimi se do t`i falet çdo njeri i cili nuk ka bërë *shirk*".[816]

Transmeton Ebu Dherri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më është dhënë fundi i sures Bekare prej thesareve që gjenden nën Arsh, e nuk i janë dhënë asnjë pejgamberi para meje".*[817]

Transmeton Ibn Abbasi r.a. se: "Në një rast, derisa tek i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte Xhibrili a.s., u dëgjua një kërcitje. Xhibrili shikoi drejt qiellit dhe tha: *"Kjo është për shkak hapjes së një dere të qiellit, e cila nuk është hapur asnjëherë"*. Pastaj shtoi: *"Prej atje zbriti një melek, që i*

[813] Ahmed-i, "Musned", 3/497, nr.2070;
[814] Taberi-u, "Xhamiul Bejan fi te`vili`l-Kuran", vëll.5, fq.130-138;
[815] Buhari-u, "Sahih", kitab Fadail`ul-Kuran, bab 10, nr.5009; Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 43, nr.808; etj.
[816] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 76, nr.173; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiru`l-Kuran, bab min sureti`n-Nexhëm, nr.3287 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Nesai-u, kitab es-Salati, bab 1, nr.452;
[817] Ahmed-i, "Musned", 35/446, nr.21.564; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi, thotë se është Sahih li gajrihi;

erdhi të dërguarit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "Sihariq, për dy drita që të janë dhënë ty, e nuk i janë dhënë asnjë të dërguari para teje: "Fatihat`ul-Kitab" dhe dy ajetet e fundit të sures Bekare. Nuk do të ndodh të lexosh shkronjë prej tyre e mos të jepet ajo që ke kërkuar".[818]

Transmeton Nu`man b. Beshiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, Allahu ka shkruar libër njëmijë vite para se t`i krijojë qiejt e tokën, në të cilën ka zbritur dy ajete në fund të sures Bekare, të cilat nëse lexohen tre net radhazi në një shtëpi, asaj shtëpie nuk do t`i afrohet asnjë shejtan".*[819]

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Janë dy ajete në Kuran, ata do të bëjnë ndërmjetësim, ata i do Allahu xh.sh. këto janë dy ajetet e fundit të sures Bekare".*[820]

Këto janë ndër *hadith*-et më të sakta që flasin për vlerën e këtyre dy *ajet*-eve të fundit, kurse ka edhe shumë *hadith*-e tjera, të cilat do ta zgjasnin tepër këtë temë nëse do të përmendeshin të gjitha, por neve na mjafton të kuptojmë se kanë një veçori të dalluar, si dhe ne si besimtarë, t`i bëjmë ato pjesë e përditshmërisë sonë, si dhe atë t`ua mësojmë fëmijëve, grave dhe të tjerëve, që të përfitojnë nga mirësitë e shumta që ngërthen ajo.

[818] Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 43, nr.806; Nesai-u, "Sunen", kitab Iftitah, bab Fadlu Fatihati`l-Kitab, nr.913;
[819] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Kurani, bab 4, nr.2891 dhe thotë se ky hadith është Hasenu-Garib;
[820] Dejlemi-u, "Firdeus", 1/413, nr.1671;

HADITHI I SHTATËDHJETËEDYTË (72)

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ خَشْرَمٍ قَالَ: أَخْبَرَنَا عِيسَى بْنُ يُونُسَ، عَنْ عِمْرَانَ بْنِ زَائِدَةَ بْنِ نَشِيطٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي خَالِدٍ الوَالِبِيِّ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، قَالَ: " إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى يَقُولُ: يَا ابْنَ آدَمَ تَفَرَّغْ لِعِبَادَتِي أَمْلَأْ صَدْرَكَ غِنًى وَأَسُدَّ فَقْرَكَ، وَإِلَّا تَفْعَلْ مَلَأْتُ يَدَيْكَ شُغْلًا وَلَمْ أَسُدَّ فَقْرَكَ«

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë Allahu xh.sh. thotë:* ***"O biri i Ademit, përpiqu në adhurim ndaj Meje, e Unë do ta mbush gjoksin me pasuri dhe do t`i laj borxhet (do ta largoj varfërinë), e nëse nuk e bën këtë, do të angazhoj duart e tua (me preokupim) dhe nuk do ta laj borxhin (nuk do të siguroj nga varfëria)".***[821]

Adhurimi i Zotit është ecenca e ardhjes së njeriut në këtë botë dhe qëllimi final, pasi kjo botë është kalimtare dhe e përkohshme. Për këtë shkak, njeriu duhet të preokupohet në arritjen e kënaqësisë së Zotit, përmes adhurimit të Tij dhe largimit nga gjërat të cilat Ai i ka ndaluar. Në këtë *hadith*, Zoti u premton bijëve të Ademit a.s. se nëse ata do ta preokupojnë veten me adhurim, Zoti do t`u jep bereqet në pasurinë e tyre dhe do t`i bëjë të pavarur ndaj pasurisë, sepse lakmia pas pasurisë, është dëmi më i madh që i ka goditur njerëzit në të gjitha kohërat. Edhe vërejtja e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte që të kemi kujdes nga depërtimi i dashurisë ndaj pasurisë në zemrat tona. Ai na tregoi se sprova e këtij *umet*-i do të jetë pasuria. Transmeton Ka`b b. Ijadi el-Esh`arij r.a. se Pejgamberi sal-lallahu

[821] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 30, nr.2474 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 2, nr.4107; Ahmed-i, "Musned", vëll.14, fq.321, nr.8696; Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/481, nr.3657 dhe thotë se "hadithi është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar", me këtë pajtohet edhe Dhehebiu;

alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, çdo popull (ummet) e ka pasur sprovën e vet, kurse sprova e popullit tim është pasuria".*[822]

Këtë e konfirmon edhe Abdurahman b. Aufi radijeAllahu anhu i cili thotë: "U sprovuam gjatë kohës së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem me skamje e varfëri por duruam, pas tij u sprovuam me të mira dhe bollëk, por nuk arritëm të bëjmë durim *(sabër)*".[823]

Prandaj, njeriu duhet të jetë shumë i kujdesshëm të mos bie në këtë sprovë e cila është shumë e këndshme, sepse epshi i njeriut e lakmon kënaqësinë, kurse rënia në të është shumë e lehtë. Për këtë, këshilla e këtij *hadith*-i është që të angazhojmë shpirtin me adhurim, që të mos biem pre e kësaj sprove e cila mund të na devijoj nga rruga e mirë.

Në këtë kontekst, mund të përmendim edhe *hadith*-in që e përcjell Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e ka preokuptim ahiretin, Allahu do t`i jep pasuri në zemër dhe do t`ia përmbledh punët e tija dhe do t`ia jep hisen e dunjasë edhe nëse ai nuk e donë, e kush e ka preokupim dunjanë, Allahu do t`ia jep varfërinë pranë dy syve të tij, do t`ia shkapërderdh punët dhe nuk do të merr nga kjo botë përpos se atë që i është caktuar".*[824]

Nëse njeriu do të largohet nga kënaqësitë e kësaj bote, do të pasurohet zemra e tij me kënaqësi në atë që posedon, kështu do të jetë i dashur tek Zoti dhe tek njerëzit. Por, nëse lakmon në atë që është në duart e njerëzve, atëherë zemra e tij do të varfërohet dhe do të fillojë nënçmimi i tij në sytë e njerëzve.

Transmeton Sehël b. Sa`d es-Saadijju radijeAllahu anhu se një njeri erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më mëso një vepër që nëse e veproj, do të më doj Allahu dhe njerëzit?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Mos lakmo dynjanë, do të dojë Zoti, mos lakmo atë që është në duart e njerëzve dhe ata do të duan".*[825]

---

[822] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab ma xhae enne fitnete hadhihi`l-ummeti fi`l-mal, nr.2343 dhe thotë se ky hadith është Hasenun-Sahihun-Garib;

[823] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 30, nr.2472 dhe thotë se hadithi është Hasen;

[824] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 30, nr.2473;

[825] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 1, nr.4102; Busiri-u në "Zevaid", thotë se në zinxhirin e hadithit, gjendet Halid b. Amër i cili është i dobët, për dobësinë e të cilit ka

Të jeshë i kënaqur me atë që të ka caktuar Zoti, është edhe pjesë e besimit në Caktimin e Zotit, sepse njeriu duhet të jetë i bindur se atë që e posedon, është ajo që ka qenë pjesë e caktuar e tij, e atë që nuk e posedon, nuk ka qenë e destinuar për të, andaj nuk ka nevojë të lakmojë pasurinë e tjetërkujt.

Pasuria e vërtetë është besimi në zemër, nëse njeriu e posedon këtë, atëherë është më i pasuri i botës, e nëse nuk e posedon imanin, ai do të ngel i varfër, po edhe nëse ka miliona në duart e tija. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk është pasuria në shumëzimin e mallit, porse pasuri është pasuria e shpirtit".*[826] E kush e gjenë këtë rrugë, ka gjetur rrugën e shpëtimit në këtë botë dhe botën tjetër *(ahiret).*

Nëse njeriu e mbush zemrën e tij me *iman*, me sinqeritet, me mbështetje në Zotin e gjithësisë dhe me vepra të mira, atëherë Zoti atë do ta pasurojë me ndihmë, mbështetje dhe siguri, do t`ia largojë nënçmimin dhe do ta bëjë të pavarur nga njerëzit. Ky njeri nuk do të varfërohet dhe nuk do të vlerësojë botën ndaj *ahiret*-it, do të jetojë krenarë ditën dhe do të flejë i qetë natën. Por, nëse njeriu nuk angazhohet me adhurim, por me kërkimin e dunjasë, ai çdoherë do të jetë i preokupuar e asnjëherë i pasuruar, ai i ngjan njeriut i cili vazhdimisht vrapon të kapë hijen e tijë, porse nuk e kap dot. Zemra e tijë do të jetë e mbushur me varfëri, edhe nëse në duar ka të holla, sepse e ka mbuluar zemrën e tijë dashuria ndaj kësaj bote dhe kjo lakmi, e ka zënë në zemrën e tij vendin e imanit dhe sineritetit.

Lakmia pas kësaj bote, i ngjan ujit të kripur të detit, sa më shumë që pi prej tijë, aq më shumë të shtohet etja. Edhe njeriu, sa më shumë që kap pasuri, aq më shumë i shtohet lakmia për ta shtuar atë, saqë nëse do të kishte një kodër me ari, do të dëshironte të ketë edhe tjetrën. Transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sikur njeriu t`i ketë dy lugina me pasuri, do të dëshironte ta kishte edhe të tretën. Nuk e mbush syrin e njeriut asgjë, përpos dheut".*[827]

---

konsensus, gjithashtu është i akuzuar për falsifikim të haditheve. Këtë hadith e refuzon Ukajli duke thënë se nuk ka bazë ky hadith i cili përcillet përmes Sufjan eth-Theurit. Ndërsa Neveviu për këtë hadith thotë: "E përcjell Ibni Maxheh dhe të tjerë me zinxhir të mirë –hasen".

[826] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab El-gina gine`l-nefsi, nr.6446; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 40, nr.1051; etj.

[827] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 10, nr.6439; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 39, nr.1048; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 27, nr.4235 nga Ebu

Nuk është edhe e pakuptimtë fjala e një personi, i cili tha: "Disa njerëz janë aq të varfër, saqë nuk kanë asgjë tjetër përpos parave".

Edhe ne, nëse duam suksesin dhe fitoren, duhet të angazhohemi me adhurim dhe mbështetje në Zot, të punojmë për të siguruar furnizimin, pa e harruar *ahiret*-in, në këtë mënyrë Zoti do na jep sukses dhe do të na largojë varfërinë. Nëse ne i japim përparësi punës dhe kësaj bote, atëherë Zoti do na angazhojë tërë kohën me angazhime, nuk do kemi kohë për asgjë, kurse përsëri do të ngelim të varfër dhe të humbur. Allahu xh.sh. na mbroftë nga kjo gjendje. Për këtë, aludon edhe fjala e Tij në Kuran**: "Dhe (pëkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: "Nëse falënderoni, do t'ua shtojë të mirat, e nëse përbuzni, s'ka dyshim, dënimi Im është i ashpër!".**[828]

Hurejre, kurse Busiriu në "Zevaid", në vlerësim të këtij hadithi, thotë se është hadith Sahih, ndërsa transmetuesit janë të besueshëm.

[828] Kurani, Ibrahim, 7;

HADITHI I SHTATËDHJETËETRETË (73)

أَخْبَرَنَا أَبُو الطَّاهِرِ مُحَمَّدُ بْنُ الْحُسَيْنِ الْمَوْصِلِيُّ، أبنا عَلِيُّ بْنُ عُمَرَ الْحَرَّانِيُّ السُّكَّرِيُّ، ثنا أَحْمَدُ هُوَ ابْنُ الْحَسَنِ بْنِ عَبْدِ الْجَبَّارِ الصُّوفِيُّ، ثنا الْحُسَيْنُ بْنُ حَمَّادٍ، ثنا عَمْرُو بْنُ هَاشِمٍ، عَنْ جُوَيْبِرٍ، عَنِ الضَّحَّاكِ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى نَادَى مُوسَى عَلَيْهِ السَّلَامُ بِمِئَةِ أَلْفٍ وَأَرْبَعِينَ أَلْفِ كَلِمَةٍ وَصَايَا كُلُّهَا، فَكَانَ فِيمَا نَاجَاهُ أَنْ قَالَ لَهُ: يَا مُوسَى إِنَّهُ لَمْ يَتَصَنَّعِ الْمُتَصَنِّعُونَ لِي بِمِثْلِ الزُّهْدِ فِي الدُّنْيَا، وَلَمْ يَتَقَرَّبِ الْمُتَقَرِّبُونَ بِمِثْلِ الْوَرَعِ عَمَّا حَرَّمْتُ عَلَيْهِمْ، وَلَمْ يَتَعَبَّدِ الْمُتَعَبِّدُونَ بِمِثْلِ الْبُكَاءِ مِنْ خِيفَتِي "

Transmeton Ibni Abasi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. e ka thirrur Musën a.s. me njëqindekatërdhjetëmijë (140.000) fjalë që të gjitha ishin urdhëresa, e prej atyre me të cilat e thirri Musaun a.s. ishte edhe fjala që i tha atij:* ***"O Musa, nuk mund të veprojë vepruesi diç në këtë botë për Mua të ngjashme me Zuhdin, e as që mund të më afrohet afruesi me diç të ngjashme sesa me nënshtrimin ndaj asaj që ia kam ndaluar, e as që mund të më adhuroj adhuruesi me diç më të mirë sesa me të qarët prej frikës Sime".***[829]

Në këtë tekst shohim zhvillimin e një bisede në mes pejgamberit të zgjedhur Musës a.s. dhe Zotit i Cili i është drejtuar atij me Fjalë pa ndërmjetës.

[829] Muhamed b. Selame el-Kadai, "Musnedu`sh-Shihab", Muessesetu`r-risale, Bejrut, botimi i parë, 1985, vëll.2, fq.328, nr.1458; këtë hadith por me shtesë, e shënon edhe Taberani-u, në "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.4, fq.188, nr.3937; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 10/384, nr.18.125 thotë: "E transmeton Taberani në "Euset", por në zinxhir gjendet Xhuvejbir b. Seidi i cili është i dobët"; Humejdi Abdulmexhid es-Selefi në verifikim të Musned-it të Shihabit, për këtë hadith thotë se Xhuvejbiri është i braktisur (metruk), ka transmetues të panjohur dhe ka ndërprerje në mes Dahakut dhe Ibni Abasit r.a.;

Këtë fakt e potencon Zoti në shumë *ajet*-e kuranore, në të cilat thotë: **"..e Musait i foli Allahu me fjalë".**[830]

Për numrin të cilin e përmend në këtë tekst (140.000) nuk do të thotë se me çdo kusht duhet të jetë i saktë, por është e vërtetë e pamohueshme se Zoti ka folur me Musain a.s.

Prej veprave të mira të cilat i lavdëron Zoti në këtë bisedë, është asketizmi ose siç njihet në terma fetar *Zuhdi. Zuhdi* në aspekt gjuhësor nënkupton të përmbahesh, abstenosh, indiferencë, heqje dorë, braktisje, asketizëm, modesti, i matur e shumë kuptime tjera.[831]

Në kuptim më të ngushtë, nënkupton braktisjen e kënaqësive të kësaj bote dhe zhvillimin e jetës asketike, larg luksit dhe dëfrimit. Po ashtu nënkupton largimin nga gjërat të cilat nuk të bëjnë dobi në botën tjetër. Në Kuran gjejmë shumë ajete të cilat nxisin largimin nga kënaqësitë dhe mashtrimet e kësaj bote dhe insistimin në vepra të cilat do të bëjnë dobi në botën tjetër, kurse me nocionin `*zuhd*` e hasim nëpër shumë *hadith*-e të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ku aludohet në braktisjen e kënaqësive të kësaj bote dhe përgatitjen për botën tjetër. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem na përkujtoi se Xheneti i besimtarit nuk është në këtë botë, por në botën tjetër. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Bota është burg i besimtarit dhe Xhenet i pabesimtarit".*[832]

Ngjashëm me këtë *hadith*, i cili tregon se kjo botë nuk ka vlerë, është transmetimi nga Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kaloi në një anë të tregut dhe njerëzit ishin të mbuluar me rrobe, ai kaloi pranë një cjapi të vogël, i cili kishte ngordhur. E kapi për veshi dhe tha: *"Kush dëshiron që kjo të jetë e tij për një dirhem?".* Ata thanë: "Ky nuk do të kishte vlerë edhe të ishte i gjallë, e çka të bëjmë me të pasi ka ngordhur?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Pasha Allahun, kjo botë është më e pavlefshme te Zoti sesa ky cjap".*[833]

Shumë mirë na sqaron në *hadith*-in tjetër se çka në realitet ka njeriu prej kësaj bote, e çka ngelet këtu dhe askush nuk e merr me vete. Transmeton

[830] Kurani, Nisa, 164;
[831] Isa Memishi, "Fjalor arabisht-shqip", vëll.1, fq.773;
[832] Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zuhdu, nr.2956; etj.
[833] Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zuhdu, nr.2957; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab et-Tahareti, bab 73, nr.186;

Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Robi thotë: "Pasuria ime, pasuria ime". Por njeriut i takojnë tre gjëra: "Atë që ka ngrënë dhe është zhdukur, atë që ka veshur dhe është prishur, atë që ka harxhuar dhe është paksuar. E çka është jashtë këtyre, ajo do të ngelet te njerëzit tjerë".*[834] Ose *hadith*-i tjetër nga Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njeriun e ndjekin tre gjëra, dy prej tyre kthehen kurse ngelet vetëm njëra. E përcjellin familja, pasuria dhe puna e tij, përderisa familja dhe pasuria kthehen, me të ngelet vetëm puna e tij".*[835]

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem na këshilloi që të qëndrojmë afër atyre të cilët janë asket dhe të cilët flasin pak, por kur flasin diç, prej tyre dalin fjalë si perla. Transmeton Ebu Hal-ladi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nëse shihni një njeri të cilit i është dhënë zuhdi (indiferenca) nga kjo botë dhe i cili flet pak, atëherë qëndroni pranë tij sepse prej tij dalin vetëm urtësi".*[836]

Po ashtu Allahu xh.sh. e donë njeriun i cili e ka braktisur kënaqësinë e kësaj bote dhe jeton për kënaqësinë e Allahut xh.sh. Transmeton Sehël b. Sa`d es-Saadijju radijeAllahu anhu se një njeri erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më mëso një vepër që nëse e veproj, do të më dojë Allahu dhe njerëzit?" Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Mos lakmo dynjanë, do të dojë Zoti, mos lakmo atë që është në duart e njerëzve dhe ata do të duan".*[837]

Në këtë kontekst, është edhe *ajet*-i kuranor ku thotë: **"Ashtu që të mos dëshproheni tepër për atë që u ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai u ka dhënë, pse All-llahu nuk e do asnjë arrogant që u lavdërohet të tjerëve".**[838] Kjo është esenca e *Zuhdit*, që njeriu të mos dëshpërohet kur humb diçka nga kjo botë, e as të gëzohet pa masë kur fiton diçka prej kënaqësive të kësaj bote.

---

[834] Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zuhdu, nr.2959; Ahmedi, "Musned", 14/411, nr.8813;
[835] Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zuhdu, nr.2960; etj.
[836] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab zuhdu fi dunja, nr.4101;
[837] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 1, nr.4102; Busiri-u në "Zevaid", thotë: "Në zinxhirin e hadithit, gjendet Halid b. Amër i cili është i dobët, për dobësinë e të cilit ka konsensus, gjithashtu është i akuzuar për falsifikim të hadittheve. Këtë transmetim e refuzon Ukajli duke thënë se nuk ka bazë ky hadith i cili përcillet përmes Sufjan eth-Theurit. Ndërsa Nevevi-u për këtë hadith thotë: "E përcjell Ibni Maxheh dhe të tjerë me zinxhir të mirë –hasen".
[838] Kurani, Hadid, 23;

Pjesa e dytë prej vlerave të cilat i kërkohen besimtarit dhe me të cilat Zoti është i kënaqur, është nënshtrimi ndaj urdhrit për t`u larguar nga ndalesat e Zotit. *Zuhdi* është të largohesh nga gjërat të cilat nuk të bëjnë dobi në *ahiret*, kurse *Vere`a* është të largohesh nga gjërat prej të cilave ke frikë se mund të dëmtojnë në *ahiret*. Edhe *vere`a* është degë dhe pjesë prej pjesëve të asketizmit. Ajo nënkupton që të kesh kujdes në veprimet e tua, që të kesh kujdes në ushqimin, pijen dhe veshjen se në cilën mënyrë fitohen. Përmes kësaj cilësie, i afrohemi kënaqësisë së Allahut xh.sh. më së shumti, në bazë të këtij *hadith*-i. Në këtë drejtim, mund të përmendim edhe *hadith*-in që e transmeton Atije b. Sa`diju r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njeriu nuk mund të arrijë të bëhet prej të devotshmëve, derisa nuk e lë edhe atë që nuk prish punë, nga frika (që mos bie në atë) që prish punë".*[839]

Hudhejfe r.a. përcjell prej Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili ka thënë: *"Vlera e diturisë, është më e mirë sesa vlera e ibadeteve, kurse çështja më e mirë e fesë është "el-vere`u" (maturia)".*[840]

Gjithashtu e kemi edhe transmetimin e Vathile b. Eska r.a. se atij i ka thënë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në lidhje me "*el-vere`u*": *"Ajo nënkupton të braktisësh gjërat e vogla, që të mos biesh në gjërat e mëdha"* po ashtu i ka thënë: *"se "el-vere`u" ka kuptimin e ndalimit të vetes nga gjërat e dyshimta".*[841]

Dhe pjesa e tretë e këtij *hadith*-i, vë në fokus të qajturit e njeriut, nga frika prej Zotit. Kjo nënkupton që njeriu të qajë kur të kujtojë mëkatet e veta, të qajë kur të kujtojë dënimin e Zotit, por edhe Mëshirën e Tij, sepse të qajturit vjen ose prej frikës ose prej gëzimit. Qarja është cilësi njerëzore dhe vjen si pasojë e emocionit. Qarja vjen si zakonisht pas mërzisë dhe pikëllimit, shkaku i ndonjë dhimbjeje ose humbjeje të diçkaje të shtrenjtë.

Të qajturit e shton edhe më shumë përkuljen dhe devotshmërinë në zemrën e besimtarit, sidomos gjatë dëgjimit të Kuranit. Zoti thotë në Kuran: **"Dhe**

[839] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 19, nr.2459 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 24, nr.4215;
[840] Taberani-u, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.4, fq.196, nr.3960;
[841] Taberani-u, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.22, fq.78, nr.193;

duke qarë hidhen me fytyra dhe ai (leximi i Kuranit) ua shton edhe më shumë përuljen".[842]

Gjersa përmend pejgamberët dhe pasardhësit e mirë të tyre, thotë: **"...kur u lexoheshin atyre ajetet e Zotit, binin në sexhde dhe qanin".**[843]

Për vlerën e dridhjes së zemrës nga përkujtimi i Allahut xh.sh. na flet edhe *ajet*-i: **"Kur e përkujtojnë Allahun, u dridhen zemrat".**[844]

Për vlerën e të qajturit prej frikës nga Allahu xh.sh. flasin shumë *hadith*-e, por ne do të veçojmë vetëm disa, për të kuptuar rëndësinë e këtij veprimi dhe për të kuptuar *hadith*-in më mirë. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Shtatë kategori njerëzish do të hyjnë nën Hijen e Arshit, atë ditë kur nuk ka hije tjetër përpos hijes së tij":* Prej tyre ka përmendur: *"Njeriu i cili e përkujton (dhikër) Allahun në vetmi dhe i lotojnë sytë".*[845]

Përveç që njeriu do të jetë nën Hijen e *Arsh*-it, ai që qanë nga frika e Zotit, nuk do të dënohet me Xhehenem në *Ahiret*. Transmeton Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu nuk dënon për lotin e syrit e as pikëllimin e zemrës, por dënon për këtë (*dhe bëri me shenjë te gjuha*)".*[846]

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk do të hyjë në Zjarr ai i cili qanë nga frika prej Zotit, derisa të mundet të kthehet qumështi në gji dhe nuk mund të bashkohet pluhuri në rrugë të Allahut me tymin e Xhehenemit".*[847]

Transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Dy lloje sysh nuk i prek zjarri i Xhehenemit, një sy i cili qanë prej frikës së Zotit dhe një sy i cili rri zgjuar si roje në luftë për në rrugë të*

[842] Kurani, Isra, 109;
[843] Kurani, Merjem, 58;
[844] Kurani, Enfal, 2;
[845] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab men xhelese fi`l-mesxhidi jentedhiru`s-salate, nr.660; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab fadlu ihfai`s-sadakati, nr.1031; etj.
[846] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab bukau indel meridi, nr.1304; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab el`bukau ale`l-mejit, nr.924; etj.
[847] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Xhihadi, bab fadlu`l-gubari fi sebililah, nr.1633 dhe thotë se është Hasenun-Sahih, etj.

Allahut".[848] I ngjashëm me këtë *hadith*, është edhe transmetimi tjetër që përcillet nga Behz b. Hakimi nga babai e ai nga gjyshi i tij, se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre persona, syri i tyre nuk do ta sheh Zjarrin: "Syri i cili ri zgjuar duke bërë roje në rrugë të Allahut, syri që loton nga frika prej Allahut dhe syri i cili është larguar nga e ndaluara (harami)".*[849]

Po ashtu, prej gjërave që dëshiron t`i sheh Zoti te robi i Tij, janë edhe lotët prej frikës së Tij. Transmeton Ebu Umame r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ka gjë më të dashur te Zoti sesa dy pika dhe dy gjurmë. E do pikën e lotit i cili bie prej frikës së Zotit dhe pikës së gjakut që derdhet në rrugë të Allahut. Kurse sa për dy gjurmët, njëra gjurmë është gjurma që lë në rrugë të Allahut dhe gjurma në farzet prej farzeve të Zotit".*[850]

Duhet ta kemi të qartë, se loti dhe qarja të cilën e do Zoti është kur buron nga zemra dhe rrjedh prej frikës së Tij, e jo qarja prej ndonjë problemi tjetër, ose kur ndodh për mashtrim, sepse shumë lavire ka që qajnë derisa t`i bindin të tjerët se janë të pafajshme, e kështu është edhe me fajtorë të tjerë, prandaj, duhet dalluar qarjen.

Po ashtu, nuk do të thotë se çdo ligjërues i cili qanë gjatë ligjeratës, është në të drejtë, pasi mund ta shfrytëzojë atë si një mekanizëm për të depërtuar në zemrat e njerëzve, ndërsa nga ana tjetër të ketë qëllime të mbrapshta. Siç na tregon Zoti në Kuran për vëllezërit e Jusufit a.s. të cilin e hodhën vëllezërit e vet në pus, pastaj para babait qanin sikur janë të pafajshëm. Thotë Zoti: **"dhe në mbrëmje erdhën te babai i tyre duke qarë".**[851] Pra, qarja nuk është argument se folësi është i sinqertë.

[848] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Xhihadi, bab fadlu`l-haresi fi sebililah, nr.1639 dhe thotë se është Hasenun-Garib;
[849] Taberani-u, "Mu`xhem`ul-Kebir", vëll.19, fq.416, nr.1003;
[850] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadail`ul-Xhihadi, bab ma xhae fi fadli`l-murabiti, nr.1669 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib;
[851] Kurani, Jusuf, 16;

NAMAZI

HADITHI I SHTATËDHJETËEKATËRTË (74)

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: فإِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " قَالَ اللهُ تَعَالَى: قَسَمْتُ الصَّلَاةَ بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي نِصْفَيْنِ، وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ، فَإِذَا قَالَ الْعَبْدُ: {الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ} [الفاتحة: 2] ، قَالَ اللهُ تَعَالَى: حَمِدَنِي عَبْدِي، وَإِذَا قَالَ: {الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ} [الفاتحة: 1] ، قَالَ اللهُ تَعَالَى: أَثْنَى عَلَيَّ عَبْدِي، وَإِذَا قَالَ: {مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ} ، قَالَ: مَجَّدَنِي عَبْدِي – وَقَالَ مَرَّةً فَوَّضَ إِلَيَّ عَبْدِي – فَإِذَا قَالَ: {إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ} [الفاتحة: 5] قَالَ: هَذَا بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي، وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ، فَإِذَا قَالَ: {اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ} [الفاتحة: 7] قَالَ: هَذَا لِعَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ "

Transmeton Ebu Hurejre (*r.a.*) nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili ka thënë: "*Ka thënë Allahu xhele she`nuhu:* ***"Namazin e kam ndarë më dysh në mes Meje dhe robit Tim dhe robit Tim i takon ajo që kërkon. Kur robi thotë:*** **"El Hamdu lil-lahi rabbil alemin" (Falënderimi absolut i takon Allahut Zotit të botëve)"** ***Zoti thotë: "Robi Im më ka falënderuar". Kur thotë:*** **"Er-Rahmani`r-Rahim" (I gjithëmëshirshmi, Mëshiruesi)",** ***Zoti thotë: "Robi im më ka lartësuar". Kur thotë*****: "Maliki jeumi`d-din" (Sunduesit të Ditës së Gjykimit)",** ***Zoti thotë: "Robi im më ka lavdëruar". Kur thotë:*** **"Ijjake nea`budu ve ijjake nestein" (Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti mbështetemi)",** ***thotë (Zoti): "Kjo është në mes Meje dhe robit Tim, kurse atij i takon ajo që kërkon". Kur thotë (njeriu):*** **"Ihdine`s-Siratal mustekim, Siratal-ledhine en`amte alejhim gajri`l-magdubi alejhim ve le`d-dalin" (Na udhëzo në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre të cilët i ke bekuar, e jo të atyre ndaj të cilëve je i hidhëruar dhe që**

kanë humbur)”, *thotë (Zoti): “Kjo i takon robit Tim, atij i takon ajo që kërkon”.*[852]

Në këtë *hadith Kudsij,* na bëhet e qartë vlera madhështore që ngërthehet në kaptinën e parë të Librit Hyjnorë, në *suren El-Fatiha*, e cila është edhe *sureja* fillestare me të cilën fillon *Mus`hafi,* është prej kaptinave të para të shpallura në Meke dhe është ndër kaptinat më madhështore për nga përmbajtja, me vetë faktin që legjislacioni Islam, e kërkoi prej nesh që ta lexojmë gjatë çdo *rekati* në *namaz,* pasi është thelbi i Kuranit dhe çelësi i tij, për të depërtuar në brendësinë e urtësive hyjnore. Është çelësi i dyerve të udhëzimit dhe të vërtetës, si dhe çelës për mbylljen e dyerve të devijimit.

Pra, të përsëriturit kaq shumë të *sure*-s Fatiha në mesin e besimtarëve, qoftë ajo në namaz ose jashtë saj, nuk është diç tjetër vetëm se i përfshin të gjitha parimet e Fesë Islame e cila duke u filtruar më pas jep edhe si rezultat tërë Kuranin. *Fatiha* është një pishtar në rrugën drejt Allahut xh.sh. duke e lajmëruar njerëzimin që të shmanget nga ecjet pas çdo të keqeje e cila mbart me vete hidhërimin e Zotit.

Nuk është zbritur në asnjë prej Librave të mëparshëm diçka e ngjashme me këtë *sure*, as në Teurat e as në Inxhil. Transmeton Ubejje b. Ka`bi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Thotë Allahu xh.sh.: **“Nuk ka as në Teurat, as në Inxhil si Ummu`l-Kurani (Fatihaja), ajo është shtatë të përsëriturat, ajo është e ndarë në mes Meje dhe robit Tim, kurse robit i takon ajo që kërkon”.***[853]

Vetë zbritja e kësaj kaptine tek i Dërguari i Allahut ka ndodhur në mënyrë madhështore, siç tregon vetë ai, se ka qenë në shoqërim të melekut Xhibril, kur në një çast është dëgjuar një kërcitje. Kur shikoi drejt qiellit, Xhibrili tha: “Kjo është për shkak të hapjes së një dere në qiell, e cila derë nuk është hapur kurrë më parë, prej së cilës zbriti një melek i cili të përgëzon me dy drita që të janë dërguar, ato janë *sureja* Fatiha dhe dy *ajet*-et e fundit të

[852] Muslim-i, “Sahih”, kitab es-Salatu, bab 11, nr.395; Tirmidhi-u, “Sunen”, kitab Tefsiri`l-Kuran, bab 1, nr.2962; Ebu Davud-i, “Sunen”, kitab es-Salati, bab 137, nr.821; Nesaiu, “Sunen”, kitab es-Salati, bab 23, nr.910; etj.

[853] Ibni Hiban-i, “Sahih”, kitab Rikak (7), bab kiraeti`l-Kuran, nr.775; e shënon edhe Tirmidhi-u, “Sunen”, kitab Tefsiru`l-Kuran, bab suretu Hixhër, nr.3136 por jo si hadith kudsij;

sures Bekare! Nuk do të ndodh të lexosh shkronjë prej tyre e mos të jepet ajo që ke kërkuar".[854]

Fakt se Zoti në *hadith* e quajti këtë kaptinë *salat* (namazi) nënkupton se Ai e ka ndarë leximin e kësaj kaptine në dy pjesë, njëra i kushtohet lavdërimit të Zotit e pjesa tjetër është lutje drejtuar Atij, porse për nga vlera që ngërthen kjo *sure*, Allahu e quajti `namaz` e jo Fatiha, prandaj edhe nuk është i vlefshëm namazi pa leximin e kësaj *sure*-je sipas disa dijetarëve.[855]

Gjithashtu, është quajtur *Ummu`l-Kitab* (nëna e librit) ose baza e këtij librit, sepse ka ngërthyer në vete të gjitha elementet që trajtohen në të.

Nga fakti se ne e lexojmë atë 40 herë brenda ditës, 17 herë brenda namazeve të obliguara dhe 23 herë gjatë namazeve vullnetare, tregon për vlerën universale të kësaj kaptine madhështore, sepse ne së paku katërdhjetë herë brenda ditës jemi në bisedë të drejtpërdrejtë me Zotin e gjithësisë, sidomos kur meditojmë se bisedën e fillojmë me këtë kaptinë të mrekullueshme, e cila fillon me manifestimin e falënderimit të përgjithshëm dhe përfundon me lutje drejtuar Atij i Cili plotëson kërkesat.

Ajo përmban një përmbledhje të shkurtër të doktrinave Islame si dhe besëlidhjen e pashkëputur e cila manifestohet mes njerëzve dhe Zotit të tyre. Kjo *sure*, ngërthen në vete mirësi të shumta, pasi është një bisedë e drejtpërdrejtë në mes robit dhe Zotit, me çka tregohet përkulja e robit përpara Sunduesit Suprem dhe paraqitja e nevojës njerëzore për mbështetjen në Fuqinë Absolute. Në këtë dialog, shihet dimensioni shpirtëror i adhurimit, ku njeriu duhet të zhvishet nga të gjitha cilësitë negative, duke u munduar ta përsos shpirtin dhe moralin e tij pasi të përfundojë dhe të del prej namazi, sepse ai ka dalë nga biseda me më të Lartin, Zotin e gjithçkaje.

Në këtë *hadith*, manifestohet qëndrimi i Zotit ndaj lutjes së besimtarit, i cili kur drejtohet për të falur namazin, Allahu xhele she`nuhu e dëgjon me

[854] Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 43, nr.806; etj.

[855] Sipas medhhebit Hanefi, leximi i sures Fatiha në namaz është vaxhib (shih: Meusili, "El-Ihtijar", Daru`l-Hadith, Kajro, 2001, vëll.1, fq.101), ndërsa leximi i Fatihasë në rekatin e tretë dhe të katërt në namazet farz, është sunet. (Muhamed b. Hasen esh-Shejbani, "El-Aslu", vëll.1, fq.138) Imam Kuduri thotë: "Kiraeti (leximi Kuran në namaz) është vaxhib në dy rekatet e para në namazet farze, kurse në dy rekatet e fundit nëse do lexon Fatihanë, nëse do hesht apo mund të bëjë tesbih. Leximi në namazet nafile është vaxhib në të gjitha reqatet dhe në çdo rekatë të vitrit". (Kuduri, "Muhtesar", Daru`s-Selam, botimi i parë, 2013, fq.32);

përkushtim, pasi Zoti dëshiron të dëgjojë zërin e robit të Tij i cili i drejtohet vetëm Atij, ku thotë edhe në Kuran, se është afër robërve të Vet kur ata i luten dhe u përgjigjet në lutjet e tyre,[856] për këtë edhe u konsiderua lutja adhurim në vete.

Nga fjala e parë në këtë kaptinë, neve na bëhet me dije se kush është meritorë për t`ia shprehur falënderimet tona, sepse Ai na furnizoi me të gjitha mirësitë, na dha shëndet dhe trup të mirë, na dha pasuri dhe fëmijë, e shumë gjëra të tjera të cilat njeriu asnjëherë nuk mund t`i numërojë. Për gjitha këto të mira, ne duhet të shprehim falënderim ndaj Zotit i Cili ka krijuar dhe drejton të gjitha universet dhe galaktikat.

Allahu xh.sh. është mirënjohës ndaj falënderimit që e shprehim, pasi në këtë *hadith*, kuptojmë se në çdo rast që njeriu e shqipton gjatë namazit ajetin e parë të kësaj kaptine, Allahu xhele she`nuhu thotë: ***"Më falënderoj robi Im"***, me çka shohim se Zoti e dëshiron mirënjohjen, andaj për shkak këtij lavdërimi që na e mësoi vetë Ai në Kuran, në fund të kësaj kaptine, premton se do të pranojë kërkesat dhe lutjet që i bëjmë, pasi jemi treguar mirënjohës ndaj begative të tij duke shprehur falënderim. Edhe pse Zoti është i falënderuar para se ta falënderojnë krijesat, edhe pse Ai nuk ka nevojë për falënderimin e krijesave, përsëri shfaq mirënjohje për lëvdatat e tyre.

Ne duhet të jemi falënderues edhe për faktin se Zoti na mësoi se si ta falënderojmë, së paku përmes këtyre dy fjalëve: *`El-hamdu-lilah`*, sepse sikur mos të na mësonte këtë, ne nuk do të dinim as ta falënderojmë, e ky mësim vjen prej gjerësisë së Mëshirës së Tij ndaj krijesave, që është meritori të bartë këto dy emra të bukur *Er-Rahmani`r-Rahim.*

Pa marrë parasysh se sa njeriu kërkon prej Zotit, Ai nuk varfërohet, sepse Ai është pronari i çdo gjëje në qiej dhe në tokë, Ai është i Pasuri absolut, thesaret e të Cilit nuk shteren prej kërkesave të njerëzve. Kur të kërkojë besimtari, le të kërkon tek Zoti i tij, i Cili është i Pasur dhe Bujar, nuk është koprrac dhe nuk ndalon së ndihmuari robërit e Tij, pasi Ai turpërohet që t`ia kthejë duart zbrazur atij të cilit ngrit duart dhe i lutet vetëm Zotit.

Vetëm prej Allahut xh.sh. kërkohet mbrojtja, udhëzimi, mbështetja, falja dhe mirësia, andaj besimtari duhet të jetë sa më i lidhur me namazin, që të jetë vazhdimisht në hijen e kësaj kaptine e cila besimtarit i siguron paqe dhe siguri.

[856] Kurani, sure Bekare, ajeti 186 dhe në sure Gafir, ajeti 60;

Kjo kaptinë përfshinë mirësi të shumta, saqë nuk mund të arrijmë dot t`i numërojmë, sepse përpos që është shërim i shpirtit dhe arsye që Zoti t`u përgjigjet lutjeve tona, është edhe shërim për trupin, gjë e cila dëshmohet me *hadith*-in kur Ebu Seid el-Hudriju r.a. kishte qenë i thirrur nga një fis arab, që t`i lexojë diçka kryetarit të tyre i cili ishte kafshuar nga një akrep, ky *sahab*-i i lexoi atij *sure*-n Fatiha dhe ai u shërua. Ky fis si mirënjohje ndaj këtij veprimi fisnik, i dhuruan një tufë dhensh. Kur u kthyen tek i Dërguari i Allahut, ai i pyeti se prej nga e kishin marr këtë dhuratë? Kur ia shpjeguan atij rastin, e pyeti Ebu Seidin radijeAllahu anhu: *"Prej nga e dije se ajo është për rukje (shërim)?".*[857]

Imam Fahrudin er-Razi në *tefsir*-in e tij ka shkruar rreth 90 faqe vetëm për mësimet që dalin ose ndërlidhen me kaptinën e Fatihasë. Ndërsa së bashku edhe me rregullat dhe mësimet e *Besmeles* dhe *Istiadhes* numri i faqeve në këtë *tefsir* kalon në mbi 230.

Pasi fjala *El-hamdulilah* është fjala e parë e thënë nga njeriu dhe pejgamberi i parë Ademi alejhi`s-selam me rastin e fryrjes së shpirtit në trupin e tij edhe fjala e fundit që do ta thonë besimtarët pasi të hyjnë në Xhenet, siç ilustrohet në *ajet*-in e dhjetë të sures Junus, ku thonë besimtarët lutjen e tyre të fundit: **"...Falënderimi absolut i qoftë All-llahut, Zotit të botërave!".** Kështu Zoti e përfundon ilustrimin e lidhjes së vetme të mundshme ndërmjet njerëzve dhe Zotit të tyre.

[857] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Tibbi, bab 33, nr.5736; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Selamu, bab 23, nr.2201; etj.

HADITHI I SHTATËDHJETËEPESTË (75)

حَدَّثَنِي مُحَمَّدُ بْنُ عُثْمَانَ بْنِ كَرَامَةَ، حَدَّثَنَا خَالِدُ بْنُ مَخْلَدٍ، حَدَّثَنَا سُلَيْمَانُ بْنُ بِلاَلٍ، حَدَّثَنِي شَرِيكُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي نَمِرٍ، عَنْ عَطَاءٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " إِنَّ اللَّهَ قَالَ: مَنْ عَادَى لِي وَلِيًّا فَقَدْ آذَنْتُهُ بِالحَرْبِ، وَمَا تَقَرَّبَ إِلَيَّ عَبْدِي بِشَيْءٍ أَحَبَّ إِلَيَّ مِمَّا افْتَرَضْتُ عَلَيْهِ، وَمَا يَزَالُ عَبْدِي يَتَقَرَّبُ إِلَيَّ بِالنَّوَافِلِ حَتَّى أُحِبَّهُ، فَإِذَا أَحْبَبْتُهُ: كُنْتُ سَمْعَهُ الَّذِي يَسْمَعُ بِهِ، وَبَصَرَهُ الَّذِي يُبْصِرُ بِهِ، وَيَدَهُ الَّتِي يَبْطِشُ بِهَا، وَرِجْلَهُ الَّتِي يَمْشِي بِهَا، وَإِنْ سَأَلَنِي لَأُعْطِيَنَّهُ، وَلَئِنِ اسْتَعَاذَنِي لَأُعِيذَنَّهُ، وَمَا تَرَدَّدْتُ عَنْ شَيْءٍ أَنَا فَاعِلُهُ تَرَدُّدِي عَنْ نَفْسِ المُؤْمِنِ، يَكْرَهُ المَوْتَ وَأَنَا أَكْرَهُ مَسَاءَتَهُ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xhele she`nuhu thotë:* ***"Kush e ngacmon ndonjë prej të dashurve të Mi, Unë i kam shpallur atij luftë. Nuk do të më afrohet robi Mua me diçka më të dashur sesa me atë që ia kam bë farz. Kështu robi Im vazhdon të më afrohet me nafile derisa ta dua, e kur Unë ta dua, atëherë bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën mbahet dhe këmba e tij me të cilën ecën. Nëse më kërkon do t`i përgjigjem, e nëse mbrohet me Mua, atëherë do ta mbroj atë. Asnjë punë nga punët e Mia nuk nguroj ta bëj, sa nguroj ta marr shpirtin e një besimtari, që nuk e donë vdekjen, ngaqë nuk dua ta lëndoj"***.[858]

---

[858] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 38, nr.6502; Ibni Hiban-i, "Sahih", vëll.2, fq.58, nr.347; Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", vëll.1, fq.5; Dejlemi-u, e shënon në "Firdeus", vëll.3, fq.168, nr.4445 por përmes Enes b. Malikut r.a.; imam Dhehebiu në "Mizanu`l-I`tidal", përmend disa prej dijetarëve të cilët i kanë bërë kritika njërit prej transmetuesve të këtij *hadithi,* i cili quhet Halid b. Mahled. Ebu Davudi thotë se është i sinqertë, por ka fjalë për të. Ahmedi thotë se ai përcjell hadithe munker. Jahja thotë: "Nuk ka asgjë të keqe tek ai". Ebu Hatimi thotë: "Prej tij shkruhet *hadith*-i, porse nuk lejohet argumentimi me ta". Ibni Sa`di ka thënë: "I refuzohet hadithi, sepse ka filluar të harrojë afër pleqërisë". E përmend Edhe Ibni Adij por ia refuzon diku 10 hadithe si munkere, por thotë: "Ai është prej të shumtëve, që nuk ka diç të keqe tek ta inshallah". Imam Dhehehiu për këtë hadith të lartshënuar thotë se është shumë i panjohur (*Garib xhidden*) e sikur të mos ishte i regjistruar

Secili e mbron atë që e donë. Edhe njeriu e ka të mbjellë në natyrën e tij që t``i mbrojë ata të cilët i donë. E mbron familjen, fëmijët, shokun, pronën dhe të gjitha gjërat të cilat kanë vlerë tek individi. Nga shkaku se zemra është e lidhur për ta dhe nuk mund të lejojë të shoh që të dashurit të tij, t`i shkaktohet padrejtësi ose diçka e keqe.

Edhe Allahu xh.sh. është në mbrojtje të të dashurve të Tij dhe nuk toleron që dikush të ngacmojë ndonjërin prej tyre, qoftë me fjalë ose me vepra. T`i shpallësh luftë ndonjë *evliaje* të Allahut xh.sh. do të thotë t`i shpallësh luftë Zotit dhe armiqësia ndaj të dashurve të Tij, do të thotë armiqësi me Zotin e botërave. Vallë, a mendon dikush se mund të del triumfues nga kjo luftë? A mos mendon se ka gjasa të fitojë kundër Zotit? Ai që e fillon këtë luftë nuk do të përfundojë ndryshe përpos se i shkatërruar. Në frymën e këtij *hadith*-i, mund të përmendim edhe *hadith*-in tjetër *kudsij*, të cilin e transmeton Aliu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Është dyfishuar hidhërimi Im ndaj atij i cili i bën padrejtësi atij që nuk ka ndihmës tjetër përpos Meje".***[859]

Për këtë shkak, njeriu duhet të jetë vazhdimisht në shoqërim me njerëz të këtillë, të cilët e kanë merituar Dashurinë Hyjnore, si dhe duhet të kemi kujdes që të mos biem në armiqësi me njerëzit e tillë. Duhet të jemi në anën e atyre që Zoti i do e të mos jemi në anën e armiqve të besimtarëve. Gjithashtu është detyrë fetare që mos i marrim për mbrojtës tanë armiqtë e Allahut xh.sh. Siç thotë edhe në Kuran: **"..mos e zini mik (mbrojtës, kujdestar ose velij) armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri...".**[860]

---

në librin "Sahih", do ta kisha radhitur në hadithet munkere (të mohuara) nga Halid b. Mahled, shkaku i fjalëve të rralla në tekstin e *hadith*-it, si dhe me këtë transmetim veçohet Sheriku, kurse ai nuk është *Hafidh*. (Dhehebiu, "Mizanu`l-I`tidal", vëll.1, fq.640-641, nr.2463); *Hadith* të ngjashëm shënon edhe Ahmedi në "Musned", 6/256 nga Aishja radiaAllahu anha; po ashtu ky hadith përcillet edhe nga sahabë tjerë;

[859] Taberani, "Mu`xhemu`s-Sagir", vëll.1, fq.61, nr.71; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 4/266, nr.7066 thotë: "E transmeton Taberani në "Sagir" dhe "Euset", por në zinxhir gjendet Mis`ar b. Haxhaxh en-Nehdiu, kështu është tek Taberani, por unë nuk e kam gjet dikë tjetër (me këtë emër) përpos Mis`ar b. Jahja en-Nehdiu, i cili është i dobët sipas Dhehebiut sipas një lajmi të cilin e përmend ai, e Allahu e dinë më së miri".

[860] Kurani, Mumtehine, 1;

Allahu xh.sh. i bëri vërejtje edhe të Dërguarit të Allahut, që të përqendrojë vetveten në shoqërimin e kësaj kategorie, e të mos heq vëmendjen e tij prej tyre. Këtë e shprehi në mënyrë të ilustruar në Kuran, kur thotë: **"Përkufizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar".**[861]

Njeriu përfiton nga shoqërimi me të mirët dhe të dashurit e Zotit, sepse mëson mirësinë dhe afrimin tek Ai. Siç përfiton njeriu nganjëherë nëse qëndron pranë të pasurit, ose kur qëndron njeriu pranë dijetarit, ose ai që qëndron pranë të fuqishmit, të gjithë këta fitojnë nga shoqërimi i tyre dhe kanë dobi nga ky shoqërim, kështu edhe njeriu do të ketë dobi nga të qenët i dashur i Zotit. Vallë, ku ka fuqi dhe krenari më të madhe sesa ta kesh në anën tënde Zotin e gjithësisë?!

Allahu xhele she`nuhu miqtë e Tij që i do, i përshkruan në mënyrën më të bukur, i do dhe ata e duan. Zoti thotë në Kuran: "**Mik i juaj është vetëm Allahu, është i dërguari i Tij dhe ata që besuan, e falin namazin dhe japin zekatin duke bërë ruku. E kush e ka për mik Allahun, të dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s`ka dyshim se ana e Allahut është ngadhënjimtare".**[862] Ja pra, kjo është fitorja e madhe, aleanca e cila nuk dështon asnjëherë, fitimtare në këtë botë dhe në botën tjetër. Këtë meritë e kanë vetëm ata që kanë besuar Allahun xhele she`nuhu dhe Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Zoti pohon se të dashurit e Tij, nuk kanë arsye të frikësohen dhe të jenë të dëshpëruar, sepse janë në shoqërimin më të mirë që mund të ekzistojë. Këta miq, janë ata të cilët e besojnë Allahun xhele she`nuhu sinqerisht dhe vetëm prej Tij kanë frikë, ndërsa nuk i frikësohen dhe nuk i nënshtrohen askujt tjetër përpos Allahut xhele she`nuhu. Siç thotë edhe vet Ai në Kuran: **"A nuk janë vërtetë të dashurit e All-llahut pa frikë e brengosje? Të cilët besuan dhe ishin (prej atyre) që ruheshin (nga gabimi)".**[863]

Gjithashtu përmendi disa cilësi të tyre në një vend tjetër, ku thotë: **"Të devotshmit janë në kopshte e burime. Të kënaqur se kanë shtënë në dorë**

[861] Kurani, Kehf, 28;
[862] Kurani, Maide, 55-56;
[863] Kurani, Junus, 62-63;

atë që u dha Zoti i tyre, ata edhe më parë (në dynja) ishin mirëbërës. Ata ishin të cilët pak flinin natën. Dhe në syfyr (kah mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet. Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp).[864]

Të armiqësohesh me të dashurit e Zotit dhe t`i fyesh ata, qoftë edhe me fjalë, saqë do të shkaktosh në çfarëdo qoftë mënyre një brengë në zemrën e tyre, do të tërheqësh pas vete një mëkat të madh me pasoja shumë të rënda. Thotë Zoti në Kuran: **"E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtaret, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me shpifje dhe me një mëkat shumë të madh".**[865]

Nëse njeriu vjen në një shkallë që të torturojë ose të vras ndonjë prej të dashurve të Zotit dhe pastaj nuk pendohet për veprimin e bërë, atëherë këta do të kenë ndëshkim të dhembshëm në botën tjetër, një dënim prej të cilit assesi nuk do të shpëtojnë. Hidhërimi dhe mallkimi i Zotit zbret mbi ta dhe asnjëherë nuk do të kenë sukses dhe qetësi në jetë. Zoti thotë në Kuran: **"Ata që mohojnë argumentet e All-llahut, mbysin pejgamberët pa asnjë të drejtë, mbysin njerëzit të cilët kështillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroi për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues".**[866]

Lufta në botë ka qenë çdoherë në mes dy grupeve, në mes grupit të shpëtuar dhe grupit të humbur, partia e Zotit dhe partia e *shejtan*-it, grupi i të dashurve të Allahut dhe grupi i armiqve të Tij. Kjo është lufta mes dritës dhe errësirës, që do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit. Por, triumfuesit, do jenë gjithmonë ata që janë në anën e Allahut xhele she`nuhu i Cili posedon fuqi absolute.

Të dashurit e Zotit janë ata të cilët e adhurojnë Zotin, besojnë në atë që Ai ka shpallur dhe ka urdhëruar, largohen prej ndalesave të Zotit dhe kryejnë urdhrat e Tij. Janë ata që rregullisht adhurojnë Zotin dhe Atë e përkujtojnë. Nuk ngopen me adhurimet e obliguara, por vazhdojnë të veprojnë edhe vepra vullnetare, që të arrijnë kënaqësinë e Zotit.

Në këtë grup, bëjnë pjesë edhe dijetarët e mirëfilltë dhe të sinqertë në adhurimin e Tij,[867] të cilët kanë mësuar dhe i mësojnë edhe të tjerët në

[864] Kurani, Dharijat, 15-19;
[865] Kurani, Ahzab, 58;
[866] Kurani, Ali Imran, 21-22;
[867] Shih: Ibni Haxher-i, "Fet`hul-Bari", vëll.14, fq.674;

rrugën e udhëzimit dhe të mirësisë, ndërsa bëjnë thirrje për shmangje nga mëkati dhe rruga e *shejtan*-it.

Zoti atyre të cilët e kanë frikë vetëm Atë, ua mëson edhe gjërat të cilat nuk i dinë. Zoti thotë në Kuran: **"..Keni frikë Allahun, e Ai do t`u mësojë juve.."**.[868] Kështu Zoti i mundësoi dituri të jashtëzakonshme të dashurit të Tij, Hidrit (Hëzrit), i cili e demonstroi diturinë e tij gjatë shoqërimit me pejgamberin e Zotit, Musain alejhi`s-selam.[869]

Edhe më parë, ka pasur njerëz siç ka edhe sot, të cilët kanë urrejtje ndaj ithtarëve të vërtetës, ndaj të dashurve të Zotit, siç është urrejtja e *Rafidive* ndaj Ebu Bekrit radijeAllahu anhu, Umerit radijeAllahu anhu, Aishes radiaAllahu anha dhe *sahab*-ëve tjerë, ose siç është urrejtja e ithtarëve të risisë ndaj ithtarëve të sunetit.[870] Të gjithë ata të cilët kanë urrejtje ndaj *sahab*-ëve, dijetarëve të devotshëm dhe besimtarëve të sinqertë, do të përfshihen në këtë kërcënim të ashpër nga Zoti.

Zoti në Kuran u kanoset me armiqësi dhe luftë atyre të cilët punojnë me kamatë dhe kusarëve të rrugës, grupe këto që shqetësojnë njerëzit me veprimet e tyre negative, andaj Zoti i quajti armiq të Tij.

Besimtari i sinqertë çdo vepër e kryen vetëm për Allahun xhele she`nuhu e kur veprën e kryen me dashuri për Zotin, ai nuk lodhet nga ai veprim asnjëherë, e nëse e kryen vetëm nga frika e dënimit, atëherë do të lodhet dhe do të mërzitet. Zoti dëshiron që t`i nxjerrë të dashurit e Tij nga errësira e rrugës së humbjes, drejt dritës së shpëtimit dhe ndriçimit të shpirtit. Thotë Zoti në Kuran: **"All-llahu është mbikëqyrës (i dashur) i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë..."**.[871]

I dashuri i Tij i kryen me dëshirën më të madhe urdhrat e Atij të cilin e do, andaj edhe nuk i ngjan një besimtari që të paraqitet përtac në kryerjen e urdhrave të Zotit. Urdhrat e Zotit janë kryerja e *farze*-ve dhe largimi nga *haram*-et. Nëse besimtari nuk tregohet i përpiktë ndaj këtyre dy detyrimeve, atëherë ai do të humb të drejtën që të quhet i dashur i Zotit, pasi i dashuruari nuk priton të kryejë diçka që i pëlqen të dashurit.

---

[868] Kurani, Bekare, 282;
[869] Kurani, Kehf, 60-82;
[870] Shih: Ibni Haxheri, po aty;
[871] Kurani, Bekare, 257;

Vetë dashuria, nënkupton afërsi. Njeriu i afrohet Zotit me besim dhe vepra, e më pas edhe me sinqeritet, kurse Zoti i afrohet robit të Tij me Falje dhe Mëshirë. Zoti në këtë *hadith*, na tregon se njeriu nuk mund të afrohet te Zoti me diçka më të dashur tek Ai sesa me *farze*t e tij. Kurse *farz* është një vepër të cilën Zoti e ka urdhëruar që të veprohet në mënyrë të prerë dhe me argument të qartë. Mohuesi i kësaj dispozite bëhet pabesimtarë, kurse ai që nuk e vepron pa arsyetim, është mëkatarë.

Ndër *farzet* kryesore të një besimtari musliman, është falja e namazit, dhënia e *zekat*-it, agjërimi i Ramazanit, shkuarja në *haxh* për atë i cili ka mundësi, etj. E njeriu nuk mund të afrohet tek Zoti me diç më të dashur sesa *farzet*. Nga shkaku se me këtë besimtari vërteton dëgjueshmërinë dhe nënshtrimin ndaj Zotit. Me këto vepra, besimtari e lidhë veten për Zotin, që të jetë në kontakt të vazhdueshëm me Të.

Nuk ka vepër më të dashur te Zoti sesa *farzet* dhe me kryerjen e *nafile*-ve nuk mund të arrijë kurrë shpërblimin e *farz*-it. Ajo që është vullnetare ka shpërblime të shumta, porse nuk mund të arrijë kurrë vendin e *farzit*. Siç ka thënë edhe i Dërguari i Allahut në një *hadith*, se: *"Ai që e prish pa arsye dhe pa sëmundje një ditë agjërimi të Ramazanit, nuk do të mund ta kompensojë atë edhe nëse agjëron tërë kohën vullnetarisht".*[872]

Besimtari mund të arrijë shpëtimin duke kryer vetëm *farz*-et, nëse nuk mund të arrijë të kryejë ndonjë vepër vullnetare. Për këtë, dëshmon *hadithi* që e përcjellë Talha b. Ubejdullahu r.a. se një *beduin* erdhi te Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe e pyeti se me çka është i obliguar? Në këtë pyetje, i Dërguari i Allahut iu përgjigj se ka obligim pesë namaze gjatë natës dhe ditës. Në këtë shtoi një nën pyetje: "A jam i obliguar me diçka jashtë kësaj?" Ai iu përgjigj: *"Jo, vetëm nëse dëshiron diçka vullnetarisht".* Kështu ai i tregoi edhe për agjërimin dhe zekatin. Në fund, *beduini* tha: "Pasha Allahun, as që do t`u shtoj e as që do u pakësoj diçka këtyre". Në këtë, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Ka shpëtuar, nëse e ka thënë të vërtetën".*[873]

Prej veprave vullnetare që pasojnë *farz*-in e namazit, janë *sunet*-et ditore, që numri i atyre është dymbëdhjetë, duke filluar prej dy *sunet*-eve të sabahut, katër *sunet*-e para *farz*-it të drekës dhe dy pas saj, dy *sunet*-e pas *farz*-it të

[872] Këtë hadith e shënon imam Buhariu në kapitullin e agjërimit si *Mual-lek* përmes Ebu Hurejres në titullin e hadithit 1935.
[873] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Imanu, nr.46; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, nr.11; etj.

akshamit dhe dy *sunet*-e pas *farz*-it të jacisë. Po ashtu, prej namazeve vullnetare, është namazi i natës, namazi i *duha*-së, namazi i përshëndetjes së xhamisë, etj.

Nga veprat vullnetare që pasojnë *farzin* e agjërimit të muajit Ramazan, janë gjashtë ditë të muajit *Sheval*, agjërimi ditën e hënë dhe të enjte, agjërimi i tre ditëve në mesin e çdo muaji hënorë, që përkojnë me datën e 13, 14 dhe 15 të çdo muaji hënorë, agjërimi i ditës së *Arafatit*, ditës së *Ashurasë*, etj.

Ndërsa për çështjen e shpërndarjes së pasurisë, përpos *farz*-it të *zekat*-it të cilën e kemi obligim në pasurinë tonë, preferohet të shpërndahet diçka edhe në mënyrë vullnetare ndaj të varfërve dhe nevojtarëve.

Një ndër *nafilet* më të mira me të cilat njeriu i afrohet Allahut xh.sh. është leximi dhe dëgjimi i Kuranit, të medituarit dhe të kuptuarit e porosive të tij.[874]

Habab b. Ereti radijeAllahu anhu i kishte thënë një njeriut: "Afroju Allahut sa më shumë që mundesh. Por dije se Ai më së shumti e pëlqen afrimin përmes fjalës së Tij (Kuranit)".[875] Ndërsa nga *hadith*-i i Ebu Umames radijeAllahu anhu tregohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk mund të afrohet njeriu me diçka tek Zoti, më shumë sesa përmes asaj që del prej Tij (Kuranit)".*[876] Për *ashik*-ët nuk ka asgjë më të pëlqyeshme se fjalët e personit të dashur. Ai është shija e zemrës së tyre dhe qëllimi i tyre i fundit.[877]

Uthmani radijeAllahu anhu ka thënë: "Sikur zemrat tuaja të ishin vërtetë të pastra, kurrë nuk do të ngopeshit me fjalët e Zotit tuaj".[878] Ndërsa Ibni Mes`udi radijeAllahu anhu ka thënë: "Kush e do Kuranin, ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij".[879]

Pra, kemi shumë veprime të cilat janë vullnetare e që kanë shpërblime të shumta në vetvete, të cilat Zoti ua jep robërve të Vet besimtarë. Këtu shohim se njeriu i afrohet Zotit përmes *farz*-eve, ndërsa do ta arrijë

[874] Ibni Rexheb El-Hanbeli, "Xhamiu`l-Ulum ve`l-Hikem", vëll.3, fq.1080;
[875] Ibni Rexheb-i, po aty;
[876] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Fadailu`l-Kurani, bab 17, nr.2921 dhe thotë se hadithi është Garib;
[877] Shih: Ibni Rexheb-i, po aty, fq.1081;
[878] Ebu Nuajm-i, "Hiljetu`l-Evlija", 7/300;
[879] Ibni Rexheb-i, po aty, fq.1081;

dashurinë e Zotit ndaj tij përmes veprave vullnetare. Përpjekja maksimale për t`iu afruar Zotit, me *farze* dhe pastaj me *nafile*, e ngrit njeriun nga niveli i *iman*-it në nivel të *ihsan*-it.

Roli i veprave vullnetare është se shton në mes dy palëve dashurinë dhe afërsinë. Pra, edhe në mes njerëzve, shtohet dashuria me dhënie vullnetare, siç ka thënë i Dërguari i Allahut: *"Dhuroni që të duheni mes jush".*[880] Kështu që, Zoti e do më shumë atë i cili vazhdimisht është i preokupuar me adhurime ndaj Tij, sesa ai i cili preokupohet më shumë me vetveten.

Me alegorinë që e kanë kuptuar arabët e asaj kohe, vijon *hadith*-i dhe thotë: ***"..e kur Unë ta dua, atëherë bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën mbahet dhe këmba e tij me të cilën ecën.."*** Me këtë pjesë, na bëhet e qartë se Zoti e shpëton çdo pjesë të trupit të besimtarit. Zoti e do nënshtrimin e robit përmes këtyre gjymtyrëve, andaj edhe ia kushton Vetes, shkaku i vlerës që marrin përmes nënshtrimit të Zotit. Njeriu këto gjymtyrë i ka ruajtur që të jenë vetëm në atë që është për kënaqësinë e Zotit, nuk ka shikuar të ndaluarën, nuk ka dëgjuar të ndaluarën, nuk ka prekur *haram* e as që ka ecur drejt ndonjë vendi ku ka *haram*. Këtij njeriu i bëhet dëgjimi vetëm për atë që e do Zoti, nuk shikon përpos asaj që do Zoti dhe nuk ec askund përpos atje ku Zoti është i kënaqur.

Kur zemra mbushet me ndjenjën e madhështisë së Allahut xh.sh. anulon gjithçka që ka mbetur në të. Në shpirtin e njeriut pas kësaj nuk mbetet asnjë pasion as dëshirë pos asaj që e do Zoti i tij. Atëherë fjala e njeriut është vetëm *dhikri*, ecë vetëm për hir të Tij, nëse flet do të flasë vetëm për hir të Allahut xh.sh. nëse dëgjon do të dëgjojë vetëm në Emër të Tij, nëse shikon, do të shikojë vetëm në Emër të Tij, nëse ndërmerr diç, do të ndërmerr vetëm në Emër të Tij.

Ebu Ferexh Ibën el-Xheuzi thotë: "Fjalët në këtë *hadith* si këmba, dora, dëgjimi dhe shikimi, janë vetëm shembuj që mund të kuptohen në tri forma: E para: ***Jam për të sikur vetë dëgjimi i tij, shikimi i tij,*** d.m.th. ai e do respektin ndaj Meje sikur i donë këto gjymtyrë. E dyta: Gjymtyrët e robit Tim janë të preokupuara me Mua: Nuk dëshiron asgjë që nuk më kënaq Mua, vetëm se me lejen Time. E treta: Ia mundësoj qëllimet ashtu si i arrin ato me dëgjimin, shikimin dhe dorën e tij, gjëra që e ndihmojnë atë përpara armikut. Këtu kemi të bëjmë me Allahun, Ai është i pastër nga këto sende,

[880] Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", nr.594; etj.

prandaj ato nënkuptojnë po atë që nënkupton shprehja te thënia e Allahut (në hadithin kudsi): ***"Kush më vjen duke ecur, i shkoj me nxitim".***[881]

Nuk është i saktë interpretimi i atyre të cilët këtë *hadith* e sqaruan në mënyrë figurative, siç vepruan ata që kanë bërë *hulul* dhe *iltihad*, kinse Zoti është shkrirë (*fena*) në objektet përreth nesh dhe se Zoti gjendet në çdo send e cila na rrethon, siç pohoi edhe Bistamiu ose Halaxhi kur shpalosi këmbën e tij dhe tha: "Edhe këtu gjendet Zoti".[882]

Zoti pas kësaj situate, tregon se këtij robi të mirë, do t`ia plotësojë nevojat e tija. Nëse e lut Zotin, Ai do t`ia pranojë Atij, nëse kërkon prej Zotit, Ai do t`i jep, nëse kërkon mbrojtje, Allahu xh.sh. do ta mbrojë, sepse ky është besimtari i cili e ka kuptuar se nuk ka kush që meriton të adhurohet dhe t`i kërkohet diçka, përpos se prej Allahut xhele she`nuhu. Andaj, Zoti i përgjigjet lutjes së lutësit, kur ai kërkon prej Tij. Siç thotë edhe në Kuran: **"Zoti juaj thotë: "Më lutni Mua, do t`u përgjigjem..".[883]**

Nga rastet e shumta ku Zoti ua ka pranuar lutjen të dashurve të Tij, është edhe rasti i Sa`d b. Ebi Vekasit radijeAllahu anhu kur kishte një kontest me një person i cili kishte gënjyer për të, e Sa`di u lut duke thënë: "O Allahu im, nëse njeriu gënjen, verboje, zgjatja jetën dhe sprovoje me vuajtje të shumta". Krejt kjo i ndodhi njeriut, ai u plak shumë, saqë fëmijët e përbuznin dhe thoshte: "Unë jam një plak i sprovuar, më ka goditur duaja e Sa`dit".[884]

Një herë një grua me emrin Erva bint Uvejs kishte ngritur padi gjyqësore ndaj Seid b. Zejdit r.a. për një pjesë toke, kinse ai ia kishte uzurpuar atë. Me këtë rast, Seidi u lut duke thënë: "O Allahu im, nëse gënjen, verboje dhe merrja shpirtin në arën e saj". Kështu edhe ndodhi, ajo u verbua dhe një natë gjersa po ecte në arën e saj, u rrokullis në një pus dhe kështu vdiq".[885]

Allahu xhele she`nuhu është më i mëshirshëm ndaj nesh se vet nënat tona, andaj edhe i dhimbset robi që të ketë frikë nga takimi me Të, kështu që, edhe Allahu xh.sh. nuk dëshiron ta lëndojë atë. Por, Zoti ia lehtëson

---

[881] Ebu Ferexh Ibën el-Xheuzi, "Flakja e dyshimeve të teshbihizmit", Qendra për Studime dhe Kërkime Islame, Zvicër, 2011, fq.264-265;
[882] Attari, "Tedhkiretu`l-Evlija", Nami Press, Lucknow, Indi, 1914, fq.105-112;
[883] Kurani, Gafir, 60;
[884] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab vuxhubi`l-kiraeti lil imami vel me`mumi, nr.755; etj.
[885] Muslim-i, "Sahih", kitabu`l-Musakatu, bab 30, nr.1610; etj.

vështirësitë dhe dhembjet e vdekjes të dashurit të Tij, saqë e bën t`i del shpirti lehtë siç del uji nga vrima e ibrikut.

Ebu Ferexh Ibën el-Xheuzi thotë: "Disa dijetarë ndërkaq thonë se pasi besimtari ndodh të sëmuret dhe pastaj kërkon shërim, dhe Allahu e shëron, kjo është sikur nguron ta vdes atë. Që këndej fjala "ngurrim" është formë shprehje që ne kemi mundësi ta kuptojmë.[886]

Nga ky *hadith*, vërejtëm se Allahu xh.sh. është në mbrojtjen e robërve të Tij të sinqertë, të cilët kryejnë urdhrat e Tij dhe largohen nga ndalesat e Tij, i do më shumë ata të cilët veprojnë edhe punë vullnetare saqë do të jetë Mbrojtësi i tyre.

[886] Ebu Ferexh Ibën el-Xheuzi, "Flakja e dyshimeve të teshbihizmit", fq.265;

HADITHI I SHTATËDHJETËEGJASHTË (76)

حَدَّثَنَا يَعْقُوبُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ، حَدَّثَنَا يُونُسُ، عَنِ الْحَسَنِ، عَنْ أَنَسِ بْنِ حَكِيمٍ الضَّبِّيِّ، قَالَ: خَافَ مِنْ زِيَادٍ، أَوْ ابْنِ زِيَادٍ، فَأَتَى الْمَدِينَةَ، فَلَقِيَ أَبَا هُرَيْرَةَ، قَالَ: فَنَسَبَنِي، فَانْتَسَبْتُ لَهُ، فَقَالَ: يَا فَتَى، أَلَا أُحَدِّثُكَ حَدِيثًا، قَالَ: قُلْتُ: بَلَى، رَحِمَكَ اللَّهُ – قَالَ يُونُسُ: وَأَحْسَبُهُ ذَكَرَهُ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ – قَالَ: «إِنَّ أَوَّلَ مَا يُحَاسَبُ النَّاسُ بِهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مِنْ أَعْمَالِهِمُ الصَّلَاةُ» ، قَالَ: " يَقُولُ رَبُّنَا جَلَّ وَعَزَّ لِمَلَائِكَتِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ: انْظُرُوا فِي صَلَاةِ عَبْدِي أَتَمَّهَا أَمْ نَقَصَهَا؟ فَإِنْ كَانَتْ تَامَّةً كُتِبَتْ لَهُ تَامَّةً، وَإِنْ كَانَ انْتَقَصَ مِنْهَا شَيْئًا، قَالَ: انْظُرُوا هَلْ لِعَبْدِي مِنْ تَطَوُّعٍ؟ فَإِنْ كَانَ لَهُ تَطَوُّعٌ، قَالَ: أَتِمُّوا لِعَبْدِي فَرِيضَتَهُ مِنْ تَطَوُّعِهِ، ثُمَّ تُؤْخَذُ الْأَعْمَالُ عَلَى ذَاكُمْ "

Enes bin Hakim ed-Dabiu thotë: "(Enesi) është frikësuar prej Zijadit ose ibni Zijadit dhe erdhi në Medine ku takoi Ebu Hurejren r.a. dhe tha: "I jam prezantuar dhe ai më është prezantuar, e në atë rast ka thënë: "O djalosh, a dëshiron të të tregoj një *hadith*?" Thotë: "Po si jo, Allahu të mëshiroftë". Tha: "Unë e kam dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"Gjëja e parë që do të llogaritet robi musliman në Ditën e Gjykimit, është namazi. Zoti jonë i Madhërishëm u thotë melekëve edhe pse Ai është më i Dijshëm:* ***"Shikoni namazin e robit Tim, a e ka të plotë apo të mangët?!"*** *Nëse e ka të plotë, i shkruhet ashtu i plotë, e nëse e ka të mangët diçka prej saj, thotë:* ***"Shikoni se robi Im a ka falur namaz vullnetar?"*** *Nëse ka pas namaz vullnetar, do t`i plotësohen farzet me ato vullnetaret, e kështu do të veprohet edhe me punët tjera obligative".*[887]

[887] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 144, nr.864; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 188, nr.413 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti salat, bab 202, nr.1425; Ahmed-i, "Musned", 15/299, nr.9494; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/394, nr.965 dhe thotë se ky hadith është me zinxhir Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar, porse ekziston hadith dëshmi me zinxhir Sahih sipas kushteve të Muslimit". Me këtë vlerësim pajtohet edhe imam Dhehebiu; Ibni Maxheh (nr.1426) dhe

Çdo njeri do të jep llogari në Ditën e Gjykimit, ditë kur nuk mund të fshihet asgjë, atë ditë kur do të del në shesh çdo vepër dhe do të llogaritet çdo imtësi. Njerëzit do të presin të fillojë gjykimi që të shpëtojnë prej asaj vështirësie, kur nuk e dinë se çka do të ndodh me ta, a do të shpëtojnë apo do të dënohen?!

Muslimanët do të japin llogari për veprat e tyre, qoftë ai borxh ndaj Zotit ose borxh ndaj njerëzve. Puna e parë që do të llogaritet prej borxheve ndaj Zotit, është obligimi kryesor dhe adhurimi bazë i fesë tonë, që është namazi. Kurse si borxh ndaj njerëzve, e para vepër që do të llogaritet atë ditë, do të jetë vrasja dhe derdhja e gjakut në mes njerëzve.

Namazi është obligimi i parë i besimtarëve, vepra e fundit që do të ngrihet nga njerëzit para kiametit dhe obligimi i parë për të cilin do të japin llogari. Namazi është shtylla e fesë sonë dhe lidhja kryesore në mes robit dhe Zotit. Është qetësia e zemrës së besimtarit dhe drita e syrit të tij. Nuk mund të mbahet dot feja pa këtë shtyllë, që është ndër fondamentet bazë të fesë Islame. Nëse besimtari e braktis këtë obligim, rrezikohet edhe besimi i tij.

Transmeton Muadh b. Xhebeli radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Çështja kryesore është Islami, ndërsa shtylla e saj është namazi".*[888]

Allahu xhele she`nuhu na obligoi me pesë kohë brenda ditës dhe natës, të cilët i kemi të domosdoshme që t`i kryejmë. Këto kohë janë: sabahu, dreka, ikindia, akshami dhe jacija. Po ashtu e kemi obligim ditën e Premte edhe faljen e namazit të xhumasë. Këto janë borxh ndaj Zotit që për to do të japim llogari në Ditën e Gjykimit.

Por, besimtari nuk duhet të mjaftohet vetëm me këto namaze, porse duhet të bëjë përpjekje që të shtojë namazet vullnetare, në rast të mos plotësimit të *farz*-eve në mënyrë të duhur, të plotësohen *farz*-et në Ditën e Gjykimit me namazet vullnetare.

Ebu Davud-i (nr.866), e shënojnë këtë hadith në Sunen-et e tyre edhe përmes Temim ed-Dari-t;

[888] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Iman, bab ma xhae fi hurmeti`s-Salati, nr.2625 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Ahmed-i, "Musned", 36/344, nr.22.016; etj.

Kemi shumë lloje të namazeve vullnetare të cilat ceken nëpër tekstet fetare. Prej tyre kemi namazin e natës, *sunet*-et gjatë ditës të cilat i falim para dhe pas çdo namazi farz, namazi i *Duha*-së, namazi i *istihare*-s, namazi për përshëndetje të xhamisë, namazi i eklipsit, namazi i teravive dhe shumë mënyra të tjera përmes së cilave do të arrijmë të shtojmë namazet tona vullnetare.

Pra, nafilet do të bëjnë plotësimin e mangësive gjatë faljes së *farz*-eve, sepse çdo njeri mund të gabojë ose të harrojë diçka, të humbë vëmendjen dhe përqendrimin, kështu që me faljen e namazeve vullnetare, do të plotësohen këto mangësi.

Pasi të llogaritet namazi, veprat tjera do të shkojnë më lehtë, e nëse besimtari nuk e ka namazin në rregull, atëherë edhe punët e tjera do të komplikohen. Kështu që, besimtari duhet të bëjë përpjekjen maksimale që të plotësojë namazin në mënyrën siç është e sqaruar në bazë të praktikës së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Përveç namazeve, edhe mangësitë e obligimeve tjera do të plotësohen me veprat vullnetare që janë të llojit të njëjtë. Shembull, nëse agjërimi i obliguar ka pasur ndonjë mangësi, do të plotësohet me agjërimet vullnetare që ka vepruar njeriu, si p.sh. agjërimi i çdo të hëne dhe të enjte, agjërimi i ditës së *arafat*-it, i ditës së *ashura*-së, i gjashtë ditëve nga muaji *Sheval*, agjërimi i ditëve të bardha (dita e 13, 14 dhe 15 të çdo muaji hënorë) dhe të tjera, të gjitha këto lloje të agjërimit vullnetarë, do të kontribuojnë që të shmangen mangësitë e adhurimit tonë dhe të plotësohen me veprat vullnetare.

Ngjashëm do të veprohet edhe me obligimin e zekatit, ku mangësitë e saja do të plotësohen me sadakanë vullnetare. Kështu do të veprohet me çdo adhurim tjetër të obliguar.

Më lart kemi sqaruar se Zoti nuk i pyet *melek*-ët se nuk e dinë gjendjen e robërve, porse kjo na shërben neve për të kuptuar pozitën tonë karshi engjëjve. Këtu nuk duhet të kuptojmë se Zoti ka nevojë për dijen e melekëve apo evidencën e tyre, sepse Allahu xhele she`nuhu është i Gjithëdijshëm dhe i njohur hollësisht me veprat e qenieve, porse këtë e bën në formë të konfirmimit të veprave para robërve dhe demonstrimin e Mëshirës së Tij ndaj robërve të Tij, të cilët nuk mund të arrijnë Xhenetin me veprat e tyre, porse vetëm në sajë të Mëshirës Hyjnore.

Nga ky *hadith*, kuptojmë se veprat e njerëzve do të merren në llogari dhe nuk do të ngel asgjë pa u llogaritur, siç thotë edhe Zoti në Kuran: **"Kush vepron një vepër të mirë sa grimca do ta sheh, por edhe kush punon një vepër të keqe sa grimca, do ta sheh atë".**[889]

Në këtë fjalë të shenjtë, vërejmë edhe Mëshirën Hyjnore e cila do t`i kaplon besimtarët, nëse nuk e kanë kryer një adhurim të caktuar në mënyrë të duhur, do të kompensohen lëshimet me veprat vullnetare.

[889] Kurani, Zilzal, 7-8;

HADITHI I SHTATËDHJETËESHTATË (77)

حَدَّثَنَا أَبُو جَعْفَرٍ السِّمْنَانِيُّ قَالَ: حَدَّثَنَا أَبُو مُسْهِرٍ قَالَ: حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ عَيَّاشٍ، عَنْ بَحِيرِ بْنِ سَعْدٍ، عَنْ خَالِدِ بْنِ مَعْدَانَ، عَنْ جُبَيْرِ بْنِ نُفَيْرٍ، عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ، وَأَبِي ذَرٍّ، عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنِ اللَّهِ تَبَارَكَ وَتَعَالَى أَنَّهُ قَالَ: «ابْنَ آدَمَ ارْكَعْ لِي أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ مِنْ أَوَّلِ النَّهَارِ أَكْفِكَ آخِرَهُ»

Transmetojnë Ebu Derda (r.a) dhe Ebu Dherri (r.a.) se Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xhele she`nuhu ka thënë:* ***"O biri i Ademit, fali për Mua katër rekate në fillim të ditës, do të mjaftojë për pjesën tjetër të saj".***[890]

Ky *hadith* fillon me thirrjen `o biri i Ademit`, për të nderuar qenien njeri dhe t`i përkujtojë atij prejardhjen fisnike. Po ashtu, me këtë thirrje, tregon obligimin e njerëzve të cilët kanë arritur moshën madhore dhe e kuptojnë thirrjen për t`iu përgjigjur Zotit.

Edhe pse në këtë thirrje përmenden njerëzit, nuk do të thotë se *xhin*-ët janë të shkarkuar prej obligimit, pasi edhe ata kanë përgjegjësi dhe do të llogariten për veprat e tyre, do të kenë shpërblim për punët e mira dhe do të dënohen për veprat e këqija, pra ata do të kenë trajtim të ngjashëm siç kanë edhe njerëzit.

Sipas shumicës së dijetarëve, edhe ky *hadith* i ndershëm, flet për vlerën e namazit vullnetarë, sidomos të një namazi i cili falet në fillim të ditës, në këtë periudhë kur shpërndahet bereqeti i Zotit, në periudhën e paraditës, apo e quajtur në terminologjinë e fesë, "*Ed-Duha".* Kjo periudhë përfshin kohën

[890] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Vitr, bab 229, nr.474 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Garib; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab salatu`d-Duha, nr.1289; Ahmed-i, "Musned", 37/143, nr.22.475; etj. Hejthemi-u, në "Mexhmeu`z-Zevaid", 2/408, nr.3409 thotë se e transmeton Ahmedi dhe Ebu Ja`la, e transmetuesit e këtij hadithi janë të besueshëm; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, thotë se ky hadith është Sahih; ky hadith përcillet edhe nga Ibni Umeri r.a., Ebu Umame r.a., Ukbe b. Amir r.a., Nuajm b. Hemmari r.a., Ebu Dherri r.a., Ebu Murre et-Taifi r.a.;

pas lindjes së diellit (45 minuta pas lindjes së diellit) dhe deri në kohën para drekës.

Zoti është betuar në këtë periudhë të ditës, me çka vërtetohet vlera e kësaj kohe, sepse Ai betohet në ato gjëra që kanë vlerë të veçantë. Thotë në Kuran: "**Pasha paraditën".**[891] Për shkak të kësaj veçorie që ka kjo kohë, i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem na këshilloi që t`i drejtohemi Zotit në këtë periudhë me një namaz vullnetar.

Namazi *Duha* është *sunet* tek *medhhebi* Hanefij, Shafij dhe Hanbelij, kurse te Malikit konsiderohet *mendub*.[892] Në enciklopedinë Kuvajtiane të fikhut (27/222), thuhet: "Namazi i *duha*-së është një *nafile* e preferuar sipas shumicës së *fukaha*-ve, ndërsa shafiijtë dhe malikitë potencojnë se është *sunet* i fortë".

Edhe në *medhheb*-in Hanefi, ky lloj namazi konsiderohet prej namazeve vullnetare. Në librin "El-Fetava`l-Hindije" thuhet: "Prej namazeve *Mendub* është edhe namazi i *Duha*-së, i cili falet më së paku me dy *rekate,* kurse më së shumti me dymbëdhjetë *rekate*, ndërsa koha e saj është prej ngritjes së diellit deri në *zeval".*[893]

Ndërsa për vlerën e këtij namazi, flasin *hadith*-e të shumta. Në disa prej këtyre *hadith*-eve, vërehet se Zoti ia premton edhe *Xhenetin* atij i cili fal këtë namaz, duke e ngritur në 12-të *rekate*. Transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush i fal 12 rekate të namazit Duha, Allahu në Xhenet do t`ia ndërtojë një pallat prej ari".*[894]

Kurse në transmetimin tjetër prej Enesit radijeAllahu anhu kuptojmë se vlera e këtij namazi arrin edhe vlerën e një haxhi dhe umreje të plotë. Transmeton Enesi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e fal namazin e sabahut me xhemat, pastaj ulet për të përkujtuar Allahun (duke bërë dhikr) derisa të agojë dielli, më pas i fal dy*

[891] Kurani, Duha, 1;
[892] Shih: Xheziri-u, "Fikh ala medhahibi`l-Erbe`a", Daru`l-Kutubu`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i dytë, 2003, vëll.1, fq.301;
[893] Shejh Nidhami, "El-Fetava`l-Hindijje", Daru`l-Kutubu`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2000, vëll.1, fq.124;
[894] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Vitr, bab 229, nr.472 dhe thotë se hadithi është Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Salatu, bab 187, nr.1380;

rekate, atij do t`i shkruhet shpërblimi sikur të kishte kryer një haxh dhe një umre të plotë, të plotë, të plotë".[895]

Edhe prej Ebu Hurejres radijeAllahu anhu përcillet vlera e këtij namazi, ku ai transmeton se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk kujdeset për namazin e Duhasë përpos se të Devotshmit (evab), sepse ky është namazi i të devotshmëve".*[896]

Po ashtu, transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu i cili ka thënë: "Dosti im (Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem) më ka këshilluar që të ndjek tri gjëra, të cilat nuk do t`i lë derisa të vdes: "Të agjëroj tri ditë të çdo muaji (ditën e 13,14 dhe 15 të muajit hënor), të fal namazin *Duha* dhe të mos flej pa falur *vitr*-in".[897]

Kurse në *hadith*-in tjetër që e transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu tregon se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush i fal rregullisht dy rekate namaz Duha, do t`i falen gjynahet edhe nëse janë sa shkuma e detit".*[898]

Ky namaz qenka në barasvlerë me faljen e mëkateve, që është një mirësi e madhe për besimtarët musliman, sepse nuk ka njeri pa mëkate, kështu që përmes këtij lloj namazi, do të arrijmë të pakësojmë mëkatet tona të përditshme.

Gjithashtu, ky lloj namazi është kompensim për mos dhënien e sadakasë që duhet ta jep njeriu si falënderim për mirësitë e shumta që posedon në sajë të mëshirës së Zotit. Transmeton Ebu Dherri radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Çdo mëngjes për çdo nyje të trupit ka sadaka. Çdo tespih, është sadaka, çdo tahmid është sadaka, çdo tekbir është sadaka, urdhërimi në të mira është sadaka, të ndalohet nga e keqja*

---

[895] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sefer, bab dhikru ma justehabu, nr.586 dhe thotë se është Hasenun-Garib;

[896] Hakim-i, "Mustedrek", 1/459, nr.1182 dhe thotë se "është Sahih sipas kushteve të Muslim-it, por nuk e ka shënuar me këto fjalë", por me të nuk pajtohet Dhehebiu;

[897] Buhari-u, "Sahih", kitab Tehexhud, bab 33, nr.1178; Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 13, nr.721; etj.

[898] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Vitr, bab 229, nr.475; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Salatu, bab 187, nr.1382; Ahmed-i, "Musned", 15/446, nr.9716; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, thotë se ky hadith ka zinxhir të dobët shkaku se aty gjendet Nehhas b. Kahmi, i cili është i dobët dhe po ashtu gjendet Shedad Ebu Ammari, i cili nuk ka dëgjuar prej Ebu Hurejres.

është sadaka. Të gjitha këto kompensohen me dy rekate namaz të Duhasë".[899]

Imam Sheukani për këto katër *rekate* thotë se kanë të bëjnë me namazin *Duha*, porse thotë ka edhe prej tyre që mendojnë se këto katër rekate kanë të bëjnë me *sunet*-in dhe *farz*-in e sabahut, që janë në fillim të ditës, siç vërteton edhe *hadith*-i: *"Kush e fal sabahun, do të jetë në mbrojtjen e Zotit".*[900]

Por, sipas shumicës së dijetarëve, ky *hadith* ka të bëjë me namazin e *Duha-së*, andaj duhet njeriu të jep mund sa më shumë që mos t`i kalojë ky namaz vullnetarë pa e falur.

Me pjesën e fundit të *hadithit* ***"Do të mjaftojë për pjesën tjetër",*** nënkupton se Zoti do ta ndihmojë, do ta mbrojë, do ta furnizojë prej nga nuk e pret dhe do t`ia lehtësojë çështjet në pjesën tjetër të ditës. Si mos jetë kështu, kur pamë se sa vlerë ka ky namaz?! Pra, njeriut do t`i mjaftojë ky namaz vullnetarë për atë ditë, edhe nëse nuk fal namaz tjetër *nafile* brenda asaj dite. Allahu xhele she`nuhu na mundësoftë që të jemi të kujdesshëm ndaj këtij namazi që të përfitojmë prej mirësive të tij.

Besimtari i sinqertë është që në fillim të ditës i lidhur me Zotin e vet, pasi periudha *"Ed-Duha"* është periudha më e gjatë që nuk ka namaz në të (prej namazit të sabahut deri në namazin e drekës) e besimtari nuk mund të pajtohet me faktin që të mos e adhurojë Zotin e tij aq gjatë, si dhe fal namaz nate vullnetarisht, sepse ajo është periudha më e gjatë kur njeriu nuk fal namaz (prej namazit të jacisë deri në namazin e sabahut), kështu që përpos me namazet e obliguara, njeriu lidhet me Zotin edhe me namazet vullnetare, që të jetë në çdo periudhë të ditës i lidhur me Krijuesin Absolut.

[899] Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab istihbabu salati`d-duha, nr.722; etj.
[900] Sheukani, "Nejlu`l-Eutar", Mektebetu`l-Kulijati`l-Ez`herijjeti", 1978, vëll.3, fq.343;

HADITHI I SHTATËDHJETËETETË (78)

أَخْبَرَنَا مُحَمَّدُ بْنُ سَلَمَةَ قَالَ: حَدَّثَنَا ابْنُ وَهْبٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ، أَنَّ أَبَا عُشَّانَةَ الْمَعَافِرِيَّ حَدَّثَهُ، عَنْ عُقْبَةَ بْنِ عَامِرٍ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " يَعْجَبُ رَبُّكَ مِنْ رَاعِي غَنَمٍ فِي رَأْسِ شَظِيَّةِ الْجَبَلِ يُؤَذِّنُ بِالصَّلَاةِ وَيُصَلِّي، فَيَقُولُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: انْظُرُوا إِلَى عَبْدِي هَذَا يُؤَذِّنُ وَيُقِيمُ الصَّلَاةَ يَخَافُ مِنِّي، قَدْ غَفَرْتُ لِعَبْدِي وَأَدْخَلْتُهُ الْجَنَّةَ "

Nga Ukbeh b. Amir (r.a.) përcillet se ka thënë: "E dëgjova të Dërguarin e All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"Zoti kënaqet me bariun, i cili thërret ezanin për namaz dhe falet në majë të bjeshkës. Pastaj All-llahu thotë:* ***"Shiheni robin Tim i cili thërret ezanin dhe e fal namazin prej frikës ndaj Meje. Unë ia kam falë këtij robi mëkatet e tij dhe e kam pranuar në Xhenet".***[901]

Besimtari çdoherë është i gatshëm t`i përgjigjet thirrjes së Zotit kudo qoftë, si në shtëpi, punë, mal, fushë, sepse ai nuk i jep përparësi asgjëje para urdhrit të Zotit. Me kënaqësinë më të madhe i kryen urdhrat e Tij dhe nuk lodhet e as që mërzitet gjatë adhurimit. Puna dhe angazhimi për kërkimin e furnizimit, për të nuk është pengesë që të adhurojë Allahun xh.sh. kur vjen koha e namazit. Këtu kuptojmë se besimtari duhet t`i jep rëndësi kohës së namazit dhe duhet të ketë kujdes që ta kryejë namazin në kohën e vet, e jo të shtyhet për më vonë.

Ai që i kryen veprat për dyfaqësi, nuk do ta kishte kryer adhurimin nëse do të gjendej në ndonjë vend ku nuk e sheh askush, sepse ai vepron vetëm për

[901] Nesai-u, "Sunen", kitab Edhani, bab 26, nr.667; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Salatu`s-Sefer, bab 3, nr.1203; Ahmed-i, "Musned", 28/649, nr.17.442; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belban-it në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", vëll.4, fq.545, nr.1660; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.17, fq.302, nr.833; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sahihut të Ibni Hibanit, për këtë hadith thotë se ka zinxhirin Sahih, Ebu Ushane është i besueshëm, kurse transmetuesit tjerë janë sipas kushteve të Muslimit..;

ta parë njerëzit, por kur njeriu me të vërtetë ka frikë Zotin, ai do ta kryejë adhurimin kudo që të jetë, bile dëshiron që mos të vërehet në publik, sepse adhurimin e kryen për Zotin e jo për njerëzit.

Me pjesën ***`ja`xhebu rabbuke`*** *(Zoti habitet)* nuk nënkupton se te Zoti ndodh ndonjë ndryshim, por nënkupton miratimin e asaj vepre nga ana e Zotit dhe shpërblimin për atë vepër. Allahu xh.sh. do ta ngritë lart këtë person sepse Ai e vlerëson shumë këtë veprim te Vetja, andaj e përshkruan si formë e habisë, e jo se me të vërtetë Zoti habitet prej robërve të Vet, sepse Ai është më i Dijshëm për çdo gjë dhe ende pa vepruar njeriu, Zoti e din se çka do të bëjë dhe si do ta bëjë.

Sujuti dhe Sindi thonë se me pjesën `habitet` nënkupton kënaqësinë dhe shpërblimin e Zotit për atë veprim dhe kjo është si formë e metaforës dhe nuk nënkupton fjala `habi` gjendjen reale.[902]

Namazi falet edhe i vetëm në majë të malit, sepse nuk është kusht i namazit falja me *xhemat,* por është sunet i fortë që të thirret *ezan*-i, edhe nëse nuk ka askush përreth, nga shkaku se ezani është një adhurim prej të cilit fiton shpërblim, me çka dëshmon besimtari se e madhëron Zotin e vet kudo që të jetë. *Ezani* është një simbol i fesë Islame, me çka tregojmë madhështinë e kësaj feje karshi popujve tjerë.

Për një besimtar i cili thërret ezanin në vende ku nuk ka njerëz tjerë prezent, në Ditën e Gjykimit do të dëshmojë çdo gjë e cila e rrethon, qoftë ai njeri, *xhin, melek* apo edhe objekte të ngurta. Transmeton Ebu Seid el-Hudriju radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ndodh që ta dëgjojë zërin e myezinit ndonjë xhin, njeri apo diçka tjetër, përpos se do të jetë dëshmitar për të në Ditën e Kijametit".*[903]

Dhe *hadith*-et për vlerën e *ezan*-it janë të shumtë, ku në to tregohet se për thirrësin e *ezan*-it, do të ketë falje mëkatesh, se në Ditën e Gjykimit do të jenë njerëzit me qafat më të gjata. Kjo është një alegori që tregon se myezinët do të jenë prej të parëve që do të shohin apo ndjejnë mëshirën e Allahut xh.sh. ngase qafëgjati i sheh gjërat më parë se të tjerët që janë më të shkurtë se ai dhe kjo si shpërblim për atë që kanë thirrur njerëzit në namaz

[902] Sujuti, "Sunen Nesai bi sherh Hafidh Xhelaludin es-Sujuti ve hashijetu Sindi", vëll.1, fq.348;
[903] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab 5, nr.609; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 14, nr.645; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edhanu, bab 5, nr.723; etj.

dhe shumë *hadith*e me kuptime të ndryshme, që të gjitha aludojnë në vlerën e madhe që ngërthen në vete thirrja e *ezan*-it. Gjithashtu, kur thërret *ezani*, ikën *shejtan*-i dhe largohet derisa arrin në ato vende ku nuk dëgjohet zëri i tij.

Edhe nëse je vet gjatë faljes së namazit, në çast kur e thirr ezanin, do të bashkëngjiten *melekë*-t apo *xhin*-ët musliman në namazin tënd, andaj preferohet që të thirret *ezani* dhe *ikameti* para se të fillojmë faljen e namazit.

Dijetarët kanë pohuar se *ezani* dhe *ikameti* janë *sunet* për pesë namazet ditore, gjatë zbatimit të tyre në kohën e vet apo kur i kompensojmë (*kaza*), në rrugë apo në shtëpi, në *xhemat* apo kur falemi vet dhe kjo është vetëm për meshkujt. Për femrat, është *mekruh* (e papëlqyeshme) të thirret *ezan*-i dhe *ikamet*-i.[904]

Nëse besimtari falet në shtëpinë e tij, nuk e ka *mekruh* nëse nuk e këndon *ezan*-in, ngase i mjafton *ezan*-i i lagjes edhe pse i preferohet (*mendub*) që ta thërras atë.[905] Kjo, ngase transmetohet që Ibni Mes`udi radijeAllahu anhu ishte falur me miqtë e tij në shtëpi pa *ezan* dhe *ikamet* dhe me këtë rast kishte thënë: "Ikameti i vendit mjafton".[906]

Nëse besimtari falet (vet) në xhami, nuk do të thërras *ezan*, ngase me këtë do të shkaktonte hutim, pos nëse falet vetëm dhe thërret *ezan* me zë aq të ulët sa mund ta dëgjojë vetëm ai (atëherë lejohet). [907]

Në fund të këtij *hadithi kudsij*, shohim se Zoti krenohet para *melekëve* me këtë besimtarë dhe premton se atij do t`ia fal mëkatet dhe do t`ia mundësojë hyrjen në *Xhenet*. Allahu xhele she`nuhu i falë mëkatet e robërve të Tij të cilët janë të përkushtuar në adhurim dhe kanë frikë vetëm prej Zotit. Allahu xhele she`nuhu të këtillëve, do t`ua mundësojë hyrjen në *Xhenet*, sepse aty është vendi i atyre të cilët kanë frikë Zotin, ndërsa për ata të cilët adhurimet i kryejnë për dyfaqësi, nuk do të ketë falje dhe shpërblim, porse do të urdhërohen që të kërkojnë shpërblimin prej atyre për të cilët i kanë kryer adhurimet.

[904] Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, "Fikhu Hanefi", vëll.1, fq.243;
[905] Sagirxhi-u, "Et-Tejsir Fi`l-Fikhi`l-Hanefi", Daru`l-Kelimi`t-Tajib, 2002, vëll.1, fq.163;
[906] Tuhmaz, po aty, vëll.1, fq.244;
[907] Tuhmaz, po aty, vëll.1, fq.245;

Zoti krenohet dhe e konsideron rob të vërtetë atë i cili namazin e zbukuron dhe e perfeksionon, qoftë duke u falur vetë apo në publik. Për këtë është dëshmi *hadithi kudsij* të cilin e përcjell Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sallallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur robi falet në publik dhe e zbukuron atë, apo falet në fshehtësi dhe e zbukuron atë, Allahu xh.sh. thotë për të:* ***"Ky është robi Im i vërtetë".***[908]

Allahu xhele she`nuhu na mundësoftë të jemi të sinqertë në veprat tona, të kryejmë adhurimet vetëm për hir të Tij dhe t`i kryejmë adhurimet me nënshtrim dhe përkulje, Zoti na i faltë mëkatet dhe na mundësoftë *Xhenetin*. *Amin.*

[908] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 20, nr.4200; Busiri-ju në "Zevaid" thotë se në zinxhir gjendet Bekije b. Velidi i cili është *mudelis*, si dhe ka bërë *an-an*. Jahja b. Meini për të ka thënë: "Nëse përcjell prej të besueshmëve, atëherë nuk ka të keqe tek ai" kurse në një vend tjetër ka thënë: "atëherë është i sinqertë". (Ibni Meini, "Ma`rifetu`r-Rixhal", 1985, vëll.1, fq.79 dhe fq.84); Ibni Mubarek-u ka thënë se nëse i paraqiten hadithet e Ismail b. Ajashit dhe të Bekijes, atëherë më të dashur për të janë hadithet e Bekijes". Kështu përcillet edhe prej Ahmedit, vetëm se ai kushtëzon që të jetë prej të njohurve, e nëse përcjell prej të panjohurve, atëherë nuk pranohet hadithi i tij. (Ebu Hatimi, "Xherh ve Ta`dil", 2/434, nr.1728); Sufjan b. Ujejne ka thënë: "Ajo që përcillet në lidhje me sunetin nga Bekije, mos e pranoni, e çka përcillet në lidhje me shpërblimin e të tjera, atëherë pranonie". Ixhliu thotë: "Është i besueshëm kur përcjell prej të njohurve, e kur përcjell prej të panjohurve, atëherë nuk është asgjë transmetimi i tij". (Mizzi-u, "Tehdhibu`l-Kemal", 4/196 dhe fq.198).

HADITHI I SHTATËDHJETËENËNTË (79)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عُثْمَانَ بْنِ مَخْلَدٍ الْوَاسِطِيُّ، قَالَ: نا أَبِي، عَنْ زِيَادِ بْنِ الْمُنْذِرِ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَلِيِّ بْنِ الْحُسَيْنِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ: لَمَّا أَرَادَ اللَّهُ أَنْ يُعَلِّمَ رَسُولَهُ الْأَذَانَ أَتَاهُ جِبْرِيلُ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِمَا بِدَابَّةٍ يُقَالُ لَهَا: الْبُرَاقُ، فَذَهَبَ يَرْكَبُهَا فَاسْتَصْعَبَتْ، فَقَالَ لَهَا جِبْرِيلُ: اسْكُنِي فَوَاللَّهِ مَا رَكِبَكِ عَبْدٌ أَكْرَمُ عَلَى اللَّهِ مِنْ مُحَمَّدٍ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، قَالَ: فَرَكِبَهَا حَتَّى انْتَهَى إِلَى الْحِجَابِ الَّذِي يَلِي الرَّحْمَنَ تَبَارَكَ وَتَعَالَى قَالَ: فَبَيْنَمَا هُوَ كَذَلِكَ إِذْ خَرَجَ مَلَكٌ مِنَ الْحِجَابِ، فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: يَا جِبْرِيلُ مَنْ هَذَا؟ قَالَ: وَالَّذِي بَعَثَكَ بِالْحَقِّ إِنِّي لَأَقْرَبُ الْخَلْقِ مَكَانًا وَإِنَّ هَذَا الْمَلَكُ مَا رَأَيْتُهُ مُنْذُ خُلِقْتُ قَبْلَ سَاعَتِي هَذِهِ، فَقَالَ الْمَلَكُ: اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، قَالَ: فَقِيلَ لَهُ مِنْ وَرَاءِ الْحِجَابِ: صَدَقَ عَبْدِي أَنَا أَكْبَرُ أَنَا أَكْبَرُ، ثُمَّ قَالَ الْمَلَكُ: أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، قَالَ: فَقِيلَ لَهُ مِنْ وَرَاءِ الْحِجَابِ: صَدَقَ عَبْدِي أَنَا لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا، قَالَ: فَقَالَ الْمَلَكُ: أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، قَالَ: فَقِيلَ مِنْ وَرَاءِ الْحِجَابِ: صَدَقَ عَبْدِي أَنَا أَرْسَلْتُ مُحَمَّدًا، قَالَ الْمَلَكُ: حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ، قَدْ قَامَتِ الصَّلَاةُ، ثُمَّ قَالَ الْمَلَكُ: اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، قَالَ: فَقِيلَ مِنْ وَرَاءِ الْحِجَابِ: صَدَقَ عَبْدِي أَنَا أَكْبَرُ أَنَا أَكْبَرُ، ثُمَّ قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، قَالَ: فَقِيلَ مِنْ وَرَاءِ الْحِجَابِ: صَدَقَ عَبْدِي لَا إِلَهَ إِلَا أَنَا، قَالَ: ثُمَّ أَخَذَ الْمَلَكُ بِيَدِ مُحَمَّدٍ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَدَّمَهُ فَهَمَّ أَهْلُ السَّمَاءِ فِيهِمْ آدَمُ، وَنُوحٌ.

Transmeton Aliu (r.a.) i cili ka thënë: "Kur Allahu (xh.sh.) deshi që të Dërguarit të Tij t`ia mësojë ezanin, i erdhi Xhibrili a.s. me një kafshë me

emrin *Burak*. Kur deshi t`i hipte asaj, për të mos e hipur, u shqetësua. Xhibrili a.s. i tha asaj: "Qetësohu, se vallahi nuk ka hypur te ti ndonjë rob më i ndershëm tek Allahu sesa Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem". Tha: "Ai i hypi mbi të dhe vazhduan derisa erdhën te një perde dhe iu afrua Rahmanit xh.sh. (të Gjithëmëshirshmit) se ai vetëm kështu mund të ishte. Pas perdes doli një *melek* dhe Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"O Xhibril, kush është ky?" Ai tha: "Pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, unë jam krijesa më e afërt me pozitë, por këtë melek nuk e kam parë para këtij momenti që kur jam krijuar". Meleku tha: "Allahu ekber Allahu ekber (Allahu është më i Madhi)". Tha: "Iu tha atij prej pas perdes:* ***"Robi im e tha të vërtetën, Unë jam më i Madhi, Unë jam më i Madhi".*** *Pastaj meleku tha: "Esh`hedu el-la ilahe il-lallah (Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër përpos Allahut)". Tha: "Iu tha atij prej pas perdes:* ***"Robi im e tha të vërtetën, nuk ka hyjni tjetër përpos Meje".*** *Meleku tha: "Esh`hedu enne Muhameden resulullah (Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut) Tha: "Iu tha atij prej pas perdes:* ***"Robi im e tha të vërtetën, Unë e kam dërguar Muhamedin".*** *Meleku tha: "Hajja ale`s-Salah Hajja ale`l-Felah kad kameti`s-salatu (ejani në namaz, ejani në shpëtim, namazi ka filluar)" pastaj meleku tha: "Allahu ekber Allahu ekber" Tha: "Iu tha atij prej pas perdes:* ***"Robi im e tha të vërtetën, Unë jam më i Madhi, Unë jam më i Madhi".*** *Pastaj tha: "La ilahe il-lallah (nuk ka hyjni tjetër përpos Allahut)". Tha: "Iu tha atij prej pas perdes:* ***"Robi im e tha të vërtetën, nuk ka hyjni përpos Meje".*** *Tha: "Pastaj e mori meleku për dore Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe shkoi me të për të parë banorët e qiellit, e prej tyre edhe Ademin (a.s.) dhe Nuhin (a.s.)".*[909]

Ky *hadith kudsi* flet për zanafillën e *ezan*-it dhe se si meleku i veçantë për këtë rast ia mësoi Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem mënyrën e

[909] Bezzari, "El-Bahru`z-Zehar el Ma`ruf bi Musned Bezzar", vëll.2, fq.146-147, nr.508; Bezzari thotë se nuk e dimë këtë hadith me këtë tekst të përcillet përmes Aliut përpos përmes këtij zinxhiri, (në zinxhir gjendet) Zijad b. Mundhir, i cili është shiit, kurse prej tij ka përcjellur edhe Mervan b. Muavije etj"; Ibni Haxher el-Askalani në "Tekrib" thotë për Zijad b. Mundhiriun se ai është Ebu Xharud el-A`ma nga Kufja, ka qenë Rafidij, e ka përgënjeshtruar atë Jahja b. Meini…". (Ibni Haxher-i, "Tekribu`t-Tehdhib", fq.209, nr.2101). Hejthemi-u e shënon hadithin në "Mexhmeu`z-Zevaid", vëll.2, fq.62-63, nr.1851 dhe thotë se "e shënon Bezzari, në të gjendet Zijad b. Mundhir, për të cilin dijetarët janë unik se ai është i dobët"; Hejthemi-u hadithin e shënon edhe në "Keshfu`l-Estar an Zevaidi`l-Bezzar", tahkik Habibu Rahman el-Adhamiju, Muessesetur-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1979, vëll.1, fq.178, nr.352;

thirrjes së *ezan*-it. Por, ky *hadith* përpos që është i rrallë, pasi e shënon vetëm Bezzari, në zinxhirin e *hadith*-it ka dobësi shkaku i një transmetuesi, por edhe në tekstin e *hadith*-it ka disa kontradikta.

Ky *hadith* flet për udhëtimin e *Miraxh*-it, që ka ndodhur tre vite para Hixhretit, kurse *ezan*-i është ligjësuar pas ardhjes në Medine. Këtë e dëshmon *hadith*-i tek imam Buhariu, që e përcjell Ibni Umeri r.a. i cili thotë: "Muslimanët pasi erdhën në Medine, ishin tubuar dhe e prisnin namazin dhe po bisedonin për këtë. Por nuk kishin me çka t`i thirrin njerëzit për të. Disa thanë: "Të marrim një këmbanë siç bëjnë të krishterët". Disa të tjerë thanë: "Të marrim një bori sikur e kanë jehudët". Umeri r.a. tha: "Përse të mos çohet një njeri që të thërret për namaz?!". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"O Bilal, çohu dhe thirri për namaz".*[910]

Kurse te koleksionuesit tjerë të *hadith*-it, rrëfehet se inspirimi i tekstit të ezanit ka ardhur sipas një ëndrre që ka parë *sahabiu* Abdullah b. Zejdi r.a. Transmeton Jahja b. Seidi se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem deshi që të merr dy dërrasa për të tubuar njerëzit për namaz. Abdullah b. Zejdi i shqetësuar për brengën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem për të gjetur një formë për bashkimin e xhematit për namaz, kishte shkuar në shtëpi dhe pasi kishte ra në gjumë kishte parë një ëndër ku thotë: "Derisa isha në gjum, një njeri u soll reth meje e në dorë kishte dy dërrasa, e unë i thash: "O zotri, a nuk mi shet këto?" Ai më tha: "Çka do të bësh me të?" Thashë: "Me të i thirrim njerëzit për namaz!" Ai më tha: "A dëshiron të të mësoj për një gjë më të mirë se kjo?" I Thash: "Po si jo". Tha: "Thuaj: **"All-llahu ekber**, **All-llahu ekber"**, deri në fund të *ezan*-it. Pastaj u largua pak nga unë dhe më tha: "E kur ta këndosh *ikamet*-in thuaj: All-llahu ekber, All-llahu ekber, e pas fjalës "haj-je alel felah" shtoje "kad kametis-salatu". Kur u zgjova shkova te i Dërguari i All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe e informova për ëndrrën, e ai më tha: *"Ajo është ëndërr e vërtetë. Çohu me Bilalin, tregoja atij ezanin e ai le ta thirrë sepse e ka zërin më të thekshëm se ti"*. Pasi këtë e dëgjoi Omeri r.a. i kishte thënë Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "O i Dërguari i Allahut, pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, edhe unë e kam parë të njëjtën që e ka parë Abdullahu". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Falënderimi i takon Allahut"*.[911]

---

[910] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab bed`ul-edhan, nr.604; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab bed`ul-edhan, nr.377; etj.

[911] Malik-u, "Muvetta", kitab es-Salatu, bab ma xhae fi nidai lis-salat, nr.143; Ebu Davud-i, "Sahih", kitab es-Salati, nr.512; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab fi bed`il-edhan,

Në bazë të këtyre transmetimeve të sakta, shohim se nuk përputhet tregimi dhe është plotësisht në kundërshtim me versionin që shënohet përmes Aliut r.a. si *hadith kudsi*. Pra, nga kjo kuptojmë se edhe teksti i këtij *hadith*-i *kudsij* është problematik, sepse nuk përputhet me kohën dhe ngjarjen.

Në *hadith* potencohet perdja si pengesë në mes Zotit dhe Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që në një farë mënyre, i jep kahje dhe drejtim Zotit, që është në kundërshtim me besimin e saktë të *ehlu-sunet*-it.

Gjithashtu në tekst të *hadith*-it, përmendet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem gjatë këtij udhëtimi, ka parë Ademin a.s. dhe Nuhin a.s., kurse në hadithet që flasin për udhëtimin e *Miraxh*-it, nuk përmendet Nuhu a.s. Nëse tubojmë rrugët e këtyre transmetimeve, shohim se në katin e parë të qiellit është Ademi a.s. pastaj në të dytin është Isa dhe Jahja a.s. më pas në të tretin Jusufi a.s., në qiellin e katërt është Idrizi a.s., në qiellin e pestë është Haruni a.s., në qiellin e gjashtë gjendet Musa a.s. dhe në qiellin e shtatë është Ibrahimi a.s.[912]

Vërejmë qartë se ky *hadith kudsi* bie në kundërshtim me shumë tekste tjera të sakta dhe shkaku që ka dobësi në tekst dhe në zinxhir, ky *hadith* konsiderohet i dobët dhe nuk do të zgjerohemi më shumë në interpretimin e tij.

---

nr.189; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edhanu, bab bed`ul-edhan, nr.706; Ahmed-i, "Musned", 26/397, nr.16.476-78;

[912] Shih: Buhari-u, "Sahih", kitab es-Salat, bab 1, nr.349, etj.

HADITHI I TETËDHJETË (80)

حَدَّثَنَا حَيْوَةُ بْنُ شُرَيْحٍ الْحَضْرَمِيُّ، حَدَّثَنَا بَقِيَّةُ، عَنْ ضُبَارَةَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي سُلَيْكٍ الْأَهْلَانِيِّ، أَخْبَرَنِي ابْنُ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ شِهَابٍ الزُّهْرِيِّ، قَالَ: قَالَ سَعِيدُ بْنُ الْمُسَيِّبِ: إِنَّ أَبَا قَتَادَةَ بْنَ رِبْعِيٍّ أَخْبَرَهُ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: «إِنِّي فَرَضْتُ عَلَى أُمَّتِكَ خَمْسَ صَلَوَاتٍ وَعَهِدْتُ عِنْدِي عَهْدًا أَنَّهُ مَنْ جَاءَ يُحَافِظُ عَلَيْهِنَّ لِوَقْتِهِنَّ أَدْخَلْتُهُ الْجَنَّةَ وَمَنْ لَمْ يُحَافِظْ عَلَيْهِنَّ فَلَا عَهْدَ لَهُ عِنْدِي»

Transmeton Ebu Katade (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "*Ka thënë Allahu xhele she`nuhu:* ***"Unë ia kam bërë obligim ummetit tënd pesë namaze dhe jam besatuar në veten Time se ai i cili vjen duke i ruajtur (duke i falur ato) në kohët e tyre, do ta fusë në Xhenet. Kurse ai i cili nuk i ruan ato (duke mos i falur) ai nuk ka besë (mbrojtje dhe sigurim) tek Unë".***[913]

---

[913] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 9, nr.430; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab 194, nr.1403; Dejlemi-u, "Firdeus", vëll.3, fq.166, nr.4440; Busiri-u në "Zevaid", (1/452) thotë: "Ky zinxhir duhet të shikohet, sepse në të gjenden Dubare b. Abdullah dhe Duvejd b. Nafi". Ibni Kattani thotë për Dubare-n: "është i panjohur"; kurse Ibni Adij e konsideron të dobët dhe thotë se gjashtë hadithe i ka munker; kurse Duvejdin e kanë konsideruar të besueshëm Dhuhejli dhe Ixhli; Sujuti në "Xhamiu`s-Sagir", 2/678 aludon në dobësinë e këtij hadithi; Mul-la Ali el-Kariu në "Ehadith kudsije el-erbainije" fq.73 thotë se e përjcell Ibni Maxhe me zinxhir Hasen;
hadith i ngjashëm përcillet edhe nga Ubade b. Samit r.a. të cilin e regjistron Tajalis-i, në "Musned", nr.573, Ibni Maxheh, në "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab 194, nr.1401; Ebu Davudi, në "Sunen", kitab es-Salati, nr.425; Ahmedi, "Musned", 5/317, nr.2891. Këta e shënojnë me këtë tekst: *"Allahu i ka bërë obligim pesë kohët e namazit, ai i cili e merr abdesin sipas rregullave duke i falur ato (namazet) në kohët e tyre, duke plotësuar rukun e tyre dhe duke i falur ato me devotshmëri, ai e ka besën e Zotit, se do t`ia falë mëkatet e tij. E kush nuk vepron kështu, ai nuk ka besë (mbrojtje dhe siguri) te Allahu. Nëse do, e falë atë e nëse do, e ndëshkon".*
imam Ahmed-i e shënon këtë hadith edhe përmes Ka`b b. Uxhre r.a. i cili tregon se kanë qenë në xhami duke pritur namazin e drekës, e Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i pyeti se çka po bëjnë aty? Ata u përgjigjën se e presin namazin! Në këtë, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e çoi kokën kah qielli dhe pastaj na tha: *"A e dini se çka thotë Zoti*

Allahu xhele she`nuhu i obligoi besimtarët musliman me faljen e pesë kohëve të namazit, duke e obliguar çdo namaz në kohë të caktuar, ashtu siç thotë edhe në *ajet*-in kuranorë: **"Me të vërtetë namazi është i caktuar për besimtarët në kohë të caktuar".**[914] Prandaj, edhe kur u pyet Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem se cila është vepra më e mirë? Ai u përgjigj: *"Falja e namazit në kohën e vet".*[915]

Në lidhje me këtë kontekst, kemi edhe përcjelljen e Hasenit se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Zoti ka thënë:* ***"Kush i ruan tre gjëra është rob i Imi i vërtetë dhe i dashuri Im, e kush nuk i kryen, ai është armiku Im i vërtetë: "Namazin, agjërimin dhe guslin nga xhunubllëku".***[916]

Nëse ne kujdesemi që t`i falim këto namaze në kohën e vet, duke mos e anashkaluar obligueshmërinë e namazit, atëherë Allahu xhele she`nuhu betohet në Veten e Vet, betim i cili nuk ka mundësi të thyhet, se do t`i shpëtojë ata besimtarë që ruajnë namazin, do t`ua falë mëkatet dhe do t`i fus në *Xhenet*.

Namazi është i obliguar për çdo besimtar të moshërritur, qoftë mashkull apo femër, i lirë apo rob, qoftë vendas apo udhëtar, i shëndosh apo i sëmurë, në gjendje lirie apo gjendje lufte, pra, në çdo situatë, namazi nuk pushon nga dispozita obliguese. Sipas fjalës së Aliut r.a., këshilla e fundit që dha Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem për brezat që pasojnë dhe fjala e fundit që shqiptoi ishte: "*Namazi, Namazi*".[917]

Zoti tregon se ia ka bërë *farz* këtij *ummet*-i faljen e namazit, duke e dalluar nga të gjithë *ummet*-et e mëparshme. Edhe te pejgamberët tjerë ka ekzistuar falja e namazit, porse *ummet*-i i jonë u dallua me faljen e këtyre pesë namazeve në kohë të caktuar. Ky obligim, është i vetmi i cili u obligua në

---

i juaj?" Pastaj vazhdon hadithi sikur hadithi i përmendur, shih Ahmedi, "Musned", 30/55, nr.18.132;

[914] Kurani, Nisa, 103;

[915] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 36, nr.85 dhe Ahmed-i, "Musned", vëll.7, fq.5, nr.3890 nga Abdullah b. Mes`udi radiaAllahu anhu;

[916] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.4, fq.265, nr.2494; e regjistron edhe Taberani në "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.9, fq.8, nr.8961 nga Enes b. Maliku r.a. por jo si hadith kudsij.

[917] Ahmed-i, "Musned", 2/24, nr.585;

qiell, në natën e *Miraxh*-it. Po ashtu, i vetmi obligim i cili u obligua pa ndërmjetësimin e *melekut*, porse drejtpërdrejt Allahu xhele she`nuhu ia obligoi Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Numri i namazeve është pesë kohë, ndërsa në shpërblim janë të barabartë me 50 namaze, sepse Zoti për çdo vepër, shpërblen dhjetëfish. Po ashtu, në natën e *Miraxh-it*, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur u obligua me pesëdhjet kohët e namazit, Musa alejhi`s-selam e këshilloi që të kërkojë t`i lehtësohet *ummet-it*, sepse nuk do të mund ta realizojnë. Kështu që, ai kërkoi derisa u zbrit numri prej 50, në pesë namaze brenda një dite.[918]

Njeriu më afër Zotit është kur gjatë namazit shkon në *sexhde*, në këtë pozicion, ai e lartëson Zotin e tij, i Cili është më meritori për falënderim dhe për t`iu bërë *sexhde*, sepse Zoti nuk i ka krijuar njerëzit dhe xhinët për diç tjetër, përpos se për ta njohur dhe për ta adhuruar Atë.[919]

Namazi është biseda e drejtpërdrejt e robit me Zotin, pa ndërmjetësues dhe pa pengesë, andaj, nëse dëshiron të flasësh me Zotin, bëje këtë përmes namazit. Për këtë arsye, besimtari nuk duhet të lejojë që t`i kalojë namazi pa e falur. Si mundet vallë njeriu të mos përgjigjet në bisedë me Zotin? Paramendoni tani se si do të ishte situata nëse njeriu më i dashur të kërkon e ti mos ia hapësh telefonin?! E si atëherë Zotit ia anulon thirrjen kur thërritesh për namaz pesë herë në ditë?! A nuk dëshiron t`i përgjigjesh thirrjes së Zotit kur thërret *myezini "Hajja al`el-Felah"* (Eja në shpëtim?!) A nuk e kupton se namazi është shpëtim?! Nëse i përgjigjesh asaj thirrje, do të arrijsh shpëtimin në këtë botë dhe në botën tjetër, do të pastrohesh nga mëkatet ashtu siç pastrohet njeriu nëse lahet pesë herë në ditë dhe çka është më kryesorja, do ta kesh në duart tua çelësin e Xhenetit, sepse namazi është çelësi i tij.

Pejgamberit tonë sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur i vështirësohej ndonjë çështje dhe nuk gjente rrugëzgjidhje, atëherë i drejtohej Zotit me namaz.[920]

Besatimi i Zotit në Vetveten, nënkupton nderimin e robit me një nder të veçantë dhe të dalluar, sepse besa që jep Zoti nuk ndryshon dhe nuk thyhet

[918] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 1, nr.349; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 74, nr.163; etj.
[919] Shih: Kurani, Dharijat, 56;
[920] Transmeton Hudhejfe radiaAllahu anhu se kur Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i vështirësohej ndonjë çështje, falte namaz". Shih: Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab vaktu kijami`n-Nebiji minel lejli, nr.1319; Ahmed-i, "Musned", 38/330, nr.23.299;

assesi sepse edhe Zoti thotë në Kuran: **“Allahu nuk e thyen premtimin”.**[921]

Kurse ruajtja e namazit, nënkupton plotësimin e saj në mënyrën më të mirë që është e mundshme, duke marr abdesin në rregull, duke zgjedhur rrobat më të mira, duke u falur me përpikëri, duke plotësuar qëndrimin në këmbë, *rukunë* dhe *sexhden*, ku në këtë mënyrë do të jetë namazi më i plotësuar. Zoti në Kuran, tregon për cilësitë e besimtarëve të shpëtuar, ku në fillim të saj përmend ata që namazin e tyre e falin me respekt. Zoti thotë: **“Kanë shpëtuar besimtarët. Të cilët ndaj namazit të tyre janë të kujdesshëm”.**[922] Po ashtu i përmend edhe ata që e ruajnë namazin e tyre, ku thotë: **“Dhe ata të cilët e ruajnë namazin e tyre”.**[923]

Gjithashtu Zoti urdhëron ruajtjen e namazeve edhe në një vend tjetër, ku thotë: **“Vazhdoni rregullisht** (**ruani) namazet, e edhe atë namazin e mesëm dhe ndaj Allahut të jeni respektues”.**[924]

Ruajtja e namazit, bëhet edhe përmes pritjes së namazit në xhami, kur njeriu e përfundon një namaz, e pastaj pret të vjen koha e namazit tjetër. Transmeton Abdullah b. Amri radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem pasi e fali akshamin, hyri në shtëpinë e vet, e kush doli prej xhamie doli, e kush qëndroi mbeti, më pas erdhi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke nxituar, i mbushur në frymë dhe duke u mbështetur me duar te gjunjët e tij tha: *“Përgëzime, ky është Zoti i juaj i Cili ka hapur një prej dyerve të qiellit dhe krenohet para melekëve duke thënë:* ***“Shikoni robërit e Mi, e kanë falur një farz e tash janë duke pritur tjetrin”.***[925]

Në fundin e kësaj pjese të *hadithit kudsij*, thotë Zoti se këtë person i cili është i kujdesshëm për namazin e vet, do ta fus në *Xhenet*. Kjo është besa që ka dhënë Zoti ndaj besimtarëve. Në këtë kuptim, janë edhe *ajetet* që flasin

---

[921] Kurani, Ali Imran, 9 dhe Rra`d, 31;
[922] Kurani, Mu`minun, 1-2;
[923] Kurani, Mu`minun, 9;
[924] Kurani, Bekare, 238;
[925] Ibni Maxheh, “Sunen”, kitab el-Mesaxhidu, bab 19, nr.801; Ahmed-i, “Musned”, 11/362, nr.6750; etj. Busiri-u në “Zevaid”, thotë: “Zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, kurse transmetuesit janë të besueshëm”; Mundhiriu në “Tergib” 1/372, nr.117 thotë se transmetuesit janë të besueshëm; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmedit, për këtë hadith thotë se e ka zinxhirin Sahih, sipas kushteve të Muslim-it, transmetuesit janë të besueshëm, që gjenden edhe në dy Sahihe, përpos Hamad b. Seleme, i cili është prej transmetuesve të Muslimit...”.

për cilësitë e besimtarëve, ku thotë: **"Ata do të trashëgojnë Xhenetin Firdeus ku do të jenë përgjithmonë".**[926] Pra, në fillim të *sure*-s Mu`minun, ku Zoti i përmendi cilësitë e besimtarëve, ndër to, përmendi qëndrueshmërinë e tyre për faljen e namazit dhe ruajtjen e tij në mënyrë të duhur, kurse në fund bëri me dije se ata do të jenë trashëgimtarë të *Xhenetit Firdeus*.

Por, nëse veprojnë muslimanët në mënyrë të kundërt, duke mos i ruajtur namazet dhe duke mos i falur ato në mënyrë të përpiktë, atëherë ata do të ngelin në mëshirën e Zotit, nëse do, i dënon, e nëse do, ua fal atyre gabimin. Për këtë, edhe thotë Zoti në Kuran: **"Mjerë për ata që falin namazin. Që në namazin e tyre janë të pakujdesshëm".**[927] Apo siç thotë në *ajet*-in tjetër: **"E kur çohen për në namaz, çohen me përtaci, si dhe falen për t`u paraqitur para njerëzve".**[928]

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem na tregoi se kush e humb namazin, është sikur t`i jetë shkatërruar familja dhe pasuria, ky person nuk do të ketë ndihmë në Ditën e Gjykimit, nuk do të pastrohet nga mëkatet, nuk do të ketë dritë, si dhe do përfundojë në Zjarr me zullumqarët tjerë.

Nga ky *hadith kudsij*, po ashtu kuptojmë se personi i cili nuk ka arritur të fal namazin, nuk del prej fesë dhe nuk bëhet *kafir* përderisa nuk e mohon obligimin e namazit, por ai do të ngelet në mëshirën e Zotit, nëse do Zoti e fal, nëse do e dënon. Pra, sikur të bëhej *kafir* njeriu i cili nuk e fal namazin, atëherë nuk do të përdorej në *hadith* shprehja `nëse do e fal`, sepse për pabesimtarin nuk do të ketë falje nga ana e Zotit në botën tjetër, pasi falja është enkas për muslimanët.

Të jemi sa më të kujdesshëm ndaj namazit, që Allahu xh.sh të na përfshijë me Mëshirën e Tij të gjerë dhe të na mundësojë *Xhenetin.*

[926] Kurani, Mu`minun, 11;
[927] Kurani, Maun, 4-5;
[928] Kurani, Nisa, 142;

HADITHI I TETËDHJETËENJËTË (81)

حَدَّثَنَا حَسَنٌ، حَدَّثَنَا ابْنُ لَهِيعَةَ، حَدَّثَنَا أَبُو عُشَّانَةَ، أَنَّهُ سَمِعَ عُقْبَةَ بْنَ عَامِرٍ، يَقُولُ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " رَجُلَانِ مِنْ أُمَّتِي يَقُومُ أَحَدُهُمَا مِنَ اللَّيْلِ فَيُعَالِجُ نَفْسَهُ إِلَى الطَّهُورِ وَعَلَيْهِ عُقَدٌ فَيَتَوَضَّأُ، فَإِذَا وَضَّأَ يَدَيْهِ، انْحَلَّتْ عُقْدَةٌ ، وَإِذَا وَضَّأَ وَجْهَهُ، انْحَلَّتْ عُقْدَةٌ، وَإِذَا مَسَحَ رَأْسَهُ، انْحَلَّتْ عُقْدَةٌ، وَإِذَا وَضَّأَ رِجْلَيْهِ، انْحَلَّتْ عُقْدَةٌ، فَيَقُولُ الرَّبُّ لِلَّذِينَ وَرَاءَ الْحِجَابِ: انْظُرُوا إِلَى عَبْدِي هَذَا يُعَالِجُ نَفْسَهُ، مَا سَأَلَنِي عَبْدِي هَذَا فَهُوَ لَهُ "

Nga Ukbeh b. Amir (r.a.) përcillet se ka thënë: "Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nga ummeti im, dy persona (i donë Allahu apo ua fal atyre), njëri prej tyre ngrihet natën dhe veten e tij e angazhon drejt ujit (pastrohet me abdes) edhe pse në vetveten e tij ka lidhëse (pengesa). Kur i lanë krahët, i zgjidhet një nyjë, kur e lanë fytyrën, i zgjidhet edhe një nyje, pasi e përkon kokën, i zgjidhet edhe një nyje tjetër, dhe kështu edhe kur i lanë këmbët i zgjidhet një nyje. Më pas, Zoti xhele she`nuhu u thotë atyre që janë pas perdeve (engjëjve):* ***"Shikojeni robin Tim që merret me veten e tij, çka do që të më kërkoj ky rob i Imi, do t`i jap".***[929]

Edhe ky *hadith* trajton njësinë e namazit vullnetarë, konkretisht faljen e namazit të natës, një namaz të cilin i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk e ka braktisur gati asnjëherë. Ky lloj namazi ka vlerë të veçantë, pasi besimtari vetmohet me Zotin e vet në kohën kur të tjerët janë duke fjetur. Besimtari i jep përparësi Zotit para çdo gjëje, nga fakti se kur thotë në

[929] Ahmed-i, "Musned", 28/657, nr.17.458 dhe 29/329, nr.17.791; Ebu Ja`la, "Musned", fq.409, nr.1751; Tahavi-u, "Mushkilu`l-Athar", vëll.1, fq.368, nr.416; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", vëll.6, fq.295, nr.2555; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.17, fq.305, nr.843; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, për këtë hadith thotë se është Sahih; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 1/309, nr.1135 thotë: "E transmetojnë Ahmedi dhe Taberani në "Kebir"... e përcjellin përmes dy zinxhirëve, transmetuesit e njërit prej tyre janë të besueshëm".

namaz `Zoti është më i madh`, tregon se nuk i jep rëndësi gjumit para adhurimit. E ky besimtar, në kohën kur të tjerët janë në gjumë, çohet dhe në thellësinë dhe qetësinë e natës, e adhuron Allahun xhele she`nuhu.

Zoti e përmendi namazin e natës në shumë *ajet*-e kuranore, por ne do të përmendim vetëm disa sa për të kuptuar rëndësinë që i jep Zoti këtij lloj namazi. Thuhet në Kuran: **"E robërit e të Gjithëmëshirshmit, janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe!" Dhe për hir të Zotit të tyre, natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë".**[930]

"O ti i mbuluar! Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj. Gjysmën e saj, apo diçka më pak se gjysma. Ose shto diçka ndaj saj dhe lexoje Kuranin me vëmendje..".[931]

"Ata ngriten nga shtrati dhe bëjnë ibadet natën".[932]

"Dhe një pjesë të natës, zgjohu me të! Kjo është vetëm për ty. Ndoshta Zoti yt do të ringjallë në një vend të lavdëruar".[933]

Në koment të ajetit 79 të sures Isra, Sujuti në *tefsir*-in e vet shënon një transmetim nga Aishja radiaAllahu anha ku tregon se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre gjëra janë farz për mua, kurse sunet për umetin tim: "Namazi i vitrit, misvaku dhe namazi i natës*".[934]

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk e ka braktisur namazin e natës nga shkaku se për të ka qenë i obliguar, kurse neve na ngelet si namaz vullnetarë. Namazi i natës është namazi më i dashur pas namazit të obliguar, kurse *hadith*-et në këtë temë janë të shumta, andaj ne nuk do të zgjerohemi në to.

Në këtë *hadith kudsij,* na bëhet me dije se besimari që shkon në gjumë, i lidhen atij disa nyje dhe i vendohen disa pengesa nga ana e *shejtan*-it, që të

[930] Kurani, Furkan, 63-64;
[931] Kurani, Muzemmil, 1-4;
[932] Kurani, Sexhde, 16;
[933] Kurani, Isra, 79;
[934] Taberani, "Mu`xhemu`l-Euset", vëll.3, fq.315, nr.3266; Sujuti, "Ed-Durru`l-Menthur", 9/417; Për Musa b. Abdurahmanin, Ibni Hibani thotë se është shpikës i haditheve; hadithin e shënon edhe Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 8/264, nr.13.981 dhe thotë për këtë transmetues se është gënjeshtar;

mos arrijë të çohet për të falë namaz nate apo namazin e sabahut. Çdoherë do ta preokupojë me gjëra që ta bëjë të harrojë namazin, sidomos në kohën e sabahut, i fut në mendje se ka kohë namazi ende, kështu që ai mashtrohet nga kjo intrigë dhe vazhdon gjumin duke menduar se ka kohë, por në esencë kur do të zgjohet, do të vërejë se i ka kaluar koha e namazit.

Për këto nyje që i lidh *shejtan*-i tek njeriu, tregohet edhe në *hadith*-in tjetër të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Shejtani çdonjërit prej jush, kur të flejë ia lidh tri nyje në qafë dhe i thotë flejë se para teje është një natë e gjatë. Dhe kur të zgjohet, nëse e përmend Allahun e zgjidh një nyje, nëse merr abdes e zgjidh edhe një nyje tjetër. E nëse edhe falet, e zgjidh edhe nyjën e tretë. Ai njeri do të zgjohet aktiv dhe i disponuar, por nëse nuk vepron kështu, do të zgjohet i padisponuar dhe dembel".*[935]

Ne nuk mund t`i vërejmë ato nyje, nga shkaku se ato nuk janë objekte fizike, porse metafizike, ngjashëm siç është edhe trupi i melekëve dhe *shejtan*-ëve i padukshëm për syrin tonë, ashtu janë edhe mjetet e tyre.

Arma e besimtarit kundër *shejtan*-it është abdesi, prandaj i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem u tha *sahab-ëve*, që kur të nervozohen të marrin abdes, ngase nervoza është prej *shejtan*-it, e *shejtan*-i është prej zjarri, kurse zjarrin e shuan vetëm uji.[936] Andaj, nëse dëshironi ta shuani hidhërimin, merrni abdes dhe faleni ndonjë namaz vullnetarë, me çka do të kalojë gjendja e tensionuar.

Zoti pasi krenohet me veprimin e këtij besimtari, që natën është ngritur për të falë namaz, tregon se këtij do t`ia pranojë lutjen, pa marrë parasysh se çka do të kërkojë. Kjo është prej mëshirës së Zotit i Cili ua plotëson nevojat besimtarëve të cilët i drejtohen vetëm Atij.

Për këtë pjesë të *hadithit*, shërben si dëshmi edhe *hadithi* tjetër i konfirmuar ku tregohet se brenda natës ekziston një çast, në të cilin besimtari nëse do të

[935] Buhari-u, "Sahih", kitab Tehexhud, bab 12, nr.1142; Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 28, nr.776; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 18, nr.1306; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salat, bab 5, nr.1608; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab ma xhae fi kijami lejli, nr.1329; Ahmed-i, "Musned", 12/258, nr.7308; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", vëll.6, fq.293, nr.2553; etj.

[936] Shih: Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Edebi, bab ma jukalu inde`l-gadabi, nr.4784; Ahmed-i, "Musned", 29/505, nr.17.985;

lutej, lutja do t`i pranohej. Dhe kjo ndodh për çdo natë. Transmeton Xhabiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Gjatë natës, ekziston një moment që nëse njeriu në të kërkon ndonjë të mirë të kësaj bote apo botës tjetër, ajo do t`i jepet. Ky çast është në çdo natë".*[937]

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Vërtet Allahu (xh.sh.) zbret çdo natë në qiellin më të ulët, kur mbetet pjesa e fundit e natës, dhe thotë:* ***"A ka dikush që pendohet, që t`ia pranojë pendimin? A ka dikush që kërkon falje për mëkatet, që t`ia fal? A ka dikush që lyp diçka, e t`ia jap atë që lyp?*** *E kështu vazhdon derisa të lindë agimi".*[938]

Mjafton që besimtari të çohet në këtë pjesë të natës, të merr abdes dhe të falë së paku dy *rekate* namaz vullnetarë, ndërsa Allahu xhele she`nuhu do t`ia pranojë lutjen e tij.

Në këtë *hadith kudsij,* transmetuesi nuk e ka përmendur veçorinë që e meritojnë këta dy persona si dhe rolin e personit tjetër (pasi në tekstin e *hadith*-it përmenden në fillim dy persona), pasi është e mundur që transmetuesi ta ketë harruar këtë pjesë të *hadith*-it apo e ka transmetuar ashtu siç e ka dëgjuar për shkak të besnikërisë, ngase në Sahih-un e Ibni Hibanit, në *hadith*-in me numër 1025 dhe 2555, i njëjti transmetim është në njëjës dhe në të thuhet: *"Një njeri prej umetit tim çohet natën...".*

Nga *ajet*-et dhe *hadith*-et që i përmendëm deri tash, na bëhet e qartë roli i kësaj pjese të natës dhe merita që e gëzon besimtari në saj të abdesit dhe namazit.

---

[937] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 23, nr.757; Ahmedi, "Musned", 22/255, nr.14.355;

[938] Buhari-u, "Sahih", kitab Tehexhud, bab 14, nr.1145; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 24, nr.758; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab 21, nr.1315; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 211, nr.446 dhe thotë se është hadith Hasenu-Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab 182, nr.1366; Ahmed-i, "Musned", 13/34, nr.7592; Darimij-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 168, nr.1478-79; Busiri-u thotë se me zbritje nënkuptohet dituria e Zotit.

HADITHI I TETËDHJETËEDYTË (82)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَحْيَى قَالَ: حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ قَالَ: أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ: " فُرِضَتْ عَلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَيْلَةَ أُسْرِيَ بِهِ الصَّلَوَاتُ خَمْسِينَ، ثُمَّ نُقِصَتْ حَتَّى جُعِلَتْ خَمْسًا، ثُمَّ نُودِيَ: يَا مُحَمَّدُ، إِنَّهُ لَا يُبَدَّلُ القَوْلُ لَدَيَّ، وَإِنَّ لَكَ بِهَذِهِ الخَمْسِ خَمْسِينَ «

Enes b. Maliku (r.a.) ka thënë: "Të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem natën e *Israsë* iu bënë obligim pesëdhjetë namaze, pastaj iu pakësua derisa arriti në pesë, më pas i është thënë: ***"O Muhamed, me të vërtetë te Unë fjala Ime nuk ndryshon dhe ti për këto pesë (namaze) do të keshë pesëdhjetë (vlerën e 50 namazeve)".***[939]

Allahu xhele she`nuhu dëshiroi që të Dërguarin e Tij të fundit, ta merr në një udhëtim që asnjë prej krijesave nuk e kishte përjetuar më parë. Në periudhën kur atij iu vështirësua gjendja në Meke, Allahu xhele she`nuhu e ngriti në qiej për t`i treguar mbretëritë e qiejve dhe të tokës, që t`i bëjë me dije se sa fuqi posedon Ai, ndërsa pabesimtarët nuk posedojnë fuqi as sa një grimcë.

Ky udhëtim i vërtetuar fetarisht dhe që aspak nuk është i pamundshëm për logjikën e shëndoshë njerëzore (njeriu ka arritur të bëjë mjete udhëtimi që e shkurtojnë kohën apo distancën për orë, ditë e muaj, e si të mos jetë kjo e mundur për Zotin, Krijuesin e çdogjëje), ndodhi për mbi shtatë qiej dhe në këtë udhëtim Zoti i bëri obligim Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem

[939] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 45, nr.213 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahihun-Garib; gjithashtu këtë hadith e përcjellin edhe prej Ubade b. Samit r.a., Talha b. Ubejdullahut r.a., Ebu Dherrit r.a., Ebu Katades r.a., Malik b. Sa`sasë r.a. dhe Ebu Seid el-Hudrijut r.a. siç pohon Tirmidhiu; gjithashtu e shënon edhe imam Buhari-u, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 1, nr.349; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab 74, nr.163; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab 194, nr.1399; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 1, nr.449; Ahmed-i, "Musned", 19/485, nr.12.505 por e shënojnë me variacione të ndryshme në tekst;

faljen e pesë kohëve të namazit për *ummet*-in, ashtu siç ka qenë namazi obligim edhe për popujt e mëhershëm.

Edhe pse në tekstin e *hadith*-it theksohet se namazi u obligua në natën e *Israsë*, nënkuptohet nata e *Miraxh-it,* sepse këto kanë ndodhur në natën e njëjtë, që është mendimi i shumicës së dijetarëve. Allahu xhele she`nuhu këtë natë e përmendi edhe në Kuran, shkaku i veçorisë që e posedon. Zoti thotë në Kuran: **"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi`l-Haramit (prej Qabesë) deri në Mesxhidi`l-Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është Dëgjues dhe Pamës".**[940]

Zoti në fillim i obligoi Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem faljen e pesëdhjetë namazeve, por gjatë kthimit të tij për në tokë, takoi Musain alejhi`s-selam në qiellin e gjashtë, i cili i rekomandoi që të kërkojë lehtësim prej Zotit, sepse njerëzit nuk do të mund t`i realizojnë pesëdhjetë namaze brenda një dite. I Dërguari i Allahut e pranoi këtë këshillë dhe kërkoi lehtësim prej Zotit, ku çdoherë që kërkonte lehtësim, ia lehtësonte nga pesë namaze, derisa erdhi në vijën e fundit, ku Zoti i tha se fjala e Tij nuk ndryshon, edhe pse do të jenë të obliguara pesë namaze, ato do të kenë vlerën e pesëdhjetë namazeve në shpërblim.

Në transmetimin që e shënon imam Buhariu në "Sahih",[941] tregohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka kthyer tre herë, kurse nuk ka pranuar të kthejë herën e katërt, sepse është ndier i turpëruar të kërkojë lehtësim, pasi është lehtësuar deri në pesë namaze.

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e kuptoi që dëshira e Zotit është që të ngelin pesë kohë të namazit për *Ummet-in* e tij, andaj nuk kërkoi më që të zvogëlohet numri i namazeve, sepse atëherë do të duhej të ngelin shumë pak namaze apo aspak, nëse shkojmë në bazë të lehtësimit në çdo kthim nga pesë namaze. Porse, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka dëshiruar që çdo vepër e tij të jetë në përputhje me kënaqësinë e Zotit, e Kënaqësia e Tij ishte të ngelin pesë kohë, të cilën e kuptoi në momentin kur Zoti i tregoi se do ngelin pesë kohë me vlerën e pesëdhjetëve, andaj edhe nuk kërkoi të lehtësohet më tepër.

[940] Kurani, Isra, 1;
[941] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 1, nr.349; etj.

Allahu xhele she`nuhu për çdo vepër shpërblen dhjetëfishin e saj, andaj edhe pse në esencë ne falim pesë kohë të namazit, tek Zoti ato regjistrohen sikur pesëdhjetë, pra, esenca ka ngelur e njëjtë, vetëm se numri i namazeve është zvogëluar, kurse shpërblimi për to është ashtu siç caktoi Zoti në fillim.

Nga shkaku se namazi është i vetmi obligim i cili u bë *farz* në qiej gjatë udhëtimit të *Miraxh-it*, disa dijetarë si Nisaburiu, Sujutiu, Munaviu dhe Alusi, e quajnë atë `*Miraxh-i* i besimtarit`, sepse kur e fal namazin muslimani, ai ngrihet shpirtërisht dhe i falen mëkatet, ashtu siç na përshkroi i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur tha se shembulli i atij i cili fal pesë kohët e namazit, është si personi i cili ka para derës së shtëpisë së tij një lum në të cilin lahet pesë herë në ditë, ku nuk do të ngelte në trupin e këtij ndonjë shenjë e papastërtisë, ashtu edhe nga besimtari i cili falë pesë kohët e namazit, do t`i largohen mëkatet prej shpirtit të tij.[942]

[942] Shih: Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu, nr.463; Darimij-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 1, nr.1182;

HADITHI I TETËDHJETËETRETË (83)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ يُوسُفَ، قَالَ: حَدَّثَنَا مَالِكٌ، عَنْ أَبِي الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " يَتَعَاقَبُونَ فِيكُمْ مَلاَئِكَةٌ بِاللَّيْلِ وَمَلاَئِكَةٌ بِالنَّهَارِ، وَيَجْتَمِعُونَ فِي صَلاَةِ الفَجْرِ وَصَلاَةِ العَصْرِ، ثُمَّ يَعْرُجُ الَّذِينَ بَاتُوا فِيكُمْ، فَيَسْأَلُهُمْ وَهُوَ أَعْلَمُ بِهِمْ: كَيْفَ تَرَكْتُمْ عِبَادِي؟ فَيَقُولُونَ: تَرَكْنَاهُمْ وَهُمْ يُصَلُّونَ، وَأَتَيْنَاهُمْ وَهُمْ يُصَلُّونَ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se me të vërtetë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Te ju ndërrohen melekë gjatë natës dhe gjatë ditës, ndërsa ato takohen në namazin e iqindisë dhe të sabahut. Pastaj, ngjiten lart ata që kanë qenë natën te ju dhe Ai (Allahu) i pyet ata edhe pse Ai e di më së miri:* ***"Në çfarë gjendje i latë robërit e Mi?"*** *Ata thonë: "Ne i lamë duke u falur dhe po ashtu kur shkuam, i gjetëm duke u falur".*[943]

Të gjitha qenjet e Zotit janë të krijuara me qëllim të caktuar, e asgjë nuk është e ardhur në jetë rastësisht apo pa arsye. Zoti ka caktuar rolet e tyre. Çdo krijesë realizon dhe çon në vend urdhrin e Tij, përveç shumicës së njerëzve dhe xhinëve. Ndër krijesat që janë më të përpikta dhe më precize në kryerjen e urdhrave të Zotit, janë pa dyshim engjëjt. Ata nuk e kundërshtojnë asnjëherë urdhrin e Zotit dhe veprojnë atë që u është urdhëruar.[944]

Zoti atyre u caktoi detyra të ndryshme dhe veprime të caktuara. Disa janë të krijuara vetëm për t`i bërë adhurim Zotit, kurse disa kanë edhe detyra tjera. Zoti disa prej tyre i ka caktuar që të jenë mbikëqyrëse të krijesave tjera, siç janë njerëzit dhe xhinët. Në këtë grup, bëjnë pjesë *melekët* që regjistrojnë

[943] Buhari-u, "Sahih", kitab Mevakitu`s-Salat, bab 16, nr.555; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu ve mevadiu`s-Salat, bab 37, nr.632; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 21, nr.486; Malik-u, "Muvetta`", kitab es-Salatu, bab xhamii`s-Salat, nr.408; Ahmed-i, "Musned", 12/460, nr.7491;
[944] Shih: Kurani, Tahrim, 6;

veprimet e njerëzve dhe xhinëve. Këto *melek* qëndrojnë në anën e djathtë dhe anën e majtë të njeriut dhe shënojnë punët e mira dhe ato të këqija. Këto *melek* quhen *Kiramen katibin (shkruesit besnik).* Ata nuk lënë asgjë nga evidentimi, andaj në Ditën e Llogarisë do të gjejmë çdo vepër tonën të regjistruar. Siç thotë Zoti në Kuran: **"Kurse ndaj jush janë përcjellësit! Janë shkrues të ndershëm te All-llahu. Ata e dinë se çka punoni",**[945] apo siç thotë në ajetin tjetër: **"Dhe se kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm".**[946]

Allahu xhele she`nuhu i mbikëqyr besimtarët dhe dërgon rroje ndaj tyre të cilat janë vazhdimisht në mbikëqyrje. Zoti thotë në Kuran: **"(Njeriu) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhrin e Allahut e ruajnë atë..."**[947] Shohim se në këtë *ajet* përdoret fraza **"muak-kibatun",** kurse në *hadith,* përdoret e njëjta frazë, ku thuhet **"jeteakabune"** me çka dëshmohet, se *melekët* që përmenden në *hadithin kudsij,* janë ato *melek* të cilët Zoti i ka përmendur në këtë *ajet* kuranorë.

Me këtë, nënkuptojmë se vazhdimisht jemi të rrethuar me praninë e *melekë*-ve dhe ato dëshmojnë punët tona, qofshin ato të mira apo jo, si dhe për to japin llogari para Zotit të gjithësisë.

Abdullah b. Mes`udi radijeAllahu anhu thotë: "Mbrojtësit prej *melekëve* mblidhen në namazin e sabahut, pastaj disa ngjiten, e disa mbeten".[948]

Edhe në këtë *hadith kudsij*, sipas shumicës së dijetarëve, bëhet fjalë për *melekët* të cilët janë përcjellës të njerëzve,[949] ku këto *melek* kanë kohën e tyre kur ndërrohen me njëra tjetrën. Disa qëndrojnë me njeriun prej sabahu deri në iqindi, kurse grupi i dytë fillon prej iqindije deri në sabah. Në periudhën e faljes së këtyre dy namazeve (sabahut dhe iqindisë) bëhet ndërrimi i tyre. Njëri grup qëndron me njerëzit, kurse grupi i dytë kthehet te Zoti dhe japin dëshminë e tyre për punët e njerëzve, edhe pse Zoti nuk ka nevojë për këtë, sepse Ai që në pafillimësi e di çdo punë që e bëjnë njerëzit. Por, këtë e bën me qëllim që të mos ngelet mundësi për njeriun, që të mohojë veprimet e veta në Ditën e Gjykimit.

---

[945] Kurani, Infitar, 10-12;
[946] Kurani, Kaf, 17-18;
[947] Kurani, Rra`d, 11;
[948] Ibni Kethir-i, "Tefsir-i i Ibni Kethirit", vëll.4, fq.627;
[949] Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari", vëll.2, fq.326;

Me rastin e kthimit të tyre, Zoti u parashtron pyetje rreth gjendjes së robërve të Tij, se në çfarë gjendje i latë dhe në çfarë gjendje i gjetët? *Melekët* e sinqerta tregojnë se i kanë lënë duke falur namazin dhe i kanë gjetur përsëri duke e falur namazin.

Për prezencën e këtyre melekëve në kohën e namazit të sabahut, dëshmon gjithashtu *ajet*-i kuranorë ku thotë: **"Fale namazin kur zbret dielli e deri në errësirën e natës dhe fale namazin e agimit. Vërtet namazi i agimit (sabahut) është i përcjellë".**[950]

Ibni Abasi radijeAllahu anhu thotë se këtu bëhet fjalë për namazin e sabahut.[951] Namazi i sabahut është i përcjellur dhe i dëshmuar nga *melekët*. Ata`u thotë se edhe *melekët* edhe xhinët prezantojnë dhe dëshmojnë gjatë këtij namazi.[952]

Në koment të këtij *ajeti* të madhëruar, komentuesit kanë thënë se bëhet fjalë për periudhën kur *melekët* ndërrohen. Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem pasi ka lexuar këtë ajet, ka thënë: *"Namazin e sabahut e përcjellin melekët e natës dhe të ditës në periudhën kur tubohen aty".*[953]

Po ashtu nga Ebu Hurejre radijeAllahu anhu përcillet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Në namazin e sabahut tubohen melekët e ditës dhe të natës",* ku pas kësaj, Ebu Hurejre radijeAllahu anhu tha: "lexoni nëse dëshironi: **"Vërtet namazi i agimit (sabahut) është i përcjellë".**[954]

Gjithashtu, me këtë nënkuptojmë se siç u veçua koha e namazit të sabahut në Kuran shkaku i prezencës së *melekëve*, ngjashëm Zoti e veçoi edhe kohën e iqindisë, sepse këto janë dy periudhat në të cilat *melekët* i ndërrojnë pozitat e tyre. Zoti thotë në Kuran: **"Vazhdoni rregullisht (ruani) namazet, e edhe atë namazin e mesëm dhe ndaj Allahut të jeni respektues".**[955]

---

[950] Kurani, Isra, 78;
[951] Sujuti, "Durru`l-Menthur", vëll.9, fq.414;
[952] Abdurezak-u, "Musannef", vëll.1, fq.572, nr.2179;
[953] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiru`l-Kuran, bab sure Beni Israil, nr.3145 dhe thotë se është Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Salatu, bab 2, nr.670; Ahmed-i, "Musned", 16/126, nr.10.133; etj.
[954] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab 31, nr.648; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu, bab 42, nr.649; etj.
[955] Kurani, Bekare, 238;

Këtu nënkuptohet namazi i iqindisë. Pra, këto dy namaze u dalluan shkaku i rrethimit të tyre me mëshirën hyjnore dhe prezencën e engjëjve.

Me këtë, nënkuptojmë se ne duhet të bëjmë përpjekje maksimale që të jemi të pranishëm në këto dy namaze që kanë vlera të shumta, duke mos neglizhuar kohët tjera, si dhe të përpiqemi që këto namaze t`i falim në xhami me *xhemat*, sepse këtu në *hadith*, bëhet fjalë për dëshmimin e *melekëve* ndaj atyre të cilët e falin namazin me *xhematë*, porse mund të nënkupton edhe ata të cilët nuk marrin pjesë në *xhemat* (porse e falin namazin vet).[956]

Allahu xhele she`nuhu i ka nderuar shumë besimtarët, sidomos ata të cilët falin namazin me *xhemat*, sepse i ka rrethuar me *melek* dhe ka bërë që aty të jetë vendtubimi dhe vend ndarja e *melekëve* përcjellës. Për ta, edhe *melekët* dëshmojnë se janë njerëz të mirë, pasi i gjejnë vazhdimisht në adhurim dhe në falje të namazit. Kjo është sikur të ishin duke kryer adhurim pandërprerë. Nuk ka nder më të lartë sesa të jesh i shoqëruar nga *melekët*, krijesat më të pastra, andaj, ne duhet të përpiqemi që të jemi sa më të fokusuar në adhurim dhe të përpiqemi të arrijmë shkallë të larta në pastrimin e shpirtit.

Ne si besimtarë i besojmë këto lajme dhe nuk hedhim dyshim mbi to, sepse mendja njerëzore është e kufizuar e nuk mund të arrijë të kuptojë gjërat e fshehta të Zotit (*gajb*) pasi në to nuk ka qasje mendja njerëzore, sepse mendja e njeriut nuk arrin të kuptojë as gjërat fizike që e rrethojnë në natyrë, e jo më ato të cilat janë metafizike. Edhe pse syri i jonë në kushtet dhe ligjet fizike të kësaj bote nuk është i aftë për t`i kapur këto krijesa, kjo nuk do të thotë se nuk ekzistojnë. Ngase, me këtë sy nuk i shohim as rrezet e dritës infra të kuqe, ultravioletë, gama dhe ato kozmike, por kjo nuk do të thotë se këto rreze drite nuk ekzistojnë.

Ky *hadith kudsij*, në disa vende haset edhe me një shtesë në fund, me çka përpos vlerës së prezencës së melekëve, vërtetohet edhe falja e mëkateve për ata të cilët prezantojnë në këto kohë të namazit. Në këtë transmetim, gjendet në fund shtesa: *"Zoti u thotë atyre*: ***"Do ua fali mëkatet atyre në Ditën e Llogarisë".***[957]

Pra, këtyre besimtarëve që falin namazin e sabahut dhe ikindisë me *xhemat*, u janë dëshmitarë në Ditën e Gjykimit *melekët,* sepse kanë qenë të

[956] Shih: Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari", vëll.2, fq.326;
[957] Ahmed-i, "Musned", vëll.15, fq.76, nr.9151;

vazhdueshëm në namaz, kurse Zoti premton se për ta do të ketë falje mëkatesh, Allahu na e mundësoftë.

HADITHI I TETËDHJETËEKATËRTË (84)

حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، حَدَّثَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ أَبِي قِلَابَةَ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " أَتَانِي رَبِّي عَزَّ وَجَلَّ اللَّيْلَةَ فِي أَحْسَنِ صُورَةٍ – أَحْسِبُهُ يَعْنِي فِي النَّوْمِ – فَقَالَ: يَا مُحَمَّدُ هَلْ تَدْرِي فِيمَ يَخْتَصِمُ الْمَلَأُ الْأَعْلَى؟ قَالَ: قُلْتُ: لَا " قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " فَوَضَعَ يَدَهُ بَيْنَ كَتِفَيَّ، حَتَّى وَجَدْتُ بَرْدَهَا بَيْنَ ثَدْيَيَّ – أَوْ قَالَ: نَحْرِي – فَعَلِمْتُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ، ثُمَّ قَالَ: يَا مُحَمَّدُ، هَلْ تَدْرِي فِيمَ يَخْتَصِمُ الْمَلَأُ الْأَعْلَى؟ قَالَ: قُلْتُ: نَعَمْ، يَخْتَصِمُونَ فِي الْكَفَّارَاتِ وَالدَّرَجَاتِ، قَالَ: وَمَا الْكَفَّارَاتُ وَالدَّرَجَاتُ؟ قَالَ: الْمُكْثُ فِي الْمَسَاجِدِ بَعْدَ الصَّلَوَاتِ، وَالْمَشْيُ عَلَى الْأَقْدَامِ إِلَى الْجَمَاعَاتِ، وَإِبْلَاغُ الْوُضُوءِ فِي الْمَكَارِهِ، وَمَنْ فَعَلَ ذَلِكَ عَاشَ بِخَيْرٍ، وَمَاتَ بِخَيْرٍ، وَكَانَ مِنْ خَطِيئَتِهِ كَيَوْمِ وَلَدَتْهُ أُمُّهُ، وَقُلْ يَا مُحَمَّدُ إِذَا صَلَّيْتَ: اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْخَيْرَاتِ، وَتَرْكَ الْمُنْكَرَاتِ، وَحُبَّ الْمَسَاكِينِ، وَإِذَا أَرَدْتَ بِعِبَادِكَ فِتْنَةً، أَنْ تَقْبِضَنِي إِلَيْكَ غَيْرَ مَفْتُونٍ، قَالَ: وَالدَّرَجَاتُ: بَذْلُ الطَّعَامِ، وَإِفْشَاءُ السَّلَامِ، وَالصَّلَاةُ بِاللَّيْلِ وَالنَّاسُ نِيَامٌ "

Transmeton Ibni Abasi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më erdhi Zoti im natën (në ëndërr) në pamjen më të bukur dhe më tha:* ***"O Muhamed, a e dinë se për çka polemizohet në Mele`i-l-A`la (elita e lartë)?"*** *Thashë: "Jo". Thotë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Atëherë e vendoi "dorën" e Tij mes shpatullave të mia dhe e ndjeva ftohtësinë e saj në gjoksin tim. Në atë moment, mësova çfarë ka në qiej dhe në tokë. Pastaj përsëri më tha:* ***"O Muhamed, a e dinë se për çka polemizohet në Mele`il-A`la?"*** *Thashë: "Po. Polemizohet për faljen e mëkateve dhe ngritjen e shkallëve". Tha:* ***"E çka është falja dhe ngritja e shkallëve?"*** *Thashë: "Shlyerja e mëkateve është qëndrimi në xhami pas*

namazit, shkuarja në këmbë deri te xhemati dhe përkryerja e abdesit në kushte të vështira". Ai tha: ***"Të vërtetën e the o Muhamed. Kush i bën këto, jeton me mirësi dhe vdes me mirësi, ndërsa mëkatet e tij janë sikur atë ditë kur e ka lindur nëna".*** *Dhe më tha:* ***"O Muhamed, kur të falesh, thuaj (pas namazit): "Allahumme inni es`eluke`l-hajrati ve terkel munkerati ve habbel mesakini ve idha eredte bi ibadike fitneten en takbideni ilejke gajre meftun (O Zoti im, unë Ty të lus të më ndihmosh në kryerjen e të mirave, braktisjen e të ligave, dashurinë ndaj të varfërve, e nëse dëshiron që t`i sprovosh robërit e Tu, më merr te Ti të pa sprovuar).*** *Kurse ngritja e shkallëve është shpërndarja e ushqimit, përhapja e selamit dhe namazi natën, gjersa njerëzit flejnë****".***[958]

Këtu kemi të bëjmë edhe me kuptim alegorik, sepse në parim, Zotit nuk i përshkruhet trup dhe gjymtyrë. Është e mundur që kjo të ketë ndodhur në gjumë siç pohon Ibni Kethiri, por duke marrë parasyshë kritikat e dijetarëve për këtë *hadith,* e kuptojmë se kjo pjesë e parë e *hadith*-it ka mundësi të ketë pësuar ndonjë ndryshim nga ndonjëri prej transmetuesve apo dikush tjetër.

---

[958] Ahmed-i, "Musned", Daru`l-Hadith, Kajro, botimi i parë, 1995, vëll.3, fq.458, nr.3484; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsiru`l-Kuran, bab 2, nr.3244-3245 dhe thotë "se është Hasenu-Garib"; Tirmidhi-u e përcjell edhe nga Muadh b. Xhebeli r.a. (nr.3246) dhe thotë se hadithi është hasenu-Sahih", e këtë transmetim e përcjell edhe Bezzar-i në "Bahru`z-Zehar" 7/110, nr.2668 dhe Taberani, 20/109-110; Taberani e shënon edhe përmes Ebu Hurejres r.a., Enesit r.a., Ebu Rafiut r.a., Theubanit r.a., Ebu Umames r.a. dhe Semures r.a., ndërsa në transmetimin e tij nga Ebu Ubejde b. Xherrahu r.a. thuhet se kjo ka ndodhur në natën e Miraxh-it; e shënon edhe Bejhekiu në "Esma ve`s-Sifat", 2/72, nr.644 dhe thotë: "Ky hadith ka kundërthënie në zinxhirin e tij..."; Imam Ebu Ferexh el-Xheuzi thotë se të gjitha rrugët e këtij hadithi janë kontradiktore dhe se nuk kanë asnjë rrugë të shëndoshë (shih më gjerësisht: "Flakja e dyshimeve të teshbihizmit", fq.165-166); Dhehebiu në "Sijeru A`lam en-Nubela", 10/113-114 thotë: "Hadithi i plotë gjendet në veprën e Bejhekiut. Ky hadith është munker (i keq) lusim Allahun të na shpëtoj në fe". Edhe Ibni Kethiri në "Tefsir Kurani`l-Adhim", vëll.4, fq.43, në koment të ajetit 69 të sures Sad, thotë se kjo ka ndodhur në gjumë, e kush pretendon se ka ndodhur në gjendje të zgjuar, ka gabuar; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid" 1/238, nr.1223 thotë se e përcjell Taberani në "Euset" dhe "Kebir" por në zinxhir të tij gjendet Ebu Seid e-Bekkal i cili është mudelis, kurse të besueshëm e ka llogaritur Vekiu"; kurse Hejthemiu (7/276, nr.11.737) për transmetimin e Ahmedit përmes Ibni Aishit, thotë se transmetuesit i ka të besueshëm; Ahmed Shakir-i në verifikim të këtij hadith-i në Musned-in e Ahmedit (3/458), thotë se është me zinxhir Sahih; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmed-it (5/438, nr.3484) thotë se zinxhiri i këtij hadith-i është i dobët, Ebu Kilabe nuk ka dëgjuar hadithe prej Ibni Abasit, si dhe hadithi ka *Idtirab* (përzierje teksti)...".

Imam Ebu Ferexh el-Xheuzi në lidhje me pjesën e hadith-it *"e vendosi dorën e Tij mes shpatullave të mia"* thotë se ka dy kuptime, njëri dëshiron të tregojë kujdesin e tepruar për të dhe gjendjen e tij dhe i dyti, këtu `dora` mund të nënkuptojë dhuntinë. Ndërkaq, pjesa e *hadith*-it *"mes shpatullave të mia"* nëse do të ishte i vërtetë, ka qëllim të tregojë se i futi në zemër tipare të butësisë dhe mëshirës. Kurse pjesa *"e ndjeva freskinë e saj"* ka mundësi që freskia të nënkuptojë dhuntinë, ëmbëlsinë dhe qetësinë e saj. Ashtu siç përdoret edhe gjuhësisht kur thuhet: "jetë e freskët" ose kur thuhet: "jetë e begatshme".[959]

Sa i përket nocionit *`Melei`l-A`la* - aludon në *melek*-ët e lartësuar dhe të afërt. Taberiu sqaron se këto janë *melek*-ët të cilët janë prej atyre të cilët u konsulutuan në lidhje me krijimin e Ademit a.s. dhe thanë: **"Si do të krijosh në të atë që do të krijojë trazira dhe do të derdh gjak?.."[960].** Këtë mendim e përcjell prej Ibni Abasit r.a., Sudijut dhe Katades.[961]

Sa i përket këtij nocioni, përmendet edhe në Kuran ku thuhet: **"Unë nuk kam pasur kurrfarë dije për elitën e lartë (melei`l-A`la) kur ata bën polemikë (rreth Ademit)".[962]** Në këtë *ajet*, Zoti flet për polemikën e engjujve të lartë në lidhje me krijimin e Ademit a.s.

Sa i përket pjesës ku sqarohet se çka janë fshirja e mëkateve dhe ngritja e shkallëve, kjo pjesë e *hadith*-it përforcohet edhe me transmetime tjera. Këto janë tre vepra që i fshijnë mëkatet e besimtarit. Prej tyre është edhe të presësh namazin tjetër, pasi ke falur një namaz. Nëse ke mundësi, ulu pas namazit edhe pse të tjerët dalin. Ti ndalu dhe bëj *dhikër*, lexo Kuran, medito dhe lutju Zotit. Ai krenohet shumë me këtë vepër që do të bësh.

Mirësinë e kësaj vepre, e vërteton edhe hadithi që e transmeton Abdullah b. Amri radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem pasi e fali akshamin, hyri në shtëpinë e vet, e kush doli prej xhamie doli, e kush qëndroi mbeti, më pas erdhi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke nxituar, i mbushur në frymë dhe duke u mbështetur me duar te gjunjët e tij tha: *"Përgëzime, ky është Zoti i juaj i Cili ka hapur një prej dyerve të qiellit*

[959] Ebu Ferexh el-Xheuzi, "Flakja e dyshimeve të Teshbihizmit", fq.168-169;
[960] Kurani, Bekare, 30;
[961] Shih: Taberi-u, "Xhami`ul-Bejan fi te`vili`l-Kuran", vëll.20, fq.142;
[962] Kurani, Sad, 69;

dhe krenohet para melekëve duke thënë: ***"Shikoni robërit e Mi, e kanë falur një farz e tash janë duke pritur tjetrin".***[963]

Që këmbët e tua të lodhen për të shkuar në vepra të mira. Të të lodhen këmbët për të shkuar në namaz, që të fshihen mëkatet. Të lodhen këmbët duke shkuar në vizitë tek i sëmuri, në vizitë tek farefisi, në përcjelljen e xhenazes, të lodhesh duke punuar me hallall. Në këto raste, melekët bëjnë gara se cila do të regjistrojë sa më parë veprën e robit.

Të marrësh abdes në kushte të vështira, nënkupton të marrësh abdes kur është ftohtë gjatë dimrit, apo kur mungon uji dhe ke vështirësi në arritje deri te uji, të marrësh abdes kur ke turp se të shikojnë njerëzit të habitur se çka je duke bërë kështu, e raste të ndryshme.

Që të tri këto vepra, përfshihen në *hadith*-in e saktë që e përcjell Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"A doni t`u tregoj se me çka Allahu i shlyen mëkatet dhe me çka i lartëson derexhet?"* Ata thanë: "Po o i Dërguari i Allahut!" Ai tha: *"Marrja e abdesit edhe kur është vështirë (kur është ftohtë), shkuarja e shpeshtë në xhami, pritja e namazit pas namazit. Kjo është fortifikatë, kjo është fortifikatë".*[964]

Pasi i tregoi tre veprimet të cilat fshijnë mëkatet, e që të trija ndërlidhen me namazin, atëherë i tregoi edhe një lutje që duhet ta bëjë pas faljes së namazit. *"Dhe më tha:* ***"O Muhamed, kur të falesh, thuaj (pas namazit): "Allahumme inni es`eluke`l-hajrati ve terkel munkerati ve habbel mesakini ve idha eredte bi ibadike fitneten en takbideni ilejke gajre meftun (O Zoti im, unë Ty të lus të më ndihmosh në kryerjen e të mirave, braktisjen e të ligave, dashurinë ndaj të varfërve, e nëse dëshiron që t`i sprovosh robërit e Tu, më merr te Ti të pa sprovuar)..."***

Në fund i tregoi edhe për ngritjen e shkallëve të besimtarit tek Zoti, e kjo është shpërndarja e ushqimit tek nevojtarët, përhapja e paqes në mesin e njerëzve, duke filluar me përshëndetjen me *selam* dhe duke u sjellur si besimtar i cili nuk e kanos sigurinë e askujt dhe duke falur namaz nate, kur të tjerët janë në gjumë. Kjo vërtetohet edhe me disa transmetime tjera, prej tyre është *hadith*-i prej Aliut r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem

[963] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Mesaxhidu, bab 19, nr.801; etj. Busiri-u në "Zevaid", thotë: "Zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, kurse transmetuesit janë të besueshëm"; Mundhiri-u në "Tergib" 1/372, nr.117 thotë se transmetuesit janë të besueshëm;
[964] Muslim-i, "Sahih", kitab Tahare, bab fadlu isbagi`l-vudui alel mekarihi, nr.251; etj.

ka thënë: *"Në Xhenet ka dhoma që brendësia e tyre duket prej jashtë, kurse pjesa e jashtme duket prej brenda".* U ngrit një beduin dhe tha: "Për kë janë përgatitur ato, o i Dërguari i Allahut?" Ai tha: *"Për atë që flet fjalë të mira, atë që shpërndanë ushqim, vazhdon me agjërim dhe falet për Allahun natën, kur njerëzit flenë".*[965]

Po ashtu Abdullah b. Selami r.a. tregon se kur erdhi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në Medine të gjithë njerëzit thonin `erdhi Pejgamberi, erdhi Pejgamberi`, e dola edhe unë të shoh. Por kur e pashë në fytyrë, e kuptova se ajo nuk mund të jetë fytyrë e ndonjë gënjeshtari, dhe fjalën e parë që tha ishte: *"O ju njerëz, përhapeni selamin (paqen), ushqeni nevojtarin dhe faluni gjersa njerëzit flenë, do të hyni në Xhenet me paqe".*[966]

Këto janë veprat e mirësisë, që shpresojmë të na afrojnë pranë Mëshirës së Zotit dhe te dyert e Xhenetit.

[965] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Birru ve`s-siletu ve`l-adabu, bab ma xhae fi kauli`l-ma`ruf, nr.1984 dhe thotë se hadithi është Garib; Ahmed-i, "Musned", 2/449, nr.1338;

[966] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 42, nr.2493 dhe thotë se hadithi është Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Ikameti`s-Salat, bab ma xhae fi kijami`l-lejli, nr.1334; Ahmed-i, "Musned", 39/201, nr.23.784;

HADITHI I TETËDHJETËEPESTË (85)

حَدَّثَنَا بَهْزٌ، حَدَّثَنَا هَمَّامٌ، حَدَّثَنَا قَتَادَةُ، عَنْ أَنَسٍ قَالَ: جَاءَ رَجُلٌ وَالنَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي الصَّلَاةِ، فَقَالَ: الْحَمْدُ لِلَّهِ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ، فَلَمَّا قَضَى النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، الصَّلَاةَ قَالَ: " أَيُّكُمُ الْقَائِلُ كَذَا وَكَذَا؟ " قَالَ: فَأَرَمَّ الْقَوْمُ، قَالَ: فَأَعَادَهَا ثَلَاثَ مِرَارٍ، فَقَالَ رَجُلٌ: أَنَا قُلْتُهَا، وَمَا أَرَدْتُ بِهَا إِلَّا الْخَيْرَ، قَالَ: فَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " لَقَدِ ابْتَدَرَهَا اثْنَا عَشَرَ مَلَكًا، فَمَا دَرَوْا كَيْفَ يَكْتُبُونَهَا حَتَّى سَأَلُوا رَبَّهُمْ عَزَّ وَجَلَّ؟ " قَالَ: اكْتُبُوهَا كَمَا قَالَ عَبْدِي"

Transmeton Enesi (r.a.) i cili thotë: "Erdhi një njeri gjersa i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte në namaz dhe tha: "El-hamdulilahi hamden kethiren tajjiben mubareken fihi" (Falënderimet i takojnë Allahut, falënderimet e shumta të mira dhe të bekuara), e pasi e përfundoi namazin Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Ku është ai që tha kështu e kështu?"* Tha: "Njerëzit heshtën, kurse pyetjen e përsëriti tre herë, kur njeriu tha: "Unë e thash atë por me të nuk dëshirova diç tjetër përpos të mirës". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Kanë garuar dymbëdhjetë melek, porse nuk dinin si ta shkruajnë, gjersa e pyetën Zotin e tyre të Madhëruar, e Ai tha:* ***"Shkruani atë ashtu siç e ka thënë robi Im"****.*[967]

Këtë *hadith* e dëshmojnë edhe shumë *hadith*-e tjera, kurse përmes Enesit r.a. e regjistrojnë edhe dijetarët tjerë, por jo si *hadith kudsij*, por vetëm si fjalë të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem. *Hadith*-i është ai që e transmeton Enesi r.a. se një njeri erdhi dhe hyri në *saff*, por ishte mbushur në frymë dhe

[967] Ahmed-i, "Musned", vëll.20, fq.300, nr.12.988 dhe vëll.21, fq.336, nr.13.844; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se është me zinxhir Sahih sipas kushteve të Buhari-ut dhe Muslim-it; e shënon edhe Ebu Davud et-Tajalisi në "Musned", vëll.3, fq.494, nr.2113; Muhamed b. Abdulmuhsin et-Turki në verifikim të librit të Tajalisit, thotë se ky hadith është Sahih;

tha: "El-hamdulilah, hamden kethiren tajjiben mubareken fihi" – pasi e përfundoi namazin Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Kush i tha këto fjalë?"* Njerëzit të gjithë heshtën. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem përsëri tha: *"Kush i tha këto fjalë nga ju, sepse nuk ka thënë asgjë të keqe!".* Një njeri tha: "Unë, pasi erdha isha mbushur në frymë dhe i thashë ato". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Pashë dymbëdhjetë melek dhe shtyheshin se cili do t`i ngritë (te Allahu)".*[968]

Në një transmetim tjetër që e regjistron imam Ahmedi, thuhet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka qenë me *sahab*-ët në hallkë dhe personi kur është afruar i ka përshëndetur me *selam*, e pasi i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ia ktheu *selam*-in, ai kur u ul e tha këtë fjali, e në këtë transmetim shohim se nuk ka qenë në namaz.[969]

Por shumica e transmetimeve pohojnë se ka qenë në namaz. Ngjashëm me këto transmetime është edhe *hadith*-i që vjen përmes Rifa b. Rafiut r.a. i cili thotë: "Një ditë, ndërsa po faleshim pas Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ai ngriti kokën nga *ruku*-ja dhe tha: *"Semiallahu limen hamideh" (E dëgjon Allahu atë i cili falënderon),* kur dikush nga pas tha: "Rabbena lekel hamd, hamden kethiren tajjiben mubareken fihi (O Zoti ynë, gjithë lavdërimet dhe falënderimet të takojnë Ty. Falënderime të shumta të mira dhe të bekuara). Kur Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e përfundoi namazin, tha: *"Kush ishte ai burri që i tha ato fjalë?"* Njeriu u përgjigj: "Unë". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Pashë mbi tridhjetë melekë duke nxituar se cila do ta shkruajë më parë atë".*[970]

Pastaj, një transmetim tjetër përcillet po ashtu nga i Dërguari i Allahut, ku shohim se një person ka përdorur fjalë tjera, porse edhe për to melekët kanë nxituar për ta regjisruar, kurse *hadith*-i është i formës së *hadith*-eve *kudsije*. Transmeton Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-

[968] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Mesaxhidu ve mevadiu`s-salat, bab ma jukalu bejne tekbireti`l-ihrami ve`l-kiraeti, nr.600; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Tefri`i istiftahi`s-salat, bab ma justeftehu bihi`s-salatu mine`d-dua, nr.763; Nesai-u, "Sunen", kitab Iftitah, bab neun aharu mine`dh-dhikri ba`de tekbiri, nr.901; por këta dy shtojnë se këtë e ka thënë pasi ka marë tekbirin fillestar;

[969] Ahmed-i, "Musned", 20/62, nr.12.612; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se zinxhiri i tij është i fortë (kavij), por Half b. Hulejfe para vdekjes së tij ka filluar të ngatërohet në memorie.

[970] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab, nr.799; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Tefri`i istiftahi`s-salat, bab ma justeftehu bihi`s-salatu mine`d-dua, nr.770; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Salati, bab 179, nr.404 dhe thotë se është hadith Hasen; Malik-u, "Muvetta", kitab es-Salatu, bab ma xhae fi dhikrilahi tebareke ve teala, nr.489;

lem i ka thënë atij: *"Një rob prej robërve të Allahut tha: "O Zot, Ty të takon falënderimi ashtu siç i ka hije Madhërisë Tënde dhe Madhështisë së Pushtetit Tënd". Melekët ishin habitur dhe nuk dinin si ta regjistrojnë atë dhe shkuan në qiell dhe thanë: "O Zoti ynë, robi Yt ka thënë një fjalë që nuk dimë si ta shkruajmë?" Allahu tha (kurse Ai është më i dishëm se çka ka thënë robi i Tij):* ***"Çka ka thënë robi Im?"*** *Ata thanë: "O Zot, ai ka thënë: "O Zot, lekel hamdu kema jenbegij li xhelali vexh`hike ve adhimi sultanike". Allahu u tha atyre dyve:* ***"Shkruani atë ashtu siç e ka thënë robi Im, gjersa të më takojë Mua dhe ta shpërblejë për të".***[971]

Në të gjitha këto transmetime, qofshin ato *kudsi* apo jo, vërejtëm se sa vlerë të madhe ka shprehja e falënderimit përmes këtyre fjalëve, gjë që edhe melekët regjistrues nuk kanë gjetur mënyrë adekuate se si ta shënojnë, kurse Zoti kërkon prej tyre që ta lënë në atë formë që është shprehur, pasi Ai në Ditën e Llogarisë do ta shpërblejë në mënyrën më të mirë atë fjalë.

Falënderimi ndaj Allahut xh.sh. është prej veprave madhore në fenë tonë, sepse Allahu xh.sh. dëshiron të dëgjojë robërit e Tij duke e falënderuar vetëm Atë për mirësitë dhe begatitë të cilat i posedojnë njerëzit. Jo rastësisht e ka filluar Zoti librin e Tij me fjalën *El-hamdu-lilah*. Kjo fjalë përmendet edhe në shumë *ajet*-e kuranore, në të cilat shihet rëndësia e shprehjes së falënderimit ndaj Tij.

Transmeton Esved b. Sureji i cili ka thënë: "O i Dërguari i Allahut, e kam admiruar Zotin tim të Plotfuqishëm dhe të Lartësuar, me *hamd* (falënderim)". Ai tha: *"Zoti yt e do hamdin (falënderimin)".*[972]

Po ashtu, për të kuptuar më mirë vlerën e falënderimit, do të përmendim *hadith*-in që e përcjell Ebu Dherri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sellem është pyetur: "Cila fjalë është më e dashur?" Ai ka thënë: *"Atë të cilën e zgjodhi Allahu për melekët dhe robërit e Tij: "Subhanallahi ve bi hamdihi".*[973]

---

[971] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edebi, bab fadlu`l-hamidin, nr.3801; Busiriu në "Zevaid" thotë: "Në zinxhirin e hadithit gjendet Kudame b. Ibrahimi të cilin e përmend Ibni Hibani në "Eth-Thikat". Sadaka b. Beshirin nuk kam gjetur dikë ta vlerësojë apo ta kritikoj. Transmetuesit tjerë të hadithit janë të besueshëm.

[972] Buhari-u, "Edebu`l-Mufred", nr.859;

[973] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab fadlu subhanallahi ve bi hamdihi, nr.2731; etj.

Kjo vlen edhe si lutje ndaj Allahut xh.sh. dhe është prej lutjeve më të mira përmes së cilave mund të lutet robi besimtar. Transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Dhikri më i vlefshëm është fjala La ilahe ilallah, kurse lutja më e vlefshme është fjala el-hamdulilah".*[974]

Po ashtu, prej fjalëve që rëndojnë shumë në peshojë, është përmendja e Allahut xh.sh. apo falënderimi ndaj Tij. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Dy fjalë janë të lehta për shqiptim, kurse janë të rënda në peshore, ndërsa i Gjithmëshirshmi i do shumë ato: Subhanallahi ve bi hamdihi subhanallahi`l-adhim".*[975]

I ngjashëm me këtë *hadith*, është edhe transmetimi tjetër ku Ebu Malik el-Esh`ariu r.a. tregon se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Pastërtia është pjesë e imanit, fjala El-Hamdulilah e mbush peshoren, kurse fjala Subhanallahi vel hamdulilahi mbush çdo gjë në mes qiellit dhe tokës, namazi është dritë, sadakaja është argument, durimi është ndriçim, Kurani është dëshmi për ty apo kundër teje. Çdokush e fillon ditën e tij dhe çdonjëri është tregtar i shpirtit të tij, mund ta çlirojë apo ta sjellë në shkatërrim".*[976]

Prej *hadith*-eve që flasin për vlerën e falënderimit ndaj Zotit ka shumë, e ne do të përmendim disa, që të stimulojmë besimtarët musliman që sa më shumë të kenë në gjuhë këtë shprehje. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Fjala Subhanallahi ve`l-hamdulilahi ve la ilahe il-lallahu vall-llahu ekber, janë më të dashura për mua sesa gjithçka mbi të cilën lind dielli".*[977]

Se kjo fjalë është më e dashur te Allahu xh.sh. argumenton edhe *hadith*-i që përcillet nga Semure b. Xhundub r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Katër fjali më të dashura te Allahu janë: "Subhanallahi, vel-*

---

[974] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab ma xhae enne d`vete`l-muslimi mustexhabetun, nr.3394 dhe thotë se është Hasenun-Garib; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Edebi, bab fadlu`l-hamidin, nr.3800; Hakim-i, "El-Mustedrek", 1/676, nr.1834 dhe thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë shënuar`; edhe Dhehebiu në "Telhis" thotë se është Sahih;

[975] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab 58, nr.7563; Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab 10, nr.2694; etj.

[976] Muslim-i, "Sahih", kitab Tahare, bab 1, nr.223;

[977] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab fadlu`t-tehlili ve`t-tesbihi ve`d-duai, nr.2695; etj.

hamdulilahi, la ilahe il-lallahu dhe Allahu ekber. Nuk të bën dëm me cilin do që të fillosh. Mos e emërto fëmijën tënd me emrin Jesar, as Rebah, as Nexhih, as Eflah, sepse është e mundur që të pyesësh: "A është ai atje?" dhe ai të mos jetë dhe atëherë thuhet: "Nuk është". Këta janë katër emra dhe mos shtoni asgjë mbi thëniet e mia".[978]

Ai i cili shpreh fjalë falënderimi ndaj Allahut, në Ditën e Gjykimit do të jetë njeriu më i privilegjuar në mesin e të tjerëve. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush thotë në mëngjes dhe në mbrëmje `Subhanallahi ve bi hamdihi` njëqind herë, nuk do të vij kush në Ditën e Gjykimit me diçka më të mirë sesa ai, përpos nëse dikush e ka thënë njëjtë sikur ai apo më shumë".*[979]

Është mirë që kur të përfundojmë ushqimin apo pijen, ta falënderojmë Allahun xh.sh. sepse kjo është shumë e dashur tek Zoti. Transmeton Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu është i kënaqur me robin i cili kur e përfundon ushqimin e tij falenderon për të (thotë El-hamdulilah), apo kur pin ndonjë pije falënderon për të (thotë el-hamdulilah)".*[980]

Ngjashëm është edhe arsye për faljen e mëkateve të cilat i kryen njeriu. Transmeton Muadh b. Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush han ushqim e pastaj thotë: "El-hamdulilahi ledhi etamenij hadha`t-ta`ame ve rezekanihi min gajri haulin minni ve la kuvvetin" do t`i fshihen mëkatet të cilat i ka bërë dhe do t`i bëjë. E kush thotë kur të vesh tesha:"El-hamdulilahi ledhi kesani hadhe`th-theube ve rezekanihi min gajri haulin minni ve la kuvvetin" do t`i fshihen mëkatet të cilat i ka bërë dhe do t`i bëjë".*[981]

Edhe në namaz preferohet që pas rukusë të falënderojmë Allahun xh.sh. siç u përmend në hadithet në fillim të kësaj teme, por edhe të tjera e përforcojnë një veprim të tillë. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur imami thotë `Semiallahu limen hamideh`,*

---

[978] Muslim-i, "Sahih", kitab el-Adabu, bab kerahetu`t-tesmijeti bi`l-esmai`l-kabihati, nr.2137; etj.

[979] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab fadlu`t-tehlili ve`t-tesbihi ve`d-duai, nr.2692; etj.

[980] Muslim-i, "Sahih", kitab edh-Dhikru ve`d-Duau ve`t-Teubetu ve`l-istigfaru, bab istihbabu hamdilahi teala ba`de`l-ekli ve`s-shurbi, nr.2734; etj.

[981] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Libasu, bab, nr.4023; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Et`imeh, bab ma jukalu idha ferega mine`t-ta`ami, ne.3285; etj.

ju thoni `Rabbena lekel hamd`, se nëse thënia e dikujt prej jush përkon me atë të melekëve, atëherë atij do t`i falen të gjithë mëkatet e mëparshme".[982]

Në *hadithin kudsij* që u përmend në fillim, kuptojmë se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka miratuar që të fillohet namazi me atë lutje para se të lexohet Fatiha-ja. Por, në medhhebin tonë, është praktikë që të fillohet namazi me *subhaneke*-n. Imam Muhamedi ka thënë: "Kur njeriu dëshiron të hyjë në namaz, e thotë tekbirin dhe i çon duart në nivel të veshëve dhe thotë: *"Subhaneke`llahumme ve bi hamdike, ve tebareke`s-muke, ve teala xheduke ve lailahe gajruke"...*".[983] Edhe imam Kuduri regjistron fjalët e imam Ebu Hanifes dhe Muhamedit të cilët thonë se është e pëlqyeshme (mustehab) që të fillohet namazi me *subhaneke*".[984]

Nga ky *hadith* po ashtu shohim se *sahab*-iu e ka bërë një veprim të cilin nuk e ka mësuar nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe nuk e ka dëgjuar prej tij, porse e ka thënë në bazë të rezonimit të vet, me çka kuptojmë se risitë mund të jenë edhe të mira, bile të pëlqyeshme, siç ishte rasti në këtë *hadith*, ku shohim se përpos që e veproi nga vetja, ai po ashtu u lajmërua se melekët nxitojnë për ta regjistruar dhe Zoti do ta shpërblejë atë.

Hadith-et për shprehjen e falënderimit ndaj Zotit janë të shumta dhe ne nuk mund t`i përmbledhim të gjitha, porse me këto mendoj që e sollëm sado pak para lexuesit një pasqyrë të qartë se sa vlerë ka të themi sa më shpesh brenda ditës *El-Hamdulilah.*

[982] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Salatu, bab fadli Allahume rabena lekel hamd, nr.796; etj.
[983] Muhamed b. Hasen esh-Shejbani, "El-Aslu", vëll.1, fq.6;
[984] Kuduri, "Texhrid", Darus-Selam, Kajro, botimi i parë, 2004, vëll.1, fq.481;

HADITHI I TETËDHJETËEGJASHTË (86)

حَدَّثَنا يوسف بن موسى حَدَّثَنا إسحاق بن سليمان عن إبراهيم بن يزيد , عن عَطَاء , عن أبي هريرة رَضِيَ اللهُ عَنْهُ , قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِنَّ الْعَبْدَ إِذَا قام إلى الصلاة فإنما هو أحسبه قال بين يدي الرحمن تبارك وتعالى , فإذا التفت يقول تبارك وتعالى إلى من تلتفت إلى خير مني؟ أقبل يابن آدم إلي فأنا خير ممن تلتفت إليه.

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur robi çohet për të falur namaz, ai gjendet para të Gjithmëshirshmit xh.sh., e kur ai (robi) fillon të kthehet anash, Zoti i Madhërishëm thotë:* ***"Kah po kthehesh? Kah dikush më i mirë se Unë? Kthehu kah Unë o biri i Ademit, sepse Unë jam më i mirë se kah çdo gjë tjetër që kthehesh".***[985]

Përqendrimi në namaz është i domosdoshëm që të arrijmë të shijojmë atë në mënyrën e duhur. Nëse nuk do të jemi të fokusuar në namaz, por do të shikojmë anash, atëherë do të humbim vëmendjen dhe do të pakësojmë shpërblimet e namazit.

Allahu xh.sh. për këtë arsye e ndaloi faljen e namazit në gjendje të dehur, shkaku se gjatë atij namazi do të mungojë logjika dhe nuk mund të ketë kujdes gjatë leximit.[986] Kështu që, ndalohet hyrja në namaz me çdo lloj dehje që ka mendja e njeriut, si mendimet e këqija, sugjestionet, kënaqësitë e kësaj bote, etj.

---

[985] Bezzar-i, "Bahru`z-Zehar", vëll.16, fq.200, nr.9332; e shënojnë edhe Ibni Ebi Shejbe në "El-Musannef", 1/395, nr.4538; Ukajli, "Kitabu`d-Duafau`l-Kebir", vëll.1, fq.70; në zinxhiin e hadithit gjendet Ibrahim b. Jezid el-Hauzi. Nesaiu thotë se është i refuzuar në hadith (shih: Nesai-u, "Duafau vel metrukin", fq.42, nr.14); Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 2/188, nr.2427 thotë: "E shënon Bezzari por aty gjendet Ibrahim b. Jezid el-Hauzi, i cili është i dobët". Të dobët e kanë konsideruar edhe shumë kritikë të tjerë;

[986] Shih Kurani, ajetin: Nisa, 43;

Besimtari duhet ta kuptojë se në namaz është duke biseduar me Allahun xh.sh. dhe gjatë kësaj bisede duhet të jetë i nënshtruar. Transmeton Enes b. Maliku r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Besimtari kur është në namaz, ai bisedon vetëm me Zotin e tij..."*.[987]

Në praninë e zemrës dhe frikërespektit gjatë namazit, aludon edhe Kurani ku thotë: **"Ata të cilët janë të përulur gjatë namazit të tyre".**[988]

Nga ana tjetër, e qorton atë i cili nuk është i kujdesshëm gjatë namazit, ku thotë: **"Pra, shkatërrim është për ata që falen. Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm".**[989]

Hadith-in që kemi në trajtim, edhe pse në zinxhirin e tij gjendet një transmetues i dobët, kuptimi i tij përforcohet me këto *ajete* që përmendëm më lart dhe me *hadith*-et tjera të cilat e përforcojnë kuptimin e tij, që shikimi anash është veprim i qortuar dhe humb vlerën esenciale të namazit.

Do të përmendim edhe disa transmetime tjera, që të kuptojmë më qartë qortueshmërinë e një veprimi të tillë gjatë namazit. Transmeton Ebu Dherri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. në kontinuitet do të mëshirojë robin e Tij, derisa ai të jetë në namaz dhe nuk është duke larguar vëmendjen nga namazi, e kur ta largojë vëmendjen nga namazi, largohet edhe shikimi i mëshirshëm nga ai".*[990]

Transmeton Aishja r.a.h. e cila ka thënë: "E kam pyetur Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem për lëvizjet (djathtas dhe majtas) e njeriut në namaz, e ai më tha: *"Kjo është grabitje prej grabitjeve të shejtanit nga namazi i robit".*[991]

---

[987] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Salatu, bab 36, nr.413; etj.
[988] Kurani, Mu`minun, 2;
[989] Kurani, Maun, 4-5;
[990] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab iltifatu fi`s-salat, nr.909; Nesai-u, "Sunen", kitab Sehvi, bab teshdidu fi`-iltifati fi`s-salati, nr.1195; Ahmed-i, "Musned", 35/400, nr.21.508;
[991] Buhari-u, "Sahih", kitab Edhani, bab el-iltifati fi`s-salat, nr.751; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sefer, bab ma dhukire fi`l-iltifati fi`s-salat, nr.590 dhe thotë se ky hadith është Hasenun-Garib; Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Salati, bab iltifatu fi`s-salat, nr.910; Nesai-u, "Sunen", kitab Sehvi, bab teshdidu fi`-iltifati fi`s-salati, nr.1196; Ahmed-i, "Musned", 40/475, nr.24.412;

Transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i ka thënë: *"O biri im! Derisa je në namaz, ruaju dhe mos u rrotullo prapa, sepse vërtitja në namaz është shkatërrim. Nëse detyrohesh që të kthehesh, atëherë le të jetë në ato namaze vullnetare e jo në farze".*[992]

Po ashtu përcillet prej Ibni Umerit r.a. se ai e ka konsideruar *mekruh* rrotullimin e shikimit gjatë namazit.[993]

Ebu Esvedi përcjell se Imran b. Huseini në lidhje me *ajet*-in kuranor: **"Për ata të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre"**[994] thotë se këta janë ata që nuk shikojnë anash në namazin e tyre.[995]

Imam Muhamedi e ka pyetur imam Ebu Hanifen se a prishet namazi me kthimin e shikimit? Ai ka thënë: "Jo".[996]

Edhe Imam Kasani prej dijetarëve hanefi thotë: "Nuk duhet kthyer (kokën) djathtas apo majtas, për shkak të *hadith*-it të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Sikur ta dinte namazliu se me kë bisedon (në namaz) nuk do të largonte shikimin anash"...* sa i përket kthimit të kokës anash, është mekruh nëse e largon fytyrën nga drejtimi i *kible*-s. E nëse shikon me bisht të syrit djathtas apo majtas, pa e rrotulluar kokën, kjo nuk është *mekruh*. Kjo është shkaku i *hadith*-it që përcillet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i shikonte shokët e tij me bisht të syrit".[997]

Gjatë namazit duhet të përpiqemi që të jemi sa më të koncetruar, të përfitojmë nga namazi i jonë dhe të mos e marrim atë si tallje dhe lojë, duke mos i dhënë rëndësinë e duhur e duke ia ulur vlerën e tij. Të fokusojmë shikimin tonë në vendin e *sexhde*-s gjersa jemi në këmbë, te këmbët kur jemi në *ruku* dhe tek gjunjët gjersa jemi ulur, e të mos shikojmë anash që të humbim vlerën e namazit.

---

[992] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sefer, bab ma dhukire fi`l-iltifati fi`s-salat, nr.589 dhe thotë se ky hadith është Hasenun-Garib;
[993] Ibni Ebi Shejbe në "El-Musannef", 1/395, nr.4536;
[994] Kurani, Mearixh, 23;
[995] Ibni Ebi Shejbe në "El-Musannef", 1/396, nr.4546;
[996] Muhamed ibni Hasen esh-Shejbani, "El-Aslu", 1/171;
[997] Kasani, "Bedaiu`s-Sanaiu", 1/215;

NAMAZI I XHENAZES

HADITHI I TETËDHJETËESHTATË (87)

حَدَّثَنَا صَالِحُ بْنُ مُحَمَّدِ بنِ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْقَطَّانُ قَالَ: حَدَّثَنَا عُبَيْدُ اللَّهِ بْنُ مُوسَى قَالَ: أَنْبَأَنَا مُبَارَكُ بْنُ حَسَّانَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ عُمَرَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: إِنَّ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ يَقُولُ: «يَا ابْنَ آدَمَ، اثْنَتَانِ لَمْ تَكُنْ لَكَ وَاحِدَةٌ مِنْهُمَا، جَعَلْتُ لَكَ نَصِيبًا مِنْ مَالِكَ حِينَ أَخَذْتُ بِكَظَمِكَ، لِأُطَهِّرَكَ بِهِ وَأُزَكِّيَكَ، وَصَلَاةُ عِبَادِي عَلَيْكَ بَعْدَ انْقِضَاءِ أَجَلِكَ»

Transmeton Ibni Umeri (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"O biri i Ademit, të kam dhuruar dy gjëra të cilat nuk i meriton (përpos se me Mëshirën e Allahut). E para: Të kam mundësuar hise prej pasurisë tënde edhe në çastet kur Jam duke të nxjerrë shpirtin, që të të pastroj e të dëlirësoj dhe (e dyta që të kam mundësuar) është namazi i robërve të Mi (namazi i xhenazes) pasi të përfundojë afati i jetës tënde".***[998]

Allahu xh.sh. e thërret robin e Tij dhe i bën me dije se gjithçka që posedon e ka në sajë të Mëshirës së Zotit i cili i dhuron të mira vazhdimisht, prej në barkun e nënës, pastaj gjersa është gjallë, në momentin e vdekjes dhe pas vdekjes së tij.

---

[998] Ibni Maxheh "Sunen", kitab Vesaja, bab el vesijetu bi thuluthi, nr.2710; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.7, fq.149, nr.7124; Darekutni, "Sunen", kitab Vesaja, vëll.5, fq.262, nr.4287; gjendet edhe te Abdurezak-u, "Musannef", vëll.9, fq.56, nr.16.327 prej Ebu Kilabes si Mursel. Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Sunen-it të Ibni Maxhes (vëll.4, fq.15) thotë se "Zinxhiri i hadithit është i dobët, për shkak se aty gjendet Mubarek b. Hasani i cili është i dobët". Por për këtë transmetues (Mubarek b. Hasan) ka vlerësime të ndryshme. Sipas Jahja b. Meinit ai është i besueshëm dhe nuk ka gjë të keqe te ai. Nesaiu thotë se nuk është i fortë. Ibni Hiban-i e përmend në gjeneratën e etbai tabiinëve në librin e tij "Eth-Thikat" dhe thotë se ka gabuar dhe ka mendime të ndryshme për të. Ibni Adiju thotë se përcjell gjëra që nuk i ka memorizuar si duhet. Ebu Fet`h el-Ezdi thotë se është akuzuar për gënjeshtar. Bejhekiu thotë se është i dobët. Kështu e analizon edhe Busiriu në "Zevaid" në sqarim të këtij hadithi te Ibni Maxheh. (për më shumë vlerësime rreth këtij transmetuesi, shih: Miziu, "Tehdhibu`l-Kemal", 27/173-177, nr.5762);

Allahu xh.sh. me këtë tregon se mendon vazhdimisht për robërit e Tij dhe kujdeset që ato të përfitojnë të mira të kësaj bote siç është *vasijjeti* që përmendet e para dhe për në botën tjetër siç është namazi i xhenazes. Allahu xh.sh. dëshiron që robi i Tij të përfitojë të mira të vazhdueshme dhe të jetë i përkujtuar për të mirë dhe të mos dëmtohet me diçka. Këto të shërbejnë për pastrimin e tij prej mëkateve që të takohet me Zotin i pastër nga gabimet.

Njeriu në fakt këto gjëra nuk i meriton, pasi edhe nuk ka qenë traditë më herët që të ngel prej *vasijet*-it hise për njeriun në shtratin e vdekjes, por sheriati Islam vëndoi rregulla duke e përkufizuar atë dhe duke mos lejuar që njeriu të jep të gjithë pasurinë *vasijet* që të dëmtojë vetveten.

Po ashtu nuk ka qenë parim falja e namazit të xhenazes, por feja Islame i vëndoi këto parime që besimtarët t`i japin lamtumirën e fundit të ndjerit përmes namazit të xhenazes. Njerëzit nuk e kanë pasur zakon që t`i praktikojnë këto dy gjëra para Islamit, por me ardhjen e fesë tonë të pastër, Allahu xh.sh. mundësoi që besimtarit t`i takojnë këto dy gjëra që ai nuk i ka pasur më herët. Këtu shihet mëshira e gjërë e Zotit. Kështu kanë potencuar disa dijetarë.

Por sa i përket namazit të xhenazes, disa dijetarë kanë thënë se kjo nuk është veçori e këtij umeti, por që nga Ademi a.s. është praktikuar falja e namazit të xhenazes, siç potencohet në *hadith*, ku melekët kanë falur namazin e xhenazes dhe e kanë legalizuar për bijtë e Ademit a.s. Transmeton Ubej b. Ka`bi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur melaiket ia kanë larë dhe falur namazin e xhenazes Ademit a.s. kanë bërë katër tekbire dhe kanë thënë: "Kështu veproni o bijtë e Ademit a.s."*.[999]

E para që potencohet në këtë *hadith kudsij* është *vasijjeti. Vasijet* nënkupton bartjen e pronësisë ndaj një pasurie të caktuar ose të drejtën e shfrytëzimit dhe përdorimit pas vdekjes. Zoti thotë në Kuran: **"Kur ndonjëri prej jush është afër vdekjes, nëse lë pasuri pas vetes, i caktohet si obligim për atë që e kanë frikë Allahun, që në mënyrë të drejtë të bëjë testamentin për prindërit dhe të afërmit".[1000]**

[999] Darekutni, "Sunen", 2/431, nr.1813-15; Ibni Ebi Shejbeh, "El-Musannef", 2/450, nr.10.912, por me zinxhir tjetër; Hakimi, "Mustedrek", 1/496, nr.1275 dhe thotë se senedi është Sahih, por dy shejhët nuk e kanë shënuar;
[1000] Kurani, Bekare, 180;

Por prej *ajet*-it nuk nënkuptohet se testamenti është obligim, por që është i preferuar. Testamenti është i obliguar për atë që ka borxhe dhe obligime ndaj të tjerëve, apo ka pasuri të huaja me vlerë që janë të ruajtura tek ai, në mënyrë që kështu nga pasuria e tij të kthehen borxhet dhe obligimet ndaj të tjerëve, duke ua kthyer sendet me vlerë pronarëve. Numri më i madh i dijetarëve Islam deklarojnë se në fazën e fillimit të Islamit testamenti për prindërit dhe të afërmit e të vdekurit ka qenë obligim, pavarësisht nëse me këtë janë barazuar apo preferuar disa ndaj të tjerëve, e pastaj ky është derroguar me *ajet*-in e trashëgimisë.[1001]

Pra, Zoti ia kufizoi të drejtën e shpërndarjes, kështu që për t`i lënë hise edhe atij, nuk e lejoi që ta shpërndajë tërë pasurinë e vet për t`ua dhënë të tjerëve. Transmeton Sad b. Ebu Vekasi r.a. i cili thotë: "Erdhi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem të më vizitonte gjersa isha në Mekë dhe unë i thashë: "O i Dërguari i Allahut, do të lija testament për gjithë pasurinë time!". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Jo".* I thashë: "Po gjysmën?". AI tha: *"Jo".* E pyeta përsëri: "Po një të tretën?". Ai u përgjigj: *"Të tretën (1/3), madje edhe kjo është shumë. Me të vërtetë, t`i lësh pasardhësit e tu të pasur është më mirë se t`i lësh të varfër, që të lypin nga të tjerët. Çka do që jep nga pasuria e jote, ajo është sadaka, madje edhe një kafshatë që e çon deri në gojën e gruas tënde".*[1002]

Allahu xh.sh. e ka përcaktuar testamentin për t`i mundësuar njeriut të zotërojë një pjesë të pasurisë së vet edhe pas vdekjes. Kjo dëshmon se Islami e respekton njeriun dhe e nderon dëshirën e tij me rastin e disponimit të pasurisë pas vdekjes, por njëkohësisht ruan të drejtën e të afërmve të tij ndaj pasurisë së tij, e që është vetëm njëri prej treguesve të rrugës së mesme dhe maturisë së Sheriatit.[1003]

Për më shumë detaje rreth testamentit, duhet konsultuar literaturën përkatëse nëpër librat e *fikh*-ut dhe *hadith*-it, sepse është temë e gjërë kurse nuk është qëllim i këtij punimi që të zgjerohemi deri në detajet më të hollësishme.

Sa i përket namazit të xhenazes, është obligim i besimtarëve musliman që të falin namazin e *xhenaze*-s së një besimtari mysliman qoftë i vdekuri mashkull apo femër.

[1001] Shih: Tuhmaz, "Fikhu Hanefi", vëll.2, fq.351;

[1002] Buhari-u, "Sahih", kitab Vesaja, bab ej jetruke verethetehu egnijae hajrun, nr.2742; Muslim-i, "Sahih", kitab Vesijetu, bab el vesijetu bi`th-thuluthi, nr.1628; etj.

[1003] Shih: Tuhmaz, po aty, vëll.2, fq.354;

Një ndër namazet që është i obligueshëm për besimtarët është edhe namazi i xhenazes i cili për dallim nga namazet tjera është farz kolektiv (*kifaje*) e nuk është obligim personal, kështu që nëse një grup e falin këtë namaz, qoftë edhe një person, nga të tjerët bie obligimi i këtij namazi, e nëse nuk e falën askush, atëherë përgjegjësia bie mbi të gjithë njerëzit e atij vendi.

Namazi i *xhenaze*-s është *farz kifaje* për burrat, e jo edhe për gratë, por nëse e falin edhe ato, nuk ka problem. Namazi i xhenazes është adhurim që bëhet për Allahun, kurse lutje për të vdekurin, lutje drejtuar Allahut xh.sh. që vëllait tonë të fesë Islame t`ia falë mëkatet dhe të metat, kjo është detyra jonë e fundit ndaj tij.

Falja e namazit të *xhenaze*-s ka vlerë të madhe. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e shoqëron xhenazen e një muslimani me iman dhe shpresë (në shpërblim) dhe qëndron derisa t`ia fal namazin e xhenazes dhe kthehet, do të ketë shpërblim një kirat. E kush shkon edhe në varrimin e tij, do të ketë shpërblimin e dy kiratëve. Çdo kirat është sa kodra e Uhudit".*[1004]

Pra, namazi i *xhenaze*-s ka vlerë të madhe për atë që e kryen dhe mirësi të shumta për atë që i bëhet *nijet*. Njeriu edhe pas vdekjes së tij, përfiton prej veprimeve të të gjallëve. Dëshmia e të gjallëve për të vdekurin, pranohet nga Allahu xh.sh. dhe mundëson që i vdekuri të përfitojë prej lutjeve që bëjnë ata.

Transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"S`ka mysliman që vdes dhe pastaj për të, të dëshmojnë katër persona nga fqinjët e tij të afërt (se është i mirë), e të mos thotë (Zoti):* ***"Unë ua pranova dijen tuaj për të, kurse ia kam falur atë që ju nuk e dinit për të".***[1005]

[1004] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 58, nr.1325; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 17, nr.945; etj.

[1005] Ahmed-i, "Musned", 21/174, nr.13.541; Ebu Ja`la, "El-Musned", 6/199 nr.3481; Ibni Hibban-i, "Sahih", 7/295 nr.3026; Hakim-i, "Mustedrek", 1/534, nr.1398 dhe thotë se "ky hadith është Sahih sipas kushteve të Muslimit", e me këtë pajtohet edhe Dhehebiu; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 3/61, nr.3960 thotë: "E transmeton Ahmedi dhe Ebu Ja`la, kurse transmetuesit e Ahmedit janë transmetues që gjenden në Sahihe"; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në Musned-in e Ahmedit, thotë se zinxhiri i hadithit është i dobët, shkaku i Mu`mel b. Ismailit i cili ka pasur memorie të dobët, me këtë mënyrë nuk është e ruajtur përmes Enesit r.a.;

Gjithashtu për vlerën e namazit të xhenazes dhe përfitimit të shpërblimeve të shumta nga kjo, është *hadith*-i që e transmeton Merthed b. Abdullah el-Jezeniju se kur Malik b. Hubejre e falte namazin e xhenazes dhe kur njerëzit radhiteshin në *safe*, i ndante në tre pjesë, e pastaj thoshte se ka dëgjuar Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem që ka thënë: *"Kujt i falet namazi i xhenazes prej tre safeve, atij i është bërë obligim (Xheneti)".*[1006]

Kurse në një transmetim tjetër përkufizohet numri i *xhemat*-it në njëqind. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Atij që namazin e xhenazes ia falin 100 musliman, ai do të jetë i falur".*[1007] Këtë e përforcon edhe transmetimi tjetër që përcillet nga Aishja r.a.h. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk ka të vdekur, që ia falin namazin e xhenazes një grup i myslimanëve, numri i të cilëve arrin njëqind (100) dhe të gjithë kërkojnë falje për të, e që të mos pranohet kërkimi i faljes së tyre për të".*[1008]

[1006] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab el-Xhenaizu, bab fi sufufi alel-xhenaiz, nr.3166; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 40, nr.1030 dhe thotë se është Hasen; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab ma xhae fijmen sal-la alejhi xhema`atun minel muslimine, nr.1490; Ahmed-i, "Musned", 27/281, nr.16.724; Ibni Ebi Shejbeh, "El-Musannef", 3/13, nr.11.625; Hakim-i, "Mustedrek", 1/516, nr.1341 dhe thotë se "hadithi është Sahih sipas kushteve të Muslimit" e me të pajtohet Dhehebiu; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në Musned-in e Ahmedit, thotë se zinxhiri i hadithit është i dobët, shkaku i Muhamed b. Is`hakut i cili është mudelis dhe ka bërë `anan` e me këtë veçohet, kurse transmetuesit tjerë janë të besueshëm, transmetues që gjenden tek dy shejhët (Buhariu dhe Muslimi)..".

[1007] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 19, nr.1488; Ibni Ebi Shejbeh, "El-Musannef", 3/13, nr.11.624; Busiri-u në "Zevaid" për hadithin që e shënon Ibni Maxheh thotë se përcillet edhe nga Aishja r.a.h. ngjashëm me këtë, e shënohet nga Tirmidhiu dhe Nesai-u. Zinxhiri është Sahih kurse transmetuesit janë prej atyre që gjenden edhe në dy Sahih-et;

[1008] Muslim-i, "Sahih", kitabu`l-Xhenaizu, bab 18, nr.947; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 40, nr.1031 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab fadlu men sal-la alejhi mietun, nr.1991; etj.

ZEKATI

DHE

SADAKAJA

HADITHI I TETËDHJETËETETË (88)

حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ، قَالَ: حَدَّثَنِي مَالِكٌ، عَنْ أَبِي الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " قَالَ اللَّهُ: أَنْفِقْ يَا ابْنَ آدَمَ أُنْفِقْ عَلَيْكَ "

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ka thënë Allahu xhele she`nuhu***: *"O biri i Ademit, jep që të të jap Unë ty!".***[1009]**

Me këtë *hadith* madhështorë, e fillojmë këtë temë të re, që trajton një ndër virtytet më bujare të një besimtari musliman, e ajo është solidarizimi me të varfërin dhe nevojtarin, duke ndjerë dhimbjen e tjetrit, sepse besimtarët janë sikur një trup, kur një pjesë është e sëmurë, i tërë trupi e ndjen dhimbjen. Kështu që edhe besimtari i pasur, kur sheh vëllanë e tij besimtarë se gjendet në pozitë të vështirë dhe nuk mund të arrijë të sigurojë të ardhura të mjaftueshme për të furnizuar familjen dhe nevojat e tija, atëherë i del në ndihmë muslimani i pasur, për të siguruar një rrugëzgjidhje për të ngushtuarin.

Edhe pse dikush mund të mendojë se përmes shpërndarjes së pasurisë mund të harxhohet apo të varfërohet, Zoti na premton të kundërtën, se nëse ne ndajmë prej pasurisë sonë, ajo do të shtohet shumëfish te Ai e assesi nuk pakësohet.

Me dhënie të *sadaka*-së në këtë botë, arrijmë të shtojmë bereqetin e pasurisë sonë, ta pastrojmë atë prej hises së nevojtarit në pasurinë tonë, ta shtojmë *rrizk*-un, të shuajmë zjarrin e mëkateve tona dhe të arrijmë kënaqësinë e Zotit. Vet hadithi që kemi në trajtim, tregon se Zoti i drejtohet besimtarit musliman, me këtë *hadith* të shkurtë, që: "Nëse jep, do të jap edhe Unë ty". Pra, Zoti të jep më shumë nëse ti jep prej pasurisë tënde, por nëse nuk jep

[1009] Buhari-u, "Sahih", kitab Nefekat, bab 1, nr.5352; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 11, nr.993; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Kefarat, bab 15, nr.2123; Ahmed-i, "Musned", 13/493, nr.8153; etj.

asgjë, atëherë as Zoti nuk të jep. Ai sjell në Kuran shembullin e atij i cili shpërndanë në rrugën të Tij, ku thotë: **"Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kallij ka nga njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është Bujar i Madh, i di qëllimet".[1010]**

Ibni Kethir-i në koment të këtij *ajet*-i thotë: "Këtë shembull, Allahu xh.sh. e përmend për shtimin e shpërblimit të atij që harxhon nga pasuria e tij në rrugën e Allahut xh.sh. dhe duke synuar kënaqësinë e Tij. Ajeti në fjalë bën me dije se vepra e mirë shtohet prej dhjetë deri në shtatëqind herë. .. Përmendja e këtij shembulli lë gjurmë më të thella në shpirtin e njeriut, se përmendja e numrit shtatëqind. Ky shembull sinjalizon se Allahu xh.sh. i shton punët e mira për njerëzit që i bëjnë këto punë, ashtu sikur që zhvillohet kokrra për atë që e mbjell atë".[1011]

Dhe thotë: **"Kush është ai që i huazon All-llahut një hua të mirë, e Ai t'ia shtojë atij shumëfish Atë?"[1012]**

Si dhe: **"S'ka dyshim se ata që japin lëmoshë (sadaka) dhe sinqerisht japin për hir të All-llahut, atyre u shumëfishohet dhe ata kanë shpërblim të madh".[1013]**

"..Allahu e zhduk kamatën dhe e shton sadakanë..."[1014]

"Thuaj: "S'ka dyshim se Zoti im është Ai që jep furnizim të begatshëm atij që do nga robërit e vet dhe Ai ia pakëson atij, e çkado që të jepni, Ai e kompenson atë dhe Ai është dhuruesi më i madh".[1015]

Të gjitha këto *ajet*-e dhe shumë të tjera, aludojnë në shtimin e pasurisë së atij që jep *sadaka*, e assesi nuk i pakësohet. Për atë besimtarë luten edhe melekët, ku kjo na bëhet e ditur përmes *hadith*-it që e transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Për çdo ditë që zgjohen njerëzit, dy melek zbresin nga qielli dhe*

[1010] Kurani, Bekare, 261;
[1011] Ibni Kethir-i, "Tefsir Kurani`l-Adhim", vëll.1, fq.316;
[1012] Kurani, Bekare, 245;
[1013] Kurani, Hadid, 18;
[1014] Kurani, Bekare, 276;
[1015] Kurani, Sebe`, 39;

luten. Njëri prej tyre thotë: "O Allah, jepi kompensim dorëdhënësit", tjetri thotë: "O Allah, jepi shkatërrim dorështrënguarit".[1016]

Nuk është e rëndësishme të jepet vetëm kur njeriu posedon me bollëk, por edhe në raste kur një gjë i pëlqen atij apo është vet i nevojshëm për të, në këtë rast, personi i tillë nëse jep sadaka, do të jetë merritor për Xhenetin e premtuar nga Zoti i Gjithësisë, i cili në Kuran thotë: **"Shpejtoni në faljen e Zotit tuaj dhe Xhenetit, gjerësia e së cilës është sa qiejt dhe toka, e cila është e përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë shlirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllefin, që u falin (keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit".**[1017]

Por edhe nëse nuk mund të jep aq shumë saqë të ndajë në mesin e myslimanëve të nevojshëm, atëherë vet shpërndarja e asaj pasurie me antarët e familjes së tij do të konsiderohet e barazvlefshme sikur ta kishte ndarë me të tjerët. Transmeton Ebu Mes`ud el-Ensariu radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur muslimani u jep diçka familjes së vet, e ky shpreson në shpërblim për të, do t`i regjistrohet sadaka".*[1018]

Kur të japim diçka për hir të Allahut xh.sh. duhet të kemi kujdes që mos e japim atë duke e përcjellë me fjalë të vrazhda apo ofenduese, si dhe nuk duhet të jepet atë që as vetë nuk do ta kishe pranuar për dhuratë.

Kështu na mëson etikën e dhurimit në *ajet*-et kuranore ku thotë: **"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që ia jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk beson All-llahun dhe botën tjetër".**[1019]

Si dhe në *ajet*-in tjetër ku thotë: **"O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranonit për vete pos symbyllas. Dhe dijeni se All-llahu nuk ka nevojë për ju, ngase është i Madhëruar".**[1020]

[1016] Buhari-u, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 27, nr.1442; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 17, nr.1010; Ahmed-i, "Musned", 13/419, nr.8054;
[1017] Kurani, Ali Imran, 134;
[1018] Buhari-u, "Sahih", kitab Nefekat, bab 1, nr.5351; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 14, nr.1002; etj.
[1019] Kurani, Bekare, 264;
[1020] Kurani, Bekare, 267;

Njeriu duhet të nxitojë që të jep diçka prej asaj që e ka furnizuar Allahu xh.sh. para se të vijë një periudhë e varfërisë kur më nuk do të ketë mundësi për të dhënë, apo para se të vijë çasti pas së cilit nuk ka kthim, e atëherë do të dëshirojë robi të jep diçka, por më nuk ka kthim në këtë botë.

Zoti thotë në Kuran: **"O ju që keni besuar, jepni nga ajo me çka Ne u furnizuam juve para se të vijë një ditë kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësi. Me të vërtetë pabesimtarët janë mizorë".**[1021]

Dhe thotë: **"Dhe jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë juve, para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja, e atëherë të thotë: "O Zoti im, përse nuk më shtyve edhe pak afatin (e vdekjes), që të jepja lëmoshë e të bëhesha prej të mirëve!" Por, All-llahu kurrsesi askënd nuk e shtyn për më vonë kur atij t'i vijë afati i vet. All-llahu hollësisht është i njohur me atë që ju punoni".**[1022]

[1021] Kurani, Bekare, 254;
[1022] Kurani, Munafikun, 10-11;

HADITHI I TETËDHJETËENËNTË (89)

حَدَّثَنَا أَبُو اليَمَانِ، أَخْبَرَنَا شُعَيْبٌ، حَدَّثَنَا أَبُو الزِّنَادِ، عَنِ الأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ: أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " قَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: أَنْفِقْ أُنْفِقْ عَلَيْكَ، وَقَالَ: يَدُ اللَّهِ مَلْأَى لاَ تَغِيضُهَا نَفَقَةٌ سَحَّاءُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ، وَقَالَ: أَرَأَيْتُمْ مَا أَنْفَقَ مُنْذُ خَلَقَ السَّمَاءَ وَالأَرْضَ، فَإِنَّهُ لَمْ يَغِضْ مَا فِي يَدِهِ، وَكَانَ عَرْشُهُ عَلَى المَاءِ، وَبِيَدِهِ المِيزَانُ يَخْفِضُ وَيَرْفَعُ "

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu i Lartmadhëruar thotë:* ***"Shpenzo, Unë do të shpendoj për ty".*** Pastaj tha: *"Dora e Allahut është plot dhe kjo nuk pakësohet nga shpërndarja e saj natën dhe ditën".* Dhe thotë: *"A nuk e shihni çfarë ka shpërndarë që kur është krijuar qielli dhe toka, e nuk është pakësuar ajo që është në Dorën e Tij, ndërsa Arshi i Tij ishte mbi ujë, si dhe në Dorën e Tij është Peshoja, me të cilën ngre lart (disa njerëz) dhe ul (disa të tjerë poshtë)".*[1023]

Ky *hadith* është i ngjashëm me *hadith*-in paraprak, kurse pjesa tjetër e shtuar në këtë *hadith*, nuk është *hadith kudsij*, por fjalë e të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i cili sqaron se Allahu xh.sh. jep me bollëk dhe se ajo që gjindet tek Ai, nuk harxhohet kurrë, edhe pse shpërndahet ditën dhe natën, që kur është krijuar qielli dhe toka.

Përveç kësaj, këtu tregohet se Arshi i Zotit ka qenë mbi ujë, kurse tek Ai është drejtësia absolute, i Cili nuk u bën padrejtësi krijesave të Tija, dikë e lartëson e dikë e poshtëron, kjo në bazë të shpërndarjes së pasurisë, ku Zoti do ta ngrejë atë i cili jep për hir të Tij, kurse do ta ul atë i cili nuk

[1023] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Tefsiri, bab ve kane arshuhu alel mai (3), nr.4684; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 11, nr.993; Ahmed-i, "Musned", vëll.7, fq.126, nr.7296 me verifikim të Ahmed Muhamed Shakir, Daru`l-Hadith, Kajro, botimi i parë, 1995 dhe thotë se zinxhiri i hadithit është Sahih;

shpërndanë për hir të Tij, edhe pse atë pasuri e ka fituar në sajë të Mëshirës Hyjnore.

Ibni Haxheri në koment të këtij *hadith*-i thotë se me peshojë aludohet në drejtësinë.[1024]

Ndërsa imam Neveviu përcjell fjalët e Maziriut, se nuk mund të përshkruhet Zoti me trup apo kufi, pasi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem u ka folur njerëzve me ato shprehje që mund t`i kuptojnë.[1025]

Duhet të kemi kujdes gjatë interpretimit të këtyre *hadith*-eve *muteshabihat*, sepse njeriu mundet të bjer në *teshbihizëm* dhe në *texhsim*, pra, të përshkruajë Zotin e Lartësuar me trup apo gjymtyrë dhe të kufizuar në kufijt e logjikës njerëzore, prej së cilës Ai është i pastër.

Zoti na thërret që të mos kemi frikë nga dhënia *sadaka*, sepse nuk pakësohet pasuria prej dhurimit, pasi edhe këtë që kemi, e kemi përsëri dhuratë prej Zotit. Vallë, a nuk shohim se që nga fillimi i ekzistimit të krijesave, Zoti pa ndalë i furnizon krijesat dhe nuk harxhohet ajo që gjendet tek Ai? E përse atëherë ne frikësohemi të japim, kur kemi për Zot Atë i Cili jep natë e ditë dhe pasuria e Tij nuk shteret asnjëherë?!

[1024] Ibni Haxher-i, "Fet`hu`l-Bari", vëll.10, fq.215;
[1025] Nevevi-u, "Sahih Muslim bi sherh Nevevi", vëll.3, fq.32;

HADITHI I NËNTËDHJETË (90)

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ قَالَ: حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ هَارُونَ قَالَ: حَدَّثَنَا العَوَّامُ بْنُ حَوْشَبٍ، عَنْ سُلَيْمَانَ بْنِ أَبِي سُلَيْمَانَ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: " لَمَّا خَلَقَ اللَّهُ الأَرْضَ جَعَلَتْ تَمِيدُ، فَخَلَقَ الجِبَالَ، فَقَالَ بِهَا عَلَيْهَا فَاسْتَقَرَّتْ، فَعَجِبَتِ المَلاَئِكَةُ مِنْ شِدَّةِ الجِبَالِ. قَالُوا: يَا رَبِّ هَلْ مِنْ خَلْقِكَ شَيْءٌ أَشَدُّ مِنَ الجِبَالِ؟ قَالَ: نَعَمُ الحَدِيدُ. قَالُوا: يَا رَبِّ فَهَلْ مِنْ خَلْقِكَ شَيْءٌ أَشَدُّ مِنَ الحَدِيدِ؟ قَالَ: نَعَمُ النَّارُ. فَقَالُوا: يَا رَبِّ فَهَلْ مِنْ خَلْقِكَ شَيْءٌ أَشَدُّ مِنَ النَّارِ؟ قَالَ: نَعَمُ المَاءُ. قَالُوا: يَا رَبِّ فَهَلْ مِنْ خَلْقِكَ شَيْءٌ أَشَدُّ مِنَ المَاءِ؟ قَالَ: نَعَمُ الرِّيحُ. قَالُوا: يَا رَبِّ فَهَلْ مِنْ خَلْقِكَ شَيْءٌ أَشَدُّ مِنَ الرِّيحِ؟ قَالَ: نَعَمْ ابْنُ آدَمَ، تَصَدَّقَ بِصَدَقَةٍ بِيَمِينِهِ يُخْفِيهَا مِنْ شِمَالِهِ "

Transmeton Enes b. Maliku (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur e krijoi Zoti tokën, ajo filloi të shtrihet dhe të shpërndahet, më pas Zoti e përforcoi atë me kodrat, ndërsa melekët u habitën me fuqinë e kodrave. Ato thanë: "O Zot, a ka prej krijesave tua diçka më të fortë se kodrat?" Ai tha:* ***"Po, hekuri".*** *(Melekët) thanë: "O Zot, po a ka prej krijesave tua diçka më të fortë se hekuri?" Tha:* ***"Po, zjarri".*** *(Melekët) thanë: "O Zot, a ka diçka prej krijesave më të fortë se zjarri?" Tha:* ***"Po, uji".*** *(Melekët) thanë: "O Zot, a ka diçka prej krijesave më të fortë se uji?" Tha:* ***"Po, era".*** *(Melekët) thanë: "O Zot, a ka diçka prej krijesave më të fortë se era?" Tha:* ***"Po, është biri i Ademit, i cili kur jep sadaka me dorën e djathtë, nuk e kupton e majta".***[1026]

[1026] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Tefsir, bab 95, nr.3380 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib, pasi nuk e dimë që përcillet si hadith merfu` përpos se përmes kësaj rruge; Ahmed-i, "Musned", 19/276, nr.12.253; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/115, nr.3167; Ibni Haxher-i në "Fet`hu`l-Bari", vëll.2, fq.507 thotë se ky hadith nga imam Ahmedi, është me zinxhir Hasen;

Allahu xh.sh. krijoi tokën, kurse dëshmitarë të kësaj ngjarje ishin melekët. Allahu xh.sh. e stabilizoi tokën përmes kodrave, të cilat janë shtyllat e tokës, ngase nuk lejojnë të shafitet toka me njerëzit. Kur panë melekët fuqinë e kodrave, ngelën të habitura prej kësaj fuqie dhe rolit të rëndësishëm që kanë në përmirësimin e kushteve për jetesë mbi sipërfaqen e tokës. Atëherë, ato nga habia, pyetën Zotin e madhërishëm, se a ka ndonjë krijesë që është më e fortë se kodra? Zoti iu dha përgjigje se hekuri është më i fortë se kodra. Allahu xh.sh. në Kuran ka zbritur *sure* të veçantë e cila titullohet "*el-Hadid"* që d.m.th. `hekuri`, shkaku i rëndësisë dhe i vlerës së madhe që posedon. Më pas, kureshtja e *melekë*-ve nuk përfundoi këtu, porse ata u interesuan se vallë, a ka diçka më të fortë se hekuri, kurse Zoti iu dha përgjigje, se më i fortë se hekuri është zjarri, i cili ka kapacitetin për të shkrirë hekurin. Hekuri shkrihet në temperaturë prej 1482 deri 1593 C°.[1027]

Më pas, parashtruan pyetjen, se a ka diç më të fortë se zjarri, i cili paska aftësinë të shkrijë edhe hekurin?! Përgjigja ishte se më i fortë se zjarri, është uji, i cili e shuan zjarrin. Pas kësaj, deshën të marrin përgjigje për çështjen e ujit, se mos vallë kjo është krijesa më e fortë që ekziston mbi sipërfaqen e kësaj toke të porsakrijuar, ndërsa Zoti ua bëri me dije, se nuk është uji forca kulminante, pasi era është edhe më e fortë se uji. Era ka kapacitetin të thajë ujin apo në kohën e dimrit ta ngrijë ujin. Era është në gjendje ta zhvendos ujin prej një vendi në vend tjetër. Pra, fuqia e erës tejkalon fuqinë e ujit.

Por, më në fund, morën përgjigjen për krijesën më të fortë që ekziston, ai është biri i Ademit, besimtari i cili jep me dorën e djathtë *sadaka* (ndihmë vullnetare) fshehtas, pa u publikuar, duke mos u krenuar, porse fshehtas për hir të Allahut xh.sh., ky është më i forti te Zoti, i cili ka kapacitetin të largojë fatkeqësitë me *sadaka*, i cili shuan zjarrin e Xhehenemit me sadaka, i cili jep ujë ndonjë kalimtari apo kafshe, me çka i shkruhet sadaka, si dhe është i shpejtë sikur era në ndihmën ndaj të tjerëve, në këtë formë ky person ua tejkalon edhe fuqisë së krijesave tjera.

Besimtari për të arritur këtë vlerë tek Zoti, duhet të ketë kujdes që të mos ekspozohet shumë me ndihmën e tij, por ta kryejë atë mundësisht fshehurazi. *Shejtani* mund të fus në zemrën e njeriut dëshirën për t`u parë nga të tjerët, andaj më e mira është të jepet ndihma fshehurazi. Ky person, do të jetë edhe një prej shtatë personave që do të jenë nën hijen e *Arsh*-it, atë ditë kur nuk

[1027] Për temperaturën në të cilën shkrihet hekuri, shih: www.onlinemetals.com/melting points

ka hije tjetër, përpos hijes së tij, që shpresojmë Zoti t`na e mundësojë këtë pozitë të gjithë besimtarëve.

HADITHI I NËNTËDHJETËENJËTË (91)

أَخْبَرَنَا أَبُو عَبْدِ اللهِ الْحَافِظُ، وَمُحَمَّدُ بْنُ مُوسَى، قَالَا: حَدَّثَنَا أَبُو الْعَبَّاسِ الْأَصَمُّ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ أَبِي طَالِبٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ، حَدَّثَنَا عَوْفٌ، عَنِ الْحَسَنِ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَرْوِي ذَلِكَ عَنْ رَبِّهِ عَزَّ وَجَلَّ أَنَّهُ يَقُولُ: " يَا ابْنَ آدَمَ، أَوْدِعْ مِنْ كَنْزِكَ عِنْدِي لَا حَرَقَ، وَلَا غَرَقَ، وَلَا سَرَقَ أُوفِيكَهُ أَحْوَجَ مَا تَكُونُ إِلَيْهِ "

Transmeton tabiiu Hasan el-Basriu i cili thotë: "Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke përcjellur nga Zoti i tij se Ai xh.sh. ka thënë: ***"O biri i Ademit, depono nga thesari yt tek Unë, (sepse tek Unë) nuk digjet, nuk fundoset dhe nuk vidhet, por, do ta kthejë atëherë kur do të jesh më se i nevojshëm për të".***[1028]

Edhe ky është një *hadith* madhështor, i cili komenton çështjen e *sadaka*-së, ku Zoti i drejtohet robit të Vet, i cili në këtë botë, ndërmerr të gjitha kushtet për të mbrojtur pasurinë e tij, e deponon atë nëpër banka, që ta ruajë atë prej zhdukjes dhe shkatërrimit, por përsëri ajo pasuri do të lihet pas dhe nuk merret me vete në varr. Kurse Zoti i bën me dije, se nëse dëshiron që ta deponosh në vend të sigurt, vend i cili e mbron nga zjarri i kësaj bote pasurinë, ndërsa e mbron vet atë nga Zjarri i *ahiret*-it, e mbron pasurinë nga fundosja në ujë dhe zhdukja në të, e mbron pasurinë nga vjedhja e hajnave, atëherë kjo është sadakaja që do e mbrojë pasurinë e tij, ku vet Allahu xh.sh. mer në garancë atë person, që pasurinë e tij ta manifestojë në vepra të mira në Ditën e Gjykimit, atë ditë kur nuk ka pasuri materiale që do t`na ndihmoj, porse vetëm veprat e mira që kemi realizuar në këtë botë.

[1028] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.5, fq.45, nr.3071; Muteki el-Hindi, "Kenzu`l-Ummal", vëll.1, fq.782, nr.16.021; Por Bejheki-u thotë se hadithi është Mursel, sepse e transmeton Tabiini drejtpërdrejt nga Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem;

Në Ditën e Gjykimit njeriu do të ketë më së shumti nevojë për ndihmë, do të dëshirojë që të kishte pasuri që të shpëtojë, por vetëm *sadaka*-ja e dhënë në këtë botë për hir të Allahut xh.sh., do të jetë pasuri që do t`i ofrojë ndihmë.

Dikush mund të mendojë, se nëse e shpërndanë pasurinë e tij, do të varfërohet dhe nuk do t`i ngelet pasuri, por nëse analizon më thellë, asgjë nuk është e tija, përpos asaj që e jep *sadaka*, sepse atë që e deponon në këtë botë, do të shpërndahet te trashëgimtarët dhe do të ngel këtu, kurse në varr nuk merr asgjë prej saj.

Transmeton Aishja radiaAllahu anha se ata kanë prerë *kurban* një dele dhe i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Çka ka mbetur prej saj?"*. Ajo tha: "Nuk ka mbetur prej saj asgjë pos një shpatulle!". Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *"Na ka mbetur gjithçka përpos një shpatulle".*[1029]

Kjo është një sqarim i bukur i kësaj që thamë deri tani, pra, gjithë atë që e japim *sadaka*, është për ne, kurse atë që e deponojmë për këtë botë, nuk është në realitet pronë e jona.

Edhe pse ky *hadith kudsij* ka vërejtje nga kritikët e *hadith*-it, përsëri urtësia e tij është e madhe dhe përforcohet qëllimi i tij me *hadith*-e tjera të sakta.

[1029] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab 33, nr.2478 dhe thotë se hadithi është Sahih;

HADITHI I NËNTËDHJETËEDYTË (92)

حَدَّثَنَا زَيْدُ بْنُ يَحْيَى الدِّمَشْقِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ الْعَلَاءِ بْنِ زَبْرٍ، قَالَ: سَمِعْتُ الْقَاسِمَ، مَوْلَى يَزِيدَ ، يَقُولُ: حَدَّثَنِي أَبُو هُرَيْرَةَ، أَنَّهُ سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " إِنَّ اللهَ عَزَّ وَجَلَّ، يَقُولُ: يَا ابْنَ آدَمَ، إِنْ تُعْطِ الْفَضْلَ فَهُوَ خَيْرٌ لَكَ، وَإِنْ تُمْسِكْهُ فَهُوَ شَرٌّ لَكَ، وَابْدَأْ بِمَنْ تَعُولُ، وَلَا يَلُومُ اللهُ عَلَى الْكَفَافِ، وَالْيَدُ الْعُلْيَا خَيْرٌ مِنَ الْيَدِ السُّفْلَى"

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"O biri i Ademit, nëse e shpërndanë pasurinë tënde, është më mirë për ty, e nëse e mban, është më e dëmshme për ty, ndërsa (shpërndarjen) filloje me ata që janë të varur prej teje, Zoti nuk do të qortojë nëse mbanë atë që është e mjaftueshme për nevojat e tua, kurse dora e epërme, është më e mirë se dora e poshtme".***[1030]

Islami si fe madhështore që është, na jep të kuptojmë se njeriu në këtë botë duhet të jetë solidarë dhe i ndjeshëm ndaj dhimbjes së tjetrit, e jo të bëhet zemërngurtë që t`i sheh vuajtjet e të tjerëve e të mos ndërmerr asnjë veprim.

Feja Islame nuk i lë anash të varfërit dhe nuk i braktis ata, që pastaj të ndjehen sikur janë të shkelur, por dëshiron që edhe ata të ngriten në nivel të barabartë me të tjerët, që të mund t`i shijojnë mirësitë e Zotit. Zoti në saje të tyre na mundëson shumë mirësi, na jep rastin që të japim *sadaka*, të meditojmë për mirësitë e Zotit që na ka dhënë neve, ndërsa disa të tjerë i ka privuar, këtë për faktin që të marrim mësim dhe të dijmë të falënderojmë për mirësitë që posedojmë.

[1030] Ahmed-i, "Musned", 14/356, nr.8743; ky hadith po ashtu gjendet përmes Ebu Umames r.a. tek Muslim-i, në "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 32, nr.1036; Tirmidhi-u në "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 32, nr.2350 dhe thotë se "hadithi është Hasenu-Sahih", por te këta dy nuk përcillet si hadith Kudsi; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musned-it të Ahmedit, thotë se hadithi është Sahih li Gajrihi, kurse zinxhiri i këtij hadithi është Hasen nëse Kasimi e ka dëgjuar prej Ebu Hurejres r.a. sepse ka thënie se ai nuk ka dëgjuar prej tij, por edhe ai është i sinqertë, kurse transmetuesit tjerë janë të besueshëm;

Prandaj nuk duhet të nënçmohen të varfërit, sepse në saje të tyre kemi shumë mirësi. përcjell Sa`d b. Vekasi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ju as nuk merrni fitore (dhe as nuk fitoni jetesën), veçse me (bekimet dhe lutjet) e të dobtëve nga mesi juaj".*[1031]

Nga ky *hadith*, kuptojmë se Zoti na drejtohet neve duke na thënë, se pasuria të cilën e shpërndajmë, është më e mirë për ne sesa atë që e mbajmë, nga shkaku se prej shpërndarjes përfitojmë shumë mirësi të kësaj bote dhe botës tjetër, kurse me mbajtje dhe deponim të pasurisë, shtohet përgjegjësia ndaj saj si në këtë botë si në botën tjetër. Njeriu nuk do të hyjë në Xhenet, derisa të jep llogari se pasurinë e tij si e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar.

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk do të lëviz këmba e njeriut Ditën e Gjykimit (para Zotit) derisa të përgjigjet për katër gjëra: Jetën e tij si e ka kaluar, me diturinë e tij se si ka vepruar, për pasurinë e tij se si e ka fituar dhe ku e ka harxhuar dhe trupin e tij (në një transmetim tjetër thuhet me rininë) se si ka vepruar dhe ku e ka harxhuar".*[1032]

Ne duhet të shfrytëzojmë pasurinë dhe begatinë e Zotit në të mirën tonë, e jo që ajo të kthehet në një armik për ne. Jo rastësisht këshilloi i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem që të shfrytëzojmë pasurinë, para se të vijnë momente të pakëndshme.

Transmeton Ibni Abasi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Shfrytëzo pesë gjëra, para se të vijnë pesë të tjera: Shfrytëzo rininë, para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para se të preokupohesh me probleme, dhe jetën para vdekjes".*[1033]

Hadith-i na këshillon që të fillojmë dhënien e *sadaka*-së ndaj atyre që jemi përgjegjës, sepse Zoti nga mëshira e Tij e pakufishme, na e konsideron lëmoshë edhe atë që e japim për familjen tonë. Transmeton Ebu Mes`ud el-Ensariu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur*

[1031] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhihadi ve`s-Sijeri, bab 75, nr.2896; etj.

[1032] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Kijameti ve`r-rekaiki ve`l-vere`i, bab fil kijame, nr.2425 nga Ebu Berze el-Eslemiju. Ebu Isa thotë: Ky hadith është Hasenu-Sahih; Ebu Ja`la, "Musned", 2/353; Taberaniu, "Mu`xhem`ul-Kebir", 8/10, nr.9722; Bejhakiu, "Shuab`ul-Iman", 2/284, nr.1785;

[1033] Hakim-i, "Mustedrek", 4/341, nr.7846 dhe thotë: "ky hadith është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ato nuk e kanë regjistruar". Me të pajtohet edhe Dhehebiu;

muslimani u jep diçka familjes së vet, e ky shpreson në shpërblim për të, do t`i regjistrohet sadaka".[1034]

Po ashtu, thotë në *hadith*-in tjetër, që e përcjell Sa`d b. Vekasi radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sa herë që ti shpenzon prej pasurisë tënde si sadaka përmes së cilës kërkon kënaqësinë e Zotit, veçse do të shpërblehesh për të, madje edhe për atë kafshatë që e vendos në gojën e gruas tënde".*[1035]

Për çdo gjë që shpërndajmë, për ne do të jetë e regjistruar si *sadaka*, prandaj, duhet të nxisim këtë veti tek vetja dhe tek familja, që të bëhet një shprehi e këndshme me të cilën mundohemi të arrijmë kënaqësinë dhe mëshirën e Zotit. Çdo herë të kemi parasysh, se dora më e ndershme është ajo që dhuron dhe që ndihmon, kurse dora që kërkon, është më e ulët se dora që jep.

[1034] Buhari-u, "Sahih", kitab Nefekat, bab 1, nr.5351; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 14, nr.1002; etj.
[1035] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhenaizu, bab 36, nr.1295; Muslim-i, "Sahih", kitab Vasijeh, bab 1, nr.1628; etj.

HADITHI I NËNTËDHJETËETRETË (93)

حَدَّثَنَا أَبُو النَّضْرِ، حَدَّثَنَا حَرِيزٌ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ مَيْسَرَةَ، عَنْ جُبَيْرِ بْنِ نُفَيْرٍ، عَنْ بُسْرِ بْنِ جَحَّاشٍ الْقُرَشِيِّ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ بَزَقَ يَوْمًا فِي كَفِّهِ، فَوَضَعَ عَلَيْهَا أُصْبُعَهُ، ثُمَّ قَالَ: " قَالَ اللهُ: ابْنَ آدَمَ أَنَّى تُعْجِزُنِي وَقَدْ خَلَقْتُكَ مِنْ مِثْلِ هَذِهِ، حَتَّى إِذَا سَوَّيْتُكَ وَعَدَلْتُكَ، مَشَيْتَ بَيْنَ بُرْدَيْنِ وَلِلْأَرْضِ مِنْكَ وَئِيدٌ، فَجَمَعْتَ وَمَنَعْتَ، حَتَّى إِذَا بَلَغَتِ التَّرَاقِيَ، قُلْتَ: أَتَصَدَّقُ، وَأَنَّى أَوَانُ الصَّدَقَةِ"

Transmeton Busër b. Haxhash el-Kureshi (r.a.) se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem një ditë pështyri në shuplakën e tij, vëndoi gishtin në të, pastaj tha: *"Thotë Allahu xh.sh.: **"O biri i Ademit, si mund të ikësh prej Meje, kur Unë të kam krijuar me diç të ngjashme me këtë (pështyma), gjersa të kam formuar dhe të kam bërë drejtësi që të ecësh mes këtyre dy veshjeve, ndërsa toka ka një vend varrimi për ty, kështu që ti ke tubuar pasuri dhe nuk ke dhënë, derisa të erdhi shpirti në fyt. Pastaj do të thuash: "Të jap sadaka". Por, tash është vonë për të dhënë sadaka?!".***[1036]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka qenë mësuesi më i mirë që ka parë historia njerëzore, i cili ka dhënë mësime që të ngulitet në mendjet e njerëzve, e këtë mësim e ka pasuruar me ilustrime të ndryshme. Edhe në këtë rast, ka përdorur fillimisht një ilustrim ku u tregon shokëve të vet dhe gjithë neve, prejardhjen e dobët të njeriut, ku ai erdhi në këtë botë dhe nuk posedonte asgjë. Edhe Zoti në Kuran tregon se njeriu është i krijuar prej një lëngu të dobët. Kjo ceket në këtë varg të shenjtë: **"Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët".**[1037]

[1036] Ahmed-i, "Musned", vëll.29, fq.385, nr.17.842; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab Vesaja, bab 4, nr.2707; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", 2/32, nr.1193; Hakim-i, "Mustedrek", 2/545, nr.3855 dhe thotë se zinxhiri i këtij hadithi është Sahih, por (Buhariu dhe Muslimi) nuk e kanë shënuar; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/136, nr.3198; Busiri-u në "Zevaid", thotë se zinxhiri i këtij hadithi (që e shënon Ibni Maxheh) është Sahih; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmedit, për këtë hadith thotë se është me zinxhir Hasen...".

[1037] Kurani, Sexhde, 8;

Gjithashtu thotë: **“A nuk u kemi krijuar juve nga një lëng i dobët?”**[1038]

Me këtë, na përkujtohet prejardhja e dobët e jona dhe se Zoti është Ai i Cili na furnizon dhe na jep ushqim, është Ai që na nxori në këtë botë pa asgjë, por më pas na dha të gjitha të mirat, andaj kur të kërkohet prej nesh që të ndihmojmë, duhet të kemi parasysh se ne gjithçka që posedojmë e kemi në saje të Mëshirës Hyjnore dhe se nuk kemi sjellur asnjë pasuri me vete nga mitra e nënës.

E nëse njeriu mendon se ka ku të ik prej Allahut xh.sh. ai mashtrohet rëndë, sepse Zoti është Krijuesi i njeriut, andaj nuk ka qenie që mund të fshihet prej Zotit. Ai na ka bërë mirësi të shumta, që nëse do të mundoheshim t`i numërojmë, nuk do të arrinim atë, edhe nëse do të shndërronim të gjithë drunjtë në lapsa dhe oqeanet në ngjyrë! Ne duhet të jemi falënderues që Zoti na ka begatuar me të gjitha mirësitë.

Nëse njeriu mendon se ka vend ku të ik, mos të harrojë se për çdo njeri ka varr, se ai vrapon andej-këndej, por përsëri përfundimi i çdokujt prej nesh është në varr dhe nuk ka njeri që do të mund t`i shmanget kësaj. Allahu xh.sh. thotë: **“Mandej atë e bëri të vdesë dhe atij i bëri varr”.**[1039] Pra, çdo njeri e ka momentin dhe vendin e tij të caktuar, kështu që, sado që mundohet të ik, prej vetes nuk do mund të shkëputet. E kur të vijnë këto çaste të rënda, njeriu do të kërkojë zgjidhje dhe do shtohet tek ai dëshira për të dhënë lëmoshë, por ajo është stacioni i fundit pas të cilit nuk ka kthim dhe të gjitha dëshirat veniten dhe humben, sepse fillon procesi i botës tjetër. Zoti thotë në Kuran: **“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!” Kurrsesi, (Kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) der në ditën kur ringjallen”.**[1040]

Kurrsesi të mos harrojmë se pasuria është sprovë dhe njeriu mund të mashtrohet dhe të jepet pas saj, sepse njeriu është lakmitarë dhe mashtrohet lehtë, por, besimtarit të sinqertë, duhet t`i shërbejë si këshillues fjalimi i Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ku na orientoi drejt rrugës së mirësisë dhe devotshmërisë, kur na tregoi se sprova e këtij populli do të jetë pasuria. Ka`b b. Ijad radijeAllahu anhu thotë se Pejgamberi sal-lallahu alejhi

[1038] Kurani, Murselat, 20;
[1039] Kurani, Abese, 21;
[1040] Kurani, Mu`minun, 99-100;

ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, çdo popull ka pasur sprovë, kurse sprova e umetit tim do të jetë pasuria".*[1041]

Shpresojmë që Zoti të na zbutë zemrat dhe të fillojmë të shpërndajmë *sadaka,* para se të vijë momenti kur atë do ta dëshirojmë, por nuk do të kemi mundësi.

[1041] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 26, nr.2343 dhe thotë se është Hasenu-Sahih-Garib; Ahmed-i, "Musned", vëll.29, fq.15, nr.17.471;

HADITHI I NËNTËDHJETËEKATËRTË (94)

حَدَّثَنَا أَبُو عَامِرٍ، حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ، عَنْ أَبِي وَاقِدٍ اللَّيْثِيِّ، قَالَ: كُنَّا نَأْتِي النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا أُنْزِلَ عَلَيْهِ، فَيُحَدِّثُنَا فَقَالَ لَنَا ذَاتَ يَوْمٍ: " إِنَّ اللهَ قَالَ: إِنَّا أَنْزَلْنَا الْمَالَ لِإِقَامِ الصَّلَاةِ، وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ، وَلَوْ كَانَ لِابْنِ آدَمَ وَادٍ، لَأَحَبَّ أَنْ يَكُونَ إِلَيْهِ ثَانٍ، وَلَوْ كَانَ لَهُ وَادِيَانِ، لَأَحَبَّ أَنْ يَكُونَ إِلَيْهِمَا ثَالِثٌ، وَلَا يَمْلَأُ جَوْفَ ابْنِ آدَمَ إِلَّا التُّرَابُ، ثُمَّ يَتُوبُ اللهُ عَلَى مَنْ تَابَ "

Ebu Vakid el-Lejthi (r.a.) thotë: "Ishim pranë të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur i zbriste shpallja atij dhe na tregonte neve, më pas një ditë na tha: *"Allahu xh.sh. thotë:* ***"Unë ju kam zbritur pasurinë që të falni namazin dhe të jepni zekatin. Sikur biri i Ademit të kishte një luginë (me pasuri), do të dëshironte të dytën, e nëse do të kishte dy lugina, do të dëshironte të tretën, por gojën e birit të Ademit nuk e mbush asgjë përpos se dheut, pastaj do t`ua pranojë Zoti pendimin atyre që pendohen".***[1042]

Zoti me këtë *hadith* na bënë me dije se pse ka sjellë furnizim në tokë, jo që me të të bëjmë lojë dhe luks, por për të pasur mundësi të falim namazin dhe të japim zekatin. Njeriu nuk është krijuar kot, porse me një qëllim fisnik. Zoti thotë në Kuran: **"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë".**[1043]

[1042] Ahmed-i, "Musned", vëll.36, fq.237, nr.21.906; Taberani, "Mu`xhemu`l-Kebir", vëll.3, fq.279, nr.3301; Hejthemi-u në "Mexhmeu`z-Zevaid", 7/140, nr.11.507 thotë se zinxhiri i hadithit që përcjell Ahmedi është Sahih; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët për shkak Hisham b. Sa`d el-Medeniu për të cilin ka mendime të kundërta;

[1043] Kurani, Dharijat, 56;

Më pas, na tregon se njeriu kurrë nuk mjaftohet me atë që posedon, por gjithnjë do të vrapojë pas asaj që nuk mund ta arrijë. Prandaj, atë që nuk e mbush lakmia, e mbush dheu, kur të mbulohet me dheun përmbi dhe të shuhen të gjitha dëshirat dhe aspiratat. Nuk tha rastësisht i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Përkujtonie atë që ua shkatërron kënaqësitë (vdekjen)".*[1044]

Në ndërlidhje të këtij *hadith-i kudsi,* është edhe *hadith*-i që përcillet nga Enesi radijeAllahu anhu në të cilën vërtetohet një pjesë e *hadith*-it, se njeriu asnjëherë nuk mjaftohet me atë që posedon, porse do të ketë lakmi të vazhdueshme për të shtuar pasurinë. Transmeton Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sikur njeriu t`i ketë dy lugina me pasuri, do të dëshironte ta kishte edhe të tretën. Nuk e mbush syrin e njeriut asgjë, përpos dheut".*[1045]

Nuk është larg këtij kuptimi edhe *ajet*-i kuranor, ku thotë: **"Juve u preokupoi dëshira për shtim, derisa t`i vizitoni varrezat".**[1046]

E nëse njeriu jepet shumë pas pasurisë dhe depërton në zemrën e tij dashuria ndaj shtimit, do të anashkalojë edhe obligimet e tij ndaj të varfërve, kurse ata do të kërkojnë llogari për këtë në botën tjetër. Nëse muslimani nuk jep zekat, në Ditën e Gjykimit të varfërit do të kërkojnë të drejtën e tyre, siç thotë *ajet*-i **"Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp)".**[1047] Si dhe *hadith*-i nga Enes b. Maliku radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Mjer për të pasurit nga fukaratë në Ditën e Gjykimit, të cilët thonë: "O Zot neve na është bërë padrejtësi në atë që është bërë obligim për ne". Zoti thotë:* ***"Pasha Madhërinë Time, se do t`u kthehet borxhi".***[1048]

[1044] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 4, nr.2314 dhe thotë se ky hadith është Garibu-Hasen; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 31, nr.4258; Nesai-u, "Sunen", kitab el-Xhenaizi, bab 3, nr.1823; etj.

[1045] Buhari-u, "Sahih", kitab er-Rikaku, bab 10, nr.6439; Muslim-i, "Sahih", kitab ez-Zekatu, bab 39, nr.1048; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab ez-Zuhdi, bab 27, nr.4235 nga Ebu Hurejre, kurse Busiri-u në "Zevaid", në vlerësim të këtij hadithi, thotë se është hadith Sahih, ndërsa transmetuesit janë të besueshëm;

[1046] Kurani, Tekathur, 1-2;

[1047] Kurani, Dharijat, 19;

[1048] Taberani, "Mu`xhemu`s-Sagir", 1/246; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 3/148, nr.4325 thotë: "E transmeton Taberani në "Sagir" dhe "Euset" por aty gjendet Harith b. Numani i cili është i dobët";

Allahu xh.sh. na pastroftë zemrat nga dashuria ndaj pasurisë dhe na mundësoftë dhënien e lëmoshës dhe zekatit.

AGJËRIMI

HADITHI I NËNTËDHJETËEPESTË (95)

حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ مُوسَى، أَخْبَرَنَا هِشَامُ بْنُ يُوسُفَ، عَنِ ابْنِ جُرَيْجٍ، قَالَ: أَخْبَرَنِي عَطَاءٌ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ الزَّيَّاتِ، أَنَّهُ سَمِعَ أَبَا هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، يَقُولُ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " قَالَ اللَّهُ: كُلُّ عَمَلِ ابْنِ آدَمَ لَهُ، إِلَّا الصِّيَامَ، فَإِنَّهُ لِي وَأَنَا أَجْزِي بِهِ، وَالصِّيَامُ جُنَّةٌ، وَإِذَا كَانَ يَوْمُ صَوْمِ أَحَدِكُمْ فَلاَ يَرْفُثْ وَلاَ يَصْخَبْ، فَإِنْ سَابَّهُ أَحَدٌ أَوْ قَاتَلَهُ، فَلْيَقُلْ إِنِّي امْرُؤٌ صَائِمٌ "

Transmeton Ebu Hurejre radijeAllahu anhu se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"All-llahu (xh.sh.) thotë:* ***"Çdo punë e birit të Ademit është për të, përpos agjërimit, ai është Imi dhe Unë jam ai që jep shpërblimin për të. Agjërimi është mburojë, e kur të vijë agjërimi, mos shajë e as mos ofendo, e nëse dikush të ofendon apo të lufton, thuaj: "Unë jam agjërueshëm".*** [1049]

Në një transmetim tjetër të Buhariut vjen me shtesën: ***"Pasha Atë që shpirti Muhamedit është në dorën e Tij, ndryshimi i erës së gojës së agjëruesit te All-llahu është më i mirë sesa era e miskut. Ai që agjëron ka dy gëzime: "Kur han iftarin dhe kur takohet me Zotin e vet do të jetë gëzimi tjetër për agjërimin e tij".***[1050]

Agjërimi është prej shtyllave të fesë dhe një prej adhurimeve që ngre lart shpirtin e besimtarit. Është një mënyrë e mirë për të pastruar shpirtin dhe trupin. Është adhurim që e din vetëm Zoti i gjithësisë, pasi është një sekret në mes Tij dhe robit. Besimtari i kryen adhurimet, porse ato mund të vërehen nga ana e njerëzve, kurse agjërimi dallon prej veprave tjera, sepse vetëm Zoti është në dijeni për gjendjen e njeriut dhe është larg syefaqësisë

[1049] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Saumu, bab hel jekulu inni saimun idha shutime, nr.1904; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab 30, nr.1151; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Saumi, bab 55, nr.764; Nesai-u, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 42, nr.2215; Ibn Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 1, nr.1638 dhe nr.3823; etj.

[1050] Buhari-u, "Sahih", kitab et-Teuhidi, bab 35, nr.7492; etj.

dhe shtirjes. Zoti më shumë i donë ato vepra që i kryen robi fshehtas, larg syve të njerëzve, sepse atëherë është e sinqertë vepra dhe më afër pranimit.

Në transmetimin e Ahmedit vjen me këtë tekst: ***"Çdo vepër të mirë që e kryen biri i Ademit, shumëzohet për dhjetë fish deri në shtatëqind fish, përpos agjërimit, sepse ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të, pasi agjëruesi e lë dëshirën e tij për Mua dhe e braktis ushqimin për hir Timin".***[1051]

Zoti dëshiron, që agjërimin ta shpërblejë në mënyrë të veçantë, duke i bërë me dije besimtarit, se vepra e tij nuk shkon kot. Me këtë thënie, Zoti edhe e ngre vlerën e agjërimit, pasi ia përshkruan atë Vetes. Shkaku i vlerës së madhe që ka ky adhurim, edhe ka përgatitur Zoti një derë të veçantë në Xhenet, përmes së cilës do të hyjnë vetëm agjëruesit, e ajo është dera *Rejjan.*

Është e mundur, që Zoti ta shpërblejë në mënyrë të veçantë agjërimin, shkaku se vetëm besimtari mysliman e kryen atë për hir të Zotit dhe është adhurim të cilin idhujtarët nuk e kanë realizuar për idhujt e tyre, pasi idhujtarët, nuk kryejnë agjërim për idhujt e tyre, por kryejnë namaz, sadaka, flijime dhe adhurime tjera për ta.

Agjërimi është edhe mburojë e njeriut, sepse e mbron nga mëkatet, e mbron nga fjalët dhe sjelljet e pahijshme, i bën një disiplinë shpirtërore njeriut, saqë besimtari edhe largohet dhe distancohet nga jeta e shfrenuar dhe me mëkate. Agjërimi është mburojë, sepse e largon njeriun nga ngatërresat, duke e përkujtuar veten se është agjërueshëm.

Agjërimi është mburojë për agjëruesin nga zjarri i Xhehenemit, sepse me agjërim, besimtari largohet shumë larg zjarrit të botës tjetër. Këtë e vërteton edhe *hadithi kudsij* që përcillet nga Xhabiri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Zoti jonë:* ***"Agjërimi është mburojë, e mbron robin prej Zjarri, ai (agjërimi) është për Mua dhe Unë shpërblej për të".***[1052]

[1051] Ahmed-i, "Musned", 13/49, nr.7607; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit thotë: "Zinxhiri i këtij hadithi është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit".

[1052] Ahmedi, "Musned", 23/33, nr.14.669; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/317, nr.3292; Hejthemiu në "Mexhmeu`z-Zevaid", 3/180, nr.5077 thotë: "E përcjell Ahmedi kurse zinxhiri i tij është Hasen". Shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të Musnedit të Ahmed-it thotë se hadithi është Sahih në bazë të haditheve tjera dëshmi, ndërsa zinxhiri i këtij hadithi është Hasen...".

Agjërimi është mburojë, sepse e mbron njeriun nga sëmundjet e ndryshme, që mund ta godasin trupin e njeriut nga helmet e ndryshme, të cilat pastrohen përmes agjërimit.

Besimtari gjatë agjërimit duhet të jetë i durueshëm, sepse edhe kjo është ndër motivet kryesore të agjërimit, që të shtojë durimin në zemrën e njeriut. Nëse njeriu ofendohet nga ndonjë person, ai duhet të tregohet i durueshëm, sepse është agjërueshëm. Agjëruesi nuk duhet të bie pre e provokimeve të ndryshme, po as të jetë shkaktarë i provokimit. Agjërimi duhet të jetë alarmi për largim nga ngatërresat e ndryshme. Nëse dikush e provokon dhe dëshiron të zihet me të, agjëruesi le të thotë: "Unë jam agjërues". Këtë mund ta thotë me zemër ose me gjuhë, fshehtas ose haptas.

Ndërsa, era e gojës që ndryshon tek agjëruesi gjatë agjërimit, për Allahun xh.sh. është më i dashur, sesa era e parfumit, sepse ajo gojë ka ndryshuar erën për hir të Zotit, duke qëndruar pa ushqim dhe pije brenda ditës. Me këtë nënkuptohet se Zoti është i kënaqur me robin e tillë. Është e mundur që kjo erë, të vijë në shprehje në Ditën e Gjykimit dhe njerëzit tjerë, të nuhasin erë të këndshme nga agjëruesi, siç do të nuhasin erë të mirë nga gjaku i *shehid*-ave.

Kurse agjëruesi, për shkak të agjërimit të tij, do të ketë dy gëzime, njërin në këtë botë dhe tjetrin në botën tjetër. Gëzimi në këtë botë, është çasti i uljes në sofër duke pritur iftarin, sepse njeriu gjatë tërë ditës duke qëndruar i uritur, pret çastin kur i lejohet të konsumojë ushqim dhe pije. Me këtë ai realizon adhurimin e tij që ka kryer gjatë ditës dhe me sukses e përmbyllë këtë adhurim. Po ashtu, ai gëzohet në ato çaste, sepse është momenti kur pranohen *dua*-të. Sa i përket gëzimit në botën tjetër, është momenti i takimit me Zotin e gjithësisë dhe kur do të merr shpërblimin për agjërimin e vet. Zoti e ndërlidhi gëzimin e përjetuar të agjëruesit në *iftar*, me gëzimin që do ta përjetojë në Ditën e Gjykimit, kur do të takohet me Allahun xh.sh. dhe prej Tij do të merr shpërblimin për agjërimin e vet.

HADITHI I NËNTËDHJETËEGJASHTË (96)

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الأَنْصَارِيُّ قَالَ: حَدَّثَنَا الوَلِيدُ بْنُ مُسْلِمٍ، عَنْ الأَوْزَاعِيِّ، عَنْ قُرَّةَ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " قَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: إِنَّ أَحَبَّ عِبَادِي إِلَيَّ أَعْجَلُهُمْ فِطْرًا ".

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Thotë Allahu xh.sh.:* ***"Robërit e Mi më të dashur, janë ata që më së shumti përshpejtojnë me iftarin".***[1053]

Ramazani si muaji më madhështorë në kalendarin islamik, në vetvete ngërthen shumë begati dhe mirësi, që nuk mund të numërohen me fjalë, sepse aftësitë tona, janë të kufizuara dhe nuk mund të arrijnë të përshkruajnë Mëshirën hyjnore të Zotit. Në Ramazan, gjendet edhe një begati tjetër madhore, që fut gëzim në zemrën e agjëruesit, prej së cilës besimtari shpreson mirësi të shumta, ajo është *iftari* në fund të ditës. Nga *hadith*-et e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem kuptojmë se *iftari* nuk është vetëm fundi i ditës dhe fillimi i të ushqyerit, porse në të gjenden edhe begati të ndryshme, që shpresojmë të jemi meritorë për t`i gëzuar ato.

Prej mirësive dhe begative të shumta që ka kjo periudhë e ditës së agjërimit, është se agjëruesi, i cili nxiton për të filluar *iftar*-in, është prej robërve më të dashur të Zotit, e nderi më i madh që mund t`i ofrohet një besimtari, është Dashuria Hyjnore për të. Kjo vërtetohet përmes *hadith*-it *kudsij*, i cili u shënua më sipër.

[1053] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Saumi, bab 13, nr.700 dhe thotë se hadithi është Hasenu-Garib; Ahmed-i, "Musned", 12/182, nr.7241 dhe 14/98, nr.8360; Ibni Hiban-i, në "Sahih"-un e tij, sipas radhitjes së Ibën Belbanit në "Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban", 8/275, nr.3507; Ibni Huzejme, "Sahih", kitab Saum, bab 128, nr.2062; Begavi-u, "Sherhu`s-Sunneh", 6/256, nr.1732-33 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; shejh Shuajb el-Arnauti thotë se zinxhiri i këtij hadithi është i dobët, në zinxhir gjendet Kurre Abdurahman b. Muafiriju, për të cilin janë unik se është i dobët, e disa kanë thënë se është i besueshëm;

Et-Tibi konsideron se shkaku për të cilin Allahu xh.sh. i do ata që nxitojnë me iftarin, është se ata e praktikojnë sunetin e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe kundërshtojnë risimtarët dhe ithtarët e librit (jehudët dhe krishterët).[1054] Gjithashtu i donë nga shkaku se ata shpejtojnë ta realizojnë urdhrin e Zotit sa më shpejtë. Ata ishin të urdhëruar me agjërim dhe u nënshtruan atij urdhëri, si dhe ishin të urdhëruar të bëjnë *iftar* dhe ata nxituan që ta realizojnë atë. Kjo është prej shenjave të besimit të sinqertë dhe nënshtrimit të plotë të Zotit.

Këtë traditë Islame, e vërtetojnë edhe tekste tjera të shumta. Ne do të përmendim vetëm disa për dëshmi. Trasmetohet nga Sehl ibn Sa'di r.a. se Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njerëzit do të kenë mirësi derisa ta shpejtojnë iftarin".*[1055]

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njerëzit do të kenë mirësi derisa ta shpejtojnë iftarin. Shpejtoni me iftarin, sepse jehudët e vonojnë atë".*[1056]

Nga begatitë e çastit të iftarit, është edhe pranimi i lutjeve të agjëruesit, sepse Allahu xh.sh. në ato çaste ka hapur dyert e pranimit për ta. Transmeton Abdullah b. Amër el-Asi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë*: "Vërtet lutja e agjëruesit në iftar nuk refuzohet".*[1057]

Në këtë kontekst, mund të përmendim edhe *hadith*-in tjetër, që trasmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre personave u pranohet lutjet: 1. Agjëruesit deri në iftar; 2. Udhëheqësit (prijësit) të drejtë; 3. Lutja e të dëmtuarit (të keqtrajtuarit) ngrihet lart, i hapen dyert e qiellit dhe Zoti i thotë:* ***"Pasha fuqinë Time, do të ndihmoj, qoftë edhe pas një kohe".***[1058]

[1054] Mubarekfuri, "Tuhfetu`l-Ahfedhi", fq.918;

[1055] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Saumu, bab 45, nr.1957; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab 9, nr.1098, Tirmidhi-u, "Sunen", kitab es-Saumi, bab 13, nr.699; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 24, nr.1697; Ahmed-i, "Musned", 37/463, nr.22.804;

[1056] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Sijamu, bab ma justehabu min taxhili`l-fitri, nr.2353; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 24, nr.1698; Ahmed-i, "Musned", 15/503, nr.9810;

[1057] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 48, nr.1753; etj. shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në "Sunen"-in e Ibni Maxhes (2/636) thotë se zinxhiri i hadithit është Hasen;

[1058] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 128, nr.3609 dhe thotë se hadithi është Hasen; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 48, nr.1752; Ahmed-i, "Musned", 15/463, nr.9743; shejh Shuajb el-Arnauti në verifikim të këtij hadithi në Musnedin e

Prej begative të iftarit, është lirimi i një numri të madh të njerëzve nga zjarri i Xhehenemit. Transmeton Ibni Mes`udi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu për çdo natë të Ramazanit gjatë iftarit liron gjashtëdhjetë mijë njerëz nga Zjarri. E kur vjen dita e Bajramit, liron tridhjetë herë më shumë seç ka liruar gjatë gjithë Ramazanit".*[1059]

Është e preferuar që të bëhen edhe lutjet të cilat na janë përcjellë prej Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i cili bënte *dua* të ndryshme gjatë kohës së iftarit. Prej tyre mund të përmendim lutjen që e përcjellë Ibni Umeri r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem para iftarit ka thënë: "Dhehebe`dh-dhame`u, ve`b-tel-leti`l-uruk, ve thebete`l-exhru inshaallah" - *"Kaloi etja, u lagën venët dhe u realizua shpërblimi inshaallah".*[1060]

Po ashtu, transmeton Ibni Abasi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në iftar, ka lexuar edhe këtë dua: *"Allahumme leke sumtu, ve ala rizkike eftarna, fe tekabbelhu minna inneke ente Semiu`l-Alim". (O Zot, për Ty agjërova, me furnizimin Tënd bëj iftar, andaj pranoje prej nesh, sepse Ti je Ai që Dëgjon dhe Di)".*[1061]

Transmeton Muadh b. Zuhre (*Tabiin*) se i kanë përcjellë, që Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur ka bërë *iftar*, ka bërë këtë *dua*: *"Allahumme leke sumtu, ve ala rizkike aftartu" (O Allahu im, për Ty agjërova dhe me rizkun Tënd bëj iftar)".*[1062]

Këto janë lutje të ndryshme, porse gjithsesi njeriut në çastet e iftarit, i lejohet të bëjë edhe lutje për nevojat e tija, sepse është çasti kur lutjet nuk refuzohen.

Është shumë me vlerë, që njeriu të shtrojë iftar për të tjerët, sepse me këtë rast, do të fitojë shpërblimin e barazvlefshëm me shpërblimin e të gjithë atyre që janë ftuar për *iftar*, duke mos u pakësuar nga shpërblimi i tyre

---

Ahmedit, thotë se hadithi është Sahih në bazë të rrugëve tjera dhe hadithe dëshmi, por ky zinxhir është i dobët shkaku i Ebu Mudiles..;

[1059] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/221, nr.3334;

[1060] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Sijamu, bab 22 nr.2357;

[1061] Ibni Sunnij-u, "Amelu`l-Jeumi ve`l-Lejleti", fq.288, nr.480; në sened është Abdulmelik b. Harun b. Anter të cilin Ahmedi dhe Darekutni e konsiderojnë të dobët. Jahja thotë se ai është gënjeshtar. Ibni Hatim-i thotë që është i përjashtuar dhe hadithet e tij nuk pranohen. Ibni Hibbani thotë se ai ka trilluar hadithe;

[1062] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Sijamu, bab 22, nr.2358;

asgjë. Trasmetohet nga Zejd ibn Halid El-Xhuheni r.a. se Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush ushqen një agjërues, fiton shpërblimin sa të tij ashtu që nuk pakësohet as shpërblimi i agjëruesit"*.[1063]

Gjeneratat e mëhershme, e kanë pasur princip që të mos hanë vet në tryezë, porse të shoqërohen nga dikush, sidomos nga të varfërit dhe jetimët. Abdullah b. Umeri r.a., Malik b. Dinari dhe Ahmed b. Hanbeli e jepnin iftarin e tyre për të tjerët, edhe pse vet ishin të nevojshëm. Edhe ne duhet ta kthejmë në praktikë që sa më shumë të organizojmë iftare të përbashkëta, qofshin ato familjare ose shoqërore.

Është mirë që të bëhet lutje për nikoqirin e shtëpisë i cili ka shtruar iftarin, sepse kështu ka qenë sjellja e mësuesit të njerëzisë, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që t`u jep kënaqësi shpirtërave të tyre. Transmeton Enesi r.a. se kur bënte Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem iftar te dikush thonte: *"Te ju bëfshin iftar agjëruesit, ushqimin tuaj e paçin ngrënë të mirët dhe te ju zbritshin engjëjt".*[1064]

Transmeton Abdullah b. Busër r.a. se në shtëpinë e tij, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka bërë këtë *dua*: *"O Allah, jepu bereqet në rrizkun e tyre, fali ata dhe mëshiroi".*[1065]

Transmeton Mikdadi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...O Zoti im! Ushqeje atë që më ushqeu mua dhe jepi të pijë atij që më dha mua për të pirë...".*[1066]

Prefeforet që agjëruesi të fillojë iftarin me hurma, e nëse nuk gjen hurma, atëherë mundet edhe me ujë. Transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kur kishte hurma, e bënte iftarin vetëm me hurma...".[1067]

[1063] Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Saum, bab 82, nr.807 dhe thotë sa hadithi është Hasenu-Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 45, nr.1746; Ahmed-i, "Musned", 28/261, nr.17.033;

[1064] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab Et`ime, bab 54, nr.3854; Ahmed-i, "Musned", 19/215, nr.12.177;

[1065] Muslim-i, "Sahih", kitab Eshribeh, bab 22, nr.2042; etj.

[1066] Muslim-i, "Sahih", kitab Eshribeh, bab 32, nr.2055; etj.

[1067] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Sijamu, bab 21, nr.2356; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Saum, bab 10, nr.696 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Garib; Ahmed-i, "Musned", 20/110, nr.12.676;

Trasmeton Selman ibn Amir ed-Dibbij r.a. se Muhmedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë*: "Kur bën ndokush iftar, le të fillojë me hurme sepse ajo është begati, e nëse s'gjen dot, ateherë me ujë, sepse uji është i pastër".*[1068]

Nuk është e preferuar që njeriu ta teprojë me ushqim në iftar, nga shkaku se rëndon veten dhe pasivizohet në namazet e teravisë, andaj do duhet të kontrollohet sasia e ushqimit.

Të lutemi që Zoti të na jep bereqet në iftaret tona, të na bashkoj zemrat tona ashtu siç bashkohemi në sofër dhe t`na pranoj lutjet tona të iftarit.

[1068] Ebu Davud-i, "Sunen", kitab es-Sijamu, bab 21, nr.2355; Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Saum, bab 10, nr.695 dhe thotë se hadithi është Hasenun-Sahih; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 25, nr.1699; etj.

HADITHI I NËNTËDHJETËESHTATË (97)

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللهِ بْنُ وَهْبٍ، أَخْبَرَنِي أَبُو نَافِعٍ الْمَعَافِرِيُّ، عَنْ إِسْحَاقَ بْنِ أُسَيْدٍ، عَنْ أَبِي بَكْرٍ الْهُذَلِيِّ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ الْهَمْدَانِيِّ، أَنَّ عَلِيَّ بْنَ أَبِي طَالِبٍ، قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: " إِنَّ اللهَ عَزَّ وَجَلَّ أَوْحَى إِلَى نَبِيٍّ مِنْ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنْ أَخْبِرْ قَوْمَكَ أَنْ لَيْسَ عَبْدٌ يَصُومُ يَوْمًا ابْتِغَاءَ وَجْهِي إِلَّا صَحَّحْتُ جِسْمَهُ وَأَعْظَمْتُ أَجْرَهُ "

Transmeton Ali b. Ebu Talibi (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sellem ka thënë: *"Allahu xh.sh. i ka shpallur një të dërguari prej beni Israilëve që t`i lajmërojë popullin e tij se:* ***"Nuk ka rob i cili agjëron një ditë duke synuar kënaqësinë Time, e të mos ia përmirësoj trupin dhe t`ia shumëfishoj shpërblimin".***[1069]

Agjërimi si adhurim ka qenë i pranishëm edhe te popujt e mëparshëm, kurse Zoti edhe neve na e obligoi që të mos ngelim pas me shpërblime, por që të përfitojmë nga mirësitë e shumta që ka agjërimi. Këtë e thotë Zoti në Kuran: **"O ju që keni besuar, u është bërë obligim juve agjërimi, siç ishte obligim edhe për ata që ishin para jush, në mënyrë që të jeni të devotshëm".**[1070]

Numri i pejgamberëve që ishin dërguar te beni Israilët është i madh, andaj nuk përmendet me emër në këtë *hadith* se për cilin pejgamber bëhet fjalë, kështu që nuk do të presupozojmë.

Çdo pejgamber ka pasur urdhër që t`i lajmërojë ithtarët e vet dhe t`ua tregojë obligimet me të cilat i ka ngarkuar Zoti.

[1069] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", vëll.5, fq.416, nr.3638; verifikuesi i veprës së Bejhekiut, Abdulalij Abdulhumejd el-Hamidi për këtë hadith thotë se ka zinxhirin e dobët shkaku i dobësisë së disa transmetuesve;
[1070] Kurani, Bekare, 183;

Në këtë *hadith*, shohim vlerën e një dite agjërimi, që realizohet për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. Në një *hadith*, që e transmeton Ebu Seid el-Hudriju r.a. kuptojmë se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ai që agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Allahu do ta largojë Zjarrin prej fytyrës së tij në distancë prej 70 viteve".*[1071]

Nëse besimtari e realizon këtë obligim të cilin ia kërkon Allahu xh.sh. ai do të ketë dy lloje të dobisë, e para trupore dhe e dyta shpirtërore. Ajo trupore, është se do t`i përmirësohet trupi dhe shëndeti, kurse ajo shpirtërore është se i falen mëkatet dhe i pastrohet shpirti.

Edhe trupi i njeriut ka dobi nga agjërimi, gjë e cila është konfirmuar edhe përmes analizave mjekësore dhe përvojave të ekspertëve të kësaj fushe. Në këtë drejtim kemi edhe një *hadith* të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem ku vërtetohet dobia shëndetësore e agjërimit. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...Agjëroni, që të shëroheni (të jeni të shëndoshë)...".*[1072]

Edhe pse ky *hadith* në vlerësimin e disa dijetarëve është i dobët, por përvoja dhe eksperienca e mjekëve të specializuar, e konfirmon dhe vërteton këtë të vërtetë se trupi ka dobi nga agjërimi i bërë.

Një ndër sëmundjet të cilat i parandalon dhe i shëron agjërimi është edhe sëmundja që sot është ndër më të përhapurat në botë, e ajo është kanceri. Përse agjërimi shëron kancerin? Është e njohur se qelizat e tumorit kanë nevojë jashtëzakonisht më të madhe për ushqim se që u nevoiten të gjitha qelizave tjera në organizëm. Po ashtu është fare e ditur se zvoglimi i konsiderueshëm i sasisë së pranuar të ushqimit, ose thënë thjesht uria ndikon shumë më dëmshëm në qelizat malinje të tumorit, përkatësisht kancerit se sa në qeliza të indit normal. Pra me uri praktikisht mbyten qelizat malinje, ndërsa me këtë qelizat normale praktikisht mbeten të padëmtuara.

Ana tjetër e dobisë së agjërimit është se ai ndihmon në shërimin e shumë sëmundjeve, si dhimbjet akute të stomakut, shqetësimet e zorrës së trashë, sëmundjet e mëlçisë, të mos tretjes si duhet të ushqimeve, etj. Po ashtu ai ndihmon në mjekimin e dhjamosjes (obezitetit), të trombozave dhe

[1071] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Xhihadi ve`s-Sijeri, bab fadli`s-saumi fi sebililah, nr.2840; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab fadlu`s-sijami fi sebililahi limen jutikuhu, nr.1153; etj.
[1072] Taberani, "Mu`xhemu`l-Evsat", 8/174, nr.8312;

sklerozimit të enëve të gjakut, në uljen e tensionit të gjakut, të frymëmarjes, etj. Mjeku zviceran Barsilius ka shkruar se dobia e urisë në mjekimin e disa sëmundjeve e kalon shumë herë dobinë e përdorimit të barnave medicinale. Ndërsa mjeku Hilab ua ndalonte ushqimin të sëmurëve të tij per disa ditë me radhë dhe vetëm pas kësaj fillonte t'u jepte porcione ushqimore të lehta. Agjerimi ndihmon gjithashtu në shkatërrimin e fibrave të sëmura e të panevojshme, e kjo ndodh gjatë fenomenit të agjerimit, por që rindërtohen të reja përsëri pas marrjes së ushqimit. Ky është shkaku që i ka bërë disa shkencëtarë, midis të cilëve edhe Bashutin, të pohojnë se agjerimi ndihmon në kthimin e rinisë.

Sot njihen disa mjekë të rangut botërorë që shërojnë të sëmurët vetëm me agjërim. Kështu mjeku i njohur dr.Riedlin është i njohur për shërimin e pacientëve të tij me agjërim dhe e ka quajtur agjërimin “operim pa thikë”.

Dijetarë të ndryshëm vërtetojnë se agjërimi në mënyrë efikase i nxjerr helmet e ndryshme nga organizmi. Në trupin e njeriut ka disa mikrobe të cilat zhduken vetëm me uri rigoroze. Gjatë agjërimit zhduken yndyrat e tepërta, të thatët mbyllen, po ashtu zhduken puçrrat dhe njollat tjera nga fytyra.

Dobitë shëndetësore të agjërimit janë të shumta dhe ato vërtetohen dita ditës edhe më shumë nga mjekët ekspert, kështu që ne si besimtarë para se ta marrim si dietë agjërimin, ne këtë e kryejmë si nënshtrim ndaj Zotit dhe adhurim, por nëse ka edhe dobi tjera që ne nuk i dimë, janë të mirëseardhura.

HADITHI I NËNTËDHJETËETETË (98)

حَدَّثَنَا يَزِيدُ، أَخْبَرَنَا هِشَامُ بْنُ أَبِي هِشَامٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْأَسْوَدِ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " أُعْطِيَتْ أُمَّتِي خَمْسَ خِصَالٍ فِي رَمَضَانَ، لَمْ تُعْطَهَا أُمَّةٌ قَبْلَهُمْ: خُلُوفُ فَمِ الصَّائِمِ أَطْيَبُ عِنْدَ اللهِ مِنْ رِيحِ الْمِسْكِ، وَتَسْتَغْفِرُ لَهُمُ الْمَلَائِكَةُ حَتَّى يُفْطِرُوا، وَيُزَيِّنُ اللهُ عَزَّ وَجَلَّ كُلَّ يَوْمٍ جَنَّتَهُ، ثُمَّ يَقُولُ: يُوشِكُ عِبَادِي الصَّالِحُونَ أَنْ يُلْقُوا عَنْهُمُ الْمَئُونَةَ وَالْأَذَى وَيَصِيرُوا إِلَيْكِ، وَيُصَفَّدُ فِيهِ مَرَدَةُ الشَّيَاطِينِ، فَلَا يَخْلُصُوا فِيهِ إِلَى مَا كَانُوا يَخْلُصُونَ إِلَيْهِ فِي غَيْرِهِ، وَيُغْفَرُ لَهُمْ فِي آخِرِ لَيْلَةٍ " قِيلَ: يَا رَسُولَ اللهِ، أَهِيَ لَيْلَةُ الْقَدْرِ؟ قَالَ: " لَا، وَلَكِنَّ الْعَامِلَ إِنَّمَا يُوَفَّى أَجْرَهُ إِذَا قَضَى عَمَلَهُ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Umetit tim i janë dhënë pesë gjëra në Ramazan, që nuk i janë dhënë asnjë ummeti të mëhershëm: "Era e gojës së agjëruesit, është më e dashur për Allahun sesa aroma e miskut, për ta luten melekët për falje derisa të vijë koha e iftarit, si dhe për çdo ditë, për ta Zoti e zbukuron Xhenetin dhe thotë:* ***"Edhe pak dhe do të largohet çdo brengë dhe shqetësim prej robërve të Mi dhe ata do të vijnë te ti".*** *Prej tyre (agjëruesve) largohet intriga e shejtanit dhe ata nuk mund të bëjnë atë që bënin më parë jashtë tij (jashtë Ramazanit) dhe atyre (agjëruesve) u falen mëkatet në natën e fundit të tij (të Ramazanit)".* I thanë: "O i Dërguari i Allahut, a është kjo në natën e Kadrit?" Tha: *"Jo, por kur një punëtor kryen punën e tij, në fund për atë punë i jepet edhe pagesa".*[1073]

[1073] Ahmed-i, "Musned", vëll.13, fq.295, nr.7917; Bezzar-i, "El-Bahru`z-Zehar", 15/189, nr.8571 dhe thotë se Hisham b. Zijadi nuk është i fortë në hadith; Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/219-220, nr.3330; Hejthemi-u e shënon në "Mexhmeu`z-Zevaid", 3/255, nr.4778 dhe thotë: "E shënojnë Ahmedi dhe Bezzari, e në të gjendet Hisham b. Zijadi ebu Mikdam, i cili është i dobët; Shuajb el-Arnauti dhe Adil Murshid në verifikimin e këtij hadithi, thonë se hadithi është shumë i dobët, shkaku se në zinxhir gjendet Hisham b. Ebu Hisham i cili quhet Hisham b. Zijad el-Kureshiju Ebu Mikdam për të cilin dijetarët janë unik se është i dobët. Po ashtu në zinxhir gjendet Muhamed b. Muhamed b. Esved, të cilit nuk i dihet

Ky *hadith* na bën të qartë vlerën e madhe që ka brenda vetes ky muaj madhështor, që ngërthen shumë mirësi dhe begati për besimtarët musliman, kurse *hadith*-i vë theksin në pesë prej tyre, të cilat kanë një rëndësi të veçantë në jetën e besimtarit, sidomos gjatë Ramazanit, andaj duhet munduar që ta kuptojmë në mënyrën sa më të qartë.

Nga *hadith*-i kuptojmë se këto pesë veçori, nuk i janë dhënë asnjë populli të mëhershëm, edhe pse agjërimi ka qenë prezent edhe në adhurimet e tyre, porse për këtë *umet*, agjërimi ka tjetër tretman, sepse ky *umet* është më i dashur i Zotit, pasi për ta, u dërgua pejgamber më i dashuri i Zotit, Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Veçoria e parë që e karakterizon agjërimin e këtij *umeti*, është se aroma që kundërmon nga goja e agjëruesit, edhe pse është e padashur për njerëzit, është e dashur për Zotin, sepse agjëruesi qëndron uritur për hir të Allahut xh.sh., kurse era e tillë vjen si pasojë e urisë dhe zbrazjes së lukthit, kështu vjen erë që ndoshta njerëzit e urrejnë një të tillë, por ajo nuk është e urryer për Zotin. Ai xh.sh. shpërblen për urinë që përjeton besimtari për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. Te Zoti nuk ka aromë misku, që mund të krahasohen me erën e gojës së agjëruesit. Këtë pjesë të *hadith*-it, e dëshmon edhe *hadith*-i tjetër që regjistrohet te Muslimi, të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...Pasha atë që shpirti im është në duart e Tij, era e gojës së agjëruesit është më e këndshme tek Allahu i Lartësuar sesa era e parfumit".*[1074] Por edhe në *hadithin kudsij* që u shënua më herët në këtë temë, e dëshmon këtë fakt.

Veçoria e dytë e agjërimit të Ramazanit nga besimtari që është pjesëtar i këtij *umet*-i, është se për të luten melekët, që Zoti t`ia falë mëkatet dhe kështu luten derisa të fillojë ushqimin në kohën e iftarit. Kurse dihet se Zoti nuk e refuzon lutjen e melekëve, të cilat janë krijesat më të pastra dhe më të dashura të Zotit. Për një besimtarë që luten melekët, ai ka një pozitë të ndershme dhe do të përfitojë gjithqysh nga kjo lutje e tyre.

Veçoria e tretë, është se në ditët e Ramazanit, Zoti e zbukuron Xhenetin sa më shumë dhe e stolis për besimtarët musliman, të cilët kanë agjëruar për hir

---

gjendja, prej të cilit përcjell vetëm Hishami dhe Abdullah b. Auni, kurse Ibni Hiban-i e përmend në librin e tij "Eth-Thikat".

[1074] Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab 30, nr.1151; etj.

të Allahut xh.sh. dhe të kënaqen në të kur të hyjnë aty në Ditën e Gjykimit. Në *hadith*, përmendet se Xheneti i cili është i përgatitur enkas për agjëruesit quhet *Rejjan*. Transmeton Sehël ibën Sa`di r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Vërtet në Xhenet është një derë, e cila quhet Rejjan, në të cilën do të hyjnë Ditën e Gjykimit vetëm ata që kanë agjëruar, nëpër atë derë të tjerët nuk do të hyjnë. Do të thirret në atë derë:* ***"Ku janë agjëruesit****". Do të çohen agjëruesit dhe nuk do të mund tjetërkush të hyjë nga kjo derë, e pasi të hyjnë agjëruesit, dera do të mbyllet e nuk do të mundet të hyjë askush tjetër".*[1075]

Veçoria e katërt e agjërimit, është se në këtë muaj Zoti i mbron besimtarët nga *shejtan*-ët e tërrbuar, por ata duhet të kenë kujdes në frenimin e *nefsit*, sepse njeriu mund të kursehet nga mashtrimet e *shejtan*-it, por e ka edhe armikun tjetër të brendshëm, që është nefsi, i cili në disa raste mund të jetë më i rrezikshëm se edhe vet *shejtan*-i. Pra, *shejtan*-ët jashta Ramazanit kanë qasje tek njeriu më lehtë, kurse në muajin e Ramazanit, *shejtan*-ët lidhen me zinxhirë. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e Zjarrit, kurse shejtanët lidhen".*[1076]

Dhe veçoria e pestë që përmendet në këtë *hadith*, është se agjëruesve me përfundimin e muajit të Ramazanit, u falen mëkatet. Kjo vërtetohet edhe me shumë hadithe tjera, që dëshmojnë se agjërimi është shkak për faljen e mëkateve. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kushdo që agjëron Ramazanin me besim të sinqertë dhe me shpresë (për t`u falur nga Allahu e jo për rija) do t`i falen të gjitha mëkatet e kaluara".*[1077]

Gjithashtu si dëshmi vlen edhe *hadith*-i tjetër që përcillet nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"...çdo ditë të Ramazanit, Allahu liron disa (prej Xhehenemit) dhe kjo vazhdon kështu çdo natë (të Ramazanit)".*[1078]

[1075] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Saumu, bab 4, nr.1896; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab 30, nr.1152; etj.
[1076] Buhari-u, "Sahih", kitab es-Saumu, bab 139, nr.1899; Muslim-i, "Sahih", kitab es-Sijamu, bab fadl shehri ramadan, nr.1079; etj.
[1077] Buhari-u, "Sahih", kitabu`l-Imanu, bab 28, nr. 38; Muslim-i, "Sahih", kitab Salatu`l-Musafirine ve kasriha, bab 25, nr.760; etj.
[1078] Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 2, nr.1642; etj.

Sahab-ët që ishin prezent ngelën të habitur dhe kërkuan t`u sqarohet se mos vallë kjo gjerësi e faljes së mëkateve, është nata e Kadrit, kur Zoti e falë atë i cili e qëllon me adhurim këtë natë, apo është diç tjetër? Por, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ua bëri me dije se nuk është në pyetje nata e Kadrit, por është nata e rëndomtë e fundit të këtij muaji, që me arritjen e kësaj nate, Zoti ua fal mëkatet të gjithë agjëruesve, ditë kur e marrin shpërblimin e tyre për angazhimin që kanë bërë gjatë këtij muaji.

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ilustroi këtë falje, me punëtorin i cili punon gjatë një muaji, dhe në fund të tij merr shpërblimin, kështu edhe besimtari në fund të muajit me agjërim, e merr shpërblimin e vet, që është falja e mëkateve dhe kjo do të jetë kënaqësia e agjëruesit i cili në Ditën e Gjykimit, do të përjetojë gëzimin për agjërimin e vet, kur do të sheh faljen e Zotit dhe fitimin e Xhenetit.

Bejhekiu e shënon edhe një transmetim tjetër, nga Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"I janë dhënë umetit tim në muajin e Ramazanit pesë gjëra të cilat nuk i janë dhënë ndonjë pejgamberi para meje: "E para, kur është nata e parë e Ramazanit, Allahu i shikon ata, e kë e shikon Allahu nuk e dënon atë asnjëherë"; e dyta: "Era e gojës së agjëruesit deri në iftar, është më e dashur te Zoti se era e miskut"; e treta: "Melekët kërkojnë falje për ta gjatë çdo dite dhe nate"; e katërta: "Allahu e urdhëron Xhenetin dhe i thotë:* ***"Drejtohu dhe zbukurohu për robërit e Mi, Dëshiroj që të pushojnë nga lodhjet e botës dhe të vijnë në Shtëpinë Time dhe Nderimi Im".*** *Kurse e pesta: "Kur vjen nata e fundit, ua fal të gjithëve".* Një njeri në mesin e turmës tha: "O i Dërguari i Allahut, a është kjo në natën e Kadrit?" Tha: *"Jo, a nuk e ke parë se si punëtorët punojnë, e kur e përfundojnë punën e tyre, u jepet shpërblimi".*[1079]

[1079] Bejheki-u, "Shu`abu`l-Iman", 5/220, nr.3331; e shënon edhe Mundhiri-u në "Tergibu ve`t-Terhib", 2/56, nr.1477 dhe thotë: "E transmeton Bejhekiu, kurse zinxhiri është i mirë sikur i hadithit paraprak". Në zinxhir gjendet Zejd el-Amiju të cilin e kanë konsideruar të dobët disa, kurse disa të tjerë e kanë vlerësuar si të mirë, ndërsa për vlerësimet dhe kritikat ndaj këtij transmetuesi, shiko: Miziu, "Tehdhibu`l-Kemal", 10/56-60, nr.2102;

HADITHI I NËNTËDHJETËENËNTË (99)

حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا سَعْدَانُ الْجُهَنِيُّ، عَنْ أَبِي مُجَاهِدٍ، عَنْ أَبِي مُدِلَّةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: " ثَلَاثَةٌ لَا يُرَدُّ دُعَاؤُهُمْ: الْإِمَامُ الْعَادِلُ، وَالصَّائِمُ حَتَّى يُفْطِرَ، وَدَعْوَةُ الْمَظْلُومِ، يَرْفَعُهَا اللهُ فَوْقَ الْغَمَامِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ، وَيَفْتَحُ لَهَا أَبْوَابَ السَّمَاءِ، وَيَقُولُ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ: بِعِزَّتِي لَأَنْصُرَنَّكِ وَلَوْ بَعْدَ حِينٍ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre vetave nuk u refuzohet duaja: "Sundimtarit të drejtë, agjëruesit derisa të bëjë iftar dhe atij që i është bërë padrejtësi. Atë (duanë) Allahu e ngre përmbi re në Ditën e Kijametit, ia hap dyert e qiellit e thotë:* ***"Pasha Madhërinë Time, Unë do të të ndihmoj kurdo qoftë".***[1080]

Dua-ja është arma më e fuqishme e besimtarit, përmes së cilës arrin të realizojë kërkesat dhe nevojat e tija. Zoti dëshiron që të dëgjojë zërin e robit të Vet përmes lutjes, e cila njëkohësisht, është edhe adhurimi më i fuqishëm dhe lidhja më sublime në mes njeriut dhe Zotit.

Edhe pse në *hadith* përkufizohet pranimi i lutjeve ndaj këtyre tre kategorive të njerëzve, përsëri nëpër *hadithe* tjera na bëhet me dije se ky numër nuk është i përkufizuar vetëm në këto tre, por edhe në kategori tjera të cilëve u pranohet lutja nëse ato luten, por ne për të mos u zgjeruar shumë, do të fokusohemi në këto tre kategori njerëzish.

Kategoria e parë së cilës nuk i refuzohet lutja, është udhëheqësi i drejtë, i cili edhe në këtë botë është i ngritur në shkallë të lartë duke iu pranuar lutja,

[1080] Ahmed-i, "Musned", vëll.15, fq.463, nr.9743; Shuajb el-Arnauti dhe Adil Murshid në verifikimin e këtij hadithi, thonë se hadithi është Sahih në bazë të rrugëve dhe transmetimeve tjera që e dëshmojnë kuptimin e tij, përpos fjalës "në Ditën e Kijametit", pasi zinxhiri i këtij hadithi është i dobët për shkak të injorancës së Ebu Mudiles; hadithin e regjistrojnë edhe Tirmidhi-u, në "Sunen", kitab ed-Da`avati, bab 128, nr.3609 dhe thotë se hadithi është Hasen; Ibni Maxheh, "Sunen", kitab es-Sijami, bab 48, nr.1752;

por edhe në botën tjetër, duke u pozicionuar nën hijen e Arshit, si një prej shtatë grupeve të cilët do të jenë nën atë hije, kur nuk do të ketë hije tjetër përpos hijes së tij.

Sundimtari i drejtë është i dashur te Zoti sepse është duke çuar në vend emanetin të cilin e ka marrë mbi supet e veta, për të ndihmuar shoqërinë dhe vendin, që të ketë drejtësi dhe barazi, e nuk u bën padrejtësi atyre duke i nënçmuar, duke u bërë padrejtësi dhe shkelur të drejtat e tyre. I lumi ai udhëheqës që sot në mesin e gjithë kësaj padrejtësie, bëhet i drejtë dhe korrekt.

Kategoria e dytë që veçohen në këtë *hadith*, janë agjëruesit të cilët ditën e kanë kaluar në agjërim, kurse në *iftar* ulet dhe i bën lutje Zotit duke kërkuar që t`i plotësohet ndonjë nevojë e kësaj bote ose botës tjetër, edhe këtij Zoti nuk ia refuzon lutjen por e pranon atë. Pra, agjëruesi gëzon një respekt të veçantë tek Zoti, duke iu realizuar kërkesat e tija nga ana e Zotit, kështu që agjëruesi duhet të shfrytëzojë rastin në çastet e *iftar*-it dhe të lutet sa më shumë duke kërkuar prej Zotit të tij.

Kategoria e tretë të cilëve u pranohet duaja, është njeriu të cilit i është bërë padrejtësi, e ky njeri nuk ka askë i cili mund t`i ndihmojë që të rikthejë të drejtën e vet. Në këtë rast, e vetmja rrugë që i ka ngelur për të rikthyer të drejtën e vet, është lutja të Gjithfuqishmit, i Cili i pranon lutjet nga zemra e thyer dhe e përkushtuar.

Në një transmetim të cilin e shënon imam Ahmedi, potencohet se Zoti ia pranon lutjen atij që i është bërë padrejtësi, pa marrë parasysh se cilës fe i takon, sepse Zoti nuk e toleron padrejtësinë. Transmeton Enes b. Malik r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë*: "Keni kujdes lutjen e atij që i është bërë padrejtësi, edhe nëse është pabesimtar (kafir), sepse mes tyre nuk ka perde"*.[1081]

Zoti e pranon lutjen e këtyre tri kategorive dhe nuk e kthen prap, po nëse vonohet përgjigja për ndonjë arsye, përsëri Zoti atyre do t`ua pranon lutjen. *Hadith*-i që përmend këto tri kategori, regjistrohet edhe nga Tirmidhiu, por ai e shënon me tekst më të gjatë.[1082]

[1081] Ahmed-i, "Musned", vëll.20, fq.22, nr.12.549; Shuajb Arnauti në verifikimin e Musned-it të Ahmedit thotë se hadithi është i dobët;

[1082] Ky hadith është me version më të gjatë te Tirmidhi-u, "Sunen", kitab Sifeti`l-Xheneti, bab 2, nr.2534 dhe thotë se hadithi nuk e ka zinxhirin e fortë dhe nuk është mutasil;

HADITHI I NJËQINDTË (100)

أَخْبَرَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ الْحَكَمِ، عَنْ شُعَيْبٍ، عَنْ اللَّيْثِ، قَالَ: أَنْبَأَنَا خَالِدٌ، عَنْ ابْنِ أَبِي هِلَالٍ، عَنْ نُعَيْمٍ الْمُجْمِرِ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ، قَالَ: أَخْبَرَنِي صُهَيْبٌ، أَنَّهُ سَمِعَ مِنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، وَمِنْ أَبِي سَعِيدٍ، يَقُولَانِ: خَطَبَنَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَوْمًا، فَقَالَ: «وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ» ثَلَاثَ مَرَّاتٍ، ثُمَّ أَكَبَّ، فَأَكَبَّ كُلُّ رَجُلٍ مِنَّا يَبْكِي لَا نَدْرِي عَلَى مَاذَا حَلَفَ، ثُمَّ رَفَعَ رَأْسَهُ فِي وَجْهِهِ الْبُشْرَى، فَكَانَتْ أَحَبَّ إِلَيْنَا مِنْ حُمْرِ النَّعَمِ، ثُمَّ قَالَ: " مَا مِنْ عَبْدٍ يُصَلِّي الصَّلَوَاتِ الْخَمْسَ، وَيَصُومُ رَمَضَانَ، وَيُخْرِجُ الزَّكَاةَ، وَيَجْتَنِبُ الْكَبَائِرَ السَّبْعَ، إِلَّا فُتِّحَتْ لَهُ أَبْوَابُ الْجَنَّةِ، فَقِيلَ لَهُ: ادْخُلْ بِسَلَامٍ "

Transmeton Ebu Hurejre (r.a.) dhe Ebu Seidi (r.a.) të cilët thonë: "Na ligjëroi i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem një ditë dhe na tha: *"Pasha Atë që ka në "Dorë" shpirtin tim"* dhe këtë e përsëriti tre herë, pastaj heshti dhe qau e bashkë me të qanë të gjithë. Pastaj ngriti kokën e tij dhe në fytyrën e tij pamë përgëzime, e kjo ishte për ne më e dashur se devetë e kuqe, pastaj tha: *"Nuk ka rob i cili fal pesë namazet, e agjëron Ramazanin, e nxjerr zekatin, u largohet shtatë mëkateve të mëdha, e të mos i hapen dyert e Xhenetit dhe t`i thuhet:* ***"Hyn me paqe".***[1083]

Në këtë *hadith*, komentohen disa adhurime dhe veprime të cilat e shpëtojnë njeriun në jetën e amshueshme nga vuajtja, kështu që Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i radhiti ato me qëllim që dëgjuesit të dëgjojnë veprimet që duhet t`i kryejnë për të shpëtuar. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem në fillim e filloi fjalimin e tij duke u betuar tre herë, por më pas heshti, që të

[1083] Nesai-u, "Sunen", kitab ez-Zekati, bab vuxubu`z-zekat, nr.2438; hadithin e regjistron edhe Hakim-i, "El-Mustedrek", 2/262, nr.2943 dhe thotë se hadithi është Sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por ata nuk e kanë shënuar" me këtë vlerësim pajtohet edhe Dhehebi-u. Por tek Hakimi nuk është formulimi i tekstit si hadith kudsij;

ngjallë kureshtjen tek dëgjuesit dhe të shtojë dëshirën për të kuptuar fjalimin më mirë. Një moment heshtjeje gjatë ligjërimit, e tërheq vëmendjen e dëgjuesit.

Pasi të gjithë qanë kur e panë Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sel-lem duke qarë, ngase besimtari ndjen atë që ndjen i dashuri i vet, e kur njeriu e do dikë, ai përjeton emocionin e njëjtë siç e përjeton edhe njeriu të cilin e do.

Por, më pas vërejtën shenja gëzimi në fytyrën e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, pasi i erdhi inspirimi dhe përgëzimi për besimtarët të cilët janë meritorë për Xhenetin. Kjo shenjë i gëzoi edhe *sahab*-ët të cilët u gëzuan aq shumë, saqë nuk mund të krahasohej ky gëzim edhe nëse do të kishin fituar pasuritë më të dashura për ta, siç ishin devetë e kuqe.

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem më pas radhiti veprimet ose adhurimet që besimtarin e drejtojnë për në rrugën e Xhenetit. Prej gjërave të para në listën e adhurimeve të besimtarit, patjetër se do të radhitet falja e pesë kohëve të namazit, sepse namazi është adhurimi qëndrorë dhe kryesorë që e lidhë besimtarin me Zotin. Nëse namazi është në rregull, atëherë edhe adhurimet tjera do të jenë në rregull, e nëse humbet namazi, humben edhe gjërat e tjera. Kështu që, patjetër muslimani të jetë i rregullt në faljen e namazit.

Pasi përmendi faljen e namazeve, potencoi edhe detyrën dhe obligimin e agjërimit të muajit Ramazan, që është rrugë e devotshmërisë së zemrës, pastrim i shpirtit, mbrojtje nga të këqijat dhe afrim drejt kënaqësisë së Zotit.

Ndërlidhje me këto adhurime, nuk u la anash as përmendja e dhënies së zekatit, që është po ashtu një adhurim shumë shpirtëror, aq sa është edhe material, pasi përmes këtij obligimi, pastrojmë zemrën nga mëkatet dhe lakmia ndaj pasurisë, pastrojmë pasurinë, ndihmojmë të varfërin, ia lehtësojmë jetën atij dhe përmirësojmë gjendjen ekonomike dhe sociale të shoqërisë sonë.

Më pas, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem kërkoi prej nesh që të largohemi nga shtatë mëkatet shkatërruese, që shkatërrojnë punët e mira të njeriut dhe shkatërrojnë moralin e besimtarit. Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Largohuni nga shtatë mëkatet shkatërruese!"* I thanë: "Kush janë ato?" Ai tha: *"Shirku, Sihri, vrasja e njeriut të cilën e ka ndaluar Allahu, ngrënia nga kamata, ngrënia e*

pasurisë së jetimit, ikja nga fushëbeteja, shpifja ndaj grave të ndershme".[1084]

Nëse njeriu realizon këto adhurime që u përmendën dhe largohet nga këto shtatë mëkate shkatërruese dhe të tjerat që janë përmendur nëpër *hadith*-e, atëherë Allahu xh.sh. për të do të hap dyert e Xhenetit dhe do t`i thotë: ***"Hyn me paqe".***[1085] E kjo është fitorja më e madhe e besimtarit.

[1084] Buhari-u, "Sahih", kitab el-Vesaja, bab kaulilahi teala ineledhine je`kulune emvale`l-jetama dhulmen, nr.2766; Muslim-i, "Sahih", kitab el-Imanu, bab bejanu`l-kebairi ve ekberiha, nr.89; etj.
[1085] Kurani, Hixhër, 46;

LITERATURA E KONSULTUAR:

1. ABDUREZAKU, Ebu Bekër Abdurezak b. Hemam es-San`ani, "El-Musannef", Mexhlisu`l-ilmi, botimi i parë, 1972;

2. ABDUREZAKU, Ebu Bekër Abdurezak b. Hemam es-San`ani, "Tefsir Abdurezak", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 1999;

3. ADHIM ABADI, Ebu Abdurahman Sherefu`l-Hak, "Aunu`l-Ma`bud ala sherhi Suneni Ebu Davud", Daru Ibni Hazëm, Bejrut, botimi i parë, 2005;

4. AJNI, Bedrudin ebu Muhamed Mahmud b. Ahmed, "El-Binaje fi sherhi`l-Hidaje", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 2000;

5. AJNI, Bedrudin ebu Muhamed Mahmud b. Ahmed, "Umdetu`l-Kari sherh Sahih el-Buhari", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2001;

6. ARABIU, Ebu Bekër Muhamed b. Abdullah b. Muhamed b. Abdullah el-, "Aridetu`l-Ahvedhij bi sherhi Sahih et-Tirmidhi", Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë, 1997;

7. ASKALANI, Ahmed b. Ali ibni Haxher, "Fet`hul-Bari sherh Sahih el-Buhari", Daru Tajbeh, Rijad, botimi i parë, 2005;

8. ASKALANI, Ahmed b. Ali ibni Haxher, "El-Isabe fi temijizi`s-sahabe", tahkik Abdullah b. Abdulmuhsin et-Turki, Kajro, botimi i parë, 2008;

9. ASKALANI, Ahmed b. Ali ibni Haxher, "Lisanu`l-Mizan", Mektebetu`l-Metbuatil islamijeti, Bejrut, botimi i parë, 2002;

10. ASKALANI, Ahmed b. Ali ibni Haxher, "Tekribu`t-Tehdhib", Bejtu`l-Ifkar, Jordan, 2000;

11. ASKALANI, Ahmed b. Ali ibni Haxher, “Tehdhibu`t-Tehdhib”, tahkik Ibrahim Zejbik dhe Adil Murshid, Muessesetu`r-Risale, Bejrut;

12. ATTARI, Ebu Hamid b. Ebu Bekër Ibrahim Feridudin, “Tedhkiretu`l-Evlija”, Nami Press, Lucknow, India, 1914;

13. BAJRAMI, Dr. Zekerija, “Çështjet kelamistike të Fahrudin Raziut në veprën “El-Mealim”, Shkup, 2007;

14. BEGAVIU, Husejn b. Mes`ud, “Sherhu`s-Sunneh”, tahkik Shuajb el-Arnauti, Mektebetu`l-Islamije, botimi i dytë, Bejrut, 1983;

15. BEJHEKIU, Ahmed b. Husejn b. Ali n. Musa el-Husreuxhirdi el-Hurasani, “Delailu`n-Nubuvve”, Daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1988;

16. BEJHEKIU, Ahmed b. Husejn b. Ali n. Musa el-Husreuxhirdi el-Hurasani, “Esma ve`s-Sifat”, Mektebetu`s-Sevadiju, Xhide, Saudi Arabi, botimi i parë, 1993;

17. BEJHEKIU, Ahmed b. Husejn b. Ali n. Musa el-Husreuxhirdi el-Hurasani, “Shu`abu`l-Iman”, Mektebetu`r-Rushd, Rijad, botimi i parë, 2003;

18. BEJHEKIU, Ahmed b. Husejn b. Ali n. Musa el-Husreuxhirdi el-Hurasani, “Sunenu`l-Kubra”, tahkik Muhamed Abdulkadir Ata, Darul-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i dytë, 2003;

19. BELBAN, el-Farisi el-Hanefi Alaudin Ali Ibni, “Ihsan fi tekrib Sahih Ibni Hiban”, Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1988;

20. BEZZARI, Ebu Bekër Ahmed b. Amër b. Abdulhalik el-Atakiju, “Bahru`z-Zehar maruf bi Musned Bezar”, Mektebetu`l-ulum ve`l-hikem, Medine, botimi i parë, 1988;

21. BUHARI, Ebu Abdullah b. Ismail b. Ibrahim, “Edebu`l-Mufred”, përktheu Hanife Dauti, Dëshmia botime, Shkup, 2010;

22. BUHARI, Ebu Abdullah b. Ismail b. Ibrahim, “Kitab Duafau`s-Sagir”, Daru`l-Ma`rife, Bejrut, 1986;

23. BUHARI, Ebu Abdullah b. Ismail b. Ibrahim, “Sahih”, Elfa, Kajro, botimi i parë, 2010;

24. BUHARI, Ebu Abdullah b. Ismail b. Ibrahim, “Tarihu`l-Kebir”, tahkik Hashim Nedevi, Daru`l-Kutubi`l-ilmijje, Bejrut;

25. DARIMIJU, Abdullah b. Abdurahman es-Semerkandi, “Sunen”, Daru`l-Hadith, Kajro, botimi i parë, 2000;

26. DEJLEMIU, Ebu Shuxha Shirevehji b. Shehredar b. Shirevejhi, “El-Firdeus bi me`thuri`l-Hitab”, Daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1986;

27. DHEHEBIU, Ebu Abdullah Muhamed b. Ahmed b. Uthman, “El-Kashif fi ma`rifeti men lehu rivajetun fil-kutubi`s-sitte”, Muessesetu`l-ulumi`l-Kuran, Xhide, botimi i parë, 1992;

28. DHEHEBIU, Ebu Abdullah Muhamed b. Ahmed b. Uthman, “Mizanu`l-I`tidal fi nakdi`r-Rixhal”, Daru`l-Ma`rife, Bejrut;

29. DHEHEBIU, Ebu Abdullah Muhamed b. Ahmed- b. Uthman, “Sijeru A`lam en-Nubela”, Muesesetu`r-risale, Bejrut, botimi i parë, 1982;

30. EBU DAVUD, Sulejman b. Esh`ath b. Is`hak el-Ezdij es-Sixhistani, “Sunen”, Darus-Selam, Rijad, botimi i parë, 1999;

31. EBU HANIFE, Numan b. Thabit b. Mirzaban, “Fikhul Ekber”, përktheu Nexhat Ibrahimi, Zëri Islam, Prizren, 2005;

32. EBU HANIFE, Numan b. Thabit b. Mirzaban, “El-Vesijjetu”, Daru Ibni Hazëm, Bejrut, botimi i parë, 1997;

33. EBU HANIFE, Numan b. Thabit b. Mirzaban, “El-Alim ve`l-Mutealim”, cituar nga vepra e doc.dr.Ibrahim Emiroglu, “Pesë kryeveprat e Ebu Hanifes”, Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2000;

34. EBU HATIM ER-RAZI, Ebu Muhamed, Abdurahman, “Xherh ve`t-Ta`dil”, Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1952;

35. EBU HATIM, Muhamed ibni Hiban ibni Ahmed, “Kitabu`th-Thikat”, Indi, botimi i parë, 1973;

36. EBU JA`LA, Ahmed b. Ali b. Muthenna el-Meusiliju, “Musned”, Daru`l-Ma`rife, Bejrut, botimi i parë, 2005;

37. EBU NUAJMI, Ahmed b. Abdullah b. Ahmed b. Is`hak b. Musa b. Mihran el-Esbahani, “El-Hiljetu`l-Evlija ve Tabakatu`l-Esfija”, Daru`l-Fikr, Bejrut, 1996;

38. EBU NUAJMI, Ahmed b. Abdullah b. Ahmed b. Is`hak b. Musa b. Mihran el-Esbahani, “Ma`rifetu`s-Sahabeti”, tahkik Adil b. Jusuf el-Azazi, Daru`l-Vatani, Rijad, botimi i parë, 1998;

39. GAURI, Abdulmaxhid el-, “Mausuatil ulumil hadith”, Daru Ibni Kethir, Damask-Bejrut, botimi i parë, 2007;

40. GAZALIU, Ebu Hamid Muhamed b. Muhamed b. Ahmed, “Ihja ulumu`d-Din”, Mektebetu`l-Fejad, Kajro;

41. HAKIMI, Ebu Abdullah Muhamed b. Abdullah en-Nisaburi, “El-Mustedrek ale`s-Sahihejn”, Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i dytë, 2002;

42. HANBELI, Ebu Abdullah esh-Shejbani, Ahmed b. Muhamed b. Hilal b. Esed, “Musned”, tahkik Ahmed Shakir, etj, Daru`l-Hadith, Kajro, botimi i parë, 1995;

43. HANBELI, Ebu Abdullah esh-Shejbani, Ahmed b. Muhamed b. Hilal b. Esed, “Musned”, tahkik Shuajb el-Arnauti etj, Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 2001;

44. HANBELI, Ebu Abdullah esh-Shejbani, Ahmed b. Muhamed b. Hilal b. Esed, “Ez-Zuhd”, Daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1999;

45. HEJTHEMIU, Nurudin Ali b. Ebu Bekër b. Sulejman, “Keshfu`l-Estar an Zevaidi`l-Bezzar”, tahkik Habibu Rahman el-Adhamiju, Muessesetur-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1979;

46. HEJTHEMIU, Nurudin Ali b. Ebu Bekër b. Sulejman, “Mexhmea`l-Bahrejn fi zevaidi`l-mu`xhemejn”, Mektebetu`r-Rushd, Rijad, botimi i parë, 1992;

47. HEJTHEMIU, Nurudin Ali b. Ebu Bekër b. Sulejman, “Mexhmeu`z-Zevaid”, Daru`l-kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2001;

48. HINDI, Ebu Hasen, Alaudin Ali el-Muteki b. Hisamudin b. Kadi Abdulmelik b. Kadi Han, “Kenzu`l-Ummal fi suneni`l-Ekval ve`l-Ef`al”, Bejtu`l-Ifkar, Jordan, botimi i dytë, 2005;

49. HUMSIJ, Hisham A. El-Humsij, “Kadaja dhe kaderi”, përktheu Xhaudet Iseni dhe Hatixhe Iseni, Kibla, Gostivar, 2003;

50. IBNI ABDULBER, Jusuf b. Abdullah b. Muhamed, “Et-Temhid lima fi`l-Muvetta mine`lmeani ve`l-Esanid”, tahkik Mustafa b. Ahmed el-Alevij dhe Muhamed Abdulkebir el-Bekri, Vezaretu`l-umumu`l-Eukaf ve`sh-shu`un, Magrib, 1992;

51. IBNI ADIJ, Ebu Ahmed, Abdullah b. Adij el-Xhurxhani, “El-Kamilu fi duafai`r-Rixhal”, Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut;

52. IBNI ETHIRI, Ebu Hasen, Ali b. Ebu Kerem Muhamed b. Muhamed b. Abdulkerim, “El-Kamilu fi`t-Tarih”, Daru`l-kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1987;

53. IBNI ETHIRI, Ebu Hasen, Ali b. Ebu Kerem Muhamed b. Muhamed b. Abdulkerim, “Usdu`l-Gabe fi ma`rifeti`s-Sahabe”, Daru`l-kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1996;

54. IBNI EBI SHEJBEH, Ebu Bekër Abdullah b. Muhamed, “Kitab el-Musannefu fi`l-ehadith ve`l-athar”, Daru`t-Taxh, Bejrut, botimi i parë, 1989;

55. IBNI HISHAMI, Abdulmelik b. Hisham b. Ejub, “Siretu Nebevije”, Daru Ibni Hazëm, Bejrut, botimi i dytë, 2009;

56. IBNI HISHAMI, Abdulmelik b. Hisham b. Ejub, “Biografia e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem”, përktheu Miftar Ajdini, Logos A, Shkup, 2017;

57. IBNI HUZEJME, Ebu Bekër, Muhamed b. Is`hak es-Sulemiju Nisaburi, "Sahih", tahkik Dr. Mustafa Adhmij, Mektebetul Islamije, 2003;

58. IBNI KETHIRI, Ismail b. Umer b. Kethir el-Kureshiu, "El-Bidajetu ve`n-Nihajetu", tahkik Shuajb el-Arnauti, Vizaretu`l-Eukaf vesh-Shu`unu`l-Islamijeti, Katar, 2015;

59. IBNI KETHIRI, Ismail b. Umer b. Kethir el-Kureshiu, "Rrëfime për të Dërguarit e Allahut", përktheu Muhamed Dollaku, Gjurma Botime, botimi i dytë, Prishtinë, 2007;

60. IBNI KETHIRI, Ismail b. Umer b. Kethir el-Kureshiu, "Tefsir`ul-Kurani`l-Adhim" Mektebetu tixharetil kubra, Egjipt;

61. IBNI KETHIRI, Ismail b. Umer b. Kethir el-Kureshiu, "Tefsiri i Ibni Kethirit", përktheu Bashkim Aliu, Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, 2008;

62. IBNI MAXHEH, Ebu Abdullah Muhamed b. Jezid el-Kazneviju, "Sunen", Darul-Fikër, Bejrut, botimi i parë, 2003;

63. IBNI MEINI, Ebu Zekerija, Jahja, "Ma`rifetu`r-Rixhal", tahkik Muhamed Kamil El-Kusar, 1985;

64. IBNI MUBAREK, Abdullah el-Mervezi, "Kitabu`z-Zuhd", Daru`l-Kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i dytë, 2004;

65. IBNI REXHEB, Zejnudin ebu Ferexh Abdurhman b. Shihabudin b. Ahmed- el-Hanbeli, "Xhamiu`l-Ulumi ve`l-Hikemi fi sherh hamsine hadithen min xhevami`il-kelimi", Daru`s-Selam, Kajro, botimi i dytë, 2004;

66. IBNI SA`DI, Muhamed b. Sa`d b. Muni` ez-Zuhri, "Kitab Tabekatu`l-Kebir", tahkik dr. Ali Muhamed Umer, Kajro, botimi i parë, 2001;

67. IBNI SUNNIJ, Ebu Bekër Ahmed b. Muhamed b. Is`hak, "Amelu`l-Jaumi ve`l-Lejleti", tahkik dr.Abdurahman Keuther b. Shejh Muhamed Ashik Ilah e-Bureniu, Daru Erkam b. Ebi Erkam, Bejrut, botimi i parë, 1998;

68. IBNI XHEUZI, Ebu Ferexh Xhemaludin Abdurahman b. Ali b. Muhamed, "El-Ilelu`l-Mutenahije", Iradetul Ulumul etherije, Fejsal Abadi, Pakistan, botimi i dytë, 1981;

69. IBNI XHEUZI, Ebu Ferexh Xhemaludin Abdurahman b. Ali b. Muhamed, "Meuduat", me verifikim të Abdurahman Muhamed Uthman, Mektebetu Selefije, Medine, botimi i parë, 1966;

70. IBNI XHEUZI, Ebu Ferexh Xhemaludin Abdurahman b. Ali b. Muhamed, "Flakja e dyshimeve të teshbihizmit", përktheu Ahmed Memedi, Qendra për Studime dhe Kërkime Islame, Zvicër, 2011;

71. KADAI, Ebu Abdullah, Muhamed b. Selame el-, "Musnedu`sh-Shihab", tahkik Hamdi Abdulmexhid es-Selefi, Muessesetu`r-risale, Bejrut, botimi i parë, 1985;

72. KADI IJAD, Ebu Fadël Ijad b. Musa el-Jahsubi, "Esh-Shifa bi ta`rifi hukuki`l-mustafa", botimi i parë, 2013;

73. KARIU, Mul-la Ali, "El-Hadheru fi emri`l-Hadiri", Damask dhe Bejrut, 1991;

74. KARIU, Mul-la Ali, "Kitabu`l-Ehadithi`l-Kudsijjeti`l-Erbainijjeti", Mektebetu`s-Sahabe, Xhidde;

75. KASANI, Alaudin Ebu Bekër b. Mes`ud b. Ahmed, "Bedaiu`s-Sanaiu fi tertibi`sh-Sharaiu", Daru`l-Kutubi`l-Ilmije, Bejrut, botimi i dytë, 1986;

76. KASHMIRI, Muhamed Enur Deobendi, "Fejdu`l-Bari ala Sahih`ul-Buhari", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2005;

77. KUDURI, Ebu Husejn Muhamed b. Xha`fer el-Bagdadi, "Muhtesar", Daru`s-Selam, botimi i parë, 2013;

78. KUDURI, Ebu Husejn Muhamed b. Xha`fer el-Bagdadi, "Texhrid", Darus-Selam, Kajro, botimi i parë, 2004;

79. KURTUBIU, Ebu Abdullah, Muhamed b. Ahmed b. Ebu Bekër, "Xhamiu`l-Ahkami`l-Kuran", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 2006;

80. KURTUBIU, Ebu Abas, Ahmed b. Umerejni b. Ibrahim, "El Mufhemu lima eshkele min telhisi kitabi Muslim", Damask, botimi i parë, 1996

81. MALIK, Malik b. Enes b. Malik b. Ebu Amir b. Amër b. Harith, "El-Muvetta", muessesetu`l-Muhtar, Kajro, botimi i parë, 2006;

82. MEMISHI, Isa "Fjalor arabisht-shqip", Logos A, Shkup, 2014;

83. MENSHAVI, Muhamed, "Kamus Mustalahatu`l-hadithu`n-Nebevij", Daru`l-Fadile, Kajro;

84. MERGINANI, Ali b. Ebu Bekër b. Abdulxhelil el-Fergani, "El-Hidaje", Daru Ihjai Turath el-arabi, Bejrut;

85. MEUSILI, Abdullah b. Mahmud b. Meulud, "El-Ihtijar li ta`lili`l-Muhtar", Daru`l-Hadith, Kajro, 2009;

86. MIZZIU, Xhemaludin Ebu Haxhaxh Jusuf, "Tehdhibu`l-Kemal fi esmai`r-Rixhal", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i dytë, 1983;

87. MUBAREKFURI, Ebu A`la Muhamed Abdurahman b. Abdurahim, "Tuhfetu`l-Ahfedhij sherh Xhami`it-Tirmidhi", Bejtu`l-Ifkar, Aman;

88. MUKATIL B. SULEJMAN, "Tefsir", Muessesetu`t-Tarih el-Arabij, Bejrut, botimi i parë, 2002;

89. MUSLIMI, Ebu Husejn Muslim b. Haxhaxh el-Kushejri en-Nisaburi, "Sahih", Daru Ibni Hazëm, Kajro, botimi i parë, 2010;

90. MUNAVI, Muhamed Abdurauf, "Fejdu`l-Kadir sherh xhamiu`s-Sagir", Bejrut, botimi i dytë, 1972;

91. MUNDHIRIU, Abduladhim b. Abdulkavij b. Abdullah Zekijudin, "Et-Tergib ve`t-Terhib mine`l-hadithi`sh-Sherif", Daru`l-Kutubi`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1996;

92. “El-Mu`xhemu`l-Vesit”, botimi i dytë, Kajro, 1973;

93. NESAIU, Ebu Abdurahman, Ahmed b. Shuajb b. Ali b. Sinan, “Amelu`l-Jaumi ve`l-Lejleti”, Muessesetu`r-Risale;

94. NESAIU, Ebu Abdurahman, Ahmed b. Shuajb b. Ali b. Sinan, “Kitabu`d-Duafau ve`l-Metrukin”, Muessesetu`l-kutubi`th-thikafe”, Bejrut, botimi i parë, 1985;

95. NESAIU, Ebu Abdurahman, Ahmed b. Shuajb b. Ali b. Sinan, “Sunen”, Darus-Selam, Rijad, botimi i parë, 1999;

96. NESAIU, Ebu Abdurahman, Ahmed b. Shuajb b. Ali b. Sinan, “Sunenu`l-Kubra”, tahkik Shuajb el-Arnauti, Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 2001;

97. NESAIU, Ebu Abdurahman, Ahmed b. Shuajb b. Ali b. Sinan, “Sunen Nesai bi Hashijeti Sindi”, Daru`l-Marife, Bejrut, vëll.2, fq.184;

98. NESEFIU, Abdullah b. Ahmed b. Mahmud, “El-Mustesfa”, universiteti Ummu`l-Kura, Meke, 2011;

99. NESEFIU, Abdullah b. Ahmed b. Mahmud, “Komentimi i Nesefiut”, përktheu Bahri Aliu, Tetovë, 2017;

100. NESEFIU, Ebu Hafs Omer b. Muhamed b. Ahmed b. Ismail Nexhmudin, “Besimi Islam sipas imam Nesefiut”, përktheu Nexhat Ibrahimi, Zëri Islam, Prizren, 2003;

101. NEVEVIU, Ebu Zekerija Muhjidin Jahja b. Sheref b. Mera b. Hasen b. Husejn b. Hazam, “Sahih Muslim bi sherh Nevevij”, Daru`sh-Shab, Kajro, 1970;

102. NEVEVIU, Ebu Zekerija Muhjidin Jahja b. Sheref b. Mera b. Hasen b. Husejn b. Hazam, “Tehdhibu`l-Esmai ve`l-Lugati”, Darul Kutubi`l-Ilmije, Bejrut;

103. NIDHAMI, “El-Fetava`l-Hindijje”, Daru`l-Kutubu`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2000;

104. RAZIU, Muhamed b. Umer b. Husejn b. Hasan b. Ali Fahrudin, "Mefatihu`l-Gajb", Daru`l-Fikër, Bejrut, botimi i parë, 1981;

105. SAGIRXHIU, Esed Muhamed Seid, "Et-Tejsir Fi`l-Fikhi`l-Hanefi", Daru`l-Kelimi`t-Tajib, Bejrut, 2002;

106. SHEJBANI, Muhamed b. Hasen, "El-Aslu", Daru Ibni Hazëm, Katar, botimi i parë, 2012;

107. SHEUKANI, Muhamed b. Ali b. Muhamed, "Nejlu`l-Eutar sherh Munteka`l-Ehbar min hadithi sejjidi`l-ehjar", Mektebetu`l-Kulijati`l-Ez`herijjeti", 1978;

108. SUBKI, Tekijudin Ali b. Abdulkafi b. Ali, "Shifau`s-Sikam fi zijareti hajri`l-Enam", daru`l-kutubi`l-ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 2008;

109. SULEJMI, Amër Abdulmun`im, "Tejsiru Ulumi`l-Hadith", Daru Dija;

110. SUJUTIU, Abdurahman b. Ebu Bekër Xhelaludin, "Durru`l-Menthur fi tefsiri bi`l-me`thur", tahkik Abdulmuhsin et-Turki, botimi i parë, 2003;

111. SUJUTI, Abdurahman b. Ebu Bekër Xhelaludin, "Xhamiu`s-Sagir",

112. SUJUTI, Abdurahman b. Ebu Bekër Xhelaludin, "Kutul Mugtedhi ala xhami`it-Tirmidhi", tahkik Nasir b. Muhamed el-Garibi, xhamiatu Ummul Kura, Meke, 2004;

113. SUJUTI, Abdurahman b. Ebu Bekër Xhelaludin, "Sunen Nesai bi sherh hafidh Xhelaludin es-Sujuti", Darul Ma`rife, Bejrut;

114. TABERANI, Ebu Kasim Sulejman b. Ahmed b. Ejub b. Metir, "Musnedu`sh-Shamijin", Muessesetu`r-Risale, Bejrut, botimi i parë, 1989;

115. TABERANI, Ebu Kasim Sulejman b. Ahmed b. Ejub b. Metir, “Mu`xhemu`l-Kebir”, Mektebetu Ibni Tejmije, Kajro, botimi i tretë, 1994;

116. TABERANI, Ebu Kasim Sulejman b. Ahmed b. Ejub b. Metir, “Mu`xhemu`l-Euset”, Daru`l-Haramejni, Kajro, 1995;

117. TABERANI, Ebu Kasim Sulejman b. Ahmed b. Ejub b. Metir, “Mu`xhemu`s-Sagir”, Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, 1983;

118. TABERANI, Ebu Kasim Sulejman b. Ahmed b. Ejub b. Metir, “Ed-Dua”, Daru`l-kutubil-Ilmijje, Bejrut, botimi i parë, 1992;

119. TABERIU, Muhamed b. Xherir b. Jezid b. Kethir b. Galib, “Tarih”, tahkik Ebu Fadël Muhamed Ibrahim, Daru`l-Muarif, botimi i dytë;

120. TABERIU, Muhamed b. Xherir b. Jezid b. Kethir b. Galib, “Xhamiu`l-Bejan fi te`vili`l-Kuran”, Hixhër, botimi i parë, 2001;

121. TAHAVIU, Ebu Xhafer, Ahmed b. Muhamed b. Selame, “Akidja e Tahavit”, përktheu Edvin Cami, Qendra Studimore Fetare Erasmus, Tiranë, 2014;

122. TAHAVIU, Ebu Xhafer, Ahmed b. Muhamed b. Selame, “Sherh Mushkilu`l-Athar”, tahkik Shuajb el-Arnauti, Muesesetu`r-risale, Bejrut, botimi i parë, 1994;

123. TAJALIS, Sulejman b. Davud b. Xharud, “Musned”, Hixhër, botimi i parë, 1999;

124. TIRMIDHIU, Ebu Isa Muhamed b. Isa b. Surete, “Sunen”, Daru`l-Fikër, Bejrut, 2008;

125. TUHMAZ, Abdulhamid Mahmud, “Fikhu Hanefi”, përktheu Dr. Selim Sulejmani, Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, 2011;

126. UKAJLI, Ebu Xhafer Muhamed b. Amër b. Musa b. Hamad el-Meki, “Kitabu`d-Duafai`l-Kebir”, Daru`l-kutubi`l-ilmije, Bejrut, botimi i parë;

127. XHEUZIJE, Shemsudin Ebu Abdullah Muhamed b. Ebu Bekër b. Ejub b. Sa`d b. Hariz ez-Zehri Ibni Kajjim, "Zadu`l-Mead fi hedji hajri`l-ibad", përktheu Nig`jar Hoti, Ebu Hanife, Shkup, 2011;

128. XHEZIRIU, Abdurahman, "Fikh ala medhahibi`l-Erbe`ati", Daru`l-Kutubu`l-Ilmijje, Bejrut, botimi i dytë, 2003;

PËRMBAJTJA

HYRJE 3
Çka është HADITH? 6
Çka do të thotë hadith kudsi? 6
Veçoritë e hadithit kudsij 7
Dallimi mes Kuranit dhe hadithit kudsi 7
Dallimi mes hadithit kudsi dhe hadithit nebevij 9
Dijetarët dhe librat që kanë shkruar për hadithet kudsi 10
IMANI, TEUHIDI DHE SHIRKU 12
HADITHI I PARË (1) 13
HADITHI I DYTË (2) 23
HADITHI I TRETË (3) 28
HADITHI I KATËRT (4) 31
HADITHI I PESTË (5) 35
HADITHI I GJASHTË (6) 39
HADITHI I SHTATË (7) 41
HADITHI I TETË (8) 44
HADITHI I NËNTË (9) 48
HADITHI I DHJETË (10) 54
HADITHI I NJËMBËDHJETË (11) 58
HADITHI I DYMBËDHJETË (12) 61
HADITHI I TREMBËDHJETË (13) 65
KRIJIMI I BOTËS 69
HADITHI I KATËRMBËDHJETË (14) 70
MELEKËT E ZOTIT 73
HADITHI I PESËMBËDHJETË (15) 74
HADITHI I GJASHTËMBËDHJETË (16) 77
PEJGAMBERËT E ZOTIT 82
HADITHI I SHTATËMBËDHJETË (17) 83
KADAJA DHE KADERI 89
HADITHI I TETËMBËDHJETË (18) 90
HADITHI I NËNTËMBËDHJETË (19) 93
HADITHI I NJËZETË (20) 98
HADITHI I NJËZETENJËTË (21) 102
MENDIMI I MIRË 107
PËR ALLAHUN 107
HADITHI I NJËZETEDYTË (22) 108

HADITHI I NJËZETETRETË (23) 111
MËSHIRA 115
DHE 115
FALJA E ALLAHUT 115
HADITHI I NJËZETEKATËRTË (24) 116
HADITHI I NJËZETEPESTË (25) 118
HADITHI I NJËZETEGJASHTË (26) 121
HADITHI I NJËZETESHTATË (27) 124
HADITHI I NJËZETETETË (28) 128
HADITHI I NJËZETENËNTË (29) 130
HADITHI I TRIDHJETË (30) 134
HADITHI I TRIDHJETËENJËTË (31) 137
HADITHI I TRIDHJETËEDYTË (32) 140
HADITHI I TRIDHJETËETRETË (33) 143
HADITHI I TRIDHJETËEKATËRTË (34) 148
HADITHI I TRIDHJETËEPESTË (35) 152
DASHURIA E ALLAHUT 155
PËR ROBËRIT E TIJ 155
HADITHI I TRIDHJETËEGJASHTË (36) 156
HADITHI I TRIDHJETËESHTATË (37) 161
HADITHI I TRIDHJETËETETË (38) 165
HADITHI I TRIDHJETËENËNTË (39) 168
HADITHI I KATËRDHJETË (40) 174
HADITHI I KATËRDHJETËENJËTË (41) 178
HADITHI I KATËRDHJETËEDYTË (42) 181
PENDIMI 186
HADITHI I KATËRDHJETËETRETË (43) 187
HADITHI I KATËRDHJETËEKATËRTË (44) 191
HADITHI I KATËRDHJETËEPESTË (45) 194
DËSHMIA 198
LA ILAHE IL-LALLAH 198
MUHAMEDUN RESULULLAH 198
HADITHI I KATËRDHJETËEGJASHTË (46) 199
HADITHI I KATËRDHJETËESHTATË (47) 203
HADITHI I KATËRDHJETËETETË (48) 207
HADITHI I KATËRDHJETËENËNTË (49) 209
VEÇORITË E 212
MUHAMEDIT 212
ALEJHI SELAM 212
HADITHI I PESËDHJETË (50) 213
HADITHI I PESËDHJETËENJËTË (51) 219

HADITHI I PESËDHJETËEDYTË (52) 225
HADITHI I PESËDHJETËETRETË (53) 231
MORALI 236
HADITHI I PESËDHJETËEKATËRTË (54) 237
DITURIA 242
HADITHI I PESËDHJETËEPESTË (55) 243
HADITHI I PESËDHJETËEGJASHTË (56) 249
HADITHI I PESËDHJETËESHTATË (57) 254
KURANI 257
HADITHI I PESËDHJETËETETË (58) 258
HADITHI I PESËDHJETËENËNTË (59) 264
HADITHI I GJASHTËDHJETË (60) 270
HADITHI I GJASHTËDHJETËENJËTË (61) 273
HADITHI I GJASHTËDHJETËEDYTË (62) 275
HADITHI I GJASHTËDHJETËETRETË (63) 283
URDHËRIMI PËR 288
PUNË TË MIRA 288
DHE NDALIMI 288
NGA PUNËT E KËQIJA 288
HADITHI I GJASHTËDHJETËEKATËRTË (64) 289
HADITHI I GJASHTËDHJETËEPESTË (65) 295
HADITHI I GJASHTËDHJETËEGJASHTË (66) 298
HADITHI I GJASHTËDHJETËESHTATË (67) 302
HADITHI I GJASHTËDHJETËETETË (68) 304
SHUMËZIMI I 306
PUNËVE TË MIRA 306
HADITHI I GJASHTËDHJETËENËNTË (69) 307
HADITHI I SHTATËDHJETË (70) 314
HADITHI I SHTATËDHJETËENJËTË (71) 328
HADITHI I SHTATËDHJETËEDYTË (72) 332
HADITHI I SHTATËDHJETËETRETË (73) 336
NAMAZI 342
HADITHI I SHTATËDHJETËEKATËRTË (74) 343
HADITHI I SHTATËDHJETËEPESTË (75) 348
HADITHI I SHTATËDHJETËEGJASHTË (76) 358
HADITHI I SHTATËDHJETËESHTATË (77) 362
HADITHI I SHTATËDHJETËETETË (78) 366
HADITHI I SHTATËDHJETËENËNTË (79) 370
HADITHI I TETËDHJETË (80) 374
HADITHI I TETËDHJETËENJËTË (81) 379
HADITHI I TETËDHJETËEDYTË (82) 383

HADITHI I TETËDHJETËETRETË (83)..... 386
HADITHI I TETËDHJETËEKATËRTË (84)..... 391
HADITHI I TETËDHJETËEPESTË (85)..... 396
HADITHI I TETËDHJETËEGJASHTË (86)..... 402
NAMAZI I XHENAZES..... 405
HADITHI I TETËDHJETËESHTATË (87)..... 406
ZEKATI..... 411
DHE..... 411
SADAKAJA..... 411
HADITHI I TETËDHJETËETETË (88)..... 412
HADITHI I TETËDHJETËENËNTË (89)..... 416
HADITHI I NËNTËDHJETË (90)..... 418
HADITHI I NËNTËDHJETËENJËTË (91)..... 421
HADITHI I NËNTËDHJETËEDYTË (92)..... 423
HADITHI I NËNTËDHJETËETRETË (93)..... 426
HADITHI I NËNTËDHJETËEKATËRTË (94)..... 429
AGJËRIMI..... 431
HADITHI I NËNTËDHJETËEPESTË (95)..... 432
HADITHI I NËNTËDHJETËEGJASHTË (96)..... 435
HADITHI I NËNTËDHJETËESHTATË (97)..... 440
HADITHI I NËNTËDHJETËETETË (98)..... 443
HADITHI I NËNTËDHJETËENËNTË (99)..... 447
HADITHI I NJËQINDTË (100)..... 449
LITERATURA E KONSULTUAR:..... 452
PËRMBAJTJA..... 464